

# ENVER HOXHA

VEPRA

17



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE**



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

V E L L I M I

17

SHKURT 1959 - DHJETOR 1959

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1974



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 17

Vëllimi i 17-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin shkrime të vitit 1959. Në këtë vëllim ndër të tjera hyjnë: Raporti në Plenumin XIII të KQ të PPSH (18 shkurt 1959), Fjala në Konferencën e Partisë të Qytetit të Tiranës (15 mars 1959), Fjala e mbylljes në Plenumin XIV të KQ të PPSH mbi problemin e pyllëzimeve dhe të ujitjes (3 nëntor 1959), Fjala në mbledhjen solemne me rastin e 15-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë (28 Nëntor 1959), Fjala në Konferencën kombëtare për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës në fshat (16 dhjetor 1959), diskutime në mbledhje të Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të PPSH, biseda, letra etj. Një pjesë e këtyre materialeve botohen për herë të parë.

Viti 1959 ishte viti i katërt i pesëvjeçarit të dytë. Në këtë kohë Partia dhe populli luftonin për të plotësuar vendimet e Kongresit III të PPSH në të gjitha fushat, ekonomike dhe politike, ideologjike dhe shoqërore.

Në materialet e këtij vëllimi, krahas detyrave për të plotësuar para afatit planin e dytë pesëvjeçar, i kush-tohet rëndësi e madhe përmirësimit të cilësisë së pro-

dhimit, duke e konsideruar atë jo vetëm si një problem ekonomik, por dhe si një problem me rëndësi politike dhe ideologjike. Gjithashtu i kushtohet rëndësi e madhe forcimit të regjimit të kursimit dhe të ndërgjegjes socialiste në punë duke ia nënshtruar interesin vetjak interesave të shoqërisë.

Në fushën e bujqësisë krahas përfundimit të kolektivizimit në përgjithësi shtrohet domosdoshmëria e forcimit ekonomik dhe organizativ të kooperativave bujqësore dhe zmadhimi i tyre nëpërmjet bashkimit të kooperativave bujqësore të vogla. Në çështjen e zmadhimit të kooperativave, në praktikë u vërejtën edhe gabime, disa rrethe u nxituan dhe krijuan para kohe kooperativa bujqësore tepër të mëdha. Shoku Enver, duke parë dëmin që mund t'i shkaktoheshin çështjes së kolektivizimit të bujqësisë nga veprime të tilla, porosiste që zmadhimi të bëhej i studjuar, me hapa të matur dhe në bazë të vullnetit të lirë e të bindjes së plotë të kooperativistëve.

Në veprat që botohen në këtë vëllim një vend të rëndësishëm vazhdon të zërë lufta për demaskimin e imperializmit dhe të revizionizmit modern, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Udhëheqja revizioniste sovjetike vazhdonte të bënte presione që PPSH të ndryshonte kursin e saj marksist-leninist. Në këtë kohë udhëheqësit sovjetikë ngulnin këmbë që Partia jonë të ndërpriste luftën kundër revizionizmit modern dhe të hiqte dorë nga kursi marksist-leninist për të ndërtuar socializmin duke u mbështetur kryesisht në forcat e veta. Materialet e këtij vë-

llimi dëshmojnë qartë se PPSH nuk bëri asnjë lëshim dhe nuk hoqi dorë për asnjë çast nga vija e saj marksiste-leniniste. Duke demaskuar publikisht revizionizmin jugosllav, PPSH i drejtonte goditjet e veta edhe kundër kursit revizionist të udhëheqjes sovjetike. Ndërkohë në politikën ekonomike ajo vazhdoi të ndjekë dhe të respektojë me rigorozitet parimin e ndërtimit socialist të mbështetjes në forcat e veta. Në luftën për mbrojtjen e lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të revolucionit socialist, PPSH vlerësonte lart rolin e Partisë Komuniste Kineze dhe të Revolucionit të madh kinez duke e quajtur RP të Kinës një kështjellë të socializmit dhe një bazë të fuqishme të revolucionit botëror.

Në materialet e këtij vëllimi zënë një vend të rëndësishëm problemet e forcimit të jetës së brendshme të organizatave të Partisë, e ngritjes së nivelit ideologjik, politik dhe arsimor të komunistëve, e kalitjes së tyre nëpërmjet luftës kundër pikëpamjeve mikroborgjeze, frymës së tarafit dhe shfaqjeve të thyerjes së unitetit.

Në to u kushtohet rëndësi e madhe rritjes së vijilencës, problemit të ruajtjes së sekretit shtetëror dhe të Partisë dhe në mënyrë të veçantë forcimit dhe modernizimit të mëtejshëm të Ushtrisë Popullore për ta bërë atë një mbrojtëse të vendosur të fitoreve të arritura. Veprat e këtij vëllimi flasin qartë për kujdesin e vazhdueshëm të Partisë për të ruajtur dhe forcuar karakterin thellësisht popullor të forcave tona të armatosura, për domosdoshmërinë e lidhjeve të tyre me popullin, për kalitjen e tyre politike dhe ideologjike, për rolin udhëheqës të Partisë në ushtri.

*Veprat e shokut Enver të kësaj periudhe pasurojnë më tej përvojën e PPSH për ndërtimin e socializmit në një vend të vogël si vendi ynë dhe janë një dëshmi e qartë e luftës së saj të pandërprerë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për fitoren e socializmit dhe të komunizmit.*

**TË BËJMË BASHKIME TË KOOPERATIVAVE  
BUJQËSORE TË VOGLA, POR NË RADHË TË  
PARË TË PUNOJMË PËR TË FORCUAR  
KOOPERATIVAT EKZISTUESE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**16 shkurt 1959**

Në këtë mbledhje të Byrosë Politike mendoj të diskutojmë çështjen e bashkimit të kooperativave bujqësore, sepse muajt e fundit na duket se është nxituar në këtë drejtim. Mehmeti dhe unë kemi qenë jashtë shtetit dhe atje nëpërmjet shtypit mësuam se është bërë bashkimi i fshatrave të Konispolit, të Fierit dhe të Lushnjës. Me këtë rast, mendoj që në plenumin e ardhshëm kjo çështje të ngrihet në raport dhe t'u japim orientim shoqëve të Komitetit Qendror e sekretarëve të parë të komiteteve të Partisë të rretheve, që do të marrin pjesë në këtë mbledhje, se si të veprojnë lidhur me këtë çështje.

Sikurse dihet, për këtë problem, Plenumi i Komitetit Qendror ka marrë një vendim, sipas të cilit nuk

duhen bërë bashkime të kooperativave që kanë mesatarisht më tepër se 500-600 ha. Pra fryma e këtij vendimi ishte që të mos kalohej në bashkime të mëdha kooperativash, por të procedohej në bashkime të kooperativave të vogla dhe kjo t'i shërbente forcimit organizativo-ekonomik të kooperativave.

Sipas mendimit tim, ky bashkim duhet të jetë një proces i gjatë dhe i zbatueshëm në kushtet tona reale të kolektivizimit. Ne duhet të bazohemi në gjendjen që ekziston. Cila është gjendja? Kemi 12 vjet që po punojmë për kolektivizimin e bujqësisë. Në këtë punë kemi pasur suksese, kemi pasur edhe dobësi. Brenda dy vjetëve të fundit arritëm të kolektivizojmë 75 për qind të ekonomive bujqësore, është forcuar udhëheqja e kooperativave, janë rritur rendimentet etj. etj. rezultate pozitive. Por këto suksese nuk duhet të na bëjnë të harrojmë dobësitë e mëdha që ekzistojnë në kooperativat tona. Për këtë, Komiteti Qendror ka caktuar detyrë që të punohet për forcimin e gjithanshëm të kooperativave ekzistuese, duke dërguar në to kuadro, duke punuar për të rritur rendimentet dhe për të përfunduar kolektivizimin në fushë. Prandaj, në kushte të tilla këto janë detyrat kryesore që duhet të qëndrojnë në plan të parë dhe jo çështja e bashkimit të kooperativave bujqësore.

Komiteti Qendror ka theksuar që bashkimet e kooperativave të fillojnë, por me shumë kujdes, atje ku është e nevojshme dhe ku kushtet janë të përshtatshme. Kemi thënë që në fillim të bëhen bashkime të vogla, bashkime lagjesh, dy-tri fshatra bashkë, që janë afër njëri-tjetrit, dhe gradualisht të kalohet në bashkime më të mëdha, por pasi të jenë parë kushtet, që do

të thotë pasi të jenë forcuar kooperativat ekzistuese. Kurse bashkimi i kooperativave që është bërë në Fier, me tendencë që këto bashkime të përfundojnë brenda dy-tre vjetësh, nuk është aspak në rrugë të drejtë, sepse nuk është vetëm çështja e agroteknikës dhe e kuadrit, por ka edhe shumë gjëra të tjera, të cilat duhet të zgjidhen më parë e të përgatitet terreni.

Partia jonë ka një eksperiencë të madhe në përpunimin dhe në zbatimin e direktivave të saja. Ajo i shoqëron ato kurdoherë me një varg masash politike e organizative, kurse për bashkimin e kooperativave nuk është menduar si duhet.

Të marrim, për shembull, disa probleme që dalin në kooperativën e bashkuar të Konispolit. Në radhë të parë është çështja e ndërtimit të Partisë. Si do të funksionojë organizata-bazë e Partisë? Sipas statutit dhe rregullave në fuqi, në çdo kooperativë duhet të ketë një organizatë-bazë. Po kush do ta drejtojë organizatën? Do të ketë byro apo si do të jetë? Ja një çështje për të cilën nuk është menduar.

Çështje tjetër është ajo e asamblesë së kooperativës. Në bazë të statutit kooperativat duhet të udhëhiqen nga asambleja e tyre; ndërsa tani është marrë një vendim, sipas të cilit, për bashkimin e kooperativave të mbledhen jo asamblatë, por 10-15 të deleguar nga çdo kooperativë e veçantë, të cilët do të zgjedhin edhe kryesinë e kooperativës së bashkuar, gjë që mendoj se s'mund t'u lihet disa delegatëve, por vetëm asamblesë së përgjithshme. Këto janë çështje të rëndësishme parimore, shokë, të cilat duhet të zbatohen pasi t'i vendosë Byroja Politike.

Ka dhe çështje të tjera për të cilat duhet menduar se si do të zgjidhen, pastaj të veprohet për bashkim. Të tilla janë për shembull: si do të ndërtohet pushteti dhe si do të organizohet drejtimi ekonomik në këto kooperativa? Këtu lindin një sërë problemesh organizative dhe financiare siç janë: çështja e normave dhe shpërblimet, organizimi i brigadave, zgjedhja e kryetarëve, si do të punojnë kooperativat e mëparshme, a do të jenë sektorë, apo do të mbahet po ajo formë organizimi etj. Thuhet se do të ketë një, dy ose tre nënkryetarë, po kush e thotë këtë? Këto duhet t'i vendosë Partia dhe qeveria. Ata që dërgohen në një kooperativë për t'u zgjedhur në drejtim të saj, mund të jenë për një kohë si të deleguar dhe të mbeten më vonë, duke u zgjedhur, dikush si kryetar, tjetri si sekretar i organizatës-bazë.

Probleme të tilla ka plot dhe të tjera do të dalin më vonë, për të cilat jeta do të thotë fjalën e saj. Por për këto probleme asnjëri s'ka menduar si duhet. Prandaj unë them se në drejtim të bashkimit të kooperativave është shpejtuar dhe shokët nuk janë thëlluar. Ne nuk duhet të nisemi nga dëshira, por ta shikojmë çështjen drejt e të merren qysh më parë masat e nevojshme politike e organizative.

Orientimi i Komitetit Qendror për bashkimin e kooperativave bujqësore duhet të qëndrojë siç ka qenë. Propozoj që kooperativat e bashkuara kohët e fundit të shikohen një për një dhe të prishen ato që janë bërë para kohe, duke krijuar në vend të tyre 2-3 kooperativa. Këtë çështje të venë për ta shikuar në vend



ministri i Bujqësisë dhe drejtori i Drejtorisë së bujqësisë në aparatën e KQ. Shokët e Sarandës kanë pyetur edhe shokun Hysni, i cili i ka kritikuar për mendimet që kishin lidhur me bashkimet, por megjithëkëtë, këto bashkime u bënë. Në qoftë se pyetem edhe unë, them se këto bashkime duhet t'i korrigojmë, prandaj ta bisedojmë dhe të veprojmë si të vendosë Byroja Politike. Mendimi im personal është se nuk na ngut gjë, por bashkime të bëjmë, kur të kemi forcuar kooperativat ekzistuese, kur ato të kenë arritur rezultate të mira dhe të kemi fituar eksperiencë.

Më tha Haku [Toska] se duan të bashkohen dy kooperativat, e Goranxisë dhe e Libohovës. Unë them që këto dy kooperativa vështirë se mund të bashkohen. Po të bëjmë bashkime të tilla, do të ngrihet edhe Shkodra e do të thotë: «Mbeta pas, ma kaluan rrethet e tjera»! Dhe do të shpejtojë për bashkime. Mirëpo ne e dimë se ky rreth ka dobësi në kolektivizim dhe, në vend që të luftojë për të shtuar numrin e anëtarëve e të forcojë kooperativat që ka ngritur, do të merret me bashkime. Po kështu edhe rrethi i Elbasanit etj., që bëjnë propozime për bashkime, sepse kanë mbetur pas dhe gjoja këtë e kërkon populli, fshatarësia.

Kjo çështje është serioze. Prandaj duhet të bëjmë korrigjimet e nevojshme, t'u themi Partisë dhe asamblesë që t'i futen punës për të realizuar planin. Ne do të dërgojmë njerëz në vend për t'i parë bashkimet që janë bërë dhe, ato që do të gjenden me vend, le të qëndrojnë të bashkuara, atje ku bashkimi sot dëmton prodhimin, do t'u themi kur të vijë vjeshta. Atje ku janë 2-3 fshatra

mund t'i pranojmë këto bashkime, por kjo çështje jo të na preokupojë si një fushatë e të lëmë prodhimin. Kështu t'i shtrojmë çështjet në plenum dhe t'i këshillojmë e t'i orientojmë drejt shokët.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verball i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **TE REALIZOJMË ME SUKSES DHE PARA AFATIT PLANIN E SHTETIT PËR VITIN 1959**

*Nga raporti në Plenumin XIII të KQ të PPSH*

**18 shkurt 1959**

Shokë,

Detyra jonë e ngutshme dhe më kryesore, siç e theksoi edhe Plenumi i fundit i Komitetit Qendror, është që të realizojmë me sukses dhe para afatit planin e shtetit për vitin 1959 që është viti vendimtar për përfundimin e mirë të të gjithë pesëvjeçarit të dytë. Viti 1959 është edhe viti i 15-vjetorit të Çlirimit të atdheut tonë, viti i festës së madhe të popullit. Mënyra më e mirë për ta festuar këtë jubile të rëndësishëm është realizimi i detyrave që ne i kemi vënë përpara vetes sonë dhe që shprehen në planin e shtetit.

Kemi hyrë në muajin e dytë të vitit dhe që tani mund të gjykojmë se si po realizohen detyrat që shtruan në plenum. Duhet theksuar se gjatë muajit janar shumë ndërmarrje i kanë realizuar mirë detyrat e tyre. Kështu p.sh. e kanë realizuar e tejkaluar planin minierat e

qymyrit, kombinati i tekstileve «Stalin», miniera e Selenicës e shumë të tjera. Qarkullimi i mallrave, si nga sistemi i tregtisë shtetërore, ashtu edhe kooperativiste është realizuar e tejkaluar etj.

Por ka një numër të madh ndërmarrjesh e sektoreësh të ndryshëm të cilët nuk e kanë filluar mbarë vitin 1959. Kështu p.sh. industria e naftës nuk e ka realizuar planin e janarit. Kështu ndodh edhe me minierat e kromit dhe të bakrit, me NISH-Këpucën në Tiranë etj. Prapa janë veçanërisht ndërtimet që kanë realizuar planin vetëm 75 për qind dhe ndërmarrjet e transportit etj.

Ne duhet të marrim masa që në fillim për të vënë në pozita luftarake organizatat e Partisë dhe organet e ndryshme të pushtetit, duke filluar që nga ministrinë e aparatit qendror. Duhet të kërkohet me insistim realizimi ritmik i planit. Kjo është garancia që detyrat, të cilat parashikohen për gjithë vitin, të realizohen me sukses. Çfarë duhet të kenë parasysh shokët e Partisë dhe të pushtetit?

1. — Të luftohet tendenca e justifikimeve për mosrealizimin e planit, duke mobilizuar më mirë komunistët në radhë të parë dhe gjithë punonjësit, për të luftuar kundër vështirësive.

2. — Të merren masa, duke filluar që nga përgjegjësit e organeve qendrore, për një organizim më të mirë të punës. Realizimi i planit duhet të ndiqet çdo ditë. Drejtuesit e ndërmarrjeve, të reparteve dhe çdo punëtor që në darkë duhet të dinë se ç'duhet të bëjnë të nesërmen. Drejtuesit ekonomikë duhet të sigurojnë me

kohë rezervat e materialeve të nevojshme për kryerjen e detyrave.

3. — T'i kushtohet më shumë kujdes, nga organet e Partisë dhe ato ekonomike, veçanërisht nga bashkimet profesionale, organizimit më të mirë të emulacionit socialist. Duhet të merren masa që të përdoren më mirë të gjitha format e propagandës për emulacionin, me qëllim që ky të bëhet me të vërtetë forcë lëvizëse për realizimin e detyrave. Të inkurajohen inisiativat krijuese që ndërmarrin punonjësit për realizimin e planit.

4. — T'i kushtohet kujdes i vazhdueshëm, nga komitetet e Partisë dhe nga organizatat-bazë, zbulimit të rezervave të brendshme dhe planifikimit të shfrytëzimit të tyre, me qëllim që të krijohen mundësi edhe më të mëdha, jo vetëm për realizimin e planit, por edhe për tejkalimin e tij.

Unë tërhoqa vëmendjen tuaj, shokë, në çështjet e mësipërme, por ne duhet të luftojmë për të vënë në jetë të gjitha vendimet e rëndësishme që aprovoi Plenumi i fundit i Komitetit Qendror.

Përsa u përket detyrave në fushën e bujqësisë ne duhet të luftojmë për vënien në jetë të vendimeve që kemi marrë. Por në mënyrë të posaçme unë dua të tërheq vëmendjen në këto çështje:

1. — Organet e Partisë dhe të pushtetit duhet të mobilizohen më mirë për të përfituar nga koha e mirë e këtyre ditëve për të kryer detyrat e kohës në bujqësi. Në këtë drejtim të punohet veçanërisht për hapjen e tokave të reja, duke mos pritur që gjithçka të bëhet me traktor.

2. — Të fillohet më shpejt nga punimi i tokave për

mbjelljet pranverore. Në radhë të parë të merren masa që të jenë në gatishmëri të gjithë traktorët, plugjet dhe makinat bujqësore, të vazhdojë puna e filluar për qilizëm (për misër e kulturat e tjera pranverore), të sigurohen farërat e përshtatshme për çdo kooperativë, të shtohet kujdesi për farishtet e duhanit dhe shfrytëzimin më të mirë të plehrave.

3. — Në mënyrë të veçantë dua të ndalem në çështjen e kolektivizimit të bujqësisë. Duhet theksuar se nga sukseset që u arritën gjatë vitit 1957 dhe në fillim të vitit 1958 disa shokë filluan të flenë mbi dafina ose të dehen nga sukseset. Kjo gjë shihet nga fakti se gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 1958 në të gjithë Republikën u krijuan vetëm 11 kooperativa të reja. E keqja është se edhe fillimi i vitit 1959 nuk po na sjell ndonjë ndryshim në këtë drejtim. Përkundrazi kjo detyrë është lënë pas dore dhe shumë shokë, të rrëmbyer nga një entuziazëm pa vend, i janë vënë punës për të krijuar kooperativa të bashkuara, të pastudjuara mirë, sikur ky të ishte problemi kryesor i ditës te ne.

Komiteti Qendror i ka përcaktuar drejt detyrat lidhur me kolektivizimin. Çështjet kryesore lidhur me kolektivizimin janë: e para, të luftojmë për forcimin organizativo-ekonomik të kooperativave ekzistuese, të cilat, siç dihet, kanë akoma dobësi të mëdha, dhe e dyta, të punohet për përfundimin e kolektivizimit, duke pasur parasysh vendimet e Kongresit III të Partisë dhe vendimet e mëvonshme të Komitetit Qendror të Partisë, duke ngritur kooperativa të reja dhe duke shtuar numrin e anëtarëve në kooperativat ekzistuese nga radhët e atyre që akoma qëndrojnë jashtë kooperativave bujqësore.

Këto detyra theksoi edhe Plenumi i fundit i Komitetit Qendror të Partisë. Por praktika po tregon se zbatimi i tyre është lënë mënjanë. Komiteti Qendror foli edhe për çështjen e bashkimit, por jo në atë mënyrë si po veprohet nga disa komitete partie.

Lidhur me këtë çështje përfitoj nga rasti që ndodhen në këtë mbledhje edhe sekretarët e parë të komiteteve të Partisë në rrethe për t'i këshilluar ata për një interpretim dhe një zbatim më të drejtë në praktikë të vendimit të fundit të Komitetit Qendror në lidhje me bashkimin e kooperativave bujqësore. Interpretimi që i bëhet aktualisht këtij vendimi s'është i drejtë dhe si rrjedhim zbatimi i tij në praktikë, në mjaft raste, është i gabuar dhe i shpejtuar. Çështja po merr rrugën e një fushate.

Bashkimi i kooperativave është një proces i tërë dhe në kushtet tona aktuale nuk është një problem shumë i ngutshëm, ai është një perspektivë relativisht e afërt, por që më parë duhet të krijojmë kushtet objektive. Direktiva e Komitetit Qendror nuk ka për qëllim që brenda një ose dy vjetësh të përfundojë kjo çështje, siç kanë në mendje Fieri dhe disa rrethe të tjera; direktiva ka për qëllim që të fillohet kjo çështje me shumë kujdes, duke kaluar gradualisht nga bashkime të vogla, nga bashkime lagjesh që tani janë kooperativa të veçuara, në bashkime me kooperativën më të madhe afër, duke bashkuar fundi edhe dy kooperativa bashkë afër njëra-tjetrës, dhe, duke fituar eksperiencë, gradualisht të kalojmë në tri e më shumë kooperativa. Dhe një proces i tillë duhet të zhvillohet në fushë dhe jo në malësi.

Ç'ka ngjarë këto kohët e fundit? Drejt e në thela! Jo vetëm që janë bashkuar një e dy kooperativa, në mal e në fushë, por janë bashkuar lokalitete të tëra me 9, 11 dhe deri 17 fshatra, me 3-4 mijë hektarë tokë. Kjo çështje ka filluar të bëhet preokupante dhe detyrat kryesore për kolektivizimin, siç janë forcimi organizativ, teknik, agroteknik i kooperativave, ngritja e nivelit agroteknik dhe e rendimenteve të kulturave, si dhe mbarimi sivjet i kolektivizimit në fusha, të lihen deri diku pas dore dhe të mbulohen me këtë preokupacion të ri që ka filluar të dalë në plan të parë.

E gjithë kjo nuk është reale dhe s'është e drejtë. Direktiva e Komitetit Qendror në lidhje me bashkimin e kooperativave nuk ka këtë qëllim, por ka për qëllim të forcojë në përgjithësi kooperativat, ngritjen e rendimenteve, forcimin organizativ dhe të drejtimit, në mënyrë reale dhe jo vetëm të shohim anën teorike, pse disa shokë pretendojnë «t'i bashkojmë kooperativat pa frikë se kjo punë do të na e rregullojë çdo gjë, ka entuziazëm të madh në fshatarësi dhe kooperativat kështu të bashkuara do të drejtohen më mirë nga kryesia e re ku kemi dërguar një njeri, dhe nga rrethi, gjithashtu, do të drejtohet më mirë, do të shkurtojmë shpenzimet etj. etj.». Shokë, të gjitha këto arsye time janë të drejta në parim, por nuk mund të arrihen në kushtet tona aktuale në rast se jemi realistë, në rast se i shikojmë drejt kushtet tona konkrete dhe kështu duhet t'i shikojmë. Realiteti ynë me pak fjalë është ky: ne kemi suksese në kolektivizim edhe për arsye se kemi ecur me kujdes dhe kemi bërë pak gabime, për të mos thënë fare. Ne duhet ta mbarojmë kolektivizimin këtë vit në



fusha. Ne kemi kooperativa të vjetra, por shumicën i kemi të reja. Fakt është se kolektivizimi ka bërë që të rritet numri i kulturave që mbillen, të rriten rendimentet, ka përmirësuar jetën e fshatarësisë. Ne në çdo kooperativë kemi organizata partie, rinie, kemi tani një udhëheqje që preokupohet seriozisht për mbarëvajtjen e punës. Të gjitha këto organe po fitojnë eksperiencë. Pra, kemi një bazë të mirë dhe po punohet me entuziazëm. Këto janë fakte dhe ky është realiteti.

Por këto suksese nuk duhet të na bëjnë të harrojmë dobësitë e mëdha në kooperativat tona që janë: njohuritë shumë të ulëta agroteknike në kuadrot dhe në masën e kooperativistëve, drejtimi organizativ dhe agroteknik është shumë i dobët, disiplina në punë është prapa, shumë masa agroteknike vendimtare për kooperativën s'janë vendosur akoma, nuk është forcuar ndjenja e punës dhe e jetës kolektive në kooperativat. Sëmundjet e fillimit, si ambiciet ndaj kryetarëve, ndaj kryesisë, tarafet në kooperativë, e bile disa herë edhe në gjirin e organizatave të Partisë, jo vetëm që s'janë zhdukur akoma, por vazhdimisht ka shfaqje kundër të cilave lufton me sukses Partia. Shumica e kuadrove tanë drejtues janë pa shkolle bujqësore, shumë me shkolla fillore, ata kanë vetëm njohuri praktike në bujqësi, fundi ata janë të aftë për të drejtuar një ekonomi të përbashkët, por relativisht të vogël. Ne kemi në rreth shumë pak teknikë të lartë bujqësorë e blegtoralë dhe një numër të paktë teknikësh të mesëm të bujqësisë. Përveç këtyre, çdo kooperativë te ne, qoftë ajo e madhe ose e vogël, ka një gamë të tërë aktivitetesh mjaft të

komplikuara dhe akoma të pavëna në rrugën e zgjidhjes së kënaqshme. S'duhet, më në fund, të harrojmë mentalitetin individualist të fshatit si kooperativë, të mos harrojmë se na kanë ngjarë edhe gjëra të papëlqyera për një copë kullotë ose për një vijë uji. Këtë situatë nuk duhet kurrsesi ta harrojmë.

Tani shtrohet çështja: cili është problemi aktual më preokupant, bashkimi i kooperativave në këtë frymë që po kërkohet të ecet, apo forcimi i gjithanshëm i kooperativave? Sigurisht ky i dyti. Disa shokë mund të mendojnë se pikërisht duke i bashkuar ne do t'i forcojmë kooperativat bujqësore. Ky gjykim aktualisht nuk është real. Bashkimi i një shumice kooperativash, në kushtet tona aktuale, nuk është real. Një bashkim i tillë në vend që të na i forcojë kooperativat, ka shumë mundësi që të na i dobësojë.

Kur ne t'i kemi në një shkallë më të lartë kooperativat, kur të forcojmë më mirë punën e brigadave dhe të zbatojmë vendimet e shumta që kemi marrë për lidhjen e ngushtë të interesit të përgjithshëm të kooperativës me interesin personal të kooperativistit, kur ne të ngremë edhe më lart nivelin e njohurive agroteknike, kur të përmirësojmë drejtimet e kulturave dhe të aktiviteteve ndihmëse, kur të ngremë akoma më shumë ndjenjën e përgjegjësisë në punë, dashurinë për punën dhe për pronën socialiste, atëherë bashkimi do të jetë i frytshëm, i nevojshëm, i domosdoshëm.

Por ka kooperativa shumë të vogla, mund të thuhet. Jemi të detyruar ta pranojmë edhe për një kohë këtë realitet derisa të përmirësojmë kushtet. Nga e reja ne nuk duhet të kemi frikë, s'duhet të ngurrojmë,

por kjo s'do të thotë të ecim pa i matur punët, pa i peshuar. Qëllimi është të bëjmë mirë, t'i sjellim përmirësim çështjes së madhe dhe të koklavitur të bujqësisë sonë. Partia, shokë, ka punuar me të gjitha forcat 12 vjet të tërë për kolektivizimin dhe ka punuar mirë, ka arritur suksese kolosale. Këto suksese duhet jo vetëm t'i ruajmë, por edhe t'i shtojmë çdo ditë e më shumë, pa i dëmtuar.

Partia lufton në kooperativa dhe udhëheqja e kooperativave mund të themi se ka hyrë në rrugën e mirë të drejtimit të një ekonomie të madhe. Por të gjithë e dimë se dobësi ka edhe tani që kryesia qëndron në krye të punës, afër punës dhe njerëzve, nën drejtimin dhe kontrollin e asamblesë së kooperativës. Tani ne ç'kërkojmë të bëjmë? Në këto kushte akoma të papërshtatshme ia heqim kokën kooperativës dhe i vëmë një kokë të re, shumë larg kooperativës dhe jemi të kënaqur pse dërguam një kuadër nga rrethi, i cili mund të jetë i mirë, por që, sipas mendimit tim, i duhen të paktën dy vjet të marrë si duhet në dorë drejtimin e 4 mijë hektarëve dhe kjo, se shumica e njerëzve që dërgojmë nuk kanë shkollën përkatëse bujqësore, jo të lartë, po as të mesme bujqësore.

Shokë, po t'i hedhim një sy veprimtarisë së Partisë sonë, do të shohim se ajo çdo direktivë që ka marrë e ka shoqëruar kurdoherë me masa organizative, përndryshe direktiva dështon në zbatimin e saj. Kjo direktivë e rëndësishme e Komitetit Qendror, në lidhje me bashkimin e kooperativave, jo vetëm që nuk interpretohet drejt, jo vetëm komitetet e Partisë në rrethe dhe sekretarët e tyre nuk e kanë përgatitur këtë çështje

ashtu si u këshillua nga plenumi i fundit, por as Drejtoria e bujqësisë pranë Komitetit Qendror dhe as Ministria e Bujqësisë nuk i kanë përpunuar masat organizative për një çështje kaq të rëndësishme. Kam përshtypjen se s'po e vëmë ujët në zjarr për këtë çështje.

Shumë çështje dalin dhe do të dalin më vonë, lidhur me këtë problem. Kur është çështja e bashkimit të një lagje ose të dy lagjeve me kooperativën më të afërt, ose kur është çështja e bashkimit të dy kooperativave afër njëra-tjetrës edhe këtu dalin disa probleme, por këto s'janë shumë preokupante që të mendojmë për masa organizative të tjera, sido që edhe për këto diçka duhet menduar, po këtu bëhet fjalë kur ne bashkojmë një sërë fshatrash.

Si do të organizohen dhe si do të drejtohen këto kooperativa? Të marrim, për shembull, kooperativën e bashkuar të Konispolit. Kjo u formua, bile dhe pa aprovimin e Komitetit Qendror u dërgua shoku [Gaqo] Lula si kryetar, u zgjodh ky nga një asamble jo e rregullt, ku çdo kooperativë kishte dërguar nga 10 ose 20 përfaqësues dhe bashkimi mbaroi. Kësaj i thonë punë e papjekur dhe e rrezikshme.

Pikësëpari këto çështje janë në kompetencë të Byrosë Politike dhe të qeverisë dhe këto duhet të marrin shumë vendime për çështje të tilla parimore. E para, si do të funksionojë organizata e Partisë në Konispol, çfarë udhëheqje do të ketë kjo organizatë? Ka ligje dhe rregulla në Parti për këto çështje që në asnjë mënyrë s'lejohet të shkelen e as të mbeten varur dhe në forma anarkike. Asnjë propozim i studjuar nga poshtë, i përsh-

tatshëm me situatën, nuk i ka ardhur Komitetit Qendror për këtë.

Si do të funksionojë asambleja e kooperativës së bashkuar të Konispolit dhe si do të përbëhet ajo? Për këtë çështje duhet të marrë vendim Komiteti Qendror, se është një çështje nga më parimore. Vendimi që është marrë është një vendim jo i studjuar mirë. A do të ketë asamble në kooperativat e veçanta të kooperativës së bashkuar të Konispolit? Edhe këtë duhet ta vendosë Komiteti Qendror. Ish-kooperativat bujqësore të kooperativës së bashkuar të Konispolit si do të punojnë, si unitete të veçanta, apo si sektorë dhe këta sektorë, ku kultivohen kultura të ndryshme, do të shkrihen në të gjithë kooperativën apo do të përmbliidhen në unitetin e ish-kooperativës? Këtu hyn çështja e brigadave të ndryshme, si do të krijohen këto, si do të drejtohen, ç'lidhje do të kenë me kompleksin e gjithë kooperativës? Aktivitetet ndihmëse si do të organizohen, si do të lidhen me të gjithë kooperativën?

Këto janë çështje shumë të rëndësishme për të cilat asnjëri s'ka menduar, ose ka menduar përciptas. Këto lypin gjykime dhe vendime nga udhëheqja, sipas formave organizative që do të vendosen, se ato krijojnë marrëdhënie ekonomike të veçanta dhe të ndryshme nga të parat. Këtu lindin çështje financiare me shumë rëndësi për një ekonomi të madhe, duhet të ndryshohen raportet në pagesat, në stimulet e brigadierëve, të kryetarit të kooperativës, të ndihmësve të tij, të cilat duhen caktuar me ligj sa do të jenë, si do të jenë, ku do të jenë etj. Mbajtja e llogarive në kooperativë është një problem me rëndësi shumë të madhe, problem kyç. Një

mijë probleme të tilla na dalin tani dhe do të ketë plot të tjera që do të na i nxjerrë më vonë jeta. Por për këto kryesoret asnjëri s'ka menduar. Kjo shokë nuk është serioze.

Me një kalem do të vendosim ne që me mijëra kryetarë kooperativash t'i çojmë brigadierë pa një punë përgatitore? Shokë sekretarë, ju pyes ju, që keni eksperiencë nga baza dhe nga njerëzit, është serioze kjo punë? Do ta kuptojnë vallë këtë ulje këta njerëz pa i përgatitur më parë? Mos harroni, shokë, anën financiare të çështjes dhe mos u ngopni vetëm me një aprovim të tyre. Më vonë, në rast se Partia nuk vepron me kujdes, me durim, me sqarim, siç ka punuar për shumë raste analoge, ne do të dëmtohem. Përse, pra, të dëmtohem, pse të bëjmë gjëra të shpejtuara, pse ta interpretojmë gabim direktivën e Komitetit Qendror për këtë çështje, kur neve Komiteti Qendror na i ka bërë të qarta detyrat aktuale në bujqësi?

Sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve, siç më kanë raportuar, janë shumë entuziastë dhe thonë se me bashkimin e kooperativave ata do të drejtojnë më mirë. Në qoftë se mendojnë për një drejtim formal dhe përgjegjësinë ua hedhin shokëve që kanë dërguar në krye të kooperativave të bashkuara atëherë kjo është e vërtetë, bëhet më e lehtë për ta. Por shokët sekretarë kanë eksperiencë dhe duhet ta dinë se nuk do të jetë kështu. Tani me të vërtetë ne kemi një kokë në kooperativën e Konispolit, por të nëntë ose dhjetë kooperativat e djeshme, ku ti shoku sekretar shkoje në tri ditë një herë, tani kanë mbetur pa kokë të afërt, atje ka vetëm brigadierë të pakalitur në një punë ashtu siç

e kërkojnë kushtet e bashkimit. Në rast se mban lidhje vetëm me shokun Lula, mbaroi puna, por tash do të duhet të mbash lidhje me brigadierët bile, se ata kërkojnë shumë ndihmë. Dhe ki parasysht se kryetari i kooperativës së bashkuar s'ka as telefon as automjet, bile edhe për kalin që do të marrë, do të gjenden gjuhë të papjekura që do ta kritikojnë se mbeti mbi kalë etj.

Prandaj shokë të mos shpejtohem në këtë çështje, të ecim me kujdes, të krijojmë kushtet, të mendojmë seriozisht për masat organizative, t'i përmirësojmë këto masa nga eksperiencia në punë. Çështjen e bashkimit të kooperativave të mos e lëmë pas dore, se atëherë do të gabojmë, po të fillojmë së pari të bashkojmë disa lagje me një kooperativë, të bashkojmë dy kooperativa, të bashkojmë fundi tri dhe këto jo në formë fushate, po me baza të shëndosha, të shoqëruara me masa organizative, teknike dhe me kuadro. Të fitojmë eksperiencë dhe gjatë kësaj kohe të rritim kuadro të rinj, qoftë në drejtimin konkret të kooperativës, qoftë në shkolla të ndryshme bujqësore, të cilat duhet të studjojnë programet për një aktivizim e zgjerim më të madh për perspektivën e bashkimit.

Një hap i tillë i matur dhe gradual, jo vetëm nuk duhet të na bëjë të harrojmë detyrat për forcimin e gjithanshëm të kooperativave dhe për mbarimin e kolektivizimit në fusha, por ky bashkim në këtë rrugë graduale të ndihmojë konkretisht në këto dy detyra kryesore aktuale, të ngutshme.

Të gjitha kooperativat e bashkuara aktuale duhet të rishqyrtohen me kujdes të madh nga komitetet e

Partisë në rrethe, në bashkëpunim konkret në bazë nga një ekip i Drejtorisë së bujqësisë pranë Komitetit Qendror dhe i Ministrisë së Bujqësisë. Ky rishikim duhet të bëhet shpejt dhe në frymën që thamë më lart. Kooperativat e mëdha, si ajo e Konispolit, e Cakranit etj., duhet të riorganizohen dhe në vend të tyre, në baza të shëndosha, të krijohen nga 2-3 ose 4 kooperativa.

Qëndron kurdoherë në fuqi vendimi se për çdo propozim të matur dhe të drejtë për bashkim kooperativash duhet të merret aprovimi i Drejtorisë së bujqësisë pranë aparatit të Komitetit Qendror. Pa këtë aprovim nuk mund të lejohet dhe është shumë gabim kur dëgjohen propozime të atilla që i bëjnë pa pyetur Partinë. Atëherë duhet kuptuar sikur këto masa që ne marrim për mbarëvajtjen e kolektivizimit janë të gabuara dhe s'i aprovon masa. Kjo as ka qenë dhe as është reale dhe masa e Partisë të gjitha i ka kuptuar, i ka aprovuar, dhe të gjitha i ka gjetur me vend fshatarësia jonë. Dhe një hap i tillë i matur në bashkimin e kooperativave është një masë shumë e drejtë që fshatarësia do ta aprovojë. Masën tjetër të shpejtuar ajo nuk do ta aprovojë. Një aprovim i përciptë e formal neve nuk na duhet dhe të jemi shumë vigjilentë ndaj veprimeve të përcipta ose të shpejtuara.

Këtë interpretim dhe këto rekomandime bën Byroja Politike në zbatimin e vendimit të Plenumit të fundit të Komitetit Qendror, në lidhje me bashkimin e kooperativave. Ne jemi në fillim të kësaj çështjeje dhe fillimi i mirë luan një rol të madh për të ardhshmen. Disa mund të mendojnë se ne tërhiqemi. Ne s'tërhiqemi aspak nga direktiva e Komitetit Qendror, se ajo është e drejtë.



Ose mund të mendohet se ne do të kemi humbje politike. Ne nuk mund të kuptojmë përse do të kemi humbje politike për një çështje që sapo e fillojmë, dhe e fillojmë drejt duke mënjanuar që në lindje gabimet që mund të na kushtojnë shtrenjtë më vonë. Të jemi të bindur se fshatarësisë sonë kooperativiste nuk i pëlqejnë gjërat e nxituara, sidomos kur nuk sheh konkretisht në praktikë dobinë e një veprimi dhe veçanërisht të bashkimit të kooperativave në një shkallë të gjerë. Kur ne të organizojmë një propagandë të zgjuar e të veprojmë për bashkimin ashtu si na këshillon Komiteti Qendror dhe Byroja Politike, kooperativistët do ta kuptojnë thelbin e çështjes, njëkohësisht do të binden më mirë nga jeta, nga praktika dhe Partia do të fitojë eksperiencë, do të ketë kohë të përgatitet, të marrë masa të mëtijshme në çështjen e bashkimit të kooperativave.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# **TË ORGANIZOJMË DHE TË ZHVILLOJMË MË MIRË PUNËN SHKENCORE NË UNIVERSITETIN SHTETËROR TË TIRANËS**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**20 shkurt 1959**

Unë mendoj se të gjithë shokët e Byrosë Politike janë dakord me çështjet që ngrenë shokët e universitetit. Puna shkencore duhet zhvilluar në baza të drejta. Nëse do të shtohen disa kuadro për këtë qëllim, tani ose në vitin 1960, është një gjë tjetër. Çështja është që ne të jemi dakord parimisht për zhvillimin e punës shkencore dhe t'i lëmë kompetencë Ministrisë së Arsimit që të marrë të gjitha masat e nevojshme. Kjo duhet bërë për të zhvilluar gjithnjë e më shumë ekonominë tonë.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u diskutua mbi disa çështje të punës shkencore në Universitetin Shtetëror të Tiranës, sipas raportit të paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës.

Shokët e universitetit duhet të na kuptojnë se ç'vështirësi kemi për kuadro, prandaj nuk mund t'ua plotësojmë të gjitha kërkesat që na bëjnë. Edhe vërejtjet që bëri shoku Spiro Koleka për çështjen e kuadrit, nisen nga vështirësitë që kemi sot në vendin tonë. Megjithëse jemi ngushtë, disa kuadro do t'ua japim, sepse edhe ata kanë nevojë, se deri tani kushtet na kanë detyruar të marrim si pedagogë njerëz të rinj, kurse këtej e tutje mund të marrim më të vjetër e më të përgatitur.

Ngritjen e sektorëve për punën shkencore nuk duhet ta ngatërrojmë me atë që bën Komiteti Shtetëror i Gjeologjisë. Universiteti mund të ngarkohet të bëjë disa studime me afate të gjata, ndërsa Komiteti Shtetëror i Gjeologjisë nga ana e tij, mund të organizojë sesione shkencore duke aktivizuar gjithë inxhinierët gjeologë.

Edhe laboratorët janë të nevojshëm. Ne mund të bëjmë shkurtime në disa vende të tjera por jo në laboratorët, pa të cilët nuk bëhet puna shkencore. Ne nuk themi t'i pajisim laboratorët që tani si në Bashkimin Sovjetik ose në Çekoslovaki, por sipas kushteve tona. Edhe bibliotekën e universitetit duhet ta krijojmë, por Partia duhet të punojë që t'u nxitë studentëve dëshirën për studime serioze, krijuese dhe jo t'i marrin gjërat të gatshme e t'i hedhin në kartë.

Lidhja e punës praktike me punën shkencore është gjëja e parë që kërkon Partia, e cila në këtë fushë duhet të insistojë. Gjithë inxhinierët dhe teknikët që punojnë në miniera dhe në vendet e tjera duhet të lidhen me universitetin dhe anasjelltas. Kështu do të bëhet më mirë lidhja e punës praktike me punën shkencore.

Prandaj në universitet dhe në shkollat e tjera duhet bërë punë shkencore e praktike në bazë të kushteve tona, duke marrë edhe eksperimentin e vendeve të tjera.

Të aprovojmë, shokë, në përgjithësi këtë raport me vërejtjet që u bënë këtu nga shokët e Byrosë Politike dhe të ngarkojmë Ministrinë e Arsimit dhe Drejtorinë e arsimit e të kulturës të KQ të PPSH që të përgatitin vendimin përkatës duke caktuar edhe afatet. Kështu do të organizohet dhe do të zhvillohet më tej puna shkencore në universitet.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**NGA FJALA NË SESIONIN III TË LEGJISLATURËS  
SË KATËRT TË KUVENDIT POPULLOR  
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË**

**3 mars 1959**

Shokë deputetë,

Sesioni i zakonshëm i Kuvendit tonë Popullor është mbledhur për të shqyrtuar dhe aprovuar buxhetin e shtetit të këtij viti. Në jetën e një vendi socialist p'ani dhe buxheti vjetor janë ngjarje me rëndësi të madhe, sepse në planin dhe buxhetin përcaktohet rruga që do të ndjekin ekonomia dhe kultura gjatë një viti.

Kaloi me suksese në të gjitha drejtimet edhe viti 1958, viti i tretë i planit të dytë pesëvjeçar. Viti që kaloi u karakterizua nga zhvillimi i mëtejshëm i forcave prodhuese, nga fillimi i punës për shpejtimin e ritmeve të ndërtimit të socializmit në vendin tonë, ashtu sikurse e përcaktoi Plenumi i Shkurtit i Komitetit Qendror të Partisë sonë<sup>1</sup>. U zbatuan me sukses detyrat e shtruar në kushtet e reja të krijuara me heqjen e plotë të sistemit të triskëtimit; u realizua një ngritje e mëtejshme

---

<sup>1</sup> Është fjala për Plenumin VIII të KQ të PPSH që zhvilloi punimet më 3-5 shkurt 1958.

e mirëgenies materiale dhe kulturele të masave tona punonjëse; u forcua akoma më shumë aftësia mbrojtëse e vendit; u rrit edhe më shumë autoriteti ndërkombëtar i Partisë dhe i Republikës sonë Popullore.

Klasa punëtore, fshatarësia punonjëse, inteligjencia popullore, nën drejtimin e Partisë, u mobilizuan dhe punuan me vetëmohim për të vënë në jetë detyrat që shtroi plenumi i shkurtit për një zhvillim më të shpejtë të ekonomisë sonë popullore. Rezultatet e arritura treguan drejtësinë e plotë të vendimeve të plenumit të shkurtit mbi shtesat në pesëvjeçarin e dytë.

Vëllimi i përgjithshëm industrial në vitin që kaloi u plotësua 101,6 për qind, ose 20 për qind më shumë se në vitin 1957.

U prodhuan rreth 150 milion kilovat-orë energji elektrike, — 255 mijë tonë qymyrguri, — 403 mijë tonë naftë, — 201 mijë tonë mineral kromi, — 87 mijë tonë mineral bakri, — 88 mijë tonë mineral hekuri, — 147 mijë metra kub lëndë e sharruar, — 77 mijë e pesëqind tonë çimento, — 740 mijë palë këpucë e sandale, — 22 milion metra tekstile të pambukta, — 738 mijë metra tekstile të leshta, — 10 mijë tonë sheqer, — 2 mijë e 800 tonë vaj ulliri, — 2 mijë e 800 tonë djathëra, — 51 mijë hektolitra birrë etj.

Viti 1958 ishte viti i një hovi të madh në kolektivizimin e bujqësisë. Fshatarësia punonjëse, me vullnet të lirë, duke zbatuar direktivat e Partisë, arriti suksese të mëdha. Në fund të vitit 1958 sipërfaqja e tokës së punëshme e kolektivizuar arriti peshën specifike 76,2 për qind të të gjithë sipërfaqes së punëshme të fshatarësisë dhe 63,2 për qind të ekonomive. Së bashku me

gjithë sipërfaqen e tokës së ndërmarrjeve bujqësore shtetërore ajo zë 78,4 për qind kundrejt 61 për qind që ishte në fund të vitit 1957. Kjo është një fitore e madhe për bujqësinë tonë. Mekanika jonë bujqësore mori nga shteti, gjatë vitit që kaloi, edhe 800 traktorë të tjerë (të llogaritur me 15 kuaj-fuqi), — 78 kombajna dhe autokombajna si dhe makineri të tjera bujqësore. Shqipëria që përpara nuk kishte fare fuqi motorike, në vitin 1958 pati 4,1 traktorë fizikë për çdo 1 000 hektarë tokë të punuar, shifër që nuk e kanë sot as Greqia as Turqia as Jugosllavia.

Bujqësisë, blegtorisë, frutikulturës iu kushtua një kujdes më i madh. U mbollën 5 milion pemë frutore, — 830 mijë rrënjë ullinj, — 95 mijë rrënjë agrume, — 2 283 hektarë vreshta, — 5 milion e 284 mijë pjergulla. U ndërzyen artificialisht 697 300 krerë dhen dhe 9 000 krerë lopë.

Gjatë vitit 1958 u grumbulluan më shumë se në vitin 1957, 52,8 për qind qumësht, — 11,3 për qind petime, — 24,1 për qind oriz, — 3,8 për qind pambuk, — 7,1 për qind duhan etj. Vëllimi i ndërtimeve u rrit 26,7 për qind më shumë. Gjatë këtij viti u përfunduan vepra të rëndësishme, sikurse janë vënja në shfrytëzim e katër turbinave të hidrocentralit «Karl Marks», linjat e tensionit të lartë Ulëz-Kurbnesh dhe Qyteti «Stalin» — Marinëz, ujësjellësi i Durrësit e i Fierit, asfaltimi i rrugës Elbasan-Librazhd, frigoriferi i Tiranës, hoteli turistik në plazhin e Durrësit, teatri i Shkodrës etj. Vazhduan me ritme të shpejta punimet në veprat e rëndësishme të bonifikimit në Myzeqe, në Vurg, në Mursi. Filluan punimet në hidrocentralet e Shkopetit

e të Bistricës, në fushat e Thumanës dhe të Fier-Roskovecit, në fabrikën e pasurimit të bakrit në Kurbnesh, në kombinatin ushqimor në Tiranë, në fabrikat e vërërave në Këlcyrë e në Çorovodë, në fabrikat e tullave në Shkodër, Lushnjë e Vlorë dhe në objekte të tjera.

Duke zbatuar porositë e Partisë për të shpejtuar ndërtimin e banesave për punonjësit, vitin që shkoi u shpenzuan 70 për qind më shumë fonde për ndërtime apartamentesh, ndërsa me ndihmën e Bankës së Shtetit dhe me kursimet e tyre, punonjësit e qytetit e të fshatit ndërtuan më tepër se 7 000 shtëpi banimi.

Shqipëria, atdheu ynë i dashur, është kthyer në një kantier të madh ndërtimi. Hidhni sytë në kryeqytetin tonë të dashur, në të katër anët e tija po ndërtohen apartamente e shtëpi për punonjësit, po ngrihen fabrika, kombinatë e uzina, po bëhen lulishte, parqe e punime të ndryshme komunale. Një gjë e tillë shikohet në të gjitha rrethet e Republikës. Kjo tregon se sa të drejta janë planet që ka aprovuar Partia jonë e dashur për zhvillimin e gjithanshëm të atdheut tonë.

Viti 1958 ishte viti i parë i tregtisë sonë socialiste pa triska. Në këtë vit u bë një ulje tjetër e ndieshme e çmimeve, nga e cila popullsia përfitoi mbi 1 miliard e 300 milion lekë. U rrit kështu paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve në masën 6 për qind në krahasim me vitin 1957.

Popullsia bleu më shumë bukë 21,9 për qind, sheqer — 29,3 për qind, yndyrna — 2,4 për qind, qumësht — 40 për qind, djathëra — 28,4 për qind, perime e patate — 3,3 për qind, të pambukta — 31,4 për qind, të leshta



—57,6 për qind, këpucë e opinga —22,4 për qind, çimento —94 për qind, lëndë druri —80,6 për qind etj.

Ndërsa në atdheun tonë në vitin 1958 u rritën të ardhurat reale të punëtorëve, të fshatarëve e të intelektualëve, u ulën çmimet etj., në disa vende kapitaliste ja se çfarë ka ngjarë:

Kostoja e jetesës gjatë 8 muajve të vitit 1958 është ngritur në Turqi 82 për qind. Në fund të vitit 1958 atje u bënë ngritje të tjera çmimesh në një sërë artikujsh të konsumit të gjerë, midis të cilëve në sheqer dhe në duhan, në taksat e shërbimit komunal, në qiratë, si dhe 50 për qind ngritje në të gjitha llojet e transportit dhe në biletat e kinoteatrove. Populli nuk është në gjendje të blejë barërat e recetave që i ka lëshuar mjeku, mbasi këto janë shumë të shtrenjta.

Në Greqi, fuqia blerëse ka pasur një rënie tjetër gjatë vitit 1958 prej 25-30 për qind. Në maj të vitit 1958, në krahasim me vitin 1953, çmimi i bukës është ngritur 40 për qind, i yndyrnave —77 për qind, i orizit —78 për qind, i artikujve prej mielli —71 për qind, i qumshtit —77 për qind, i djathit —50 për qind, i sheqerit —31 për qind, kurse tarifa për shërbimet komunale është ngritur 30-90 për qind. Të tjera ngritje çmimesh janë bërë, deri në fund të vitit 1958, në një sërë artikujsh kryesorë si në peshk, në patate, në djathë, në veshmbathje dhe në artikujt e importit. Politika e re doganore e tregut të përbashkët evropian i ka dhënë një goditje të rëndë fshatarësisë greke në lidhje me prodhimet e saj kryesore për eksport, pambukun dhe duhanin, ku nuk i ka gjetur akoma treg prodhimit të vitit 1957.

Në Jugosllavi, gjatë 10 vjetëve të fundit, niveli i

jetesës së punëtorëve, jo vetëm që nuk u ngrit, por u ul. Në qoftë se do të marrim për bazë vëllimin e konsumit për frymë të popullsisë më 1948 në 100, niveli i vjetëve 1950-1953 ka rënë në 93 për qind. Më 1956 konsumi i sendeve kryesore ushqimore dhe i mallrave industriale vazhdoi të mbetet në nivelin e vitit 1948. Në vjetët e mëvonshëm niveli i jetesës së punonjësve jugosllavë vazhdoi të ulet. Në qershor të vitit 1958 çmimet e sendeve ushqimore, në krahasim me periudhën analoge të vitit 1957, u ngritën 14 për qind. Në tetor 1958 u ngrit çmimi i miellit të bukës, i sheqerit në 10-15 për qind, çmimi i energjisë elektrike mbi 20 për qind, tarifat e hekurudhës më shumë se 15 për qind. Rritja e këtyre çmimeve u pasua nga një valë tjetër rritjeje të çmimeve. Gjatë vjetëve të fundit, në Jugosllavi kanë falimentuar mbi 2 000 ndërmarrje ekonomike.

Në Itali që nga shtatori i vitit 1957 deri në shtator të vitit 1958 kostoja e jetesës është rritur në 5,2 për qind, kurse nga viti 1954 deri në vitin 1958 kostoja e jetesës është rritur 19,8 për qind. Vetëm gjatë vitit 1958 çmimet e artikujve ushqimorë janë rritur 8,5 për qind, kështu që populli është i detyruar të heqë dorë ose të kufizojë konsumin e mjaft artikujve të nevojshëm.

Arsimi, kultura, artet në vendin tonë gjatë vitit të kaluar shënuan përparime të mëdha. U rrit numri i shkollave të të gjitha kategorive, të ditës e të mbrëmjes, u shtua numri i nxënësve dhe i studentëve. Në shtator të vitit 1958 mbaruan universitetin dhe institutet e larta të vendit e jashtë atdheut 490 vetë. Shikoni sa shpejt jemi duke ecur. Gjithë regjimet e kaluara deri më 1938 patën pregatitur kuadro me arsim të lartë gjithsej 380

vetë, ndërsa në Shqipërinë socialiste tani përgatiten çdo vit 500 quadro të lartë.

Në sektorin e artit e të kulturës një sukses i madh ishte vënia e së parës opera shqiptare «Mrika» në skenën e teatrit të Shkodrës, ku nga të 119 pjesëmarrësit, 104 prej tyre ishin diletantë. Në kinematë e atdheut tonë u shfaq i pari film artistik shqiptar «Tana», suksese të mëdha u arritën në të gjithë sektorët e tjerë. Rezultatet e arritura gjatë vitit 1958 i japin mundësi vendit tonë të ecë me hapa të sigurtë në rrugën e caktuar nga Partia për shpejtimin e ritmeve të ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Gjatë punës për realizimin e planit e të buxhetit për vitin 1958, krahas sukseseve janë vërtetuar dhe një sërë të metash e dobësish. Mbi këto u ndal dhe bëri një analizë të hollësishme Plenumi i Dhjetorit i Komitetit Qendror të Partisë<sup>1</sup>, i cili caktoi edhe detyrat për organet shtetërore dhe të Partisë për këtë vit. Këto detyra janë parashikuar me hollësi në vendimin e botuar të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë.

Plani dhe buxheti i vitit 1959 kanë një rëndësi të madhe; realizimi i tyre ka rëndësi vendimtare për plotësimin me sukses të planit të dytë pesëvjeçar. Plani i këtij viti është plani i vitit të parafundit të pesëvjeçarit. Ne duhet të vëmë të gjitha forcat, të gjitha dijenitë, të gjithë entuziazmin dhe t'i përvishemi punës për realizimin e tejkalimin e këtij plani. Detyrat që kemi përpara janë më të mëdha.

---

1. Është fjala për Plenumin XV të KQ të PPSH që zhvilloi punimet më 22-23 dhjetor 1958.

Këtë vit duhet të prodhojmë: 157 milion kilovat-orë energji elektrike, 285 mijë tonë qymyrguri, 550 mijë tonë naftë brut, 46 mijë e 500 tonë benzinë, 40 mijë tonë bitum natyral, 252 mijë tonë mineral kromi, 110 mijë tonë mineral bakri, 175 mijë tonë mineral hekuri, 154 mijë metra kub lëndë druri të sharruar, 71 mijë tonë çimento, 123 milion copë tulla, 23 milion e 300 mijë metra pëlhurë pambuku, 800 mijë metra stofa të leshta, 837 mijë palë këpucë e sandale, 12 mijë e 700 tonë sheqer, 2 mijë e 650 tonë vaj, 4 mijë e 255 tonë djathë etj.

Bujqësia jonë duhet të prodhojë 453 mijë tonë drithëra buke. Këtë vit duhet të mbillen 4 milion e 910 mijë pemë frutore, — 7 milion e 260 mijë pjergulla, — 4 300 hektarë vreshta, — 225 mijë rrënjë agrume, duhet të hapen 37 900 hektarë toka të reja etj.

Këto janë detyra shumë të rëndësishme për ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike të prodhimit, për klasën tonë punëtore dhe fshatarësinë punonjëse. Këto detyra janë plotësisht të realizueshme. Partia dhe qeveria jonë i kanë kushtuar dhe do t'i kushtojnë vazhdimisht kujdes të posaçëm ngritjes së mirëqenies materiale e kulture të masave punonjëse.

Do të tregohet një kujdes më i madh për furnizimin e popullit me më shumë mallra e prodhime ushqimore dhe me cilësi më të mirë, qoftë nga ato që prodhohen në vend, qoftë nga ato që do të importohen.

Popullit do t'i shiten më shumë se në vitin 1958: sheqer 23 për qind, sapun 34 për qind, yndyrna 48 për qind, këpucë e opinga 42 për qind etj. Do të rritet paga reale e punëtorëve dhe e nëpunësve më shumë nga sa u

rrit në vitin 1958. Një kujdes i veçantë do të vazhdohet të tregohet për ndërtimin e banesave për punonjësit.

Gjatë këtij viti 52,3 për qind ose mbi 14 miliard lekë të buxhetit do të shpenzohen për zhvillimin e ekonomisë sonë popullore. Do të punohet në më shumë se 200 objekte të mëdha sikurse janë zgjerimi i rafinerisë së naftës në Cërrik, fabrika e briketimit të qymyrgurit, fabrika e pasurimit të bakrit në Kurbnesh, hidrocentrali i Shkopetit e i Bisticës, zgjerimi i fabrikës së çimentos në Vlorë, fabrika e mobiljeve në Elbasan, fabrikat e tullave në Shkodër, në Elbasan e në Vlorë, kombinati ushqimor dhe kombinati i mishit në Tiranë, uzina e fermentimit të duhanit në Durrës, vazhdimi i punimeve të bonifikimit në Myzeqe, në Roskovec, në Vurg të Delvinës, në Thumanë etj., sistemime e asfaltime rrugësh, ndërtimi i portit të Durrësit, do të ndërtohen hotele, hotele turizmi, shtëpi pushimi, konvikte, shkolla e spitale, do të ndërtohen 220 000 metra katrore banesa.

Në buxhetin e këtij viti janë paraparë të shpenzohen për financimin e objekteve socialo-kulturale 5 miliard e 712 milion lekë, ose 16 për qind më shumë nga sa u shpenzuan në vitin 1958. Këto shifra tregojnë sa kujdes i kushtohet në vendin tonë që ndërton socializmin, arsimit, kulturës, artit, shkencave, shëndetit të popullit, në një kohë kur në vendet kapitaliste bëhet gjithnjë më e vështirë jetesa e masave punonjëse.

Në buxhetin e këtij viti është paraparë të shpenzohen për fëmijët e vendit tonë 1 miliard e 420 milion lekë, nga të cilët: 110 milion lekë do t'u jepen nënave me shumë fëmijë, 500 milion lekë prindërve që kanë fëmijë shumë, sikurse u vendos kur hoqëm sistemin e

triskëtimit, 150 milion për të mbuluar shitjen me çmime më të lira të konfeksioneve për fëmijët, 46 milion lekë për të financuar qendrat e pushimit të pionierëve, 337 milion lekë për të mbuluar shpenzimet për ushqim që bëhen në kopshtet e fëmijëve, (prindërit mbulojnë me kuotat e tyre vetëm 16,9 për qind të shpenzimeve), 177 milion lekë për të mbuluar shpenzimet që bëhen për çerdhet e fëmijëve (prindërit mbulojnë me kuotat e tyre vetëm 12,6 për qind të shpenzimeve) etj.

Të tilla shpenzime bëhen vetëm në vendet ku ndërtohet socializmi, për t'ua bërë jetën sa më të mirë punëtorëve dhe punonjësve.

Për të kuptuar rëndësinë e madhe që duhet t'i kushtojmë mobilizimit në punë të të gjithë punonjësve do të përmend faktin se këtë vit, 1 për qind e rritjes së rendimentit në prodhimin industrial është e barabartë me 284 milion lekë, kundrejt 249 milion që ishte në vitin 1958 dhe 1 për qind e uljes së kostos së prodhimit industrial është baras me 160 milion lekë akumulacion për buxhetin e shtetit, kundrejt 140 milion që ishte për vitin 1958.

Këtë vit, pra, ne duhet të mobilizohemi më mirë për realizimin dhe tejkalimin e planit. Entuziazmi dhe emulacioni që kanë shpërthyer në kolektivet punonjëse të qytetit e të fshatit për nder të 15-vjetorit të Çlirimit të atdheut tonë duhet të mbahen e të zhvillohen edhe më shumë, në mënyrë që të shkojmë në festën e Çlirimit me duar plot.

Vëmendja e organeve shtetërore, e ndërmarrjeve dhe e organizatave ekonomike duhet të përqëndrohet në realizimin ritmik të planit, të mos krijohen boshllëqe,

çdo ditë të realizohet e të tejkalohet detyra e planit, çdo mbrëmje të pregatiten dhe të jepen detyrat që duhet të kryhen të nesërmen.

Me gjithë sukseset e arritura në të gjithë sektorët, ka akoma të meta e dobësi në punët tona. Jo kudo po realizohet plani sipas parashikimit. Nuk shfrytëzohen në masën e duhur makineritë. Ka makineri në ndërmarrjet industriale dhe në ato të ndërtimit që nuk shfrytëzohen si duhet. Industria jonë e naftës, sidomos, duhet të tregojë një kujdes më të madh në drejtim të pakësimit të avarive në punë, mbasi vitin që shkoi në gjashtëmuorin e parë shpejtësia e shpimit të sondave u arrit vetëm 66 për qind, kryesisht si pasojë e ndalesave për shkaqe avarish. Makineritë që punojnë në bonifikimet nuk u përdorën plotësisht me dy turne etj. Shfrytëzimit të makinerive ekzistuese dhe mirëmbajtjes së tyre duhet t'i kushtohet një kujdes i madh, në mënyrë që të marrim nga ato maksimumin e nevojshëm.

T'i kushtohet kujdes i veçantë forcimit të punës së kërkimeve gjeologjike. Ne duhet të shtojmë vendburimet e reja dhe të gjejmë sasi më të mëdha mineralesh për nevojat imediate dhe për pesëvjeçarin e ardhshëm.

Problemi i ndërtimeve është një problem i rëndësishëm e i ngutshëm që kërkon një kujdes shumë të madh nga ana e Ministrisë së Ndërtimit, nga ndërmarrjet e ndërtimit dhe nga të gjithë punonjësit e këtij sektori.

Prandaj duhet të mobilizohen forcat tërësisht në drejtimet e mëposhtme: të punohet që ndërtimet të

kushtojnë sa më pak, të shkurtohet sa të jetë e mundur më shumë koha e çdo objekti që ndërtohet, duke pasur njëkohësisht parasysh që ndërtimi të dalë me cilësi të mirë. Për të realizuar këto detyra duhet të forcohet kudo organizimi i punës, të shfrytëzohen tërësisht mekanizmat, të perfeksionohet dhe të shtohet kuadri; të ngrihet ndërgjegjja socialiste e të gjithë punonjësve të ndërtimit, nëpërmjet një pune intensive politike, teknike dhe ideologjike.

Lidhur me ndërtimet ka një rëndësi vendimtare kapërcimi i vështirësive në realizimin e planit në industrinë e material-ndërtimit, sepse gjendja paraqitet e pakënaqshme në këtë çështje. Të marrë fund prodhimi sezonal i tullave e i tjegullave, të merren masat më të ngutshme që të mbarojë në afatet minimale ngritja e fabrikave të reja të tullave, të forcohet sa më tepër mekanizimi dhe teknologjia e prodhimit, të përgatiten me shpejtësi kuadrot më të kualifikuar.

Materiali tjetër i lëndë-ndërtimit nuk po shfrytëzohet si duhet. Duhet pra të shpejtohen studimet dhe të përdoret material i ri ndërtimi, përveç tullave, dhe të bëhen të gjitha përpjekjet që ky material të bëhet më i leverdisshëm nga tullat.

Lënda e drurit që është deficitare duhet të përdoret kudo me kursim. Asgjë të mos shkojë dëm në sharrat dhe në zdrukthëtaritë tona. Prandaj, për këtë qëllim duhet të merren masa shumë të rrepta nga të gjitha entet që përdorin lëndë druri në punët e tyre.

Një vëmendje serioze duhet t'i kushtojnë organet tona ekonomike problemit të përmirësimit të cilësisë së mallrave. Prodhimet tona nga viti në vit rriten,



por duhet që krahas me këtë të bëhen çdo ditë përpjekje që të përmirësohet edhe cilësia edhe asortimenti i tyre, në mënyrë që mallrat e konsumit të gjerë për popullin të jenë të cilësisë së mirë, me paraqitje të bukur, të ambalazuara sipas rregullave të higjienës dhe të hijshme. Prandaj ndërmarrjet ekonomike që prodhojnë mallra të konsumit për popullin duhet të marrin menjëherë masa dhe këtë vit të bëhet një përparim i dukshëm në realizimin e kësaj detyre të rëndësishme.

Një detyrë e dorës së parë për të gjitha organet tona ekonomike është si kurdoherë lufta për rritjen e rendimentit në punë dhe për uljen sistematike të koston, mbi bazën e të cilave krijohen mundësitë për uljen e mëtejshme të çmimeve dhe për rritjen e fuqisë blerëse të punonjësve. Kjo detyrë e rëndësishme do të realizohet jò vetëm me ngritjen e vazhdueshme të nivelit teknik të ndërmarrjeve tona ekonomike, por edhe me masat që po merr Partia për kualifikimin dhe pregtitjen e kuadrit, si dhe me punën që duhet të bëjnë drejtuesit e ekonomisë për forcimin e disiplinës në punë, për kualifikimin e punëtorëve, për shfrytëzimin në maksimum të makinerisë dhe në radhë të parë për organizimin e mirë të punës në çdo ndërmarrje dhe kontrollin e zbatimit të detyrave të ngarkuara.

Jo më pak rëndësi kanë gjithashtu përpjekjet për të bërë kudo kursime, siç është lufta kundër shpenzimeve pa vend të lëndës së parë, lufta kundër skarciteteve, kundër thyerjeve të disiplinës në punë, vjedhjeve, shpërdorimit të pasurisë socialiste etj.

Jemi para detyrash të mëdha në lëmin e bujqësisë. Mbjelljet pranverore duhet të bëhen një aksion i madh

për të gjithë fshatarësinë tonë. Hedhja e fshatarësisë pa rezerva në punët bujqësore është detyrë e ditës. Punimi i tokave me të gjitha mjetet, plehërimi i tyre, zgjedhja e farërave, përgatitja e kanaleve për vaditje janë detyra imediate të të gjithë punonjësve të bujqësisë. Paralelisht me këto detyra aktuale shumë të rëndësishme për bujqësinë, organet drejtuese të Partisë dhe të pushtetit në bazë dhe e gjithë fshatarësia jonë kooperativiste të mos lënë pas dore detyrat e tjera të rëndësishme, siç janë forcimi ekonomik-organizativ i kooperativave bujqësore dhe ngritja e rendimentit të kulturave bujqësore. Zgjidhja e këtyre detyrave ka rëndësi të madhe për kooperativat, për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, si dhe për rritjen e të ardhurave dhe mirëqenien e vetë kooperativistëve.

Problem kryesor i ditës mbetet këtë vit, për organizatat e Partisë dhe për organet e pushtetit në rrethe dhe në bazë, puna për përfundimin e kolektivizimit në zonat fushore të vendit. Siç e vuri në dukje edhe Plenumi i Komitetit Qendror, i muajit shkurt të vitit 1958, organizatat e Partisë, sidomos gjatë gjysmës së dytë të vitit të kaluar, e lanë pas dore këtë çështje kaq të rëndësishme. Plenumi i Komitetit Qendror porositi të gjitha komitetet e Partisë që direktivën e bashkimit të kooperativave bujqësore ta interpretojnë drejt dhe ky proces shumë i rëndësishëm për fatin e bujqësisë sonë, të zhvillohet gradualisht, pa u shpejtuar, kryesisht në fusha, sepse shpejtimi në këtë çështje nuk u përgjigjet kushteve reale aktuale. Prandaj në këtë punë duhet ecur me kujdes, duke menduar thellë për masat organizative, për masat teknike dhe për ndihmën konkrete

që duhet t'u japim kooperativave që bashkohen në fillim, në mënyrë që këto të bëhen shembull për bashkime më të gjera në të ardhshmen.

Gjatë muajit shkurt, koha ka qenë shumë e mirë. Edhe tani në ditët e para të marsit koha është shumë e bukur e plot me diell. Prandaj kjo kohë duhet të shfrytëzohet në maksimum nga e gjithë fshatarësia jonë për kryerjen sa më parë të punimeve të stinës, siç janë punimi i tokave, çelja e tokave të reja, hapja e qilizmave, pastrimi i kanaleve etj. Dua të theksoj se jo të gjitha kooperativat dhe të gjithë fshatarët e shfrytëzojnë si duhet këtë kohë. Çdo ditë, çdo orë që humbet tani në këto ditë kaq të përshtatshme për punë bujqësore është një dëm i madh që i bëhet bujqësisë dhe vetë ekonomisë së çdo familjeje fshatare. Prandaj të luftohet humbja pa vend e kohës nga ana e fshatarësisë nëpër pazaret e qyteteve, kur në fusha ka kaq shumë për të bërë. Vetë fshatarësia jonë duhet t'i llogaritë humbjet e mëdha që ka nga shëtitjet e kota nëpër pazare në një kohë kur tregtia shtetërore dhe kooperativiste e ka shtrirë rrjetin e saj thellë në çdo zonë dhe gati në të gjitha fshatrat.

Puna e fshatarëve në fusha, në ara, në hapje kanalesh, goftë në ato të kooperativave të tyre goftë në veprat e mëdha të bonifikimit që ndërmerr shteti, ku investohen jo qindra miliona po miliarda lekë, është një detyrë e madhe dhe e veçantë e fshatarësisë punonjëse. Kështu ajo punon jo vetëm për ngritjen e mirëqenies së saj, por jep edhe një kontribut të domosdoshëm në ndërtimin e socializmit, d.m.th. në sigurimin njëkohësisht të mirëqenies edhe të klasës punë-

tore dhe të të gjithë punonjësve të tjerë të vendit tonë, në forcimin e aleancës me klasën punëtore.

Të merren masa nga të gjitha dikasteret, komitetet ekzekutive, komitetet e Partisë dhe drejtoritë e ndërmarrjeve për të plotësuar kudo planet e prodhimit, të ndërtimit e të shërbimeve. Kudo duhet të forcohet kontrolli dhe disiplina në punë, të forcohet regjimi i kursimit në përgjithësi dhe i kursimit në përdorimin e materialeve e të vlerave monetare. Të forcohet disiplina financiare dhe kontrolli me anë të lekut.

Shokë deputetë, detyrat që kemi përpara janë të mëdha, por ato janë plotësisht të realizueshme. Ne duhet t'ia bëjmë të qarta popullit tonë punëtor këto detyra, ta drejtojmë atë dhe të mësojmë nga populli e bashkë me të të punojmë dhe të kapërcejmë vështirësitë. Ne kemi një popull të mrekullueshëm që fjalën dhe thirrjen e Partisë i çon në vend. Të punojmë, pra, me popullin tonë të mrekullueshëm për plotësimin e detyrave të planit.

Shokë deputetë,

Ju jeni të informuar se Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria jonë po përfundojnë studimin e projektplanit të tretë pesëvjeçar për vjetët 1961-1965. Ky studim parashikon një zhvillim të vrullshëm të ekonomisë sonë, ritme të larta zhvillimi, ngritjen akoma më shumë të nivelit të jetesës së popullit tonë. Realizimi me sukses dhe tejkalimi i planit të dytë pesëvjeçar do të krijojnë kushte shumë të favorshme për të përballuar pesëvjeçarin e tretë, i cili do të ketë domosdo detyra akoma më të mëdha, sepse do të shpejtojë

ndërtimin e jetës së lumtur e të begatshme, ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Prandaj detyra jonë imediate është që të mobilizojmë të gjitha forcat për të realizuar dhe tejkaluar planin ekonomik të këtij viti që është viti vendimtar i planit të dytë pesëvjeçar. Partia dhe qeveria kanë besim se shokët deputetë do të vënë të gjitha forcat për të kontribuar me punën e tyre të rëndësishme në kryerjen e kësaj detyre të lartë patriotike.

Duke ndjekur me besnikëri politikën e unitetit vëllazëror me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera të demokracisë popullore, politikën e paqes dhe të miqësisë midis popujve, Republika Popullore e Shqipërisë ka forcuar pozitat e saja ndërkombëtare, ka zgjeruar vazhdimisht marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me një numër kurdoherë më të madh shtetesh, është bërë një faktor i shëndoshë paqeje dhe stabiliteti në zonën e Ballkanit dhe të Adriatikut. Republika Popullore e Shqipërisë zë sot një vend nderi në radhën e shteteve që luftojnë për paqen dhe përparimin shoqëror, ajo respektohet dhe ka miq të shumtë, gëzon një simpati të sigurtë në radhët e popujve që porsa kanë fituar lirinë ose që luftojnë akoma me armë në dorë kundër zgjedhës koloniale. Politika e drejtë e Partisë dhe e qeverisë sonë e ka bërë Republikën Popullore të Shqipërisë një vend të paprekshëm nga çdo armik. Orvatjet e panumërta të imperialistëve amerikano-anglezë dhe të veglave të tyre kanë dështuar me turp; i njëjti fat i pret edhe në të ardhshmen. Republika Popullore e Shqipërisë është e fortë sepse i fortë është populli ynë heroik, sepse e drejtë dhe e paprekshme ka qenë, është dhe do

të jetë vija e Partisë sonë të lavdishme që udhëheq me siguri dhe urtësi të madhe fatet e popullit tonë.

Politika jonë ndaj vendeve fqinje ka qenë frymëzuar kurdoherë nga vullneti për të pasur marrëdhënie normale dhe për t'i zhvilluar ato në frymën e fqinjësisë së mirë, të dobisë reciproke dhe në interes të paqes së përgjithshme. Në këtë drejtim, inisiativat janë marrë kurdoherë nga ana jonë dhe ato kanë qenë të shumta. Edhe në të ardhshmen ne do të ndjekim të njëjtën politikë, por ne nuk mund të rrimë duar kryq kur vende fqinje të Shqipërisë kurdisin komplete, zhvillojnë fushata dhe kryejnë akte që drejtohen kundër interesave më të larta të popullit dhe të atdheut, kundër lirisë, integritetit tokësor, pavarësisë dhe sovranitetit kombëtar të Shqipërisë.

Shokë deputetë,

Këtë vit populli shqiptar do të festojë 15-vjetorin e Çlirimit të tij nga pushtimi barbar nazi-fashist dhe nga shtypja e egër shekullore e klasave shfrytëzuese. Nën udhëheqjen e urtë të Partisë sonë të Punës, brenda kësaj periudhe të shkurtër, populli ynë ka përshkuar një rrugë të lavdishme. Nga një vend i shtypur dhe shumë i prapambetur, sot atdheu ynë i dashur është bërë një shtet agraro-industrial që po ndërton socializmin, një shtet socialist sovran që ka pozita dhe autoritet të fortë ndërkombëtar. Mjerimi dhe injoranca në të cilën e kishin lënë popullin tonë regjimet antipopullore po zhduket përgjithmonë, niveli i jetesës së punonjësve të qytetit e të fshatit është rritur dhe po rritet çdo vit, arsimi, kultura, shëndetësia janë zhvilluar në

shkallë të gjerë dhe e kanë bërë më të ndritur e më të gëzuar jetën e popullit tonë. Perspektiva akoma më të shkëlqyera na ka hapur Partia dhe ne po marshojmë me vendosmëri në rrugën e socializmit.

Populli dhe Partia jonë me të drejtë kanë pse të mburren. Por ne nuk dehemi nga sukseset. Ne e dimë se na mbetet akoma shumë për të bërë. Ne duhet të fitojmë kohën e humbur, të zhdukim sa më parë gjurmët e prapambetjes së trashëguar, nga një e kaluar plot hidhërime. Ne duhet të shpejtojmë ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Për këtë i kemi të gjitha kushtet. Pasuritë e mëdha të vendit tonë presin të shfrytëzohen akoma më mirë dhe më shumë që jeta e popullit tonë të bëhet më e lumtur, që socializmi të triumfojë.

Datën historike të 29 Nëntorit, 15-vjetorin e Çlirimit të atdheut tonë, duhet ta presim me suksese të reja. Dhe suksesi më i mirë e më konkret është të realizojmë dhe të tejkalojmë planin ekonomik të këtij viti. Partia dhe qeveria u bëjnë thirrje të gjithë punonjësve tanë heroikë dhe patriotë, në të gjithë sektorët e prodhimit, të ndërtimit dhe të punës, të mobilizohen me energji akoma më të mëdha për të kryer me nder detyrat e mëdha që na dalin përpara, për të festuar 15-vjetorin e Çlirimit ashtu si i ka hije popullit tonë të mrekullueshëm që ndërton socializmin me fitore, me plan të realizuar dhe të tejkaluar. Kjo do ta bëjë festën tonë më të bukur e më të gëzuar.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 53 (3268), 4 mars 1959*

*Botohet me shkurtime sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## ÇËSHTJET ORGANIZATIVE TË PARTISË JANË ÇËSHTJE TË TË GJITHË PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

9 mars 1959

Vërejtjet që u bënë në këtë mbledhje duhet t'i kenë parasysh e t'i zbatojnë shokët e komiteteve të Partisë të Korçës e të Peshkopisë.

Desha të theksoja se ashtu sikurse interesohemi për forcimin e Partisë me gjak të ri, po ashtu jemi të interesuar edhe për ruajtjen e efektivit të Partisë dhe për forcimin e vazhdueshëm të saj. Kjo është një nga direktivat kryesore të Partisë.

Në radhët e Partisë janë njerëzit më të mirë dhe më të vendosur, prandaj kujdesi për ruajtjen e tyre duhet të jetë i madh. Është e domosdoshme që ruajtja e efektivit të Partisë të na preokupojë seriozisht. Efektivi i Partisë përbën një forcë të madhe për ndërtimin e

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim problemi «Mbl përjashtimet nga Partia në rrethin e Korçës e të Peshkopisë».



socializmit në vendin tonë. Kjo nuk do të thotë se ecja përpara e Partisë nuk do të lërë pas disa njerëz, por sa më të paktë të jenë këta, aq më mirë është. Prandaj të bëhen të gjitha përpjekjet për t'i shpëtuar njerëzit, që të ecin të vendosur në rrugën revolucionare të Partisë.

Puna organizative e Partisë ka një rëndësi vendimtare. Në këtë sektor, Partia ka caktuar njerëz dhe kuadro të aftë, sekretarë komitetesh partie dhe shokë të tjerë, të cilët, në kuadrin e punës organizative të Partisë, duhet të luajnë një rol më të madh se deri tani për edukimin dhe kalitjen ideologjike të komunistëve. Por çështjet organizative të Partisë nuk duhet të mbeten vetëm në dorën e kuadrove të ngarkuar, të cilët, natyrisht, duhet të luajnë një rol gjithnjë e më të madh në këtë drejtim. Është e nevojshme që për forcimin organizativ të Partisë të interesohen më shumë të gjithë anëtarët e byrove të Partisë në rrethe. Që të arrihet kjo duhet të ngrihet më lart roli i sekretarit të komitetit të Partisë, i ngarkuar me çështjet organizative. Si do të bëhet kjo? Kjo do të bëhet duke e kuptuar mirë se çështjet organizative të Partisë janë çështje të të gjithë Partisë. Në këtë prizëm duhet luftuar kundër pikëpamjeve mikroborgjeze që ekzistojnë në disa komunistë, kundër frymës së tarafeve që shfaqet aty-këtu në organizata-bazë. Për probleme të tilla nuk mjafton vetëm të vëmë në dijeni byronë e komitetit të Partisë të rrethit, por të bëhen analiza të thella në byro dhe në plenumin e komitetit të Partisë. Prandaj sekretari që merret me çështjet organizative të mos i kalojë përceptazi të dhënat dhe problemet e organizatës-bazë, të

mos i nënvleftësojë këto duke menduar se «janë të vogla», por t'i studjojë dhe t'i bëjë çështje të Partisë, të forumeve e të drejtuesve të saj.

Gjallërimi i jetës së organizatave-bazë ka rëndësi të madhe dhe përbën një detyrë kryesore për sekretarin që merret me çështjet organizative të Partisë, i cili duhet të organizojë praktikisht ndihmën për to. Natyrisht, ai nuk mund të vejë në të gjitha organizatat-bazë, mund të shkojë në disa prej tyre, ndërsa në të tjerat të aktivizohen të gjithë shokët e byrosë së komitetit të Partisë të rrethit. Është e domosdoshme që sekretari i ngarkuar me çështjet organizative të bashkëpunojë me sekretarin e Partisë që merret me agjitacionin e propagandën dhe të mendojnë, për shembull, se ç'leksione duhen punuar për të luftuar kundër shfaqjeve të huaja që manifestohen në këtë ose në atë organizatë. Kjo gjë nuk bëhet në mënyrë sistematike. Çështja e njohjes së shfaqjeve të huaja të anëtarët e Partisë ka një rëndësi të madhe, sepse, duke njohur se çfarë shfaqje të huaja ka ky ose ai komunist, jepet mundësia edhe të ndihmohen, në mënyrë që të mos arrijë puna sa njerëzit të flaken jashtë Partisë. Nuk mendoj se këto detyra sekretarët e komitetit të Partisë që merren me çështje organizative, nuk i dinë, por është fakt se nuk i konkretizojnë si duhet dhe të bëjnë një punë më të organizuar në bashkëpunim me shokët e tjerë për të mbajtur të pastër efektivin e Partisë; ata që nuk vlejnë, të përjashtohen nga radhët e saja.

Jo pa qëllim drejtova pyetjen: A kërkojnë komunistët që t'u shlyhen masat ndëshkimore? E bëra këtë pyetje, sepse më duket sikur ka disa komunistë që nuk

kërkojnë të shlyejnë masat, shpeshherë as organizatat-bazë nuk kujtohen. Partia t'ua bëjë të qartë komunistëve se ai që ka bërë faj dhe është ndëshkuar, duhet të kërkojë i pari që t'i shlyhet masa. Është e natyrshme se ai do ta bëjë këtë kur ta ketë ndjerë fajin dhe të ketë dhënë prova. Por ç'ngjet në praktikë? Në praktikë ndodh që ka komunistë, në dokumentet e të cilëve figurojnë 4-5 vërejtje. Kjo nuk është e mirë, prandaj duhet shtruar me forcë të madhe se ata që kanë bërë faj të punojnë që t'ia lajnë Partisë dhe, kur e shikojnë se kjo është arritur, të kërkojnë shlyerjen e masës. Kjo nuk do të thotë që byroja e komitetit të Partisë dhe sekretarët e organizatave-bazë t'ia lënë këtë çështje spontancitetit. Sekretari i organizatës-bazë duhet t'i thotë komunistit: ti, shok, ke bërë këtë gabim për të cilin edhe je ndëshkuar, mirëpo, me sa shohim, nuk po bën përpjekje për t'ia larë Partisë. Kurse atij që ka punuar mirë dhe mendohet se i ka kuptuar gabimet, i thuhet: ti, shoku komunist, po punon mirë, por nuk po bën kërkesën për shlyerjen e masës ndëshkimore. Duke e shtruar kështu këtë çështje, nuk do të thotë që ndonjëri qysh nesër të veprojë dhe të shlycë menjëherë të gjitha masat.

Kisha për të thënë edhe pak fjalë për njerëzit e përjashtuar nga Partia. Këta duhet t'i mbajmë afër, t'i shohim në punë e sipër dhe, sipas rastit, t'i ndihmojmë. Kjo direktivë e Partisë nuk zbatohet si duhet ose zbatohet keq. Ka të përjashtuar nga Partia, të cilëve u duhet çelur perspektiva se me një punë të mirë nesër mund të pranohen përsëri në Parti, sepse këtyre nuk u është mbyllur dera një herë e përgjithmonë. Këtu u

dha një shembull se në Peshkopi një komunist nuk hyri në kooperativë në një kohë kur ishte bashkuar i gjithë fshati. Edhe unë jam dakord se një njeri i tillë nuk mund të mbahet në Parti. Por të shohim edhe anën tjetër të problemit. Kur u përjashtua ky ish-komunist nga Partia, masa e marrë ka qenë e drejtë, po tani, pas disa vjetëve, që ai ka hyrë në kooperativë dhe mund të jetë bërë një kooperativist i mirë a nuk duhet parë çështja e tij? Mendoj se ky duhet të rehabilitohet.

Këto çështje ne i shikojmë shpesh në Sekretariatit e Komitetit Qendror, prandaj edhe shokët e rretheve, herë pas here, duhet t'i shtrojnë e t'i diskutojnë në mbledhjet e byrosë. Ja, ne tani po shqyrtojmë çështjen e përbërjes së Partisë. Një problem të tillë mund të analizojnë edhe shokët e Partisë të terrenit e të ushtrisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **PARTIA TË INTERESOHET AKOMA MË SHUMË PËR EDUKIMIN E RINISË**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**10 mars 1959**

Dua të theksoj se çështja e rinisë është jetike për të gjithë Partinë dhe popullin tonë. Është fakt se gjatë kohës së pushtetit popullor janë krijuar shumë mundësi për edukimin komunist të rinisë, por këto nuk shfrytëzohen si duhet, prandaj shtrohet detyra që organizatat e Partisë, të rinisë dhe organet shtetërore të mobilizohen totalisht për të përmirësuar punën edukative me rininë duke përdorur për këtë qëllim format dhe mjetet e shumta që kemi në dispozicion.

Partia interesohet për edukimin e rinisë, por është e domosdoshme të interesohet akoma më shumë. Çësh-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u diskutua rreth raportit «Mbi disa probleme të edukimit komunist të rinisë», paraqitur nga ana e Drejtorisë së organeve të Partisë, të rinisë e të bashkimeve profesionale pranë aparatit të KQ të PPSH.

tjes së edukatës së rinisë dhe të mbarëvajtjes së saj, komunistët duhet t'i kushtojnë rëndësinë e duhur. Të mendojmë, shokë, se ne po plakemi dhe në të ardhshmen do të na zëvendësojë brezi i ri. Këtë duhet ta shikojmë konkretisht në punë, në jetë dhe në familjet tona. Prandaj çështjen e rinisë ta bëjmë një çështje të madhe partie, jo vetëm nga ana organizative, por duke u marrë me të në mënyrë të përditshme deri edhe në jetën familjare. Të mos gabojmë duke menduar se rininë e kemi të mirë, sepse influenza e borgjezisë depërton edhe në vendin tonë e në radhë të parë synon të prekë rininë. Nuk mund të thuhet që «meqenëse të rinjtë tanë nuk kanë vajtur në Amerikë dhe as në vendet e tjera kapitaliste, nuk ka mundësi të infektohen», sepse influenza borgjeze hyn në rrugë të ndryshme edhe në Shqipëri, si në vendet e tjera socialiste, duke mos përjashtuar as Bashkimin Sovjetik. Në shfaqjet borgjeze që manifestohen gjen terren të përshtatshëm edhe revizionizmi, i cili është pjellë e imperializmit. Prandaj duhet bërë një punë e organizuar dhe e thelluar edukative si nga ana e Partisë, ashtu edhe nga organizata e rinisë, organizatat e tjera, shkolla, familja etj.

Nuk duhet të na preokupojë çështja që kemi mjaft shokë me moshë të rritur si drejtues të rinisë. Për një kohë, përderisa të krijohen kuadro të pjekur, është e nevojshme që këta kuadro të jenë. Prandaj të mos e bëjmë problem heqjen e tyre dhe zëvendësimin me më të rinj.

Lidhur me kërkesat për të pasur më shumë salla, mendoj të ecim sipas kushteve tona. Në radhë të parë të shfrytëzojmë mirë sallat që kemi, shumë nga të cilat

rrinë bosh dhe në to nuk organizohen sa duhet aktivitete për edukimin e dëfrimin e rinisë. Problemi është që të rinjtë të mos humbasin shumë kohë vetëm duke luajtur. Pse disa prej tyre lihen të luajnë me orë të tëra me top e të sillen nëpër rrugë? Nuk jemi në gjendje ne të kontrollojmë fëmijët tanë e t'i mësojmë ata me një regjim në jetë? Për të zgjidhur këtë problem nuk nevojiten të holla, por punë shoqërore. Ne jemi rritur në kohë të tjera, por kur errej, secili shkante me kohë në shtëpi, ndryshe babai i fliste të birit duke i thënë: «Duhet të vish në shtëpi para meje, pse ty do të presim që të hamë darkë?!»

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## NGA FJALA NË KONFERENCËN E PARTISË TË QYTETIT TË TIRANËS

15 mars 1959

Shokë;

Më lejoni t'ju sjell përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë dhe urimet më të mira për sukseset në punimet e kësaj konference, juve, të deleguarve të organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës, t'ju uroj gjithashtu për punën e mirë që keni bërë gjatë këtij viti dhe për suksese të tjera të mëtejshme në të gjithë punën tonë të drejtimit dhe të prodhimit!

Dëgjova këtu me vërejtje si raportin e komitetit të Partisë, ashtu edhe diskutimet e delegatëve. Unë mund të them se diskutimet që u bënë këtu ishin të një niveli të lartë, gjë që tregon pjekurinë e Partisë sonë në kryerjen e detyrave.

Tani jemi larg atyre kohëve, kur Partia jonë, si edhe tani, luftonte me vështirësi shumë të mëdha, sepse në realizimin e planeve kishte mjaft boshllëqe dhe në punën e shokëve, me gjithë vullnetin e tyre të madh, kishte shumë dobësi. Kjo nuk do të thotë se dobësitë tona tani janë zhdukur, ne kemi akoma mjaft dobësi, po çdo vit kuadrot e Partisë sonë rriten, fitojnë



eksperiencë e dituri dhe punojnë më mirë. Ky proces ndodh në të gjithë Partinë tonë. Shokët e Komitetit Qendror, që kanë asistuar në konferencat e ndryshme të Partisë, më kanë raportuar se një gjë e tillë ndodh në të gjitha organizatat e Partisë. Tani shokët e Partisë sonë janë lidhur mirë me punën, me prodhimin, me bazën dhe luftojnë me heroizëm në këtë drejtim. Kjo duket në sukseset që kemi arritur.

Konferencat e Partisë që ne bëjmë janë shumë të nevojshme, bile të domosdoshme, sepse në to komunistët përfitojnë shumë dhe armatosen. Udhëheqjes së Partisë i kanë ardhur shumë herë propozime për t'i mbledhur më rrallë këto konferenca. Këtë e bëjnë shokët se kanë më tepër telashe në përgatitjen e konferencave. Por Komiteti Qendror nuk i ka marrë parasysh këto propozime, duke u nisur nga vlera që kanë dhe duke menduar se po të rregullohet mirë puna e përgatitjes së konferencave, d.m.th. po të jetë udhëheqja e organizatës kurdoherë në krye të situatës, përgatitja e konferencës nuk lyp ndonjë kohë të gjatë. Kjo nuk do të thotë se punimet e konferencës në këtë rast do të bëhen në një nivel të ulët. Faktet tregojnë se konferencat e Partisë te ne po bëhen çdo vit e më mirë.

Rëndësi ka çështja që jo vetëm shokët të dalin këtej më të armatosur për të kryer me sukses detyrat që iu ngarkohen, po këtu udhëheqja e Partisë duhet të shkëmbejë eksperiencën me bazën. Në këto mbledhje ka rëndësi edhe fakti që udhëheqja duhet të japë edhe llogari përpara Partisë për punën që ka bërë. Kështu asaj i duhet të dalë këtu me analizë të punës së saj, të vërë në dukje të metat dhe dobësitë e punës së saj e të

të gjithë organizatës dhe të ndjejë përgjegjësinë, sepse konferenca do ta thotë fjalën e vet, do ta lavdërojë udhëheqjen për ato që ajo i ka kryer mirë, do ta kritikojë për të metat dhe dobësitë dhe pastaj do të zgjedhë në udhëheqje ata që e meritojnë. Në këtë mënyrë si përgjegjësia individuale ashtu dhe ajo kolektive bëhen më të mëdha.

Të gjithë ju që jeni këtu të deleguar duhet ta kuptoni edhe përgjegjësinë që keni përpara organizatave-bazë dhe komunistëve që ju kanë zgjedhur. Çështja është që për punimet e konferencës, vendimet, kritikën dhe vërejtjet që u bënë këtu në lidhje me punën, ju duhet të reflektoni mirë dhe jo vetëm ju, por të mobilizoni organizatat-bazë që këto mësimë të vihen në jetë.

Unë vura re me kujdes se ju i dëgjuat me vërejtje raportin që u mbajt këtu dhe diskutimet që u bënë, se e kuptoni momentin dhe rolin e madh udhëheqës të Partisë. Duhet të keni parasysh se organizata e Partisë e qytetit të Tiranës është organizata më e madhe në Partinë tonë dhe ju e dini se ajo ka në përbërjen e saj komunistë më të ngritur ideologjikisht nga të gjitha organizatat e tjera. Prandaj edhe detyrat tuaja, shokë, janë më të mëdha, ato detyra nuk kanë vetëm karakter lokal, por edhe nacional. Këtë e them, sepse shumë nga organizatat-bazë të Partisë të kryeqytetit, kanë për detyrë të ndihmojnë në kontrollin dhe zbatimin e vendimeve të Partisë dhe të shtetit në të gjithë Shqipërinë, sepse në organizatën e Tiranës bëjnë pjesë një sërë kuadrësh që janë në drejtim të organeve të Partisë dhe të pushtetit tonë demokratik popullor dhe kanë kështu përgjegjësi jo vetëm lokale, por edhe nacionale.

Një tjetër çështje që duhet të kemi parasysh ne komunistët e organizatës së Tiranës është që me rezultatet e punës, besnikërinë dhe inisiativën tonë të bëhemi shembull për të gjithë komunistët e organizatave të tjera të vendit tonë. Qëndrimet tona janë pasqyrë për të gjithë anëtarët e Partisë dhe punonjësit e vendit tonë. Po të punojë mirë organizata e Tiranës, në shembullin e saj do të punojnë edhe të gjitha organizatat e tjera të Partisë. Unë vura re me kënaqësi se shokët që diskutuan këtu punën e tyre e lidhën me punën e organizatës-bazë në qendrën e punës së tyre. Me këtë dua të them se komunistët e organizatës së qytetit të Tiranës e kanë kuptuar mirë rëndësinë dhe rolin e Partisë në drejtim të të gjithë jetës së vendit si dhe vetë rolin e organizatës-bazë.

Pa një organizatë-bazë të shëndoshë është e pamundur të kishim këto rezultate që janë arritur, si dhe të sigurojmë ato që duhen arritur. Prandaj të kemi kurdoherë parasysh punën që duhet të bëjmë për të forcuar organizatat-bazë në qendrat e punës në shumë drejtime. Në radhë të parë t'i forcojmë ato organizativisht. D.m.th. komunistët jo vetëm të kuptojnë si duhet detyrat që përmban Statuti i Partisë si dhe ligjet e saj, por edhe t'i zbatojnë ato sa më mirë, në mënyrë që jeta në organizatat-bazë të bëhet sa më luftarake. Ne konstatojmë me kënaqësi se shumë organizata-bazë partie janë bërë me të vërtetë luftarake. Megjithatë ka edhe organizata të dobëta në të cilat nuk rrihen problemet kyçe që preokupojnë Partinë dhe popullin, kështu që mbledhjet në to shumë herë bëhen formale. Në këtë drejtim ne duhet të ecim duke i forcuar organizatat-

-bazë dhe ligjet e Partisë për çështjet organizative t'i zbatojmë mirë në jetë.

Që të bëhen me të vërtetë luftarake organizatat-bazë, duhet që çështjet e edukimit politik dhe ideologjik të marrin një hov më të madh se deri tani. Me gjithë dobësitë që ekzistojnë, deri tani ne kemi rezultate në këtë çështje, e megjithatë çështjes së edukimit të komunistëve duhet t'i kushtojmë rëndësi të veçantë. E kam fjalën për ndjekjen e të gjitha formave të edukimit të Partisë nga ana e komunistëve. Çështja këtu nuk qëndron vetëm në faktin që ata të mësojnë teorinë marksiste, po atë që mësojnë ta vënë të tërë në jetë, ta zbatojnë dhe ta lidhin me jetën e organizatës-bazë. Në diskutimet që bëhen në organizatën-bazë për probleme të ndryshme duket niveli ideologjik dhe politik i kuadrove. Me këtë barometër ne e kuptojmë se sa mësojnë dhe ngrihen anëtarët e Partisë. Vetëm duke e zbatuar mirë këtë detyrë ne do ta forcojmë akoma më shumë organizatën-bazë.

Ne duhet të luftojmë akoma më shumë për forcimin ideologjik e politik të Partisë dhe në këtë drejtim duhet të bëjmë një punë të madhe veçanërisht kundër mbeturinave mikroborgjeze të komunistët, sepse në jetën e anëtarëve të Partisë shohim disa shfaqje që duhen luftuar, sidomos ato që kanë të bëjnë me jetën shoqërore sepse në disa raste ato bëhen preokupante. Këto gjëra ne duhet t'i luftojmë në organizatat-bazë, sepse duhet të kemi parasysh se Partia jonë është e shëndoshë, gjë që pasqyron karakterin e pastër dhe të fortë të popullit tonë, te i cili nuk kanë hyrë dhe nuk janë bërë sëmundje shumë vese që në vendet e tjera janë më të

përhapura e më të zhvilluara. Po kjo nuk do të thotë se në vendin tonë shumë mbeturina të klasave feudale dhe borgjeze janë zhdukur ose e gjithë propaganda e madhe që bën imperializmi për të komprometuar njerëzit dhe rininë nuk është futur sado pak edhe në vendin tonë. Prandaj që tani që shohim disa shfaqje, sidomos te disa të rinj, të cilat janë një sëmundje e madhe, ne duhet të bëjmë një luftë të ashpër kundër tyre, si dhe kundër propagandës së armikut që përpiqet të degjenerojë njerëzit tanë, veçanërisht rininë.

Organizatata-bazë duhet të ushtrojnë një kontroll të fortë në lidhje me ngritjen e nivelit arsimor dhe teknik të komunistëve. Shumë herë këto detyra kuptohen si thjesht shtetërore, po këtë punë e ka për detyrë ta kontrollojë Partia, sepse punën e shkollave, çështjen e edukimit të punëtorëve në kurse nuk e ka vetëm ndërmarrja. Çdo gjë duhet të bëhet nën drejtimin e Partisë. Nëse organizata-bazë e ushtron mirë këtë kontroll dhe jep ndihmën e duhur, njerëzit tanë do të ngrihen, do të edukohen, do të përfitojnë nga të gjitha këto mundësi që kanë krijuar shteti dhe Partia. Kështu organizatat-bazë do të forcohen, komunistët do të ngrihen, organizata-bazë do të jetë në krye të punëve dhe kjo do të ketë pasojat e saja në realizimin e planeve tona ekonomike. Prandaj disa çështje duhet të kuptohen mirë dhe organizatat-bazë t'i marrin në dorën e tyre. Ato duhet të shikojnë si do të funksionojnë dhe cilat janë detyrat e tyre në drejtim të rolit drejtues, edukues të rinisë, të gruas, të bashkimeve profesionale etj., sepse disa komunistë dhe organizata-bazë nuk e kanë të qartë akoma këtë çështje. Ata i dinë ato në teori, po kur vjen

çështja për t'i kryer në praktikë këto detyra, tregojnë dobësi të mëdha. Prandaj në këtë drejtim duhet të luftojmë shumë.

Komunistët duhet të japin shembullin personal në punë dhe në jetë, sepse ndodh që këtë nuk e bëjnë të gjithë. Ka anëtarë partie që nuk janë shembull në disiplinë, në zbatimin e normave, në punën për edukimin e tyre, në jetën shoqërore dhe në punën e përditshme. Një gjë e tillë neve nuk na lejohet. Duhet të kemi parasysh se sytë e popullit janë drejtuar nga komunistët, sepse populli ka besim të madh te Partia, prandaj duhet të punojmë vazhdimisht që ta meritojmë këtë besim.

Organizata e Partisë e qytetit të Tiranës është më e favorizuar nga të gjitha organizatat e tjera të Partisë sonë, sepse ajo ka ndihmën direkte të Komitetit Qendror dhe të qeverisë në zbatimin e direktivave të Partisë dhe kjo ndihmë është e përditshme, kontaktet janë të afërta dhe masat për çdo gjë merren shpejt. Prandaj ne anëtarët e Partisë të organizatës së Tiranës duhet ta kuptojmë rolin drejtues si udhëheqje kolektive, si plenum ose si byro e komitetit të Partisë e jo vetëm kaq, po edhe çdo komunist duhet ta kuptojë përgjegjësinë personale që ka në kryerjen e detyrave. Partia jonë e ka rritur nivelin e saj aq sa komunistët i preokupojnë jashtëzakonisht problemet e Partisë, të popullit dhe të shtetit. Ky është një sukses i madh për Partinë tonë se edhe në vendet e tjera në partitë komuniste ka anëtarë partie që bëjnë përpjekje në punë, po shumë herë përpara interesave të vogla personale harrojnë detyrat e mëdha që kanë si pararojë, si udhëheqës. Pjesa dërrmuese e anëtarëve të Partisë sonë janë komunistë

me ndërgjegje të lartë, ata s'i zë as gjumi për çështjet e Partisë dhe të shtetit. Pra ne duhet të punojmë që këtë anë pozitive ta forcojmë në të gjithë komunistët tanë. Para së gjithash secili nga ne të zbatojë detyrat që kemi përpara Partisë dhe popullit për t'i dhënë popullit sa më shumë të mira, që ai të shohë kështu figurën e shquar të anëtarit të Partisë.

Ju, shokët e Tiranës, jeni të favorizuar se këtu në kryeqytet edukimi profesional, politik, ideologjik i komunistëve mund të bëhet shumë më lehtë dhe më mirë se kudo, sepse këtu ka shumë mundësi. Këtu është Shkolla trevjeçare e Partisë, ka shkolla të shumta të ndryshme shtetërore. Atëherë është me të vërtetë një faj i rëndë në qoftë se në radhë të parë komunistët, por edhe të gjithë punonjësit, nuk do të përfitojnë nga të gjitha këto lehtësi. Në Tiranë shfaqen më shumë filma, ka klube, shtëpi kulture dhe akoma të tjera do të ndërtohen. Prandaj të na vrasë ndërgjegjja si komunistë në qoftë se këto mundësi të mëdha nuk i shfrytëzojmë. Këtë e lyp e mira jonë.

Ne kemi edhe avantazhe të tjera këtu: 35 për qind e efektivit të organizatës sonë janë elementë të klasës punëtore, kurse kemi rrethe që e kryejnë mirë detyrën, po përqindja e punëtorëve në organizatat e tyre është jashtëzakonisht e ulët, pasi janë rrethe bujqësore ose blegtorale. Por ata, pavarësisht se kanë klasë punëtore të vogël, kanë një fshatarësi të vendosur revolucionare siç është e gjithë fshatarësia e vendit tonë e lidhur ngushtë me klasën punëtore dhe Partinë. Fakti që organizata e Partisë e Tiranës ka 35 për qind punëtorë tregon se ajo është një organizatë e shëndoshë, prandaj këtu

duhet të bëjmë akoma më shumë përpjekje në realizimin e planeve dhe në përmirësimin e jetës së punonjësve, në zhdukjen e mbeturinave mikroborgjeze nga radhët tona.

Një tjetër avantazh ka Tirana se këtu janë dhe punojnë shumica dërrmuese e kuadrove të vjetër të Partisë sonë, që kanë një eksperiencë të madhe. Vetëm të vjetëve 1941—1945 këtu ka rreth 250 kuadro. Kjo është një ndihmë e madhe për organizatën e Tiranës. Prandaj në qoftë se ky grup e organizon mirë punën atje ku e ka ngarkuar Partia, planet tona në Tiranë jo vetëm do të realizohen, por duhet të luftojmë edhe për t'i tejkaluar në një shkallë të madhe.

Siç e shihni, organizata e Partisë e qytetit të Tiranës ka favore të mëdha, por ajo ka njëkohësisht edhe detyra të mëdha, të cilat duhet t'i kryejë më përpara dhe më mirë se organizatat e tjera që nuk i kanë gjithë këto mundësi dhe që duhet të marrin shembull e mësim nga organizata e Tiranës.

Sigurisht ju shokë të Tiranës në aktivin tuaj keni plot suksese, po te ju mund të punohet akoma më mirë, se edhe këtu ka të meta e dobësi në punë, të cilat u theksuan si në raport, i cili është serioz dhe vë mirë në dukje të gjithë veprimtarinë njëvjeçare të organizatës sonë dhe hap perspektiva të mira për të ardhshmen, ashtu edhe në diskutimet që u bënë nga ana e shokëve. Në raportin që mbajti shoku Rrapo [Dervishi] duhet të bëhet një studim më i thellë për të përgatitur si duhet masat për mobilizimin e Partisë në realizimin e detyrave. Po edhe diskutimet që bënë këtu shokët kanë një vlerë të madhe, prandaj komiteti i ri i Partisë duhet të



gjejë formën që ato të bien në duart e të gjithë komunistëve të organizatës së Tiranës, sepse pasqyrojnë jo vetëm sukseset, të metat dhe detyrat tona, por edhe kuptimin e drejtë të direktivave të Partisë me të cilat duhet të armatoset çdo komunist në jetën e tij praktike. Kështu komunistët do të shohin se do t'i kapërcejnë më me lehtësi vështirësitë që u dalin përpara e që i hasim çdo ditë dhe muaj në realizimin e planeve tona. Në punën tonë kemi mungesa, qoftë objektive ashtu edhe subjektive, por, po të armatosemi me direktivat e Partisë, këto do t'i kapërcejmë më me lehtësi.

Tani do të them edhe disa gjëra lidhur me realizimin e planit, që nuk janë të reja për ju, po dëshiroj të theksoj disa prej tyre.

Ju e dini se plani ynë megjithëse i madh është real. Nga realizimi i tij varet mirëqenia e popullit tonë. Veçanërisht këtë vit që do të festojmë 15-vjetorin e Çlirimit, jetën e popullit duhet ta bëjmë akoma më të gëzuar, sepse i kemi të gjitha mundësitë që planin pesëvjeçar ta realizojmë në 4 vjet e gjysmë. Komiteti i Partisë i Tiranës e tha në raportin e vet dhe e gjithë organizata e Tiranës është dakord për këtë gjë. Por që të realizohet plani në 4 vjet e gjysmë, duhet që ky vit të jetë viti i një sforcje dhe i një heroizmi të madh në punë që nuk është parë deri tani, sepse viti 1959, sikurse ka thënë Komiteti Qendror, është një vit vendimtar për realizimin dhe tejkalimin e pesëvjeçarit të dytë.

Planet ekonomike të qytetit të Tiranës në sektorin e industrisë, të ndërtimit e të artizanatit kanë një peshë shumë të madhe në planin e përgjithshëm të shtetit. Prodhimi industrial këtu përfaqëson 19-20 për qind të

planit të të gjithë industrisë së vendit, ai i industrisë lokale 28 për qind, i artizanatit afërsisht 16 për qind dhe i ndërtimeve 12 për qind. Xhiroja e tregtisë zë gati  $1/5$  e gjithë xhiros si Republikë. Prandaj në këto drejtime këtë vit duhet të bëhet një sforcë e madhe. Këto çështje i shtrojmë edhe një herë, se megjithëqë shtrohen çdo vit, punët nuk ecin si duhet. Këtë vit ndjekja e planit ka filluar më mirë nga vjetët e tjerë. Kjo tregon se organizata e Partisë e qytetit të Tiranës qëndron në krye të çështjeve. Mirëpo ka rrezik që ky ritëm të ngadalësohet, prandaj plani të ndiqet çdo muaj e çdo ditë dhe jo vetëm nga lart, po dita-ditës në bazë, atje ku punohet. Ritmika e planit dhe organizimi i punës duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të mos krijohen boshllëqe dhe vështirësitë që do të na dalin përpara të përpiqemi t'i zgjidhim. Ndërmarrje të tilla si NIL-Prodhimet, ajo e qelqit, e zarzavateve duhet ta forcojnë organizimin e punës dhe organizatat-bazë atje ta ndjekin mirë realizimin e planit se nuk e kanë filluar si duhet punën.

Ne komunistët që jemi edhe drejtues, edhe edukues, edhe prodhues, edhe konsumatorë, ashtu si gjithë populli na dhimbset dhe nuk na vjen mirë kur blejmë plaçka me cilësi jo të mirë. Po nga varet përmirësimi i cilësisë? Nga ne, në radhë të parë, nga anëtarët e Partisë. Populli kënaqet kur plaçka që blen është me cilësi të mirë, pa le të kushtojë edhe pak më shtrenjtë. Megjithatë duhet të përpiqemi që çmimi të jetë edhe më i lirë. Cilësia e mallit e kënaq popullin nga ana e jashtme po duhet ta kënaqë atë edhe nga ana ekonomike, d.m.th. të jetë më i lirë. Ne nuk do të ecim drejt ngritjes së rrogave. Komiteti Qendror dhe qeveria

janë duke studjuar disa rregullime, do të merren edhe disa masa të tjera që po i studjojmë, po rëndësi duhet t'i vëmë cilësisë dhe sasisë së mallit të prodhuar.

Këtu u ngrit edhe çështja e fuqisë punëtore që nuk shfrytëzohet si duhet. Humbje në punë kemi nga mungesa e disiplinës në punë, nga pakujdesitë dhe hiletë që bëhen nga njerëzit e pandërgjegjshëm. Shifrat këtu u thanë, po që të mos kemi humbje, Partia duhet të bëjë një punë të shëndoshë politike, të thellë dhe sqaruese. Organizatat profesionale duhet të lidhen më ngushtë me punëtorët e udhëheqësit dhe të kërkohet nga udhëheqja të merren masat e duhura të parashikuara në kontratat kolektive, që punëtorët të shohin një interesim të veçantë nga qendrat e punës, të shohin se Partia interesohet për edukimin e tyre politik, ta kuptojnë se humbjet e mëdha në punë për një çështje të vogël i dëmton në radhë të parë ata vetë. Kur vjen çështja e uljes së çmimeve, e favoreve, punëtorët duhet të kuptojnë se këto të ardhura lindin nga një punë e sinkronizuar, prandaj që t'i kemi këto favore duhet të insistojmë që të forcohet ndërgjegjja dhe disiplina në punë si nga ana shtetërore, ashtu edhe nga ana e Partisë. Kjo do të bëhet me një punë të mirë politike dhe shoqërore me punonjësit.

Një detyrë tjetër e rëndësishme për ne është shfrytëzimi i mirë i makinerisë, sepse në këtë çështje nuk bëhet sa duhet. Edhe në këtë punë kemi suksese, nuk jemi si përpara, sepse punëtorët tanë tani kanë kaq vjet që i përdorin ato dhe kanë mësuar, po rëndësi të madhe ka që makineria të shfrytëzohet më shumë dhe kjo detyrë mund të realizohet plotësisht me edu-

kimin teknik të punëtorëve, prandaj kësaj duhet t'i vëmë rëndësi shumë të madhe. Për këtë qëllim duhet që drejtuesit e ndërmarrjeve dhe organizatat e Partisë në to të tregojnë kujdes të madh për edukimin teknik të punëtorëve dhe të ushtrohet kontroll i vazhdueshëm e i rreptë në drejtim të shfrytëzimit të makinerive. Çështja është që të ndodhin sa më pak difekte, të ekonomizohen veglat e ndërrimit, të ketë kujdes sepse kujdesi mund të evitojë shumë dëme në makineritë. Prandaj organizatat-bazë në prodhim duhet të kenë kujdes më të madh në këtë drejtim.

Të luftohet me të gjitha forcat për uljen e kostos. Disa ndërmarrje e kanë realizuar këtë detyrë, kanë marrë edhe angazhime, po ato kanë edhe rezerva të mëdha të brendshme, për të cilat flasim aq shumë që të shfrytëzohen. Por ndërmarrjet e qelqit, të qeramikës dhe të tullave nuk kanë punuar mirë. Në rast se Partia nuk mobilizohet dhe nuk ua bën të qartë këtë çështje punëtorëve, ulja e kostos nuk mund të realizohet në shkallën që dëshirohet dhe që është në favorin e punonjësve. Atje ku kjo çështje merret në dorë me forcë, plani realizohet dhe tejkalohet. Eksperiencën e mirë të ndërmarrjeve në drejtim të uljes së kostos ne duhet ta përgjithësojmë në të gjithë industrinë nacionale dhe lokale.

Organizata e Partisë e qytetit duhet të mos kënaqet me vendosjen e normave vetëm në disa fabrika, po këtë çështje ta zgjerojë në një shkallë më të madhe në sektorin e industrisë, sidomos atje ku përdoren makineri të reja. Ne kemi akoma shumë punëtorë që nuk realizojnë as normat e thjeshta, jo se nuk janë në gjendje t'i zbatojnë ato, por ngaqë mungon vullneti, kontrolli dhe

dëshira e fortë e drejtuesve, e organizatës së Partisë dhe e organizatës profesionale për t'i futur këta punëtorë në rrugën e punës së normuar. Për këtë qëllim organizatat-bazë duhet ta kenë çështjen e vendosjes së normave në punë si detyrë të tyre të përditshme.

Një problem i madh, nacional dhe nga më të vështirët, është çështja e ndërtimeve. Në sektorin e industrisë ne kemi hedhur baza të mira, në bujqësi kemi bërë mjaft përparime, kudo tani kemi traktorë, vegla e makineri të reja bujqësore, po bëhen bonifikime jashtëzakonisht të mëdha që do t'i sjellin fitime e të ardhura të mëdha ekonomisë popullore, po përse i përket ndërtimit, kemi filluar t'i japim rëndësi vetëm këto dy-tre vjetët e fundit. Megjithatë ky mbetet një problem i madh nacional, sidomos në qytetet. Në këtë drejtim Komiteti Qendror preokupohet shumë dhe kini parasysh se këtë vit dhe vitin që vjen do të bëjmë ndërtime të mëdha, kurse në pesëvjeçarin e ardhshëm ne do të bëjmë ndërtime kolosale. Prandaj jo vetëm të përpiqemi për realizimin e planeve të ndërtimeve aktuale, sa më shpejt, më mirë dhe me kosto të ulët, po duhet të përgatitim edhe brigada të tëra ndërtuesish me njerëz të kualifikuar dhe këta njerëz do t'i nxjerrim nga ndërmarrjet e ndërtimit. Prandaj njerëzit e Partisë që punojnë në sektorin e ndërtimit duhet të jenë të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha që kanë përpara, për vështirësitë që do të hasin dhe po të mos mendojnë që tani për detyrat e mëdha që kanë, nuk ka për të ecur mirë puna në pesëvjeçarin e tretë dhe atëherë nuk do të jetë gjendja më si tani kur një ndërmarrje i drejtohet Komitetit Qendror që të ndërhyjë për t'i siguruar 10 karpentierë.

Atëherë neve do të na duhen me mijëra specialistë të tillë apo punëtorë të kualifikuar të degëve të tjera të ndërtimit që duhen përgatitur që tani. Përse i përket ndërmarrjes «21 Dhjetori» puna nuk ka shkuar keq, sido që objektet nuk i ka dorëzuar në kohë dhe angazhimet që morën shokët e ndërtimit, sidomos për dorëzimin e ndërtesave të banimit, nuk i mbajtën. Prandaj angazhimi që kanë marrë këtë vit për t'i dorëzuar ato me rastin e 28-29 Nëntorit duhet të realizohet me doemos.

Po edhe ndërmarrjet furnitore të ndërtimit duhet të jenë në rregull, sidomos Ministria e Industrisë, e cila i furnizon këto ndërmarrje me lëndë druri dhe me materiale të tjera ndërtimi. Kjo çështje duhet marrë seriozisht. Bëhen studime në rrugë e sipër se nevojiten materiale për ndërtimin e fabrikave të shumta për prodhimin e tullave dhe këto ngecin në vend. Çdo dobësi në këtë drejtim duhet të marrë fund dhe të shpejtohet ndërtimi i fabrikave të tullave, sepse ndërtimet kërkojnë tulla dhe shumë objekte kanë mbetur pa përfunduar vetëm për mungesë të tyre.

Organizata-bazë e ndërmarrjes së transportit të punojë më mirë dhe të vendosë qëndrueshmëri në gjendjen teknike dhe në përdorimin e automjeteve, se gjatë vitit 1958 kjo ndërmarrje ka punuar me hope dhe ka pasur humbje. Prandaj të riorganizohen si duhet repartet e riparimit dhe të ngrihet gatishmëria teknike. Shumë orë harxhohen për riparimin e një kamioni, prandaj shumë nga këto orë mund të konsiderohen të humbura. Po të organizohet mirë puna, po të mobilizohen mirë anëtarët e Partisë dhe të edukohen më mirë shoferët e parkut automobilistik, do të sigurohet gatishmëria tek-

nike e automjeteve dhe parku i Tiranës do të japë një ndihmë të madhe edhe për parqet e tjera. Prandaj organizata-bazë e parkut automobilistik të punojë që të përmirësohet cilësia e riparimeve, të punojë akoma më mirë me shoferët që të tregojnë kujdes në ruajtjen e automjeteve. Shoferët janë njerëz të mirë. Ne shohim me kënaqësi se në lëvizjen për të bërë 100 dhe 300 mijë km pa revizionim të përgjithshëm etj. marrin pjesë shumë prej tyre dhe i realizojnë angazhimet. Ata kanë një punë shumë të vështirë. Po edhe puna e Partisë për shkak të natyrës së punës së shoferëve është pak e vështirë. Prandaj organizata-bazë e Partisë e parkut të gjejë format dhe metodën e përshtatshme për edukimin e punonjësve të saj, se janë njerëz të klasës punëtore dhe vënë në përdorim mjete të tilla pa të cilat nuk mund të mendohet zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës në vendin tonë. Dhe të mos harrojmë se akoma transporti automobilistik është lloji kryesor i transportit në vendin tonë. Shoferët tanë kanë punë të vështirë dhe kushte të vështira punë, ku flenë sot nuk flenë nesër. Prandaj sa të jetë e mundur të bëhen përpjekje për përmirësimin e kushteve të punës së tyre dhe për edukimin e tyre.

Organizata-bazë në oficinën qendrore të transportit punon më mirë për pakësimin e ciklit të riparimeve, për përmirësimin e cilësisë së prodhimit. Po një kujdes akoma më i madh i duhet kushtuar ruajtjes me shumë kujdes të pjesëve të këmbimit sepse sigurimi i tyre na kushton shumë valutë.

Është një gjë shumë e mirë fakti që organet e transportit kanë lidhje kaq të ngushta me uzinën

«Enver» dhe së bashku me të ato duhet të bëjnë një punë akoma më të madhe për të prodhuar në vend akoma më shumë vegla ndërrimi. Në uzinën «Enver» bëhen mjaft përpjekje në këtë drejtim; atje ka një kolektiv shumë të mirë që bën përpjekje, ka inisiativë dhe prodhon mjaft gjëra të reja. Ne duhet të kënaqemi edhe me veglat që prodhohen për herë të parë në vendin tonë, megjithëse ato mund të mos jenë me atë cilësi siç mund të jenë të njëjtat vegla që vijnë nga jashtë, se menjëherë nuk mund të arrihet niveli teknik botëror. Megjithatë po shihet se punëtorët e uzinës sonë kanë arritur të prodhojnë shumë vegla të përsosura, në atë shkallë sa u afrohen shumë atyre që vijnë nga jashtë. Prandaj duhet të kënaqemi me veglat që prodhohen në vend. Por ndodh që nga ndonjë dikaster, si nga Ministria e Bujqësisë, bëhen porosi të pastudjuara mirë, kështu që, porsa uzina i prodhon këto vegla, i thuhet se nuk na duhen të tilla vegla. Prandaj nga ana e Ministrisë së Bujqësisë duhet të tregohet më shumë interesim në këtë drejtim.

Të gjithë duhet ta kuptojnë, qofshin këta ministra apo anëtarë të Komitetit Qendror, se organizata e Partisë e qytetit të Tiranës është drejtuesja kryesore e punës në kryeqytet dhe në rast se këto çështje nuk shkojnë ashtu sikurse ka vendosur Komiteti Qendror, të mos mendojnë këta shokë përgjegjës se nuk përgjigjen përpara organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës, se ata qenkan përgjegjës vetëm përpara Komitetit Qendror dhe qeverisë. Në rast se këta shokë mendojnë kështu gabohen. Ata janë ndihmësit kryesorë të Komitetit Qendror dhe të qeverisë, po ata janë njëkohësisht



edhe anëtarë të organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës. Prandaj ju, shokë udhëheqës, që do të zgjidhni në krye të organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës, duhet t'u vini në dukje këtyre shokëve përgjegjës në e madhe që kanë në realizimin e direktivave të Partisë edhe përpara organizatës së kryeqytetit. Prandaj çdo komunist, çfarëdo përgjegjësi që të ketë, mund të thërritet nga sekretari ose në byro apo në komitet të Partisë dhe atje t'i kërkohet llogari. Kur uzina ankohet se Ministria e Bujqësisë nuk po tregon asnjë interesim për veglat që ajo ka prodhuar me porosi të saj, atëherë komiteti i Partisë ta thërresë ministrin e Bujqësisë e ta bëjë që të dërsijë dhe kështu mund të veprohet me çdo ministër ose anëtar të Komitetit Qendror që është efektiv i organizatës së Tiranës, se nuk duhet të mbetemi vetëm me fjalët «i dinë punët lart», «merremi vesh lart» etj., po më parë duhet të kalosh një herë këtu pastaj të shkosh lart.

Për fat të keq këtu nuk dëgjuam ndonjë nga shokët e tregtisë të na fliste. Tregtia ka rëndësi të madhe veçanërisht këtu në kryeqytet. Nuk është se tregtia ka gjëra të zeza. Përparime ka, sidomos në furnizimin e organizatave tregtare, në paraqitjen e mallrave, njerëzit e tregtisë po ngrihen, ata sillen më mirë me popullin, ruajnë më me kujdes pasurinë e shtetit, po në këtë sektor ka edhe plot të meta që u përmendën në raportin që u paraqit.

Komunistët që punojnë në sektorin e tregtisë duhet të kenë parasysh se kanë të bëjnë orë e çast me popullin. Të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë së vendit tonë prodhojnë për ta kënaqur popullin, prandaj edhe

tregtia, po të mos ngrihet në nivelin e kërkesave të popullit dhe të kënaqë ato kërkesa, nuk mund të konsiderohet tregti. Prandaj të punohet që njerëzit e tregtisë të jenë të gatshëm, të ndershëm, të ndërgjegjshëm, të sillen mirë me popullin dhe t'i paraqitin mirë mallrat, se çështja e paraqitjes luan një rol me rëndësi në psikologjinë e njerëzve.

Shokët e tregtisë bëjnë gabim të madh që nuk pranojnë kontrole të organizatës së gruas mbi punën e tyre. Këtë ata duhet ta konsiderojnë si një ndihmë të madhe se në lokalet tregtare ka papastërti, shumë dyqane mbyllen etj. Syri i popullit është shpëtim për organet e tregtisë dhe çdo dyqan jo vetëm duhet të mos i ndalojë këto kontrole po ato t'i kërkojnë me kënaqësi vetë se do të shpëtojë tregtia nga shumë të këqija. Tregtia duhet të bëjë shumë punë që ajo të furnizohet në rregull. Në rast se në këtë punë nuk ndihmohet sa duhet nga bujqësia, nga industria ose nga importi atëherë tregtia do të ketë vështirësi në drejtim të plotësimit të kërkesave të punonjësve. Prandaj dyqanet jo vetëm të furnizohen me mallra në sasi të mjaftueshme po edhe të cilësisë së mirë.

Kujdes i madh duhet të tregohet nga organizatat-bazë të Partisë edhe për përmirësimin e shërbimit ndaj popullit dhe për mbajtjen e pastërtisë në lokalet tregtare. Tani jemi në pragun e verës dhe të festës së 1 Majit e më vonë të festës së madhe të 15-vjetorit të Çlirimit. Që tani tregtia duhet të marrë masa dhe sido që na mungojnë shumë baza materiale ato që kemi duhet të shfrytëzohen si duhet dhe të bëhen përpjekje që të jemi gati për në verë.

Në çështjet e ekonomisë komunale kemi shumë dobësi. Këtë vit sidomos duhen bërë hapa përpara se me rastin e festave do të na vijnë plot delegacione partie e qeverie dhe duhet që të gjitha qytetet e Shqipërisë e veçanërisht Tirana të zbkurohen, po ajo që ka rëndësi është se ne duhet të krijojmë kushte për të kënaqur sa më mirë popullin. Disa përparime ka nëpër qytete, po në disa qytete gjendja është të vësh duart në kokë. Komiteti Qendror ua ka vënë këmbët në një këpucë shokëve të Partisë dhe të pushtetit të këtyre qyteteve. Në këtë drejtim ka përmirësime, po kemi akoma shumë për të bërë, sidomos për sistemimin e rrugëve, shesheve, parqeve etj. Po në këto çështje një rol të madh luan edhe puna e Partisë për t'i edukuar punonjësit që këta të mbajnë pastër qytetet, që të lyejnë e të pastrojnë shtëpitë dhe oborret. Në këtë drejtim kemi mundësi të organizojmë punën dhe mirë e kemi filluar, por duhet vazhduar.

Shumë harxhime bëhen për ujë, prandaj duhet edhe nga ndërmarrjet komunale të merren masa në këtë drejtim. Ujë të kemi jo me bollëk dhe mund të na qëllojë një verë e thatë e të kemi vështirësi në sigurimin e tij. Prandaj të disiplinohet harxhimi i kotë i ujit.

Drejtuesit e ndërmarrjeve ekonomike dhe organizatat e Partisë në to duhet të tregojnë shumë kujdes edhe për çështjet financiare se ka shumë të meta. Serioze vazhdon të jetë gjendja e debi-kredive në disa organizata ekonomike, si në ndërmarrjet e tullave, të qelqit, në atë ushqimore etj., të cilat nuk kanë paguar në degën e bankës 163 milion lekë. Prandaj duhet të bëhet luftë kundër debi-kredive dhe kjo çështje të jetë nën

kontrollin e organizatave-bazë të cilat duhet të luftojnë për forcimin e regjimit të kursimit.

Për artizanatin këtu nuk diskutoi njeri. Ky sektor luan një rol të madh në furnizimin e punonjësve dhe ka pasur suksese në të, por populli nuk është i kënaqur nga artizanati, sidomos përsa u përket shërbimeve dhe riparimeve. Në këtë drejtim të përmirësohet akoma puna dhe t'i shërbehet më mirë popullit. Përsa i përket çështjes së kooperimit të artizanëve privatë këtë vit puna ka shkuar mirë. Ne e kemi diskutuar edhe në Byronë Politike këtë problem që të arrijmë të krijojmë kolektive të zanatçinjve privatë. Këtë e bëjmë për t'i ardhur më mirë në ndihmë popullit dhe ta lehtësojmë nga shpenzimet, sepse artizanët privatë marrin shtrenjtë për punën e tyre. Kur artizanët privatë të shohin se kanë interes të kooperohen ata nuk do të rrinë më të veçuar. Prandaj të forcohet organizimi dhe të përmirësohet puna në ato kolektive që janë krijuar deri tani, që rreth tyre të grumbullohen edhe ata që janë akoma jashtë.

Një detyrë e rëndësishme për organizatat e Partisë është lufta që ato duhet të bëjnë për ruajtjen e pasurisë socialiste. Ka akoma shumë vjedhje, abuzime e dëmtime. Këto janë miliona, kurse shteti mendon shumë se për të rregulluar rrogat do të duhen rreth 300 milion lekë. Por në rast se u bëhet një luftë e ashpër vjedhësve, prishësve, shpërdoruesve, ne mund të sigurojmë jo 300 milion, po disa qindra milion lekë më shumë. Sigurisht ata e bëjnë punën e tyre kur gjejnë shesh, po kur vigjilenca e anëtarëve të Partisë dhe e punonjësve është e madhe dhe vjedhjet goditen ashpër, do

të kemi më pak të tilla. Prandaj duhet të marrim masa në këtë drejtim.

Me gjithë përparimet që vihen re në drejtim të ruajtjes së shëndetit të popullit në Tiranë duhet të forcohet shërbimi i popullit në poliklinika dhe spitale, të forcohet bashkëpunimi i këtyre institucioneve me fakultetin e mjekësisë, sepse shohim që mundësitë ekzistuese nuk shfrytëzohen sa duhet dhe ndodh që në spitalet venë njerëzit për t'u shtruar e presin me orë e bile me ditë të tëra dhe shumë herë nuk pranohen fare. Këto gjëra duhet të shihen mirë nga drejtuesit e institucioneve shëndetësore. Në kombinatin e tekstileve «Stalin» shërbimi mjekësor nuk kryhet si duhet. Megjithëse është një qendër e madhe punëtorësh, ka vetëm një mjek. Prandaj Ministria e Shëndetësisë ta shikojë më mirë çështjen e mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve.

Shokë,

Kundër vendit tonë, veçanërisht duke menduar se jemi një vend i vogël, grupi revizionist i Beogradit, me konceptet e tij antimarksiste, shoviniste dhe nacionalisto-borgjeze, kurdis një sërë shpifjesh dhe provokacionesh, të cilat janë të njohura prej jush. Qëllimi i të gjitha këtyre provokacioneve kundër vendit tonë dhe të gjitha vendeve të tjera të kampit të socializmit synon të na dëmtojë ne dhe çështjen e socializmit e të komunizmit dhe njëkohësisht të armiqësojë popujt e Jugosllavisë me popujt tanë.

Revizionistët jugosllavë s'kanë asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin dhe janë armiqtë e doktrinës sonë ngadhënjimtare.

E gjithë lufta e drejtë që ne u bëjmë revizionistëve, është një luftë ideologjike, e bazuar në marksizëm-leninizmin, kurse çdo veprim i tyre, çdo koncept i tyre është në luftë me marksizëm-leninizmin dhe ndihmon orë e çast imperializmin e kapitalizmin. Edhe miqtë e grupit revizionist jugosllav, ekonomistët dhe sociologët borgjezë amerikanë, në studimet e tyre mbi titizmin, dalin me konkluzionin e natyrshëm dhe të pamaskuar se titizmi s'ka asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin dhe Jugosllavia shkon drejt një shteti demokratiko-borgjez. Këtë transformim të Jugosllavisë revizionistët e shpejtojnë dhe njëkohësisht përpiqen ta maskojnë, jo më shumë për botën e jashtme, për të cilën kjo gjë është e qartë, po sidomos për të gënjer masat punonjëse të Jugosllavisë.

Kur revizionistëve jugosllavë u është çjerrë maska përgjithmonë, kur këta janë demaskuar nga e gjithë lëvizja komuniste ndërkombëtare si renegatë të marksizëm-leninizmit, Tito përsëri në fjalimet e Shkupit dhe të Beogradit, mbajtur këto ditët e fundit pas udhëtimit të tij prej 3 muajsh në Azi dhe në Afrikë, vazhdoi të pretendojë se mosmarrëveshjet ideologjike «në mes nesh, janë shumë të vogla». Sigurisht Tito e di fare mirë se këto mosmarrëveshje ideologjike janë të pakapërcyeshme, se nga ana jonë luftohet për pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe nga ana e tyre luftohet për revizionimin e marksizëm-leninizmit, për shkatërrimin e lëvizjes komuniste botërore. Por udhëheqësit revizionistë jugosllavë përpiqen të hiqen si marksistë për të gënjer popujt e Jugosllavisë, duke u thënë atyre se gjoja lufta jonë e drejtë s'ka karakter ideologjik dhe parimor.

Shumë karakteristike janë fjalimet e fundit të Titos, jo vetëm nga absurditeti i tyre, po ato pasqyrojnë disfatën e madhe të politikës së jashtme dhe të brendshme të këtij grupi, ato tregojnë se grupit revizionist të Beogradit po i rrëshqet çdo ditë e më shumë toka nën këmbë dhe çdo ditë që kalon ata po, hutohen dhe çoroditen.

Shumë bujë deshën t'i bënin revizionistët udhëtimet 3-mujor në Azi dhe në Afrikë të kryetarit të tyre. Por mali polli një mi.

Në fakt ky udhëtim ka pasur për qëllim në radhë të parë të zhvillonte në këto vende një propagandë dhe një punë armiqësore kundër Kinës dhe vendeve të tjera të kampit të socializmit dhe të mundte sado pak t'i largonte ose t'i ftohte këto vende nga miqësia e sigurtë me Republikën Popullore të Kinës dhe me vendet e tjera socialiste. Ky mision i parë dështoi me turp. Asnjëri s'i mori seriozisht fjalët dhe argumentet e këtij tellalli të imperializmit.

Qëllimi i dytë i Titos ka qenë që vendet ku ai kaloi t'i fuste në kombinacione të atilla që kapitali i hapët ose i maskuar amerikan të fuste nën kthetrat e tija ekonominë dhe drejtimin politik të këtyre vendeve. Presidenti jugosllav u propozoi udhëheqësve të vendeve afrikano-aziatike që të bëheshin pjesëtare të një banke ndërkombëtare ku edhe Jugosllavia do të vinte kuotën e saj, kurse ajo vetë është e rjepur dhe mbahet me dollarët që merr nga Amerika. Por edhe ky mision iu hodh poshtë nga udhëheqësit e këtyre vendeve, udhëheqës të zgjuar dhe luftëtarë të vendosur kundër kolonializmit.

Qëllimi tjetër i Titos ishte t'i shmangte këta popuj

nga politika paqësore e Bandungut dhe t'i fuste këto vende në kombinime politike tepër të dyshimta që binin erë departament shteti amerikan. Ai, duke u munduar të lërë në harresë frymën e vendimet e mbledhjes së Bandungut, u propozoi udhëheqësve të vendeve afrikano-aziatike të bëhen mbledhje të shteteve neutrale. Po edhe ky qëllim i tij u përbuz dhe iu hodh poshtë. Ata iu përgjigjën se ne kemi ndjekur e do të ndjekim politikën që kemi vendosur në Bandung. Me një fjalë ata i thanë Titos, ti shih punën tënde.

Më në fund, qëllimi i tij ishte thjeshtësisht propagandistik.

Vihet pyetja: Ç'i solli popullit jugosllav presidenti i tij nga ky udhëtim kaq i kushtueshëm? Këtë e tha vetë Tito në fjalimin që mbajti në Beograd kur u kthye nga udhëtimi. Ai i tha popullit, pa kurrfarë respekti për të: «I lexoni këto të mira që ju solla në komunikatat që firmosëm në ato vende».

Plagët e rënda të popullit jugosllav të shkaktuara nga udhëheqja e tij revizioniste sigurisht nuk shërohen me nuskat e Titos. Por presidenti i Jugosllavisë në fjalimet e tij pati kohë vetëm për sulme kundër Bashkimit Sovjetik, Kinës, vendeve të demokracisë popullore dhe veçanërisht kundër vendit tonë dhe Bullgarisë. Gjithë fjalimet e Titos ishin ndërtuar në këtë frymë. Ai s'la gjë pa shpifur kundër vendeve tona, bile fjalimet e tij të Shkupit dhe të Beogradit treguan edhe një herë tjetër shumë qartë, pikëpamjet antimarksiste të revizionistëve jugosllavë.

Thelbi i fjalimeve të kohëve të fundit të udhëheqësit të revizionistëve jugosllavë dhe e tërë përmbajtja



e tyre qëndron në sulmin kundër kampit të socializmit, në nxitjen e popullit jugosllav në rrugën e armiqësisimit me vendet tona për «ta bindur» popullin jugosllav se miqësia me vendet e socializmit s'është aq e nevojshme, se presidenti i tyre u siguroi popujve të Jugosllavisë «miqësinë e 600 milion vetëve» të vendeve që ai vizitoi, duke u premtuar se nga viti i ardhshëm do të shkojë edhe në 11 vende të tjera të Azisë dhe të Afrikës, të cilat e presin atë si «shpëtimtar». Dhe si zakonisht, Tito s'tha asnjë fjalë për imperialistët amerikanë, për ata që i japin dollarë, po kjo donte të thoshte natyrisht se përveç «miqësisë së re» që kaliti Tito me udhëtimin e tij, popujt e Jugosllavisë kanë edhe «miq besnikë» në Amerikë dhe në Perëndim dhe kushdo e di se kjo «miqësi» është vëltosur me miliona monedha.

Deri atje arriti Titō sa të thotë e të theksojë se vetëm 600 milion popujt që ai vizitoi janë për paqe dhe linte qartë të kuptohet se popujt e vendeve të kampit të socializmit, partitë komuniste dhe punëtorë që e urrejnë këtë grup renegatësh, janë luftënxitës, janë kundër paqes.

Tito në fjalimin e tij të Shkupit paska pyetur se kush na e dha neve shqiptarëve këtë të drejtë që t'ia themi të katër të vërtetat në fytyrë atij dhe grupit të tij tradhtar e shovinist dhe t'i demaskojmë pa mëshirë shpifjet dhe komplotet e tij kundër vendit tonë.

Është krejt e kuptueshme se një revizionist nuk mund, me konceptet ideologjike dhe politike që ka në kokë, ta kuptojë së kush na e dha neve këtë të drejtë e këtë forcë. Por ne i përgjigjemi se këtë forcë na e

dha marksizëm-leninizmi, na e dha populli dhe Partia jonë që luftuan me heroizëm dhe i thyen fashistët italianë, gjermanë, feudalët, borgjezët, intrigat e imperialistëve të ndryshëm dhe armiqtë e egër, revizionistët e Beogradit me Titon në krye. Është kjo forcë e pamposhtur që mbron sovranitetin, lirinë, kufijtë e atdheut dhe marksizëm-leninizmin në Shqipëri. Sigurisht Tito si revizionist, që s'ka as më të voglin koncept marksist, nuk mund të ketë asnjë fije besimi as në forcën e popullit, as në forcën e marksizëm-leninizmit. Por konceptet e Titos janë koncepte nacionalisto-borgjeze, janë shoviniste, janë provokuese.

Tito na akuzoi se ne marrim direktiva nga jashtë. Kjo është parulla e vjetër e imperialistëve dhe e shërbëtorëve të tyre për «gishtin dhe syrin e Moskës». Tito s'mund të bëjë përjashtim në këtë, dhe ai e vë veten në rolin e provokatorit.

Ç'argument dha Tito për të rrëzuar faktet tona të bazuara që demaskojnë veprimtarinë djallëzore të revizionistëve veçanërisht kundër vendit tonë? Absolutisht asgjë. Çfarë të thoshte, faktet janë kryeneçe. Ai tha vetëm një gjë, se gjoja ne kemi thënë në Kuvendin Popullor se «çështjen e Kosovës do ta çojmë në Kombet e Bashkuara». Ju e dini se unë s'thashë një gjë të tillë, ajo që thashë unë është e shkruar me të zezë mbi të bardhë. Pra kjo është një shpifje si të gjitha shpifjet e tyre të zakonshme, se gjoja ne po bëjmë një politikë «iridentiste» dhe «shoviniste».

Por thënia e mësipërme e Titos provon pikërisht atë që thashë unë në Kuvendin Popullor se radioja e fshehtë amerikane, me qendër në Athinë, shpreh

dëshirat dhe provokacionet e revizionistëve jugosllavë, asgjë më shumë, asgjë më pak.

Tito na kërcënoi se do të na çojë në Kombet e Bashkuara dhe do ta padisë vendin tonë si luftënxitës kundër Jugosllavisë. Populli ynë në këtë rast thotë një fjalë: «sa poshtë ka rënë kátundi».

Revizionistët jugosllavë kanë humbur logjikën dhe shpresat, megjithatë ata e dinë se as me këto kërcënime dhe as me kërcënimet e prerjes së marrëdhënieve diplomatike s'trembet njeri. Të gjitha gjyqet që janë zhvilluar kohët e fundit në Jugosllavi janë fund e krye të trilluara. Gjyqet që po kurdisin agjentët e Rankoviçit në Prizren e gjetkë janë provokacione të përgatitura me njerëz që nuk kanë asnjë lidhje me organet tona të Sigurimit të Shtetit. Këto gjyqe bëhen me qëllim nga ana e revizionistëve jugosllavë për të maskuar veprimtarinë e tyre të gjerë, por pa sukses, me anë agjentësh etj. kundër vendit tonë. Më kot ata përpiqen të grumbullojnë shpifje, për t'i pasur si argumente gjoja që të na bëjnë fajtorë për prerjen e marrëdhënieve diplomatike duke shpresuar se do të fitojnë ndonjë farë kredie në opinion ose se do ta nxitin akoma më shumë popullin jugosllav kundër popujve dhe vendeve tona. Ne pikëpamjen tonë e kemi thënë vazhdimisht, ne jemi absolutisht të papajtueshëm me këtë klikë renegatësh. Ne s'i ngatërrojmë udhëheqësit revizionistë me popullin vëlla jugosllav, të cilin e duam dhe do ta duam kurdoherë me një miqësi të sinqertë. Ne duam të kemi marrëdhënie shtetërore me shtetin jugosllav, të bëjmë tregti, por në asnjë mënyrë nuk lejojmë dhe nuk do të lejojmë që të cenohen interesat e atdheut tonë. Tito

tha në fjalimin e tij të Beogradit se është e pakuptueshme «kur burrat e shteteve të vendeve të ashtuquajtura kamp i socializmit thonë se duan të kenë marrëdhënie shtetërore me ne, dhe nga ana tjetër na quajnë agjentë të amerikanëve. A mund të bashkëpunohet me agjentët e amerikanëve?» — pyeti Tito.

Shumë vende të kampit tonë kanë marrëdhënie shtetërore dhe lidhje diplomatike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e tjera të Perëndimit. Një nga këto vende jemi dhe ne. Ne s'kemi kundërshtim që të kemi marrëdhënie edhe me Amerikën e Anglinë dhe s'është faji ynë në qoftë se s'kemi. Sidoqoftë kemi jetuar fare mirë edhe pa këto. Karvani ynë ka ecur përpara. Pra marrëdhënie shtetërore mund të kemi edhe me shtetin jugosllav dhe ashtu si nuk jemi ndalur asnjëherë dhe i kemi demaskuar dhe luftuar me sukses luftënxitësit imperialistë dhe intrigat e tyre, atë gjë do të bëjmë dhe kundër renegatëve titistë, tradhtarë të marksizëm-leninizmit.

Ne kemi qenë korrektë dhe do të jemi kurdoherë korrektë në marrëdhëniet shtetërore me fqinjët dhe me çdo shtet tjetër, por duhet edhe ata të jenë korrektë në marrëdhëniet shtetërore me ne dhe t'u përmbahen normave ndërkombëtare. E gjithë Partia, i gjithë populli, si kurdoherë, dhe bile çdo ditë e më shumë, duhet të jenë shumë vigjilentë ndaj intrigave, provokacioneve dhe kompleteve, veçanërisht të imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre. Kjo është një nga detyrat kryesore patriotike, një nga detyrat kryesore të Partisë.

Të ruhet me heroizëm dhe vigjilencë atdheu dhe populli!

Të ruhet me heroizëm dhe vigjilencë uniteti i Partisë dhe pastërtia e marksizëm-leninizmit!

Të ruhet miqësia me vendet e kampit të socializmit!

Të ruhet uniteti i kampit në bazë të parimeve marksiste-leniniste! - -

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**MBI RRITJEN E VIGJILENCËS REVOLUCIONARE  
PËR RUAJTJEN E SEKRETIT SHTETËROR  
E TË PARTISË**

*Letër gjithë organizatave-bazë të Partisë në terren,  
në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve  
të Brendshme*

**28 mars 1959**

Sivjet mbushen plot 15 vjet nga dita e Çlirimit të atdheut tonë. Në këto 15 vjet populli ynë, i udhëhequr nga Partia e tij marksiste-leniniste, ka korrur suksese të shkëlqyera. Të gjitha këto fitore janë arritur në saje të punës së madhe e të palodhur që kanë bërë masat punonjëse të vendit tonë, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë të lavdishme të Punës. Por të gjitha këto fitore janë arritur gjithashtu me luftë të ashpër e të papajtueshme kundër të gjithë armiqtë të jashtëm e të brendshëm të vendit tonë. Forcimi i gjith-anshëm i vendit tonë, perspektivat e shkëlqyera që i hapen atij i tërbojnë armiqtë, prandaj ata s'lënë mjet pa përdorur për të na dëmtuar në punën tonë, për të cenuar sado pak interesat e popullit tonë. Kjo duhet të na bëjë që për asnjë çast të mos dehem nga sukse-

set, të mos flemë mbi dafina, por të jemi kurdoherë syhapur e vigjilentë që të dështojnë kurdoherë me turp tërë përpjekjet e armiqve.

Akoma më serioze bëhet kjo detyrë për ne kur kemi parasysh faktin se ne ndërtojmë socializmin duke pasur në kufi armiq të betuar, si revizionizmin jugosllav, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë, të cilët haptazi kanë deklaruar synimet e tyre grabitqare ndaj vendit tonë, faktin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës po shpenzojnë çdo vit miliona dollarë për qëllimet e tyre kundër vendeve tona të kampit socialist.

Por duhet thënë se në disa kuadro dhe anëtarë e kandidatë partie ka një farë naiviteti, qetësie, qëndrimi të shkujdesur në kryerjen e detyrës, mungesë vigjilence dhe disipline në punë dhe në jetën personale të tyre. Këta shokë pa të drejtë nënvleftësojnë rrezikun dhe dëmin që i sjellin çështjes sonë me qëndrimin e tyre.

Nga të dhënat që ka Komiteti Qendror i PPSH, rezulton se te disa komunistë dhe kuadro në dikastere, në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, në repartet e ushtrisë dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme vihet re një nënvleftësim i palejueshëm në lidhje me ruajtjen e sekretit të Partisë dhe të shtetit. Ka thyerje të disiplinës dhe mungesë vigjilence në kryerjen e përpiktë të shërbimit dhe në zbatimin e të gjitha rregullave për ruajtjen e sekretit dhe të objekteve ekonomike e ushtarake. Shkeljet vërehen kryesisht në këto drejtime:

1. — Disa shokë si pa të keq bisedojnë në rrugë, në shtëpi, në kafene ose në telefon çështje të rëndë-

sishme sekrete të Partisë ose të shtetit, duke krijuar kështu mundësi të informohet për to edhe elementi armik. Kështu ka pasur raste që shokë të kufirit, të ushtrisë e të dikastereve kanë biseduar në telefon çështje të cilat janë transmetuar më parë me telegram shifër, gjë që sjell jo vetëm dekonspirimin e çështjes konkrete por vë në rrezik serioz edhe vetë dekonspirimin e shifrës. Disa anëtarë e kandidatë partie, sidomos në organizatat e Partisë të fshatit, si në rrethin e Durrësit, në rrethin e Lezhës e gjetkë, kanë biseduar me elementë të tjerë, bile edhe me qëndrim jo të mirë, çështjet që janë shtruar në organizatat-bazë, kështu i kanë dhënë rast elementit armik t'i shfrytëzojë kritikën e drejtë të komunistëve për të mbjellë grindje e përçarje. Ka të tjerë që u japin të dhëna njerëzve të huaj pa qenë të autorizuar. Në këto gabime kanë rënë disa kategori njerëzish. Disa se janë naivë dhe nuk kanë ditur të dallojnë çfarë është sekrete e çfarë jo. Të tjerët se janë llafazanë të sëmurë, ose kapadai që duan të tregohen se dinë gjithçka, që mundohen të dinë më shumë se sa u takon, që nuk mbajnë qëndrim serioz ndaj përgjegjësisë që kanë. Për këta njerëz duhen marrë masa të rënda dhe në rast se nuk ndreqen duhen shkarkuar nga postet që kanë të bëjnë me punë të një karakteri sekret.

2. — Ka mungesa kontrolli e disipline në zbatimin e rregullave për administrimin e dokumenteve. Si rrjedhim marrin njoftim për këto dokumente edhe njerëz që s'kanë asnjë lidhje me to e për më tepër nga administrimi i keq i tyre kanë humbur dhe dokumente me karakter sekret.

Nuk respektohen rregullat për arkivat, kartotekat



dhe zyrat sekrete. Dokumentet e vjetëve të kaluar mbahen në vende krejtësisht të pasiguruara...

Dokumente sekrete të punës së përditshme ose udhëzime të rëndësishme administrohen keq, disa herë merren në shtëpi ose mbahen nëpër xhepa dhe për pasojë kanë humbur...

Ka raste gjithashtu që dokumentet nuk dërgohen me postën speciale, siç është rregulli, por me persona privatë pa përgjegjësi, bile me njerëz me nënshtetësi të huaj siç ka vepruar Ministria e Tregtisë.

Shumë pakujdesi ka në ruajtjen e dokumenteve personale, tesarave të Partisë, kartave të kandidatit, pashaportave personale e librezave ushtarake, të cilat elementi armik është i interesuar shumë që t'i shtjerrë në dorë...

S'ka dyshim se nga mungesa të tilla përfiton armiku, dëmtohet shteti ynë.

3. — Ka pakujdesi në zbatimin e plotë të rregullave që ekzistojnë në ruajtjen e objekteve e të mjeteve ushtarake dhe ekonomike. Pakujdesi të tilla fillojnë që nga marrja në punë e elementëve të pakontrolluar, nga hyrja e dalja në këto objekte e njerëzve të paautorizuar, nga shkelja e rregullave kundër zjarrit e deri te fotografimi i këtyre objekteve. Nga pakujdesi të tilla dhe për mungesë vigjilence mund të dëmtohej rëndë kombinati i drurit në Elbasan, u dogj kantieri i Kryeziut në sharrat e Pukës. Kur u arrestua një element i dyshimtë për veprimtari armiqësor ai deklaroi: «Në depo pinin të gjithë duhan, pija edhe unë», kështu nga moszbatimi me rigorozitet i rregullave, depoja u dogj, armiku u fsheh dhe shteti humbi disa milion lekë...

4. — Ka pakujdesi në zgjedhjen dhe vendosjen e njerëzve në punë, sipas besnikërisë dhe aftësisë; merren në punë njerëz pa dokumente ose pa marrë aprovimin e rregullt të organeve që i kanë në nomenklaturë dhe më vonë rezulton se janë të papërshtatshëm e hiqen. Por e keqja është se njerëz që s'duhej t'i dinin sekretet e asaj pune u njoftën me to. Po kështu ka gabime në zgjedhjen e elementëve për në kurse e shkolla brenda e jashtë shtetit, ose dërgohen me shërbim apo për pushime jashtë shtetit njerëz që nuk i kanë garancitë e nevojshme. Këtu pa dyshim kanë gabime si komitetet e Partisë dhe dikasteret apo komandat e reparteve që i kanë aprovuar, ashtu edhe organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme që u kanë lëshuar pashaportat.

5. — Mbrojtja e fitoreve të popullit tonë nga elementët armiq e keqbërës është bërë te ne çështje e vetë masave dhe kjo është një fitore e madhe që ka arritur Partia jonë, por megjithatë jo në të gjitha rastet dhe nga të gjithë kuadrot vlerësohen si duhet e në kohë denoncimet dhe sinjalizimet e popullit... Mosvlerësimi i denoncimeve influencon negativisht edhe në edukimin e popullit, në ngritjen e vigjilencës së tij.

6. — Vlen të tërhiqet vëmendja e kuadrove tanë për të qenë më vigjilentë edhe në ruajtjen e sekretit nëpërmjet botimeve në shtyp, fjalimeve, urdhëresave, vendimeve, komunikatave etj., si edhe nëpërmjet të korrespondencës private që bëjnë me të tjerët.

Shokë,

Vigjilenca revolucionare është një detyrë e domosdoshme dhe e përhershme, ajo është e lidhur ngushtë

me të ardhshmen e vendit tonë, me ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Edukimi dhe forcimi i vigjilencës politike, ruajtja rigoroze e sekretit të Partisë dhe të shtetit janë të pandara edhe me edukimin e popullit shqiptar në frymën e patriotizmit të lartë dhe të urrejtjes ndaj armiqve të tij të çdo ngjyre.

Vigjilenca nuk është një veti që lind te njerëzit në mënyrë spontane. Ajo farkëtohet si rezultat i edukimit politik e i përpjekjeve të vullnetshme të çdo njeriu. Vigjilenca politike është tërësia e atyre vetive të njeriu, të cilat kërkojnë prej tij, para së gjithash, që të ruajë në mënyrë rigoroze sekretet shtetërore, të mos lejojë që të njihen me to persona, të cilët nuk e kanë këtë të drejtë, të mos dekonspirojë të dhëna sekrete që ai mëson gjatë punës ose rastësisht etj.

Vigjilenca është e lidhur ngushtë me qëndrimin e papajtueshëm që duhet të mbajë çdo komunist dhe punonjës ndaj gabimeve dhe të metave në punë, ndaj fenomeneve negative që ndeshen në jetën e njerëzve tanë.

Me qëllim që të forcohen akoma më shumë vigjilenca revolucionare dhe regjimi në ruajtjen e sekretit shtetëror e ushtarak, Komiteti Qendror i Partisë porositi:

1. — Organizatat-bazë të Partisë ta diskutojnë me seriozitetin më të madh këtë problem dhe të forcojnë kritikën si një nga mjetet e aprovuara në luftën kundër naivitetit, indiferentizmit, pakujdesisë dhe mosrespektimit të ligjshmërisë socialiste, të cilat krijojnë një ambient të përshtatshëm për dëmtuesit, spiunët dhe diversantët.

2. — Komitetet e Partisë në rrethe, organet poli-

tike dhe organizatat-bazë të Partisë të vendosin një kontroll sa më rigoroz në respektimin e rregullave të caktuara për ruajtjen e sekretit shtetëror e ushtarak nga të gjithë punonjësit që merren me dokumente sekrete. Të kihet kujdes që asnjë rast, sado i vogël dhe i pjesshëm qoftë, i shkeljes së rregullave të caktuara për ruajtjen e sekretit shtetëror të mos mbetet pa u analizuar. Të vihen para përgjegjësisë së Partisë dhe asaj shtetërore, duke marrë masa deri në përjashtimin nga Partia ose dërgimin para gjyqit, të gjithë ata punonjës që shkelin disiplinën, flasin poshtë e lart për çështje me karakter sekret shtetëror e ushtarak, tregohen të pakujdesshëm dhe indiferentë në detyrë.

3. — Drejtuesit e ministrive, institucioneve dhe ndërmarrjeve të ndryshme si edhe komandat e reparteve të forcojnë me çdo kusht regjimin në ruajtjen e sekreteve shtetërore e ushtarake dhe të marrin masa e nevojshme, pa bërë asnjë lëshim, në rast se dobësohet vigjilenca dhe nxirret sekreti nga punonjësit e tyre. Me materiale sekrete e tepër sekrete duhet të njihen vetëm ata kuadro që kanë lidhje direkte me këto materiale. Në çdo sektor pune janë ngarkuar me përgjegjësi njerëz të posaçëm dhe vetëm ata përgjigjen për punën, prandaj nuk ka përse të dijë askush tjetër për punë që nuk i përkasin.

4. — Organet e Partisë, dikasteret dhe organet e prokurorisë duhet të organizojnë punën për njohjen e ligjeve dhe të rregullave që përcaktojnë ruajtjen e sekretit të shtetit dhe të paralajmërohen të gjithë punonjësit për përgjegjësinë që kanë në rast se vërtetohen shkelje të rregullave për ruajtjen e sekretit të shtetit.

5. — Në mënyrë të veçantë porositen kuadrot dhe komunistët që punojnë në organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore si edhe ata të reparteve të tyre vartëse, që të forcojnë vigjilencën, rregullin dhe disiplinën në kryerjen e shërbimit të tyre meqë edhe elementi armik në drejtim të këtyre sektorëve ka synuar e do të synojë në mënyrë të veçantë. Komunistët dhe kuadrot në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të forcojnë punën politike me njerëzit, me qëllim që ata ta kuptojnë mirë se çfarëdo dëkonspirimi, sado i vogël qoftë, është krim ndaj atdheut dhe i sjell dëme serioze shtetit.

6. — . . . . .

7. — Komiteti Qendror i Partisë porositi gjithë organizatat dhe organet e Partisë, organet politike, komandat e reparteve dhe drejtuesit e sektorëve ekonomikë dhe kulturalo-socialë që të godasin si pikëpamje oportuniste mendimin që ekziston në disa, sipas të cilit, meqë ne jemi të fortë, armiku s'ka ç'na bën. Që ne jemi të fortë, kjo as vihet në dyshim, por është gjithashtu e vërtetë që për të prishur e për të bërë dëm nuk duhen po aq forca sa duhen për të ndrequr. Prandaj sukseset nuk duhet të na dehin por të marrim masa që të forcojmë vigjilencën. Të bëhet kjo për të gjithë një detyrë e rëndësishme partie.

Për ne janë gjithnjë aktuale fjalët e Leninit të madh i cili këtu e 40 vjet më parë ka thënë:

*«...porosia e parë e politikës sonë, mësimi i parë... , mësim që duhet ta kenë parasysh të*

*gjithë punëtorët dhe fshatarët, është që t'i hapim sytë mirë, të mos harrojmë se jemi të rrethuar nga njerëz, nga klasa dhe qeveri, të cilat shprehin haptazi një urrejtje shumë të madhe për ne»<sup>1</sup>.*

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të plotë se të gjitha organizatat-bazë të Partisë, komitetet e Partisë dhe organet politike të reparteve ushtarake, duke luftuar për ngritjen sa më lart të ndërgjegjes socialiste në punë dhe kudo, do t'u bëjnë një luftë të ashpër dobësive dhe të metave që vërtetohen në kryerjen e detyrës dhe në jetën e komunistëve e të punonjësve dhe njëkohësisht do t'i edukojnë ata me frymën e një vigjilence të lartë revolucionare, në mënyrë që armiqve të Partisë, të shtetit dhe të popullit tonë t'u priten të gjitha rrugët nga ku ata mundohen dhe do të mundohen të na godasin.

Kjo letër të punohet në mbledhje të mbyllura të të gjitha organizatave-bazë të Partisë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë  
*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 33, f. 151.

# GJITHÇKA PËR MIRËQENIEN E POPULLIT — KY ËSHTË QËLLIMI I PARTISË SONË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

8 prill 1959

Këto çështje që na paraqiten për shqyrtim vlejné të diskutohen sa më mirë, sepse janë masa të rëndësishme që merren nga Partia dhe qeveria. Diskutimi i thellë i tyre na ndihmon që të vendosim drejt.

Masat që propozohen me rastin e 15-vjetorit të Çlirimit kanë një rëndësi të madhe politike dhe ekonomike. Këtu kemi tri gjëra: ngritjen e rrogave, uljen e çmimeve dhe unifikimin e çmimeve bujqësore e blegtorale për të favorizuar fshatarësinë. Këto masa mund të zbatohen në dy data të rëndësishme: më 1 Maj dhe më 29 Nëntor, që është dita e 15-vjetorit të Çliri-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u diskutua rreth studimit «Mbi çmimet unike të grumbullimeve të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mënyrën e organizimit të grumbullimeve dhe uljen e çmimeve të shitjes me pakicë të mallrave të konsumit të gjerë».

mit. Në qoftë se marrjen e këtyre masave e ndajmë në dy faza, atëherë ka mundësi që më 1 Maj të bëjmë uljen e çmimeve, kurse më 29 Nëntor ngritjen e rrogave dhe marrjen e masave të tjera në favor të fshatarësisë. Prandaj të organizojmë mirë propagandën e Partisë për t'i popullarizuar këto masa që marrim dhe për të ngritur më lart entuziazmin dhe mobilizimin e punonjësve në plotësimin e detyrave që kemi përpara.

Lidhur me çmimet kisha këto vërejtje: Po t'i shikosh shifrat nga jashtë, ato janë shumë të mira, por në qoftë se hyjmë në brendinë e tyre, do të gjejmë edhe gjëra që kërkojnë diskutim. Kështu, po të caktojmë çmimin e bukës 20 lekë/kg më duket se e ulim shumë. Nga ana tjetër, në qoftë se do të heqim detyrimin e leshit, duhet të kemi parasysh që atë do ta bëjmë duke e zëvendësuar me prodhimet tona industriale. Fshatari, duke dorëzuar leshin, duhet të blejë shajake ose sende të pambukta dhe të shohë leverdinë. Pra, në qoftë se pranojmë të heqim detyrimin e leshit, duhet të parashikojmë një ulje çmimesh më të madhe për stofat e leshta dhe të pambukta. Po ne nuk jemi në gjendje ta bëjmë tani uljen e çmimeve për këta artikuj, prandaj jemi të detyruar ta mbajmë detyrimin e leshit.

Ashtu si të gjithë shokët, edhe unë jam i mendimit se ne i ulim çmimet e mallrave industriale për arsye se ulim koston e prodhimit në industri. Në këtë sektor, me përpjekjet e klasës punëtore janë krijuar mundësitë e nevojshme për të bërë uljen e çmimeve. Ndërsa në bujqësi nuk bëhen të gjitha përpjekjet për realizimin e rendimenteve të caktuara që të mund të ulet edhe



çmimi i bukës. Në qoftë se nuk marrim masa që të ulim koston e prodhimit bujqësor dhe të shtojmë rendimentet, çmimet në artikujt e këtij sektori do të ulen në kurriz të akumulacionit që sigurojmë nga industria; kështu ne prekim interesat e shtetit dhe të klasës punëtore. Prandaj fshatarësia duhet të shtojë përpjekjet dhe të rritë mobilizimin për më shumë prodhime bujqësore.

Më duket se nuk është e drejtë që ne të paguajmë për pambukun dhe duhanin si për të gjitha prodhimet e tjera industriale. Këto çmime i kemi caktuar para dy vjetësh në kushte të tjera me qëllim që të nxitim fshatarësinë për t'i kultivuar, por tani mund të themi se ka ardhur një kohë tjetër. Fakti është që këto bimë kanë leverdi të madhe për fshatarësinë, por ne duhet të stimulojmë edhe drithërat për prodhimin e të cilave fshatarësia sot nuk ka dhe aq leverdi.

Është e domosdoshme që të sigurojmë prodhimin e bukës në vend, rezervat shtetërore dhe realizimin e të gjitha detyrave të caktuara nga Kongresi III i Partisë. Për këtë arsye ne nuk duhet ta heqim detyrimin e drithit, bile të vazhdojmë edhe grumbullimin e tepricave, natyrisht me çmime të diferencuara nga detyrimi. Në qoftë se tepricat do të kenë të njëjtin çmim sikurse edhe detyrimet, atëherë këto do të quhen detyrime. Çmimi i tepricave duhet të jetë më i madh se çmimi i detyrimeve. Ndryshe fshatari do ta mbajë drithin në shtëpi si rezervë të tij në vend që ky fond të jetë rezervë shtetërore. Çmimet e diferencuara midis detyrimit dhe tepricave, do të jenë një nxitje për fshatarin, i cili do të ketë leverdi që të prodhojë, të shesë e të

fitojë më shumë. Në të kundërtën mund të bëhen edhe spekulime.

Unë them se detyrimi i mishit mund të hiqet, sepse nga të dhënat që kemi, plani i grumbullimit të tij realizohet. Për pambukun dhe duhanin duhet luftuar për rritjen e cilësisë së prodhimit të tyre. Për këtë janë të gjitha kushtet. Tatimin financiar të oborreve kooperativiste të mos e heqim. Kjo është çështje parimore. Në qoftë se duam të bëjmë diçka në favor të fshatarësisë, mund të ulim ndonjë gjë tjetër. Edhe çështjen e heqjes së tatimit për punëtorët dhe nëpunësit ta shikojmë së bashku me rregullimin e rrogave. Tatimet e punonjësve kanë të bëjnë me kontributin që japin ata për ndërtimin e socializmit.

Detyrimet në natyrë për oborret kooperativiste duhet t'i heqim, por duhet pasur parasysh se ka rrezik që kooperativistët të preokupohen më shumë për oborret se sa për pronën e përbashkët të tyre. Prandaj fshatarësia ta kuptojë drejt këtë masë, prodhimin që i lëmë asaj, secili ta vërë në shërbim të familjes për të përmirësuar jetesën e saj. Gjithçka për mirëqenien e popullit — ky është qëllimi i Partisë.

Partia duhet ta ketë të qartë se këto favorizime që u bëhen kooperativave bujqësore kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe dhe duhet t'i shërbejnë shtimit të prodhimit bujqësor e blegtoral. Fshatarësia jonë nuk rron në bollëk, por jeta e saj po përmirësohet çdo ditë. Në fshat po ndërtohen shtëpi të reja. Në këtë drejtim shumë fshatarë ndihmohen edhe nga të ardhurat që marrin prej pambukut dhe duhanit, që kanë leverdi të madhe, prandaj duhet të përpiqemi që të ulim çmi-

min e tyre. Të ulet diçka çmimi i pambukut dhe të shtohet ai i panxharit, të cilin tani fshatari e mbjell vetëm ngaqë i është vënë si detyrë.

Si përfundim, për uljen e çmimeve është e domosdoshme të merren masat qysh tani, me përjashtim të çmimit të bukës për të cilin duhet të konsultohemi edhe një herë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **T'I JEPET PRIORITET EDUKIMIT IDEOPOLITIK TË PUNËTORËVE DHE TË RINISË**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 prill 1959

Marrja në shqyrtim e punës së Partisë dhe e bashkimeve profesionale në kantierin detar dhe në portin e Durrësit, do të vlejë për të forcuar më shumë këto dy qendra të rëndësishme prodhimi. Këtu dalin mjaft detyra që duhen zgjidhur menjëherë. Unë propozoj të krijohet një komision, i cili të shqyrtojë çështjen e edukimit të punëtorëve që punojnë në port dhe jashtë tij. Ky komision të jetë nën drejtimin e Partisë dhe në përbërjen e tij të ketë përfaqësues nga bashkimet profesionale dhe organizata e rinisë. Ai të shikojë si zhvillohet e ç'duhet bërë për të përmirësuar punën politike dhe edukative, çështjen e kurseve e të shkollave, të ndihmojë për këto probleme dhe të marrë masa, pastaj

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim puna e Partisë dhe e bashkimeve profesionale në kantierin detar dhe në portin e Durrësit.

për këto t'i raportohet Komitetit Qendror. Ky komision, pasi të vërë punën në vijë, të mos shkarkohet nga përgjegjësia, por të ndjekë zbatimin e këtyre detyrave bashkë me komitetin e Partisë.

Durrësi është porti kryesor i Shqipërisë, këtu vijnë të huaj, tani e tutje do të marrin zhvillim më tepër lëvizjet jashtë atdheut, prandaj marinarët duhet të edukohen që të jenë vigjilentë ndaj presioneve, shantazheve dhe kusarëve. Rastet e kontrabandës ndodhin për shkak se edukimi politik i njerëzve të portit nuk është në lartësinë e duhur. Popullin polak ne e kemi mik, por ata marinarë polakë që bëjnë kontrabandë janë armiq, prandaj vigjilenca duhet të jetë në kulm. Kujdes duhet pasur për njerëzit e anijes. Këtyre u duhet bërë instruktazh për rreziqet që mund t'u ndodhin në portet e huaja, prandaj është e domosdoshme të zhvillohet një punë e mirë edukuese me të gjithë komunistët. Të shikohet shtrirja e forcave të Partisë, duke siguruar që në çdo anije të ketë komunistë.

Gjatë diskutimeve dolën edhe disa çështje shtetërore, për zgjidhjen e të cilave duhen marrë masa. Ministria e Komunikacionit të qëndrojë akoma më afër portit të Durrësit. Ne nuk do të futemi këtu në çështjen e veglave të këmbimit; për këto Byroja Politike dhe qeveria kanë caktuar detyra, por është fakt se këto detyra nuk po realizohen si duhet. Ka edhe çështje të tjera që duhen parë, siç janë: mosshfrytëzimi i mirë i mjeteve detare, lëvizja pa kriter e automjeteve që shkojnë edhe në ato vende ku vete treni dhe ku mund të shkojnë anijet etj. Prandaj për këto çështje duhet

të veprohet shpejt nga ana e Ministrisë së Komunikacionit.

Ju, shokët e Durrësit, të bashkimeve profesionale dhe të rinisë, keni përgjegjësi të madhe për këto dy qendra, kantierin detar dhe portin e Durrësit, prandaj të merrni masa për përmirësimin e punës së tyre si në rrugë shtetërore, ashtu dhe në rrugë partie, duke u dhënë prioritet edukimit politik dhe ideologjik të punëtorëve dhe të rinisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# KRYEARTIKUJT E SHTYPIT TONË TË JENË SA MË KONKRETE, EDUKATIVE, TEORIKË DHE PRAKTIKË

*Diçkutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 prill 1959

*Para se të diskutohëz rreth planit orientues të gazetës «Zëri i popullit» dhe revistës «Rruga e Partisë», shoku Enver u drejtoi shokëve të rretheve që morën pjesë në mbledhjen e Sekretariatit, disa pyetje, siç ishin:*

A ju pëlqen juve, shokë të rretheve, gazeta «Zëri i popullit»? A ju plotësohen nevojat dhe çfarë vërejtje keni për këtë gazetë? Ju, shokë sekretarë të komiteteve të Partisë në rrethe, a e lexoni çdo ditë kryeartikullin e gazetës «Zëri i popullit»? Në rast se nuk e lexoni, na thoni arsyet përse ndodh kjo. A kanë brumë këta kryeartikuj, me qëllim që kush i lexon të mbajë shënime dhe të reflektojë për punën e vet?

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u paraqit për shqyrtim dhe aprovim plani orientues i gazetës «Zëri i popullit» dhe i revistës «Rruga e Partisë».

*Në përfundim të diskutimeve, e mori fjalën shoku Enver, i cili tha:*

Unë kisha nja dy vërejtje për shkrimet që botohen në «Zërin e popullit» dhe në «Rrugën e Partisë», prandaj drejtova edhe disa pyetje për kryeartikujt që botojnë këto dy organe.

Kryeartikujt kanë rëndësi të madhe. Ata duhet të vlejnjë për edukimin e kuadrit udhëheqës dhe të popullit, në mënyrë që secili, aty ku punon, të marrë masa për zgjidhjen e detyrave të tija. Me gjithë përmirësimet që kanë kryeartikujt, duhet pranuar se shpeshherë ata janë të përgjithshëm, disa prej tyre jo vetëm kanë shumë ujë, por nuk janë konkretë dhe nuk hyhet drejt e në çështje. Rëndësi ka titulli i kryeartikullit, por rëndësi më të madhe ka brendia e tij. Shpesh një e katërta e kryeartikujve kanë fraza të përgjithshme. Prandaj shokët që janë në krye të gazetës «Zëri i popullit» nuk duhet të lejojnë të përsëriten të metat që u vunë në dukje në diskutimet e shokëve.

Të marrim për shembull kryeartikullin që është planifikuar për botim lidhur me forcimin e disiplinës së Partisë dhe asaj shtetërore. Kur të shkruhet ky kryeartikull unë nuk do ta lexoj fare, sepse tri të katërtat e kolonës së parë do të jenë hyrje, pastaj do të jepet ndonjë shembull për këtë ose atë ndërmarrje dhe me kaq shkrimi do të mbarojë. Unë s'jam dakord me një trajtim të tillë të problemit. Kur shkruajmë për disiplinën e Partisë dhe të shtetit duhet të kemi parasysh që aty, përveç të tjerave, të thuhet se çfarë do të bëjnë organizatat e Partisë, bashkimet profesionale dhe levat e tjera për forcimin e disiplinës, si duhet ta kuptojë



dhe ta zbatojë komunisti disiplinën shtetërore, ku qëndrojnë rreziqet ndaj të cilave komunistët duhet të luftojnë në organizatën e Partisë, në punë etj.

Drejt është menduar që të shkruhen një sërë artikujsh për edukimin e klasës punëtore. Kjo është një temë e gjerë. Autorët e këtyre shkrimeve që punojnë në «Zërin e popullit» kanë vërtet eksperiencë të shkruaj-në, por nuk kanë eksperiencën e punës së Partisë. Për të shkruar mirë artikuj të tillë, nuk duhet të mbështetemi vetëm në raportet që mund të lexohen, por të shkohet në disa ndërmarrje, ku të shikohet në praktikë problemi që i kushtohet kryeartikulli ose artikulli. Po të veprohet kështu, në artikuj nuk do të ketë më ujë, por do të shkruhet si duhet për edukimin e klasës punëtore. Kemi dëgjuar se ka njerëz të cilët kanë frikë të kritikojnë dhe mendojnë se është më mirë që të vejë sekretari i komitetit të Partisë ose i organizatës-bazë për të konstatuar të metat. Kurse artikujt e shtypit tonë duhet t'i frymëzojnë e t'i nxitin këta njerëz të kenë guxim për të kritikuar dhe jo të presin që të metat të zbulohen nga të tjerët.

Ose të marrim temën tjetër që gjithashtu parashikohet për t'u botuar në gazetën «Zëri i popullit», «Mbi përmirësimin e metodës së punës të komiteteve të Partisë për zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror». Këtu ka një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me veprimtarinë e të gjitha komiteteve të Partisë të rretheve. Në rast se do të trajtohen disa probleme teorike dhe praktike të kuptueshme, atëherë artikulli do të jetë në nivelin e duhur. Mendoj se duhet luftuar që kryeartikujt dhe artikujt të jenë sa më konkretë, edu-

kativë, teorikë dhe praktikë, me eksperiencë të gjerë partie mbi ato probleme që na preokupojnë.

Lidhur me shkrimet që do të botohen me rastin e 15-vjetorit të Çlirimit, përveç këtyre që propozohen këtu, është mirë që të fillohet qysh këtë tremujor të flitet me fakte konkrete se çfarë është bërë në vendin tonë gjatë këtyre 15 vjetëve në fusha të ndryshme, për zhvillimin e industrisë, të bujqësisë, të arsimit, të kulturës. e të tjera. Artikujt që do të shkruhen për këtë qëllim të mos jenë me fjalë bombastike. Në fund të festimeve të 15-vjetorit të gjithë këta artikuj mund të përmbliidhen në një libër me titullin «Shqipëria socialiste gjatë 15 vjetëve». Këta artikuj të jenë shken-  
corë, politikë dhe propagandistikë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**RUAJTJA E SEKRETIT TË PARTISË DHE  
SHQYRTIMI I LETRAVE TË POPULLIT —  
DETYRA TË RËNDËSISHME  
PËR TË GJITHË NE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**21 prill 1959**

Më tërhoqi vëmendjen fakti që, kur folën shokët për dobësitë që ekzistojnë në Shkodër në lidhje me ruajtjen e dokumenteve, shoku sekretar i komitetit të Partisë të rrethit që është thirrur këtu, sikur u prek ca. Kontrolli për ruajtjen e sekretit ka rëndësi të madhe. Në qoftë se ky kontroll gjen dokumente mbi bango, kur njeriu s'është në zyrë, atëherë ai që i ka lënë është fajtor. Kontrolli nuk ka për qëllim të zërë njerëzit në gabim, por ka për qëllim të shikojë se si po zbatohen vendimet e Komitetit Qendror në lidhje me ruajtjen e sekretit.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua çështja e mirëmbajtjes së korrespondencës dhe e lutjeve në komitetet e Partisë të Shkodrës e të Lezhës.

Shokët drejtues të Partisë në Shkodër dhe aparati i komitetit të Partisë, duhet ta kuptojnë mirë përgjegjësinë që kanë për ruajtjen e dokumenteve të Partisë, prandaj të marrin masa dhe të vënë çdo gjë në vend. Ruajtja e dokumenteve dhe e sekretit të Partisë e të shtetit është një çështje e dorës së parë. Armiku përpiqet me çdo mënyrë që të shtjerë në dorë dokumentet tona. Ndonjë nga shokët tanë që lexon materiale të Partisë, mund të mendojë se ky ose ai dokument nuk ka rëndësi të madhe; por duhet të dijë se për armikun, rënia në dorë e një dokumenti të tillë ka vlerë shumë të madhe, pse ai do ta përdorë për qëllimet e tij armiqësore. Për shembull gjendja e një kooperative bujqësore ose e kryetarit të saj për ndonjë njeriun tonë mund të mos ketë interes, ndërsa për armikun e brendshëm apo të jashtëm ka rëndësi të madhe. Për armikun shërbejnë shumë sidomos raportet statistikore që tregojnë gjendjen e Partisë, të dhëna për kuadrin, qëndrimet e organizatës-bazë ndaj direktivave të Partisë etj. Në Bashkimin Sovjetik ka ndodhur që armiku ka shtënë në dorë një protokoll të organizatës-bazë të një anijeje, të cilin e shfrytëzoi për të zhvilluar punën e tij armiqësore. Merrni me mend se çfarë mund të bëjë armiku edhe te ne po të shtjerë në dorë raporte të Partisë, që disa shokë i mbajnë të pasiguruar. Komiteti Qendror ka caktuar rregulla të cilat duhen zbatuar me rreptësi. Në qoftë se rrethet nuk kanë fonde për të ndërtuar vende të sigurta, Partia nuk kursen të subvencionojë.

Ju, shokët e Shkodrës, duhet t'i shtroni këto çështje në mbledhjen e byrosë së komitetit të Partisë dhe të merrni masa. Mos harroni se armiku synon të marrë

dokumente sidomos në Shkodër. Ju, kur të shkoni edhe në fshat, dokumentet duhet kurdoherë t'i siguron mirë.

Edhe shqyrtimit të letrave, e pritjes së popullit u duhet kushtuar kujdes i madh. Letra më vijnë edhe mua, natyrisht punë kam edhe unë, por e gjej kohën për t'i lexuar ato e për të parë hallet e njerëzve. Por nëpërmjet letrave të popullit unë shikoj si punon Partia, si punoni ju, shokët erretheve. Në letra vë re se ka shumë gjëra që popullit nuk i zgjidhen drejt, siç ka edhe raste, kur bëhen kërkesa të padrejta. Kam marrë një raport të qeverisë mbi zbatimin e ligjshmërisë, në të cilin pashë se mjaft çështje i referohen Shkodrës. Për shembull, në komitetin e Partisë ose në komitetin ekzekutiv vijnë grupe fshatarësh, të cilët kërkojnë t'u dërgohen teknikë për matjen e tokave. Ju u premtoni dhe kur vjen puna nuk ua dërgoni. Kjo nuk është e drejtë. Ose raste që në komitetin ekzekutiv të kp të rrethit qëndrojnë 25 lutje të nënave me shumë fëmijë, të cilave nuk u jepen prej kohësh të drejtat e siguruara me ligj, nuk respektohet 8-orëshi ose disa herë punëtorët punojnë edhe ditët e djela. Shembuj të tillë ka dhe të tjerë. Ju, shokët e Shkodrës, duhet t'i keni parasysh ankesat e punonjësve sepse jeni qytet i madh. Në qoftë se nuk zgjidhen drejt ankesat dhe kërkesat e njerëzve, atëherë ka prej tyre që ikin të pakënaqur dhe këto raste i shfrytëzon armiku. Kur njeriut që vjen në pritje, ose bën një letër dhe i jepet përgjegje e drejtë sipas ligjit, nuk është nevoja të pritët disa herë ose të marrë përgjegje sa herë që bën letra. Prandaj, kini kujdes për këto çështje, shokë!

Duke përfunduar këtë pikë të rendit të ditës, mendoj që t'u drejtojmë një letër komiteteve të Partisë të rretheve, ku të theksohet rëndësia e ruajtjes së sekretit, e administrimit të korrespondencës, e shqyrtimit të letrave dhe e ankesave të popullit. Në këtë letër të pasqyrohet edhe eksperiencia që ka në këto drejtime Komiteti i Partisë për Qytetin e Tiranës. Gjithashtu të tregohet roli i Partisë dhe i këshilltarëve popullorë për zgjidhjen e çështjeve të masave punonjëse.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **MBI SHPEJTIMIN E QARKULLIMIT DHE ULJEN E NORMATIVAVE TË MJETEVE TË XHIROS**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**21 prill 1959**

Shpejtimi i qarkullimit të mjeteve të xhiros është një problem shumë preokupant për Komitetin Qendror të Partisë dhe qeverinë. E kam fjalën për ato mjete të xhiros që janë të tepërta dhe janë sjellë nga importi. Është fakt se ka shumë ndërmarrje shtetërore, të cilat nën pretekstin e nevojave të tyre bëjnë kërkesa të fryra. Shokët përgjegjës të dikastereve qendrore e dinë këtë çështje në parim, por e meta e tyre është se nuk ushtrojnë kontrollin e duhur mbi porositë që bëjnë ndër-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua problemi «Mbi fushatën e shpejtimin të qarkullimit të mjeteve të xhiros». Kjo fushatë u çel me vendim të Plenumit të KQ të PPSH që u zhvillua në dhjetor 1958. Fushata do të vazhdonte nga janari deri në prill të vitit 1959. Qëllimi i saj ishte shpejtimi i qarkullimit të mjeteve të xhiros dhe pakësimi i normativave të tyre. Nga një studim paraprak që u bë rezultoi se normativa e mjeteve të xhiros mund të pakësohej afro 500 milion lekë.

marrjet. Ky është një shkak që në kombinatin e naftës, për shembull, ka mjaft materiale të tepërta<sup>1</sup>. Prandaj shoku Adil<sup>2</sup> duhet t'i vërë para përgjegjësisë drejtuesit e këtij kombinati dhe të ndërmarrjeve të tjera që bëjnë porosi pa kritere të drejta, t'i mobilizojë më mirë në këtë drejtim vartësit e tij, komunistë dhe specialistë, ndryshe çështja për të cilën diskutojmë nuk do të zgjidhet si duhet dhe puna do të dëmtohet shumë.

Këtu u tha që të shikohet mundësia e shkurtimit të disa mallrave të importit. Edhe unë jam dakord me këtë mendim, sepse mund të bëhen disa korrigjime, por çështja është që t'i mësojmë shokët e bazës të ecin në mënyrë ekonomike, që kërkesat e tyre të jenë sa më objektive. Nuk mund t'ia dalim kurdoherë duke bërë rishikime e korrigjime nga Komisioni i Planit, i cili, natyrisht, do ta bëjë këtë punë edhe në të ardhshmen, por mua më duket se një nga detyrat tona me rëndësi është që përgjegjësit kryesorë në organet dhe aparatet qendrore në rrethe e në bazë t'i bëjmë të ndërgjegjshëm, me qëllim që të hartojnë plane sa më të studjuara. Ne, për shembull, çështjen e naftës do ta shqyrtojmë edhe në mbledhjen e Byrosë Politike, por duhet pasur parasysh që porosinë për sonda të bëhen me kujdes dhe jo duke u nisur nga dëshira subjektive. Shokët sovjetikë nuk na dhanë mjaft sonda, prandaj ne duhet të veprojmë me ato mjete që kemi. Çështja e sondave u pa

---

<sup>1</sup> Në ndërmarrjen e furnizimit teknik të kombinatit të naftës kishte 700 artikuj të ndryshëm me një vlerë prej 70 milion lekësh, të cilët gjatë vitit 1958 nuk janë vënë fare në lëvizje.

<sup>2</sup> Shoku Adil Çarçani, në atë kohë ministër i Industrisë dhe i Minerave.



edhe në mbledhjen e qeverisë, ku doli se gjendja e tyre është e pakënaqshme, shumë prej tyre nuk punojnë. Ose siç na rezulton janë sjellë mjaft motorë nga të cilët ka që s'na duhen dhe nuk janë importuar në vend të tyre mjete të tjera më të nevojshme. Kjo bën që nga njëra anë të mos realizohet plani dhe, nga ana tjetër, të dëmtohet ekonomia, prandaj këto çështje duhet medoemos të zgjidhen drejt, sepse kemi të bëjmë jo me çështje të vogla, por me probleme të rëndësishme ekonomike për shtetin tonë.

Çështje të tilla duhet t'i shikojmë në këtë frymë jo vetëm në industri, por edhe në bujqësi. Mund të na ngjasë që edhe në këtë sektor të ndodhemi në një gjendje të vështirë për pjesë këmbimi. E them këtë sepse ka raste që, kur vijnë makina të reja, disa thonë se «të vjetrat nuk duhen më», në vend që të bëjmë kujdes për ruajtjen, kursimin dhe zgjatjen e jetës së tyre. Fakti është se ka ndonjë sekretar partie, që vjen nga rrethi dhe thotë: «Na jepni leje të bëjmë hidrocentrale, sepse materialet i gjejmë vetë». Del pyetja: Ku i gjejnë materialet këta shokë, si i sigurojnë?

Më duket se faji këtu është te dikasteret. Ato duhet jo vetëm të ushtrojnë kontroll mbi mjetet që kanë në të gjitha hallkat e tyre, por ajo që ka rëndësi është të mbajnë rezerva, gjë që duhet të bëhet në mënyrë të shtërnguar. Pastaj Komisioni i Planit duhet t'i shikojë këto gjëra më mirë, dhe jo vetëm ato që janë të nomenklaturës së vet, por edhe të tjerat. Komisioni i Planit është për Komitetin Qendror dhe qeverinë një organ i caktuar për zgjidhjen e drejtë të këtyre çështjeve. Veçanërisht Komisioni i Planit është përgjegjës

për naftën, por ai duhet të tregojë kujdes dhe për gjërat e tjera që kanë të bëjnë me kleringun, në mënyrë që të mos krijohen stoqe.

Aktualisht, materialet e tepërta që ka Ministria e Industrisë, mund t'i mbajë, po ato të llogariten në planin e vitit 1960. Po kështu edhe për dikasteret e tjera, të cilat materialet e tepërta t'i kalojnë për llogari të vitit 1960. Ato që shikohen të arsyeshme, mund t'u shpërndahen ndërmarrjeve në bazë të nevojave strikt, por jo të hiqen nga ndërmarrjet e industrisë e t'i kalojnë Komistonit të Planit. Veçanërisht duhet parë mirë çështja e veglave të këmbimit, si për porositë që bëhen ashtu edhe për përdorimin e tyre.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **TË SHPEJTOJMË PUNËN PËR BONIFIKIMIN E TOKAVE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 prill 1959

Shokët sekretarë<sup>2</sup> duhet ta kuptojnë mirë se çështja e bonifikimit të tokave ka një rëndësi të madhe për vendin tonë. Për këtë arsye, shokët e rretheve kanë ardhur dhe kanë raportuar disa herë si këtu në udhëheqjen e Partisë ashtu dhe në qeveri. Por është fakt se kjo punë nuk është marrë me seriozitetin e duhur.

Byroja Politike dhe qeveria nuk kanë thënë që piktetimet e kanaleve të bëhen pranë shtëpive të fshatarëve, prandaj është me vend që këta të mobilizohen e të shkojnë atje ku do të bëhen punimet e bonifikimit.

---

1 Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim problemi «Mbi pjesëmarrjen e fshatarësisë në punimet e bonifikimit të veprave bujqësore».

2 U drejtohet sekretarëve të komiteteve të Partisë të rretheve Lushnjë, Durrës e Shkodër, që ishin thirrur në mbledhje të Sekretariatit të KQ të PPSH.

Ne nuk kërkojmë, për shembull, që fshatarët e Fierit të venë në rrethin e Sarandës, por bëjmë thirrje që të punojnë në rrethin e tyre. Kjo është e mundur dhe e leverdisshme si për shtetin, se nuk del nevoja të bëhen ndërtime, ashtu dhe për fshatarët të cilët edhe bukën mund ta marrin me vete.

Çështja e pjesëmarrjes së fshatarësisë në bonifikimin e tokave nuk është vetëm një çështje partie. Për këtë duhet të interesohen më shumë edhe organet shtetërore. Detyra e Partisë është që t'u bëjë të qartë fshatarëve domosdoshmërinë e këtij aksioni dhe të krijojë bindje për pjesëmarrjen e tyre në punimet bonifikuese duke shpjeguar edhe përfitimet që do të kenë ata. Nga ana tjetër, Partia ka për detyrë të ndihmojë në organizimin e forcave të fshatarëve që shkojnë në aksion.

Si duhet vepruar për të realizuar këto detyra që ka Partia? Të udhëzohen komunistët që të kuptojnë përgjegjësinë e tyre për organizimin e punës politike, edukuese dhe organizuese, ndërsa me çështjet e tjera organizativo-teknike të merren organet shtetërore. Për shembull, se ku duhen bërë piketimet është detyrë e organeve shtetërore. Ministria e Ndërtimit të caktojë frontet e punës. Të jemi realistë dhe të kuptojmë se, po nuk qenë të gatshme piketimet, kjo do të ndikojë në çmobilizimin e njerëzve në punë. Ose, në qoftë se Ministria e Bujqësisë, ta zëmë, vë re se në një rreth nuk po mobilizohen si duhet fshatarët, atëherë të informojë Sekretariatit e Komitetit Qendror duke i thënë se komiteti i Partisë i rrethit përkatës nuk po e bën mirë punën. Sigurimi i pjesëmarrjes dhe i punës së ndërgjegjshme në punimet bonifikuese kërkon një propagandë të gjerë dhe të

dendur. Është fakt se puna propagandistike bëhet gjer atje sa nxirren fshatarët dhe dërgohen në punë. Mendoj se veprimtaria ideopolitike dhe edukuese e Partisë duhet të vazhdojë edhe në aksion për të realizuar planin.

Por të kuptohemi, nuk duhet t'ia ngarkojmë të gjithë barrën Partisë. Ministria e Ndërtimit dhe ajo e Bujqësisë, për shembull, duhet të marrin të gjitha masat për organizimin e punimeve të bonifikimit. Të mbahet parasysh që pjesëmarrësit në këtë aksion të mos largohen nga puna, prandaj të vendoset disiplinë shtetërore. Në vendimin e marrë për këtë çështje nga Partia pasqyrohen edhe detyra të tjera shtetërore, prandaj këtë vendim ta zbërthejë dhe ta ndjekë që të zbatohet Kryesia e Këshillit të Ministrave.

Kritika që i bëhet gjendjes të shërbejë për të forcuar punën në rrugë partie dhe shtetërore. E them këtë sepse shokët e Lushnjës, në fillim nuk e vlerësuan detyrën, kurse tani e kanë marrë më mirë në dorë. Rrethi i Fierit nuk paraqitet mirë; me sa duket shokët drejtues të këtij rrethi nuk kanë parasysh si duhet se nesër fshatarësia do të ketë më tepër punë, prandaj duhet të mobilizohen tani, pa humbur kohë. Partia nuk duhet të lejojë që të mbeten pa plotësuar detyrat e bujqësisë, por gjithashtu s'duhet të lejojë që të lihet pas dore edhe aksioni i bonifikimit. Çështja nuk duhet parë ngushtë e me syrin e interesit të vogël të fshatarit, aq sa disa nuk largohen nga dera e shtëpisë për të punuar dy orë larg. Ky koncept duhet thyer. Nuk është çështja se fshatarët janë të zënë shumë me punë bujqësore, se po të ishte kështu nuk do të mbetej plani pa u realizuar. Ne e dimë që në drithë kemi deficite të

mëdha. Kuptohet se forcat nuk janë organizuar mirë. Kjo është një arsye që të ardhurat e kooperativave janë shumë të pakta. Në këtë mënyrë nuk mund të ecë mbarë puna jonë; prandaj është e domosdoshme që shokët të thellohen dhe t'i studjojnë mirë direktivat e Komitetit Qendror të Partisë dhe udhëzimet e Ministrisë së Bujqësisë.

Për të metat dhe dobësitë që u përmendën, Sekretariati i Komitetit Qendror mund të mbajë edhe qëndrim ndaj personave përgjegjës, sidomos për shokët e Fierit dhe të Lushnjës, por rëndësi ka që të veprohet menjëherë për të zbatuar detyrat. Prandaj, në bazë të vërejtjeve që u bënë në këtë mbledhje të dalë një vendim i Sekretariatit. Ky problem të trajtohet më mirë edhe në shtyp.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **TË FORCOHET PUNA PËR REALIZIMIN E PLANIT TË NAFTËS DHE SHPIM-SHFRYTËZIMIN E PUSEVE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 prill 1959

Është e qartë se plani i naftës në kombinat nuk po realizohet dhe puna e shpim-shfrytëzimit shkon keq. Në këto ndërmarrje kyçe ka të meta serioze organizative, ka dobësi të mëdha në punën drejtuese.

Ju, shokë të kombinatit të naftës, duhej të kishit bërë më shumë përpjekje për përgatitjen e kuadrit. Për ardhjen e sondave ne kemi marrë masa, kurse ju nuk përgatitët kuadrin që do t'i vërë në lëvizje ato dhe sondat e tjera që do të vijnë më vonë. Këtu ka faj organizata e Partisë e kombinatit, por edhe Drejtoria e industri-ndërtimit pranë Komitetit Qendror. Nuk e di me saktësi sa kontroll ka ushtruar Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe sa e ndihmon ajo kombinatin për

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u shqyrtua raporti «Mbi prodhimin e naftës dhe shpimin e puseve në kombinatin e naftës «Stalin».

këto probleme, pse për sondat që vijnë duhet të kishim gati edhe kuadrot. Nuk është e lejueshme që kaq shumë sonda të mos vihen në përdorim. Neve nuk na lejohet një luks i tillë në kurriz të ekonomisë sonë. Kjo është një e metë shumë serioze.

Çështja tjetër është se duke drejtuar vëmendjen në Marinëz, nuk lejohet që pusët e vjetra të lihen pa u shfrytëzuar. Marinëza është për perspektivën e gjatë dhe të ardhshmen, prandaj kjo nuk duhej të kishte spostuar kujdesin për shfrytëzimin e puseve të vjetra. Dhe e vërteta është se kur ju vepruat, ato dhanë naftë.

Kërkesat tuaja janë pak të ekzagjeruara. Nuk është i drejtë koncepti se «ne nuk fillojmë nga puna pa i pasur stivë pjesët e këmbimit». Materialet që janë ose që mund të adaptohen, duhet të futen në punë qoftë edhe duke pasur vegla mangut. Më duket se këto çështje drejtorja dhe organizata e Partisë duhet t'i vënë drejt. Por përgjegjësia kryesore për mosardhjen e materialeve bie mbi Ministrinë e Industrisë dhe në atë të Tregtisë, të cilat duhet të luftojnë deri në fund për të siguruar ato pjesë këmbimi që të ne nuk prodhohen dhe kjo të bëhet në kohën e caktuar.

Rëndësi të madhe ka organizimi më i mirë i punës dhe forcimi i disiplinës në kombinat. Të metat në këtë drejtim të mos fshihen prapa mungesave materiale. Në naftë gjendja e planit është serioze. Ne presim shumë nga ky sektor, prandaj gjeologjia dhe gjithsecili të marrë përgjegjësinë para qeverisë dhe Partisë. Përpjekje bëhen, por çështja është te rezultatet. Për të metat e vërtetuara që u theksuan, të merrren masat dhe të bëhet kthesë me qëllim që të përmirësohet puna dhe të arrihen



më tepër suksese në realizimin e planit të nxjerrjes së naftës. Po të jetë nevoja të dërgojmë edhe njerëz të tjerë për të ndihmuar. Në qoftë se vendos Byroja Politike që të dërgohen atje disa kuadro, kuptohet se kjo do të bëhet për interes të punës. Unë them se është e drejtë vërejtja që ndihma duhet të jetë më konkrete.

Në kombinatin e naftës ne kemi drejtor shokun Ramiz Xhabija që është anëtar i Komitetit Qendror, të cilit, për punën që bën, i heqim kapelen, por këtu atij iu bënë edhe disa kritika se nuk ka mundur t'i ndihmojë si duhet njerëzit në kryerjen e punës. Kjo është e meta e tij, por edhe ai duhet të ndihmohet më tepër nga dikasteri përkatës dhe nga Drejtoria e industri-ndërtimit pranë aparatit të Komitetit Qendror. Unë nuk them që ai të mos kërkojë llogari dhe disiplinë, por kur bëhet kjo kuadrot të mos vriten shpirtërisht dhe kërkesave e propozimeve të tyre duhet t'u jepet përgjegje. Ndonjë mosmarrëveshje që keni me shokët sovjetikë, duhet ta zgjidhni në rrugë të drejtë partie.

Ne i mbajtmë shënim zotimet tuaja që morët sot këtu në Byronë Politike dhe besojmë se do të merrni masat e duhura që ato të zbatohen një për një.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **TË NXJERRIM MËSIMI PËR FORCIMIN E KOOPERATIVAVE BUJQËSORE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**22 prill 1959**

Duke shikuar këtë raport mund të nxjerrim si konkluzion se viti 1958 nuk ka qenë i kënaqshëm për kooperativat bujqësore dhe kjo ka ndodhur për disa shkaqe, siç janë: kushtet atmosferike jo të favorshme, kujdesi i pamjaftueshëm dhe mungesa e organizimit nga ana jonë, mentaliteti i fshatarëve etj. Prandaj mësimet që nxjerrim nga ky vit të na shërbejnë për të marrë masa të tilla që vitin e ardhshëm kooperativat bujqësore të dalin më mirë.

Përmirësimi i jetës së fshatarësisë kërkon nga ne si udhëheqje që të forcojmë më tej punën e Partisë, të pushtetit e të organeve të ekonomisë në të gjitha

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u muar në shqyrtim raporti «Mbi disa çështje të kooperativave bujqësore» (lidhur me raportin përfundimtar të vitit 1958) paraqitur nga Drejtoria e bujqësisë pranë aparatit të KQ, të PPSH.

hallkat. Të tërë jemi të ndërgjegjshëm se mund të bëhet më shumë në këtë drejtim. Organizimi më i mirë i ndihmës dhe i kontrollit në bazë gjatë vitit 1957 tregoi se ka mjaft rezerva të brendshme, të cilat duhen zbuluar dhe duhen përdorur kurdoherë në dobi të ngritjes së jetesës së punonjësve. Dhe kjo është një çështje që duhet bërë konkretisht. Rezervat e brendshme planifikohen dhe kontrollohen. Pa këtë s'arrihen rezultatet e dëshiruara.

Por Ministria e Bujqësisë dhe organet shtetërore që merren me çështjet e bujqësisë, më duket se kanë një të metë serioze; ato nuk organizojnë si duhet kontrollin e zbatimit të vendimeve. Kam biseduar me ministrin e Bujqësisë për raportin vjetor të kooperativave. Kam përshtypjen se në punën e këtij dikasteri dhe të organeve të tij në rrethe shpeshherë bëhet një punë thjesht burokratike. Të marrim një shembull: Ne u kemi caktuar kooperativave bujqësore disa libra që mbushen gjatë vitit. Kjo është një pasqyrë e mirë për të parë si realizohen plani dhe detyrat e bujqësisë në rreth. Por për t'ia arritur kësaj, veprohet në mënyrë burokratike, duke i gozhduar kuadrot e bujqësisë në rreth me mbledhje e shumëzime që nevojiten për t'i bërë raport Ministrisë së Bujqësisë dhe kjo për t'ia dërguar pastaj edhe qeverisë. Nuk është mirë që specialistët e arave të gozhdohen kaq shumë për të shkruar raporte. Është e vërtetë që këto duhen bërë, por jo të pengojnë punën e gjallë të specialistëve, të cilët duhet të ndodhen atje ku janë bujqit, të ndihmojnë njerëzit që janë në drejtim të kooperativave, të bëjnë edhe studime e përgjithësime shkencore.

Një çështje tjetër është ajo që pas hartimit dhe shqyrtimit të raporteve dalin vendime të qeverisë, të cilat, natyrisht, nuk mund të jenë të detajuara, prandaj Ministria e Bujqësisë i merr ato dhe i detajon për çdo rreth e rrethi për çdo kooperativë. Por Ministria e Bujqësisë nuk duhet të mbetet vetëm te direktivat që jepen nga qeveria. Është e domosdoshme që ajo të luftojë për zbërthimin e tyre në hollësi dhe për të organizuar ndihmën e kontrollin në rreth me anë të njerëzve të saj. Kështu duhet të veprohet edhe në rreth, për çdo kooperativë; është e domosdoshme që kooperativat të caktojnë objektivet për prodhimet dhe rendimentet që duhet të marrin. Unë nuk them se njerëzit nuk venë në bazë, por çështjen e kam te një punë më konkrete që duhet bërë, duke parë se në cilin sektor çalon puna dhe pikërisht këtu të insistohet për përmirësimin e saj. Kjo të bëhet që në instruktazhin që zhvillohet kur njerëzit dërgohen për ndihmë e kontroll. Kështu do të realizohet më mirë plani, për të cilin është derdhur djersë gjatë hartimit dhe aprovimit të tij, jo vetëm nga baza, por edhe nga organet më të larta.

Sikurse u tha, të ardhura të mira marrin ata që mbjellin bimë industriale, kurse në kooperativat e tjera merren më pak të ardhura. Është e natyrshme që në kushte të tilla, fshatari nuk nxitet sa duhet, ai bën llogari se sa lekë i duhen në muaj për të harxhuar dhe sa merr. Prandaj duhet menduar për këto çështje dhe, sipas kushteve që kanë kooperativat, të caktohen burime të reja ekonomike. Për shembull, për mbjelljen e perimeve në kooperativat nuk vihet uji në zjarr. Perimet janë përqëndruar sidomos vetëm në oborret

kooperativiste. Ose pulat dhe bletët nuk shtohen. Të ardhurat në kooperativat bujqësore do të shtohen edhe duke zgjeruar aktivitetet ndihmëse.

Disa procese pune që kryhen në kooperativë sot, si për shembull, hapja e tokave të reja, mbjellja e vresh-tave etj., do të japin të ardhura më vonë dhe leverdinë ekonomike të tyre do ta shohin kur të marrin prodhim. Por duke marrë parasysh se sot vlera e ditës së punës është e ulët, të kemi kujdes në investimet që bëhen, të mos jemi dorëlëshuar në këtë drejtim.

Në kushtet aktuale, kur në mjaft kooperativa shpërndahen 40 lekë për ditë-pune, të shikohet mundësia që disa herë të bëhet edhe punë vullnetare. Në këtë mënyrë do të ketë më pak ditë-pune me pagesë, por vlera e tyre do të jetë më e madhe.

Nga ana tjetër, jam i mendimit që të përdoret më tepër fondi i paprekshëm i kooperativave bujqësore dhe të mos preket kredia e shtetit. Nuk jam dakord të shtohet kredia e shtetit për kooperativat bujqësore. Faktor me rëndësi për të shtuar të ardhurat e kooperativave bujqësore është pjesëmarrja në punë e anëtarëve. Këtu duhet të synojë më tepër propaganda dhe agjitacioni i Partisë. E them këtë sepse ka fshatarë që lënë ditën e punës dhe dalin në pazar me ca kokrra vezë.

Duhet të na preokupojë, shokë, çështja që shumë fshatra, sidomos të malësisë, marrin pak të ardhura. Prandaj të mendohet e të veprohet seriozisht për të shtuar të ardhurat e kooperativës nëpërmjet burimeve të tjera ekonomike, rritjes së prodhimit dhe të rendimentit, shtimit të pjesëmarrjes në punë etj.

Një çështje tjetër për të cilën duhen marrë masa

është ajo e ngritjes së çerdheve, gjë që do të ndihmojë, përveç të tjerave, edhe për të shtuar pjesëmarrjen e grave në punë. Në kooperativat e fushës janë mundësitë për krijimin e çerdheve, prandaj kjo detyrë duhet zbatuar.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**MBI DISA ÇËSHTJE LIDHUR ME RUAJTJEN  
E SEKRETIT, ADMINISTRIMIN E  
KORRESPONDENCËS DHE SHQYRTIMIN  
E LETRAVE E TË ANKESAVE**

*Letër komiteteve të Partisë në rrethe*

**30 prill 1959**

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të datës 21.4.1959, mori në shqyrtim relacionet e paraqitura nga Komisioni Qendror i Revizionimit, lidhur me kontrollet e ushtruara në komitetet e Partisë të rretheve Shkodër e Lezhë, për çështjen e ruajtjes së sekretit, administrimin e korrespondencës dhe shqyrtimin e letrave e të ankesave.

Nga kontrollet e bëra në këto dy rrethe, si dhe në komitetet e Partisë të rretheve Durrës dhe Elbasan, për të cilat Sekretariati i Komitetit Qendror është informuar, rezulton se instruksioni i Sekretariatit të Komitetit Qendror mbi detyrat e sektorit të përgjithshëm si dhe udhëzimet e herëpashershme të Komitetit Qendror, për ruajtjen e sekreteve të Partisë e të shtetit dhe shqyrtimin me vëmendje të letrave e ankesave të

punonjësve, nuk po zbatohen si duhet dhe ka të meta serioze.

Në rrethet Shkodër, Durrës dhe Elbasan, punonjësve të aparateve të Partisë u janë gjetur në zyra, në sirtaret e tavolinave dokumente me karakter sekret, si blloqe shënimesh të instruktorëve me të dhëna nga puna dhe jeta e organizatave të Partisë, dorëshkrime, projektvendime e vendime dhe karakteristika për pranimë e përjashtime nga Partia, për masa ndëshkimore etj. Nuk zbatohen krejtësisht udhëzimet që dokumentet sekrete të mbahen në vende të sigurta. Nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Shkodrës, në mënyrë të palejueshme ishte lënë arkiva e ish-komitetit të Partisë të qytetit në një dhomë ku ndodhej më parë godina e komitetit të Partisë.

Pakujdesi serioze vihen re në lidhje me administrimin e korrespondencës sekrete. Në rrethin e Shkodrës nuk i janë kthyer arkivës, për arsye se nuk gjenden, 38 shkresa të vitit 1957 dhe 36 të vitit 1958. Më e keqja është se një pjesë e atyre që mungojnë janë tërhequr nga shokë që janë larguar jashtë shtetit ose në ndonjë rreth tjetër; në rrethin e Lezhës, nuk i janë dorëzuar arkivës 34 shkresa të vitit 1957 dhe 46 të vitit 1958; në rrethin e Elbasanit — 70 shkresa të vjetëve 1957-1958, nga të cilat 27 të dërguara nga Komiteti Qendror nuk janë arkivuar akoma. Nga këto që nuk janë dorëzuar ka shkresa dhe dokumente me karakter sekret e tepër sekret.

Përveç këtyre, është për të theksuar se janë gjetur akte sekrete të paprotokolluara, nuk bëhen inventaret e regjistrimit, ka vonesa dhe zvarritje në përgjegjet me



ditë të tëra. Ka raste të shkeljes së rregullave në studimin e dokumenteve të Partisë e të kuadrit etj.

Komiteti Qendror i PPSH gjithnjë ka treguar kujdes të veçantë për trajtimin e punonjësve, për dëgjimin e zërit të tyre, për vlerësimin e letrave dhe zgjidhjen e drejtë e të shpejtë të ankesave dhe kërkesave të qytetarëve, duke e konsideruar çdo pakujdesi dhe mosinteresim në këtë drejtim si qëndrim të palejueshëm. Ky problem është ngritur me forcë në Kongresin III të Partisë dhe në Kongresin IV të Bashkimeve Profesionale. Në vitin 1957 Komiteti Qendror dërgoi një letër të veçantë, në lidhje me trajtimin e punonjësve, me porosi që të punohej në të gjitha organet e Partisë, të pushtetit dhe në forumet e organizatave të masave. Por me gjithë përmirësimet në krahasim me të kaluarën, në këtë drejtim, akoma vërehen të meta dhe dobësi. Për mjaft lutje që u janë drejtuar punonjës të ndryshëm komiteteve të Partisë, ose që u janë dërguar për verifikim nga ana e Komitetit Qendror, nuk dihet se çfarë është bërë, në se janë njoftuar të interesuarit apo jo, ka vonesa prej 5-6 muajsh e më tepër dhe ajo që është më e rëndësishmja, ka raste që nuk verifikohen dhe nuk shqyrtohen me kujdesin e duhur.

Byrotë e komiteteve të Partisë të Shkodrës dhe të Lezhës nuk e kanë marrë asnjëherë në shqyrtim gjatë vitit 1958 këtë problem, megjithëse kanë pasur shumë kërkesa dhe ankesa e të një karakteri të rëndësishëm. Mjaft fshatarë të këtyre rretheve janë ankuar në Komitetin Qendror me letra ose verbalisht për çështje që mund dhe duhej të zgjidheshin në rreth.

Letrat dhe ankesat e shumta që i drejtohen Komi-

tetit Qendror dhe komiteteve të Partisë, në radhë të parë tregojnë besimin që kanë masat ndaj Partisë dhe Komitetit të saj Qendror. Kjo është një gjë mjaft pozitive, të cilën Partia e ka fituar me punën dhe vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste; por nga ana tjetër, duke marrë parasysh se mjaft ankesa dhe kërkesa janë për çështje të vogla, del se disa drejtues të ndërmarrjeve, të institucioneve shtetërore dhe të komiteteve ekzekutive, si dhe organizatat-bazë të Partisë, nuk interesohen për të zgjidhur kërkesat e punonjësve. Ka drejtorë ndërmarrjesh që nuk i presin punonjësit megjithëse kanë caktuar orët e pritjes. Po kështu ndodh që organizatat profesionale, komisionet e pajtimit, nuk i kryejnë si duhet detyrat e tyre për të mbrojtur interesat e punonjësve, të cilët mund të shkelen nga disa drejtues burokratë që ndodhen në krye të ndërmarrjeve dhe të institucioneve shtetërore. Kështu, në rrethin e Shkodrës ndodh që një qytetare pushohet nga puna pse ka lindur jashtë martese, që nga komiteti ekzekutiv u premtohet fshatarëve se do t'u plotësohen kërkesat dhe nuk u plotësohen, ose që gjenden të pazgjidhura 28 kërkesa nga nënat me shumë fëmijë qysh nga viti 1958.

Kjo tregon se drejtuesit e ndërmarrjeve, organizatat profesionale dhe organizatat-bazë të Partisë, nuk kanë parasysh që kurdoherë të dëgjohet me vëmendje zëri i punonjësve dhe për ankesat e tyre të veprohet drejt dhe shpejt. Edhe atëherë kur kërkesat e tyre janë pa vend, siç ndodh me disa punonjës, të cilët ankohen se duan punë dhe kur u jepet nuk venë, duke pretenduar punë të rehatshme, duhet që me ta të bëhet punë sqaruese.

Këto çështje tregojnë se punonjësit e aparateve të Partisë, veçanërisht shokët drejtues, sekretarët e komiteteve të Partisë, nuk i vlerësojnë si duhet këto çështje të rëndësishme. Nga kjo vjen që këto të meta paraqiten akoma më tepër në komitetet ekzekutive, në ndërmarrjet, në institucionet e tjera shtetërore dhe organizatat e masave.

Për të metat serioze që u konstatuan në rrethin e Shkodrës, Sekretariati i Komitetit Qendror thirri njërin nga sekretarët e komitetit të Partisë, kritikoi ashpër byronë e komitetit të Partisë dhe porositi që këto të shtrohen në mbledhjen e tyre të parë. Por me qëllim që të zhduken të metat dhe dobësitë që mund të ekzistojnë në këtë drejtim në të gjitha komitetet e Partisë, Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH porositi:

1. — T'u tërhiqet vëmendja komiteteve të Partisë të rretheve, veçanërisht sekretarëve të komiteteve të Partisë, të kenë gjithmonë parasysh, sidomos në kushtet e sotme, që çështja e ruajtjes së dokumenteve, konspiracioni dhe ruajtja e sekreteve të Partisë e të shtetit, duhet të konsiderohet si çështje e dorës së parë dhe të mos bëhet asnjë lëshim në shkeljen e kësaj porosie dhe në rastet e dobësisimit të vigjilencës.

Duhet ditur se armiku, agjenturat e imperializmit dhe të revizionistëve jugosllavë përpiqen me çdo mënyrë që të shtien në dorë dokumente, shifra dhe fakte për t'i përdorur në punën e tyre kundër Partisë dhe pushtetit tonë popullor. Mjaft nga dokumentet dhe materialet që kalojnë çdo ditë në duart e punonjësve të aparateve të Partisë e të shtetit, të cilat mund të duken se nuk kanë aq rëndësi, për armikun kanë vlerë të madhe.

Për këtë qëllim herë pas here të ushtrohen kontrole në aparatet e Partisë e të shtetit e të vendoset rregull i fortë për ruajtjen e sekreteve dhe të dokumenteve.

2. — Byrotë e komiteteve të Partisë duhet të marrin masat për të zbatuar me rigorozitetin më të madh udhëzimet e Komitetit Qendror për administrimin dhe evadimin e dokumenteve sipas instruksionit të aprovuar nga Sekretariati i Komitetit Qendror «Mbi detyrat e sektorit të përgjithshëm dhe organizimin e punës sekrete në komitetet e Partisë të rretheve e qyteteve», e të mos konsiderohet kjo si një punë thjesht teknike që i përket vetëm sektorit të përgjithshëm, por si një çështje e rëndësishme e të gjithë punonjësve të Partisë.

3. — Një kujdes i veçantë t'i kushtohet gjithashtu punës për pritjen dhe shqyrtimin e propozimeve, letrave dhe ankesave të punonjësve. Për këtë çështje nuk mjafton vetëm kujdesi i aparateve të Partisë dhe i komisioneve të revizionimit të Partisë, por edhe i komiteteve ekzekutive, i drejtorive të ndërmarrjeve, i organizatave të bashkimeve profesionale, i komisioneve të pajtimit etj.

Në këtë drejtim duhet marrë eksperiencia e mirë e Komitetit të Partisë të Qytetit të Tiranës, i cili jo vetëm e ka analizuar në byronë e tij, por e ka bërë problem të këshillit popullor, të plenumit të bashkimeve profesionale të qytetit dhe të komisionit të revizionimit, duke dërguar dhe ekipe për kontroll e ndihmë.

Për të zgjidhur ankesat dhe për të bërë një punë më të mirë sqaruese, Komiteti i Partisë i Qytetit të Tiranës ka udhëzuar që të zgjedhurit, anëtarët e këshillave popullore të lagjeve e të qytetit, çdo 15 ditë të

marrin kontakt me popullin dhe këtu të sqarojnë disa nga problemet për të cilat paraqiten kërkesa të shumta. Gjithashtu janë organizuar aktive me drejtuesit e një ose më shumë sektorëve, ku përveç të tjerave u është theksuar respektimi i ditëve e i orëve të pritjes dhe është kritikuar ashpër tendenca e disa drejtuesve që për të shkarkuar veten i drejtojnë punonjësit në komitetin e Partisë ose në komitetin ekzekutiv.

Këto forma punc kanë rëndësi. Këshilltarët e zgjedhur, në takimet që bëjnë me popullin, nuk duhet të mbajnë vetëm shënime, por ta dëgjojnë e ta sqarojnë popullin dhe kur të jetë nevoja të ndërhyjnë për zgjidhjen e padrejtësive ose të kërkesave të njerëzve. Kështu do të rritet roli i vetë këshilltarëve. Një punë më të mirë duhet të bëjnë në këtë drejtim organizatat e masave, sidomos bashkimet profesionale, organizatat e Frontit e të gruas në lagje e në fshatra. Nga ana tjetër, drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të organeve të tjera të pushtetit popullor, si komunistë dhe përfaqësues të pushtetit popullor, duhet të dëgjojnë dhe të zgjidhin me kujdes dhe drejt kërkesat e punonjësve e të mos i përcjellin ata nga një vend në tjetrin. Në këtë drejtim duhet të rritet roli i organizatave-bazë të Partisë; ato të thërresin në raport herë pas here drejtuesit e ndërmarrjeve, duke pasur parasysh se puna me njerëzit është e vështirë, por e domosdoshme dhe duhet bërë me kujdes e durim të jashtëzakonshëm.

4. — Këto çështje të rëndësishme, të cilat janë bërë shpesh probleme të udhëheqjes së Partisë, duhet që herë pas here të shqyrtohen dhe të analizohen në byrotë e komiteteve të Partisë. Komisionet e revizionimit

të Partisë në rrethe duhet të kryejnë kontrole të herë-pashershme edhe në këtë anë të punës së aparateve të Partisë. Komisionet e revizionimit të marrin njoftimin e kësaj letre si dhe të instruksionit të Sekretariatit të Komitetit Qendror «Mbi detyrat e sektorit të përgjithshëm».

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**SHËNIME TË MBAJTURA GJATË TAKIMIT ME  
SHQIPTARËT E MËRGUIAR, PËRFAQËSUES  
TË SHOQËRISË PATRIOTIKE «SKËNDERBEU»**

4 maj 1959

*Shoku Enver përshëndetet në mënyrë shumë të përzemërt me të tetë shqiptarët e mërguar prej dhjetëra vjetësh në Argjentinë dhe u krijon atyre një ambient shumë të ngrohtë. Ata, shumë të emocionuar, zënë vend dhe fjalën e merr kryetari i këtij grupi.*

**MITRO RRAPI:** I dashur heroi i popullit tonë, Enver Hoxha, shqiptarët patriotë të Argjentinës janë shumë të gëzuar për fitoren që korri populli shqiptar në luftën kundër fashizmit me Partinë heroike Komuniste dhe me Ju në krye. Ju jeni në zemrën e të gjithë shqiptarëve të mërgimit.

Veçanërisht lufta heroike e popullit, që Ju keni drejtuar për pesë vjet me radhë është bërë ballsam në zemrën e të gjithë shqiptarëve patriotë. Shqiptarët patriotë të Argjentinës kanë dhënë besën se nuk do ta shkelin kurrë gjakun e derdhur të popullit tonë, të 28 000 dëshmorëve. Shqiptarët patriotë të Argjentinës, anëtarë të shoqërisë patriotike «Skënderbeu», na kanë

porositur t'Ju përgëzojmë për të gjitha ato që keni bërë. Ne, megjithëse kemi një kohë shumë të gjatë që jemi larguar nga atdheu, i kemi dashur dhe i kemi respektuar shumë heronjtë dhe patriotët e vjetër si Skënderbeun, Bajram Currin, Themistokli Gërmenjin e shumë të tjerë. Ne kemi luftuar me sa kemi mundur edhe kundër Ahmet Zogut me shokë, por duhej të kishim bërë edhe më shumë.

Edhe në Argjentinë na kanë ardhur ca tradhtarë shqiptarë, mbeturina të fashizmit, që janë përpjekur të na pengojnë në punën tonë, por shqiptarët patriotë të mërgimit kurrë nuk do ta lënë dhe nuk do ta harrojnë Republikën Popullore të Shqipërisë. Ne themi kurdoherë lavdi pastë Partia heroike e Punës, lavdi pastë shoku Enver Hoxha!

Ne ishim të dëshiruar dhe gjithnjë thoshim: «A do të vijë ndonjëherë koha të vemi në atdheun tonë dhe të takohemi me vëllezërit, miqtë dhe shokët tanë?» Po si thotë fjala që «mali me mal s'piqet, pa njeriu me njerinë piqen», ja erdhi koha dhe ne tani ndodhemi në atdheun tonë të dashur.

Kur zbritëm në portin e Durrësit ne pamë gjëra që na dukeshin si në ëndërr e na u bë zemra mal. Si e lamë ne Shqipërinë dhe si e kemi gjetur sot! Kjo është një lindje për herë të dytë për ne.

Këto që kemi përpara na duken si ëndërr. Kur u bë kështu Shqipëria? Ne do të duam muaj të tërë që t'ua tregojmë shqiptarëve atje.

Edhe atje na kanë ardhur ca ballistë nga Shtetet e Bashkuara që të na përçajnë, po ne u kemi thënë të gjithë shokëve: «U jepni grushtë armiqve të pabesë».



Megjithatë puna e tyre ka bërë që ne të mos i jepnim ndihmën e duhur Republikës Popullore të Shqipërisë. Po pse nuk e kemi ndihmuar? Se edhe te ne kishte, si nga jashtë ashtu edhe brenda, njerëz të ligj si kishit ju këtu Koçi Xoxeni dhe Titon. Për këtë ne ju kërkojmë ndjesë.

Tani që erdhëm këtu, do të punojmë akoma më mirë dhe do t'u themi vëllezërve tanë në Argjentinë ç'pamë në Shqipëri, që edhe ata të vijnë në atdhe po të duan dhe të shohin. Dielli me shoshë nuk mbulohet, megjithëse kundër nesh punon shumë Isuf Luzaj që nuk lë dy gurë bashkë.

Anëtarët e shoqërisë «Skënderbeu» ju kanë dërguar me ne, i dashur shoku Enver Hoxha, edhe një dhuratë me rastin e 50-vjetorit të lindjes. Ti të na rrosh sa malet bashkë me popullin që të do me mish e me shpirt. Ne ta dorëzojmë këtë dhuratë në emër të të gjithë anëtarëve dhe ne vetë ju japim këtë dhuratë të vogël.

**SHOKU ENVER:** Ju faleminderit shumë për dhuratat tuaja!

I dashur xha Mitro, të dashur shokë. Ne jemi jashtëzakonisht të prekur dhe të gëzuar që ju shokët, vëllezërit, bashkatdhetarët tanë, që keni luftuar edhe ju për çështjen e popullit, erdhët në atdheun tuaj për ta parë dhe për t'u pjekur me popullin, për të biseduar me vëllezërit tuaj sepse keni shumë kohë që jeni larguar. Ne e kuptojmë mallin e madh që keni ndjerë në zemër për vatrën tuaj, për atdheun e dashur. Atdheu është kurdoherë i shtrenjtë, sepse për këtë atdhe kanë luftuar stërgjyshërit tanë, populli ynë trim e patriot që

shumë herë është gjakosur, por që nuk ka mundur asnjëherë të fitojë lirinë, të cilën vetëm tani e fitoi, në saje të luftës së tij, të përpjekjeve të tija.

Siç e dini, populli ynë, se të gjithë jemi bijtë e tij, është zemërmirë, por është edhe i papërkulur e i ashpër kundër armiqve, se armiqtë gjithnjë kanë qenë të egër kundër popullit. Vetëm si tha xha Mitroja dhe si e ndjejmë të gjithë, u desh forca e madhe e heroizmi i popujve të Bashkimit Sovjetik që të çlirohej e gjithë bota nga fashizmi, u desh një parti trime si Partia jonë Komuniste që t'i jepej një impuls i ri luftës së popullit shqiptar kundër pushtuesve fashistë dhe këtë herë të fitonte lirinë. Gjaku i derdhur në këtë luftë pati një vlerë të madhe, sepse, siç kanë thënë poetët tanë të Rilindjes, pa derdhur gjak nuk fitohet liria. Kur dhurohet liria nuk vlen.

Kështu populli shqiptar derdhi gjakun, por fitoi lirinë përjetë, për shekuj. Nuk do të kthehen kurrë kohët e hidhura që ka kaluar populli shqiptar, nuk do të ndodhë që t'i merren fitoret nga duart. Kohët kur mbi djersën e popullit fitonin bejlerët, borgjezia, agjentët dhe spiunët e imperializmit, kanë marrë fund se populli u kalit në të gjitha këto luftëra. Lufta Nacionalçlirimtare ishte rrjedhim i gjithë luftërave të popullit tonë për liri në të kaluarën. Gjaku i derdhur në këto luftëra ka kalitur edhe pushtetin e popullit.

Ne kemi konstatuar, jo për t'ju bërë qejfin, se një nga kolonitë shqiptare nga më të përparuarat, ka qenë dhe është ajo e Argjentinës. Ju atje keni qëndruar si patriotë të vërtetë në rrugën e popullit. Kjo ka ndodhur se ju, shqiptarët e Argjentinës, jo vetëm jeni djem të

vuajtur të popullit, jo vetëm jeni bij fshatarësh që keni hequr të zit e ullirit, po me punën dhe organizimin politik keni ruajtur ndjenjat e pastra, të kulluara patriotike tradicionale të popullit tonë dhe u keni bërë ballë me sukses, ashtu siç u ka hije patriotëve, presioneve të agjentëve të imperializmit dhe të borgjezisë së korruptuar kapitaliste që bëhen në vendet e Perëndimit, veçanërisht në SHBA. Ju keni mundur t'u bëni ballë propagandës së madhe të imperializmit dhe veglave të tija, që, pasi hëngrën dru nga populli, u shpërndanë nëpër botë si korbata, se këtu nuk i mbante vendi.

Ju tregoheni modestë, kur thoni se nuk keni bërë sa duhet për popullin shqiptar. Ne jemi dakord për të gjitha me ju, vetëm me atë që thoni se nuk keni bërë sa duhet për popullin shqiptar nuk jemi dakord, sepse ne me emrin tuaj, shoku Mitro Rrapi, kemi marrë mjaft letra ku ju keni shprehur ndjenjat e pastra patriotike për atdheun dhe popullin tonë, për luftën e tij dhe për Partinë. Këtë punë ju nuk e keni bërë një herë, po shumë herë. Letrat që kemi marrë nga ju nuk janë letrat e një gazetari, po të një punëtori, ashtu sikurse jeni të gjithë ju, në to shpreheshin ndjenjat tuaja të pastra. Ne i kemi botuar ato letra në gazetatat tona që bashkë me ne të gëzohej edhe gjithë populli ynë për këto ndjenja dhe për qëndrimin tuaj patriotik ndaj popullit.

Lufta që keni bërë ju ka qenë gjithashtu e madhe, e lavdishme përkrah popullit shqiptar. Sikur të kishit qenë këtu, do të kishit marrë dyfekun në krah si i gjithë populli dhe do të dilnit në mal. Edhe pas Çlirimit, po të ishit ndodhur këtu, si edhe ne, do të ishit vënë në shërbim të popullit. Pavarësisht se njëri quhet

sekretar i parë, tjetri kryeministër ose ministër etj., në të tërë i shërbejmë popullit dhe gjakun e tij nuk e shkelim, me këtë dua të them që të mos na rritet mendja se tani u bëmë të mëdhenj. Partia kështu na mëson. Lenini ka thënë se gjersa pema i ka rrënjët thellë në tokë, ajo rritet, lulëzon dhe bën fruta, po gjersa ato rrinë mbi ujë, pema mund të rrëzohet. Pushteti ynë popullor dhe njerëzit e Partisë i kanë kurdoherë parasysh këto mësimet të Leninit, se ato s'janë gjë tjetër veçse eksperiencia e madhe e popullit, të cilën njerëzit e mëdhenj si Marksi e Lenini e kanë vënë në rrugë shkencore.

Partia jonë i mëson njerëzit por dëgjon edhe zërin e tyre. Ai që nuk ecën Partia e shkund, në rast se ai nuk vë mend i vë shkelmin. Partia jonë nuk lejon asnjë njeri t'i bëjë dëm çështjes së popullit. Interesat e popullit mbi të gjitha — thotë Partia. Ishte kjo politikë e urtë e Partisë që ndihmoi të fitonim luftën.

Ju e dini se Partia jonë që është pjellë e popullit nuk erdhi nga jashtë, nuk u importua siç thonë armiqtë e socializmit. Në mes të disa dokumenteve që na kanë ardhur nga arkivi i Kominternit është edhe një letër e komunistit Halim Xhelo. Në kohën e tij ishte një farë Zai Fundo që hiqej si komunist, por ishte agjent i huaj. Ai hyri në Shqipëri kur erdhi Italia, ai nuk ndoqi Partinë, por u bashkua me një bej kosovar, Gani Kryeziun, i cili u përpoq me ndihmën e anglezëve të bënte një kundërkryengritje kundër nesh. Por forcat partizane e kapën tradhtarin Zai Fundo dhe e vranë. Në letrën që i drejton patrioti Halim Xhelo, Zai Fundos, i thotë se

Partia do të formohet në Shqipëri në popull, në mes të punëtorëve, të fshatarëve, të patriotëve.

Partia jonë që doli nga gjiri i popullit, ishte e re por kishte eksperiencën dhe mençurinë e popullit. Bejlerët si Ali Këlcyra me shokë hiqeshin si shumë të ditur, por ata dinin vetëm t'i vinin popullit pushkën mbi kokë. Ata na nënvleftësuan, po populli që na vlerësoi fitoi. Partia fitoi në popull një autoritet të madh brenda një kohe shumë të shkurtër. Porsa vendin e pushtoi Italia fashiste ne organizuam luftën kundër pushtuesve dhe agjentëve të tyre. Populli na donte dhe thoshte: këta janë trima, kurse reaksionarët thoshin: këta janë kalamaj, janë zuzarë.

Partia jonë, sido që e re, u tregua e pjekur në çdo veprim të saj. Ajo punoi drejt se kishte eksperiencën e madhe të popullit dhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Kështu gjatë luftës, pa humbur toruan, ajo luftoi kundër armiqve deri në fund. Anëtarët e Partisë ishin në ballë të luftës në çdo aksion. Partia bëri përpjekje të mëdha që njerëzit, të cilët nuk e kishin kuptuar akoma situatën, t'i sqaronte. Kishte njerëz të paditur dhe të çorientuar që nuk i kuptonin këto gjëra. Kishte njerëz që thoshin: «Si të jemi kundër Qazim Koculit, ai ka marrë pjesë në Luftën e Vlorës?». Partia bëri përpjekje për ta sjellë në rrugë të drejtë Qazim Koculin, megjithëse ishte e bindur se ai nuk do të vinte kurrë në këtë rrugë, sepse, po të jesh i mirë, duhet të punosh deri në fund me popullin, kurse ai erdhi në Shqipëri bashkë me pushtuesit fashistë italianë, kundër popullit. Po të bësh një gabim, populli ta fal, po të bësh dy të heq veshin. Këta njerëz erdhën nëpërmjet Muso-

linit dhe bënë deklarata në favor të fashizmit. Megjithatë ne u thamë atyre: «Ejani të bashkëpunojmë në luftë kundër pushtuesve fashistë. Ti, Qazim Koculi — i thamë — ke luftuar kundër italianëve në Luftën e Vlorës. Tani Shqipërinë e pushtoi prapë Italia ku është në fuqi fashizmi, d.m.th. borgjezia më reaksionare, ajo borgjezi që na gjakosi edhe më 1920, prandaj hajde të luftojmë», por ai s'erdhi dhe u vu kështu kundër popullit. Kur kap një vrasës ose vjedhës e çon në gjyq dhe pasi e ke demaskuar mirë, atëherë i jep dënimin e merituar se atë e dënon vetë populli që e njeh tani. Edhe Partia u bëri thirrje këtyre njerëzve dhe populli e pa këtë. Ata nuk dëgjuan, kështu vetë lufta i vuri ata kundër popullit dhe simpatia që kishin më parë në popull si nacionalistë, ra menjëherë në ujë. Intrigat dhe gënjeshttrat e tyre nuk duruan më shumë se 5-6 muaj. Kështu këta njerëz që tradhtuan populli i braktisi dhe ata shkuan me ushtritë e pushtuesve fashistë.

Populli pa se djemtë e rinj komunistë ishin bij të thjeshtë që sakrifikonin çdo gjë për çlirimin e atdheut dhe të popullit, për ta nxjerrë popullin në dritë. Partia krijoi Frontin Nacionalçlirimtar, ku u grumbulluan masat e gjera të popullit. Siç e dini të gjitha regjimet kanë pasur qeveritë e tyre. Prandaj edhe ne, duke marrë eksperiencën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që në fillim të Luftës Nacionalçlirimtare i thamë popullit që të krijonte qeverinë e tij. Dhe këtë qeveri e krijuam që në atë kohë, krijuam menjëherë këshillat nacionalçlirimtare për t'i pasur gati kur të çlirohej Shqipëria. Ne, megjithëse pushtuesit fashistë kishin ushtri të mëdha të pajisura me topa, tanksa dhe aero-

planë, ishim të bindur që do ta çlironim Shqipërinë, sepse populli ishte i tëri në këmbë, ashtu siç luftojnë popujt e tjerë kundër regjimeve të Frondisve<sup>1</sup>, Ajzenhaurve etj. Populli ynë është i bindur se edhe në Amerikën Latine do të vijë koha që populli do ta marrë fuqinë në dorë. Por që fitoret e popullit tonë të përjetësoheshin duhej të hidheshin që gjatë luftës bazat e pushtetit popullor. Kështu në çdo fshat e qytet që çlironim, shkatërronim pushtetin e vjetër. Nuk linim as xhandar as tagrambledhës as kryetar komune. Por edhe në qytetet e fshatrat e paçliruara ne krijuam pushtetin tonë natyrisht në ilegalitet. Armiqtë u shpartalluan dhe ky ishte një sukses shumë i madh i popullit shqiptar.

Kur Shqipëria u çlirua pushteti ishte i tëri në duart e popullit. Por lufta që na kushtoi kaq gjak na solli edhe shumë dëme materiale. Tani ju nuk shihni gjurmë shtëpish e fshatrash të djegura, rrugësh e urash të prishura se të tëra u rindërtuan. Mund të duket çudi, por çdo gjë që u shkatërrua u ngrit përsëri brenda dy vjetësh. Kështu u rindërtuan krahina të tëra, ura, punishte. Të gjitha i ndërtoi populli në kushte të vështira, pa bukë, pa rroba dhe pa këpucë, në shi, në baltë e në dëborë. Po njerëzit ishin bërë si çeliku, as donin të dinin ç'ishin vështirësitë dhe lodhja, ata u kalitën gjatë Luftës Nacionalçlirimtare kur ishin malit. Lufta na bëri të fortë. Atëherë hanim vetëm nga një çikë bukë misri dhe ndonjë hudhër ose qepë dhe u rezistonim vështirësive të mëdha.

---

<sup>1</sup> A. Frondisi — udhëheqës politik reaksionar argjentinasi, president i Argjentinës nga viti 1958 deri në vitin 1962.

Çlirimi i vendit nga pushtuesit fashistë dhe tradhtarët ngjalli një entuziazëm shumë të madh në popull. Partia jepte direktivën se duhen rindërtuar rrugët, urat, dhe rinia, burrat, gratë, mblidheshin ku ishin e ku nuk ishin e punonin. Kështu u vunë në vend të gjitha ato që ishin prishur. Po ky ishte fillimi. Merreni me mend në çfarë mjerimesh e vështirësish ishte vendi pas Çlirimit. U desh akoma shumë punë për t'u bërë dhe u bë, siç po e shihni, se vija e Partisë dhe e qeverisë sonë ka qenë dhe është kurdoherë e drejtë.

Lufta u fitua, por duheshin forcuar fitoret, populli duhej ta ndjente veten zot të mallit të vet dhe të mos mendonte se këtë çështje kaq të madhe do ta çonte përpara një njeri apo dy ose dhjetë vetë. Prandaj duheshin mobilizuar të gjitha forcat dhe jo vetëm të krahut, por edhe të mendjes, duhej vendosmëri e sakrificë për të krijuar koncepte të reja në popull. Brumi i bukës që do të gatuhej ishte i mirë dhe i ri, por ai duhej mbrujtur mirë. Partia u tregua në lartësinë e saj. Ajo u mbështet në vullnetin dhe në dëshirat e popullit dhe në ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të demokracive popullore dhe arritëm suksese.

Armiqtë e vendit tonë nuk kishin besim se ne do ta kishim të gjatë. Sa u çlirua Shqipëria ata filluan të thoshin: «tani që këta zbritën nga mali do të fillojnë terrorin». Mirëpo Partia Komuniste nuk është parti terroriste, ajo është Parti e popullit, prandaj ajo i qetësoi njerëzit e frikësuar nga propaganda e armikut dhe e atyre që, duke qenë vetë të ngarkuar me faje të rënda kundër popullit, kërkonin të frikësonin edhe të tjerët. Por propaganda e tyre nuk zuri vend. Për ata që kishin



mbushur kupën, gjyqet ishin të pamëshirshme. Ndaj të gabuarve pushteti u tregua gjakftohtë, zemërgjerë, nuk i vrau siç propagandoi armiku, po i dënoi disa vjet burg që të vinin mend dhe të punonin për popullin për të larë një pjesë të vogël të fajeve që kishin bërë. Partitë marksiste kanë kurdoherë besim te njerëzit, i edukojnë ata që gabojnë dhe i bëjnë njerëz. Që të lanin një pjesë të fajeve, shumë nga këta të dënuar që ishin mirë fizikisht, u futën në punë për të hapur kanale, për të ngritur shtëpi që kështu t'u jepej mundësi të edukoheshin, sepse puna e edukon njeriun. Pa të punonin edhe ata një herë e të shikonin si e fiton jetën fshatari që ata e kanë shtrydhur vazhdimisht! Natyrisht, ndonjë fshatar që i ishte djegur shpirti nga këta ujç, vinte dorën në ballë dhe i thoshte beut që punonte në kanal: «e bej, si të duket puna, punon dot ndonjë çikë?...»

Kështu arritëm të fillojmë ndërtimin e Shqipërisë së shkatërruar e të mjeruar dhe mund të themi se kemi pasur suksese të mëdha. Por ju e dini se sukseset nuk na dehin dhe e keni parë vetë që populli punon akoma më shumë.

Ju jeni vëllezërit tanë dhe s'kemi të fshehta ndaj jush. Ja, si tha xha Mitroja, si e latë Shqipërinë dhe si e gjetët. Po gjendjes së dikurshme i shtoni edhe djegiet e shkatërrimet e luftës dhe do të gjykoni sa shumë janë bërë që pas Çlirimit, me të vërtetë janë bërë gjëra të mëdha. Ne nuk ju lëmë të ikni kaq shpejt me qëllim që të vizitoni pak a shumë të gjitha veprat, në të gjitha anët e Shqipërisë. Kështu do të shikoni që nga hiçi kemi ngritur një industri moderne. Borgjezia shqiptare jepte para me fajde dhe s'bëri asgjë për të zhvilluar

industrinë. Edhe pushtuesit s'bënë asgjë, përkundrazi, dhe ato që ishin bërë i shkatërruan. Të gjitha këto që patë dhe do të shihni i kemi ngritur nga e para, me punën e palodhur të popullit dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste.

Filluam, së pari, shfrytëzimin e pasurive të nëntokës, si dhe ngritjen e atyre fabrikave që do të prodhohin sende për të cilat kishte më shumë nevojë populli. Populli kishte nevojë në radhë të parë për naftë se s'kishim as të holla që ta importonim, ishim trokë. Tregtarëve të mëdhenj ua morëm fitimet e mëdha që kishin nxjerrë gjatë luftës me gjakun e popullit. Po ato nuk mjaftonin për të mëkëmbur ekonominë e shkatërruar.

Në naftë ne nuk trashëguam asgjë, sepse gjermanët i hodhën në erë të gjitha pusët. Kur nafta jonë shfrytëzohej nga italianët, këta mezi nxirrnin deri në 80 000 tonë naftë në vit. Punëtorëve shqiptarë nuk u lejohej të mësonin teknikën, kështu, kur u çlirua Shqipëria, ne kishim vetëm një inxhinier në naftë dhe ai jo specialist për naftën. Teknikë nuk kishim. Prandaj përdorëm teknikët italianë që ishin më parë në Kuçovë, të cilëve u thamë të punonin për ne. Edhe makineri nuk trashëguam përveç disa karakatinave të prishura. Në atë kohë ne kishim edhe një pjesë të ushtrisë që luftonte në Jugosllavi kundër gjermanëve. Ekonomia dhe populli kishin shumë mungesa. Në këto kushte kaq të vështira, italianët u përpoqën të na i hidhnin në erë pusët e naftës që mezi i ndreqëm. Por komplotin e tyre e zbuluam, drejtuesit e këtij komploti i vumë në plumb dhe pjesën tjetër të italianëve e dëbuam nga Shqipëria.

Që atëherë e deri tani ne kemi ngritur një industri të mirë të naftës. Në drejtimin e punimeve kemi njerëzit tanë, inxhinierë dhe teknikë, që kanë mësuar në Bashkimin Sovjetik për shfrytëzimin e naftës. Ata kanë 15 vjet që kanë kaluar nëpër shkolla, veç asaj kemi në vend edhe një teknikum të naftës. Tani në vitin e katërt të pesëvjeçarit të dytë ne jemi në gjendje të nxjerrim mbi 400 000 tonë naftë nga 80 mijë që janë nxjerrë më 1938 nga italianët. Në fund të pesëvjeçarit të tretë parashikojmë të marrim më shumë. Tani kemi në dispozicion grupe të mëdha gjeologësh që po bëjnë kërkime në të gjithë Shqipërinë, ku ka naftë, perspektivat e së cilës duket se janë shumë të mira. Për përpunimin e naftës kemi një rafineri në Qytetin «Stalin» që e kanë ngritur vetë punëtorët tanë.

Populli ynë është shumë i zgjuar e punëtor. Nuk mund ta merrni me mend me ç'hov të madh kanë mësuar njerëzit tanë; ata ishin të etur për dituri dhe këtë mundësi ua dha Partia. U zhduk analfabetizmi nën moshën 40 vjeç. Me mijëra janë njerëzit që kanë mbaruar shkollat e larta dhe të mesme si dhe teknikume të ndryshme e përsëri ne themi se kemi pak njerëz të mësuar. Partia dhe qeveria kanë ngritur mijëra shkolla në fshatra, shkolla shtatëvjeçare, të mesme dhe teknikume, edhe të tjera do të ngrihen, sepse ekonomia jonë nuk ecën më si përpara, ajo zhvillohet me ritme shumë të shpejta, prandaj na duhen shumë agronomë, inxhinierë, pedagogë etj.

Populli tani ka shumë më tepër të ardhura se përpara dhe akoma më shumë do të ketë në të ardhshmen, se vendi do të zhvillohet dita-ditës. Nuk do të jetë e

largët koha kur do të ngrihen vepra më të mëdha se deri tani. Ne duam që ju të vini çdo vit në Shqipëri, po ndonjë që do të vijë pas disa vjetësh do të shohë se atëherë në shumë qytete ne do të përdorim edhe gazin në shtëpi, sepse gaz ka vendi ynë dhe përdorimi i tij është qytetërim.

Veç naftës ne kemi edhe krom që ka perspektiva të mira. Nga Veriu, në Bulqizë, kemi një minierë shumë të mirë kromi dhe gjcologët tanë po zbulojnë shtresa kromi edhe në Martanesh. Po kështu krom ka edhe nga Tropoja e nga Elbasani dhe kromi po i sjell të ardhura të mira vendit.

Tani do të kemi fitime më të mëdha nga kromi se do ta pasurojmë. Parashikohet të ngremë një uzinë të ferro-kromit që do të jetë një kombinat i madh metalurgjik e do ta trefishojë vlerën e kromit. Parashikohet edhe ngritja e një fabrike të madhe plehrash fosforike që do të përdorë piritet që i kemi në sasi të konsiderueshme në Rubik. Në të ardhshmen, pra, ne do të eksportojmë bakër të pastër.

Minierat që kemi nga Veriu do të vihen në shfrytëzim me energji elektrike. Për këtë qëllim kemi ngritur hidrocentralin «Karl Marks» me kapacitet 20 000 kw, dhe afër tij, po aq të madh, po ndërtojmë edhe një tjetër, atë të Shkopetit. Hidrocentral po ndërtojmë edhe në Jug. Tani energji elektrike prodhohet në të katër anët e vendit tonë. Kështu kemi krijuar një rrjet të gjerë që komandohet në çdo kohë nga Tirana. Gjatë pesëvjeçarit të katërt do të ndërtojmë hidrocentrale të tjera, pse, sikurse ka thënë Lenini, elektriku dhe socializmi

janë të pandarë. Në planet e ardhshme parashikohet të ngremë një hidrocentral të madh mbi lumin Drin.

Të gjitha këto do të bëhen patjetër në një të ardhshme jo shumë të largët, natyrisht jo tani, sepse këmbët duhet t'i zgjatim sa kemi jorganin. Edhe nga ana e Korçës ka krom, si dhe qymyr dhe jo vetëm në Mborje e Drenovë, por edhe në Alarup. Në rast se do të arrijmë që qymyrin tonë ta bëjmë koks, vendi ynë do të ketë një perspektivë shumë të bukur, se atje kemi edhe hekur. Kështu mendojmë që të ngremë metalurgjinë e hekurit dhe dihet se hekuri për industrinë është si buka, se me të bëhen qyngjet për naftën; hekur për ndërtimet dhe të gjithë artikujt, shumë të nevojshëm për zhvillimin ekonomik të vendit, ne i sjellim nga jashtë. Kështu pra mendojmë të ngremë edhe ne industrinë metalurgjike në vendin tonë me ndihmën e vendeve socialiste.

Nga ana e Gjirokastrës po na dalin fosforite, me të cilat bëhen plehra kimike dhe të gjitha malet andej duket se janë të pasura me këtë mineral. Megjithatë akoma nuk jemi futur në thellësi të tyre për të parë nëse leverdis shfrytëzimi i tyre nga ana industriale e jo vetëm për të përballuar nevojat e vendit, por edhe për eksport.

Kemi ngritur gjithashtu një fabrikë të madhe tekstili që e keni parë. Kur e montuam dhe më vonë kur filloi nga shfrytëzimi, Bashkimi Sovjetik na dërgoi shumë teknikë dhe specialistë sovjetikë për të mësuar njerëzit tanë të rinj që ishin me mijëra, një pjesë e të cilëve nuk dinin akoma të shkruanin e disa nuk e kishin parë kurrë qytetin. Po këta specialistë sovjetikë qëndru-

an vetëm 2-3 vjet atje sa na mësuan njerëzit tanë, kurse tani nuk ka asnjë prej tyre, se tërë atë vepër të madhe e drejtojnë njerëzit tanë. Atje mund të shikosh vajza të reja që drejtojnë nga 15-20 makina menjëherë, saqë çuditen prindërit e tyre kur vijnë i shikojnë.

Kemi ndërtuar gjithashtu fabrikën e sheqerit në Maliq dhe një sërë fabrikash të tjera nga të katër anët e vendit. Megjithatë ne themi, dhe kështu është, se ato nuk janë të mjaftueshme sepse kërkesat shtohen, njerëzit duan të jetojnë më mirë. Ne përpiqemi jo vetëm të përmirësojmë jetën e popullit, por edhe të përballojmë nevojat që rrjedhin nga shtimi i shpejtë i popullsisë. Tani grave që kanë lindur dhe kanë rritur shëndoshë nga 10 fëmijë u japim dekoratën e nënës heroinë.

Në të ardhshmen parashikojmë të ngremë një tjetër kombinat të madh të tekstileve, në Berat. Këtu në Tiranë kemi ndërtuar një fabrikë këpucësh por do të ngremë edhe të tjera si në Korçë e në Gjirokastrë. Përveç kësaj neve na nevojitet më shumë sheqer. Edhe degët e tjera të industrisë do t'i zhvillojmë më tej.

Bujqësia jonë, e cila përpara ishte shumë e prapambetur, ka marrë një hov të madh zhvillimi. Reforma agrare që përfundoi në vitin 1946 ishte shpëtim për fshatarësinë tonë. Që gjatë luftës në zonat e çliruara edhe fshatarësinë e çliruam nga detyrimet ndaj bejlerëve dhe agallarëve; u thamë fshatarëve të mos u jepnin asnjë kokërr bërëqet, asnjë kokërr fasule, të mos i pranonin tagrambledhësit. Ne i bëmë të qartë fshatarësisë faktin se sa të çlirohej Shqipëria do të bënim menjëherë reformën agrare. Tokën ia dhamë fshata-

rit, por ai nuk kishte kafshë pune, vegla, farë e inventar bujqësor. Atëherë shteti u erdhi në ndihmë fshatarëve, por kjo ndihmë në fillim ishte shumë e vogël se kishim shumë halle dhe arka e shtetit ishte e varfër. Megjithatë duheshin ndihmuar ekonomitë bujqësore me qëllim që fshatari të jetonte më mirë se përpara. Kështu me forcimin ekonomik të shtetit u shtua ndihma e Partisë për fshatarët, sidomos kur filluan të na vijnë ndihmat edhe nga vendet miq.

Planet tona për zhvillimin e bujqësisë që në fillim ishin që ajo të ecte në rrugën e përparimit. Për këtë qëllim ne synonim që ekonomitë e veçuara të bashkoheshin se, siç thotë populli, bashkimi bën fuqinë. Por Partia porositi që kjo të bëhet me rrugën e bindjes. Çështja nacionale, lufta që bëri populli kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit, ishte e lidhur me çështjen e tokës. Kjo kishte rëndësi të madhe për popullin tonë, se për këtë tokë luftoi ai kundër pushtuesve, bejlerëve e agallarëve. Me Çlirimin e atdheut nga pushtuesit, nga çifligarët dhe nga borgjezët, fshatari e mori për herë të parë tokën. Prandaj sikur t'u thoshje që në fillim fshatarëve, ejani tani t'i kolektivizoni ekonomitë bujqësore, nuk do të na kuptonin. Fshatari do të përgjigjej me siguri: «More, unë mezi e mora këtë tokë dhe ju thoni të futem në kooperativën bujqësore». Kështu fshatarët e punuan atë vetë, shteti u dha edhe ndihmë për të blerë që, që i kishin shumë të pakta se shumicën na i therën pushtuesit dhe ballistët. Por Partia vazhdimisht propagandonte kolektivizimin e bujqësisë. Kështu në fillim në çdo vit ngriheshin nga 2-3 kooperativa.

Në fillim u bashkuan më shumë ekonomitë bujqësore në fshatrat e Korçës. Kooperativat atje u organizuan shumë mirë dhe morën prodhime të mëdha. Kështu dalngadalë erdhi koha që këta dy vjetët e fundit u kolektivizuan mbi 76 për qind e sipërfaqes së tokës së punëshme të vendit.

Ju vutë re kur vizituat krahinat tuaja se si janë pastruar tokat nga gjerdhet etj. Ne ishim të bindur se kolektivizimi do të ndihmonte për përparimin e bujqësisë, se kështu do të shfrytëzoheshin më mirë forcat e mëdha të fshatarësisë dhe ekonomitë bujqësore do të përdornin agroteknikën. Që pas Çlirimit na erdhën menjëherë ndihmat nga Bashkimi Sovjetik, sidomos në drejtim të mekanizimit të bujqësisë. Na erdhën traktorë që nuk i kishte parë kurrë Shqipëria. Në fillim u desh të bëhej një punë e madhe bindëse për përdorimin e mekanikës bujqësore se fshatarët nuk donin ta punonin tokën me traktor; «jo dua ta punoj me pendë» thoshte ndonjëri dhe në asnjë mënyrë nuk i mbushej mendja që të punonte tokën me traktor. Pa shko tani në fshat të shikosh, të gjithë, nga të katër anët kërkojnë traktorë. Po daleni, u thotë Partia, kur kërkesat janë shumë të mëdha, ku do t'i gjejmë të gjithë këta traktorë menjëherë?

Një luftë e madhe u bë nga Partia për t'u mësuar njerëzve agroteknikën e re. Toka jonë është e mirë, ajo tani punohet me mekanikë bujqësore shumë më mirë se përpara, i hidhet më shumë pleh dhe në pesëvjeçarën tjetër parashikohet të ndërtojmë një uzinë për prodhimin e plehrave azotike që mendojmë të fillojë prodhimin aty nga viti 1965, vepër tjetër kjo



që nuk ua zura në gojë më parë. Tani ne, mesatarisht për hektar, nuk hedhim më shumë se 5 kg pleh kimik në ara, po kur të ngremë fabrikat që thashë, do të kemi aq sa t'u hedhim deri në 50 kg, pra dhjetëfish. Kjo do ta rritë me siguri prodhimin. Përdorimi i plehut në bujqësi ka rëndësi të dorës së parë. Tani ne me shtimin e traktorëve dhe të veglave bujqësore, me përmirësimin e shërbimeve agroteknike, me shtimin e plehrave dhe të hapjes së tokave të reja po shtojmë nga viti në vit prodhimin. Sa për plehun kimik, atë që kemi e japim vetëm për panxhar, duhan dhe pambuk. Kur të kemi plehun tonë me siguri do të marrim jo 10 - 12, po 30 e 35 kv misër për hektar, siç marrin në Peshkopi ku nganjëherë ndonjë ekonomi arrin të marrë edhe 100 kv për ha.

Një tjetër çështje me rëndësi në bujqësi është lufta që bën Partia për hapjen e tokave të reja. Që tani ju keni parë, po pas 3-4 vjetësh shumica e këtyre tokave që hapen në brigje e në vende të pjerrta, do të mbushen me yreshta dhe me pemë, me grurë e me bimë të tjera. Parulla është që çdo pëllëmbë tokë e dobishme të hapet dhe të punohet. Problemi më i madh në këtë çështje ka qenë ai i bonifikimeve të mëdha që më parë i ëndërronte fshatarësia. Shumë nga këto sot janë realizuar. Ju tani do të shihni se ku bëhen punime bonifikimi, si në Myzeqe, në Thumanë; tani jemi duke tharë edhe kënetën e Tërbufit, po thahet gjithashtu fusha e Roskovecit, ajo e Vurgut të Delvinës. Dihet se punime kaq të mëdha nuk bëhen dot vetëm me krahë, po me anën e makinave të mëdha. Në këtë drejtim na ka ndihmuar Bashkimi Sovjetik dhe vetë fshatarësia kryen

punime për të përballuar 25 për qind të shpenzimeve, se ajo ka përfitim direkt prej tyre.

Po ne nuk kënaqemi me sa kemi bërë. Me gjithë masat që kanë marrë Partia dhe qeveria, bujqësia e vendit tonë ka hyrë tani në rrugën e përparimit. Këtë e tregon edhe jeta e fshatarit tonë që tani është më e mirë se përpara. Ju keni parë sa shtëpi të reja kanë bërë fshatarët. Kjo tregon se ata kanë përmirësuar nivelin e jetesës. Janë më mirë nga ana ekonomike fshatrat e pellgut të Korçës, sepse fshatarët atje janë bujq të përparuar, se atje hyri kolektivizimi më përpara, se niveli kultural i njerëzve atje është më i ngritur. Të gjitha këto influencojnë që ata të marrin edhe prodhime më të larta. Po fshatrat e Korçës tani kanë konkurrenca të forta edhe krahinat e tjera si ato të Fierit, të Lushnjës dhe disa nga ato të Veriut.

Në vendin tonë është fakt se jeta e popullit, për të cilën punon Partia, që pas Çlirimit ka ardhur vazhdimisht duke u përmirësuar. Socializmi është në radhë të parë një jetë më e mirë për masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit. Prandaj gjithë lufta e Partisë aty përqëndrohet: t'i sigurojë popullit bukë, mish, qumësht, gjalpë, shtëpi, shkolla, universitete, jetë më të mirë. Natyrisht një shtëpi e re nuk ngrihet brenda ditës. Pasi ngrihen muret, duhet lyer, duhen vënë dyert e penxheret, pa duhen edhe mobilje, orendi dhe pajisjet e duhura. E ne jemi në këtë rrugë. Nuk themi se vendi ynë u bë parajsë, sepse kemi akoma shumë vështirësi, ka akoma boshllëqe dhe të meta në shumë drejtime. Ja p.sh., ne kemi shumë vështirësi për banesa, megjithëse po bëhen ndërtime nga të katër anët e vendit

për çdo vit. Por tani shteti ynë ka krijuar një forcë të tillë ekonomike që, në vjetët e ardhshëm, ndërtimi i banesave për popullin do të rritet me ritme më të shpejta se deri tani.

Pastaj është edhe problemi i prodhimeve ushqimore. Përmirësimet janë të dukshme dhe populli ka pasur besim të madh te Partia në këtë çështje; ai vetë po i krijon të mirat materiale me punën dhe forcat e tija dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore. Në fillim populli kishte vësh-tirësi ekonomike, por tani paralelisht me përmirësimin e ekonomisë po përmirësohet dhe jeta e tij. Me uljen e çmimeve të ditëve të fundit çdo fëmijë fiton mesatarisht 1 100 — 1 200 lekë në muaj. Dhe ne i kemi ulur e do t'i ulim çdo vit çmimet. Kjo ndodh se ekonomia jonë forcohet, se industria jonë zhvillohet nga viti në vit dhe punon më mirë. Plani i prodhimit industrial në tremujorin e parë të këtij viti është realizuar, me përjashtim të disa gjërave të vogla, siç është lënda e drurit dhe tullat, sepse të gjithë sektorët kanë bërë përpjekje për realizimin e detyrave të planit. Plani i lëndës së drurit nuk u realizua për shkak të kohës. Në dimër u zunë rrugët dhe nuk kishte se si të transportohej lënda e drurit. Edhe në prodhimin e tullave kemi disa të meta që do t'i ndreqim.

Tani ne luftojmë me të gjitha forcat për të shtuar sa më shumë prodhimet industriale, që ato të jenë sa më të mira dhe sa më të lira. Kjo do të thotë që të ulim koston e prodhimeve, të ngremë cilësinë e tyre, të shtojmë rendimentin në punë, që populli të ketë të blejë mallra, jo vetëm sa më shumë, po edhe sa më

lirë, sa më të mira e të bukura dhe sa më të forta.

Një problem tjetër për ne është që edhe bujqësia të prodhojë më shumë dhe më mirë dhe fshatarët të mos kënaqen me pak. Të kënaqurit me pak e lufton Partia, sepse toka, po t'ia bësh shërbimet, të jep sa të duash. Kështu do të kemi çdo vit më shumë prodhime.

Sa për shkollat edhe ato janë zgjeruar shumë dhe kjo ishte një punë e domosdoshme që duhej ta bënte Partia, sepse me dituri bëhet çdo gjë e mirë. Tani ne kemi në çdo sektor teknikë moderne. Përpara luftohej me dogra kurse tani atij që shkon ushtar do t'i takojë të marrë në dorë edhe nëndetësen, prandaj që ta kryejë mirë detyrën atje, i duhet të ketë mbaruar shkollën e mesme dhe jo vetëm kaq, por pa u shkëputur nga puna të vazhdojë shkollën që të dalë edhe inxhinier. Tani që shkenca është zhvilluar shumë, njerëzit tanë duhet të mësojnë shumë që ta përvetësojnë atë. Në këtë drejtim Partia jonë ka arritur suksese të mëdha. Nga të katër anët e Shqipërisë janë hapur shkolla ku mëson rinia, bile edhe të rriturit na drejtohen që të lejohen nga puna për të mbaruar shkolla dhe në një pjesë të madhe të tyre i lejojmë.

Këtu, pra, drejtohet lufta e popullit me Partinë në krye, që ta bëjë Shqipërinë një vend të lulëzuar, në mënyrë që populli ynë, jo vetëm të jetojë i lirë e i pavarur, por edhe i gëzuar e i respektuar nga të gjithë. Ne mund të themi se lufta që bëri populli ynë ia rriti shumë autoritetin vendit tonë në botën e jashtme, jo se Shqipëria luan ndonjë rol të madh në botë, po respektohet për rrugën dhe qëndrimin e saj. Autoriteti i vendit tonë

në botën e jashtme është vendosur në saje të luftës që bëri populli ynë me Partinë e tij në krye. Pra parimet e marksizëm-leninizmit që ka ndjekur e ndjek PPSH kanë bërë që Shqipëria të respektohet në arenën ndërkombëtare dhe që askush të mos guxojë ta prekë.

Momente të rrezikshme ka kaluar Shqipëria, se vërtet u çliruar por u kurdisën shumë komplete nga jashtë dhe nga brenda për të përmbysur pushtetin popullor, nga amerikanët, anglezët e sidomos nga revizionistët jugosllavë, por edhe nga monarko-fashistët grekë e neofashistët italianë. Partia dhe populli ynë kanë qenë kurdoherë në këmbë. Që kur ishim në mal anglezët dhe amerikanët u përpoqën t'ia merrnin fitoret nga duart popullit. Për këtë qëllim ata mobilizuan gjithë reaksionin e brendshëm, zogistët, ballistët e gjithë tradhtarët e vendit e i organizuan me anën e Mithat Fra-shërit, Ali Këlcyrës me shokë, por Partia ua zbuloi e ua shkatërroi planet. Pra ata u përgatitën kështu më parë, sepse qëllimi i tyre ishte të zbarkonin në Shqipëri që të kishin forcat e tyre, nën maskën e aleatit. Ata shumë herë na thanë: «Ne jemi aleatë, të zbarkojmë që t'ju ndihmojmë». Ne u thamë: «Përse të zbarkoni, ne e çliruam vetë Shqipërinë, prandaj nuk ka nevojë të zbarkoni». Pas shumë zëniesh me ta, na propozuan të luftonin edhe ata në Shqipëri si aleatë, p.sh. në Sarandë. «Po pse?» — u thamë ne. «Sepse është një repart gjermanësh në Sarandë që ju pengon» — na u përgjigjën. «Po atë jemi në gjendje ta luftojmë vetë» — u thamë. Megjithatë më në fund i lejuam, por më parë kërkua të dinim sa trupa do të dërgonin. Kur ramë në marrëveshje për këtë, kërkuan ta kishin ata komandën e ope-

racionit të përbashkët, nën udhëheqjen e një gjenerali anglez për gjithë bregdetin. Ne refuzuam, u thamë: «Ejani ta bëjmë së bashku planin e operacionit dhe kurdoherë ai të zhvillohet nën komandën tonë dhe jo vetëm kaq, po, sa të përfundojë aksioni, ju të tërhiqeni, duke pasur parasysh të zbatoni deri në fund marrëveshjen», dhe caktuam kështu vendin e operacionit dhe gjithë zhvillimin e luftimeve. Në fillim anglezët u orvatën të zbarkojnë në Himarë (Spilë). Por gjermanët i shpartalluan trupat anglezë dhe do t'i kishin asgjësuar, po të mos u kishim ardhur në ndihmë ne. Më pas ata hynë në Sarandë, pasi e kishin çliruar qytetin partizanët. Në vend që të largoheshin që andej, sipas marrëveshjes, ushtarët anglezë filluan edhe të vidhnin. Komanda partizane njoftoi Shtabin e Përgjithshëm dhe ne atëherë iu drejtuam komandës angleze duke i thënë se aksioni kishte përfunduar, prandaj ata nuk kishin më asnjë punë të qëndronin. «Në rast se nuk ikni, atëherë do t'ju qëllojmë. Prandaj, brenda 24 orëve ose largohuni, ose filloi lufta» — u thamë. Atëherë trupat anglezë u tërhoqën në Korfuz.

Anglezët gjithashtu u përpoqën të merrnin Tiranën nga ajri. Në atë kohë në Tiranë ne po luftonim kundër gjermanëve, të cilët i kishim rrethuar. Të gjithë agjentët e anglezëve, të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit», Bazi i Canës, Ali Këlcyra etj., shpresën tani e kishin mbështetur vetëm te ndërhyrja e anglezëve dhe e amerikanëve. Anglezët i propozuan Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH të dërgonin ndihma në forca ushtarake me parashuta për çlirimin e Tiranës. Ne nuk pranuan dhe u thamë: «Tiranën do ta çlirojmë vetë, prandaj kini

kujdes mos hidhni parashutistë se do t'i vrasim». Dhe në atë kohë, sidomos në rrethet e Tiranës, kishte pëllëmbë e partizanë. Kështu edhe ky plan atyre u dështoi.

Si e panë që dështuan në kohën e luftës, filluan të pregatitin një nga një komplete me miqtë e tyre që mbetën në Shqipëri, me reaksionarët dhe të shiturit. Por të gjitha komplotet e tyre i zbuluam. Një punë të madhe armiqësore zhvilloi kundër nesh edhe misioni i UNRRA-s, por edhe planet e këtij misioni i zbuluam dhe i asgjësuam. Qëllimi i UNRRA-s ishte që të sillte në Shqipëri një mijë e ca oficerë anglezë dhe aeroplanë. Kuptohet përse donin t'i sillnin ata. Po ne u përgjigjëm se vdesim për bukë dhe këtë nuk e lejojmë. Ata thoshin se popullin e keni pa bukë, të sëmurë, keni nevojë. Ne u thamë: «Kështu jemi, po këtë gjë s'e pranojmë».

Si e panë që edhe kjo nuk u shkoi, na thanë: «Ju qenkeni njerëz të egër, nuk ju njohim si pushtet, prandaj derisa të shikojmë ç'do të bëni, ne do të dërgojmë një mision amerikan në Shqipëri me vapor lufte». Ne u thamë: «Misioni le të vijë, po vaporin e luftës të mos hyjë në ujërat tona». Pas kësaj filluan dallavere të tjera.

Amerikano-anglezët, si e panë që s'ia arritën qëllimit, ikën, po dolën pastaj trockistët jugosllavë, qëllimi i të cilëve ishte të likuidonin Partinë dhe fitoret tona nën maskën e miqësisë. Në fillim ne nuk i njohim se ç'ishin, u besuam se kishim luftuar bashkë. Populli jugosllav ka luftuar, por udhëheqësit e tij dolën tradhtarë. Ata punuan në mënyrë shumë të maskuar kundër vendit tonë.

Qysh në kohën e luftës ne e kishim kuptuar se disa çështje udhëheqësit jugosllavë nuk i shikonin drejt dhe

ne ua kishim vënë në dukje shoqërisht. P.sh. ata nuk donin që ne të krijonim Ushtrinë tonë Nacionalçlirimtare; «mjafton të keni çeta të vogla — thoshin — ç'i doni repartet e mëdha». Po ne s'ua vinim veshin. Veç kësaj ata na thoshin ta fshihnim Partinë. «Po pse, u thoshim ne — populli e do Partinë dhe lufton sipas porosive të saja», por ata na thoshin që të mos trembet populli. Ata na propozuan që në organizatën e Frontit të futeshin bajraktarë dhe njerëz të shitur si Cen Elezi, Selim Mborja etj.

Bashkë me Koçi Xoxen trockistët jugosllavë organizuan fshehurazi një komplot të madh kundër Partisë sonë në pragun e çlirimit<sup>1</sup>. Një i deleguar i Titos, Velimir Stojniçi, na tha se ne nuk e paskeshim kryer plotësisht detyrën tonë! Këtë komplot ata e kishin kurdisur me Koçi Xoxen për të na rrëzuar të gjithë ne, me qëllim që pushtetin ta merrte në dorë Koçi Xoxe, agjenti i tyre, dhe pastaj të bënin si donin vetë, d.m.th. Shqipëria të bashkohej me Jugosllavinë dhe të mos ishte më e pavarur, por një krahinë jugosllave.

Që t'ia arrinin këtij qëllimi, më parë ata duhej të shkatërronin Partinë, prandaj e filluan punën fshehur me anën e Koçi Xoxes. Pastaj ata ia hynë punës për të shkatërruar ushtrinë dhe më vonë ekonominë. Ata synonin që Shqipëria të ishte e varur ekonomikisht nga Jugosllavia. «Ç'e doni ju industrinë — na thoshin — e pse mbillni drithë, bukë ju japim ne, ka sa të duash Banati. Ju mbillni pemë, zhvilloni turizmin». Më

---

<sup>1</sup> Është fjala për prapaskenën e organizuar në Plenumin II të KQ të PKSH në Berat në nëntor 1944.



në fund ata arritën deri atje saqë kërkuan të sillnin divizione ushtarake jugosllave në Shqipëri se e panë që u dështuan të gjitha planet dhe afroi koha që të demaskoheshin. Prandaj na njoftuan të sillnin 4 divizione jugosllave sepse gjoja do të na sulmonte Greqia. Ne u thamë jugosllavëve se, po të na sulmojë Greqia, ne do të luftojmë. «Ju nuk luftoni dot as 10 ditë» — thanë ata, duke përcmuar kështu ushtrinë tonë të kalitur, të dalë nga lufta. «Po ne kemi një ushtri heroike — u thamë — prandaj s'jemi dakord me mendimin tuaj, sepse ushtria jonë jo 10 ditë po është në gjendje të luftojë me vite për të mbrojtur lirinë e popullit. Po le të pranojmë sikur Greqia do të na sulmojë, po ju që ju kemi aleatë çfarë do të bëni në bazë të traktatit të miqësisë dhe të ndihmës reciproke që kemi?». «Ne nuk mund të hyjmë në luftë» — thanë ata. «Atëherë edhe ne nuk i pranojmë divizionet tuaja» — u thamë ne.

Më vonë, në vitin 1948, siç e dini, u zbulua se ç'ishin ata. Ata bënë poshtërsi të mëdha në vendin tonë, shumë sabotime në lëmin ekonomik. Ne ishim në gjendje të mjeruar dhe ata, edhe ato pak mallra që u morëm tregtarëve nga tatimet e luftës, na i rrëmbyen të gjitha.

Më në fund puna e tyre u demaskua dhe tani është e qartë se cilët janë ata njerëz nga të cilët mund të presësh çdo gjë, po që te ne nuk u shkoj. Ata janë demaskuar para popujve nga të gjitha partitë dhe nga Partia jonë. Ata na kanë halë në sy sidomos ne, se ne ua kemi nxjerrë më shumë të palarat në shesh si armiq të betuar të popujve tanë, të socializmit dhe të vetë popullit jugosllav. Populli jugosllav është një popull

i mirë dhe trim. Kur kishim marrëdhënie të mira me ata unë kam shkuar në Jugosllavi për vizitë. Pleqtë e plakat, burrat e gratë në Jugosllavi na përshëndesnin me entuziazëm e me lot në sy na thoshin: «Jemi vëllezër, kemi derdhur gjak në luftën e përbashkët kundër pushtuesve fashistë».

Me përfaqësuesin e Titos ne kemi pasur kundërshtime gjatë kohës së luftës. Ai ishte një shovinist i madh<sup>1</sup>. Partia jonë jepte direktivën se si të punohej me shqiptarët në Kosovë, sepse kosovarët sytë i kishin nga Shqipëria, por përfaqësuesit e Titos sillnin pengesa. Lufta e përbashkët që bënim me jugosllavët kundër të njëjtit armik bëri që ne të mendonim se çështja e Kosovës do të zgjidhej drejt. Ne u thoshim udhëheqësve jugosllavë se populli kosovar dëshiron të luftojë kundër pushtuesve, qoftë edhe nën komandën e jugosllavëve, por të mbajë flamurin shqiptar; ata nuk deshën. Që kur u çlirua Shqipëria e deri në vitin 1948 që kishim marrëdhënie të mira me jugosllavët, ata nuk lejuan asnjë udhëheqës shqiptar të shkonte në Kosovë. Kur shkoi ushtria jonë në Jugosllavi, populli kosovar luftoi me bindje vetëm duke pasur besim se tani gjendja në Jugosllavi kishte për të ndryshuar, se në krye, siç besonim edhe ne, ishte partia komuniste.

Tani ne nuk mund të rrimë pa folur për të gjitha ato që titistët bëjnë kundër popullit kosovar. Ata i dërgojnë kosovarët në Turqi, i kanë shpërndarë nëpër Jugosllavi, ku bëjnë punët më të vështira, mbyllin gradualisht shkollat shqipe dhe hapin shkollat serbe.

---

<sup>1</sup> Është fjala për Vukmanoviç Tempon.

Me një fjalë ata bëjnë një politikë diskriminuese në shqiptarët e Kosovës.

Rëndësi të madhe për ne ka fakti që populli ynë trim qëndron si shkëmb rreth Partisë dhe qeverisë që i do me gjithë shpirt. Populli ynë është popull i zgjuar, ai sheh se Partia dhe qeveria punojnë për të mirën e tij, se Partia ia hapi sytë. Po të bësh një gjë jo të drejtë, ai nuk rri pa ta thënë, kështu e ka mësuar Partia dhe kështu vepron ai. Ne e mësojmë popullin që të mos mbyllë sytë para të metave e dobësive. Mbeturinat në ndërgjegjen e njerëzve nuk zhduken kollaj, se ato për shekuj kanë rënduar mbi supet tona, prandaj ne që jemi komunistë duhet të bëjmë shumë kujdes në këtë drejtim dhe çdo mbrëmje duhet të kontrollojmë veten e të themi: kemi punuar mirë sot apo jo? Kjo nuk është një punë e lehtë që mund të bëhet menjëherë. Për të zhdukur të metat që vihen re në punën tonë duhet të pastrohemi në ndërgjegje që të jemi në rregull me popullin.

Populli e sheh rrugën e drejtë të Partisë prandaj është me Partinë. Është fakt se situata në vendin tonë është shumë e qetë, shumë e shëndoshë. Çdo gjë, edhe të mirat edhe vështirësitë duken. Ka akoma te ne edhe dobësi, po këto do të zhduken gradualisht me një punë të durueshme. Partia na mëson që në çdo veprim të jemi gjakftohtë dhe të punojmë shumë për të zgjidhur çështjet e popullit. Partia që na ka vënë në këto vende me përgjegjësi na ka porositur të punojmë mirë dhe populli ka besim të madh te ne. Prandaj ka rëndësi që këtë besim ta justifikojmë.

Vendi ynë do të përparojë, populli do të jetojë

gjithnjë më mirë dhe do të lidhet më ngushtë me Partinë. Ne jemi të bindur se tradhtarët shqiptarë që ju pengojnë ju në Argjentinë, në saje të pozitës, të qëndrimit të drejtë dhe heroik të vendit tonë, do të shpartallohen, sepse këta tradhtarë kanë vetëm përkrahjen e agjenturave imperialiste që i mbajnë dhe i heqin për hunde. Po ju keni forcën morale për të bërë që të dështojnë planet e tyre, se rruga juaj është e drejtë, se dashuria juaj është e madhe për Republikën tonë Popullore, për qeverinë, për Partinë tonë dhe udhëheqjen e saj, se ju ju ndihmon atje populli argjentinasi dhe partia komuniste e partitë përparimtare.

Kohët e fundit në Argjentinë është shtuar shumë reaksioni, partinë komuniste përpiqen ta nxjerrin jashtë ligjit. Unë kam pasur rast e kam biseduar me shokë të PK të Argjentinës. Ata më kanë folur shumë fjalë të mira për shqiptarët dhe komunistët shqiptarë në Argjentinë.

Situata nuk është në favorin e imperialistëve, kurse situata jonë do të forcohet akoma më shumë në të ardhshmen. Imperialistët bëjnë përpjekje të mëdha për t'u përgatitur për luftë, po nuk janë në gjendje; ata ia kanë shumë frikën luftës, sepse ne jemi më të fortë nga ata. Mos shko më tutje po shiko vetëm Shqipërinë, si ishte ajo përpara dhe si është sot. Luftën e bëmë dhe s'u zhdukëm, përkundrazi, po forcohemi dita-ditës, po ndërtojmë socializmin, Shqipëria është e lirë, me një ushtri të fortë si çeliku, me një popull të gatshëm për ta mbrojtur atdheun. Industria po zhvillohet, bujqësia dhe të gjithë sektorët e tjerë po përparojnë.

Amerika i di të gjitha këto, ajo do që ne të shka-

tërrohem, po kapitalistët nuk rrinë pa i bërë llogaritë, ata bëjnë zhurmë për të frikësuar popujt, shkruajnë sa mundin gazetatat e tyre, po ne mbajmë gjakftohtësinë, nuk na trembin dot.

Në vitin 1920 gjeneral Kadorna<sup>1</sup> e njoftoi shtabin e përgjithshëm të ushtrisë italiane që kjo të mos hynte në Shqipëri se ushtarët italianë do të hidheshin në det. Dhe kështu ndodhi. Po nëse italianët mundën të bënin diçka më 1939 këtë ata e bënë vetëm për shkak të tradhtisë së klikës së Zogut. Këto bëjnë imperialistët prandaj ne duhet të jemi vigjilentë se si thotë populli: «Ujë të fle, hasmi s'fle». Po fjete, të mbyti hasmi, po qëndron i zgjuar të ngre kapelen. Imperialistët bënë ç'ishte e mundur për të mos na pranuar në OKB, po më së fundi e drejta fitoi, shteti ynë u bë anëtar i OKB-së.

**MITRO RRAPI:** Po mbreti Pavllo ç'do nga ne?

**SHOKU ENVER:** Atë e kanë inxheksionuar për të bërë një deklaratë të tillë se grekët e dinë që Shqipëria e sotme nuk është një koskë që gëlltitet, ata e dinë mirë se ne nuk jemi vetëm dhe kush prek Shqipërinë, do të thyejë kokën. Po imperialistët kur janë në pozita të vështira hedhin ndonjë fjalë. Reaksioni grek rifilloi të flasë për Vorio Epirin, por këto dëshira nuk do të plotësohen kurrë.

Ne jemi shumë të gëzuar për këtë takim me ju, të dashur vëllezër, prandaj në emër të shokëve ju shpreh falenderimet më të përzemërta për punën tuaj heroike

---

<sup>1</sup> Luigi Kadorna (1850-1928), mareshall italian, kryekomandant i ushtrisë italiane në vjetët 1915-1917, kur Italia fashiste hyri në Luftën e Parë Botërore.

që keni bërë, për organizimin e punës, e cila i ka shërbyer luftës për çlirimin e atdheut dhe ndërtimin e socializmit. Këtë nuk do t'ua harrojë as populli as ne kurrë. Ne jemi të bindur se te ju Shqipëria ka bij besnikë, se ky vend nuk është vetëm yni, po dhe juaji. Edhe ju jeni bijtë e kësaj toke.

Ju jetoni në Argjentinë, keni krijuar një situatë ekonomike pak a shumë të mjaftueshme për të jetuar dhe ne ju duam kurdoherë të mirën. Po, sikurse thashë, Shqipëria është juaja, urdhëroni kur të dëshironi, qoftë si turistë, qoftë të ktheheni definitivisht pranë familjeve tuaja. Partia dhe qeveria do t'u sigurojnë punë të gjithë atyre që do të dëshirojnë. Kur ta shihni të arsyeshme shikoni e mendoni dhe ejani. Këtu ju keni së pari familjet dhe shtëpitë tuaja, por do të gjeni kudo zemër të ngrohtë dhe përkrahjen e Partisë e të qeverisë. Po edhe atje ku jeni, ndihma e Partisë sonë nëpërmjet partisë dhe organizatave përparimtare, sa të jetë e mundur nuk do t'ju mungojë. Sa për ne dëshira jonë është të ktheheni në Shqipëri, megjithatë kur ju ta shihni të arsyeshme, kur t'ju thotë zemra dhe kur t'ju lejojnë kushtet ekonomike, kthehuni si në shtëpinë tuaj. Do të rrini shumë këtë radhë?

*MITRO RRAPI:* Tre muaj.

*SHOKU ENVER:* D.m.th. keni plot kohë të takoheni me njerëzit tuaj, të çmalleni. Kur të vijë koha për të ikur, ejani përsëri të takohemi se kemi shumë nevojë për këshillat dhe vërejtjet tuaja. Ju jeni njerëz me eksperiencë dhe do të na ndihmoni me vërejtjet tuaja, sepse, siç ju thashë, nuk i kemi të mira të gjitha gjërat, kemi edhe gjëra që nuk ecin si duhet. Prandaj këshillat dhe

vërejtjet tuaja i presim si këshilla e vërejtje të vëllëzërve dhe të shokëve tanë, se ato bëhen për interesin e përgjithshëm të popullit.

Tani që do të shëtitni nëpër Shqipëri do të takoheni edhe me shokë të tjerë. Çfarë ju intereson të shikoni dhe të dini, kërkoni dhe shokët do të jenë të gatshëm t'ju tregojnë.

*MITRO RRAPI:* Ne, shqiptarët e mërgimit, kemi shumë kohë larg, po vetëm me trup, se zemra dhe mendja jonë kanë qenë gjithnjë këtej. Jeta jonë dhe e shokëve tanë ka qenë e zezë. Ne kishim dëgjuar dhe mësuar shumë gjëra për përparimin e Shqipërisë, po këto që pamë dhe ato që na thatë ju na bënë që të mësojmë edhe më shumë. Ne sikur lindëm edhe një herë kur pamë popullin tonë trim dhe heroik, gjithë këto realizime të mëdha dhe nuk dimë se si t'ju urojmë dhe t'ju përgëzojmë për mundësinë që na dhatë për të realizuar dëshirën tonë prej kaq vjetësh. Edhe kjo u realizua se këtu udhëhoq Partia e artë e Punës që u dha dërmën armiqve, se Shqipëria ka mikun e madh të të gjithë botës mik, Bashkimin e madh të Sovjetëve.

Argjentina ka 20 milion frymë dhe një tokë shumë të madhe që është në duart e bejlerëve dhe të agallarëve, atje ka mundësi të zhvillohet shumë bujqësia dhe të ketë me qindra milion krerë bagëti. Edhe tani që u larguam, popullin e lamë në gjendje të keqe për ibreti alem, atje ka shtrenjtësi që ngrihet çdo vit. E gjithë borgjezia e botës është mbledhur në Buenos-Ajres, me pallate të mëdha, por, po të dalësh jashtë qytetit, shikon njerëzit që rrëjnë në kasolle shumë të vogla. Lëre pastaj arsimin si është. Njerëzit duan të mësojnë, po me se të

mësojnë? Atje ka bërë folenë kumari dhe alkooli. Atje luhet kumari, si këtu në kohën e Zogut, për të paralizuar popullin. Edhe fëmijët 7-8 vjeç luajnë dhe pinë. Rinia nuk bën asnjë punë të dobishme, po merret vetëm me letra dhe me pije, kurse gruaja jeton si në kohët e vjetra; burrat luajnë kumar, ato punojnë, po edhe rrihen nga burrat. Ne do të vemi në bashkimin e rinisë dhe të gruas shqiptare t'u tregojmë hollësisht për gjendjen e gruas dhe të rinisë në Argjentinë.

Atje ha njeriu njerinë. Atje nuk bëhet asgjë për të ruajtur shëndetin e popullit, sëmundjet janë shumë të përhapura. Të vesh nëpër spitalet të merr të qarët. Po të kesh ndonjë doktor të mirë mik dhe ta paguash mirë, të kuron mirë.

Përsa i përket kthimit, mendoj që pas 6 muajsh të kthehem në Shqipëri. Partia komuniste në Argjentinë lufton e vetëm kundër gjithë reaksionit në të tërë sektorët. Frondisi u prishi mendjen njerëzve sa pa ardhur në fuqi se gjoja do të merrte masa për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe masa për të vendosur liritë demokratike. Por sa mori fuqinë, ai iu derdh komunistëve. Kështu tani që ikëm e lamë vendin në trazira të mëdha. Në botën kapitaliste kudo ka varfëri të madhe. Kur zbritëm në Dakar, natën, shumë njerëz flinin rrugëve.

Reaksionarët e ballistët na pengojnë. Atje është një profesor Llupi dhe Isuf Luzaj<sup>1</sup> që u përpoqën shumë për të na penguar që të mos vinim në Shqipëri, se

---

<sup>1</sup> Kriminelë luftë dhe armiq të popullit shqiptar. Me Çlirimin e vendit u arratisën jashtë shtetit.



e dinë që, kur të kthehemi, do t'i nxjerrim të palarat propagandës së reaksionit. Shqiptarët të gjithë nuk besonin se ne do të niseshim aq propagandë e madhe u bë. Po kur do të niseshim u shkul gjithë kolonia për të na përcjellë.

Në qendër të shoqërisë na vijnë «Zëri i popullit», «Bashkimi», «Puna». Kemi blerë me ndihma një ndërtesë të mirë dhe e kemi pajisur sipas mundësive tona, kemi vënë fotografinë Tuaj, të Qemal Stafës etj. Kur në Shqipëri u bë huaja e shtetit ne mund të kishim dhënë më shumë ndihma po na penguan armiqtë. Ne kemi miq edhe në Amerikën e Veriut si Trebickën, doktor Xhon Nasen që erdhi edhe në Shqipëri.

Gazetën e shoqërisë e kemi të vogël po shpresojmë ta zmadhojmë. Ne të falenderojmë nga zemra Ty, Komitetin Qendror dhe qeverinë që na dërguat përfaqësuesit tuaj atje dhe na folën, gjë që ndihmoi shumë për bashkimin e shqiptarëve të Argjentinës. Këtë do ta arrinim, por do të ishim vonuar. Përçarja neve na erdhi nga një Iljas Bej Toptani që nuk la kusur pa folur, po patriotët e vërtetë atë nuk e lanë. Pastaj na ka sjellë dëm të madh edhe Mubareq Toptani, i cili për kohën e luftës na foli kundër partizanëve sikur ata ishin kusarë, po unë e kundërshtova.

Tani sa të vemi në Argjentinë do t'u flasim shqiptarëve atje për çdo gjë që pamë dhe mësuam. Ne i dinim përparimet po tjetër është t'i shikosh me sy. Prandaj edhe një herë them lavdi dëshmorëve që ranë për çlirimin e atdheut, si Qemali me shokë! Unë ju them edhe një herë se ne do të vdesim me këtë ide.

**SHOKU ENVER:** Do t'u them shokëve t'ju pregatitin

disa fotografi dhe materiale të ndryshme që do t'ju vlejnë për shtypin e shoqërisë dhe për programin e punës kulturale. Po edhe ju mund të na kërkoni materiale me të cilat do të keni nevojë ta pasuroni qendrën e shoqërisë patriotike «Skënderbeu».

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbajtur në këtë takim  
që gjendet në AQP*

# TE KUJDESEMI NE MENYRE ME TE ORGANIZUAR PER BUJQESINE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

5 maj 1959

Është e domosdoshme të kuptohet mirë se interesimi i Partisë dhe i pushtetit për çështjet e bujqësisë duhet të jetë i vazhdueshëm dhe në mënyrë të organizuar. Është fakt se të gjithë kuadrot e Partisë dhe të pushtetit punojnë pa u lodhur për mbarëvajtjen e bujqësisë, por zhvillimi i direktivës dhe shtruarja e detyrave në kooperativat bujqësore duhet bërë në një nivel më të lartë, në mënyrë të organizuar dhe frytdhënëse.

Planet në kooperativat bujqësore nuk bëhen keq, por s'merren masa konkrete që ato të zbatohen deri në fund. Organizatat e Partisë nuk i ndjekin si duhet detyrat që kanë në këtë fushë. Prandaj ndodh që këto plane shpeshherë mbeten në letër.

Praktika tregon se ka sekretarë të parë të Partisë në rrethe që shkojnë fluturimthi në kooperativat bujqë-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi zbatimin e vendimit të Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH të Nëntorit 1958 lidhur me shtimin me ritme më të shpejta të mishit dhe të qumshtit.

sore duke dhënë kështu një shembull të keq. Një metodë e tillë nuk është e drejtë dhe s'jep rezultatet e dëshiruara. Është e nevojshme që sekretari i komitetit të Partisë, para se të vejë e të japë ndihmën në një kooperativë, ta zëmë për problemin e shtimit të mishit, duhet të konsultohet për problemet dhe masat që do të merren, të mendojë për organizimin e punës atje ku shkon. Mund të marrë me vete edhe instruktorin, të thërresë sekretarin e organizatës-bazë dhe kryetarin e kooperativës bujqësore për të shkëmbyer mendime se si të organizohet puna për zbatimin e detyrave etj. Pastaj të shkohet për të parë nëse janë zbatuar ose jo këto detyra. Por sekretari i parë dhe sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë nuk kanë mundësi të venë në të gjitha kooperativat bujqësore. Prandaj ata organizojnë punën duke dërguar në bazë edhe shokë të tjerë. Veçanërisht të arrihet që të vlerësohen më mirë organet e pushtetit. Kryetari i komitetit ekzekutiv të kp që merret me bujqësinë dhe seksioni përkatës, të kujdesen në mënyrë të vazhdueshme për zbatimin e detyrave të planit në bujqësi.

Çështja është që ne duhet të realizojmë detyrat e planit për mishin dhe qumshtin. Duhet ditur se ulja e çmimeve që bëjmë mund të sjellë, bashkë me gëzimin, edhe një farë vetëkënaqësie, sepse ka të ngjarë që fshatari ta shikojë çështjen vetëm nga ana e lekëve dhe jo nga nevoja që kemi për shtimin e gjësë së gjallë. Nga kjo pikëpamje ekziston rreziku që të neglizhohet zbatimi i detyrave të caktuara për shtimin me ritëm më të madh të mishit dhe të qumshtit. Prandaj këtë problem shokët e Partisë duhet ta kenë mirë pa-

rasysh. Të kemi gjithashtu të qartë se çmimet do të vijnë duke u ulur vazhdimisht, do të vijë dita që të ulet edhe çmimi i mishit, prandaj duhet të krijojmë në fshatarësi një koncept të qartë mbi leverdinë për shtimin e gjësë së gjallë, për të marrë më shumë lekë. Po kështu, kemi shtuar grumbullimet, por do të vijë një kohë që do të ulim edhe tepricat, prandaj edhe kjo të kihet parasysh.

Krahas këtyre, duhen marrë masa të forta për sigurimin e bazës ushqimore. Jonxha kushton shtrenjtë, prandaj të merren masa për sigurimin e farës së saj. Ministria e Bujqësisë dhe komitetet e Partisë, megjithëse e dinë nevojën e madhe që kemi për jonxhë, nuk po bëjnë përpjekjet e duhura për të shtuar mbjelljen e saj. Ta mësojmë fshatarësinë që ta konsiderojë jonxhën si një prodhim të shtrenjtë dhe të rrallë. Ne nuk jemi në fazën e parë, kur fshatari nuk e kuptonte nevojën për hapjen e gropave të silazhit. Ai tani ka bërë përpara, prandaj edhe këto orientime i përvetëson shpejt. Kjo na bind për zbatimin e porosive që jepen lidhur me një bazë më të pasur ushqimore.

Ne kemi marrë një sërë vendimesh për shtimin e mishit të dërrit por duhet thënë se detyrat e caktuara nuk po realizohen. Prandaj për këtë, për ndërtimin e frigoriferëve dhe furnizimin me vezë të popullatës, të bisedohet me shokët e qeverisë se ç'duhet bërë më tej.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## KOMUNISTI ËSHTË UDHËHEQËS I MASAVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

5 maj 1959

Dëshiroj të them pak fjalë për pjesëmarrjen në punë të komunistëve. Po ta shikojmë çështjen në përgjithësi, duket se puna në këto dy rrethe është e kënaqshme, por po të hyjmë në detaje e të shikojmë se sa punohet në fshat dhe në qytet, rezulton se mundësitë janë më të mëdha, pra shifrat e pjesëmarrjes së komunistëve në punë duhet të ngrihen më lart. E kemi theksuar edhe më parë se pjesëmarrja në punët e kooperativave bujqësore është akoma e dobët. Është e domosdoshme që rrethi i Vlorës të bëjë kthesë në këtë drejtim, sepse ka komunistë që kanë bërë 160 ditë-punë në vit. Kjo duhet ta preokupojë shumë Partinë,

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Drejtoria e organeve të Partisë, të rinisë e të bashkimeve profesionale pranë aparatit të KQ, të PPSH «Mbi kryerjen e detyrave nga komunistët në rrethin e Shkodrës e të Vlorës».

prandaj të merren masa për të përmirësuar çështjen e pjesëmarrjes së komunistëve në punë. Kjo do të nxitë më tepër edhe të tjerët e do të zhvillojë më shumë ekonominë e vendit tonë.

Pjesëmarrjen në punë të komunistëve duhet ta shikojmë në dy drejtime:

Së pari, radhët e Partisë të shtohen me njerëz të prodhimit. Kjo punë bëhet, por jo në shkallën e duhur. Ka shumë punëtorë dhe fshatarë të dalluar në punë që janë jashtë Partisë. Shpeshherë e ka më lehtë të kërkojë për të hyrë në Parti një drejtor ose përgjegjës dyqani se sa një punëtor i mirë e me perspektivë. Disa janë pranuar në Parti duke u mbështetur në funksionet e tyre, në cilësitë e mira teknike që kanë. Kështu ndodh edhe në fshat, ku pranimet në Parti janë të pakta. Ne kemi caktuar disa norma orientative për pranimet në Parti, të cilat disa organizata i plotësojnë, ndërsa disa tregohen të ngurta. Po të pranohen më shumë punëtorë, kjo do të shtojë përqindjen e tyre në Parti.

Së dyti, përgjegjësia e komunistëve nuk mbaron duke qenë të dalluar në punë. Drejt shikohet kjo anë, por më duket se nuk shikohet si duhet fakti që komunisti është udhëheqës i masave. Në qoftë se nuk e vlerësojmë mirë këtë, atëherë komunistët mund të burokratizohen, ata nuk e kryejnë në shkallën që kërkohet detyrën e madhe të komunistit, që jo vetëm të japin shembullin e tyre personal në punë, por të jenë frymëzuesit dhe edukuesit e masave pa parti. Ne shikojmë se ka komunistë që nuk marrin pjesë aktive në bashkimet profesionale. Jeta tregon që në qoftë se komunistët janë në rolin që u përket në gjirin e organi-

zatës profesionale, shembulli i tyre personal përpara masave është më i lartë. Inisiativa të veçanta të komunistëve për të vënë në dukje eksperiencën e mirë në punë, nuk ka. Komunistët nuk i mbledhin punëtorët në mbarim të punës për të vënë në dukje eksperiencën e mirë të punëtorëve të dalluar, pa pritur mbledhjen e përgjithshme. Nuk është e gabuar që komunisti të mbledhë një grumbull punëtorësh ose kooperativistësh për të shpërndarë eksperiencën pozitive. Prandaj më shumë iniciativa të marrin komunistët, më tepër aktivistë shoqërorë të jenë ata.

Edhe në radhët e komunistëve ka shfaqje mikro-borgjeze, të cilat duhen luftuar me një punë më të organizuar. Faktorë me rëndësi për këtë janë: përhapja e kulturës në fshat, përmirësimi i punës edukative të komunistëve etj. Çdo komitet partie në rreth çështjen e edukimit të përgjithshëm marksist-leninist, duhet ta ketë në kujdes të vazhdueshëm. Është e domosdoshme që të vendoset disiplinë e fortë në Parti për edukimin e anëtarëve të saj. Suksesi i kësaj pune varet në një shkallë të madhe edhe nga shembulli që japin vetë sekretarët e Partisë, të gjithë kuadrot dhe punëtorët e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## TA SHPIEM ME PËRPARA' PUNËN E PARTISË ME GRUAN

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

5 maj 1959

Për zhvillimin dhe përparimin e gruas te ne nuk është bërë pak. Në radhë të parë Partia ka zgjidhur drejt pjesëmarrjen e saj në punë. Të gjithë shikojmë me kënaqësi se gratë, sikurse u tha edhe këtu, punojnë e dallohen më shumë se burrat, sepse ato kryejnë edhe punët e shtëpisë. Ky është një sukses i madh, që do të sjellë edhe suksese të tjera në rrugën e emancipimit të gruas shqiptare.

Çështja e parë që dëshiroj të ngre është ajo e nevojës për ta lehtësuar më tepër punën e gruas. Nuk

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi punën e Partisë me gruan në rrethin e Gjirokastrës dhe të Burrelit», paraqitur nga Drejtoria e organeve të Partisë, të rinisë e të bashkimeve profesionale pranë aparatit të KQ të PPSH.

mund të themi se në këtë drejtim s'është ecur, por jam i mendimit që Partia të veprojë në një mënyrë më të organizuar. Pjesëmarrja në punë e gruas është faktori vendimtar për zhvillimin e saj. Por ne duhet të mendojmë për më tej, për t'i krijuar gruas si në fshat ashtu dhe në qytet kushte lehtësuese. Partia duhet të preokupohet që grave t'u sigurohet punë më e lehtë. Por kjo s'është e mjaftueshme.

Dihet se rritja e fëmijës e pengon gruan në punët prodhuese dhe shoqërore. Kjo është e natyrshme. Prandaj, për t'i ardhur asaj në ndihmë, duhen zbatuar të gjitha udhëzimet që janë dhënë nga Partia. Është fjala që në qytet të krijohen më shumë çerdhe e kopshte për fëmijë dhe të organizohet më mirë puna në to. Po të interesohen si duhet komitetet e Partisë në rrethe dhe organizatat-bazë, ka mundësi të krijohen më shumë çerdhe se sa janë sot. Kurse në fshat, më duket se mungon interesimi i duhur për të lehtësuar pjesëmarrjen e gruas në punë duke hapur çerdhe dhe kopshte. Këtë duhet ta shikojmë jo vetëm si një çështje ekonomike, por edhe si një çështje politike e humanitare, sepse krijimi i kushteve lehtësuese do ta bëjë gruan që të jetë më aktive si në punë, ashtu dhe në jetën politike e shoqërore. Nuk duhet të na çuditë fakti që ka akoma njerëz, bile edhe disa komunistë, të cilët nuk e nxjerrin gruan jashtë shtëpisë. Kjo është pasojë e asaj shtypjeje të egër që ka rënduar në shekuj mbi kurrizin e gruas, pasojë e mbeturinave të vjetra që ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve. Prandaj Partia duhet t'i qëndrojë mbi kokë këtij problemi, që gruaja

të mos jetë inferiore, por të ketë personalitetin e vet në familje, në punë e në shoqëri.

Çështja tjetër që doja të theksoja është kujdesi më i madh për të rejat. Në qoftë se duam të kemi rezultate më të mëdha në drejtim të zhvillimit të gruas, është e domosdoshme të interesohemi për të rejat, që janë nënat e nesërme. Edukimi dhe aktivizimi i tyre është një nga faktorët me rëndësi në luftë për emancipimin e gruas. Puna me të rejat duhet të ndërtohet jo vetëm në bazë të kushteve të rrethit, por edhe të lokalitetit dhe të fshatit, të zhvillohet me to një punë e gjerë dhe e diferencuar politike jo vetëm kolektive, por edhe individuale. Partia duhet të punojë që vajzat të ndjekin jo vetëm shkollën fillore, por edhe 7-vjeçaren e të mesmen.

Gjithashtu për zhvillimin e mëtejshëm politik të gruas duhet të mbështetemi më mirë te rinia, te gratë e reja. Në këtë drejtim të përdoren të gjitha format, leksionet, aktivitetet e ndryshme kulturele, artistike, konferencat e të tjera. Ngritja e tyre politike do të bëhet vetëm me një punë më të mirë nga ana e Partisë. Një punë më e organizuar edukative duhet bërë edhe me njerëzit që janë të lidhur me punën e gruas, siç janë mësuesit, mjekët, infermierët etj. Të gjithë këta të tërhiqen në veprimtarinë e organizatës së gruas, për gjallërimin e mëtejshëm të saj. Edhe në këshillat popullore numri i grave të jetë më i madh se deri tani.

Ne shqyrtoam sot në Sekretariat punën e Partisë me gruan në dy rrethe. Dihet se Gjirokastra është shumë më përpara se Burreli. Kuptohet se këtu ka më

tepër vështirësi, por edhe në Burrel sukseset, sidomos në pjesëmarrjen e gruas në punë, nuk mungojnë. Tani çështja është që ta shpiem më përpara punën e organizatës së gruas në të gjithë vendin.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## MBI DISA PROBLEME TË HISTORISË SË SHQIPËRISË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

6 maj 1959

Ne mund të themi pa u gabuar se kemi në duar për herë të parë një histori të Shqipërisë, të shkruar në dritën e marksizëm-leninizmit. Natyrisht, në maketin që është përgatitur ka edhe boshllëqe, por me diskutimet që po zhvillohen ai do të përmirësohet. Duke dalë në emrin e autorëve, edhe unë mendoj se ka mundësi që, për disa çështje, diskutimi të vazhdojë më tej.

Maketi, në përgjithësi ka gjëra shumë të mira, por ka edhe disa probleme që duhen thelluar, zgjeruar ose shkurtuar. Është mirë që Historia e Shqipërisë fillon qysh me kohën e neolitit, bronzit dhe të hekurit,

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u morën në shqyrtim disa probleme themelore që dolën nga diskutimet rreth maketit të Historisë së Shqipërisë.

duke e argumentuar me të dhënat konkrete të zbuluara në vend si edhe me ato të shkencës së përgjithshme, si një epokë që ka ekzistuar edhe në vendin tonë.

Problemi i rëndësishëm që meriton të diskutohet është ai i prejardhjes së popullit tonë. Ky problem mund të studjohet duke u nisur, e para, nga objektet arkeologjike të cilat nuk të lënë të lëvizësh dhe, e dyta, nga gjuha, e cila, megjithëse gjatë kohës pëson ndryshime, është një nga treguesit e origjinës së popujve. Pra objektet arkeologjike dhe gjuha plotësojnë njëra-tjetrën.

Çështja e popujve dhe e kulturave më të lashta, duke përfshirë edhe pellazgët, është studjuar nga historianë e dijetarë të ndryshëm, të cilët kanë pasur si qëllim të zbulojnë se si ka ardhur qytetërimi në botë. Në pikëpamjet e tyre ka rivalitete të ndryshme, duke synuar që grupe popujsh t'i vënë mbi të tjerët. Në përgjithësi ka ekzistuar pikëpamja se në zhvillimin e kulturës kanë predominuar popujt më të mëdhenj, si kinezët, indianët, gjermanët, sllavët. Helenizmin e kanë mbrojtur të gjithë, kulturën e tij e kanë nxjerrë më të vjetër dhe më të përparuar, që i ka dhënë shkëlqim botës. Në bazë të këtyre tezave, për popujt e tjerë është vënë një mur. Megjithatë, sipas atyre që njihen si shkruarit e historisë së helenizmit, ndërmjet tyre edhe Homeri, del se para helenëve kanë ekzistuar popujt të tjerë më të vjetër, një nga të cilët janë edhe pellazgët. Por ka pasur dhe ka në Greqi njerëz që kërkojnë ta çojnë prejardhjen e popullit grek më tej.

Është fakt se pellazgët kanë ekzistuar, por asnjëri nuk është thelluar në këtë çështje nga pikëpamja ar-

keologjike dhe e gjuhës. Patriotët e shkrimtarët tanë si Naimi, disa historianë gjermanë etj. kanë thënë se populli ynë vjen nga pellazgët, po dokumente të nevojshme që të vërtetojnë këtë prejardhje, akoma nuk ka. Mendimet e historianëve gjermanë mund t'i quajmë progresiste përse i përket prejardhjes sonë nga pellazgët. Dihet se ata nuk e kanë bërë këtë vetëm për popullin shqiptar, por edhe për popujt e tjerë të vegjël si bullgarët etj. Me sa kam lexuar unë, shumë teza të tyre kanë dashur t'i hedhin poshtë, ndërsa ne, duke u nisur nga marksizëm-leninizmi, nuk mund të hedhim poshtë njerëz shumë të mësuar, idetë e të cilëve janë progresive. Ka edhe gjermanë të tjerë, tezat e të cilëve janë teza raciste, sepse ata e paraqitin popullin gjerman si një popull të vjetër e superior, tezë kjo që e ka rrënjën thellë, te konti francez Gobino<sup>1</sup>. Por te konti Gobino është edhe teza mbi ilirët. Ai flet se ky është një popull i mirë, heroik, luftarak etj., dhe se te ata është origjina jonë. Ne nuk e shtrojmë çështjen nga ana nacionaliste e të themi se kemi qenë më të kulturuarit në botë, ose më të kulturuar se helenët, por themi se tjetër është kultura dhe tjetër është lashësia e një populli.

Konda<sup>2</sup> na ka dërguar artikullin e një shkrimtari grek që thotë se pellazgët kanë ndihmuar në zhvillimin e kulturës helenike etj. Këtë dhe faktin që pellazgët

---

<sup>1</sup> Zhozef Artur Gobino (1816-1882), sociolog ekstremist reaktionar francez, një nga themeluesit e teorisë raciste të urrejtjes ndaj njeriut.

<sup>2</sup> Prof. Spiro Konda.

janë paraardhësit e shqiptarëve, shokët tanë është e zorshme t'i hedhin poshtë, duke paraqitur si argument vetëm se këto i kanë thënë edhe të tjerë. Ne nuk themi që Konda është origjinal por nuk jemi të mendimit që këto të hidhen poshtë.

Përsa i përket qytetërimit ilir ne kemi fakte dhe të tjera do të zbulojmë më vonë. Në vendin tonë janë bërë disa zbulime nga italianët dhe francezët. Ata janë nisur për të vërtetuar kulturën helenike, që në fakt ka ekzistuar, por kanë ekzistuar edhe kultura të tjera, për të cilat ata nuk janë orientuar. Ne do t'i vazhdojmë zbulimet, se këto kanë rëndësi të madhe si për popullin tonë, ashtu dhe për historinë e përgjithshme. Në këtë kuadër ne do të zbulojmë edhe se kur kanë jetuar ilirët në vendin tonë.

Tezën se ne vijmë nga pellazgët nuk duhet ta hedhim, por ta studjojmë më tej. Detyra e historianëve tanë është që të gjejnë lidhjet dhe zhvillimin e mëtejshëm të pellazgëve me ilirët. Tani nuk shtrohet si më parë çështja e ekzistencës së popullit shqiptar si komb, por problemi i prejardhjes duhet të zgjidhet shkencërisht, pra tezat që ngrihen të shpjegohen me dokumente. Ne nuk jemi specialistë, por mendime mund të shfaqim. Prandaj unë do të propozoja që teza se ne vijmë nga pellazgët, duhet të studjohet e të argumentohet, sepse ky problem nuk është zgjidhur përfundimisht, ndërsa çështja e ilirëve, si stërgjyshër të popullit shqiptar, është e provuar; megjithëkëtë, lidhja midis tyre, midis pellazgëve e ilirëve, mbetet për t'u vërtetuar.



Përsa i përket çështjes së Skënderbeut më duket se kjo duhet të dalë më mirë dhe të zhvillohet më gjerë nga ana shkencore, sepse ka rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare, për arsye se në mesjetë, në vendin tonë të vogël, filloi të ecet drejt krijimit të pushtetit të centralizuar, gjë që ka rëndësi të madhe historike. Periudha e Skënderbeut është mjaft progresive si për mbrojtjen e pavarësisë ashtu edhe për krijimin e pushtetit qendror me mbret. Dihet se kjo nuk u arrit plotësisht, sepse në atë kohë nuk pati akoma një organizim qendror, siç ndodhi më vonë. Por çështjen e mbrojtjes Skënderbeu nuk e shkëputi nga politika e jashtme dhe e brendshme dhe ata që nuk i bindeshin, i përjashtonte nga Lidhja. Për atë kohë rëndësi të madhe ka gjithashtu edhe çështja e zhvillimit ekonomik e shoqëror. Mirëpo kjo nuk pasqyrohet si duhet në maket, këtu bëhet mjaft fjalë për periudhën e broncit etj., por nuk flitet si jetonte populli ynë në këtë periudhë. Ndoshta ky boshllëk vjen për arsye se ne s'kemi në duar shumë dokumente të Stambollit.

Pas luftës së Skënderbeut duhet të dalin momentet e luftës së popullit shqiptar për pavarësinë gjer në kohën e sotme. Të dalë mirë se edhe pas pushtimit turk Shqipëria ka vazhduar të luftojë dhe asnjëherë nuk është përkulur.

Lidhur me çështjen e Epirit jam dakord me pikëpamjen që shprehet në maket, ndërsa çështja e pasqyrimin të historisë së Kosovës pas 1912-s meriton një studim të veçantë.

Këtu u diskutua edhe për Haxhi Qamilin. Që ta gjykojmë drejt këtë çështje, duhet të nisemi në radhë të parë nga faktet, ndërsa nga gojëdhënat duhet të ruhemi shumë. Është e vërtetë se në lëvizjen fshatare të vjetëve 1914-1915 ka pasur gabime, por kjo nuk e errëson atë.

Kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme, sipas mendimit tim, ka një bazë të drejtë shoqërore dhe ekonomike. Fshatarët e Shqipërisë së Mesme u ngritën në këmbë me një qëllim të caktuar: të luftojnë kundër bejlerëve dhe feudalëve për të marrë tokën. Veç kësaj, kjo kryengritje fshatare u zhvillua edhe politikisht. Përsa i përket çështjes së aleancave me forca të tjera, orientimi politik i kryengritjes shprehte aspiratat e veçjëlisë, e cila mendonte se ky u përgjigjej më mirë se orientimi i borgjezisë patriotë. Edhe karakterin social e agrar të lëvizjes nuk mund ta mohojmë. Nuk mund të mohohet gjithashtu që kryengritja fshatare është drejtuar edhe kundër Esat Pashës, Princ Vidit dhe serbëve. Si mund ta ngresh popullin pa pasur një qëllim? Kjo lëvizje kishte karakter socialo-agrar dhe pjesëmarrësit e saj kanë luftuar me armë në dorë kundër përfaqësuesve imperialistë.

Kur u ngrit flamuri në Vlorë më 1912 ne nuk konsatojmë që fshatarësia e Shqipërisë së Mesme të ishte kundër shpalljes së pavarësisë. Ky eveniment ishte rasti më i rrezikshëm për Perandorinë Otomane. Unë nuk mund të bindem që fshatarësia e Shqipërisë së Mesme pas 500 vjetësh lufte për çlirim të dalë që është me turkun.

Disa ngrënë tezën në se ishte e drejtë që kryengritja të deklarohet kundër Princ Vidit, kur të gjithë patriotët ishin pro këtij, se Shqipëria filloi të konsolidohej si shtet. Kjo çështje varet si ta kuptosh. Si do të ishin fshatarët me Qeverinë e Durrësit, në radhët e së cilës ishin futur të gjithë feudalët e bejlerët që nga Eqrem Libohova? Si mund të ishin ata me këtë qeveri, e cila qe bërë një mbështetje e fortë e feudalëve? Është e qartë se kundër Qeverisë së Vlorës fshatarët nuk u ngritën. Çështja e flamurit dhe e gjuhës së një kombi ka rëndësi të madhe. Po a kishte lëvizja fshatare e Haxhi Qamilit një organizim të përsosur në çështjen e aleancave? Jo, nuk kishte. Në lëvizjen fshatare të Shqipërisë së Mesme, që ishte një forcë e madhe revolucionare, sipas mendimit tim, elementët xhonturq u përpoqën të futen dhe të luajnë rolin kryesor në orientimin e drejtimin e kësaj lëvizjeje. Megjithatë ata nuk mundën të çonin orientimin kryesor klasor të lëvizjes.

Lëvizja fshatare nuk e humbi perspektivën e luftës kundër bejlerëve dhe përkrahësve imperialistë të regjimit të Vidit. Ajo ishte për t'i dhënë tokën fshatarësisë, pra kishte një karakter agraro-revolucionar dhe joreaksonar. Megjithëkëtë nuk mund të themi se ajo s'ka pasur të meta. Të metat në histori mund të vihen, se nuk ka lëvizje fshatare pa të meta. Edhe koka janë prerë, por kjo nuk mund të errësojë lëvizjen dhe karakterin e saj shoqëror dhe agrar. Qëllimet e kësaj lëvizjeje kanë qenë të drejta. Sa për organizimin e këshillave për mbledhjen e taksave dhe furnizimin e ushtrisë, këto janë mjaft përparimtare. Duke e vlerësuar në këtë

mënyrë lëvizjen nuk do të thotë se ajo ngrihet në nivelin e luftës nacionalçlirimtare, puna është që të gjykohet drejt, me të mirat dhe të metat e saja. Prej asaj kohe kanë kaluar 45 vjet prandaj çështja duhet gjykuar për atë moment.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**MBI DISA ANKESA PËR TË MOS U LARGUAR NGA  
QYTETI NË FSHAT DHE KËRKESA PËR T'U  
LARGUAR NGA FSHATI NË QYTET**

*Letër komiteteve të Partisë në rrethe*

**16 maj 1959**

Kohët e fundit i janë drejtuar me letra Komitetit Qendror anëtarë partie dhe njerëz pa parti, të cilët ankohen se po i largojnë nga qendrat e punës duke i dërguar në kooperativat bujqësore, ose nuk i lejojnë të largohen përkohësisht nga kooperativat bujqësore për të punuar në qendra pune, pasi me të ardhurat që marrin nga kooperativa nuk i plotësojnë nevojat ekonomike. Të tilla ankesa janë drejtuar nga rrethi i Fierit, i Beratit, i Kolonjës, i Tiranës, i Përmetit etj.

Komitetet e Partisë, të mbështetur në udhëzimet e Komitetit Qendror, kanë bërë një punë të mirë lidhur me forcimin e punës së Partisë dhe të drejtimit të kooperativave bujqësore, duke dërguar kuadro e shokë të tjerë në fshat. Kjo ka ndihmuar edhe në forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore.

Por, lidhur me këtë problem, vihet re se në disa

raste dërgimi i njerëzve në fshat nuk bëhet ashtu siç ka porositur Partia, duke i bindur dhe duke i sqaruar ata, por përdoren masa administrative, ndërhyhet nëpër ndërmarrjet e ndryshme për pushimin e tyre nga puna etj. Midis atyre që dërgohen në kooperativat bujqësore, si punonjës të thjeshtë, ka të tillë që kanë disa vjet që punojnë si punëtorë apo zanatçinj në ndërmarrje të ndryshme, në qytet ku janë vendosur me gjithë familje. I tillë është rasti i një kandidati partie i cili ka disa vjet që është larguar nga fshati, është vendosur në qytetin e Fierit me gjithë familjen, punon si marangoz dhe komiteti i Partisë i rrethit vendosi ta dërgonte në fshat. Ose si rasti i një ish-oficeri i cili punonte në zdrukthëtarinë «Misto Mame», në Tiranë, dhe u pushua nga puna me qëllim që të shkonte në kooperativën bujqësore të fshatit Yzberish, ku qëndrojnë vëllezërit e tij, megjithëse ky vetë nuk është anëtar i kooperativës.

Është e kuptueshme që veprime të tilla, të pastuajuara mirë dhe të nxituara nuk janë të drejta. Për dërgimin në kooperativat bujqësore, si punonjës të thjeshtë, duhet të mos synohet në njerëz të cilët kanë një kohë të gjatë që janë larguar nga punët e bujqësisë; janë bërë punëtorë ose zanatçinj në qytet dhe nuk dëshirojnë të kthehen përsëri në fshat, sepse puna e tyre nuk do të jepte frytet e duhura; në raste të tilla do të shkakttoheshin pakënaqësi. Prandaj të punohet për të dërguar në fshat ata që kanë dëshirë, t'u flitet për nevojën që ka fshati për forca pune dhe për të mirat që do të kenë në fshat. Por edhe në këto raste të mos përdoren masa administrative të çfarëdo forme qofshin

këto, por njerëzit të binden me arsye dhe të jenë të ndërgjegjshëm për vajtjen e tyre në fshat.

Gjithashtu ka raste që anëtarë të kooperativave bujqësore, për arsye se me të ardhurat që sigurojnë nga kooperativat bujqësore nuk plotësojnë nevojat, kërkojnë të largohen nga fshati dhe të vendosen me punë në ndërmarrje qoftë edhe për disa muaj. Komitetet e Partisë, në vend që të bëjnë një punë sqaruese e bindëse, në vend që të marrin masa për forcimin ekonomik të kooperativave dhe t'u hapin perspektiva fshatarëve, marrin masa të ndryshme administrative, duke mos u dhënë shpërnguljen apo lidhjen e Partisë, duke u marrë oborrit kooperativist etj. Kështu p.sh. është vepruar nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Kolonjës kundrejt një anëtari të kooperativës së Selenicës, duke i marrë gjysmën e oborrit kooperativist për arsye se i biri i tij u largua nga kooperativa dhe shkoi në minierën e Kurbneshit. Komiteti i Partisë i Rrethit të Përmetit, ndalon një anëtar partie nga fshati Kakos që të shkojë si punëtor në ndonjë ndërmarrje për arsye se me të ardhurat e kooperativës nuk plotëson nevojat, ose nuk lejon një tjetër anëtar partie që të punojë për disa muaj në kantierin për ndërtimin e fabrikës së rrushit etj.

Për të mënjeluar largimin e fshatarëve nga kooperativat bujqësore në radhë të parë, duhet të merren masa për forcimin ekonomik të kooperativistëve, në mënyrë që ata të sigurojnë mjetet e nevojshme të jetesës. Megjithatë, largime nga fshati mund të ketë dhe do të ketë, pse vetë zhvillimi i industrisë në vendin tonë kërkon fuqi punëtore, burimi i së cilës është edhe

fshati, por kjo punë nuk duhet t'i lihet spontaneitetit po të bëhet e organizuar. Komitetet ekzekutive të rretheve, duke pasur parasysh planin e fuqisë punëtore, duhet t'u caktojnë kooperativave bujqësore numrin e punëtorëve që duhet të nxjerrin ato, dhe, duke marrë parasysh gjendjen e anëtarëve, të caktojnë ata që duhet të shkojnë si punëtorë qoftë edhe për disa muaj.

Prandaj t'i keni parasysh këto çështje, në mënyrë që të mos ndodhin më veprime të tilla, të cilat nuk janë të drejta dhe shkaktajnë pakënaqësi në njerëzit. Këtyre veprimeve Partia në rreth dhe në bazë, me një punë bindëse, kur paraqitet rasti, duhet t'ua presë rrugën dhe të mos i nënvleftësojë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## MBI DISA ÇËSHTJE TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE

*Letër komiteteve të Partisë në rrethe*

18 maj 1959

### KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, e mbështetur në raportin vjetor përmbledhës, analizoi disa çështje të aktivitetit të kooperativave bujqësore për vitin 1958 dhe konstatoi sukseset e mëdha që janë arritur në fushën e kolektivizimit të bujqësisë. Kështu p.sh. kolektivizimi i bujqësisë tani përfshin më se 76 për qind të tokës në pronësi të fshatarësisë, nga 58,1 për qind që ishte në fund të vitit 1957 dhe më se 63 për qind të ekonomive fshatare; nga 46,4 për qind që ishte një vit më parë. Kolektivizimi ka përfunduar në rrethet Gjirokastrë, Lushnjë, Vlorë, Sarandë, Berat, Korçë, Tepelenë, ku kooperativat përfshijnë mbi 80 për qind të sipërfaqes së tokës arë që disponon fshatarësia. Përparime të mëdha kanë bërë muajt e fundit edhe rrethet Peshkopi

e Kukës, ku është kolektivizuar 86-89 për qind e tokës në zonat fushore, ndërsa në Lezhë kolektivizimi i zonës fushore përfundoi në tërësi dhe mesatarisht si rreth është 80 për qind me ekonomitë dhe 88 për qind me tokën.

Gjatë vitit 1958 fondi i pandashëm i kooperativave bujqësore është shtuar 65 për qind. Kooperativat kanë mbjellë me mijëra pemë frutore, kanë shtuar numrin e gjësë së gjallë dhe sidomos të lopëve, kanë bërë një sërë ndërtimesh, kanë shtuar inventarin e tyre e të tjera. Edhe në kushte jo të favorshme, gjatë vitit 1958, kooperativat në përgjithësi kanë marrë rendimente më të larta se ekonomitë individuale.

Por, me gjithë rezultatet e arritura, Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë konstaton se në kooperativat bujqësore ka akoma mjaft të meta, të cilat pengojnë forcimin e mëtejshëm ekonomiko-organizativ të tyre. Të tilla janë p.sh. pjesëmarrja e paktë e anëtarëve në punë, mosshfrytëzimi i plotë i rezervave të brendshme, zhvillimi i njëanshëm i ekonomisë kooperativiste (janë pak të zhvilluara sidomos blegtoria dhe frutikultura), organizimi i dobët i punës. Në kooperativat bujqësore vihen re akoma shkelje të statutit, nuk zbatohen me kujdes rregullat agroteknike dhe zooveterinare, ka ngatërresa në planet, lëvizje të tepërta kuadri etj. Si pasojë e të gjitha këtyre, shpërblimi i punës në disa kooperativa është akoma i vogël ose shumë i vogël, gjë që nuk i lidh aq sa duhet kooperativistët me ekonominë e përbashkët. Organizatat-bazë në shumë raste janë mjaft të dobëta dhe nuk e luajnë rolin që u ka caktuar Partia. Komitetet e Partisë

dhe komitetet ekzekutive të rretheve nuk u japin kooperative bujqësore një ndihmë konkrete për mënjanimin e të metave që përmenden më lart, por shpeshherë kufizohen me udhëzime e fjalë të përgjithshme.

Lidhur me sa u tha më sipër, Byroja Politike u tërheq vëmendjen komiteteve të Partisë dhe organizatave-bazë të Partisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe komiteteve ekzekutive të rretheve mbi disa nga problemet më të rëndësishme:

1. — *Mbi pjesëmarrjen në punë.* Raporti përmbledhës i kooperativave bujqësore për vitin 1958 tregon se pjesëmarrja në punë, në shumicën dërrmuese të kooperativave bujqësore, është akoma e vogël.

Gjatë vitit 1958 kanë marrë pjesë në punët e kooperativave vetëm 92,4 për qind e njerëzve të aftë për punë, (4,4 për qind e burrave dhe 11 për qind e grave të afta për punë nuk kanë bërë asnjë ditë-punë). Por edhe ata që kanë punuar, kanë bërë shumë pak ditë-punë (mesatarisht 150 ditë-punë për çdo njeri të aftë). Shumë kooperativistë në gjendje pune nuk kanë plotësuar as minimumin e detyrueshëm të ditëve të punës (24 për qind e burrave dhe 32 për qind e grave). Mjaft rrethe, si Burreli, Peshkopia, Tropoja, Puka, Lezha, Durrësi, Pogradeci etj.; i kanë treguesit e pjesëmarrjes në punë, nën mesataren e Republikës.

Shumë e theksuar është puna e paktë që bëhet gjatë muajve të dimrit. Kështu p.sh. gjatë muajve dhjetor e janar punojnë vetëm 50 për qind e njerëzve të aftë për punë, ndërsa në shkurt e në mars 55-60 për qind dhe në muajt më të ngarkuar, siç janë maji, qer-

shori dhe korriku, kanë punuar vetëm 80-85 për qind e njerëzve të aftë për punë.

Shtimi i pjesëmarrjes së kooperativistëve në punët e përbashkëta është një çështje shumë e rëndësishme, nga e cila sot varet shumë forcimi ekonomik i kooperativës. Në kushtet e vendit tonë, mund të punohet gati gjatë gjithë vitit, me ndërprerje të vogla vetëm gjatë shirave. Detyra e shokëve në rrethe dhe në kooperativa është që vazhdimisht të hapin fronte pune, jo vetëm për kultivimin gjithnjë më intensiv të drithërave, bimëve industriale, foragjereve etj., por edhe për hapjen e tokave të reja, krijimin e vreshtave, ullishtave, pemishteve, për kryerjen e punëve në bonifikime, ndërtime etj.

Është për t'u theksuar se pjesëmarrja e gjerë në punë disa herë pengohet nga pikëpamje të gabuara, se gjoja me shtimin e ditëve të punës ulet vlera e tyre etj. Kjo nuk është gjë tjetër veçse keqkuptim ose orvatje për të justifikuar dembelizmin që konstatohet në disa vende. Puna është burimi i të gjitha të mirave për njeriun, prandaj duhet shtuar sa më shumë pjesëmarrja në punë. Në rrethe duhen marrë edhe disa masa për të nxitur, në bazë të leverdisë ekonomike, pjesëmarrjen e kooperativistëve në punët e përbashkëta. Lidhur me këtë, anëtarëve duhet t'u jepen sa më shpesh paradhënie, sipas rregullave të caktuara për këtë qëllim. Bashkë me këtë të gjenden edhe forma të tjera të përshtatshme për të rritur sa më shumë interesin material të kooperativistëve lidhur me pjesëmarrjen e tyre në punë. Kuptohet se për ta bërë sa më të madh interesin material të kooperativistëve duhet para së gjithash

që, me punën e anëtarëve, të forcohet ekonomia e përbashkët e kooperativës, të rritet ndërgjegjja socialiste e anëtarëve të saj, të forcohet organizimi. Në mënyrë të veçantë për gratë, duhen marrë disa masa lehtësuese, për të cilat Partia vazhdimisht ka folur, siç janë p.sh. krijimi i kopshteve dhe i çerdheve (qoftë edhe provizore, në formën e shesheve për ruajtjen dhe dëfrimin e fëmijëve në kohën e fushatave më të rëndësishme), organizimi i furrave kolektive etj.

Një punë e veçantë duhet bërë me ata anëtarë të kooperativës, të cilët, për një arsye ose një tjetër, kërkojnë të shkojnë në punë të ndryshme me mëditje. Kjo nuk mund të ndalohej me masa administrative, siç janë përpjekur të bëjnë disa rrethe. Për këtë kategori anëtarësh duhet menduar në mënyrë të veçantë, duke i caktuar në punë të kooperativës, ku të marrin pardhënie sa më të shpeshta ose të dërgohen të organizuar në punë me mëditje, në bazë të marrëveshjeve paraprake midis kooperativës dhe ndërmarrjeve të interesuara. Byrotë e komiteteve të Partisë në rrethe, së bashku me organet e pushtetit dhe vetë kooperativat, duhet të punojnë seriozisht në këtë drejtim dhe të mos kufizohen me fjalë të përgjithshme, por të marrin masa konkrete për hapjen e fronteve të punës dhe rritjen e interesit material të kooperativistëve që këta të punojnë sa më shumë. Janë të gjitha mundësitë që në vendin tonë të gjithë burrat e aftë për punë të bëjnë jo më pak se 250 ditë-punë, ndërsa gratë jo më pak se 180 ditë-punë mesatarisht në vit.

Për të shtuar pjesëmarrjen e rregullt të anëtarëve në punët e përbashkëta, të përhapet kudo eksperiencia

e kooperativës së bashkuar të Yzberishit, Mëzezit dhe e Yrshekut në rrethin e Tiranës. Këtu më parë njerëzit nuk dilnin në punë rregullisht. Për këtë qëllim u morën disa masa. Kështu minimumi vjetor i ditëve të punës u nda sipas muajve dhe atyre që e realizojnë këtë u jepet paradhënie mujore në të holla. Tani rrallë largohen njerëzit në pazar gjatë kohës së punës.

Në disa lokalitete të rrethit të Lushnjës mbledhen të dhënat mbi pjesëmarrjen e anëtarëve në punë, studjohen me kujdes nga instruktori i zonës së bashku me kryetarin e lokalitetit çdo 10 ditë dhe ndërhyjnë në rastet e nevojshme. Po të bëhet kudo një gjë e tillë, patjetër që edhe rezultatet do të jenë të mira.

Në disa kooperativa kanë filluar t'u zvogëlojnë oborret kooperativiste atyre kooperativistëve që nuk marrin pjesë në punë prej shumë kohësh dhe që vazhdimisht nuk plotësojnë minimumin e detyrueshëm të ditëve të punës. Edhe kjo është një masë e drejtë, por duhet bërë me kujdes dhe në mënyrë të matur, pasi të paralajmërohen disa herë të interesuarit dhe me vendim të mbledhjes së përgjithshme.

Natyrisht problemi i pjesëmarrjes në punë nuk mund të zgjidhet vetëm me masa administrative. Kryesorja është hapja e fronteve të reja të punës, krijimi i kushteve dhe rritja e interesit material të anëtarëve.

2. — *Mbi forcimin organizativ dhe ekonomik të kooperativave.* Nuk ka dyshim se në këtë drejtim ka përmirësime të mëdha dhe suksese të dukshme. Kooperativat në tërësi i kanë shtuar sipërfaqet, rendimentet dhe prodhimin, kanë shtuar të ardhurat, kanë bërë mjaft investime dhe e kanë shtuar në mënyrë të ndieshme

përqindjen e prodhimit për treg. Në krahasim me vitin 1957, më 1958, megjithëse kushtet atmosferike ishin më të këqija, kooperativat në tërësi inkasuan mesatarisht 11 000 lekë më shumë për çdo 100 ha tokë bujqësore. Por megjithëkëtë, në kooperativat bujqësore ka akoma dobësi të theksuara të cilat e pengojnë zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Të ardhurat e kooperativave janë akoma të vogla, për arsye se nuk shfrytëzohen mirë të gjitha rezervat e brendshme. Kështu p.sh. vitin e kaluar për çdo 100 ha u prodhuan mesatarisht 458 kv drithëra buke, — 16 kv mish (peshë e therur) dhe 44 kv qumësht, ndërsa vlera globale e prodhimit bujqësor ishte pak më shumë se 2,2 milion lekë për çdo 100 ha. Kjo është shumë pak. Studimet konkrete që u bënë në verën e vitit 1957, në të gjitha rrethet, treguan se edhe kooperativat malore më të dobëta mund të prodhojnë disa herë më shumë se mesatarja e arritur vitin e kaluar dhe të marrin rreth 4-5 milion lekë për çdo 100 ha tokë bujqësore. Me sa duket, këto studime nuk po mbahen parasysh, prandaj porositim shokët që në hartimin e planeve vjetore të mbështeten në planet pesëvjeçare mbi shfrytëzimin e rezervave të brendshme dhe në asnjë mënyrë të mos i hedhin mënjanë ato.

Me gjithë sukseset, kooperativat sigurojnë akoma shumë pak të ardhura nga blegtorja dhe frutikultura. Ne duhet t'i zhvillojmë shumë këto degë dhe shpejt, me qëllim që të ndryshojë gjendja ekonomike e kooperativës. Më shumë kujdes duhet treguar edhe për aktivitetet ndihmëse, të cilat gjithashtu mund t'u sigurojnë kooperativave shumë më tepër të ardhura. Duke zhvilluar

degët e ndryshme të ekonomisë, kooperativat do të sigurojnë të ardhura në të holla gjatë gjithë vitit dhe kështu do të jenë në gjendje të japin shpesh paradhënie në të holla.

Duhet përmirësuar drejtimi i kooperativave bujqësore nga ana e komiteteve ekzekutive të rretheve. Në vërejmë se akoma në shumë raste, kuadrot drejtues të Partisë dhe të pushtetit në rrethe mjaftohen me udhëzime të përgjithshme mbi nevojën e forcimit organizativ dhe ekonomik të kooperativave. Disa herë në vend që t'i ndihmojnë, i pengojnë kooperativat, duke u dërguar plan pas plani. Në fakt, akoma në shumë kooperativa, detyrat e planit nuk janë stabilizuar, sepse korrigjimet që kanë bërë rrethet, me rastin e aprovimit të planeve vjetore, nuk u janë shpjeguar kooperativave; por kanë mbetur në letër. Nga kjo, edhe zotimet e disa kooperativave për vitin 1959, janë formale. Disa kuadro nuk i njohin akoma planet dhe zotimet e tyre. Kuptohet se në këtë mënyrë nuk mund të drejtohet. Prandaj sa më parë duhen vënë në rregull këto plane.

Një kujdes më i madh të tregohet për njohjen dhe zbatimin e vendimit Nr. 265 të Këshillit të Ministrave mbi organizimin dhe shpërblimin e punës në kooperativat bujqësore, sepse në mjaft raste vërejmë të meta të mëdha në këtë drejtim. Sidomos të tregohet kujdes për të mos lëvizur forcat nga një brigadë në tjetrën, të bëhet planifikimi i brendshëm në brigada, skuadra e ferma, si dhe të mbahet në rregull libri i ditëve të punës sipas kulturave.

3. — *Mbi disa çështje të kuadrit.* Me kujdesin e vazhdueshëm që është treguar për kuadrin, nëpërmjet



shkollave dhe kurseve, është përgatitur një numër i konsiderueshëm kooperativistësh. Mjafton të themi se në shkollën e kuadrove drejtues të kooperativave bujqësore kanë mbaruar 830 vetë për kryetarë kooperativash dhe 1 100 për llogaritarë, ndërsa në kurse kanë mësuar 500 brigadierë dhe 340 përgjegjës të fermave blegtorale. Nga kurset një dhe tremujore që janë organizuar në rrethe kanë kaluar 110 kryetarë, 240 llogaritarë, 730 brigadierë arash, 220 brigadierë blegtorie.

Megjithëkëtë në çështjen e kuadrit kemi dobësi dhe boshllëqe të mëdha. Ne sot nuk i kemi në krye të detyrës të gjithë këta kuadro që janë përgatitur nëpër kurse. Nga 1 872 kooperativat që dhanë raport sivjet, vetëm 353 kryetarë dhe 346 llogaritarë kanë bërë shkollën e kuadrove drejtues të kooperativave bujqësore. Pjesa tjetër, me sa duket, ka kaluar në punë të tjera. Në këtë mënyrë bëhen shpenzime të mëdha dhe plani i përgatitjes së kuadrit nuk realizohet. Kjo vjen sepse komitetet e Partisë në rrethe shumë pak kujdesen për njerëzit që dërgohen nëpër kurse, nuk zgjidhen ata më të mirët dhe me perspektivë. Veç kësaj, kuadri lëviz shpesh në mënyrë të pajustificueshme. Si mund të shpjegohet ndryshe fakti që gjatë vitit 1958 u lëvizën nga vendi 200 kryetarë, 170 llogaritarë dhe më se 420 brigadierë?

Si rezultat del e nevojshme që komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive si dhe organizatat-bazë të Partisë, të punojnë vazhdimisht për zhdukjen e tarafllëqeve, ambicieve e të tjera, që janë shkaqet kryesore për lëvizjen e panevojshme të kuadrit. Vazhdimisht t'i kushtohet kujdes zgjedhjes së kuadrit që dërgohet në

shkollat dhe kurset, duke zgjedhur njerëz të aftë dhe me perspektivë. Veç këtyre, organizatat-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore të tregojnë më tepër kujdes për dërgimin e elementëve të ndryshëm në shkollat shtetërore, për të pregatitur specialistë të ndryshëm me bursën e vetë kooperativave bujqësore.

Çështjet që ngrihen më lart, të shtrohen në një mbledhje të zgjeruar të byrosë, në plenum ose në aktiv, në bazë rrethi apo zone, sipas rastit, brenda muajit qershor 1959, ku, pas një shqyrtimi të imtë të çështjeve që ngrihen në këtë letër, të dilet me masa konkrete për çdo kooperativë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH është e bindur se, duke mobilizuar gjithë Partinë dhe organet shtetërore, të metat e konstatuara më lart do të zhduken dhe puna për forcimin organizativo-ekonomik të kooperativave, krahas me detyrën për përfundimin e kolektivizimit në të gjitha zonat fushore, do të plotësohet me nder dhe para afatit të caktuar nga Kongresi III i PPSH.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## FLOTA LUFTARAKO-DETARE DHE AVIACIONI — DY ARMË TË FUQISHME PËR MBROJTJEN E ATDHEUT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

11 qershor 1959

Partia dhe pushteti popullor kanë shpresa të mëdha dhe besim politik te luftëtarët e armëve të flotës detare dhe të aviacionit. Këto janë armë të reja dhe kanë perspektivë forcimi e zhvillimi të mëtejshëm, sepse ekziston rreziku i luftës nga ana e borgjezisë imperialiste. Por edhe kur të zhduket mundësia e luftës, kur imperializmi të jetë varrosur një herë e përgjithmonë; kuadrot e këtyre armëve do t'i shërbejnë ndërtimit të socializmit, sepse sektori i marinës tregtare dhe aviacioni civil në të ardhshmen do të marrin një zhvillim mjaft të gjerë. Sot, këto janë dy armë të fuqishme për mbrojtjen e atdheut.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën politike të Partisë në flotën luftarako-detare dhe në repartet e aviacionit.

Ne mund të themi fjalë të mira për punën që zhvillohet në këto armë. Kuadrot dhe njerëzit e tyre janë me partishmëri, patriotë dhe të vendosur për çështjen e Partisë. Natyrisht, puna e mirë varet shumë nga përbërja dhe veprimtaria e kuadrit. Nga ana teknike, mund të themi se ju, shokë të flotës detare dhe të aviacionit, i dini të gjitha, sepse jeni të zanatit, por sidoqoftë duhen bërë vazhdimisht përpjekje të mëdha për të zotëruar gjithnjë e më shumë armët tuaja të rëndësishme.

Disa dobësi personale te ndonjë shok i marinës dhe i aviacionit duhet të luftohen e të zhduken me punën edukative të Partisë. Shokët e Partisë të këtyre reparteve është e nevojshme të kenë parasysh ndryshimin që ka puna e tyre nga repartet e këmbësorisë dhe të armëve të tjera, sepse vështirësitë janë më të mëdha dhe kushtet janë më të ndryshme. Prandaj durimi i kuadrove tanë që punojnë në flotën detare e në aviacion duhet të jetë më i madh, kujdesi për njeriun të mos mungojë asnjëherë.

Të marrim marinën. Këtu njerëzit vijnë në det për herë të parë nga malet, nga fushat dhe fabrikat. Kjo është arsyeja që ndonjëherë disa edhe mërzhiten. Unë kam bindjen se ndonjë shok që këtu u kritikua do të ndreqet, prandaj njerëzit e Partisë të vazhdojnë punën e tyre pa humbur besimin dhe durimin. Edhe njerëzit e këtyre armëve vetëm Partia është ajo që mund dhe duhet t'i edukojë. Kuadrot i kemi të mirë, oficerët dhe të gjithë efektivin, por Partia mund t'i kalitë edhe më shumë dhe secili të ndjejë përgjegjësinë e lartë për detyrat e mëdha që ka.

Unë do t'u rekomandoja shokëve të Partisë dhe të komandës në këto armë që të jenë më të pjekur ndaj atyre që bëjnë gabime, të tregohen më të matur me ta. Natyrisht të gjithë kuadrot duhen edukuar me disiplinë ushtarake, por, për t'ia arritur asaj, drejtuesit e tyre të mos jenë gjaknxehëtë, po t'i matin fjalët dhe gjestet e tyre. Disiplina ushtarake ka ligjet e veta. Për edukimin e njerëzve me këtë disiplinë nuk është nevoja të bërtasësh, ose për çdo gjë ta çosh tjetrin në arrest. Metoda kryesore e Partisë ka qenë dhe është bindja. Kjo s'do të thotë që të mos përdoret detyrimi dhe arresti atëherë dhe atje ku duhet. Por në çdo rast duhet kuptuar gjendja shpirtërore e kuadrove dhe të dëgjohet zëri i tyre, sepse janë kuadro që i ka pregatitur Partia. Në marinën luftarake dhe në armën e aviacionit njerëzit duhet të jenë krenarë dhe të guximshëm, por t'i bëjmë të kuptojnë se çdo gabim, sado i vogël që të jetë, e dëmton shumë shtetin tonë.

Drejtoria politike duhet të kujdeset më tepër për jetën kulturale në këto reparte, jo aq sepse ndodhemi në kushte të vështira, por sepse edhe kuadrot e tyre janë të kulturuar dhe kanë kërkesa. Prandaj në këto armë duhet të bëhet një punë më e kulturuar se në repartet e tjera. Klubi në Qytetin «Stalin» duhet të hapet dhe të mos bëhet më gabim duke e mbyllur, siç ka ndodhur. Në këto reparte duhet të shfaqen herë pas here filma, të ketë biblioteka, salla pushimi etj. Mund të dërgohen edhe artistë nga Tirana për të dhënë shfaqje.

Të tjera porosi nuk kemi çfarë t'u japim. I urojmë suksese më të mëdha në punë efektivit të këtyre dy armëve, të cilat, me siguri në të ardhshmen, do të zgjerohen e do të forcohen edhe më tepër!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## ME SHUMË FORMA PËR ZHVILLIMIN E EMULACIONIT SOCIALIST

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

11 qershor 1959

Nga kjo mbledhje shokët sekretarë<sup>2</sup> duhet të përfitojnë nga eksperiencia e Komitetit të Partisë të Qytetit të Tiranës, lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të emulacionit socialist. Po të donj më shumë hollësi mund të bisedoni me shokun Rrapo<sup>3</sup> dhe shokët e tjerë të Tiranës.

Për emulacionin socialist mund të përdoren shumë forma duke filluar nga gjërat më të vogla, siç janë dhënia e flamujve dhe festimi i ditëlindjes së punëtorëve

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa masa për përmirësimin e punës në drejtim të garave socialiste për nder të 15-vjetorit të Çlirimit.

<sup>2</sup> U drojtohet sekretarëve të komiteteve të Partisë të rretheve Elbasan, Tiranë, Durrës, Shkodër e Berat; që ndodheshin në këtë mbledhje.

<sup>3</sup> Rrapo Dervishi, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë për Qytetin e Tiranës.

e deri te inisiativat revolucionare në fushën e prodhimit e të edukimit. Mundet që shokët sekretarë të Komitetit Qendror të Partisë të venë në emër të Komitetit Qendror për të parë se si po zbatohen këto çështje nga shokët e rretheve që folën këtu.

Më duket se shokët e rrethit të Elbasanit një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojnë bujqësisë, e cila ka një prapambetje të theksuar. Ne nuk themi se Elbasani nuk ka përparime në bujqësi, por duhet të bëjë përpjekje të ecë edhe më përpara. Dhe mundësitë janë. Tashmë organizata e Partisë e këtij rrethi nuk është e re. Ju, shokë të Elbasanit, duhet të ngulni këmbë që plani të realizohet e të tejkalohet. Nuk gaboj të them se në drejtim të bujqësisë jemi të kënaqur nga Berati, i cili këta 2-3 vjet, me një punë të mirë, ka mjaft përparime. Tirana gjithashtu ka arritur suksese në industri. Po kështu edhe Shkodra paraqitet mirë. Kjo gjë nuk po ngjet akoma në Durrës, megjithëse ka kuadro të aftë që drejtojnë.

Juve, shokë sekretarë të rretheve, ju foli shoku Hysni në lidhje me perspektivën që i hapet vendit tonë. Por duhet thënë se për këto direktiva, të cilat do të konkretizohen më vonë me ekipe të Komitetit Qendror, duhet që ju vetë të mendoni për zbërthimin dhe zbatimin e tyre. Për shembull Berati ka krijuar bllokun e fiqve, kurse tani ai duhet të mendojë për të krijuar fidanishte, që të furnizojë gjithë Shqipërinë me fidane. Po kështu edhe për rrushin duhet të mendojnë e të veprojnë të gjitha rrethet. Prandaj për këto çështje të punojë edhe mendja e drejtuesve të Partisë e të pushtetit e të mos lihen vetëm në dorë të teknikëve.



Ju e dini që së shpejti do të zhvillohet mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror për të shqyrtuar çështjen e pyjeve. Të gjithë e shohim se në këtë drejtim nuk kemi punuar mirë, prandaj për problemet që do të dalin dhe për direktivat që do të jepen, kërkohet një mobilizim serioz e përgjegjësi e madhe me qëllim që pyjet e vendit tonë të marrin një hov të ri zhvillimi.

Lidhur me problemet e ditës në bujqësi, duhet të punohet që mbjellja e misrit të mbarojë sa më parë dhe hamulloret të tejkalohen, sepse nuk mund të ecet me rendimentet e ulëta që kemi sot në qumësht.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# SHKOLLAT DYVJEÇARE TË PUNËTORËVE, NË KUSHTET E SOTME, JANË FIDANISITE PËR TË PREGATITUR TEKNIKË TË MESËM

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

11 qershor 1959

Shkollat dyvjeçare të punëtorëve duhet të kenë për qëllim përgatitjen e teknikëve të mesëm, prandaj duhet të kategorizohen si të gjitha shkollat e tjera të mesme. Nuk është i drejtë mendimi që këto shkolla të diplomojnë nxënës për të vazhduar universitetin. Ne kemi nevojë për teknikë të mesëm, profil të cilin e kanë këto shkolla.

Duke u nisur nga rëndësia e shkollave dyvjeçare të punëtorëve është e domosdoshme që dikasteret të

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua «Mbi gjendjen e shkollave dyvjeçare të punëtorëve dhe masat për përmirësimin e tyre», sipas raportit të paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Këto shkolla u çelën në vitin 1957 — 1958 dhe kishin për qëllim përmirësimin e përbërjes klasore dhe shpejtimin e ritmit për përgatitjen e teknikëve të mesëm.

marrin në dorë plotësimin e tyre me kontingjentin e nxënësve sipas planit dhe kriterit që kërkohen. Shokët e ndërmarrjeve duhet të nisen nga perspektiva dhe jo të kenë frikë për të hequr nga puna disa punëtorë, të cilët, duke shkuar në këto shkolla, nesër do të jenë kuadro të mesëm. Me disa punëtorë që largohen nga prodhimi, nuk prishet puna. Prandaj t'i jepet rëndësi dërgimit të nxënësve në shkollat dyvjeçare të punëtorëve. Degët e kuadrit të dikastereve të venë në ndërmarrje e të zgjedhin elementët e përshtatshëm. Nga ana ekonomike ata nuk do të humbasin sepse rrogën e marrin edhe gjatë vazhimit të shkollës. Nuk është e vërtetë se s'duan punëtorët të venë në shkollë e të dalin teknikë të mesëm, përkundrazi ata venë me dëshirë dhe bile falenderojnë. Në qoftë se nuk është realizuar kontingjenti i nxënësve, faji nuk është aspak i punëtorëve, por i Komitetit Shtetëror të Gjeologjisë, i Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, i Ministrisë së Ndërtimit, të cilat kanë dërguar edhe elementë të papërshtatshëm, pa shkollë 7-vjeçare, pa stazh pune, jo të kualifikuar, ndonjë edhe mbi 40 vjeç. Shifrat flasin vetë. Në teknikumin e naftës janë dërguar 24 nxënës më pak, pa folur këtu për deficitin e madh të krijuar nga mospërparimi i nxënësve në mësim në të gjitha shkollat dyvjeçare të punëtorëve.

Të bëhen të gjitha përpjekjet për ruajtjen e kontingjentit të nxënësve që venë në shkollë. Do të dalin edhe ca nxënës të dobët, për këtë jemi të ndërgjegjshëm, por të bëjmë çmos që ata të mos largohen nga shkolla. Të organizohet për ta ndihmë e veçantë dhe të fitojnë klasën. Pas 4-5 vjetësh, ata do të jenë njerëz

më të aftë. Mundet që, në këto kushte, të mos jemi aq shumë ekzigjentë për lëndët e kulturës së përgjithshme, ashtu sikurse mund të jemi për lëndët e profesionit të tyre. Por punëtorët nxënës që vazhdojnë këto shkolla duhet të bëhen të ndërgjegjshëm për detyrat që kanë. Përveç punës edukative që duhet bërë me ta, atyre që largohen t'u kërkohet diçka nga shpenzimet që ka bërë shteti, sepse nuk mund të lejohen të ikin kur të duan, në një kohë që shteti u ka paguar rrogën. Masa të tilla janë të domosdoshme. Përsa u përket programeve, jam i mendimit se duhet të shikohen e të ndryshohen.

Gjithashtu, për njerëzit që dërgohen në këto shkolla, nuk duhet kërkuar të jenë medoemos të gjithë anëtarë partie, por të jenë punëtorë dhe fshatarë të varfër. Këtu nuk duhet të lejohen të venë djem bejlerësh ose kulakësh.

Orientimet që jepen nga Sekretariati për këto shkolla, të venë menjëherë në bazë dhe dikasteret qendrore ta marrin çështjen në dorë. Të kuptohet mirë se shkollat dyvjeçare të punëtorëve në kushtet e sotme janë fidanishte për përgatitjen e kadrove të mesëm.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË  
KOOPERATIVËN BUJQËSORE TË SOFRATIKËS,  
LOKALITETI I DROPULLIT TË POSHTËM**

**19 qershor 1959**

Të dashur shokë dhe vëllezër, nëna dhe motra,

Jam shumë i gëzuar që ndodhem në mes tuaj. Jam gjithashtu i gëzuar që edhe punët në kooperativën tuaj shkojnë mirë. Kjo do të thotë se bashkimi i tri kooperativave bujqësore të ju është realizuar me sukses dhe ju ushqeni një dashuri të madhe për punën dhe jetën në kooperativë, gjë që ka ndihmuar shumë për përmirësimin e jetesës në familjet tuaja. Natyrisht kjo i detyrohet në radhë të parë popullit të mrekullueshëm të kësaj kooperative dhe udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë. Anëtarët e organizatës-bazë të Partisë në kooperativën tuaj janë nga djemtë dhe vajzat tuaja më të mira. Nuk e di mirë sa vajza dhe gra ka kjo organizatë, por kam përshtypjen se ka pak. Ky është një gabim i madh, sepse gratë e Shqipërisë, veçanërisht gratë e Dropullit, janë punëtore, heroike, të zgjuara dhe besnike për çështjen e popullit. Të tilla cilësi kërkohen për të qenë në Parti, sepse në Parti hyjnë bijtë dhe bijat më të mira të popullit. Në këto kushte duhet që në organiza-

tën e Partisë të ketë më shumë gra. E pse të mos ketë më shumë edhe gra por të ketë vetëm burra? Kohët e vjetra kanë kaluar përgjithnjë dhe ne burrat duhet ta kuptojmë se Partia i ka ngritur edhe gratë në një nivel të barabartë me ne, qoftë në të drejtat që kanë të bëjnë me punën, ashtu edhe në të drejtën për të dhënë mendime në çështjet politike e të tjera.

Një nga veprat më të mëdha që ka realizuar Partia jonë është çlirimi i gruas nga zgjedha e së kaluarës. Prandaj edhe çështja e forcimit të Partisë me gra të vendosura dhe punëtore të palodhura, duhet të kihet parasysh edhe nga organizata juaj bazë.

Qëllimi kryesor i Partisë është përmirësimi i vazhdueshëm i jetës së popullit tonë, që jeta e njerëzve tanë të bëhet çdo ditë e më e mirë.

Kjo do të thotë që populli të ketë ushqime më shumë dhe më të mira, të vishet më mirë, të ketë banesa të nevojshme dhe të rregulluara si duhet, të ketë mundësi të marrë arsimin dhe kulturën e duhur. Me një fjalë të ketë mundësi që t'i plotësojë të gjitha nevojat e tija dhe të fëmijëve. Ky është socializmi. Partia bën përpjekje të mëdha për ta udhëhequr popullin tonë në rrugën e ndërtimit të socializmit, sepse jeta e re, socializmi, nuk ndërtohet me fjalë.

Në lidhje me fshatarësinë rruga e Partisë sonë ka qenë e drejtë. Kjo ka bërë të mundur që ajo të arrijë suksese të mëdha në zhvillimin e ekonomisë bujqësore. Në radhë të parë reforma agrare i dha tokën fshatarësisë, u hoqën qafe bejlerët, agallarët, arhondët që i pinin gjakun. Koha e tyre iku dhe nuk kthehet më kurrë. Tani problemi më i madh i fshatarësisë sonë është

ai i kolektivizimit, rruga e vetme e begatisë për fshatarin.

Populli ynë thotë se bashkimi bën fuqinë dhe kë-shtu krijon begatinë. Në këtë drejtim politika e Partisë ka bërë që të arrihen suksese të mëdha, pasi tani në vendin tonë është kolektivizuar rreth 76 për qind e sipërfaqes së tokave të punuara. Por nuk është e mjaftueshme vetëm puna për bashkimin e ekonomive individuale. Për të dhënë rezultate më të mëdha ky bashkim, nga ana e Partisë dhe e qeverisë duhet të merreshin edhe shumë masa të tjera për t'i dhënë një ndihmë akoma më të madhe bujqësisë, sikurse janë problemet e mekanizimit, të bonifikimit, të ujitjes e të tjera, me qëllim që tokat të bëheshin më prodhuese dhe të rritej rendimenti i kulturave të ndryshme bujqësore. Gjatë një periudhe të shkurtër, në drejtim të mekanizimit, të bonifikimit dhe ujitjes, populli ynë, me Partinë e vet në krye, ka realizuar vepra që përpara as që mund të merreshin me mend. Me miliarda ka investuar dhe do të investojë shteti ynë për përmirësimin e bujqësisë së vendit tonë. Ja, nesër në Vurgun e Delvinës do të inaugurohet hapja e kanalit të Çukës, pesë-gjashtë lumenj dhe përrenj do të ndërrojnë përgjithmonë drejtimin e mëparshëm dhe do të dalin në det nëpër një shtrat, duke shpëtuar kështu nga shkatërrimi me mijëra hektarë toka. Këto toka, që ishin më parë kënetë, vatra malarjeje dhe vuajtjesh për fshatarësinë e asaj kra-hine, tani do të bëhen nga më prodhueset e vendit tonë.

Ashtu si në fushën e Vurgut, punime të mëdha po bëhen edhe në fusha të tjera të rëndësishme të vendit tonë, si në Shqipërinë e Mesme edhe në Shqipërinë e

Veriut dhe nuk do të jetë e largët koha që edhe fusha e Dropullit do të përmirësohet. Partia do të marrë masa për ta studjuar problemin e rregullimit të rrjedhjes së lumit që i shkakton kaq dëme fushës së Dropullit, si dhe problemin e ujitjes së kësaj fushe. Këto punë do të bëhen në radhë të parë, me qëllim që të dyfishohen prodhimet e kulturave bujqësore të fushës suaj. Natyrisht paralelisht me këtë punë, do të merren masa për të shtuar edhe më shumë mekanizimin në këtë fushë.

Jam i bindur se kooperativistët e Dropullit do ta përvetësojnë shpejt agroteknikën e përparuar, sepse ata janë njerëz me eksperiencë, me kulturë dhe të zgjuar. Futja e agroteknikës së përparuar në shkallë sa më të gjerë do të bëjë që ju të merrni prodhime të bollshme.

Pak më parë biseduam me shokë të kooperativës suaj mbi problemet e bujqësisë dhe mendojmë se ju, njëkohësisht me zhvillimin e kulturave të tilla si misri, gruri dhe duhani duhet t'i vini kujdes të madh edhe rritjes së bagëtisë, veçanërisht të lopëve. Gjatë bisedës që bëmë doli se përse i përket blegtorisë ju keni akoma shumë për të bërë. Te ju ka marrë një rrugë të mirë rritja e deleve dhe e rendimentit të qumshtit për çdo dele. Për lopën ju duhet të bëni përpjekje akoma më të mëdha. Ju e dini shumë mirë se sasia e qumshtit të lopës varet në radhë të parë nga ushqimi që i jepet asaj. Po të mos i sigurohet lopës ushqimi i bollshëm, nuk mund të marrësh sasinë e qumshtit që duhet dhe, si pasojë, ju nuk do të keni sa duhet as gjalpë as djathë as qumësht as mish.

Sigurimi i këtyre prodhimeve varet nga sigurimi



i ushqimit me silazh të bollshëm për lopët. Duhet të përpiqeni t'i siguronit çdo lope 8 deri 10 tonë silazh. Unë mendoj se sikur gratë e kooperativës suaj bujqësore që janë kaq punëtore, ta marrin në dorë këtë problem, jam i bindur se ju do të arrini t'ua siguronit lopëve këtë sasi ushqimi. Gruaja është më e kujdesshme në çështje të tilla. Prandaj merreni në dorë ju, gratë e kooperativës, problemin e sigurimit të ushqimit të lopëve dhe tregojuni burrave se, sikurse në çdo punë tjetër, ashtu edhe në këtë çështje ju jeni të zonjat ta kryeni me nder detyrën. Që të dilni faqebardhë përpara gjithë kooperativës, kini parasysh që silazhi i misrit për lopët, që duhet të bëhet bashkë me kallinj në fazën e qumësht-dyllit, është ushqim shumë i mirë. Mos keni frikë për bukë, mos u trembni se do të mbeteni pa bukë. Buka nuk i ka munguar dhe asnjëherë nuk ka për t'i munguar popullit tonë.

Kaluan ato kohë që njerëzit tanë kënaqeshin vetëm me bukë. Tani populli kërkon të ketë edhe më shumë prodhime bujqësore, blegtorale e të tjera. Ekonominë tonë ne duhet ta zhvillojmë në mënyrë të tillë që t'i sigurojmë këto prodhime dhe tani të gjitha mundësitë për këtë qëllim ne i kemi. Kini parasysh se shteti ynë ka investuar dhe po investon miliarda për të fituar toka të reja dhe me punën që është bërë deri tani shumë toka janë fituar dhe të tjera do të përfitohen në të ardhshmen. Kjo do të bëjë të mundur që ne t'i shtojmë akoma më shumë prodhimet në misër, grurë, pambuk e të tjera. Me mijëra hektarë që deri dje kanë qenë moçale, janë përmirësuar dhe tani janë vënë në shfrytëzim.

Plehra kimike më parë ne nuk kishim fare, por edhe tani kemi pak. Gjatë planit të tretë pesëvjeçar parashikohet që ne të ndërtojmë dy uzina për prodhimin e plehrave kimike. Kështu nga 5-6 kg pleh kimik për hektar që përdorim tani, kur të përfundojnë këto fabrika, do të arrijmë të sigurojmë 45-50 kg pleh kimik për çdo hektar.

Tani, shokë e shoqe, ka ardhur koha dhe janë krijuar mundësitë që t'i shtojmë më shumë prodhimet tona dhe të kemi të siguar jo vetëm bukën, por të sigurojmë më shumë se deri tani prodhime bujqësore e blegtorale. Le të na falë prifti që kemi këtu, por nga qielli këto prodhime nuk bien, ato do të sigurohen me punën dhe përpjekjet e popullit.

Një problem tjetër me rëndësi për ne është përhapja më e gjerë e kulturës së rrushit, mbjellja e vreshtave. Ja një ulli këtu afër nesh. Ai, sigurisht, bën edhe kokrra.

**NJË NGA POPULLI:** Bën, po i bën një çikë të vogla.

**SHOKU ENVER:** S'ka gjë, por hahen edhe ato. Pastaj mund të mbjellim ullinj të llojeve të mira. Pra, kultura të tilla si pjergullat, vreshtat dhe ullinjët, ne duhet t'i shtojmë, jo me qindra e me mijëra, por me miliona. Edhe në kooperativën tuaj bujqësore duhet të shfrytëzohen plotësisht të gjitha ato toka që ka mundësi të mbillen vreshta për të prodhuar sa më shumë rrush, si për ta ngrënë të freskët ashtu edhe për të prodhuar sa më shumë verë. Prandaj le të hapen toka të reja për vreshta me hapa më të guximshëm dhe jo si deri tani. Këto toka, vëllezër e motra, ne do t'i hapim edhe me traktorë që na u kërkuan nga shokët tuaj dhe, kur të na vijnë, do ta kemi parasysh këtë kërkesë. Por me

traktorë nuk mund t'i hapim të gjitha tokat, prandaj duhet të përdorim edhe punën e krahut për hapjen e tokave të reja. Populli ynë, që ka bërë kurdoherë punë të tilla, nuk i trembet punës. Ja, për shembull, në rrethin e Korçës janë hapur me qindra hektarë toka të reja vetëm me krahë. Një punë e tillë mund të bëhet fare mirë edhe nga ju. Kjo do t'ju sjellë juve në vjetët që vijnë shumë të ardhura dhe do të krijohen mundësitë që kooperativistët të marrin paradhënie më shpesh.

Ne ua hoqëm pak veshin drejtuesve të kooperativës suaj, që nuk marrin masa për t'ju dhënë të holla paradhënie jo vetëm në tre-katër muaj një herë, por po të jetë e mundur më dendur, sepse në këtë mënyrë do të plotësoni më mirë nevojat dhe ajo do të jetë një nxitje më e madhe në punë për ju.

Ne jemi vëllezër, unë jam djali dhe vëllai juaj, prandaj në qoftë se keni ndonjë vërejtje për të na e bërë, na e thoni dhe ne do ta kemi parasysh. Por ne kishim edhe një vërejtje tjetër për ju. Si kudo në vendin tonë, ashtu edhe në krahinën e Dropullit është përmirësuar jeta. Shumë djem të fshatrave tuaja tani punojnë në punë të ndryshme të shtetit, si në Gjirkastër edhe në krahina të tjera të vendit tonë dhe me të ardhurat e tyre i ndihmojnë familjes që kanë në fshat. Kjo është një punë e mirë. Mirëpo në shumë shtëpi të tilla, anëtarët e familjes që jetojnë në fshat, duke u kënaqur me ndihmat që u vijnë nga njerëzit e tyre që punojnë në qendra të ndryshme të vendit tonë, nuk mobilizohen sa duhet në punët bujqësore për të bërë sa më shumë ditë-punë. Natyrisht, me një qëndrim të tillë nuk ke si të jesh dakord, sepse ka mundë-

si që këto familje, edhe duke qenë në fshat, të punojnë akoma më shumë dhe të shtojnë më tepër të ardhurat e tyre.

Edhe një vërejtje tjetër u bëmë shokëve drejtues të kooperativës suaj për çështjen e lehtësimit të punës së gruas. Përse gruaja e Dropullit, kaq trime dhe punëtorë, të ngarkohet që nga fusha me barrë të rënda për t'i çuar në depo ose në vende të tjera, kur ju keni plot kafshë tërheqëse që nuk i shfrytëzoni si duhet? Blini qerre për transportimin e mallit, në vend që t'i ngarkoni gratë me të. Në këtë drejtim ju duhet të merrni masa për të lehtësuar punonjësit, në mënyrë që forcat që harxhojnë ata për transportimin e barrëve me krahë, t'i përdorin në punë të tjera më të frytshme si, për shembull, për hapjen e tokave për të mbjellë vreshta, ullinj, fiq dhe pemë të tjera.

Për të gjitha këto probleme ne ramë dakord me drejtuesit e kooperativës, që t'i studjojnë më parë vetë, pastaj t'i shohin me shokët e rrethit dhe së bashku të pregatitin plane të reja më të gjera, duke përmbysur planet e vjetra. Për këtë ne i kemi forcat dhe të gjitha mundësitë. Planet e reja ne do t'i realizojmë, sepse kemi një popull të mrekullueshëm, se Partinë e kemi të fortë dhe të lidhur ngushtë me popullin, se ne jemi të lidhur ngushtë dhe gëzojmë përkrahjen e të gjitha vendeve vëllezër të kampit socialist. Kështu jeta e popullit tonë, liria dhe pavarësia e atdheut, ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit në Shqipëri, janë të siguruar përgjithmonë.

Gjendja politike e brendshme dhe e jashtme e vendit tonë është më e fortë se kurrë.

Ne dëshirojmë të jetojmë në miqësi me të gjithë popujt, veçanërisht me popujt fqinjë. Me popullin jugosllav kemi qenë dhe jemi miq. Por udhëheqësit revizionistë jugosllavë, që drejtojnë sot në Jugosllavi, janë armiq të marksizëm-leninizmit, pra dhe të Partisë sonë marksiste-leniniste. Ndaj tyre ne kemi qenë dhe jemi shumë vigjilentë dhe asnjëherë nuk do ta pakësojmë vigjilencën në interes të mbrojtjes së fitoreve të popullit tonë.

Ne e duam gjithashtu edhe popullin grek. Jo vetëm ne, komunistët, që jemi internacionalistë, por i gjithë populli shqiptar e do popullin grek, që është popull i mirë, punëtor, me kulturë dhe me tradita të mëdha revolucionare. Populli grek ka luftuar me shekuj për lirinë dhe pavarësinë e tij, ai ka luftuar edhe kundër nazi-fashistëve për një jetë të lumtur, të gëzuar dhe të lirë. Natyrisht, ne nuk përzihemi në çështjet e brendshme të popullit grek, përkundrazi, ne duam të jetojmë në paqe me të, ashtu sikurse edhe me popullin italian. Ne u themi edhe qeveritarëve italianë edhe atyre të Greqisë: Përse vendosni raketa në tokat e vendeve tua-ja? Për ç'qëllim do t'ju shërbejë kjo punë? Kush do ta sulmojë Greqinë apo Italinë? Natyrisht jo ne. Vendosja e raketave në Itali ose në Greqi u shërben vetëm imperialistëve amerikanë. Por kjo punë është në radhë të parë në dëm të madh të popujve grek dhe italian. Ne i kemi paralajmëruar qeveritë e Greqisë e të Italisë të mos vendosin raketa në vendet e tyre, të bëhen përpjekje për të arritur një marrëveshje midis vendeve ballkanike për të mos vendosur raketa në këto vende.

Në rast se fqinjët tanë italianë dhe grekë do të

lejonin vendosjen e raketave në vendet e tyre, atëherë do të detyrohemi edhe ne, në interes të mbrojtjes së vendit dhe të kampit të socializmit, të marrim masa. Në këtë çështje ne e dimë se nuk kanë faj popujt grek dhe italian. Ne shohim popullin grek të protestojë energjikisht kundër masave që parashikon të marrë qeveria greke. Bile edhe partitë borgjeze në Greqi, si për shembull ajo e Venizellosit, për të mos folur për EDA-n, janë kundër politikës së qeverisë së sotme, janë kundër vendosjes së raketave amerikane në tokën greke. Qeveria greke nuk duhet të ndjekë një rrugë që është në dëm të interesave të popullit grek dhe të të gjithë popujve të Ballkanit. Ne mendojmë se në Greqi ka forca të mëdha patriotike popullore, që do t'ia vënë të dy këmbët në një këpucë qeverisë së Karamanlisit, sepse populli grek nuk do ta durojë një gjë të tillë.

Ne vëmë re se në Greqi, ku thuhet shumë fjalë për liri e demokraci, elementë patriotë të flaktë, që kanë luftuar me heroizëm për lirinë e popullit grek, ata që nën regjimin e terrorit të egër të fashizmit gjerman çorrën në Akropolin e Athinës flamurin e Hitlerit dhe vendosën atë të Elladhës, siç është heroi i popullit grek Manolis Glezos, sot janë në burgje, ndërsa gjenerali fashist i Hitlerit Hojzinger, që është përgjegjës për krime të rënda kundrejt popullit grek dhe urrehet prej tij, shkon sot në Athinë dhe pritët me ceremoni nga qarqet qeveritare greke. Na duket shumë e çuditshme politika e qeverisë greke, që përpiqet me çdo mënyrë të pengojë vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe tregtare me vendin tonë, kurse me ata që e sulmuan Greqinë dhe e gjakosën popullin vëlla grek gjatë Luftës së Dytë Botë-

rore, me pasardhësit e regjimit të Musolinit, udhëheqësit e Greqisë kanë lidhur miqësi të ngushtë dhe të sinqertë.

Sigurisht një politikë e tillë jomiqësore ndaj popullit tonë është pasojë e influencës amerikane në disa qarqe drejtuese të udhëheqjes së shtetit grek. Ne mund të themi se përfaqësuesit e qeverisë sonë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara kanë mbajtur kontakte me përfaqësuesit e qeverisë greke në këtë organizatë. Ata vetë janë shprehur se qëndrimi i mbajtur nga disa qarqe udhëheqëse greke ndaj Shqipërisë nuk ka asnjë bazë. Natyrisht, ky nuk është një qëndrim i drejtë nga ana e atyre qarqeve dhe kemi besim te populli grek se ai do ta rregullojë një situatë të tillë jonormale midis vendeve tona.

Më falni se ndoshta ju mërzhita duke folur gjatë.

**ZËRA NGA POPULLI:** Jo, nuk u mërzhitëm aspak. Ju lutemi vazhdoni.

**SHOKU ENVER:** Jam shumë i gëzuar për këtë dashuri që tregoni për Partinë dhe pushtetin tonë popullor. Partia ka te ju një popull besnik dhe punëtor, ashtu si gjithë populli ynë, një popull me besim të madh në të ardhshmen e lumtur, në socializmin. Partia jonë, vëllëzër dhe motra, është kurdoherë me ju; ju do njëlloj, pa asnjë ndryshim, ashtu si gjithë popullin shqiptar. Por në qoftë se ka ndonjë gjuhë të keqe që flet kundër kësaj dashurie, ajo nuk pi ujë, parulla të tilla do t'i marrë era, ashtu si ka marrë shpresat e atyre që qëndrojnë në arrati, larg atdheut. Ata e dinin edhe më parë se Shqipëria ishte vështirë të sulmohej, se regjimi ynë popullor është i patundur. Tani vetë këta armiq të regjur thonë:

«Mbaroi puna jonë, të bëjmë ç'të bëjmë të gjejmë ndonjë punë gjëkundi sa për të mbajtur frymën, se në Shqipëri nuk kthehemi dot më». Me gjithë fajet që kanë bërë, shumicën e këtyre njerëzve pushteti ynë popullor i ka falur. Këtë masë shteti ynë e mban akoma në fuqi për t'u dhënë mundësi atyre të kthohen në Shqipëri. Këtu është atdheu i tyre, prandaj le të vijnë, të punojnë dhe të bëhen njerëz të mirë. Kur u thotë Partia dhe qeveria që të kthohen se do të jenë të lirë në gjirin e popullit dhe këtu duke punuar do të ndreqen, ata duhet ta kenë parasysh këtë thirrje.

Njerëzit edhe gabojnë; shumë kanë qenë të gënjer, prandaj tani ka ardhur koha të kthohen dhe të jetojnë si njerëz në gjirin e atdheut, në gjirin e familjeve të tyre. Ka kohë akoma që këta njerëz t'i vënë gishtin kokës.

Na vjen keq që shumë nga bashkatdhetarët tanë kanë shkuar në mërgim të shtyrë nga nevojat ekonomike. Natyrisht, ata janë bij të këtij populli dhe janë larguar nga gjiri i atdheut e i familjes se nuk kishin me se të jetonin, kur në Shqipëri mbretëronin agai, beu dhe Ahmet Zogu.

Tani ne u themi vëllezërve tanë të mërgimit të kthohen dhe të jetojnë pranë familjes, të shikojnë fëmijët që sot janë bërë burra dhe gra, të shikojnë sa ka përparuar dhe si po ndryshon dita-ditës faqja e vendit tonë.

Bashkatdhetarët tanë në mërgim, nëna, motra dhe vëllezër të dashur, që kanë shkuar atje për të punuar, kur janë kthyer në Shqipëri pas shumë vjetësh mërgimi e vuajtjesh të mëdha në shtetet e huaja dhe kanë parë



veprat që janë ndërtuar pas Çlirimit në Shqipëri, kanë qarë me lot gëzimi. Mjaft turistë shqiptarë kanë ardhur nga Amerika për të vizituar atdheun. Të gjithë kanë mbetur shumë të mallëngjyer nga sukseset që janë arritur në atdheun e tyre. Ata më parë nuk kanë qenë shumë të informuar për gjendjen në Shqipëri, po kur kanë ardhur dhe kanë parë ndryshimet e mëdha që janë bërë te ne gjatë kohës që ata nuk kanë qenë, janë habitur dhe sot janë bërë propagandistët më të flaktë në kolonitë e shqiptarëve e veprojnë kundër propagandës së imperialistëve, në radhë të parë kundër propagandës së tradhtarëve shqiptarë që duan të mbulojnë sukseset e mëdha që ka korrur populli ynë pas Çlirimit. Sivjet të tjerë turistë do të na vijnë nga kolonitë shqiptare të mërgimit. Ne do të jemi shumë të gëzuar që midis tyre të ketë edhe dropullitë të larguar nga gjiri i familjes për të gjetur punë në vendet e huaja. Le të vijnë të rrinë në shtëpi sa të duan, le të takohen me njerëzit e tyre, të bisedojnë dhe të çmallen me ta, të shohin ç'është bërë në Shqipëri dhe pastaj le të kthehen përsëri, ose, po të dëshirojnë, le të qëndrojnë përgjithmonë pranë familjes.

Ka edhe një kategori tjetër njerëzish të arratisur që janë larguar nga atdheu pas Çlirimit, të gënjer nga propaganda e armiqve. Edhe ata janë djemtë tanë, edhe atyre ne u themi të vijnë pranë familjeve e atdheut dhe të fillojnë punën nga e para. Ne i sigurojmë ata se do t'i ndihmojmë që të ndjekin rrugën e drejtë. Partia jonë është si nëna, që kur njëri nga bijtë bën një faj të rëndë ajo zemërohet, i flet, e qorton. Por nënës i thër në zemër për fëmijët, prandaj, pasi kalon një farë

kohe, e thërret djalin e vet, e fal për fajin që ka bërë, e këshillon që të mos e përsëritë më fajin dhe e fut në gjirin e ngrohtë të familjes. Kështu punon edhe Partia me ata që gabojnë, sepse ajo dëshiron që familja jonë e madhe, i gjithë populli shqiptar të jetë sa më i bashkuar.

Pse vepron kështu Partia? Mund të ketë ndonjë gjuhë të ligë që të thotë se Partia këtë e bën për të gënjyer ata që kanë ikur dhe porsa të kthehen do t'i marrë nga veshi dhe do t'i futë në burg. Kështu nuk ka për të ndodhur. Po pse jemi kaq zemërgjerë me këta njerëz? Ne veprojmë kështu se jemi të fortë, se populli ynë është i bashkuar rreth Partisë, se Partia e udhëheq atë në rrugë të drejtë, vija e Partisë është e drejtë dhe në interes të popullit. Për këtë e do populli Partinë. Prandaj pushteti ynë nuk ka frikë se mund të kthehen 10-20 ose 100 njerëz të ikur, ai ka besim se ata do të ndreqen po të futen në gjirin e popullit dhe kjo është në interes të popullit dhe të vetë këtyre njerëzve. Prandaj thirrja që u bën Partia dhe qeveria jonë njerëzve të gabuar, që sot bredhin andej-këtej në vende të huaja, duhet të kuptohet drejt prej tyre. Ata le të kthehen pranë familjeve të tyre, se atdheu është çdo gjë, ai është nënë dhe baba, se këtu prehen koskat e të parëve tanë, sepse këtu është derdhur gjaku i tyre për mbrojtjen e këtij vendi e sot derdhet djersa për ndërtimin e një të ardhshmeje të lumtur.

Jashtë nuk të do njeri. Guri është i rëndë në vendin e tij, thotë populli, kurse në vendet kapitaliste të shfrytëzojnë deri në palcë dhe pastaj të flakin tej. Në vendin tënd, në gjirin e atdheut, je pranë popullit tënd,

pranë njerëzve të tu më të dashur, prandaj si të mirat ashtu dhe të këqijat kalojnë më lehtë në mes të motrave dhe vëllezërve, kurse jashtë, në vendet kapitaliste, nuk të njeh njeri, nuk ta qan hallin njeri dhe njeriu vuan shumë.

Të dashur shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër, kini bindje të plotë se e ardhshmeja e popullit tonë, dhe këtu e kam fjalën për një të ardhshme të afërt, do të bëhet çdo ditë më e bukur. Kini dashuri për njëri-tjetrin, kini dashuri të madhe për Partinë dhe pushtetin, i këshilloni, i mësoni dhe i ndihmoni njerëzit që janë në Parti dhe në pushtet si djemtë dhe vëllezërit tuaj! Çdo brengë dhe vërejtje që keni ia thoni hapur Partisë, se ajo do të jetë kurdoherë me ju. Në qoftë se ndonjëri gabon, po t'ia thoni Partisë ajo do të marrë masa dhe do ta ndreqë fajtorin; ose po të jetë faj i rëndë, cilido qoftë, ajo do t'i japë dënimin e merituar. Partia nuk pajtohet me gabimet, me veprimet e padrejta që janë në dëm të popullit. Në qoftë se një çështje nuk e sheh të drejtë dhe nuk e zgjidh organizata-bazë drejtohuni në komitetin e Partisë që t'jua zgjidhë. Mund të ndodhë që për një problem edhe komiteti i Partisë të mos veprojë drejt, atëherë drejtohuni në Komitetin Qendror të Partisë. Të gjitha letrat dhe ankesat e popullit studjohen me kujdes të madh, një për një, në Komitetin Qendror të Partisë, i cili dërgon njerëz për t'i parë dhe për t'i kontrolluar ato në vend se ku qëndron e vërteta dhe i jepet ankuesit e drejta që i takon.

Në kooperativën bujqësore, në asamblenë e saj duhet të sundojë zëri i masës dhe jo i një ose dy njerëzve. Ju të vendosni, ata të zbatojnë. Por edhe ju duhet të

veproni në bazë të rregullave dhe të disiplinës që keni vendosur vetë e që janë në interes të të gjithë kooperativës.

Me një punë të ndërgjegjshme ne do t'i shtojmë prodhimet dhe jeta e popullit do të bëhet akoma më e mirë. Unë po shoh këtu se fëmijët tuaj janë shumë të shëndetshëm dhe të bukur. Ata do të kalojnë jetën pa hallet që kemi pasur ne dhe me siguri do të jetojnë shumë më tepër nga ne. Sikur ata të mos e njohin luftën, do të jetojnë gjatë, kurse ndryshe është për brezin tonë, që ka kaluar dy luftëra. Për fëmijët tanë po përgatitet jeta e lumtur dhe e begatshme, socializmi dhe komunizmi.

Ju uroj, nëna, motra dhe vëllezër, jetë të lumtur, të gëzuar dhe suksese sa më të mëdha në punën tuaj kolektive!

Të rrojë populli ynë trim e punëtor!

Të rrojë rinia dhe pionierët tanë!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 150 (3365), 23 qershor 1959*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», Nr. 150 (3365). 23 qershor 1959*

## NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E INAUGURIMIT TË KANALIT TË ÇUKËS

21 qershor 1959

Të dashur shokë kooperativistë dhe kooperativiste,  
Të dashur shokë punëtorë, inxhinierë dhe teknikë,  
Të dashur shokë ushtarë dhe oficerë të ushtrisë  
sonë të lavdishme,

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të  
qeverisë sonë, më lejoni t'ju sjell përshëndetjet më të  
nxehhta të të gjithë Partisë sonë të lavdishme të Punës,  
të qeverisë sonë popullore dhe të falenderojmë me këtë  
rast punëtorët dhe ushtarët që kanë punuar me heroi-  
zëm në këtë vepër të rëndësishme dhe t'ju uroj të gji-  
thëve ju, të dashur kooperativistë dhe kooperativiste,  
që këtë vepër ta trashëgoni!

Me plot të drejtë ju e ndjeni veten sot shumë të  
gëzuar. Por sot nuk gëzoheni vetëm ju, shokë të dashur  
të Vurgut. Bashkë me ju gëzohet gjithë Shqipëria.  
Është gjithashtu shumë i justifikuar gjithë ky entuzia-  
zëm dhe dashuri e madhe që ju shprehni me këtë rast  
për Partinë tonë. Ne jemi plotësisht të ndërgjegjshëm

se pa Partinë tonë marksiste-leniniste populli shqiptar nuk do të arrinte dot në këtë ditë të lumtur dhe të gëzuar.

U desh Lufta e lavdishme Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Partisë, u desh lufta legjendare e Ushtrisë famëmadhe Sovjetike që populli ynë, i cili kishte vuajtur shumë në të kaluarën, por që kurrë nuk u ishte përvulur armiqve të jashtëm dhe feudalëve të brendshëm, që të fitonte lirinë, pavarësinë dhe të fillonte ndërtimin e jetës së re dhe të lumtur në vendin tonë, socializmin.

Motra dhe vëllezër të dashur,

Ne asistojmë në momente të tilla historike kur vendi ynë, brenda një kohe të shkurtër, ka ndryshuar shumë. Po zhvillohet dhe përparon me hapa të shpejtë ekonomia jonë popullore. Industria jonë po zhvillohet dita-ditës me ngritjen e veprave të reja; bujqësia jonë, dikur e prapambetur, është bërë një faktor i fuqishëm për lulëzimin e ekonomisë së atdheut tonë, sepse fshatarësia jonë patriotike, për zhvillimin e bujqësisë me hapa të shpejtë, ka përqaftuar rrugën e lavdishme që hapi Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik, rrugën e kolektivizimit.

Në saje të kolektivizimit të bujqësisë tani fushat tona po kthehen vazhdimisht në kopshte të lulëzuara, në to po rriten rendimentet e kulturave bujqësore, po përvetësohet dita-ditës agroteknika e përparuar nga fshatarësia jonë kooperativiste.

Ju, sigurisht, jeni në dijeni për investimet e mëdha që ka bërë dhe po bën shteti ynë për zhvillimin e buj-

qësisë. Brenda këtyre dy pesëvjeçarëve me miliarda lekë ka harxhuar dhe vazhdon të harxhojë shteti për bonifikimin e fushave të vendit tonë, duke filluar në Veri të atdheut, në fushat e Zadrimesë e të Thumanës dhe deri këtu në fushën e Vurgut tuaj dhe të Mursisë në skajin jugor të Shqipërisë. Punimet në këto vepra po ecin për bukuri. Kështu është bërë e mundur që bujqësia jonë të fitojë me dhjetëra mijë hektarë toka të reja e me dhjetëra mijë hektarë toka të tjera do të përmirësohen, punë kjo që do të bëjë të mundur shtimin e prodhimeve të kulturave të ndryshme bujqësore, shtimin e numrit të gjësë së gjallë, sidomos të lopëve dhe të rriten shumë rendimentet e ulëta që marrim sot nga çdo kulturë. Si rrjedhim i kësaj pune të madhe që është bërë dhe do të bëhet, populli ynë heroik, punëtor dhe paqedashës çdo vit do të ketë më shumë prodhimë dhe do të ushqehet më mirë, jo vetëm me bukë, por edhe me prodhime të tjera bujqësore e blegtorale.

Me veprën që do të inaugurojmë sot, ne po bëjmë të mundur që të kalojnë në rrugën e re, që kanë hapur me duart e tyre njerëzit tanë të mrekullueshëm, lumenjtë Bistrica, Kalasa, lumi i Delvinës, Pavllo, Gajdari e të tjerë, të cilët, ashtu sikurse tha shoqja kooperativiste që foli më parë, me shekuj kanë rrjedhur lirisht në këto fusha kaq pjellore të krahinës së Vurgut dhe të Mursisë, duke i shkaktuar popullit të kësaj zone përmytje dhe mjerime të papërshkruara, duke i rrëmbyer atij edhe bukën e gojës. Fushat e Vurgut dhe të Mursisë janë fushat më të mëdha dhe më pjellore që gjenden në bregdetin jugor të vendit tonë dhe që përfshijnë një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 8 000 hektarësh.

Para fillimit të punimeve për bonifikimin, këto fusha kishin vetëm kuptimin gjeografik si fusha, sepse në të vërtetë nga këta 8 000 hektarë, vetëm 1 500 hektarë mund të mbilleshin, me kushte pak a shumë të mira. E gjithë pjesa tjetër përbëhej nga zona të kënetëzuara dhe gjysmë të kënetëzuara, nga të cilat rreth 3 500 hektarë me mundime të mëdha dhe me rendimente të ulëta e pa ndonjë siguri prodhimi, mbilleshin vetëm me kultura pranverore. Kjo gjendje kaq e hidhur u detyrohej, sigurisht çrregullimeve dhe përmbytjeve që shkaktonin gjithë lumenjtë që kalonin në këto fusha e që sillnin me vete gjithfarë lëndësh të ngurta, të cilat i depozitonin gjatë rrugës së tyre, duke e lënë pjesën më të madhe në fusha, që bëheshin të pashfrytëzueshme. Vërshimet e këtyre lumenjve vononin shpeshherë mbjelljen e bimëve pranverore dhe në shumë raste bënin bile të pamundur korrjen e prodhimeve. Përveç këtyre të këqijave të mëdha, ato ishin bërë vatër e përjetshme e mushkonjave, që shkaktonin sëmundjen e rëndë të malarjes, si në njerëzit e rritur ashtu edhe në foshnjat e djepit.

Fushat e Vurgut dhe të Mursisë kanë qenë lakmia e agallarëve dhe e arhondëve të Gjirokastrës, të Delvinës dhe të Konispolit. Në këtë krahinë mund të shikoje para çlirimit kontradiktat e theksuara të regjimeve antipopullore. Nga njëra anë shikoje agallarët, të cilët, si shushunja të pangopura, pinin gjakun dhe djersën tuaj, nga ana tjetër, këtu ju shikoje ju, shokë kooperativistë dhe kooperativiste, të zbathura dhe të zhveshura pa shtëpi e katandi, në kushte të mjerueshme jetese. Agallarët e Gjirokastrës dhe të Delvinës kishin në fshatrat tuaja



edhe veglat e tyre, me anën e të cilave ju shtypnin. Ata ishin njëkohësisht agjentët e Zervës dhe të armiqve të tjerë të jashtëm të vendit tonë, siç ishin Çavo Kokali e Thimjo Loli, të cilët edhe gjatë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare u munduan të krijonin në këtë krahinë qendra për monarko-fashistët grekë dhe për Zervën. Por të gjitha përpjekjeve të tyre populli u tregoi vendin. Ato i përblau dhe i shkatërroi Lufta Nacionalçlirimtare, lufta heroike e popullit tonë.

Vuajtjet dhe mjerimet e papërshkruara të popullit tonë, urrejtja e tij e madhe kundër pushtuesve, agallarëve dhe arhondëve që ishin vegla të pushtuesit, etja e madhe e fshatarësisë për tokë dhe për një jetë më të mirë, bëri të mundur që fshatarësia e kësaj krahine të ngrihet e tëra në Luftën Nacionalçlirimtare, nën udhëheqjen e Partisë, e cila që në fillim i bëri thirrje popullit se vetëm duke luftuar pushtuesit dhe tradhtarët e vendit, ai do të fitojë lirinë, do të bëhet zot i tokës dhe do të përmirësojë jetën e tij. Edhe ju luftuat trimërisht si i gjithë populli ynë. Nga gjiri juaj dolën dëshmorët e paharruar të krahinës së Vurgut, si Lefter Talo, Thoma Lula, Lejla Malo dhe shumë të tjerë. Çetat e kësaj krahine, ashtu si të gjitha repartet e lavdishme partizane të vendit tonë, luftuan heroikisht me armë në dorë për Çlirimin e atdheut dhe të fshatarësisë nga prangat shekullore të bejlerëve, arhondëve e të agallarëve. Populli shqiptar, me luftën e tij heroike korri fitore mbi armiqtë. Ato që premtoi, Partia i bëri realitet. Ju morët tokën nga agallarët dhe arhondët, i zhdukët një herë e përgjithmonë shfrytëzuesit, që ju pinin gjakun.

Pas Çlirimit, Partisë dhe pushtetit tonë popullor iu desh të ndërrmerrnin punë të mëdha për përmirësimin e ekonomisë popullore, për transformimin e këtyre fushave nga kënetat, në ara pjellore, dhe njëkohësisht për përmirësimin e shëndetit të popullit të kësaj krahine. Kështu u morën masa dhe po vazhdon akoma puna për bonifikimin dhe sistemimin e fushave më pjellore të atdheut tonë, ndër të cilat janë edhe fusha e Vurgut dhe ajo e Mursisë, që po bonifikohen. Për të parë sa i leverdisshëm është për ekonominë tonë popullore bonifikimi i fushës së Vurgut dhe i fushës së Mursisë, mjafton të përmendim shifrat e mëposhtme: do të përfitohen 1 400 ha tokë e re në Vurg dhe 800 ha në Mursi, do të përmirësohen 3 600 ha tokë në Vurg dhe 1 000 ha në Mursi dhe do të bëhet e mundur që të ujiten 5 000 ha tokë në Vurg dhe 800 ha në Mursi. Këto janë përfitime kolosale për krahinën tuaj, të cilat do të bëjnë të mundur rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore. Duke i llogaritur këto rendimente me shifra të ulëta, dhe keni parasysh se këto llogaritje janë provizore, parashikohet që të ardhurat vjetore për Vurgun të shtohen mbi 90 milion dhe për Mursinë mbi 40 milion lekë.

Sigurisht, e gjithë kjo vepër që ne po inaugurojmë sot, nuk është kryer pa vështirësi. Probleme të vështira janë paraqitur për studimin e projektimin e saj.

Të dashur shokë, ne këtu duhet të përmendim dhe të falenderojmë inxhinierët, teknikët dhe specialistët tanë që kanë vënë forcat e tyre në shërbim të popullit dhe punojnë me vetëmohim për të mirën e tij. Dëshiroj të përmend këtu me këtë rast inxhinierët shqiptarë

Faredin Nuri, Zef Rakacolli, Nesti Lubonja, Mithat Hoxha, Aleko Bishka, Niko Kreshpani, teknikët dhe specialistët Ali Ibrahim, Koli Mekshi e shumë të tjerë, si dhe drejtorin e kantierit shokun Foto Sotiri.

Dua të falenderoj në mënyrë të veçantë repartet e ushtrisë sonë heroike, ushtarët e oficerët trima që i dërgoi këtu komanda, të cilët, në mënyrë të organizuar e të përsosur, kanë bërë një punë shumë të mirë dhe të lavdishme. Populli shqiptar, veçanërisht fshatarësia e Vurgut, nuk do ta harrojnë kurrë kontributin që ata kanë dhënë për ndërtimin e kësaj vepre.

Ne falenderojmë gjithashtu të gjithë punonjësit e ndërtimit për punën që kanë bërë dhe urojmë që edhe puna që ka mbetur të realizohet nga ana e tyre në afatin e caktuar nga Partia!

Të dashur shokë,

Shumë ndryshime janë bërë në krahinën e Vurgut. Pas Çlirimit, në vend të kasolleve me kashtë që shihe-shin përpara këtu, sot janë ngritur në fshatrat tuaja shtëpi të reja e të rehatshme, çdo fshat i Vurgut ka sot shkollën e tij. E gjithë zona juaj është kolektivizuar dhe janë shtuar të ardhurat e çdo familjeje fshatare. Këto suksese kanë krijuar një mirëqenie në familjet tuaja.

Po, të dashur shokë, perspektivat e fushës së Vurgut dhe të Mursisë janë të shkëlqyera. Toka këtu është shumë e mirë, klima është shumë e përshtatshme për kultura të rralla; këtu mund të rriten shumë mirë portokallet, limonat, greip-frutat dhe kultura të tjera

të vlefshme. Për këtë qëllim organizata e Partisë dhe gjithë populli i krahinës suaj duhet të tregojnë një kujdes të madh, sepse kështu do të ndryshohet krejtësisht brenda një kohe të shkurtër gjendja ekonomike e krahinës suaj, do të përmirësohet shumë mirëqenia e popullit të saj.

Ne duhet t'i shtojmë akoma më shumë, më tepër se deri tani agrumet, sepse ato janë një pasuri e madhe, aq më tepër se toka dhe klima e këtushme janë shumë të favorshme për to.

Limonat dhe portokallet janë delikatesa dhe të preferuara. Në vendet e kampit të socializmit prodhohen shumë pak prej këtyre frutave. Prandaj vendi ynë, që ka kushte aq të mira tokësore dhe klimaterike, duhet të kthehet me dëmos në një kopësht të lulëzuar portokallesh, limonash, vreshtash e pemësh të tjera të vlefshme frutore. Kështu të ardhurat që ne do të kemi prej tyre do të jenë dy-tri herë më të mëdha nga ato që na sjellin kulturat që ne rritim sot në këtë zonë.

Partia dhe qeveria i kanë marrë masat dhe së shpejti do të dërgohen në të gjitha krahinat e atdheut tonë grupe specialistësh të Ministrisë së Bujqësisë, të cilët do të studjojnë në vend mundësitë dhe kushtet për zhvillimin e kulturave që i sjellin ekonomisë fitime më të mëdha, në mënyrë që populli të sigurojë sa më shumë të ardhura.

Gjëja kryesore tani për ne është që të mobilizohemi për të shfrytëzuar në maksimum klimën tonë, që është shumë e përshtatshme për rritjen e atyre kulturave nga të cilat mund të nxirren të ardhura më të mëdha, siç janë agrumet e kultura të tjera me vlerë. Nga pikë-

pamja ekonomike zhvillimi i kulturave të tilla ka shumë leverdi.

Natyrisht, me këtë nuk dua të them që ne të lëmë pas dore prodhimin e drithërave; drithërat janë prodhim bazë për vendin tonë dhe ato do t'i zhvillojmë për të plotësuar sa më mirë nevojat tona. Por këtë ne do ta bëjmë në fushat e tjera të atdheut tonë, ndërsa në një fushë të tillë si kjo e Vurgut dhe e Mursisë, shumë të përshtatshme për agrumet dhe frutat e tjera të vlefshme, ka shumë më tepër leverdi t'i zhvillojmë këto me shumicë se sa të mbjellim drithëra, sepse me këtë mënyrë do të sigurojmë të ardhura të tilla me të cilat ne mund të importojmë nga jashtë shtetit prodhimet që na mungojnë.

Krahina juaj ka gjithashtu vende shumë të përshtatshme edhe për vreshta, fiq e të tjera. Kjo detyrë kërkon që të gjitha këto kodra që të zë syri duhet medocmos të përmbysen me mekanizma dhe të hapen toka të reja. Kjo detyrë do të plotësohet nga forca e madhe e popullit, nga forca e kolektivizimit, që edhe në vendin tonë do të bëjë mrekullira. Në fshatrat e Korçës po bëhet një punë e madhe për hapjen e qindra hektarëve toka të reja nëpër kodra, me krahët e kooperativistëve, pa prituri që të dërgohen mekanizma. Prandaj merrni shembull edhe ju nga një punë e tillë, që do të bëjë të mundur të shtoni prodhimet dhe të ardhurat tuaja. Kjo punë do të bëhet në të katër anët e vendit tonë. Mos u kënaqni me pemët, fiqtë dhe pjergullat që na kanë lënë gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë. Ata, megjithëse kanë punuar pa organizimin që kemi ne sot, prapë na kanë lënë disa milion pemë frutore. Por

nëse ata kanë arritur të mbjellin kaq, ne duhet të mbjellim shumë herë më tepër, pasi tani forca jonë është shumë më e madhe, sepse tani jemi të bashkuar, të organizuar në kooperativat bujqësore.

Shokë të dashur kooperativistë, mos prisni derisa të vijë ekipet që do të dërgohen nga qeveria. Shikojini më gjerë këto probleme e studjoni çfarë mund të bëhet në kooperativat tuaja dhe hartoni plane akoma më të mëdha nga ato të gjertanishmet, se ne me siguri do t'i realizojmë këto, sepse fshatarësia jonë ka plot energji që ne nuk duhet t'i lëmë në gjumë.

Në radhët tuaja një forcë e madhe janë vetë gratë. Gratë e krahinës suaj, si dhe ato të Dropullit, janë me të vërtetë heroina në punë e të zgjuara, gra të tilla kanë të gjithë vendin tonë.

Liria dhe pavarësia e atdheut tonë janë të siguruara përjetë. Ato i garantoj Lufta heroike Nacionalçlirimtare e popullit tonë, e udhëhequr nga Partia jonë e Punës. Populli ynë ka pasur besim të patundur te Bashkimi Sovjetik që në lindjen e tij, në ditët e para të Revolucionit të madh Socialist të Tëtorit, kur Lenini i madh grisi Traktatin e poshtër të Londrës, të imperialistëve, i cili parashikonte copëtimin e Shqipërisë në mes fqinjëve tanë — Italisë, Greqisë dhe Serbisë. Kur Lenini i pavdekshëm themeloi shtetin e parë të punëtorëve dhe fshatarëve, Bashkimi Sovjetik u bë flamurtari i çlirimit të të gjithë popujve dhe të shfrytëzuarve në botë. Që në këtë kohë edhe për popullin tonë lindi shpresa për ditë më të mira dhe kështu ndodhi.

Shoqe dhe shokë të dashur, situata ndërkombëtare është e favorshme. Sigurisht, ka dhe do të ketë akoma

vështirësi të mëdha, sepse imperialistët amerikanë dhe satelitët e tyre përgatiten për luftë, ata po armatosin tani për këtë qëllim edhe Gjermaninë Perëndimore.

Por popujt e vendeve socialiste nuk duan luftë. Në vendet tona punohet për zhvillimin e industrisë, për përparimin e vrullshëm të bujqësisë, për lulëzimin e arsimit dhe të kulturës së popullit, prandaj popujt tanë nuk janë për luftë. Garën e armatimeve dhe luftën i duan imperialistët, se nga këto ata nxjerrin fitime kolosale. Pra, vendet e kampit të socializmit janë shumë të interesuara për forcimin dhe triumfin e paqes në botë. Shqipëria, si pjesëtare e kampit të socializmit, ka ndjekur dhe ndjek një politikë konsekuente paqësore: Unë deklaroj edhe një herë para jush se në Shqipëri nuk ka baza për lëshimin e raketave. Po ne, më së fundi do të detyrohemi t'i vendosim ato, në interes të mbrojtjes së lirisë dhe të pavarësisë së atdheut tonë dhe për mbrojtjen e jetës paqësore të popullit tonë, pasi shtetet rreth nesh, pa asnjë arsye, janë duke ndër-tuar baza të tilla.

Ne u kemi bërë shumë herë thirrje fqinjëve tanë që të mos ecin në këtë rrugë të rrezikshme. Italinë askush nuk e kërcënon. Gjatë gjithë historisë së tij populli ynë nuk e ka sulmuar ndonjëherë Italinë; përkundrazi ka qenë Italia ajo që ka vënë shpeshherë në rrezik dhe ka sulmuar popullin tonë. Atë nuk e kërcënon gjithashtu asnjë nga vendet e tjera të kampit tonë. Atëherë, kur nuk ka ndonjë kërcënim për Italinë nga ana jonë, nuk ka asnjë arsye për ndërtimin e bazave për lëshimin e raketave nga toka e saj.

Një punë e tillë është vetëm në interes të imperia-

listëve amerikanë, sepse populli italian do të ketë pasoja shumë të hidhura nga vendosja e këtyre raketave.

Përse në tokën e popullit vëlla grek të ketë armë të rrezikshme bërthamore? Përse të ndërtohen atje baza për raketa? Nuk ka nga kush të ketë frikë Greqia, as nga populli ynë, as nga ndonjë popull tjetër fqinj. Por lejimi që u bëhet nga qarqet qeveritare greke amerikanëve për ndërtimin e bazave për raketa në Greqi, është vetëm në interes të amerikanëve dhe në dëm të paqes.

Është shumë e çuditshme politika që ndjekin sot udhëheqësit qeveritarë grekë, duke forcuar lidhjet me pasardhësit e atyre, që në Itali pregatitën sulmin kundër vendit tonë dhe më vonë kundër popullit grek, ndërsa me popullin shqiptar, që nuk i ka rënë kurrë në qafë Greqisë dhe që dëshiron të rrojë singërisht në paqe me popullin grek, disa qarqe udhëheqëse greke bëjnë gjithfarë përpjekjesh për të mos lidhur marrëdhënie diplomatike dhe tregtare me ne; përkundrazi, ato mundohen të krijojnë një situatë të nderë, artificiale midis të dy vendeve tona, gjë që është në dëm, në radhë të parë të vetë interesave të popullit grek. Ne u themi edhe një herë qeveritarëve grekë se s'ka ç'ju duhen raketat. Për të zgjidhur problemet që u interesojnë vendeve tona, le të mblidhemi dhe t'i zgjidhim ato në rrugën e bisedimeve.

Një politikë e tillë nga ana jonë na duket se është e drejtë, e arsyeshme dhe pa dyshim gjen aprovimin e të gjithëve.

Ne vëmë re gjithashtu që qeveria jugosllave ka shprehur aprovimin që në Ballkan dhe në pellgun e



Mesdheut të krijohet një zonë e çarmatosur nga armët bërthamore dhe raketat. Por nga ana tjetër ne vëmë gjithashtu re se ndaj miqve të tyre, qeveritarëve grekë, me të cilët ata janë shprehur dakord për të gjitha çështjet, nuk mbajnë asnjë qëndrim për të dënuar vendimin për ndërtimin e bazave të raketave në Greqi, gjë që është jo vetëm në dëmin tonë, por edhe të vetë popujve të Jugosllavisë. Ky është një qëndrim tipik revizionist, antimarksist, ndryshe qeveritarët jugosllavë duhej të shpreheshin haptazi kundër një vendimi të tillë të qeverisë greke, që rrezikon interesat e popujve të Ballkanit dhe të paqes. Revizionistët jugosllavë dihet se i kanë bërë shumë dëme Partisë dhe popullit tonë. Megjithatë, ne dëshirojmë të mbajmë marrëdhënie miqësore me Republikën Popullore Federative të Jugosllavisë dhe në rrugën shtetërore ne do të bëjmë të gjitha përpjekjet për të mbajtur marrëdhënie normale, por vigjilenca e Partisë dhe e popullit tonë ndaj akteve armiçësore të tyre do të jetë kurdoherë në lartësinë e kërkesave për ruajtjen e interesave të larta të popullit tonë dhe të Partisë sonë.

Të dashur shokë dhe shoqe, Partia na mëson t'i shikojmë kurdoherë në sy vështirësitë, t'i zgjidhim ato me kurajë në interes të popullit. Ju e dini rëndësinë e madhe që ka për vendin tonë zhvillimi i shpejtë i bujqësisë, prandaj më lejoni t'ju këshilloj edhe një herë që, për të realizuar detyrat tuaja, të forconi sa më shumë organizatat-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore, që ato të bëhen pulsi, zemra dhe motori që do të udhëheqë drejt dhe si duhet të gjitha aktivitetet e jetës në kooperativë.

Ju, shokë dhe shoqe të dashur, mos u kënaqni me prodhimet që kini marrë deri tani. Të jeni më të guximshëm në planet tuaja dhe më të organizuar në punë. Ju duhet të zbatoni me këmbëngulje agroteknikën e re dhe lini mënjanë metodat e prapambetura që japin rezultate të pakta. Ja p.sh., unë mund t'ju flas pak në lidhje me çështjen e ushqimit të lopëve. Populli ynë nuk do të jetojë gjithnjë vetëm me bukë, ai duhet të hajë edhe më shumë prodhime blegtorale. Për të realizuar këtë detyrë ne duhet t'i thyejmë normat dhe planet që kemi deri tani për lopët. Edhe lopët tona mund të prodhojnë 2, 3 deri në 4 mijë litra qumësht në vit, në rast se ne do t'u sigurojmë atyre ushqim të bollshëm dhe me cilësi të mirë.

Pra, jua theksoj edhe një herë problemin e ushqimit të blegtorisë, sidomos çështjen e silazhit të misrit. Misri i silazhuar me gjithë kalli në fazën e qumësht-dyllit, është ushqimi më i mirë për bagëtinë. Po t'u sigurohet lopëve 8-10 tonë silazh, mund të rritet shumë produktiviteti i qumështit të tyre. Kështu ne do të kemi më shumë qumësht dhe, si rrjedhim, do të shtohen më tepër edhe të ardhurat e kooperativistëve. Prandaj të mos kursejmë në sigurimin e silazhit të misrit me kalli, se fitimet do të jenë të mëdha. Mos luftoni me hamullore për të marrë vetëm misër kokërr. Koncentrate merrni aq sa ju nevojiten, pjesën tjetër të misrit këputeni me gjithë kallëz të njomë, sepse një ushqim i tillë është shumë i mirë për lopët. Prandaj të luftoni me të gjitha forcat për realizimin e kësaj detyre kaq të rëndësishme, korrni sa më shpejt fushat me grurë dhe i mbillni ato menjëherë me misër, për të siguruar sa

më shumë silazh. Sikur çdo kooperativë të mbjellë 5-6 ose 10 hektarë me misër për silazh dhe nga ky ushqim t'u siguron lopëve normën e caktuar, të jeni të sigurtë se do të merrni më shumë qumësht prej çdo lope. Këtë nuk ka përse të mos e bëni. Kjo është në dorën tuaj. Prandaj organizoni më mirë punën, u jepni më shumë përkrahje grave për këtë problem, sepse ato janë më të zonjat në punë për mirëmbajtjen e lopëve. Po ta kryeni plotësisht këtë detyrë në kooperativë, do të vini re me siguri se ekonomia juaj do të ndryshojë shpejt faqen.

Partia na mëson të gjithëve t'i përvishemi punës bashkë me popullin, të dëgjojmë zërin dhe këshillat tuaja dhe të ecim kurdoherë përpara. Rrugët tona janë të hapura. Çdo gjë është në duart tona. Partia ne po na çon drejt socializmit dhe komunizmit, drejt jetës së lumtur. Ne do t'i realizojmë plotësisht qëllimet tona, sepse na udhëheq Partia jonë marksiste-leniniste.

Lavdi popullit tonë punëtor dhe heroik!

Rroftë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Ju uroj, të dashur kooperativistë e kooperativiste, suksese të mëtëjshme e më të mëdha në realizimin e planit të këtij viti dhe në përgatitjen e planeve të reja, akoma më të guximshme, për pesëvjeçarin e ardhshëm!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 151 (3366), 24 qershor 1959*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», Nr. 151 (3366), 24 qershor 1959*

**NGA FJALA NË TAKIMIN ME KUADROT DHE  
PLENUMIN E KOMITETIT TË PARTISË  
TË RRETHIT GJIROKASTËR**

**24 qershor 1959**

Përshtypja ime, gjatë takimeve që pata me shokët udhëheqës të Partisë dhe të pushtetit në rreth, si dhe me popullin, është se gjendja morale, politike dhe ekonomike e rrethit tuaj është shumë e mirë. Në popull ka një entuziazëm dhe besim të madh te Partia dhe në vijën e saj të drejtë. Me sa konstatova, populli është mobilizuar mirë për realizimin e planeve ekonomike. Kjo natyrisht i detyrohet punës së mirë të organizatës së Partisë. Udhëheqja e drejtë e Partisë pasqyrohet në mobilizimin e plotë të popullit për realizimin e detyrave të planit dhe në entuziazmin e tij. Kjo është përshtypja që krijova unë, pavarësisht se në punë ka edhe plot të meta e vështirësi që duhen kapërcyer.

Por, po të punojnë të gjithë si duhet dhe të mobilizohen totalisht, komunistët në radhë të parë, po të përpiqen këta më shumë për ngritjen e nivelit të tyre teknik, ideologjik dhe kultural, shumë të meta dhe vështirësi që ekzistojnë tani mund të zhidhen më lehtë.

*Në bisedën e tij shoku Enver Hoxha foli dhe për ndryshimet që pa gjatë vizitës së tij në qendrat e punës e të prodhimit dhe në kooperativat bujqësore të rrethit, që nga koha kur ka qenë herën e fundit.*

Me ardhjen në rreth kam vënë re se këtu, si kudo në vendin tonë, janë bërë ndryshime të mëdha si në qytet ashtu edhe në kooperativat bujqësore. Ndryshime të theksuara vura re gjithashtu në ngritjen, në një shkallë të kënaqshme, të nivelit të kuadrove, gjë që ka shumë rëndësi sepse nga kuadri, nga njerëzit, varet realizimi i detyrave të rëndësishme që kemi përpara.

Kuadrot e Partisë dhe të pushtetit tonë, në radhë të parë, duhet të jenë në ballë të punës dhe për të qenë në ballë të punës duhet të punojnë që direktivat e Partisë, ligjet e shtetit dhe urdhëresat e qeverisë, jo vetëm të zbatohen në mënyrë të përpiktë, por edhe të kuptohen, të studjohen dhe të zbatohen në mënyrë krijuese në situatat konkrete të vendit tonë. Natyrisht kuadrot duhet t'u përmbahen cageve dhe parimeve të ligjeve e direktivave, po brendapërbrenda tyre ata duhet të kenë iniciativë, në mënyrë që nga zbatimi i tyre populli të shohë sa më shumë të mira. Kjo është një nga detyrat kryesore të kuadrove tanë.

Për t'i zbatuar sa më mirë direktivat e Partisë kuadrot tanë duhet të bëjnë çdo ditë përpjekje për edukimin e tyre, për ngritjen e tyre kulturele. Me këtë, çështja nuk duhet kuptuar vetëm nga pikëpamja që kuadri të dijë diçka nga historia, apo gjeografia etj. Kjo ka rëndësinë e vet, por kuadri duhet të dijë dhe të zotërojë në perfeksion në radhë të parë mjeshtërinë e tij. Pastaj ai mund t'i shtojë mjeshtërisë së vet edhe

diçka siç është kultura e përgjithshme për të zgjeruar horizontin me dituri.

Puna kryesore është që kuadrot tanë duhet të perfeksionohen çdo ditë e më shumë. Në këtë drejtim Partia jonë ka bërë një hap me të vërtetë të madh në të gjithë sektorët, megjithëse periudha që pas Çlirimit është akoma mjaft e shkurtër.

Për Partinë dhe vendin tonë ka pasur dhe ka një rëndësi të madhe edukimi dhe kalitja e klasës punëtore. Klasa jonë punëtore ka qenë e re dhe e vogël, por pas Çlirimit ajo jo vetëm është rritur në numër për shkak të zhvillimit të industrisë sonë të re, por është rritur edhe nga ana cilësore. Kjo do të thotë se tani ne kemi një klasë punëtore të kulturuar. Natyrisht ne, këto veçori të klasës sonë punëtore nuk mund t'i barazojmë me ato të klasës punëtore të disa vendeve të tjera të zhvilluara. Ne jemi akoma shumë prapa tyre. Po ne jemi shumë përpara duke bërë krahasime me të kaluarën tonë. Le të marrim për shembull vetëm Gjirokastrën, e cila përpara ka pasur vetëm një artizanat fare të vogël, ndërsa tani këtu punojnë mbi 3 000 punëtorë. Kjo ka shumë rëndësi për Gjirokastrën.

Në radhët e klasës sonë punëtore ne kemi njerëz të talentuar që kanë përvetësuar në një kohë të shkurtër teknikën e fundit dhe tani janë në gjendje të drejtojnë makina të komplikuar të tipave më modernë, në të gjithë sektorët.

Unë vizitova këto ditë disa nga ndërmarrjet ekonomike të qytetit. Përshtypje shumë të madhe më bëri në to vullneti i njerëzve në punë dhe pjekuria e tyre. Në ndërmarrjen lokale të zdrukthëtarisë u takova me

shumë njerëz, që nga punëtorët e rinj dhe deri te drejtori i fabrikës. Të gjithë këta janë njerëz të mirë dhe energjikë që realizojnë e, bile shumë prej tyre, i tejkalojnë detyrat e planit dhe njëkohësisht luftojnë ditaditës që të perfeksionohen. Kjo është një siguri e madhe për të ardhshmen.

Edhe në fabrikën e lëkurëve vura re të njëjtën frymë, ndërgjegje dhe besim ndaj Partisë. Punëtorët e kësaj ndërmarrjeje do ta realizojnë dhe do ta tejkalojnë planin, në rast se nuk do t'u nxirren pengesa nga organet furnitore, sepse atje ka një frymë të shëndoshë partie. Organizatën-bazë atje e udhëheq një djalë i atyre shtresave që në të kaluarën ishin të përbuzur nga regjimet dhe klasat shfrytëzuese. Por Partia jonë marksiste-leniniste i shikon njerëzit në frymë proletare, ajo është kundër pikëpamjeve raciste, kështu tani në vendin tonë të gjithë njerëzit, pavarësisht nga kombësia, ose ngjyra e lëkurës, konsiderohen qytetarë të njëllajtë, vlerësohen sipas meritave dhe aftësive dhe jo vetëm vihen në punë, po kur janë të zot, njëlloj si të gjithë të tjerët, vihen edhe në krye të Partisë e të pushtetit.

Më ka bërë gjithashtu përshtypje çështja e punëtorëve vajza. Shumë vajza dhe gra pashë në ndërmarrjet që vizitova, si në fabrikën e cigareve, të fermentimit të duhanit dhe në punishten e konfeksioneve. Ky është një sukses shumë i madh, duke marrë parasysh gjendjen ku ka qenë gruaja përpara në qytetin e Gjirokastrës. Gruaja këtu u çlirua në tërë kuptimin e fjalës, si nga ana politike, ashtu edhe nga ana ekonomike. Ky realitet e ka bërë gruan, si kudo në Shqipëri, me të vërtetë të barabartë me burrin. Pikëpamjet e vjetra se gruaja

duhet të merret vetëm me punët e shtëpisë dhe të ketë vendin e fundit në familje, u zhdukën. Gruaja e re punëtore, në Gjirokastrë, ka respekt për prindërit e vet ose të burrit dhe këtë respekt ajo e kupton në rrugën e drejtë, në frymën e edukatës dhe të respektit për më të vjetrit që u ka dhënë atyre Partia, sepse Partia u krijoi mundësi grave të dalin nga muret e shtëpisë dhe të marrin pjesë në jetën politike dhe ekonomike të vendit.

Në klasën punëtore të rrethit të Gjirokastrës, sado e vogël që është, në krahasim me rrethet e tjera, ne kemi një bazë të shëndoshë të pushtetit tonë. Prandaj të mos mungojë kujdesi i Partisë për edukimin e saj të mëtejshëm, në radhë të parë për edukimin teknik. Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit të kenë parasysh se kërkesat e njerëzve zhvillohen, rriten, bëhen më të kulturuar. Këtyre kërkesave duhet t'u përgjigjen ndërmarrjet tona ekonomike. Prandaj kurset dhe shkollat e ndryshme që hapen të drejtohen si duhet, në mënyrë që kuadrot tanë të përfitojnë sa më shumë, të rritet edukata e tyre. Këtij problemi Partia duhet t'i kushtojë një vëmendje të posaçme, të merren masa në mënyrë që të bëhet e mundur ngritja e vazhdueshme e nivelit teknik dhe e kulturës së përgjithshme të klasës punëtore.

Dihet se qëllimi më i lartë i Partisë është ngritja e pandërprerë e nivelit material dhe kultural të masave punonjëse. Kjo do të thotë që populli të ushqehet, të vishet dhe të plotësojë të gjitha nevojat e tija me prodhime sa më të shumta, të cilësisë së mirë dhe të lirë. Për këtë qëllim po bëhen përpjekje të mëdha nga e



gjithë klasa punëtore e vendit tonë. Një fushatë e madhe emulacioni ka shpërthyer kudo në kuadrin e 15-vjetorit të Çlirimit të atdheut. Si kudo, një fushatë e tillë po zhvillohet edhe këtu në Gjirokastrë. Prandaj të gjitha qendrat tona të punës të shfrytëzojnë në maksimum të gjitha rezervat ekzistuese. Një udhëheqje e zgjuar në ndërmarrje, një ndihmë më e madhe nga ana e Partisë dhe e pushtetit për shfrytëzimin sa më të madh të këtyre rezervave, do të bëjë të mundur përmirësimin e cilësisë së prodhimeve dhe uljen e kostos së tyre, gjë që krijon mundësi për uljen e mëtejshme të çmimeve.

Ditën e parë unë vizitova punishten e konfeksioneve. Atje ka plot gra e vajza që e dinë mirë zanatin. Megjithëkëtë shumica e tyre duhet të perfeksionohen në punë për të nxjerrë prodhime të cilësisë më të mirë, pasi disa konfeksione të qepura jo si duhet nuk blihen nga populli. Kjo shtron përpara detyrën që atje duhet të qepen akoma më mirë rrobat, të përmirësohet cilësia e përgatitjes së tyre. Për t'ia arritur këtij qëllimi, përveç masave që atje të dërgohen gra e vajza të zgjuara e me talent, me punëtorët e tanishme atje të hapen dhe kurse kualifikimi për rritjen e aftësive të tyre profesionale. Kështu duhet të veprohet në të gjitha ndërmarrjet e vendit e jo vetëm në rrethin tuaj.

Dëshiroj të theksoj edhe një tjetër problem të rëndësishëm, çështjen e furnizimeve, që luan një rol të madh në plotësimin e nevojave të popullit. Për këtë duhet të bëhet një punë e organizuar mirë dhe t'i bëhet popullit një shërbim i kulturuar. Nuk lejohet që populli të dëmtohet nga burokracia ose nga lëshimet e disa

njerëzve të organeve të tregtisë shtetërore dhe kooperativiste që merren me këtë punë. Në këtë drejtim Partia dhe pushteti duhet të punojnë shumë mirë, sepse, në fund të fundit, çdo punonjës në qytet apo në fshat punon, djersin dhe bën të gjitha përpjekjet për të realizuar detyrat që i ngarkohen, por nga ana tjetër ai kërkon që pas punës të gjejë dhe të blejë sendet që i duhen për të kënaqur nevojat e tija. Populli ynë nuk ka shumë pretendime, ai është i zgjuar dhe i durueshëm dhe kërkon aq sa janë mundësitë tona. Kur ato që janë parashikuar i plotësohen, ai kënaqet, po, kur e sheh se mundësitë janë, dhe nuk furnizohet në kohë e si duhet, ose ato që i furnizohen nuk janë të cilësisë së mirë, ka të drejtë të ngrejë zërin. Në rast se ka njeri që sjell pengesa në këtë çështje t'i hiqet veshi, ndonjë njeri i pandërgjegjshëm që nuk e kryen mirë punën në organet e tregtisë, ta dijë se vepron keq dhe Partia nuk mund ta lejojë një gjë të tillë. Ato që kemi në plan duhet t'i furnizohen medoemos popullit në kohë dhe me cilësi të mirë. Prandaj organet e furnizimit duhet të shumëfishojnë përpjekjet në këtë drejtim, të ngrenë kulturën tregtare, të jenë të gatshme dhe të sjellshme për t'i shërbyer sa më mirë popullit.

Organet e Partisë dhe të pushtetit duhet të jenë të kujdesshme për t'i ndihmuar dhe kontrolluar vazhdimisht organizatat tregtare në mënyrë që ato të përmirësojnë vazhdimisht punën e tyre. Me gjithë përparimet që janë bërë, si kudo edhe në këtë sektor, duhet të punohet akoma për zhdukjen e disa fenomeneve negative që vërehen akoma në sektorin e tregtisë. Megjithëse këto fenomene po bëhen gjithnjë më të rralla, nuk

duhet të mungojë kujdesi i vazhdueshëm nga ana e Partisë, deri në zhdukjen e tyre të plotë. Por në organet e tregtisë ka akoma njerëz të pandërgjegjshëm që nuk e kryejnë mirë punën, që bëjnë hatëre, ose që vjedhin. Megjithëkëtë në disa raste vihet re se, nga pakujdesia ose mungesa e kontrollit nga organizatat e Partisë ose organet e pushtetit në bazë mbi organet e tregtisë, si pasojë e familjaritetit ose e hatëreve, futen njerëz të një fisi në të njëjtën ndërmarrje tregtare, ose njerëz jo të ndershëm që nuk e justifikojnë besimin për t'u lënë në dorë vlera materiale. Natyrisht njerëz të tillë do të abuzojnë. Më e keqja është kur futen në organet tregtare përsëri elementë që janë dënuar një herë për vjedhje. Komiteti Qendror i Partisë ka vënë re se gjatë këtij gjashtëmujori ndër njerëzit që kanë abuzuar dhe janë dënuar shumica kanë qenë nga ata që janë dënuar një herë më parë. Njerëz të tillë nuk kanë ç'na duhen në organet e tregtisë, nuk kemi pse t'u japim atyre në dorë vlera materiale. Pa punë këta njerëz të mos mbeten, por të shkojnë gjetkë të punojnë. Asnjë besim, pra, të mos u jepet këtyre njerëzve, që ua dhamë një herë besimin po nuk e mbajtën dhe për këtë ata janë vetë fajtorë. Në organet e tregtisë të vendosen njerëz të ndershëm, sepse i ndershmi nuk humbet kurrë në llogari, ai jo vetëm nuk e prek pasurinë që i është besuar, po kujdeset ta administrojë sa më mirë atë. Për këtë problem duhet të bëjë kujdes në radhë të parë Partia. Problemi i ruajtjes së pasurisë së popullit duhet të jetë nën kujdesin e pandërprerë të organizatave të Partisë, të organeve të pushtetit dhe të kuadrove tanë.

Një problem tjetër për Partinë është lufta e vazh-

dueshme kundër burokratizmit. Për fat të keq kjo sëmundje shfaqet kudo. Këtu nuk qëndron çështja vetëm në shkurtimin e organikave. Partia dhe qeveria kanë punuar dhe do të kujdesen edhe në të ardhshmen që të bëjnë shkurtime atje ku ka vende të tepërta, pasi kështu jo vetëm pakësohen shpenzimet e shtetit, njerëzit që punonin në vende të tepërta dërgohen në prodhim e bëhen prodhues, por edhe puna do të kryhet më mirë. Kuadrot tanë nuk janë më si disa vjet më parë kur, me gjithë vullnetin e madh për punë, atyre u mungonin eksperiencia dhe dituritë e nevojshme për punë. Atëherë nevoja na detyronte të kishim më shumë njerëz nëpër aparate. Mirëpo tani kuadrot tanë kanë fituar eksperiencë dhe janë të aftë për punë më të mëdha. Ata vazhdimisht po ngrenë edhe nivelin e tyre kultural. Vetëm këtë vit mbarojnë kurset e natës ose ato me korrespondencë në universitetin tonë mbi 200 nga kuadrot tanë që punojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe të administratës. Tani këta kuadro u pajisën me kulturë të lartë dhe kanë një eksperiencë të madhe 15-vjeçare në punë. Prandaj shumë më lehtë se përpara ata mund ta drejtojnë punën. Në këtë mënyrë vazhdimisht po krijohen kushte për të bërë shkurtime dhe punët do të kryhen gjithnjë më mirë.

Shumë njerëz në vendin tonë dhe sidomos këtu në Gjirokastër, kanë pasur tendencë të punonin zyrove, qoftë edhe në një punë fare të thjeshtë. Ky mentalitet ka ndryshuar, por nuk është zhdukur fare. Kështu ka akoma edhe sot njerëz që kërkojnë të futen zyrove. Njerëz të tillë duhet të kuptojnë se vendi i nderit është në prodhim dhe në prodhim vende ka kurdoherë. Me-

gjithatë Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria do të shqyrtojnë çështjen se çka mund të bëhet akoma në rrethin tuaj gjatë planit të tretë pesëvjeçar për t'u dhënë mundësi një numri akoma më të madh grash për t'u futur në prodhim.

Është pozitiv fakti që në vendin tonë gruaja kërkon të punojë. Ja, edhe këtu në Gjirokastrë vërehet se shumë të pakta janë familjet që kanë vetëm një njeri në punë. Bile ka shumë familje që kanë 3-4-5 e deri në 6 pjesëtarë të tyre në punë. Gratë duan të futen në punë se e shohin që kështu shtohen të ardhurat në familje, përmirësohet jeta e tyre, prandaj zhvillimi i pandërprerë i industrisë, i bujqësisë, i të gjithë ekonomisë sonë, do të krijojë mundësi të vazhdueshme për futjen e gruas gjithnjë e më shumë në prodhim, si në gjithë vendin tonë ashtu edhe këtu në rrethin tuaj.

Për popullin punonjës, të zgjuar dhe punëtor, të qytetit të Gjirokastrës, ka rëndësi edhe puna që duhet të bëjë Partia për të thyer pikëpamjen e gabuar që ekziston te disa njerëz, edhe në qytete të tjera të atdheut tonë, për të mos punuar në disa kategori punësh si p.sh. në sektorin e ndërtimit. Qyteti i Gjirokastrës është i bukur, ai dallohet për shtëpitë e tija karakteristike dhe të bukura. Këto shtëpi duhen ruajtur me kujdes edhe për faktin se në to jeton popullsia e qytetit edhe për karakteristikat dhe bukurinë që i japin qytetit. Prandaj ato duhen mirëmbajtur ose rindërtuar sipas rastit, kur vjetërohen. Për këtë qëllim duhen siguruar muratorë e karpentierë, të cilët duhet të pregatiten këtu në vend. Prandaj duhet punuar që të shkojnë, sidomos të rinj e të reja, edhe në këtë sektor të rëndësishëm

dhe të thyhet mentaliteti për të mos shkuar në sektorin e ndërtimeve ose edhe në disa punë sezonale të bujqësisë. Ja, sot para dite isha në një nga kooperativat e bashkuara të Lunxhërisë. Shokët më thanë se atje ka kooperativa që nuk i përballojnë dot punët e mëdha që grumbullohen në këtë stinë, sepse u mungon fuqia punëtore. Kështu nuk e prashitin dot në kohë misrin ose duhanin etj. Fabrika e fermentimit të duhanit, si çdo vit, liron nga puna në këtë stinë një numër grash deri në vjeshtë, kur fillon të punojë me kapacitet të plotë. Atëherë shumë nga punëtorët e fermentimit, në vend që të qëndrojnë pa punë, le të shkojnë të punojnë gjatë verës në kooperativat bujqësore të afërta ose në ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe bashkë me shoqet e tyre fshatare të bëjnë punë bujqësore dhe të fitojnë të holla edhe gjatë këtyre tre muajve që fabrika e fermentimit nuk ka shumë punë.

Për drejtuesit e Partisë dhe të pushtetit në rreth është një detyrë me shumë rëndësi shqyrtimi me kujdes të madh i kërkesave dhe i ankesave të popullit. Këto pasqyrojnë zërin e popullit, prandaj jo vetëm duhet të shqyrtohen me drejtësinë më të madhe, po komiteti i Partisë në rreth duhet të bëjë herë pas here analizën e tyre, sepse mund të zbulojë dobësi dhe tendenca të dëmshme në punonjësit e administratës, të cilat duhen luftuar dhe ndrequr. Për drejtuesit e Partisë në rreth, një, dy ose tri letra me ankesa të një natyre, duhet të vlejnë si një sinjalizim për të konstatuar se në atë drejtim diçka çalon. Prandaj çështja duhet parë sa më shpejt dhe të merren masa që lutjet dhe kërkesat e popullit të shqyrtohen shpejt, mirë dhe të zgjidhen.

Letrat dhe vërejtjet që i drejtohen Partisë nga ana e masave punonjëse si dhe takimet që bëjnë shokët përgjegjës me njerëzit e popullit, kanë rëndësi jo vetëm për faktin se ato ndihmojnë për të zbuluar padrejtësitë që mund t'u bëhen punonjësve nga njerëz të pandërgjegjshëm, por edhe se me anë të tyre kontrollohet zbatimi i vijës së Partisë. Kjo ka rëndësi të madhe. Por konstatohet se jo kurdoherë tregohet vëmendja e duhur në këto çështje. Ka njerëz që nuk e presin mirë popullin, që nuk studjojnë me vëmendjen e duhur letrat që u drejtohen nga masat. Partia dhe pushteti në rreth dhe në bazë duhet të jenë shumë vigjilentë në këtë drejtim.

Dëshiroj të theksoj gjithashtu kujdesin e madh që duhet treguar nga ana e organeve lokale edhe për problemet e arsimit dhe të kulturës. Rrethi i Gjirokastrës trashëgon tradita shumë të mira në këta sektorë. Është një gjë shumë pozitive që arsimi fillor në rrethin e Gjirokastrës shkon shumë mirë; unë me kënaqësi mora vesh se rrethi juaj ka arritur që 80 për qind të fëmijëve të ndjekin arsimin 7-vjeçar dhe parashikoni që së shpejti të arrini në 100 për qind. Ky është një sukses me rëndësi të madhe. Përveç këtyre në qytet keni dhe një numër shkollash të mesme, siç janë gjimnazi, shkolla pedagogjike, të cilat ndiqen nga një numër i madh të rinjsh e të rejash.

Nga sa më thanë shokët drejtues të rrethit dhe nga informacionet që kemi nga Ministria e Arsimit, del se në shkollat e mesme të rrethit tuaj niveli i përvetësimit të programeve shkollore është mjaft i mirë. Kjo sigurisht i detyrohet përpjekjeve të palodhura të

arsintarëve të rrethit të Gjirokastrës, përpjekjeve të nxënësve si dhe kujdesit të vazhdueshëm që tregojnë organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit në rreth për problemet e arsimit.

Si kudo edhe te ju ka shkolla të natës. Këtu puna ndryshon, nuk paraqitet mirë si në shkollat e ditës, për shkak se kuadrot tanë nuk i ndjekin ato rregullisht, se nuk studjojnë në mënyrë sistematike. Shumë kuadro, jo vetëm këtu në Gjirokastrë, marrin angazhime, regjistrohen me entuziazëm në shkollat e natës dhe në ato me korrespondencë si p.sh. në Shkollën e Partisë «V. I. Lenin», në universitet, ose në shkollat e mesme e në kurse të ndryshme, por, pas pak kohësh, bie vrulli për të mësuar, njerëzit tërhiqen dhe, kur vjen fundi i vitit shkollor, katandiset kokoshi një thellë. Një qëndrim i tillë është shumë i gabuar dhe duhet t'i jepet fund. Ne e kuptojmë se kuadrot që ndjekin shkollën bëjnë një mundim të dyfishtë, punojnë e njëkohësisht mësojnë dhe kjo natyrisht s'është e lehtë. Po këto përpjekje janë të njëjlojshme të bëhen nga secili në interesin e tyre personal, në interesin e punës që bëjnë dhe të të gjithë vendit tonë. Pra në këtë drejtim ju, kuadrot, duhet të bëni përpjekje të mëdha për kapërcimin e vështirësive që ju dalin.

Kur regjistrohesh në shkollë ose në një kurs duhet të bësh përpjekjet e duhura që t'i kalosh medoemos provimet. Për këtë qëllim bëhen edhe favore nga ana e shtetit siç janë p.sh. pushimet që u jepen atyre punonjësve që ndjekin shkollat. Po duhet pasur parasysh nga ana e tyre që përvetësimin e lëndës të mos e lënë për kohën e pushimeve, duhet mësuar vazhdi-



misht me një plan të caktuar, bile shumë herë duhet sakrifikuar edhe koha e pushimit, edhe gjumi që shkolla të mbarohet, se mësimi është një ushqim shumë i nevojshëm për të kryer sa më mirë detyrat që na ngarkohen.

Në këtë drejtim duhet bërë një kthesë, veçanërisht në rrethin tuaj, sepse nuk jeni mirë. Shumë herë ju nuk plotësoni numrin e kuadrove që, sipas planit, duhet të dërgoni në kurse e shkolla të ndryshme. Shpeshherë dërgoni në to njerëz pa perspektivë, duke i shkaktuar shtetit shpenzime që nuk japin asnjë rezultat, në vend që të dërgoni në kurse dhe shkolla kuadrot më të mirë. Në shkollën dyvjeçare për kuadrot punëtorë shumë herë drejtorët e ndërmarrjeve, duke mos e vlerësuar sa duhet rëndësinë e këtij problemi politik dhe ekonomik, që ka të bëjë me ngritjen e elementëve të klasës punëtorë në teknikë të mesëm ose të lartë, dërgojnë njerëz të tillë që nuk mësojnë dot dhe mbeten në klasë, në vend që të dërgojnë njerëz të zgjuar, me perspektivë dhe punëtorë të kualifikuar. Kështu si veprohet nuk është aspak e drejtë.

Po vallë mund të bëhet pa të tillë teknikë me shkollë? Natyrisht edhe mund të bëhet, por, kur përgatit njerëz të zot në praktikë edhe me shkollë, përfitimet do të jenë më të mëdha.

Në këtë drejtim, mendojmë të veprojmë tani për përgatitjen arsimore të kuadrove drejtues të pushtetit dhe mendohet të merren disa masa për këtë çështje. Së shpejti do të fillojmë të dërgojmë në shkolla të larta së pari kryetarë apo zëvendëskryetarë komitetesh ekzekutive, me qëllim që edhe këta të plotësojnë ato

boshllëqe që kanë nga ana kulturale. Prandaj çështjes së mësimi, veçanërisht nga kuadrot tanë, i duhet kushtuar një kujdes i madh.

Vlen t'ju përmend këtu përpjekjet e udhëheqësve të Partisë dhe të pushtetit që, së bashku me punonjësit e artit dhe të kulturës, punojnë për të vënë në dukje vlerat dhe traditat e mira të popullit tonë, përpjekjet e patriotëve tanë të shquar për të cilat punonjësit dhe rinia jonë interesohen shumë t'i mësojnë. Natyrisht kjo është një punë e mirë nga ana e punonjësve të kulturës që i mbledhin këto. Partia duhet të tregojë kujdes që këto materiale, kur mblidhen e përpunohen me kujdes e në baza të shëndosha, të botohen. Në një bisedë që pata me drejtorin e muzeut të Gjirokastrës, ky m'u ankua me të drejtë se punimet e tij rreth historisë së qytetit të Gjirokastrës, të teatrit në atë qytet, rreth jetës së Avni Rustemit etj. nuk i botohen dhe në vend të tyre, botohen libra vjershash pa vlerë të madhe. Brezi i ri dëshiron të ketë më shumë materiale për të mësuar mbi përpjekjet e njerëzve përparimtarë dhe të patriotëve të shquar të popullit tonë, mbi luftën e tyre kundër pushtuesve turq etj., mbi përpjekjet e tyre për përhapjen e shkrimit në gjuhën amtare në kohën e pushtimit turk etj. Këta njerëz duhen inkurajuar se puna e tyre është në dobi të popullit, të mbahen afër sepse do të punojnë akoma më mirë.

Partia duhet të bëjë shumë kujdes me njerëzit patriotë të kaluar nga mosha. Të bëhen takime me këta patriotë, me mjekë, inxhinierë etj.; t'i respektojmë dhe t'i dëgjojmë, se ata kanë eksperiencë nga jeta dhe këshillat e tyre janë shumë të vlefshme për punën

tonë. Këtë e them, shokë, se ka disa kuadro të rinj që mbarojnë shkolla të larta, brenda ose jashtë vendit, e bile disa janë edhe në Paris, dhe mbahen fodullë përpara kolegëve të tyre të vjetër. Të nënvleftësosh të kaluarit nga mosha që nuk kanë kryer shkolla të larta por që kanë një eksperiencë të madhe në punë, është gabim i madh. Nëse vërehen të meta te ata dhe ka boshllëqe në dijenitë e tyre duhet t'ua korrigojmë, t'ua plotësojmë siç na mëson Partia, në frymën e një bashkëpunimi shoqëror.

Eksperienca ka një rëndësi aq të madhe se edhe teoria. Të rinjve tanë që mësojnë në shkolla, krahas përvetësimit të programeve, t'u krijojmë kushte që të bëjnë edhe punë praktike. Ata që gjatë pushimeve verore duan të punojnë, le të dërgohen në punë. Nga ana tjetër, vetë mësuesit dhe pedagogët, nëpërmjet mësimeve në klasë, t'ua rrënjosin nxënësve dashurinë për punën, për fabrikën, uzinën, për gurin dhe llaçin, për grurin, pemët apo për bagëtinë etj. Që kur janë të vegjël fëmijët duhet të ushqehen me dashuri për punën. Në këtë mënyrë, kur të rriten dhe të mbarojnë shkollën, ato do të shkojnë me kënaqësi atje ku e kërkon nevoja e nuk do të ndodhë si tani kur ndonjë i ri që mbaron universitetin kërkon të qëndrojë në Tiranë. Natyrisht raste të tilla janë të rralla, se ne kemi një rini heroike, besnike të Partisë që nuk i kursehet punës dhe shkon kudo që të jetë nevoja.

Një detyrë me rëndësi për ju është që me punonjësit e arsimit dhe të kulturës të vazhdoni t'i forconi akoma kontaktet dhe kulturën ta bëni me të vërtetë ashtu si do Partia. Të zhvillonit traditat revolucionare dhe patriotike të popullit tonë, të mbani afër Partisë

punonjësit e arsimit dhe të kulturës dhe të gjithë intelektualët në përgjithësi. Te intelektualët duhet të ndihet influenca dhe aftësia e drejtimit të klasës punëtore. Ndosht që në ndonjë intelektual si këtu në Gjirokastrë, të manifestohen pikëpamjet e vjetra mikroborgjeze. Te intelektualit mikroborgjez ka tendenca individualiste, duke menduar se ai është më i zoti nga të tjerët, se është i ditur etj. Te një njeri i tillë fare lehtë mund të bëjnë vend pikëpamje të huaja të nënvleftësimit të elementëve të klasës punëtore ose të fshatarësisë që drejtojnë sot në vendin tonë dhe këtej të lindë tendenca e thyerjes së disiplinës, e individualizmit etj. Kur një element i tillë e ndjen veten se është më i zoti, ai shkëputet nga klasa punëtore, kërkon të qëndrojë mbi të. Me kohë pastaj te një njeri i tillë fillojnë të zënë vend tendencat oportuniste dhe revizioniste.

Prandaj Partia duhet ta mbajë afër inteligjencien, se e kemi të pastër dhe të paprekur nga sëmundje të dëmshme. Ka te ne edhe ndonjë intelektual të ri, që, porsa mbaron shkollën, e harron fabrikën, minierën ose fshatin, harron përse e ka dërguar populli dhe e ka mbajtur për disa vjet në shkollë me djersën e tij, që kur të mbarojë mësimet të vihet në shërbim të popullit, t'ia lajë borxhin që i ka. Por ai i bën bisht detyrës duke nxjerrë një qind arsye pa baza për të mos shkuar atje ku luftohet për realizimin e planeve, atje ku punohet dhe prodhohet për popullin. Natyrisht, raste të tilla janë shumë të rralla, por Partia duhet ta luftojë një tendencë të këfillë atje ku shfaqet, t'i mbajë afër intelektualët tanë, të vjetër e të rinj, dhe t'i edukojë ata me frymën e Partisë.

*Shoku Enver Hoxha foli edhe mbi disa probleme të bujqësisë për të cilat, theksoi ai, duhet t'i tërhiqet vëmendja organizatës dhe t'i ketë parasysh që t'i ndreqë.*

Si kudo edhe në rrethin e Gjirokastrës janë arritur rezultate të mira në zhvillimin e bujqësisë. Këtu përfundoi kolektivizimi, kooperativat po ecin drejt forcimit të ekonomisë së tyre kolektive dhe këtë vit më shumë se çdo vit tjetër do të merren prodhime më të mëdha si në drithë e në duhan, ashtu edhe në blegtori. Organizata e Partisë e rrethit e ka shtuar aktivitetin në drejtim të mobilizimit të punonjësve për zbatimin e detyrave që ka shtruar Partia. Por zbatimi i detyrave që ka vënë Komiteti Qendror kërkon që të zhvillohet një punë më e madhe dhe t'u jepet një zgjidhje më e shpejtë dhe më e kualifikuar disa problemeve nga ana e organizatës së Partisë dhe e organeve të pushtetit.

Një nga këto probleme është dhe ai i hapjes së tokave të reja. Në të gjithë rrethin ka mjaft toka të papunuara, të cilat, jo vetëm me traktorë, por edhe me që ose me krahë, mund të kthehen në toka prodhuese. Plani i hapjes së tokave të reja nuk është realizuar edhe në mjaft rrethe të tjera e ndërmarrje bujqësore. Po edhe në rrethin tuaj gjatë vizitës që bëra, vura re se shumë toka janë të zëna nga ferra, rrepe dhe drurë të tjerë të padobishëm. Organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethin tuaj, nuk janë marrë sa duhet nga afër për organizimin si duhet të punës për hapjen dhe spastrimin e këtyre tokave, nuk ndjehet shumë fryma për të shtuar sipërfaqen e tokës dhe për të pasur ara të parceluara, të pastruara dhe të gjera, sado

që sipërfaqja e përgjithshme e tokës në raport me familjet kooperativiste në rrethin tuaj është e vogël, afro 2 hektarë për familje kooperativiste, ose rreth 4 dynym për frymë.

Nuk duhet pritur që këto toka të hapen vetëm me traktorë po mobilizoni punonjësit e bujqësisë për të hapur toka të reja edhe me krahë. Për këtë qëllim i kushtoni kujdes organizimit më të mirë të punës për realizimin e kësaj detyre kaq të rëndësishme, plotësoni deficitet që keni, që të arrini rezultate akoma më të mëdha si kanë arritur disa rrethe të tjera. Vetë ju, shokë të udhëheqjes, duhet ta thyeni këtë situatë.

Një detyrë tjetër që ju nuk po e kryeni si duhet është ajo e punimit të thellë të tokave dhe e qilizmave. Këtë vit kjo detyrë është marrë seriozisht në të gjitha rrethet, kurse te ju është shtruar në mënyrë shumë të çlirët, nuk janë vënë detyra mobilizuese dhe reale dhe si përfundim gjatë këtij viti janë bërë qilizmë rreth 30-40 ha. Prandaj ju duhet të merrni masa për të kaluar në punime më të thella të arave dhe për punimin e tokave qilizmë. Kooperativat tuaja bujqësore kanë shumë mundësi në këtë drejtim.

Sikur ju t'i vinit detyrë çdo kooperativisti që të bënte jo shumë po vetëm gjysmë dynym qilizmë gjatë një viti, me 8 500 forca që kanë kooperativat tuaja bujqësore do të bëheshin rreth 450 hektarë, kurse te ju deri tani janë bërë vetëm 30-40 dynym qilizmë, gjë që tregon se plani këtu është shumë prapa. Dhe ju e kuptoni se ç'rëndësi të madhe ka qilizma për rritjen e rendimenteve.

Ju duhet t'i vini rëndësi gjithashtu grumbullimit dhe përdorimit të plehrave natyrale, sepse nuk paraqi-

teni mirë. Vitin e kaluar u hodhën në arë vetëm 8 300 tonë pleh të kafshëve, — 11 tonë fekale dhe 2 tonë hi. Kjo sasi është shumë e vogël. Për vitin në vazhdim nuk kemi akoma të dhëna konkrete ç'është bërë me grumbullimin dhe përdorimin e plehrave, po këto rezultate të pakënaqshme tregojnë se ju nuk e keni marrë mirë në dorë problemin e plehërimeve. Ju duhet të organizoni mirë edhe plehërishtet, të mos bëni gropa për grumbullimin e plehrave siç praktikohet te ne, pasi kostojnë, po hapni kanale anës arave, hidhni atje plehun, e mbuloni dhe kur të vijë koha nxirreni dhe shpërndajeni drejt e në ara. Ju gjithashtu duhet të ngjallni interesin material të kooperativistëve për grumbullimin e plehut, duke blerë me para ose duke shpërblyer me ditë-punc plehun e grumbulluar në oborret e anëtarëve, me qëllim që të sigurohen sasi më të mëdha plehrash për plehërimin e arave, pasi sot mënyra kryesore e plehërimit është ajo e plehut natyral.

Në bujqësi duhet akoma më mirë dhe më shumë të tregohet kujdes për ujitjen e tokave. Ndërmarrja bujqësore e Goranxisë deri tani s'ka ujitur kurrë, ndërsa mund të ujitë rreth 150-200 hektarë me ujërat që rrjedhin nga Libohova, pa bërë asnjë investim, dhe në qoftë se me pak shpenzime do të ndërtohet ndonjë rezervuar i thjeshtë, kjo sipërfaqe mund të dyfishohet. Kjo përbën një rezervë të madhe për shtimin e prodhimeve në këtë ndërmarrje. Ka gjithashtu mundësi që edhe në shumë kooperativa të shtohen tokat nën ujë.

Ju, shokë të plenumit, duhet të kuptoni mirë rëndësinë e madhe të problemit të farërave, sepse vura re që në rrethin tuaj ka shumë mungesa në këtë çështje,

që influencojnë në uljen e rendimenteve. Duke kaluar në fushën e Dropullit vura re se arat me grurë janë të përziera me shumë varietete, bile ka ara me grurë dhe tërshërë bashkë. Natyrisht ka edhe parcela të pastra, po parcela të tilla rrallë mund t'i gjesh. Edhe shumë kooperativa bujqësore kanë mbjellë misër pa bërë pothuaj asnjë pastrim të farës. Kësaj çështjeje ju duhet t'i vini rëndësi të madhe sepse një nga faktorët më të rëndësishëm për shtimin e prodhimit është edhe sigurimi i farërave të zgjedhura. Në qoftë se gabimet në lidhje me sigurimin e farërave të zgjedhura janë bërë nga drejtoria e farërave, duhet të merrni masa që të ketë rregull dhe më shumë kujdes për trajtimin e farërave. Fara duhet të jetë e pastër. Për këtë duhet të luftoni në mënyrë të organizuar dhe të jeni të rreptë ndaj atyre që nuk e kryejnë mirë këtë detyrë të rëndësishme.

Përsa i përket sistemimit të luginës së Gjirokastrës, del se është e nevojshme që ajo të bëhet, se do të sjellë një rritje të madhe të prodhimit. Po kjo punë nuk mund të fillohet pa e studjuar qysh më parë. Megjithatë shumë kooperativa bujqësore të mos presin sistemimin e përgjithshëm të kësaj fushe, po me forcat e tyre të marrin masa për kullimin, nivelimin, parcelimin dhe masa të tjera mbrojtëse për tokat e tyre. Në këtë punë natyrisht duhet të ndihmojë edhe SMT-ja e cila duhet forcuar akoma.

Për të marrë dy prodhime nga toka, në rrethin tuaj këtë vit po tregohet më tepër interesim. Është parashikuar të mbillen 2 300 hektarë pas të lashtave, kurse vitin e kaluar te ju u mbollën vetëm rreth 300 hektarë dhe në disa kooperativa, si p.sh. në atë të Dervicanit, u morën



rendimente të mira, 25 kv misër kokërr për hektar. Shihni, pra, ç'mundësi ka për shtimin e prodhimit.

Por rrethi ka mundësi që të mbjellë sipërfaqe hamullore akoma më të mëdha nga plani. Kjo u bë e mundur nga shirat e fundit, vetëm se është e nevojshme të zgjidhen më shpejt disa çështje si ajo e sigurimit të farës, që në mjaft kooperativa bujqësore mungon, si dhe marrja sa më shpejt e masave për korrjen e të lash-tave dhe transportimin e tyre që të ketë mundësi të fillohet menjëherë nga puna.

Ju jeni akoma prapa me mbjelljen e misrit, prandaj merrni masa urgjente për kryerjen sa më shpejt të kësaj detyre si dhe për të filluar nga puna për prashitjen e misrit jo një, por dy herë.

Në lidhje me blegtorinë vihet re se kooperativat bujqësore kanë shtuar krerët e gjësë së gjallë. Në fillim të këtij viti ato kishin 750 lopë, — 27 500 dhen, — 6 000 dhi, — 690 bletë, — 6 800 shpendë, — 150 dosa etj. Po megjithëkëtë, anëtarët e kooperativave në oborret kooperative kanë më tepër bagëti nga kooperativat. Ato sot kanë 3 500 lopë, 40 800 dhen dhe 25 900 dhi. Shtimi i krerëve të bagëtive mbetet edhe për të ardhshmen një detyrë me rëndësi, pasi, siç duket nga këto shifra, sot mesatarisht çdo kooperativë ka rreth 12 lopë, — 450 dhen, — 100 dhi dhe 10 bletë. Përveç kësaj, 12 kooperativa te ju nuk kanë fare ferma të lopëve dhe 24 nuk kanë ferma të dosave. Në këtë drejtim duhet vazhduar akoma fushata për shtimin e krerëve të bagëtive.

Nuk duhet luftuar vetëm për shtimin e krerëve, por edhe për shtimin e prodhimit të qumshtit. Realizimi i kësaj detyre kërkon sigurimin e ushqimit të bollshëm,

ashtu siç e ka shtruar Komiteti Qendror i Partisë. Këtë vit rrethi i Gjirokastrës duhet të pregatitë 20 000 tonë silazh. Deri tani janë pregatitur 1 500 tonë, prandaj kini kujdes se keni akoma shumë për të bërë. Po çështja nuk paraqitet alarmante pasi pjesën më të madhe të silazhit ju e keni në detyrat për ta realizuar me misër hamullor që jeni duke e mbjellë tani. Sidoqoftë kini parasysh dhe mobilizoni mirë Partinë dhe fshatarësinë për këtë problem, se nuk është i lehtë për t'u zgjidhur. Mbjellja e misrit për silazh dhe silazhimi i tij me gjithë kalli në kohën e pjekjes qumësht-dyllë duhet të bëhet nga të gjitha kooperativat. Veç kësaj duhet të sigurohet edhe mbjellja e sa më tepër hasëlleve për të siguruar nevojat e ushqimit për dhentë në periudhën e dimrit.

Strehimi i gjësë së gjallë dhe sidomos i dhenve për kohën e dimrit duhet ta preokupojë më tepër organizatën e Partisë në rreth, pasi ka mjaft kooperativa që i kanë strehuar keq dhe kanë pasur dëmtime të shumta çdo vit.

Mungesa ka te ju edhe në lidhje me ndërzimin artificial. Disa stacione ndërzimi si ai i Libohovës etj., nuk funksionojnë. Kështu plani i ndërzimit deri tani është realizuar rreth 12 për qind. Prandaj edhe në këtë drejtim duhet të merrni masa për realizimin e kësaj detyre të rëndësishme. Një kujdes më i madh duhet treguar për ruajtjen e kafshëve të racës, pasi në disa kooperativa si p.sh. në kooperativën «Asim Zeneli» gjendja nuk është e mirë dhe shumë desh të racës janë të sëmurë. Kjo nuk i lejohet kësaj kooperative që është nga më të përparuarat, prandaj duhet të merren masa që këto kafshë të shërohen.

Unë pyeta në fshatrat e Dropullit dhe të Lunxhërisë, që vizitova, për punën e brigadave. Atje më treguan se i kanë përgatitur mirë planet e prodhimit të brigadave, d.m.th. brigada di përse lufton. Po akoma mjaft kooperativa të tjera bujqësore, si ajo e Libohovës, e Lazaratit dhe disa të Dropullit të Sipërm, nuk i kanë bërë planet e prodhimit të brigadave. Në këtë mënyrë ato nuk mbajnë përgjegjësi për realizimin e prodhimit dhe kështu nuk mund të ruhet interesi material i anëtarëve, nuk zbatohet vendimi i qeverisë mbi shpërbimin e anëtarëve.

Gjithashtu nuk tregohet kujdes i duhur në shpërndarjen e paradhënieve për anëtarët e kooperativave bujqësore si nga kooperativat, ashtu dhe nga shokët përgjegjës të rrethit. Kur janë mundësitë duhet të mos kursehen të hollat. Kooperativat e rrethit tuaj, sipas shifrave që më dha Banka e Shtetit, kanë gjendje në arkë rreth 7 milion lekë. Nga kjo del se janë krijuar mundësitë për shpërndarjen më të rregullt të paradhënieve. Ashtu sikurse punëtorëve që marrin rrogën bile dy herë në muaj, edhe anëtarëve të kooperativave u vjen mirë dhe kënaqen kur marrin paradhënie, prandaj tani duhet të rregullohet kjo çështje.

Pjesëmarrja e gruas në punët bujqësore nuk është vënë në rrugën që duhet. Po ka edhe disa shkaqe që bëhen pengesë për këtë çështje, siç është ngritja e çerdheve. Ky problem duhet të zgjidhet në bazë të kushteve tona konkrete. Le të shfrytëzojmë kushtet tona duke përgatitur qoftë dhe tenda prej gjethesh në hijen e pemëve, ku fëmijët të qëndrojnë verës në ajër të pastër, nën kujdesin e grave të përshtatshme të

caktuara për këtë punë. Kështu gratë, duke siguruar fëmijët në këto çerdhe, do të jenë të qeta për të marrë pjesë në shkollë më të gjerë dhe të realizojnë më shumë ditë-pune në kooperativa.

Pregatitja profesionale e kuadrove të kooperativave bujqësore duhet të jetë akoma më shumë nën kujdesin e komitetit të Partisë. Sot në rrethin tuaj ka 42 kryetarë dhe 110 brigadierë, pa kaluar në kurset dhe shkollat e kooperativave. Mua më bëri përshtypje shumë të mirë pregatitja e disa kryetarëve kooperativash dhe njohja mirë e problemeve nga ana e tyre. Këta ishin nga ata që kanë bërë kurse. Prandaj ky problem duhet parë më me kujdes. Zhvillimi dhe lulëzimi i bujqësisë në vendin tonë, kërkon, veç të tjerave, kuadro të shumtë teknikë, të mesëm e të lartë. Ndryshe nuk mund të sigurohen rendimentet që parashikon Partia nga kulturat e ndryshme. Kur ne të kemi bonifikuar të gjitha fushat tona, kur të arrijmë që të sigurojmë ujitjen e sipërfaqeve shumë më të mëdha se tani, kur të kemi ngritur uzinat e plehrave kimike etj., ne duhet të kemi pregatitur qysh më parë edhe njerëzit që do t'i shfrytëzojnë të gjitha këto pasuri që do të krijojë puna e lirë e popullit tonë.

Prandaj duhet të plotësohen sipas planit kontingjentet që kërkohen në kurset dhe në shkollat për të gjithë sektorët e bujqësisë. Çdo kooperativë bujqësore duhet të ketë një plan të vetin ku të parashikohet për çdo vit pregatitja e kuadrove që do t'i nevojitet dhe të mos i lihet kjo barrë vetëm shtetit. Shokët që drejtojnë në kooperativa bujqësore duhet ta kuptojnë mirë rëndësinë e ngritjes së nivelit arsimor e kultural të kuadrove.

Sot isha në fushën e Erindit. Atje ishin mbledhur të gjithë kuadrot e Lunxhërisë, kuadro të mirë, të regjur në luftën për realizimin e detyrave dhe të gjallë, pa le pastaj populli aq i mrekullueshëm i kësaj krahine. Nga biseda që bëmë me shokët e Lunxhërisë doli se shumica e kodrave ka mundësi që në të ardhshmen e afërt të mbushen me vreshta, me fiq, me dardha etj. të cilat vendi atje i prodhon shumë. Toka është bujare dhe të jep shumë po ta punosh si duhet. Tani ka ardhur koha që duke e punuar mirë të marrim sa më shumë prej saj. Pra perspektiva shumë të mira zhvillimi ka edhe kjo krahinë ku më parë thoshin se nuk mund të bëhet asgjë. Kurse atje do të zhvillohen shumë frutikultura, blegtoria, duhani etj.

Të njëjtën gjë ne vumë re edhe në fshatrat e Dropullit. Atje ka një popull të mrekullueshëm, të dashur, të zgjuar dhe të lidhur shumë ngushtë me Partinë. Ne kemi qenë edhe herë të tjera atje, po tani njeriu sheh atje ndryshime të mëdha. Ju qeshte fytyra njerëzve, burrave, grave dhe fëmijëve të fshatrave që vizituam. Populli i Dropullit e do me shpirt Partinë, sepse sheh se vetëm pas Çlirimit, në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë, jeta u bë më e mirë. Përveç kësaj, populli shikon edhe perspektivën e shkëlqyer dhe ka besim në këtë, pasi çdo gjë që thotë Partia, nuk vonon dhe realizohet. Prandaj fshatarësia e Dropullit, si e gjithë fshatarësia e vendit tonë, punon me të gjitha forcat për zbukurimin e jetës së saj.

Në Dropull shumë gjëra janë bërë deri tani, po si kudo edhe atje shumë gjëra të tjera mbeten për t'u bërë në të ardhshmen, në drejtim të shtimit të prodhimit

të kulturave të arave dhe të rëndimenteve në blegtori, në shtimin e frutikulturës dhe të duhanit.

*Pastaj shoku Enver Hoxha bëri një pasqyrë të zhvillimit të gjendjes ndërkombëtare të kohëve të fundit.*

*Më së fundi shoku Enver preku disa probleme të punës së Partisë. Partinë ne e kemi të fortë, tha ai, dhe unitetin e saj e kemi të çelniktë. Pikëpamje të huaja në Partinë tonë nuk ka. Te ne ka vetëm mbeturina mikroborgjeze, po ato nuk shkojnë në planin politik dhe ideologjik, ato janë si disa ferra nëpër këmbët e anëtarëve të Partisë që mund të pastrohen me anën e kritikës dhe të autokritikës. Kritikën ka komunistë që e presin drejt, po ka edhe nga ata që nuk e presin mirë. Por, kur vjen çështja për mbrojtjen e vijës dhe të unitetit të Partisë, kur vjen çështja për mbrojtjen e interesave të popullit dhe të Partisë, anëtarët e Partisë sonë qëndrojnë të bashkuar fort si çeliku.*

Ju, si drejtues të organizatës së Partisë në rreth, e kuptoni se në Parti rëndësinë më të madhe se çdo gjë tjetër e ka uniteti i saj. Ne duhet të luftojmë gjithnjë që ta ruajmë dhe ta forcojmë akoma më shumë këtë unitet të fortë të Partisë sonë. Kjo do të thotë që ne të mos lejojmë të futen në Parti pikëpamje të shtrembra oportuniste dhe revizioniste. Në këtë çështje ne Partinë e kemi të pastër. Por, siç thashë, ekzistojnë akoma në ndërgjegjen e komunistëve shumë mbeturina mikroborgjeze, që, në rast se mungon një punë e shëndoshë ideologjike dhe nuk zhvillohen kritika dhe autokritika në nivel të lartë, depërtojnë sëmundje në Parti, që, ashtu sikurse sëmundjet në organizmin e njeriut, zhvillohen gradualisht, derisa, po të mos merren

masat në kohën e duhur, bëhen një rrezik serioz për shëndetin e njeriut. Edhe mbeturinat mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve janë si mikrobi që, po të mos luftohet në kohën e duhur, e bren ndërgjegjen dhe e dëmton. Prandaj duhet të bëjmë kujdes që Partinë ta mbajmë kurdoherë të pastër nga këto gjëra, ashtu sikurse e kemi.

Në radhë të parë ju, shokë udhëheqës, duhet të bëni përpjekje për të mësuar teorinë marksiste-leniniste. Kemi pasur vështirësi dhe përsëri kemi akoma për të kapërcyer disa vështirësi në lëmin e studimit të marksizëm-leninizmit, po Komiteti Qendror mendon se tani në Partinë tonë nuk është më situata e dikurshme. Kuadrot tanë kanë fituar një eksperiencë të madhe në praktikë që nuk është veçse zbatimi i teorisë marksiste-leniniste. Sidoqoftë kuadrot tanë po mësojnë në këtë drejtim, po puna e bërë është e pamjaftueshme dhe duhen bërë akoma më shumë përpjekje. Teoria marksiste-leniniste duhet të na udhëheqë në çdo hap të punës sonë dhe atëherë të jemi të sigurtë se punët do të na shkojnë mirë, Partinë do ta kemi të fortë dhe asnjë përpjekje e armiqve nuk mund dhe nuk do të arrijë të na dëmtojë.

Dëshiroj të flas diçka në lidhje me organizimin e ri në Parti. Në përgjithësi ky organizim ka dhënë rezultate, po udhëheqja e Partisë në qendër dhe në bazë duhet të ketë kurdoherë parasysh ndihmën konkrete që duhet t'i jepet bazës, në radhë të parë nëpërmjet instruktorëve dhe sekretarëve të komiteteve të Partisë të zonave. Drejtimi si duhet nga ana e byrosë së komitetit të Partisë të rrethit dhe ndihma që duhet t'u japë komiteti i Partisë i rrethit sekretarëve që drej-

tojnë zona të caktuara, duhet të organizohen jo vetëm nëpërmjet mbledhjeve të rregullta dymujore që bën plenumi. Ndiheja juaj më e vlefshme si anëtarë plenumi, dhe këtë funksion të rëndësishëm udhëheqës që ju ka besuar Partia ju nuk duhet ta harroni për asnjë çast, është që të kërkoni nga instruktorët e zonave të jenë në kontakt të ngushtë me ju. Instruktorët e Partisë duhet të shikojnë në personin tuaj udhëheqësin e organizatës së Partisë së rrethit. Udhëheqja e rrethit nuk duhet parë vetëm në mbledhjet e byrosë ose të plenumit, po te secili nga ju që Partia ju ka zgjedhur. Te ju ata duhet të shohin udhëheqjen e Partisë. Dhe duke u nisur nga ky funksion ju t'i ndihmoni ata, veçanërisht sekretarin e parë dhe sekretarët e tjerë të komitetit të Partisë të rrethit, me këshillat dhe me vërejtjet tuaja. Në këtë drejtim nuk duhet të pritni sa të bëhet mbledhja e plenumit për t'i ngritur çështjet. Kur shihni se ka probleme, për zgjidhjen e të cilave duhet të merren masa të menjëhershme nga ana e sekretarëve ose e sekretarit të parë, ju pa vonesë duhet të mos i mungoni kësaj pune. Kjo metodë pune të futet në praktikën e punës suaj të përditshme, e cila duhet të jetë aktive dhe luftarake.

Ju duhet të ndihmoni sekretarët e zonave në organizimin e punës së tyre në lidhje me sekretarët e organizatave-bazë ose me instruktorët e zonës. Kjo ka shumë rëndësi për të parë se si i shtron me ta problemet sekretari ose instruktori i zonës, si raportojnë përpara këtyre shokët e organizatave-bazë. Qëllimi është që instruktorët dhe sekretarët e komitetit të Partisë të



zonës të jenë nën kujdesin dhe ndihmën e gjithanshme të udhëheqjes së Partisë në zonën e tyre.

Në këtë drejtim ne jemi pak të dobët. Shokët e udhëheqjes i tërheqin më shumë problemet ekonomike. Është e vërtetë se këto probleme kanë rëndësi të madhe jetike për vendin tonë, por edhe problemet e tjera janë të rëndësishme, duke filluar që nga ato të arsimit e të kulturës e deri te problemet e shëndetësisë, prandaj edhe këto nuk duhen neglizhuar.

Byroja dhe komiteti i Partisë duhet të kenë kujdes që sekretarët e zonave të mos bëhen specialistë vetëm për një çështje. Ata duhet patjetër t'i njohin mirë të gjitha problemet e zonës së tyre, po ata duhet të njohin njëkohësisht edhe situatën e gjithë rrethit. Prandaj ata nuk mund të mos interesohen edhe për zonat e tjera të rrethit. Për këtë qëllim në rrethin e Fierit sekretarët e zonave i dërgojnë çdo muaj për 4-5 ditë në zona të tjera të rrethit për një problem të caktuar, me qëllim që të shkëmbejnë eksperiencën dhe që sekretari të mos harrojë çështjen se është përgjegjës përpara plenumit, jo vetëm për një zonë, por për të gjithë rrethin dhe për të gjitha problemet. Prandaj sekretarët e komitetit të Partisë duhet të njohin mirë të gjithë rrethin, në radhë të parë të njohin problemet e zonës së caktuar.

Është fakt se organizata e Partisë në rrethin e Gjirokastrës në përgjithësi punon mirë. Natyrisht, ju keni shumë për të bërë akoma në këtë drejtim, sidomos për të mbyllur me sukses planin e këtij viti. Ju, me disa përjashtime të vogla, nuk paraqiteni keq me realizimin e planeve të ndërmarrjeve ekonomike. Por ju, sikurse fola pak më parë, jeni prapa me disa probleme të buj-

qësisë për të cilat duhet të keni kujdes të mobilizoni dhe të merrni masat e nevojshme që fundi i vitit t'ju gjejë me plan të realizuar.

Më bëri përshtypje këtu edhe fakti se drejtuesit e Partisë dhe të pushtetit në rreth mbajnë lidhje të shëndosha me punonjësit. Kjo është një nga karakteristikat dalluese të partisë marksiste-leniniste që ne duhet ta ruajmë dhe ta zhvillojmë.

*Duke përfunduar shoku Enver Hoxha theksoi se në të gjitha drejtimet puna e Partisë sonë është e shkëlqyer, e drejtë, e mençur. Këtë punë nuk e bëjnë një, dy ose pesë vetë, po e bën mendja dhe forca e të gjithë anëtarëve të Partisë, që nga më i thjeshti e deri te udhëheqësit. Pra, realizimi me sukses i detyrave varet nga puna dhe urtësia e gjithë Partisë.*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 153 (3368), 26 qershor 1959*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», Nr. 153 (3368), 26 qershor 1959*

**NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË KUÇ  
ME RASTIN E 15-VJETORIT TË ÇLIRIMIT  
TË KRAHINËS SË KURVELESHIT**

25 qershor 1959

Të dashur shokë, vëllezër dhe motra të Kurveleshit,

Komiteti Qendror i Partisë na ka dërguar mua dhe shokun Shefqet Peçi ta gëzojmë së bashku përvjetorin e festës së Çlirimit të krahinës suaj dhe t'ju shprehim përshëndetjet më të nxehta dhe dashurinë e Komitetit Qendror të Partisë e të qeverisë sonë, juve, luftëtarëve të lavdishëm të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit të socializmit.

Nuk ka shqiptar që të mos mburret me popullin heroik, me traditat patriotike dhe revolucionare të krahinës suaj. Traditat patriotike janë rrënjësorë thellë në zemrat e popullit të kësaj krahine gjatë gjithë historisë së popullit shqiptar. Malet e larta kreshnike të Kurveleshit, ky Shur i Kuçit kanë buçitur jo vetëm nga zhurma e lumit, por edhe nga krisma e pushkëve të stërgjyshërve, gjyshërve, prindërve, vëllezërve dhe motrave tona që kanë luftuar me heroizëm kundër shkelësve të huaj, kundër atyre që e kishin pushtuar ose që kërkonin ta pushtonin atdheun tonë dhe ta

zhduknin popullin shqiptar nga faqja e dheut. Historia e popullit tonë, veçanërisht historia e krahinës suaj, është e mbushur plot me luftëra për liri dhe pavarësi. Populli luftëtar i fshatrave të kësaj ane ka thurur e ka kënduar këngët më të bukura për trimëritë e të parëve tanë. Edhe sot e kësaj dite kujtohet kënga e Gjolekës ku pasqyrohet shpirti luftarak i popullit të Kurveleshit:

«Gjoleka në Shur të Kuçe,  
me fustanen mbi gju hajdutçe;  
pallën e larë me cullufe,  
e mban Gjoleka mbi supe.

..... »

Me këtë këngë ne kuptojmë se sa vështirë e kishin armiqtë e popullit tonë të kalonin në këtë zonë, po edhe kur futeshin ata gjenin vdekjen nga armët e gjyshërve tuaj trima. Këto tradita të lavdishme revolucionare frymëzuan të gjithë popullin dhe rininë tonë në Luftën Nacionalçlirimtare që u udhëhoq nga Partia jonë e lavdishme e Punës dhe bëri të mundur Çlirimin e Shqipërisë.

Partia e Punës e Shqipërisë është pjella e popullit. Ajo me të vërtetë u krijua në vitin 1941, po themelet e saj janë shumë më të vjetra. Ato janë të lidhura me gjakun e derdhur në shekuj nga populli ynë për lirinë e atdheut, me shpresat e tija për një jetë të lirë, të pavarur dhe të begatshme. Por shpresat për një jetë më të mirë për popullin tonë u ngjallën në epokën e triumfit të marksizëm-leninizmit, kur i madhi Lenin për herë të parë në histori vuri në jetë teorinë e lavdishme të Marksit dhe të Engelsit, bëri që të triumfojë

Revolucioni i madh Socialist i Tetorit dhe të krijohet i pari shtet socialist në botë. Ishte Partia e lavdishme e bolshevikëve ajo që ngriti në revolucion punëtorët heroikë dhe fshatarët e mjeruar të Rusisë cariste, të cilët thyen përgjithmonë kapitalizmin, shkatërruan ndërhyrjet ushtarake të të gjitha fuqive të mëdha dhe krijuan shtetin e madh sovjetik. Jehona e kësaj ngjarjeje historike për fatet e njerëzimit arriti edhe në vendin tonë. Populli shqiptar i shtypur e i shfrytëzuar e përkrahu fitoren historike të proletariatit të Rusisë dhe u ushqye me idetë jetëdhënëse të Revolucionit të Tetorit. Partia jonë që ka dalë nga gjiri i popullit, është farkëtuar me traditat më të mira të popullit tonë dhe është mburrur e armatosur me idetë e mëdha të Marksit dhe të Leninit. Ajo e udhëhoqi popullin tonë në luftën për liri.

Lufta Nacionalçlirimtare i kushtoi shumë shtrenjtë popullit tonë, por ai e di se sakrificat e panumërta që bëri, humbja e jetës së mijëra e mijëra bijve dhe bijave më të mira të popullit tonë, djegia e fshatrave dhe e shtëpive tona, shkatërrimi i ekonomisë na u imponuan nga ata që na ranë në qafë, që pushtuan vatrat tona, nga fashistët italianë e gjermanë dhe nga tradhtarët e vendit që bashkëpunuan me ta. Situata e krijuar e detyroi të gjithë popullin tonë të ngrihej i tëri në këmbë për të fituar lirinë. Vetëm nga krahina e Kurveleshit u ngritën dhe rrokën armët me mijëra burra dhe gra që luftuan për lirinë e Shqipërisë. Me mijëra nga bijtë dhe bijat më të mira të vendit tonë, prej të cilëve shumë kanë qenë edhe nga krahina e Kurveleshit, dhanë jetën

në luftën e madhe të Çlirimit. Kujtimi i tyre nuk do të harrohet kurrë, brez pas brezi do të nderohen heronjtë e popullit tonë që dhanë jetën në momentet më të vështira për atdheun.

Populli shqiptar nuk do t'i harrojë kurrë heronjtë e tij si Asim Zenelin, Mustafa Matohitin, Memo Meton dhe shumë e shumë të tjerë që udhëhoqën me trimëri të rrallë çetat dhe brigadat tona të lavdishme partizane dhe dhanë jetën për një të ardhshme të lumtur të popullit shqiptar që ai të mos shihte më luftë e gjakderdhje, po të rronte i lumtur e i qetë në fabrikat, në tokën dhe në shtëpinë e tij. Këta heronj si shqiponjat e maleve tona luftuan për një Shqipëri demokratike dhe socialiste.

Gjaku i derdhur nuk shkoi dëm si në të kaluarën kur baballarëve tanë, megjithëse luftonin për lirinë e atdheut dhe vriteshin, fitoren ua rrëmbejnë nga duart bejlerët dhe agallarët, njerëzit si Ahmet Zogu dhe veglat e tija që sundonin në kurriz të popullit dhe i pinin gjakun. Nuk ishte faji i gjyshërve tanë që nuk e siguronin dot lirinë, me gjithë heroizmat e tyre gjatë shekujve. Kjo gjë në të kaluarën ishte e pamundur të realizohej, sepse populli ynë nuk kishte një udhëheqje besnike për mbrojtjen e interesave të tij të larta. Kjo udhëheqje u krijua vetëm në Luftën Nacionalçlirimtare dhe ishte Partia jonë, Parti e popullit punonjës. Në sajë të luftës heroike të popullit tonë dhe të luftës legjendare të popujve të Bashkimit Sovjetik ne fituam lirinë dhe vendosëm pushtetin popullor. Por fitoret e mëdha historike, liria, pavarësia dhe sovraniteti i atdheut duheshin ruajtur dhe njëkohësisht duhej ndërtuar

edhe jeta e re me forcën, me diturinë e popullit dhe me zotësinë e Partisë. Për këtë qëllim populli ynë mobilizoi të gjitha forcat e tija.

Ju mbani mend shokë se porsa u çlirua Shqipëria, armiqtë filluan të profetizonin se i kishim ditët të shkurtëra, se njerëzit e dalë nga gjiri i popullit nuk dinë të drejtojnë. Por sa shumë u gabuan këta njerëz! Ata mendonin se vetëm kapitalistët janë të zgjuar, se me zgjuarësinë e tyre ata i kishin vënë gjithë ato pasuri. Pasurinë, kapitalistët e vënë duke shfrytëzuar popullin. Kush i ka ngritur vallë pallatet dhe fabrikat në vendet kapitaliste? Krahu i punëtorëve, zotësia e tyre. Po bejlerëve dhe agallarëve tanë kush ua vuri pasurinë? Djersa e popullit, zotësia e popullit tonë, e bujqve, e barinjve dhe e punëtorëve tanë. Armiqtë e popullit vetë nuk bënin asgjë, vetëm se kishin në dorë pushtetin dhe me ndihmën e xhandarit, me kamxhik dhe plumb, shfrytëzonin dhe i thithnin gjakun popullit.

Por ja, populli ynë, që mori fuqinë në dorë, brenda 15 vjetëve jete të lirë, ka bërë të gjitha këto mrekulli. Vetëm 15 vjet kanë kaluar dhe vendi ynë ka bërë një hap aq të madh përpara në zhvillimin e ekonomisë, të kulturës dhe të rritjes së mirëqenies së masave punonjëse, sa që regjimet antipopullore as për qindra vjet nuk mund t'i bënin. Gjatë këtyre 15 vjetëve ne kemi ngritur një numër të madh fabrikash, kemi ngritur industrinë tonë të re dhe moderne. Tani ne vishemi me stofat e prodhuara në kombinatin tonë, që e drejtojnë djemtë dhe vajzat tuaja, ata që deri dje nuk dinin as të shkruanin as të lexonin. Por ata i mësoi Partia të ecin përpara. Shumë nga vajzat tona, që përpara s'dinin

asgjë, por rrinin të mbyllura ose merrnin kërrabën në dorë dhe ruanin dhinë, sot në këtë kombinat drejtojnë nga 10 e deri në 20 makina moderne të tekstileve, nga më të komplikuarat. Kështu ndodh edhe në të gjitha fushat e tjera të aktivitetit në vendin tonë, kurse mbeturinat e agallarëve dhe të bejlerëve, që ishin mësuar të ushqeheshin me punën e të tjerëve, tani kanë mbetur si kërcunjt.

Bujqësia dikur në gjendje të mjeruar, tani ka ndryshuar faqen. Pas disa vjetësh ajo do të jetë akoma më e përparuar se tani dhe atdheu ynë do të bëhet një vend i begatshëm.

Në krahinën tuaj të Kurveleshit ju e keni realizuar qind për qind kolektivizimin, e vetmja rrugë shpëtimi për fshatarësinë tonë, që do të na sigurojë të ardhshmen e ndritur dhe bollëkun. Për këtë arsye fshatarësia jonë e ka përqaftuar me gjithë dëshirë këtë rrugë. Ne mendojmë se do të duhen edhe disa vjet akoma dhe kolektivizimi do të përfundojë krejtësisht.

Krahas kolektivizimit duheshin ndërmarrë punime për të bërë që toka jonë të prodhonte më shumë nga sa kishte prodhuar deri tani. Për këtë qëllim Partia dhe qeveria kanë marrë dhe do të marrin masa të ndryshme, kanë harxhuar dhe do të harxhojnë akoma miliarda, në mënyrë që fushat dhe kodrat e vendit tonë t'i kthejmë në kopshte, që të prodhojnë më shumë për popullin.

Ju e dini se kudo në vendin tonë po bëhen punime të mëdha bonifikimi. Nga këto ne do të përfitojmë mijëra hektarë toka të reja, do të përmirësojmë me dhjetëra mijë hektarë toka që më parë ishin moçale dhe



gjysmëmoçale. Të gjitha këto toka do të japin dyfishin e rendimenteve që marrim sot, bile do të ketë toka nga të cilat do të marrim edhe trefish. Nuk do të duhen më shumë se 7-8 vjet akoma kur në Shqipëri nuk do të ketë më fusha të pabonifikuara. Kjo është një ndërmarrje kolosale, që po realizohet me sukses në vendin tonë.

Megjithëse në vendin tonë po ndërtohen vepra të mëdha, për ngritjen e të cilave po investohen miliarda, niveli ekonomik i gjithë popullit tonë nuk ka mbetur në vend; përkundrazi, mirëqenia e tij rritet dita-ditës. Kjo ndodh se Partia dhe qeveria e popullit punojnë si ajo nikoqirja e mirë dhe nuk i zë gjumi për administrimin sa më të mirë dhe frytdhënës të pasurisë së popullit.

Ju e dëgjuat ç'ndodhi para disa ditësh në Vurg. Atje të gjithë lumenjtë që përmybnin fushat e Vurgut dhe të Mursisë, tani kalojnë në det nëpër një shtrat të vetëm. Këtë vepër të madhe e bëri forca e Partisë, forca dhe mobilizimi i fshatarësisë sonë. Regjimi antipopullor i Zogut në asnjë mënyrë nuk mund të ndërmernte vepra të tilla. Ai filloi të bënte gjoja një kanal në Kavajë dhe ai vetëm prej disa kilometrash, por kanali nuk u mbarua kurrë vetëm se u bë një burim ku sundimtarët gjakpirës të asaj kohe patën rast të vjedhin disa miliona. Kurse pas Çlirimit, brenda një kohe fare të shkurtër, janë bonifikuar dhe po bonifikohen të gjitha fushat, duke zhdukur kështu moçale dhe kënetat të tëra shekullore.

Një rëndësi jashtëzakonisht të madhe ka për ekonominë tonë blegtoaria. Ky sektor ka tradita kudo në vendin tonë. Ju, banorët e Kurveleshit e dini mirë zanatin e blegtorit, se jeni marrë gjithë jetën me të.

Por disa metoda të vjetëruara në trajtimin e bagëtive duhen hedhur poshtë. Ja, p.sh., përpara pleqhtë tanë thoshin se delja e ka brucin me vete, prandaj nuk e gjen gjë. Por nuk është kështu. Duke e trajtuar kësisoj delen, ajo nuk të jep atë që do. Prandaj ne duhet të tregojmë një kujdes më të madh në këtë çështje, në mënyrë që të shtojmë më shumë prodhimin e qumshit dhe të mishit.

Në kooperativën bujqësore të Bodrishtit, në Droll, ku ishim para disa ditësh dhe që nuk i kanë traditat tuaja në rritjen e blegtorisë, na thanë se nga një dhi marrin 115 litra qumësht në vit. U gëzuan shumë, duke marrë parasysh se ne kemi akoma fshatra ku mezi marrin nga një lopë 250 litra qumësht. Ky është një sukses i mirë i kësaj kooperative, që duhet vënë në dukje për të përfituar nga eksperiencia e saj edhe të tjerët.

Ju e dini se Partia jonë ka ndërmarrë disa punë të mëdha, siç është ajo e përmirësimit të racës nëpërmjet ndërzimit artificial. Miqtë tanë, Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, na kanë dhënë desh race të mirë. Këtë mundësi ne duhet ta shfrytëzojmë sa më shumë, për të përmirësuar delen e vendit, që të na japë më shumë lesh dhe të mirë, si dhe mish e qumësht më tepër. Por që të marrim atë që kërkojmë, duhet në radhë të parë të ushqehen mirë kafshët, ndryshe ato, qofshin edhe të racës më të mirë, nuk të japin dhe nga mungesa e ushqimit të mjaftueshëm do të degjenerojnë.

Tani, ju, fshatarët e Kuçit, jeni bashkuar në një kooperativë të vetme me Kallaratin dhe Bolenën. Ju

keni jetuar kurdoherë bashkë si vëllezër prej kohësh, në ditë të mira dhe të këqija dhe këtë fakt e dëshmon edhe kënga popullore:

«Kuç, Kallarat e Bolenë,  
Gjithë me Balilë u ngrenë,  
Në lum'e zunë dyfenë

Ju përpara bashkoheshit kur rreziku e kanoste krahinën tuaj. Kurse tani në pushtetin popullor ju vendosët të bashkoheni edhe ekonomikisht. Ky është një hap shumë i madh përpara. Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Lokalitetit tuaj, shoku Felek Lelaj foli për sukseset e mëdha të fshatrave të krahinës së Kurveleshit pas Çlirimit. Këto suksese janë me të vërtetë të mëdha, por ju mos u kënaqni me to, se janë pak në krahasim me ato që duhet të kemi. Në krahinën tuaj drejtimi kryesor i ekonomisë është blegtoria. Kjo është një pasuri e madhe. Prandaj i kushtoni kujdesin e duhur rritjes së dhenve dhe të dhive, pa harruar, natyrisht, lopët.

Në krahinën tuaj ka pasur kurdoherë kope të mëdha me bagëti. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare armiku shfarosi pjesën më të madhe të tyre, prandaj tani ne duhet të shtojmë edhe krerët, por rëndësi të madhe ka çështja e shtimit të prodhimit. Ju keni këtu kullota të mrekullueshme, por që të nxirren sa më shumë përfitime prej tyre, duhen mbajtur mirë dhe duhen pastruar, të qërohen ferrat dhe drizat, që në vend të tyre të mbijë bari për bagëtitë. Në Shqipëri, paralelisht me shtimin e blegtorisë, po ngushtohen kullotat, se shumë

toka po përdoren për mbjelljen e kulturave të ndryshme. Prandaj tani ka ardhur koha të ecim me llogari, të shohim se sa prodhime dhe të ardhura mund të japë një tokë me një kulturë dhe sa me një tjetër dhe të zhvillojmë ato kultura që na japin më shumë të ardhura që bagëtitë të mos hanë si përpara bar pa shkop. Shumë toka që shfrytëzoheshin si kullota tani na intereson t'i mbjellim me grurë, misër, vreshta, portokalle, limona etj.

Blegtorja për ekonominë tonë popullore ka një rëndësi të madhe, prandaj kullotat që do të kemi në dispozicion, t'i mbajmë sa më mirë, të mbjellim në to barëra shumëvjeçarë për ushqimin e bagëtive.

Për bagëtinë dhe bujqësinë, për të cilat me aq patos të madh ka thurur këngët më të bukura poeti ynë i madh i Rilindjes, Naim Frashëri, apo këngët që ka thurur vetë populli i krahinës së Kurveleshit, duhet të tregohet shumë kujdes.

Mund të ketë dhe ka akoma njerëz që thonë se është një punë e vështirë të bëhesh çoban. Puna e bariut nuk është e lehtë, por ajo është një punë e lavdishme. Tani kohët kanë ndryshuar, jeta e bariut mund të bëhet më e lehtë. Ai tani nuk është analfabet si përpara, mund të marrë librat me vete dhe, duke ruajtur bagëtitë, të lexojë për çdo gjë dhe të mësojë. Por njëkohësisht ai duhet të ndjekë me vëmendje më të madhe bagëtitë dhe të kujdeset për to ashtu si kujdeset nëna për fëmijën e vet. Unë jam i bindur se me një kujdes të tillë ju do të arrini të merrni më tepër prodhime blegtorale nga sa merrni sot. Ju duhet të tregoni kujdes gjithashtu edhe për strehimin e bagëtive.

Ne kemi pasur suksese edhe në punën për përmirësimin e racës së bagëtive nëpërmjet ndërzimit artificial. Nga një qëngj i racës, vetëm nga leshi mund të merren 500-600 lekë më shumë. Shikoni, pra, çfarë fitimi sigurohet nga përmirësimi i racës së bagëtive.

E njëjta punë bëhet edhe për rritjen e lopëve. Lopët tona, duke u kryqëzuar me demat e racës, do të arrijnë të na japin 2 500 edhe 3 000 litra qumësht në vit.

Shokë, kushtet e vendit tonë janë të tilla që pas 10-15 vjetësh ne do të kemi ecur shumë përpara. Kjo do të ndodhë me siguri, sepse tani ekonomia jonë nuk është si në periudhën e parë pas Çlirimit.

Ja, p.sh., në vjetët e parë pas Çlirimit ne kemi marrë më pak se 100 mijë tonë naftë. Në fund të këtij viti do të prodhojmë mbi 500 mijë tonë, kurse në fund të pesëvjeçarit të tretë parashikohet të marrim disa herë më tepër. Shikoni, pra, se si do të ecim këtej e tutje. Ne përpara nuk prodhonim stofa, Bashkimi Sovjetik na ndihmoi dhe ndërtuam kombinatin e tekstileve «Stalin» në Tiranë, që prodhon mbi 20 milion metra në vit. Popullsia e vendit shtohet vazhdimisht. Kjo na detyron që ta zgjerojmë industrinë tonë të tekstileve. Tani mundësitë ne i kemi për këtë gjë, prandaj në planin e ardhshëm pesëvjeçar kemi ndër mend të ndërtojmë një tjetër kombinat të tekstileve në qytetin e Beratit. Në të ardhshmen edhe te ne ka perspektiva zhvillimi i industrisë kimike, me anë të së cilës mund të prodhohen tekstile dhe artikuj të ndryshëm shtëpiakë të fortë, të bukur dhe shumë të lirë, duke shfrytëzuar lëndën e parë të vendit, naftën, gazin dhe kripën e detit.

Një rëndësi të madhe ka për vendin tonë shfrytëzimi i mineralit të hekurit. Në bashkëpunim me Bashkimin Sovjetik dhe me disa nga vendet e demokracisë popullore, tani ne jemi duke studjuar mundësinë e ngritjes së një uzine metalurgjike në Shqipëri<sup>1</sup>. Kjo do të jetë një pasuri shumë e madhe për vendin tonë.

Pra, Partia jonë i ka hapur perspektiva të mëdha popullit për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës dhe për ngritjen e pandërprerë të nivelit të jetesës së masave punonjëse.

Për t'ia arritur këtij qëllimi ne duhet të mësojmë gjithnjë më shumë. Mësimi duhet të shkojë krahas me punën. Për këtë janë hapur gjithë këto shkolla, kurse, teknikume dhe universiteti ynë. Prandaj të dërgohen në të gjitha këto shkolla njerëzit tanë, punëtorët dhe kooperativistët më të mirë për të mësuar.

Një çështje tjetër që dëshiroj t'ju rekomandoj juve, banorëve të Kurveleshit heroik, është që në kooperativat tuaja, megjithëse janë malore, t'i kushtoni një kujdes të veçantë hapjes së tokave të reja. Ju e keni realizuar shumë mirë planin e aprovuar, por duhet të keni kujdes se edhe në krahinën tuaj malore ka shumë rezerva në këtë drejtim. Janë të gjitha mundësitë që ju të hapni të gjitha kodrat e buta, që tani nuk shfrytëzohen, me qëllim që edhe prej tyre të marrim prodhime dhe të ardhura më shumë nga ç'mund të sigurojmë nga kullotat. Në tokat e hapura nëpër kodrat dhe pllajat, mbillni

---

<sup>1</sup> Si rezultat i prerjes së kredive dhe i bllokadës së egër që revizionistët hrushovianë i imponuan vendit tonë kjo uzinë nuk u ngrit. Kjo vepër e planit të pestë pesëvjeçar po ndërtohet nga populli ynë me ndihmën e RP të Kinës.

sa më shumë vreshta dhe pjergulla, fiq, arra etj. Këtu bile edhe ulliri mund të bëhet. Një kujdes të veçantë ju duhet të tregoni gjithashtu për mbjelljen e dardhave, që bëhen shumë në këtë vend dhe sidomos për shartimin e goricave, që këtu janë me shumicë.

Unë jam në dijeni se ju e keni realizuar planin e pemëve frutore dhe të pjergullave, por njëkohësisht kam marrë vesh se 60 për qind e tyre nuk kanë zënë. Ky fenomen nuk shihet vetëm në krahinën tuaj. Kjo ndodh për arsye se nuk i vihet kujdes i duhur ruajtjes së fidaneve pas mbjelljes dhe shërbimit të tyre, derisa ato të forcohen. Për bimët, bujku i mirë duhet të tregojë kujdes ashtu siç tregon për fëmijët, se edhe bimët preken nga sëmundje të ndryshme, dëmtohen nga kafshët që kalojnë mbi to, kanë nevojë për ujë e për shërbime. Prandaj duhet të merren masa në këtë drejtim, që të mos na vejë mundimi kot, pasi tani ne çdo gjë e bëjmë për vete.

Kooperativat tuaja malore nuk duhet të jetojnë vetëm me blegtori. Sigurisht kjo do të jetë baza kryesore e zhvillimit ekonomik të tyre, por ju duhet të mendoni të zhvillonin edhe aktivitete të tjera ndihmëse, që do t'ju sigurojnë të ardhura të mëdha. Prandaj të punohet që tokat e reja t'i hapni menjëherë dhe të mos prisni t'ju vijë mekanizma, por me kazma e lopata.

Unë mendoj, shokë të dashur, se ju i keni të mjaftueshme forcat e krahut, prandaj mobilizohuni sa më shumë për realizimin e kësaj detyre të rëndësishme, që do t'ju forcojë ekonominë dhe do t'ju shtojë të ardhurat. Ata që akoma nuk e kanë kuptuar si duhet çështjen e punës, ta kuptojnë se puna është nder, puna

forcon shëndetin dhe siguron lumturinë e njeriut. Përkundrazi, papunësia sjell varfërinë.

Në rast se ju, kooperativistët, do të prodhoni sasi më të mëdha artikujsh bujqësorë e blegtoralë dhe me kosto të ulët, jo vetëm do të keni për të plotësuar të gjitha nevojat tuaja, por shumë prej tyre do t'ju tepronë për t'i shitur në sasi çdo vit e më të mëdha. Shtimi i prodhimit dhe ulja e koston, si në industri ashtu dhe në bujqësi, do të krijojnë mundësitë që të ulen çmimet dhe populli do të rrojë gjithnjë më mirë. Po për të krijuar një situatë të tillë, duhet punuar në mënyrë të organizuar. Partia ka bindje se ju do ta realizoni këtë detyrë, pasi populli ynë është një popull i mrekullueshëm. Ai bëri të mundur të kapërcehen me sukses gjatë këtyre 15 vjetëve situata shumë të vështira politike dhe ekonomike dhe të arrihen këto suksese që i shohim me sytë tanë.

Ju e dini se revizionistët jugosllavë janë përpjekur me të gjitha forcat për të shkatërruar Partinë dhe pushtetin tonë popullor. Mirëpo Partia jonë qëndroi e patundur dhe i mposhti me sukses të gjitha intrigat dhe planet e revizionistëve jugosllavë, ajo i dërrmoi dhe i asgjësoi përpjekjet e veglave të tyre dhe të armiqve të tjerë të Partisë sonë dhe të popullit shqiptar. Partia jonë ka luftuar kurdoherë me të drejtë çdo veprim antimarksist të revizionistëve jugosllavë dhe do të jetë gjithnjë vigjilente për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të interesave të popullit e të Partisë sonë.

Situata ndërkombëtare paraqitet e favorshme për vendet e kampit tonë të socializmit. Çdo vit që kalon ne bëhemi gjithnjë më të fortë.



Forca jonë qëndron në unitetin e çelniktë të popullit tonë rreth Partisë marksiste-leniniste dhe qeverisë sonë popullore.

Kaloi dhe s'kthehet më kurrë koha kur Shqipëria ishte një monedhë shkëmbimi dhe plaçkë tregu në duart e fuqive imperialiste. Sot atdheu ynë është pjesëtar i kampit të socializmit dhe është bërë i paprekshëm.

Ne jemi një popull paqësor. Edhe të gjitha vendet e tjera të kampit tonë e duan dhe luftojnë për forcimin e paqes në botë, sepse ne ndërtojmë jetën e re, ne nuk ka pse të na interesojë lufta, prandaj jemi kundër luftërave grabitqare që bëjnë imperialistët, me qëllim që të realizojnë fitime me djersën dhe gjakun e popujve.

Qeveria jonë i ka paralajmëruar qeveritë e Italisë dhe të Greqisë të mos ndërtojnë në vendet e tyre baza për lëshimin e raketave. Ne kemi deklaruar se në vendin tonë nuk ka baza të tilla. Por në rast se fqinjët tanë do të ndërtojnë baza dhe do të vendosin në to armë të tilla vdekjeprurëse, atëherë ne e përsëritim se do të jemi të detyruar të marrim masat përkatëse.

Prandaj, shokë, një nga detyrat më të rëndësishme që na vë Partia përpara është të jemi vigjilentë ndaj veprimeve të armiqve dhe kurdoherë të pregatitur kundër çdo veprimi që ata mund të ndërmarrin.

Partia jonë do t'i forcojë vazhdimisht lidhjet me popullin, sepse pa këto lidhje Partia nuk mund të jetojë, ashtu sikurse edhe populli nuk mund të jetojë i lirë dhe të ndërtojë jetën e tij të lumtur e të begatshme pa Partinë. Parti e popull përbëjnë një të tërë të vetme. Prandaj ta duam Partinë si shpirtin, ta mbrojmë atë si

jetën tonë, të jemi të bashkuar si mishi me thoin me Partinë, sepse dëshirat dhe e ardhshmja e lumtur e popullit në këtë mënyrë do të realizohen sa më parë.

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Partia jonë heroike e Punës!

Të rrojë dhe të përparojë çdo ditë e më shumë populli heroik i Kurveleshit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 154 (3369), 27 qershor 1959*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», Nr. 154 (3369), 27 qershor 1959*

**PËRSHËNDETJE NXËNËSVE DHE PEDAGOGËVE  
TË SHKOLLËS SË PARTISË «V. I. LENIN» ME  
RASTIN E PËRVJETORIT TË THEMELIMIT  
TË SHKOLLËS**

**16 shtator 1959**

**DREJTORISË SË SHKOLLËS SË PARTISË «V. I. LENIN»  
GJITHË PEDAGOGËVE DHE NXËNËSVE TË KËSAJ SHKOLLE**

Të dashur shokë,

Me rastin e përvjetorit të themelimit të Shkollës së Partisë «V.I.Lenin», Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, ju përshëndet ju shokë drejtues, pedagogë e nxënës dhe ju uron suksese sa më të mëdha në punën tuaj të frytshme dhe me shumë përgjegjësi që ju ka besuar Partia!

Hapja e Shkollës së Partisë «V.I.Lenin» shënon një ngjarje me rëndësi të madhe në historinë e Partisë sonë të lavdishme.

Gjatë këtyre vjetëve, Shkolla e Partisë «V. I. Lenin» ka dhënë një kontribut të çmuar në përgatitjen marksiste-leniniste të kuadrove të Partisë sonë. Qindra kuadro kanë kryer me sukses studimet në shkollën dyvjeçare e trevjeçare dhe në kursin njëvjeçar pranë Shkollës së Partisë. Në shkollë ata kanë marrë njohuritë bazë të

shkencës marksiste-leniniste, janë njohur me veprat e pavdekshme të mësuesve të mëdhenj të marksizëm-leninizmit, kanë marrë mjaft njohuri mbi drejtimin konkret të degëve të ndryshme të ekonomisë, kanë zgjeruar horizontin e tyre të përgjithshëm kultural, ata janë bërë më të aftë për zgjidhjen me sukses të detyrave që u ka besuar Partia.

Marksizëm-leninizmi është shkenca e ligjeve të zhvillimit të natyrës dhe të shoqërisë, shkenca e revolucionit të masave të shtypura e të shfrytëzuara, shkenca e fitores së socializmit, shkenca e ndërtimit të shoqërisë komuniste. Prandaj Partia jonë, si një parti marksiste-leniniste, që në ditët e para të organizimit, i ka kushtuar një kujdes të veçantë edukimit ideologjik të anëtarëve të saj.

Marksizëm-leninizmi u dha anëtarëve të Partisë sonë forcën e orientimit, sigurinë në luftën që bënin dhe besimin në fitore. Prandaj, të edukuar nga Partia, komunistët hidheshin në sulm të parët kundër armikut dhe binin heroikisht në luftën për çlirimin e atdheut, për idealet e larta të Partisë dhe të popullit.

Rezultatet e shkëlqyera të arritura nga populli ynë gjatë këtyre 15 vjetëve pas Çlirimit, nën udhëheqjen e Partisë dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të vendeve të demokracisë popullore, janë një dëshmi e gjallë e forcës ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit.

Partia jonë, e udhëhequr nga Komiteti Qendror i saj, ka luftuar me të gjitha forcat për ruajtjen e unitetit të çelniktë ideologjik dhe organizativ të radhëve të saja duke goditur pa mëshirë dhe duke shpartalluar gjithë armiqtë e brendshëm. Ajo ka bërë një luftë të

vendosur për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e saj nga çdo rrymë oportuniste dhe sektare, ajo ka zhvilluar një luftë të ashpër kundër revizionizmit modern, flamurin e të cilit e mbajnë revizionistët jugosllavë. E edukuar në frymën e internacionalizmit proletar ajo ka përkrahur tërë lëvizjen përparimtare të popujve të shtypur që luftojnë për liri, pavarësi dhe socializëm.

Detyra akoma shumë të mëdha kemi përpara për ta bërë vendin tonë në një të ardhshme të afërt të aftë që krahas me vendet e tjera socialiste të hyjë në rrugën e ndërtimit të shoqërisë komuniste. Për këtë duhet që kuadrot tanë, gjithë anëtarët e Partisë dhe pastaj gjithë punonjësit, të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshëm për këtë rrugë kaq të ndritur, të shohin dhe të dinë të ecin përpara, të kuptojnë qartë ligjet e zhvillimit të shoqërisë. Këtë zotësi ua jep marksizëm-leninizmi, i cili përbën jetën dhe forcën e Partisë sonë, të ardhshmen dhe sigurinë e popullit shqiptar. Prandaj Shkolla e Partisë, si institucioni më i rëndësishëm që ka Partia jonë për edukimin dhe kalitjen ideopolitike të kuadrove, ka detyra të mëdha. Ajo duhet të pregatitë kuadro, të cilët gjithnjë e më mirë të zotërojnë teorinë lidhur edhe me praktikën e vendit tonë, kuadro të pjekur ideologjikisht dhe politikisht, organizatorë të zot, të aftë që të mobilizojnë dhe të udhëheqin masat punonjëse për ndërtimin e socializmit.

Shkolla e Partisë duhet të mbajë kurdoherë parasysh se marksizëm-leninizmi nuk mund të kuptohet dhe as të zbatohet si duhet pa u lidhur me të gjitha shkencat e tjera, me politikën, me ekonominë dhe me problemet

shoqërore, pa u lidhur ngushtë me jetën dhe me problemet që ka shtruar Partia para popullit tonë. Masat që ka marrë Komiteti Qendror i Partisë sonë për organizimin e praktikës së prodhimit, për punën praktike të nxënësve dhe të pedagogëve pranë komiteteve të Partisë në rrethe kanë një rëndësi të madhe. Prandaj drejtoria dhe këshilli i shkollës, organizata e Partisë në shkollë, çdo pedagog dhe çdo nxënës duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme jo vetëm mësimit në shkollë por edhe praktikës.

Pedagogët duhet të thellohen më shumë në vijën dhe vendimet e Partisë sonë, të njihen mirë me jetën dhe punën që bën populli nën udhëheqjen e Partisë për ndërtimin e socializmit, pra, ata duhet të njohin mirë realitetin e vendit tonë dhe ta lidhin mirë teorinë me praktikën. Shkolla e Partisë duhet ta ngrejë akoma punën shkencore dhe metodike mësimore, të ndihmojë nxënësit nga ana metodike si të studjojnë dhe si të punojnë, në mënyrë që pas mbarimit të shkollës çdo nxënës të jetë në gjendje që jo vetëm të punojë mirë, por dhe të studjojë për ngritjen e mëtejshme të nivelit ideologjik, kultural dhe profesional.

Drejtoria e shkollës, gjithë pedagogët, së bashku me organizatën e Partisë në shkollë duhet të bëjnë një punë të madhe për edukimin komunist të nxënësve, të cilët, nga ana e tyre, duhet ta kuptojnë se Partia, duke i sjellë në shkollë, u jep një ndihmë shumë të madhe për të mësuar marksizëm-leninizmin, për të marrë këtu atë kyç që hap të gjitha portat, që krijon të gjitha mundësitë, që sheshon të gjitha pengesat dhe e bën komunistin shumë të fortë. Prandaj, të dashur shokë;

ta shfrytëzoni mirë kohën, të thelloheni në veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe në vendimet e në vijën e Partisë sonë, të dëgjoni me kujdes leksionet që ju bëjnë pedagogët dhe të konsultoheni me ta për gjërat e paqarta. Të forconi disiplinën në mësim dhe në jetën e shkollës, të përfitonit nga jeta e organizatës së Partisë të qytetit të Tiranës dhe nga jeta politike e kulture në kryeqytet dhe gjithnjë të mendoni, të punoni dhe të jetoni si komunistë, që kur të ktheheni në punë të jeni më të edukuar, më të aftë, se edhe detyra më të mëdha ju presin.

Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, po ndërton me sukses socializmin. Janë arritur suksese të mëdha në të gjitha fushat. Një e ardhshme akoma më e lulëzuar e pret popullin tonë dhe kjo do të arrihet me punë, në ballë të së cilës duhet të jenë, si kurdoherë, komunistët, me shembullin, heroizmin dhe vetëmohimin e tyre.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka bindje se drejtuesit, pedagogët dhe nxënësit e Shkollës së Partisë që mban emrin e Leninit të madh do t'i kryejnë gjithnjë me nder detyrat që u ka ngarkuar Partia.

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 224 (3439), 17 shtator 1959*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## T E L E G R A M

### KOMISIONIT TË FESTIMIT TË 15-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË GJIROKASTRËS

*Gjirokastrë*

17 shtator 1959

Të dashur shokë,

Mora ftesën që më dërguat për të marrë pjesë në festimin e 15-vjetorit të Çlirimit të qytetit të Gjirokastrës nga pushtuesit fashistë dhe tradhtarët e vendit, dhe ju falenderoj me gjithë zemër.

Në ditët e vështira të pushtimit të atdheut tonë, populli heroik i Gjirokastrës, sikurse i gjithë populli shqiptar, në zemrat e të cilit vlonte urrejtja për pushtuesit e huaj e tradhtarët e brendshëm dhe dëshira e zjarrtë për të çliruar prej tyre atdheun tonë të bukur, iu përgjigj me vendosmëri të madhe thirrjes së Partisë sonë të Punës, duke rrokur armët në Luftën Nacional-çlirimtare. Trashëgimtar i denjë i traditave të larta të Çeços<sup>1</sup> me shokë, ai luftoi me trimëri për çlirimin e

---

<sup>1</sup> Çerçiz Topulli.



vendit dhe shumë nga bijtë dhe bijat më të mira të qytetit tonë të dashur dhanë jetën e tyre në këtë luftë të shenjtë.

Pas Çlirimit të atdheut, populli i Gjirokastrës, me të njëjtin shpirt luftarak dhe plot vrull revolucionar, duke zbatuar porositë e Partisë dhe nën udhëheqjen e saj, punoi me vetëmohim për rindërtimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore dhe ka arritur suksese të mëdha, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në luftën e mbarë popullit shqiptar për ndërtimin socialist të vendit.

Duke ju kërkuar falje që nuk mund të marr dot pjesë personalisht në festën e Çlirimit të qytetit tonë, për shkak se jam shumë i zënë me punë, ju lutem t'u transmetoni pjesëmarrësve të festës dhe gjithë vëllezërve e motrave të Gjirokastrës, përshëndetjet më të nxehta dhe urimet më të mira të Komitetit Qendror të Partisë dhe të miat personale, për suksese të reja edhe më të mëdha në punë për ngritjen e vazhdueshme të mirëqenies materiale dhe të nivelit kultural të punonjësve, për lulëzimin e qytetit të bukur heroik të Gjirokastrës, për të mirën dhe lumturinë e të gjithë popullit tonë!

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR  
NË KATUNDIN BICAJ ME RASTIN E 16-VJETORIT  
TË THEMELIMIT TË ÇETËS SË LUMËS**

**20 shtator 1959**

Të dashur shokë, vëllezër dhe motra të Kukësit,

Jam shumë i lumtur që gjendem sot në gjirin tuaj, në gjirin e këtij populli kreshnik, paqedashës dhe punëtor. Më lejoni t'ju sjell përshëndetjet më të nxehta të Komitetit Qendror të Partisë sonë e të qeverisë së Republikës dhe t'ju uroj jetë të lumtur dhe të gëzuar!

Me të vërtetë të gjithë ne sot jemi të gëzuar, sepse kur është populli i gëzuar janë edhe udhëheqësit e tij. Populli dhe udhëheqësit në vendin tonë, në Republikën tonë Popullore, janë një dhe të pandarë.

Ne sot jemi të gëzuar sepse po festojmë këtu në Bicaj 16-vjetorin e formimit të çetës së parë të krahinës suaj. Ishin çaste të rëndësishme ato që kalonte populli shqiptar në atë kohë, çaste kur vendosej nëse populli ynë do të jetonte i lirë apo do të vazhdonte të mbante zgjedhën e huaj dhe atë të pasanikëve e të bajraktarëve që shekuj me radhë e kishin vrarë, gjakosur dhe mbajtur në errësirë të plotë. Në këto çaste

pra, kur populli ishte në rrezik, nuk mund të qëndrohej pa vepruar, por duheshin lënë në një anë grindjet e mosmarrëveshjet dhe do të luftohej për një qëllim të shenjtë, për shpëtimin e jetës së popullit e të atdheut.

Sikurse e dini, të dashur vëllezër dhe motra, të gjithë shqiptarët në atë kohë u çuan në këmbë, rrokën armët në luftën për liri, për të nxjerrë popullin në dritë. Kështu ndodhi edhe në rrethin tuaj: djemtë dhe vajzat më të mira të popullit të Kukësit, hodhën prapa krahëve paragjykimet dhe thashethemet e njërit ose të tjetrit dhe qëndruan të patundur përballë armiqve pushtues dhe bajraktarëve gjakpirës që ishin lidhur me pushtuesit fashistë. Në këto kushte u formua çeta e rrethit tuaj, e vogël në fillim, por që nga ajo mori zjarr e gjithë krahina dhe u bë i mundur krijimi i reparteve më të mëdha siç qenë brigada XXIV dhe të tjera. Me qindra partizanë të tjerë nga rrethi i Kukësit morën pjesë në brigadën XXV dhe në brigadat e tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe luftuan heroikisht kundër armiqve në luftën e përgjakshme për çlirimin e atdheut, si dhe në luftën për çlirimin e popujve vëllezër të Jugosllavisë.

Mbi 45 dëshmorë ranë në luftë nga krahina juaj. Ne do t'i kujtojmë përjetë ata, sepse gjaku i tyre gjendet në themelin e Shqipërisë së re, sepse çdo vit kur shikoni se po hyn mirëqenia në shtëpitë tuaja, kur ju ndërtoni shtëpi të reja, kur mbushni hambaret me misër dhe prodhime të tjera, kur ju shtohen bagëtitë, ju duhet ta dini se në bazë të këtyre prodhimeve dhe të ardhurave, që ndihmojnë në ngritjen e mirëqenies suaj, ndodhet dhe gjaku i dëshmorëve të popullit

shqiptar. I përjetshëm do të jetë kujtimi i Meriman Jakupit, Elez Brahës, Ibish Milaimit, Xhemali Bilerit, Hasan Miftarit, Ahmet Sinanit, Ndrec Ndue Gjokës, Isuf Jashar Seferit, Alush Sadik Xhebexhis, Sherif Abdulla Munekes, Ymer Matës dhe shumë e shumë të tjerëve! Ne me respekt përulemi përpara shokëve tanë partizanë që ranë dëshmorë për lirinë e popullit, ne me respekt nderojmë gjithashtu baballarët dhe nënat e tyre që lindën këta djem trima dhe i mësuan se si të luftojnë për çështjen e popullit dhe të atdheut! Kujtimi i luftëtarëve tanë që ranë në luftë do të na udhëheqë sot për të ndërtuar Shqipërinë tonë socialiste, për të ndërtuar komunizmin, një jetë të lumtur dhe të gëzuar për të gjithë popullin tonë. Dhe ne jemi duke ecur me hapa të sigurtë në atë rrugë për të cilën dhanë jetën e shtrenjtë partizanët tanë trima.

Këto ditë të lumtura që gëzon populli sot, u arritën sepse luftën e tij çlirimtare dhe përpjekjet për ndërtimin e jetës së re i udhëhoqi Partia Komuniste sot Partia e Punës. Partia e Punës ishte motori udhëheqës, organizatorja e të gjitha fitoreve që ka korrur dhe do të korrë edhe në të ardhshmen populli shqiptar. Asgjë nuk do të ishte bërë dhe nuk mund të bëhet edhe sot, pa udhëheqjen e Partisë.

Për këtë arsye pushtuesit fashistë dhe bajraktarët e vendit e luftuan Partinë tonë që në lindjen e saj. Ata panë se nga gjiri i popullit po lindte një forcë e madhe, ata panë se populli po u ikte nga duart dhe po copëtonte zinxhirët me të cilët e kishin lidhur. Prandaj donin ta shkatërronin që në embrion këtë forcë të madhe. Por Muharrem Bajraktari me shokë më kot u

përpoqën të lidheshin me fashistët italianë dhe gjermanë për t'i prerë hovin këtij lumi të vrullshëm që do t'u bënte varrin, ashtu sikurse ua bëri. Pushtuesit fashistë dhe tradhtarët përdorën çdo mjet për të shpifur kundër Partisë dhe për të gënjyer popullin. Fakti është se ata nuk patën asnjë sukses. Ata as me armatimet e tyre të shumta as me propagandën e tyre të madhe nuk mundën ta mposhtnin popullin dhe Partinë në veprën e madhe që kishin ndërmarrë.

Komunistët fituan në luftë sepse u mbështetën dhe patën përkrahjen e plotë të popullit, sepse ata ishin djemtë e popullit, mendonin ashtu siç mendonte populli, ushqeheshin nga të njëjtat dëshira që kishte edhe populli. Prandaj ata i bënë ballë me sukses luftës aq të madhe dhe të vështirë.

Populli dhe Partia u lidhën midis tyre si një trup i vetëm dhe arritën fitoren e madhe të Çlirimit të atdheut dhe vendosjen e pushtetit popullor. Edhe në të kaluarën me heroizëm të madh kishte luftuar populli ynë, por ai nuk kishte mundur asnjëherë të fitonte lirinë dhe të vetëqeverisej, ashtu si tani kur e udhëheq në fitore të njëpasnjëshme Partia jonë e dashur.

Po ku qëndron atëherë çelsi i kësaj fitoreje? Dihet se populli është e vetmja forcë që përmban në gjirin e vet trimërinë, besimin, aftësinë për punë dhe diturinë. Një parti që do të dijë t'i bashkojë si duhet energjitë dhe diturinë e popullit dhe t'i futë ato në rrugën e përparimit, do të fitojë patjetër. Dhe ka një parti në botë që mund ta bëjë këtë gjë, jo vetëm në vendin tonë po edhe kudo. Kjo është partia e tipit marksist-leninist.

Partia jonë është parti e tipit marksist-leninist,

programi i saj ka qenë dhe është i qartë. Populli e përkrah këtë program me të gjitha forcat e veta. Prandaj ne kemi arritur rezultatet që shikojmë sot, prandaj ne fituam në Luftën Nacionalçlirimtare dhe mundëm armiq të egër, shumë më të fuqishëm nga ne.

Partizanëve shqiptarë dhe luftërave të popullit tonë në këto gërxhe i dhanë një ndihmë të madhe veprimet ushtarake të Ushtrisë Sovjetike. Sa më të forta ishin goditjet kundër armiqve gjermanë nga Ushtria Sovjetike aq më të mëdha bëheshin fitoret e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare. Qysh në fillim Partia jonë diti ta lidhë luftën çlirimtare të popullit tonë me luftën e popujve të Bashkimit Sovjetik kundër agresorëve fashistë. Partizanët tanë që luftuan për lirinë e popullit luftuan njëkohësisht edhe për mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik dhe heronjtë e lavdishëm të Ushtrisë së Kuqe luftuan jo vetëm për çlirimin e atdheut të tyre të madh por edhe për çlirimin e popujve të tjerë të robëruar nga fashizmi edhe për çlirimin e popullit shqiptar. Vepra e madhe e Partisë sonë nuk u ndërpre për asnjë çast edhe pas Çlirimit. Çështja nuk ishte të fitonim vetëm lirinë, por të ndërtonim edhe atdheun dhe ta bënim atë më të bukur e më të pasur. Para çlirimit Shqipëria njihej për bukurinë e saj natyrale, por punëtorët, fshatarët dhe malësorët tanë vuanin nga uria, vdisnin nga sëmundjet, ju pihej gjaku nga pasanikët. Prandaj populli ynë, porsa vendosi pushtetin, nën udhëheqjen e Partisë, ndërmori veprën e madhe të ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Dhe siç dihet kemi arritur sukses të mëdha në këtë drejtim.

Ju, shokë fshatarë dhe malësorë, jeni vetë ndër-

tuesit e këtyre veprave të mëdha. Ju jeni ndërtuesit e një bujqësie të re të përparuar, të fabrikave dhe të hidrocentraleve, shumë nga ju kanë punuar dhe derdhur djersën për ndërtimin e veprave të pavdekshme të socializmit në vendin tonë.

Dhe kjo djersë nuk ka shkuar kot. 15 vjet kanë kaluar që kur jemi çliruar dhe mund të themi se faqja e Shqipërisë ka ndryshuar rrënjësisht. Ato që ka bërë populli shqiptar gjatë kësaj kohe nën udhëheqjen e Partisë as që mund t'i ëndërronte ndokush në të kaluarën, ato nuk mund të bëheshin dot se populli nuk ishte i lirë por i shfrytëzuar gjer në palcë nga borgjezia dhe feudalët e vendit dhe më vonë nga pushtuesit fashistë. Duhej, pra, të hidhej poshtë zgjedha dhe shfrytëzimi e t'i jepej popullit fuqia në dorë, se vetëm kështu mund të bëheshin ato që janë bërë sot te ne. Kështu besonin komunistët dhe Partia arriti t'i bindë njerëzit.

Po akoma shumë njerëz në atë kohë mendonin çapraz dhe thoshin se komunistët nuk kanë për të bërë gjë. Ata lidheshin me të kaluarën, me emrat e disa krerëve dhe bajraktarëve që ishin në fakt edhe armiqtë e tyre. Njerëz të tillë nuk u bindën që në fillim me fjalët e Partisë, po me krerët e bajraktarët që kishin rjepur dhe vranë popullin. 15 vjet sundoi Ahmet Zogu mbi kurrizin e popullit dhe dihet se asgjë nuk bëri përveçse e varfëroi vendin. Edhe fashistët italianë që erdhën në Shqipëri me ndihmën e Zogut, Muharrem Bajraktarit, Mustafa Krujës e të tjerëve, gjithashtu asgjë nuk bënë përveç se vranë e gjakosën popullin dhe grabitën krahina të tëra.

Por ata që nuk besonin në fillim në forcën e popullit

dhe të Partisë sonë sot mendojnë ndryshe; ata thonë se komunistët, punëtorët dhe fshatarët, që i përçmonin deri dje, janë njerëz me të vërtetë të zot. Neve na vjen mirë se edhe ata pak njerëz që më parë nuk na kishin kuptuar, tani po na kuptojnë dhe po fillojnë seriozisht të bashkohen me popullin, sepse shohin që rruga jonë është e drejtë, për të mirën e popullit. Ata shohin gjithashtu kotësinë e përpjekjeve të tradhtarëve të popullit që i gënijnë. Për këta njerëz kishin mbetur vetëm dy zgjidhje, ose të vazhdonin në rrugën e verbët ku i kishin futur tradhtarët e atdheut, ose të futeshin në rrugën e drejtë ku ecën i gjithë populli. Dhe dihet se këta nuk janë njerëz budallenj. E kam fjalën për disa njerëz me mendime të vjetra, të cilët i shohin mirë interesat e tyre.

Pra kishte njerëz që mendonin dhe shpresonin se gjoja do të na rrëzonin dhe këtë e shihnin shumë të lehtë. Por ata nuk na rrëzuan dot në kohën e luftës kur ishin të armatosur deri në dhëmbë dhe kishin përkrah tyre fashistët italianë dhe gjermanë. Ne atëherë u dhamë një dru të mirë që s'panë nga vajtën. Ata prapë shpresuan se pas luftës do të ishin amerikanët ata që do t'i ndihmonin për të rrëzuar pushtetin tonë. Por pushteti i popullit i ka rrënjët thellë në popull. Ai nuk mund të rrëzohet veç asaj, se populli shqiptar nuk është më i vetëm. Me ne janë të gjithë popujt që kanë hyrë në rrugën e socializmit.

Përpara prestigjit dhe respektit që ka fituar Shqipëria në Evropë dhe në të gjithë botën, tradhtarëve të atdheut që sot ndodhen jashtë shtetit, u kanë rënë pendët, ata janë në dëshpërim të plotë dhe thonë se mbaroi një herë e mirë shpresa për t'u kthyer edhe një herë



në Shqipëri, pasi tani është e pamundur të rrëzohet pushteti popullor.

Sot e kanë të gjithë të qartë, duke filluar që nga imperialistët amerikanë e deri te zagarët reaksionarë shqiptarë, se kush prek Shqipërinë atë e pret vdekja. Prandaj edhe disa njerëz në vendin tonë që deri tani shihnin ëndrra me sy hapur, i kanë vënë mirë këmbët në tokë dhe duan apo nuk duan, ecin në rrugën e drejtë të popullit dhe të Partisë, sepse veprat duken sheshit dhe rrugë tjetër nuk ka për ta.

Gjendja e brendshme e Shqipërisë është shumë e fortë. Te ne çelnikoset uniteti në mes të popullit dhe Partisë. Populli dhe Partia janë lidhur aq ngushtë në mes tyre sa që nuk ka asnjë forcë që do të mund t'i ndante. Ekonomia jonë po ngrihet vazhdimisht dhe në Shqipëri sundon qetësia. Tani te ne nuk ka më komplotte, sepse nuk ka njerëz të tillë që të kenë forca për të komplotuar kundër popullit dhe pushtetit popullor. Sigurisht ka nga ata që u qan zemra ta bëjnë këtë, por nuk kafshojnë dot se u janë thyer dhëmbët, duan të gjerrin por u janë prerë thonjtë.

Pra, në vendin tonë gjendja e brendshme nga të gjitha pikëpamjet është më e fortë si asnjëherë. Një gjendje e tillë nuk mund të krijohet as me urdhëra e as me dekrete. Po të mos zgjidheshin me sukses detyrat e parashikuara nga Partia në programin e saj; në popull nuk mund të krijohet një bindje vetëm me disa fjalë, si jemi duke shkuar në rrugë të mbarë. Çështja është se Partia dhe qeveria e kanë krijuar me vepra mirëqenien e popullit dhe kanë krijuar bindjen e plotë se këto vepra janë kryer vetëm për të mirën e tij. Le

të pëshpëritin sa të duan armiqtë që fshihen prapa ferrës, le të flasin sa të duan revizionistët jugosllavë, le të bërtasin sa të duan të 40 radiostacionet amerikane, angleze, franceze, italiane e të tjera për të errësuar gjendjen e vërtetë të vendit tonë. Popullit shqiptar tërt nuk ia bën veshi, sepse ai shikon sa ka përparuar vendi ynë nën udhëheqjen e Partisë, se si është ngritur një industri e tërë, se janë të tijat prodhimet, si tekstilet, sheqeri, këpucët, konservat e të tjera e të tjera, që dalin nga fabrikat, të cilat ai vetë i ka ndërtuar me duart e tija.

Ndërtimi industrial në vendin tonë ishte një detyrë shumë e madhe e Partisë. Veprat e industrisë sonë të re u ndërtuan dhe po ndërtohen.

Tani Shqipëria ka një industri moderne. Por që të punojë kjo industri te ne janë ndërtuar dhe po ndërtohen edhe hidrocentrale. Vendi ynë ka gjithashtu edhe pasuri të shumta minerale. Prandaj Partia i kushtoi kujdes të madh zhvillimit të minierave duke filluar që nga nafta, kromi, bakri, e deri te hekur-nikeli.

Me rëndësi po aq të madhe për jetën e popullit është edhe çështja e bujqësisë. Vendi ynë ka qenë një vend bujqësor e blegtoral shumë i prapambetur. Qysh në fillim Partisë iu desh të ndërmernte vepra të tilla që bujqësia t'i jepte fshatarit më shumë prodhime. Për këtë qëllim rruga kryesore për zhvillimin e një bujqësie moderne ishte ajo e kolektivizimit. Partia eci me ngadalë dhe me kujdes për të bindur fshatarët që të merrnin këtë rrugë dhe kjo nuk ishte një gjë e lehtë. Duheshin përpjekje e durim për ta bindur fshatarin. Kështu u veprua dikur në Bashkimin Sovjetik,

kështu po veprohet sot edhe në vendet e tjera të demokracive popullore.

Duke ecur me kujdes, nëpërmjet rrugës së bindjes, arritëm të korrim suksese të mëdha në fushën e kolektivizimit sa që tani mund të themi se në të gjithë vendin tonë kolektivizimi i bujqësisë, rruga që duhet të ndjekë fshatarësia për të shpëtuar nga varfëria është përfunduar në 80 për qind të sipërfaqes së punueshme. Në kooperativa bashkohet forca, mendja dhe dituria e fshatarëve tanë, atje është e mundshme që të përqëndrohet mirë ndihma që shteti i jep fshatarësisë për të shtuar prodhimin.

Dhe në fakt ne kemi suksese në bujqësi, jo vetëm se arritëm të krijojmë kooperativat bujqësore, por tani kemi mundur të sigurojmë një mekanizim të fuqishëm për punimin e tokave që nga viti në vit po e shtojmë. Kemi bërë përpjekje gjithashtu edhe për shtimin e sipërfaqeve të ujitshme. Megjithatë ne duhet të punojmë akoma që deri në fund të pesëvjeçarit të ardhshëm të arrijmë të ujitim 45 për qind, bile po të jetë e mundur dhe 50 përqind të tokave të punueshme. Dihet se uji është një faktor me rëndësi që rrit rendimentin. Ju në rrethin tuaj keni shumë ara të ujitshme, kështu me punën tuaj dhe me anën e ujit ju nuk merrni më pak se 20 kv misër për hektar, pavarësisht se me përpjekje më të mëdha mund të merrni edhe më shumë.

Ju keni dëgjuar për punimet e mëdha që po bëhen në fushat e Shqipërisë ku po thahen kënetat dhe moçale e po hapen dita-ditës toka të reja. Me këtë sipërfaqe që fitohet do të arrijmë së shpejti t'i rritim deri 2 herë prodhimet bujqësore. Po merren masa që shumë

nga këto toka të reja njëkohësisht edhe të ujiten. Në rrethin e Lushnjës bile mund të themi se sipërfaqja e tokave të punueshme në fusha do të arrihet të ujitet 100 për qind. Nuk do të jetë larg ajo kohë kur Myzeqeja jonë, fushat e Fierit dhe të Lushnjës do të bëhen me të vërtetë ashtu sikurse thoshte populli përpara, hambar i gjithë Shqipërisë. Ky hambar do t'i shërbejë jo vetëm popullit të këtyre dy rretheve por gjithë popullit tonë, duke filluar që nga Maja e Hekurave në Tropojë dhe deri në kufirin tonë të Jugut në Konispol. Mund të themi se tani ne kemi krijuar një klasë punëtoare të shëndoshë, të re dhe të fortë si çeliku që po edukohet nga Partia në punë e sipër për të udhëhequr popullin më me siguri drejt komunizmit.

Në rrethin tuaj ju keni disa miniera dhe shteti do të hapë edhe të tjera, sepse malet e larta që ju rrethojnë fshehin me siguri pasuri të mëdha në thellësi të tyre. Në minierat punojnë edhe shumë nga ju shokë malësorë dhe populli ynë ka vënë shpresa të mëdha te minatorët tanë.

Në të ardhshmen ne do të ngremë edhe metalurgjinë e zezë, d.m.th. do të krijojmë mundësi për ta përpunuar në vend një pjesë të hekurit që nxjerrim. Ndërtimi i një uzine për përpunimin e hekurit, jo vetëm për të plotësuar nevojat tona, por edhe për eksport, do të na japë mundësi që me të ardhurat që do të sigurojmë, të sjellim më shumë sende dhe makineri të tjera për të cilat ka nevojë ekonomia jonë popullore. Natyrisht populli ka nevojë për shumë gjëra, por menjëherë ato nuk bëhen. Ato do t'i sigurojmë me punën tonë. Jeta tregon se puna që bëjmë nga viti

në vit po na jep rezultate gjithnjë më të mëdha. Industria e re që mendojmë të ngremë nuk do të mundë të punojë po të mos furnizohet rregullisht me energji elektrike. Mendohet që në të ardhshmen jo shumë larg prej këtej, të ngrihet një hidrocentral i fuqishëm, më i madh nga ata që janë ngritur deri sot në vendin tonë. Gjatë ndërtimit të këtij hidrocentrali që do të bëhet kryesisht nga populli i rrethit tuaj, do të dalin sigurisht shumë heronj të punës socialiste.

Pra të gjitha veprat që ne kemi sot në vendin tonë dhe që ju i dini, i ka ndërtuar populli nën udhëheqjen e Partisë. Këto vepra kanë bërë që populli të jetë i lidhur ngushtë me Partinë dhe qeverinë e tij, që uniteti i Partisë dhe i qeverisë me popullin të jetë si çeliku, që situata te ne të jetë e qetë dhe e shëndoshë dhe puna armiqësore të mos zërë vend në popull dhe në atdheun tonë.

Ju, shokë dhe vëllezër të Kukësit, keni punuar me vetëmohim, ashtu siç kanë punuar të gjitha krahinat e vendit për ndërtimin e socializmit. Shumë nga kodrat e rrethit tuaj nuk janë më si më parë. Tani edhe rrethi juaj ka marrë një pamje tjetër. Edhe te ju shumë kodra e vende të pashfrytëzuara më parë, tani po bëhen kopshte. Ato janë spastruar e po spastrohen vazhdimisht dhe po kthehen në ara pjellore, nga të cilat merren vazhdimisht rendimente më të larta në misër, grurë dhe kultura të tjera. Tani në rrethin e Kukësit po mbillen në shkallë të gjerë pemë frutore, si mollë, arra, fiq, vreshta e të tjera.

Po te ju nuk ka qëndruar në vend as blegtoria, rritjen e së cilës ju e keni traditë. Ajo përbën pasu-

rinë kryesore të rrethit, 47 për qind e të ardhurave tuaja vijnë nga blegtoria që ju me të drejtë e doni aq shumë.

Pra gjatë 15 vjetëve, si e gjithë Shqipëria, ashtu edhe rrethi juaj ka ndryshuar shumë në krahasim me të kaluarën. Kjo duket në fytyrat, në veshjen dhe në shtëpitë tuaja. Duhet pasur parasysh se të gjitha këto nuk u bënë me frymën e shenjtë po me punën dhe djersën tuaj, ju vetë ia dolët punës në krye.

Forca të mëdha ka në gjirin e popullit tonë, po duhet të themi se ne kemi akoma shumë për të bërë, ne kemi akoma forca të mëdha që na japin mundësi brenda një kohe të shkurtër të dyfishojmë rezultatet e tanishme. Dihet prej të gjithëve se faktori kryesor që bën të ndryshojë faqja e vendit tonë është puna. Vetëm me punë mund të arrihen rezultate gjithnjë më të mira. Po ta shohim thellë këtë çështje, pavarësisht se ne nuk rrimë me duar lidhur, del se duhet të punojmë akoma më shumë.

Tani duhet t'i përvishemi punës në mënyrë më të organizuar dhe me siguri brenda 3-4 vjetëve të gjitha këto kodra që kemi përreth do të kthehen në kopshte. Partia jonë nuk e ka thënë kot që Shqipëria do të bëhet një vend i lulëzuar. Kjo nuk është vetëm një parullë, këtë parullë ne do ta bëjmë realitet.

Rrethi i Kukësit ka arritur mjaft rezultate në sektorin e bujqësisë, po duhet të bëhen akoma përpjekje në mënyrë të organizuar për t'i shtuar akoma më shumë prodhimet bujqësore e blegtorale. Ju tani keni traktorë në rrethin tuaj. Në të ardhshmen do t'u jepen edhe të tjerë me qëllim që të ndihmohet bujqësia kooperativiste

për të hapur më shumë toka të reja, për t'i punuar më mirë tokat dhe për t'i mbjellë ato sipas kërkesave të agroteknikës.

Një tjetër detyrë e rëndësishme për shtimin e prodhimeve bujqësore është të mbledhim me shumë kujdes plehun e bagëtive e ta hedhim të gjithë në ara. Megjithatë Partia e di se kjo nuk është e mjaftueshme, prandaj mendohet që në planin e tretë pesëvjeçar të ndërtojmë 2 fabrika për prodhimin e plehrave kimike, një në Fier dhe një në Laç. Kur të përfundojnë këto vepra ne do të arrijmë të hedhim në ara 45-50 kg pleh për çdo hektar nga 6 kg që hedhim tani. Kjo do të jetë një gjë shumë e mirë. Një bujqësi e përparuar kërkon midis të tjerave edhe sasi të mira plehu. Kur të ndërtojmë fabrikat e plehrave kimike ne do të shpërndajmë sasi më të mëdha plehu në ara, gjë që ka rëndësi të madhe për zhvillimin e bujqësisë sonë.

Përparime ka arritur rrethi juaj edhe në blegtori. Blegtoria ka rëndësi të madhe, shokë. Midis jush ka shumë pleq, që e dinë mirë këtë zanat dhe mund të më thonë për atë që mendoj e ju këshilloj, «hajde baba të të mësoj arat». Ne duhet të kemi parasysh se bagëtitë nuk duhet t'i rritim si përpara me mënyra shumë të thjeshta.

Përparime të mëdha janë bërë në shumë vende miq për mirëmbajtjen dhe ushqimin e kafshëve, me qëllim që të merret prej tyre më shumë qumësht, lesh dhe mish. Përpyekje janë bërë edhe te ne dhe kemi pasur disa rezultate. Më përpara nga lopët p.sh. merreshin 200 deri në 300 kg qumësht në vit, kurse tani në shumicën e kooperativave bujqësore marrin mbi

600 kg. Ky është një përparim i mirë. Por lopët e vendit në Institutin Zooteknik në Shkodër kanë arritur të japin edhe 2 000 deri në 2 200 litra qumësht. Kryesorja për një rezultat të tillë është pa dyshim ushqimi. Po i dhe ushqim kafshës do të japë qumësht, po nuk i dhe do të japë «rigon» si thotë populli. Prandaj për lopët duhet të tregoni kujdes t'i ushqeni mirë. Silazhi ka rëndësi të madhe për këtë qëllim, po rrethi juaj është shumë prapa me realizimin e planit të silazhit. Ju vetëm 2 000 tonë keni realizuar deri tani. Ju mbeuten edhe 7 000 të tjerë, prandaj bëni të gjitha përpjekjet për sigurimin e silazhit për bagëtitë tuaja. Parulla për të siguruar 10 tonë silazh për lopë dhe për të korrur misrin për silazh me gjithë kalli, kur është në fazën e dyllit, ka shumë rëndësi. Po të veproni kështu dhe t'ia jepni lopës këtë ushqim, me siguri ju do të merrni dyfishin e qumështit. Disa mendojnë që të mos e bëjnë dëm farën e misrit për ta mbjellë për silazh. Bëni llogari dhe do të shihni se do të keni shumë leverdi. Keni kujdes gjithashtu që gropat e silazhit të mos i bëni sido kudo, po me mure, ndryshe silazhi mund të tharohet e si rezultat shumë fshatarë do të tërhiqen nga kjo rrugë. Natyrisht gropa të këtilla me mure nuk i bëni dot që sivjet por ta keni parasysh për vitin e ardhshëm.

Pra shumë kujdes duhet të tregoni për sigurimin e ushqimit të bagëtive, për mirëmbajtjen e kullotave që keni. Ju tani e keni kuptuar se sa e vështirë është bërë për t'i çuar bagëtitë në Jug gjatë stinës së dimrit. Blegtorët e rrethit tuaj kanë dhënë një shembull shumë të mirë, se dimrin që kaloi vetëm 1 000 krerë



bagëti kanë çuar jashtë rrethit, sepse shumica për dimër ua kanë siguruar ushqimin bagëtive në vend. Kjo është një punë për t'u lavdëruar. Duke vepruar kështu të gjithë rritësit e bagëtive do të ndihmojnë që të zgjidhet si duhet problemi që ka shtruar Partia për të siguruar më shumë mish, lesh, qumësht dhe lëkurë në vendin tonë.

Përsa u përket arsimit dhe kulturës mund të themi me siguri se në rrethin tuaj është bërë një punë shumë e madhe. Shoku sekretar i komitetit të Partisë që foli para jush dha disa shifra që tregojnë për përparimet e mëdha që janë bërë në fushën e arsimit dhe të kulturës në rrethin e Kukësit. Nga 16 shkolla fillore që kishte më parë Kukësi si rreth, tani ka 95. Kjo është një provë që dëshmon për shpirtin përparimtar dhe arsimdashës të popullit të rrethit tuaj. Sot nga gjiri i popullit të rrethit të Kukësit kanë dalë dhe po dalin njerëz të zot që drejtojnë punë të rëndësishme në organet e shtetit dhe të Partisë sonë. Nga radhët e partizanëve të rrethit tuaj kanë dalë shumë oficerë të zot dhe gjeneralë të shquar dhe dita-ditës njerëz të tjerë të rinj janë duke dalë e po marrin në duar drejtimin e punëve të rëndësishme që u ngarkohen. Kjo provon etjen e madhe për dituri dhe për punë të popullit trim e paqedashës të Kukësit i mbajtur në errësirë të madhe në të kaluarën. Por Partia i hapi atij sytë dhe i krijoi të gjitha mundësitë për të mësuar dhe për të vënë aftësitë e tija në shërbim të popullit dhe të atdheut.

Shumë shkolla 7-vjeçare janë hapur në rrethin tuaj. Më parë këtu nuk kishte asnjë të tillë, kurse tani

ka edhe një shkollë të mesme. Po edhe me kaq nuk do të mbetemi. Do të vijë koha që shkolla 7-vjeçare të ketë në të gjitha fshatrat, që çdo fshat të ketë mjekun e vet nga djemtë dhe vajzat tuaja. Direktiva e Partisë është që të gjithë të mësojnë. Por te ne kurrë nuk do të ketë njerëz të tepërt të mësuar, ashtu si ndodh në shtetet kapitaliste. Në Shtetet e Bashkuara p.sh. një numër i madh i atyre që mbarojnë shkollat e larta nuk sigurojnë dot punë në degën për të cilën janë përgatitur, kurse në vendet socialiste njerëzit e mësuar nderohen dhe respektohen sepse ata me punën e tyre ndihmojnë që të ngrihet më shpejt mirëqenia e popullit.

Populli ynë bën një luftë të vendosur për ruajtjen dhe forcimin e paqes në botë, që njerëzit, fëmijët, gratë dhe pleqtë të jetojnë të qetë dhe të gëzuar, që ai të ndërtojë me sukses jetën e re socialiste. Lufta nuk ka përse u duhet popujve. Ajo u duhet vetëm shfrytëzuesve që mendojnë të hedhin edhe një herë zaret me shpresë se mund të fitojnë. Por në këtë rast ata me siguri do të humbasin një herë e përgjithmonë. Tani ka ardhur koha që ata të mendohen thellë përpara se të veprojnë. Ne duhet të jemi shumë vigjilentë sepse imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, revizionistët, presin çastin që ne të jemi të dobët për të na ngulur thikën pas shpine. Po Partia dhe qeveria jonë janë plot vigjilencë e zgjuarësi dhe kanë fituar shumë eksperiencë në këtë çështje se është e vështirë të na e hedhin armiqtë. Prandaj ne duke ndërtuar socializmin e mbajmë njëkohësisht edhe barutin të thatë për ta pasur të gatshëm kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm që do të orvaten të dëmtojnë punën paqësore dhe interesat e

popullit tonë, për të mbrojtur Partinë tonë marksiste-leniniste që është zemra dhe forca udhëheqëse e popullit tonë.

Ne duhet të punojmë vazhdimisht për të ruajtur unitetin e çelniktë të Partisë e të popullit dhe në mes tyre. Në mes jush, shokë fshatarë dhe malësorë të rrethit të Kukësit, duhet të mbretërojë një dashuri vëllazërore. Grindjet me njëri-tjetrin nuk i sjellin asnjë të mirë as atyre që grinden as shoqërisë. Prandaj çdo mosmarrëveshje të zgjidhet midis jush në mënyrë shoqërore.

Duke forcuar miqësinë me vendet e socializmit, të shtojmë urrejtjen tonë kundër armiqve. Armiqtë tanë kryesorë janë imperialistët. Por kundër nesh dhe komunizmit ndërkombëtar ka edhe armiq të tjerë të pabesë siç janë revizionistët jugosllavë. Kundrejt atyre ne duhet të jemi vigjilentë sepse na kanë bërë shumë të zeza. Në fillim ata na u treguan si miq, po na prenë në besë, kërkonin të na bënë varrin. Por Partia jonë marksiste-leniniste bëri që përpjekjet e tyre të dështojnë. Ne u kemi zgjatur atyre dorën kurse ata na tregojnë pushkën, na hedhin diversantë dhe kurdisin gjithfarë intrigash sepse e kanë halë në sy Shqipërinë e vogël, sepse populli ynë trim, paqëndashës dhe vigjilent u ka nxjerrë në shesh të palarat. Revizionizmi është sëmundja më e keqe në lëvizjen komuniste dhe punëtore ndërkombëtare, ai i bren përbrenda Partitë si krimbi, po të mos merren masa kundër tij. Po e gjithë lëvizja komuniste dhe punëtore ndërkombëtare e ka dënuar njëzëri revizionizmin dhe revizionistët jugosllavë. Po do të na thonë përse ne flasim kundër atyre kur ata janë të gatshëm për të bashkëjetuar. Ne

jemi dakord të bashkëjetojmë edhe me imperialistët, por në fushën ideologjike nuk mund të pajtohemi me revizionizmin që nuk është gjë tjetër veçse një armë e borgjezisë kapitaliste për të shkatërruar partitë komuniste, socializmin dhe rendin e demokracisë popullore. Ne jemi të gatshëm të zhvillojmë marrëdhënie normale shtetërore dhe të bëjmë tregti me Jugosllavinë, ne e duam si vëlla popullin jugosllav, por udhëheqësit revizionistë të Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë në çdo rast që u vjen në dorë përpiqen të na sjellin pengesa dhe të na dëmtojnë. Edhe tani ata vazhdojnë të na dërgojnë diversantë, po kurrë nuk kanë pasur sukses edhe nuk do të kenë, në të tilla ndërmarrje. Ata kanë kujtuar se njerëzit që i hedhin këtej kufirit do të gjejnë përkrahje në popull. Ka pasur ndonjë shqiptar të marrë që ka lënë familjen dhe tokën ku janë varrosur të parët e tij dhe ka kaluar kufirin i gënjyer nga propaganda e revizionistëve të Beogradit, po ai e di sa e ka paguar. Revizionistët i kanë dërguar njerëz të tillë si diversantë ose spiunë në Shqipëri.

Kur ne kërkojmë që të zhvillojmë tregtinë me shtetin jugosllav, udhëheqësit revizionistë jugosllavë nxjerrin gjithfarë pengesash dhe dëshirës sonë për marrëdhënie normale i përgjigjen duke na dërguar spiunë dhe diversantë.

Ata veprojnë kësisoj sepse janë revizionistë, se nuk mund të durojnë që komunizmi të triumfojë. Prandaj duhet të jemi vigjilentë ndaj tyre. Kjo nuk do të thotë që të jenë syzgjuar vetëm forcat e Sigurimit të Shtetit dhe rojet e kufirit. Këto le ta kryejnë mirë

detyrën e tyre, po këtë detyrë do ta bëjnë si duhet kur këta të jenë lidhur ngushtë me popullin.

Të dashur shokë, ne duhet të punojmë edhe kundër propagandës së revizionistëve të cilët arrijnë deri atje sa të nxjerrin njerëz buzë kufirit dhe të bërtasin se fshatarët në Jugosllavi gjoja kanë bukë të bardhë, kanë kinema, shtëpi kulture etj. Të gjitha këto janë gënjeshtër. Nuk e them këtë se i kemi armiq revizionistët jugosllavë, po fshatrat tona kanë bërë përparime më të mëdha në krahasim me ato të Kosovës, Metohisë dhe të Maqedonisë që vuajnë dhe kanë mungesa të mëdha. Në cilin shtet ka ndodhur që shumë fshatra malore, konkretisht edhe në rrethin e Kukësit te ne, janë çliruar nga taksat? Armiqtë tanë thonë se ne këtë e bëjmë për t'i gënjer fshatarët, për t'u hedhur atyre hi syve. E vërteta është që në brezin kufitar ne kemi një fshatarësi trimë, patriote dhe besnike ndaj Partisë dhe pushtetit popullor. Po të ishte ndryshe, titistët do të futnin njerëz me shumicë brenda territorit tonë, po këtë ata nuk e bëjnë dot sepse edhe fshatarësia jonë patriote, bashkë me rojet e kufirit, mbrojnë me vigjilencë kufijtë e atdheut, socializmin, Partinë, nderin dhe fëmijët e tyre. Po kur ne i kryejmë mirë detyrat tona, kur industria dhe bujqësia jonë përparojnë, kur fshatarët çlirohen nga taksat dhe populli rron më mirë, le të lehin armiqtë, ne sytë do t'i mbajmë kurdoherë hapur për të mbrojtur interesat e popullit.

Dëshiroj t'ju flas edhe për shumë gjëra, por nuk dua t'ju lodh. Më lejoni t'ju siguroj se Partia jonë marksiste-leniniste me siguri do ta çojë popullin tonë heroik dhe punëdashës në komunizëm, drejt bollëkut.

Partia do të punojë që t'i sigurojë popullit shqiptar fitore akoma më të mëdha se deri tani.

Këtë vit, vëllezër dhe motra të Kukësit, populli ynë do të festojë 15-vjetorin e Çlirimit, kohë e shkurtër brenda së cilës populli shqiptar ka arritur fitore të mëdha. Të mbështetur në fitoret e gjertanishme, këtej e tutje ne do të ecim me hapa akoma me të mëdhenj përpara sepse tani ne kemi krijuar një bazë të shëndoshë. Garanci për këtë është puna jonë e palodhur si dhe ndihma e miqve.

Le të shkojmë shokë, vëllezër dhe motra në festën e madhe të 15-vjetorit me plan të realizuar në të gjithë sektorët!

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Të rrojë populli lirisht, trim dhe besnik i rrethit të Kukësit!

*Botuar për herë të parë  
me shkurtime në gazetën  
«Zëri i popullit», Nr. 228  
(3443), 22 shtator 1959*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga stenogrami i mbajtur në  
këtë miting që gjendet në AQP*

# TË SHFRYTËZUJMË MË MIRË GJITHË MAKINERINË E SEKTORËVE EKONOMIKË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

26 shtator 1959

Ky raport mund të mos jetë i plotë, por kjo nuk pengon që të punohet më mirë në lidhje me problemin që diskutojmë, sepse për shumë çështje Byroja Politike dhe qeveria kanë dhënë orientime dhe kanë marrë vendime. Por konstatohet se ka mungesa të ndieshme në kontrollin e zbatimit të vendimeve që merren si në rrugë partie, ashtu dhe në rrugë shtetërore.

Të marrim çështjen e pjesëve të këmbimit. Ne duhet t'i kërkojmë llogari qeverisë se çfarë po bëhet për të vënë në jetë vendimin e marrë për këtë çështje. Në vend të «arsyes» «s'kemi skica» duhet punë, duhen vepra. Nga ana tjetër, mendoj se shokët ministra e

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u shqyrtua raporti «Mbi shfrytëzimin e makinerisë në industrinë tekstile, të makinerisë së rëndë të ndërtimit, të traktorëve dhe të makinerive të tjera bujqësore», paraqitur nga aparati i KQ të PPSH.

futin Këshillin e Ministrave dhe Kryesinë e tij në vogëlsira e në hollësi, që e vështirësojnë punën e këtyre për të kontrolluar zbatimin e vendimeve. Ministri i paraqitin qeverisë propozime të shumta e të vogla dhe kështu i japin asaj pak mundësi të kontrollojë detyrat kryesore dhe jetike për vendin tonë. Në këtë mënyrë qeveria dhe kryesia e saj ngarkohen me shumë çështje, zgjidhja e të cilave është në kompetencën e ministrive. Nuk është e drejtë që edhe për të blerë një biçikletë duhet të vendosë Kryesia e Këshillit të Ministrave. Në qoftë se për gjëra të tilla duhet të vendosë Kryesia e Këshillit të Ministrave ose qeveria, po për artikuj të mëdhenj që kushtojnë miliona lekë, kush duhet të vendosë?

U bë mirë që e morëm në shqyrtim këtë çështje jo vetëm për Ministrinë e Bujqësisë dhe atë të Ndërtimit, por edhe për ne. Të marrim çështjen e traktorëve. Shokët e aparatit të Komitetit Qendror kanë të drejtë për problemet që ngrenë në raportin e paraqitur. Ne kemi importuar shumë makineri, midis të cilave edhe traktorë. Por lidhur me nevojat që kemi për traktorë, është e domosdoshme që Ministria e Bujqësisë të dalë me një studim më të mirë. Ky studim të bëhet në bazë të zonave e të rajoneve dhe të përcaktohen proporcionet e traktorëve që duhet të sjellim. Proporcioni i shfrytëzimit të traktorëve duhet të llogaritet. Është e drejtë se traktorët që kemi janë të vjetër dhe punimi i tokave me anën e tyre na kushton. Gjithashtu duhet shikuar edhe interesi i traktoristëve sepse ata synojnë të marrin traktorë të rinj, me të cilët sigurojnë më shumë të ardhura.



Veç kësaj duhet parë edhe çështja e transportit në bujqësi, nëse duhet të sjellim kamionë apo traktorë që të mund të bëjnë si punët bujqësore, ashtu dhe transportin. Mendoj se është më mirë që të dyja këto punë t'i bëjnë traktorët. Kjo nuk duhet të përjashtojë shfrytëzimin në maksimum të mjeteve primitive që kemi për transport. Ministrat tanë, si anëtarë të Komitetit Qendror, këto çështje duhet t'i shikojnë në plan të përgjithshëm dhe të mos nisen nga interesa dikasteriale. Prandaj unë mendoj se Ministria e Bujqësisë duhet t'i ketë parasysh kritikën që iu bënë në këtë drejtim. Këto kritika duhen kuptuar drejt, në frymën e lartë shoqërore. Vështirësitë mund të kapërcehen me një punë më këmbëngulëse.

Jam dakord që mekanizimi i bujqësisë të shtohet, por ajo që ka rëndësi është pjesëmarrja më e gjerë në punë e fshatarësisë dhe e shfrytëzimit më të madh të kohës së punës. Është e domosdoshme që fushat e vogla t'i punojnë vetë fshatarët me forcat e tyre dhe të marrin rendimente gjithnjë e më të larta. Nuk duhet të nisemi nga koncepti «o burra mekanizma». Mekanizmat t'i përdorim atje ku është e arsyeshme, ku e kërkojnë punimet, ose për të bërë korrje të shpejta. Çështja kryesore është që të shfrytëzohen si duhet këto mekanizma që kemi dhe për këtë përgjegjëse është Ministria e Bujqësisë. Prandaj këshillat që u dhanë në këtë mbledhje të byrosë është e domosdoshme që Ministria e Bujqësisë t'i ketë parasysh. Fondet rezervë që ka kjo ministri të përdoren me vend, kurse për shumën të mëdha që i kalojnë kompetencat e saja të vendosin sipas rasteve Byroja Politike ose qeveria.

Në planin e ardhshëm duhet të shtojmë në një shkallë të gjerë mekanizimin në bujqësi, në ndërtim, në komunikacion etj., por brenda mundësive tona financiare. Këto të ndahen proporcionalisht dhe ku ka më shumë nevojë. Sa për makinat shirëse që prodhojmë vetë nuk duhet të trembemi se ato tani na kushtojnë shtrenjtë, sepse nesër, kur të prodhohen në seri, do të kushtojnë më lirë. Kemi 2-3 vjet që flasim edhe për makinat e silazhit e veglat e këmbimit por akoma detyrat në këtë drejtim nuk po zbatohen.

Për të shfrytëzuar më mirë mekanikën mendoj se do të jetë e nevojshme të merren inisiativa dhe të bëhen bashkime ofiçinash. Kjo gjë nuk përjashton detyrën për të bërë studime, por mua më duket se mbetëm në studime; krahas tyre duhen marrë edhe inisiativa e të kalohet në aksione konkrete.

Një problem i madh është ai i kuadrit mekanik. Duhet menduar e vepruar seriozisht për sigurimin e mekanikëve jo vetëm për bujqësinë por edhe për sektorët e tjerë sepse makineritë shtohen. Tani nuk është dhe aq lehtë të tërhiqen njerëz për t'i dërguar në shkollë që të bëhen mekanikë. Unë dëgjova në Kukës që i riu, megjithëse ka dëshirë të vejë në shkollë, gjen pengesa nga prindërit. Prandaj kërkohet punë bindëse për të siguruar kontingjentin e nevojshëm. Nga ana tjetër, të tregohet më shumë kujdes që konviktorët të mos flenë në vende të papërshtatshme siç ndodh në Shkodër.

Përsa i përket ndërtimit unë mendoj se shoku Josif<sup>1</sup> është i ndërgjegjshëm që makineritë e rënda

---

<sup>1</sup> Josif Pashko, në atë kohë ministër i Ndërtimit.

janë të tepërta dhe nuk janë shfrytëzuar si duhet. Tani çështja është të mendojmë për hapjen e fronteve të reja, gjë që duhet ta vendosim në planin e vitit 1960, ose mundet edhe më përpara.

Për kombinatin e tekstileve jam dakord me shokun Rrapo që plani vete mirë, që atje zbatohen metodat e reja etj. Mendoj se organizata e Partisë në kombinat dhe Komiteti i Partisë i Qytetit të Tiranës interesohen për këtë qendër të madhe industriale. Natyrisht këto suksese nuk duhet t'i dehin shokët tanë, por t'i nxitin që të luftojnë për zhdukjen e të metave që ekzistojnë. Unë mendoj që propozimet që u bënë në këtë mbledhje të përcaktohen më mirë dhe të punohet për zbatimin e tyre.

Besoj se me këto konkluzione dhe detyra të përgjithshme jemi dakord të gjithë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# TË LUFTOJËT KUNDËR LIBERALIZMIT NË DREJTIM TË PËRVETËSIMIT E TË SHPËRDORIMIT TË PASURISË SOCIALISTE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

30 shtator 1959

Jam dakord me raportin që është paraqitur dhe me vërejtjet që bënë shokët. Më duket se në shkeljen e këtyre rregullave ka shumë fajtorë. Fajtorët direktë duhet të dalin përpara gjyqit dhe të japin llogari. Pse janë këto dobësi në organizatën e Partisë të Elbasanit? Sepse në udhëheqje të saj ka njerëz liberalë. Shokët që zgjidhen në udhëheqje të Partisë duhet të dinë mirë se ulen nga përgjegjësia jo vetëm atëherë kur s'janë në rregull politikisht, por edhe kur punojnë keq. Pse t'u lihet shteg vjedhjeve dhe shpërdorimeve? Është

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua «Mbi shkeljen e rregullave në Bashkimin e Kooperativave të Konsumit në rrethin e Elbasanit», sipas raportit të paraqitur nga Drejtorja e tregti-financës pranë aparatit të KQ të PPSH.

e qartë se shokët drejtues në atë rreth nuk e bëjnë mirë detyrën.

Dihet se Partia jonë ka përgatitur shumë kuadro, për të cilët ne kemi qenë në situatë të vështirë. Tani janë krijuar mundësi që njerëzit e paaftë të zëvendësohen me më të aftë dhe që punojnë mirë. Në qoftë se për dobësitë që vërtetohen në Elbasan nuk marrim masa, atëherë fajtorët do të mendojnë se janë të pazëvendësueshëm. Gjithnjë janë vënë re dobësi në Elbasan, por për Tahir Demin<sup>1</sup> nuk keni marrë asnjë masë. Ai duhet të punojë mirë dhe të jetë i ndërgjegjshëm për besimin që i kanë dhënë Partia dhe pushteti popullor. Po kështu duhet të jenë të ndërgjegjshëm edhe drejtuesit e tjerë të rrethit për detyrat që u janë ngarkuar.

Për çmimet që vihen lidhur me garat socialiste dhe flamujt, duhet t'i paraqitet një raport Byrosë Politike dhe qeverisë që të merren masa të rrepta ndaj atyre që shkelin rregullat dhe bëjnë abuzime. Sinjalizime për këto çështje kanë pasur drejtuesit e Partisë në Elbasan, por, me sa duket, ata nuk janë në krye të punës dhe nuk u tregojnë vendin e duhur njerëzve që drejtojnë dhe, nga ana tjetër, të veprojnë për t'u prerë rrugën vjedhjeve dhe abuzimeve. Këto ndodhin nga mungesa e disiplinës në punë dhe si pasojë e shfaqjeve liberale në këtë fushë.

Është e domosdoshme që komiteti i Partisë të

---

1 Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Elbasanit. Më vonë, duke qenë agjent i shërbimeve të huaja të spiunazhit, u gjykua nga gjyqi i popullit dhe mori dënimin e merituar.

analizojë thellë punën e vet, pasi mjaft nga organizatat e Partisë të Elbasanit kanë dobësi të theksuara. Dhe kjo mund të bëhet mirë, sepse në këtë rreth ka shokë që kanë mbaruar Shkollën e lartë të Partisë. Si mund të ndodhë që në një rreth, siç është Elbasani, ku janë dy shokë me shkollë të lartë partie, të jetë e dobët puna edukative? Kësaj gjendjeje duhet t'i jepet fund. Ju, shokë të Komitetit të Partisë të Elbasanit, duhet ta analizoni çështjen në byronë e komitetit të Partisë ose në komitetin ekzekutiv dhe të merrni masa kundër liberalizmit që vihet re në atë rreth. Po të jetë nevoja të merren masa deri edhe në shkarkimin e ndonjërit, që mund të jetë i vjetër, duke e zëvendësuar me një tjetër që është i ri dhe i mirë. Nuk duhet të merret për bazë vetëm aktivi i luftës, por edhe puna që bën sot secili për ndërtimin socialist të vendit.

Po kështu, edhe shokët e enteve shtetërore duhet të marrin masa, sepse vjedhjet bëhen në sytë e tyre. Do të ketë njerëz, të cilët edhe në të ardhshmen do të përpiqen të vjedhin, por në qoftë se mbajmë qëndrim liberal ndaj tyre, vargu i vjedhjeve do të vazhdojë. Të përpiqemi që këtej e tutje të mos i vijmë qeverisë, Byrosë Politike dhe Sekretariatit çështje të tilla, prandaj të ngrihet më lart vigjilenca nga organet e Partisë e të shtetit, të parandalohen vjedhjet e shpërdorimet, të luftohet kundër liberalizmit në këtë drejtim.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA  
E RP TË KINËS ME RASTIN E 10-VJETORIT  
TË THEMELIMIT TË REPUBLIKËS  
POPULLORE TË KINËS**

**1 tetor 1959**

I dashur shoku ambasador,  
Të dashur shokë dhe miq,

Në radhë të parë dëshiroj që, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, si dhe të mbarë popullit shqiptar, të shpreh përshëndetjet më të zjarrta për popullin e madh kinez, për Partinë Komuniste dhe Qeverinë e Republikës Popullore të Kinës me rastin e kësaj feste të shënuar, dhjetëvjetorit të themelimit të Republikës Popullore të Kinës.

Krijimi i Kinës së re, më 1 tetor 1949, që i dha fund regjimit gjysmëfeudal dhe gjysmëkolonial të Kinës së vjetër, ka qenë ngjarja më me rëndësi në histori pas Revolucionit të madh Socialist të Tetorit.

Gjatë këtyre dhjetë vjetëve të ekzistencës së Republikës Popullore populli i madh kinez, i udhëhequr me urtësi nga Partia e lavdishme Komuniste e Kinës, me birin e shquar të popullit kinez, Mao Ce Dun

në krye, mundi të shkojë nga fitorja në fitore dhe të grumbullojë gjithnjë e më shumë forca të reja.

Të mëdha dhe të shkëlqyera janë sukseset e Republikës Popullore të Kinës në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të kulturës. Populli i mrekullueshëm dhe punëdashës kinez, duke bërë të gjitha përpjekjet për të arritur rezultate më të shpejta, më të mira dhe më ekonomike e duke përdorur si duhet ndihmën e vendeve të tjera socialiste, ka arritur fitore të papara në historinë e tij, në të gjitha fushat e ekonomisë dhe të kulturës.

Republika Popullore e Kinës, si rezultat i përparimit të madh të shënuar në vitin 1958, plotësoi katër vjet para afatit objektivet e planit të dytë pesëvjeçar në qymyrguri, lëndë-druri, drithë e kripë dhe pas realizimit të planit të këtij viti, të përparimit të madh dhe të vazhdueshëm, ajo do të ketë plotësuar gati tre vjet para afatit objektivet e parashikuara në planin e dytë pesëvjeçar për prodhimet kryesore industriale dhe bujqësore, si çeliku, pajisjet metalurgjike dhe energjitike, makinat elektrike për prerjen e metalit, letër, pambuk dhe fije pambuku. Në këtë mënyrë ajo do të ketë mundësi që të arrijë Anglinë në prodhimin e produkteve kryesore industriale, jo brenda 15 vjetëve, por në krye të 10 vjetëve. Populli kinez është i vendosur që brenda 15 vjetëve ose më pak, të ndërtojë një vend socialist me industri moderne, me bujqësi, shkencë dhe kulturë shumë të zhvilluar.

Popullin dhe Partinë tonë të Punës e kanë gëzuar kurdoherë fitoret historike të popullit vëlla kinez, duke i konsideruar ato si fitore të të gjithë kampit tonë të



socializmit. Përkundrazi këto fitore të pashembullta i tërbojnë armiqtë e paqes dhe të socializmit, imperialistët dhe revizionistët modernë.

Sukseset e shkëlqyera të popullit vëlla kinez përbëjnë një kontribut të madh në forcimin dhe në çelënkosjen e kampit të socializmit. Ato janë goditje të forta kundër imperializmit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, që edhe sot, pas dhjetë vjetësh ekzistence të lirë, nuk duan të njohin qeverinë e ligjshme të Republikës Popullore të Kinës dhe të drejtat e pamohueshme të këtij populli të madh paqedashës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si dhe bashkimin e Tajvanit kinez me tokën mëmë. Republika Popullore e Kinës, ky vend i madh dhe i fortë, duan ose nuk duan imperialistët, sot luan një rol të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare; ajo ka dhënë një kontribut të çmueshëm për pushimin e luftimeve në Kore dhe është bërë sot faktor paqeje e stabiliteti në Azi dhe në botë. Shembulli i Kinës, se çfarë mund të bëjë një popull, që në të kaluarën ka qenë i prapambetur, kur merr pushtetin në dorë, ka rëndësi të madhe për popujt e tjerë të Azisë dhe të Afrikës që luftojnë për një jetë të lirë dhe të pavarur.

Populli i madh kinez feston dhjetëvjetorin e themelimit të Republikës në një kohë kur kampi i socializmit po arrin nga dita në ditë suksese të shkëlqyera dhe kur «era e Lindjes po triumfon mbi atë të Perëndimit».

Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës, po ndërton me sukses socializmin dhe ka arritur suksese të mrekullueshme në të gjitha fushat

e aktivitetit ekonomik, shoqëror dhe politik. Këto suksese kanë sjellë një përmirësim të madh në jetën e popullit tonë dhe kanë forcuar Republikën Popullore të Shqipërisë si brenda vendit, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Shokë dhe miq,

Një miqësi e pathyeshme dhe vëllazërore bashkon popullin shqiptar me popullin e madh kinez, miqësi e farkëtuar dhe e çelnikosur në luftën e përbashkët anti-imperialiste për liri, pavarësi kombëtare dhe në luftën për paqe dhe socializëm. Të dy popujt tanë, të mbështetur në idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe të frymëzuar nga idealet e përbashkëta për ruajtjen e paqes, do të luftojnë si gjithnjë për të forcuar akoma më shumë miqësinë e tyre vëllazërore e unitetin e çelniktë të vendeve tona dhe do të jenë vigjilentë kundër të gjitha përpjekjeve të imperialistëve dhe revizionistëve modernë që synojnë të dobësojnë kampin tonë të socializmit.

Midis dy popujve tanë janë zhvilluar marrëdhënie të gjithanshme dhe ekziston një bashkëpunim i ngushtë e i sigurtë, i cili forcohet dita-ditës. Vizitat reciproke të delegacioneve të partive, qeverive, përfaqësuesve të popullit dhe të sektorëve të ekonomisë e të kulturës së të dy vendeve kanë ndihmuar në shkëmbimin e eksperiencës për ndërtimin e socializmit. Ndihma e madhe dhe e çmueshme që na ka dhënë dhe na jep Republika Popullore e Kinës për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, gatishmëria e saj për të plotësuar

të gjitha kërkesat tona, si edhe ndihmat në kredi, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë sonë popullore. Për të gjitha këto populli shqiptar i është mirënjohës popullit vëlla kinez dhe në këto ditë feste i drejton atij përshëndetjet e tija më të zjarrra vëllazërore dhe i uron suksese gjithnjë e më të mëdha!

Duke i uruar nga thellësia e zemrës popullit vëlla kinez fitore të reja të shkëlqyera në të ardhshmen në luftën për ndërtimin e socializmit, ju ftoj shokë dhe miq ta ngremë këtë doli:

Për popullin e mrekullueshëm kinez!

Për miqësinë vëllazërore e të pathyeshme midis popullit shqiptar dhe popullit të madh kinez!

Për Partinë Komuniste heroike të Kinës me udhëheqësin e sprovuar Mao Ce Dun!

Për qeverinë popullore kineze të kryesuar nga shoku Çu En Lai!

Për triumfin e paqes në botë!

Për shëndetin e të gjithë të pranishmëve në këtë pritje!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**NGA FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA  
AMBASADA E RD GJERMANE ME RASTIN  
E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT  
TË RD GJERMANE**

7 tetor 1959

I dashur shoku ambasador,  
Shokë dhe miq,

Më lejoni që, me rastin e dhjetëvjetorit të themelimit të Republikës Demokratike Gjermane, të përshëndes me gjithë zemër në emër të popullit shqiptar, të Partisë së Punës dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, popullin punëtor e paqedashës të Republikës Demokratike Gjermane dhe t'i uroj atij suksese gjithnjë e më të mëdha në rrugën e ndërtimit dhe të forcimit të rendit shoqëror socialist, në rrugën e fitores së çështjes kombëtare të popullit gjerman.

Shteti i parë i punëtorëve dhe i fshatarëve gjermanë lindi në saje të fitores historike të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, e cila shpartalloi ushtrinë fashiste të Hitlerit dhe i hapi popullit të Republikës Demokratike Gjermane rrugën drejt një të ardhshme paqësore.

Krijimi i Republikës Demokratike Gjermane më

7 tetor 1949 është kurorëzimi me sukses i përpjekjeve të mëdha historike të forcave demokratike antifashiste të popullit gjerman, për të krijuar një shtet me të vërtetë demokratik e paqësor. Lindja e shtetit të parë të punëtorëve dhe fshatarëve gjermanë shënoi një kthesë të rëndësishme në historinë e Gjermanisë sepse ajo zhdukuri përgjithnjë, në Republikën Demokratike Gjermane, pushtetin e imperialistëve dhe të militaristëve gjermanë me gjithë bazën e tyre ekonomike, krijoi kushtet e favorshme për përtëritjen kombëtare të Gjermanisë në një shtet paqësor e demokratik dhe u bë një kështjellë e fortë në luftën kundër imperializmit, në luftën për ribashkimin e Gjermanisë.

Gjatë dhjetë vjetëve të ekzistencës së tij të lirë, populli vëlla i Republikës Demokratike Gjermane, me punën e tij vetëmohuese dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik ka arritur suksese të shkëlqyera në zhvillimin e industrisë socialiste, në transformimin socialist të fshatit, në ngritjen e mirëqenies së tij ekonomike e kulture. Zhvillimi i madh i industrisë, brenda një kohe relativisht të shkurtër, përparimet e jashtëzakonshme të kooperativizmit në vjetët e fundit, jo vetëm që tregojnë epërsinë e sistemit socialist mbi atë kapitalist, por shpejt do ta bëjnë Republikën Demokratike Gjermane një vitrinë të bukur verbuese për imperialistët dhe militaristët e Bonit. Nuk ka dyshim se, me realizimin e planit shtatëvjeçar për zhvillimin e gjerë të ndërtimit dhe të fitores së socializmit, populli i Republikës Demokratike Gjermane do ta bëjë realitet detyrën kryesore ekonomike që i caktoi Kongresi V i Partisë Socialiste të Bashkuar, që ta kalojë Gjermaninë

Perëndimore në konsumin për frymë të popullsisë në artikujt kryesorë ushqimorë dhe të konsumit të gjerë.

Krahas këtyre sukseseve të mëdha në ndërtimin e shoqërisë socialiste, të cilat i gëzojnë zemrat e popullit gjerman dhe të të gjithë popujve paqedashës, Republika Demokratike Gjermane ka bërë dhe vazhdon të bëjë përpjekje të shumta për të zgjidhur në mënyrë të drejtë çështjen gjermane, e cila pengohet qëllimisht nga fuqitë perëndimore që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore. Ajo lufton si gjithnjë për të përfunduar traktatin e paqes në të dy shtetet gjermane dhe për të zhdukur vatrën e tensionit në Berlinin Perëndimor, vatër e rrezikshme agresioni e imperializmit dhe e militarizmit të Gjermanisë Perëndimore kundër Republikës Demokratike Gjermane. Por përballë lojës kriminale dhe të rrezikshme të militarizmit gjerman dhe të forcave që e përkrahin atë qëndron klasa heroike punëtore gjermane, të gjitha forcat paqedashëse të popullit gjerman, qëndron i patundur populli vëlla i Republikës Demokratike Gjermane dhe ata do të bëjnë që të dështojnë planet e imperialistëve gjermanë. Zhdukja e mbeturinave të Luftës së Dytë Botërore, përfundimi i traktatit të paqes me Gjermaninë dhe likuidimi i regjimit të pushtimit në Berlinin Perëndimor janë probleme urgjente që popujt kërkojnë të zgjidhen sa më parë. Populli dhe Partia jonë kanë besim se këto probleme do të gjejnë zgjidhjen e duhur dhe do të hapet rruga për ribashkimin e Gjermanisë, për përtëritjen e saj kombëtare në një shtet të vetëm demokratik dhe paqësor.

Populli dhe Partia jonë i përshëndesin me gjithë

zemër përpjekjet paqësore të popullit vëlla të Republikës Demokratike Gjermane, si dhe luftën e palodhur që ai bën, në gjirin e kampit socialist, për ruajtjen e paqes, për forcimin e miqësisë me të gjithë popujt paqedashës, për forcimin e unitetit dhe të kompaktësisë së kampit tonë të fuqishëm.

Shokë dhe miq,

Kremtimi i festës së dhjetëvjetorit të Republikës Demokratike Gjermane, po bëhet në një kohë kur kampi ynë i socializmit, me Bashkimin Sovjetik në krye, ecën me vrull të pandalshëm drejt fitoreve të reja në fushën politike, ekonomike, kulturele, shkencore dhe teknike. Përparimet e të gjitha vendeve të kampit tonë po forcojnë çdo ditë besimin e patundur të të gjithë njerëzimit paqedashës për një të ardhshme të lumtur paqësore.

Populli shqiptar, i cili ka ndjekur me interesim të veçantë përparimet e mëdha që ka realizuar populli i Republikës Demokratike Gjermane, në ndërtimin socialist të vendit, si edhe përpjekjet e tija për të stabilizuar gjendjen në qendër të Evropës, gëzohet shumë kur shikon se ai ndjek në mënyrë konsekuente dhe në përputhje me interesat e të gjithë popujve paqedashës një politikë të afrimit dhe të marrëveshjes, të paqes dhe të ndërtimit socialist. Si mik e vëlla, ai gëzohet shumë për sukseset e arritura në Republikën Demokratike Gjermane dhe i konsideron ato si suksese që ndihmojnë në forcimin e Republikës Popullore të Shqipërisë, në forcimin e gjithë kampit socialist.

Duke i uruar edhe një herë popullit vëlla të Re-

publikës Demokratike Gjermane suksese të reja e më të mëdha në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të ruajtjes së paqes, më lejoni ta ngre këtë dolli:

Për Republikën Demokratike Gjermane dhe presidentin e saj, militantin e lavdishëm të lëvizjes punëtore ndërkombëtare, shokun Vilhelm Pik!

Për miqësinë midis dy popujve tanë!

Për fitoren dhe forcimin e paqes në botë!

Për shëndetin tuaj shoku ambasador!

Për shëndetin tuaj të dashur shokë dhe miq!

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*



## **MBI PËRHAPJEN E INISIATIVËS SË KOLEKTIVIT PUNONJËS TË KOMBINATIT TË TEKSTILEVE «STALIN» PËR KURSIMIT E LËNDËS SË PARË**

*Letër komiteteve të Partisë në rrethe*

**16 tetor 1959**

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në shqyrtimin që i bëri kohët e fundit inisiativës së kombinatit të tekstileve «Stalin» për kursimin e lëndës së parë, me kënaqësi konstatoi se kolektivi punonjës i kësaj ndërmarrjeje, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, i mobilizuar për të zbatuar vendimet e Kongresit III të PPSH dhe të Plenumit të Shkurtit 1958 të Komitetit Qendror, duke u përfshirë në emulacionin socialist për nder të 15-vjetorit të Çlirimit, po plotëson me sukses zotimin e marrur, për të dhënë mbi planin e këtij viti, nga kursimi i lëndës së parë, 230 mijë ml tekstile të pambukta dhe 10 mijë ml tekstile të leshta.

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH përgëzon kolektivin punonjës të kombinatit të tekstileve «Stalin» për këtë inisiativë, për rezultatet e para që ka arritur

në kursimin e lëndës së parë si dhe kolektivet punonjëse dhe organizatat-bazë të Partisë të ndërmarrjeve të tjera ekonomike, që e kanë përkrahur këtë iniciativë dhe po punojnë nën shembullin e kombinatit të tekstileve «Stalin» si inisiatori i garave socialiste midis ndërmarrjeve për vitin 1959.

Me qëllim që kjo iniciativë e vlefshme të gjejë një përhapje të gjerë, Sekretariati i KQ të PPSH porositi komitetet e Partisë të rretheve, organizatat-bazë të Partisë në ndërmarrjet ekonomike, organet ekonomike shtetërore dhe organizatat e masave, që t'i kushtojnë në të ardhshmen një kujdes më të madh kursimit të lëndës së parë, e në mënyrë të veçantë të lëndëve deficitare, materialeve ndihmëse etj., pasi vihet re se kjo iniciativë nuk është përqafuar nga të gjitha qendrat e punës e si rrjedhim në disa ndërmarrje jo vetëm nuk kemi kurse, por përkundrazi tejkalime në përdorimin e materialeve, duke shkaktuar ngritjen e kostos.

Komiteti Qendror i PPSH gjithnjë ka bërë të ditur se vendosja e një regjimi rigoroz kursimi në të gjitha degët e ekonomisë popullore nuk ka karakterin e një fushate të përkohshme, por është metodë e drejtimit të ekonomisë së planifikuar socialiste, se duhen bërë përpjekje të vazhdueshme për kursimin e çdo kilogrami të lëndës së parë, lëndës djegëse, çdo kilovat-orë të energjisë elektrike, që çdo pjesëtar i kolektivit punonjës të ndjejë përgjegjësinë e përditshme për përdorimin sa më me kursim të materialeve. Komunistët

duhet të jenë shembull në këtë punë dhe të tërheqin pas vetes gjithë kolektivin punonjës të repartit dhe të ndërmarrjes.

Kujdes i posaçëm i duhet kushtuar punës politike me masat. Çështjet e kursimit të lëndës së parë dhe të vlerave të tjera materiale duhet të jenë në qendrën e vëmendjes së punës së agjitorëve, propagandistëve, lektorëve, të diskutohen herë pas here në mbledhjen e Partisë, në mbledhjen e prodhimit, të pasqyrohen në agjitacionin figurativ dhe në shtypin e ndërmarrjeve.

Organizatave bashkimeve profesionale, të grave, të Bashkimit të Rinisë së Punës etj, në bashkëpunim me drejtuesit e reparteve, ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike, të organizojnë shqyrtime shoqërore të regjimit të kursimit, të ngrenë grupe inisiatore, poste kontrolli, të organizojnë konkurse dhe konferenca tekniko-prodhuese për kursimet.

Kursimi i lëndës së parë nuk duhet të bëhet në asnjë mënyrë në dëm të cilësisë dhe të shkeljes së asortimenteve të planifikuara të prodhimit.

Komiteti Qendror i PPSH ka besim se kolektivet punonjëse të ndërmarrjeve ekonomike, organizatat e Partisë dhe ato të masave, të mobilizuara për nder të festës së madhe të 15-vjetorit të Çlirimit të atdheut, krahas realizimit të planit dhe zotimeve, do të marrin masa për të vënë në jetë sa më shpejt inisiativën e përparuar të kolektivit punonjës të kombinatit të tekstileve «Stalin», me qëllim që të prodhojnë më shumë e më

mirë, me kosto më të ulët, duke plotësuar kështu një nga detyrat e Kongresit III të PPSH, për të krijuar kushtet e nevojshme për rritjen e mëtejshme të mirëqenies së masave punonjëse.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LETËR QYTETARIT SOVJETIK A. MUROMCJEV

21 tetor 1959

SHOKUT ALEKSEJ MUROMCJEV

*M o s k ë*

I dashur shoku Muromcjev,

Mora letrën tuaj, e cila më ka prekur thellësisht. Letra juaj, sidomos fotografia, në të cilën unë dhe bashkëshortja ime kemi dalë me vëllanë tuaj, të ndjerin Viktor Nikollajeviç<sup>1</sup>, më kujtoi vjetët e largët të luftës sonë për çlirimin e atdheut, ajo më kujtoi edhe ditët e këndshme plot entuziazëm që ne kaluam duke pasur në gjirin tonë mikun dhe vëllanë tonë të dashur, birin e denjë të popullit sovjetik, shokun Viktor, i cili e donte aq shumë Shqipërinë dhe popullin tonë dhe që luftoi e punoi pa u kursyer për të paraqitur në mënyrë sa më të drejtë e të denjë vendin tonë në filmin «Shqipëria».

Unë personalisht si dhe shokët e mi e gjithë ata që e kanë njohur shokun Viktor, veçanërisht banorët

---

<sup>1</sup> Toger Viktor Nikollajeviç Muromcjev, kinooperator sovjetik, laureat i çmimit «Stalin». U vra më 30 prill 1945 në luftë për çlirimin e Triestes.

e kryeqytetit të vendit tonë, nuk do t'i harrojnë kurrë heroizmat që ai tregoi për kryerjen e detyrës së tij gjatë luftës për çlirimin e Tiranës nga pushtuesit fashistë gjermanë. Ai punoi e luftoi ashtu siç i ka hije njeriut sovjetik, të edukuar nga Partia e madhe e Leninit, të mësuar nga shkolla e Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe të kalitur në betejat legjendare të popullit sovjetik kundër armiqve të njerëzimit. Ne u hidhëruam pa masë, kur morëm vesh se Viktori ka rënë në luftën kundër fashizmit pikërisht në pragun e ditës së fitores, në kohën kur e gjithë bota do të festonte me madhësi triumfin e plotë të armëve ngadhnjimtare sovjetike mbi bishën fashiste. Viktori, duke plotësuar deri në fund detyrën ndaj popullit, atdheut dhe gjithë njerëzimit, ra në fushën e nderit. Por, siç thotë populli, njerëz të tillë nuk vdesin, ata rrojnë për shekuj në mendjen dhe në zemrat e popujve, për të cilët ata japin jetën. Ne do të ruajmë përgjithmonë kujtimet më të mira nga vëllai juaj dëshmor.

Duke ju shprehur, ndonëse pas 14 vjetësh, ngushëllimet e mia të thella për vdekjen e vëllait tuaj, ju dërgoj falenderimet më të përzemërta për letrën dhe fotografinë aq të dashur që më dërguat, si edhe ju uroj juve dhe familjes suaj shëndet të mirë, jetë të lumtur e të gëzuar, suksese në punën tuaj fisnike! Shumë të fala ju dërgon gjithashtu shoqja ime, Nexhmija.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TË PËRMIRËSOHET MË TEJ PUNA E PARTISË NË DIKASTERE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**21 tetor 1959**

Do të theksoj edhe unë disa çështje që dolën në këtë mbledhje. Jam dakord me të gjitha vërejtjet që u bënë si në raport, ashtu dhe gjatë diskutimeve. Qëllimi i marrjes në shqyrtim të kësaj çështjeje është përmirësimi i mëtejshëm i punës në organet qendrore, të cilat i japin tonin gjithë punës së shtetit në realizimin e planeve tona. Problemi është që në dikastere të funksionojnë në rregull organizatat e Partisë, të forcohet disiplina në punë, të zhduket burokratizmi dhe t'i jepet një ndihmë më e madhe bazës në zbërthimin e detyrave dhe në plotësimin e nevojave të saja.

Shokët që diskutuan ngritën disa çështje që janë të rëndësishme. Shoku Rrapo [Dervishi] theksoi me të

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua «Mbi punën e organizatave-bazë të Partisë të administratës në qytetin e Tiranës».

drejtë rolin e sekretarëve të organizatave-bazë të Partisë, të cilët shpeshherë, shumë çështje i shikojnë si zëvendësministra dhe jo si sekretarë të organizatave të Partisë. Ministrat janë anëtarë të Komitetit Qendror dhe e kuptojnë më mirë rolin dhe punën e sekretarit të organizatës. Sekretari i Partisë duhet t'i shikojë problemet me syrin që organizata-bazë që drejton të ndihmojë për zhdukjen e të metave që ekzistojnë në dikastere. Prandaj, zëvendësministrat ta konsiderojnë sekretarin e organizatës-bazë jo si një shok të rangut të tyre, në rrugë shtetërore, por si një shok që e ka zgjedhur organizata-bazë e Partisë dhe që mund të kërkojë prej tyre të raportojnë në organizatën-bazë për punën që bëjnë, për sektorët që drejtojnë. Mendoj që të organizohet në Komitetin Qendror një seminar, ku të shtrohet roli i organizatave të Partisë në dikastere. Me siguri që kjo do të jetë një ndihmë e madhe. Në këtë seminar nuk është keq të thirren, përveç sekretarëve të organizatave-bazë, edhe drejtorët e dikastereve në mënyrë që të përfitojnë edhe ata e të largohen nga puna me frymë dikasteriale.

Në këtë mbledhje janë thirrur dhe dy shokë ministra, të cilët mund të influencojnë për një punë më të mirë në organizatat-bazë të Partisë ku ata bëjnë pjesë. Këtë ndihmë duhet ta japin edhe ministrat e tjerë në organizatat ku militojnë.

Për forcimin e punës së Partisë në dikastere detyra të veçanta kanë dhe sekretarët e Komitetit Qendror. Në radhë të parë sekretarët e Komitetit Qendror duhet të mbajnë kontakt me sekretarët e organizatave të Partisë të dikastereve jo vetëm për të metat që konstatohen



në këto administrata, por edhe kur venë në bazë e në rrethe. Organizatat e Partisë të dikastereve nuk duhet të veprojnë në rrugë shtetërore duke ndjekur thjesht realizimin e planit të industrisë ose të bujqësisë, por sipas problemeve që dalin, të venë në komitetin e Partisë dhe të bisedojnë. Shokë të qendrës, kur kthehen nga baza, të diskutojnë në organizatë duke parë me sy kritik anët negative të dikasterit. Kjo gjë duhet bërë në mënyrë më të organizuar.

Shokët e dikastereve është e domosdoshme të luftojnë më mirë kundër burokratizmit. Këtë burokratizëm nuk duhet ta shohim vetëm në shkresat e shumta që bëhen, por sidomos në konceptet dhe qëndrimet ndaj punës, në përgjigjet ndaj kërkesave e ankesave të popullit, në lidhjen me masat, korrektësinë, modestinë etj. Realizimi i planit në të gjithë treguesit e tij cilësorë nuk duhet të ndiqet vetëm duke u mbështetur në kartat. Kur shokët venë në bazë, duhet të dinë që kur nisen se për çfarë do të shkojnë, të marrin lidhje me Komisionin e Planit ose me dikasteret e tjera, të pregatiten dhe të venë në rrethe për të ndihmuar sa më mirë. Nuk është e lejueshme që kur shokët e organeve qendrore venë në bazë, pasi të kthehen, të thonë se kjo ose ajo çështje s'është në kompetencën tonë, se duhet studjuar me dikasteret e tjera etj.

Eksperienca ka treguar se vajtja në bazë me ekipe jep rezultate të mira. Në qoftë se këto ekipe organizohen mirë, atëherë, të paktën rrethi për 6 muaj duhet të ecë përpara dhe të ketë ndryshime me periudhën para se ta ndihmonte ekipi. Puna me ekipe nuk përjashton rastet që të shkohet në rrethe për çështje urgjente. Kështu

për shembull, ministri i Bujqësisë mund të vejë në rrethe dhe për gjysmë dite për një punë të caktuar që nuk kërkon shumë kohë.

Ministrat, para se të venë në ndërmarrje për një problem, duhet të marrin kontakt edhe me sekretarin e komitetit të Partisë dhe me kryetarin e komitetit ekzekutiv të rrethit, të cilët i dinë më mirë çështjet në territorin e tyre. Kjo gjë do t'i informojë si duhet ministrat dhe do t'i orientojë ata që të ndihmojnë më mirë për problemin që kanë shkuar në rreth. Zbatimi i një sistemi pune të tillë nga shokët ministra, do të bëjë që të mund të luftohet me sukses burokratizmi dhe t'i jepet një ndihmë më e madhe e më e kualifikuar bazës. Nga ana tjetër, dikasteret të kenë mirë parasysh që të plotësojnë si duhet detyrat e tyre ndaj ndërmarrrjeve.

Si përfundim mund të themi se organizatat-bazë të Partisë në dikastere janë forcuar, por të metat që u vunë në dukje ekzistojnë, prandaj duhet të luftohen. Edhe grupet e Partisë, atje ku shihet e nevojshme dhe plotësohen kriteret, të ndërtohen, por të kihet parasysh që të mos bashkohen komunistët e një drejtorie me një drejtori tjetër, sepse kjo nuk do të ishte e arsyeshme.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tarlatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## POPULLI TË FURNIZOHET MIRË DHE LIRË ME PERIME E FRUTA

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 tetor 1959

Siç thanë edhe shokët e tjerë, problemi që shqyrtojmë është shumë i rëndësishëm dhe duhet të na tërheqë seriozisht vëmendjen, me qëllim që të zgjidhet më mirë në të ardhshmen. Analiza që po bëjmë tregon se prodhimi i perimeve e i frutave nuk është zbatuar në sasinë e duhur dhe me çmime më të ulëta sipas detyrave të caktuara nga Komiteti Qendror. Edhe tregtia, në qoftë se nuk merr masa për grumbullimin dhe shpërndarjen e mirë të tyre, do të ketë vështirësi të mëdha për prodhime më të shumta. Prandaj puna duhet organizuar më mirë si nga prodhuesit, ashtu dhe nga sektori i tregtisë.

Më duket se çështja e çmimit të perimeve e të

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në analizë zbatim i detyrave të Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH për furnizimin e popullit me perime dhe fruta.

frutave ka shumë rëndësi. Prandaj kjo çështje duhet shikuar. Unë përjashtoj rastet që, kur nuk bëhet rrushi, çmimi do të jetë i shtrenjtë, ndryshe është me perimet. Ne nuk e kemi shumë të sistemuar çmimin e tyre, ato janë të pakta dhe të shtrenjta. Fshatari nuk u jep këtyre rëndësinë e duhur, ashtu si vepron me portokallet dhe limonat. Komisioni i Planit po studjon se sa harxhon një familje për veshmbathje dhe për sende të tjera të nevojshme, por ky studim akoma nuk është përfunduar. Sidoqoftë ne duhet t'i ulim çmimet e perimeve e të frutave, gjë që do të mund të bëhet duke shtuar prodhimet e tyre, me një trajtim më të mirë, që të mos prishen e vidhen, por të furnizohen si duhet konsumatorët.

Lidhur me atë që tha Gogo Kozmai<sup>1</sup> se perimet dhe frutat nuk i jepen tregtisë në afatin e duhur, mendoj se duhet të mbahet parasysh, por të mbahet dhe parasysh që bujqësia nuk është fabrikë. Tregtia nuk mund të kërkojë që të kronometrojë prodhimet bujqësore me ditë të caktuara. Natyrisht, detyra e bujqësisë është që të prodhojë sa më parë, në mënyrë që populli të furnizohet në kohën e duhur dhe me bollëk. Por prodhimi i perimeve varet gjer në një farë shkalle nga kushtet atmosferike. Tregtia ka përmirësime, por faktet që u përmendën këtu tregojnë se ajo nuk u përgjigjet si duhet prodhimeve, megjithëse këto janë akoma të pakta. Nesër do të kemi më shumë prodhime, sepse sot ato janë llogaritur me norma jashtëzakonisht të vogla në krahasim me nevojat e popullatës. Në qoftë

---

<sup>1</sup> Gogo Kozma, zëvendësministër i tregtisë.

se tregtia s'punon mirë sot, si do të përballojë punën në të ardhshmen, kur prodhimi i perimeve dhe i frutave do të shtohet? Gogo Kozmai tha gjithashtu që prodhimet të na vijnë atje ku do tregtia. Po tregtia s'është pa makina. Konsumi ka mbi 280 automjete, tregtia ka jashtë kuotës së transportit 150 të tjera. Prandaj, organet e tregtisë dhe të kooperativave të konsumit ta organizojnë më mirë punën për tërheqjen dhe shpërndarjen e këtyre prodhimeve. Ferma e Lushnjës, për shembull, duhet të dorëzojë prodhimet e saj në organet e tregtisë në Lushnjë, por, sipas nevojave, një pjesë e tyre mund t'i jepen, fjala vjen, Gramshit. Çështja që doli këtu se Shijaku shpie në Gjirokastër prodhime, sepse s'ia merr tregtia, nuk duhet të ndodhë më.

Është e vërtetë që transportin nuk e kemi me bollëk, por nuk është e drejtë të thuhet se nuk kemi farë. Asnjë ent nuk i shfrytëzon si duhet mjetet e transportit. Unë kam mjaft kritika për kooperativat e konsumit. Disa nga këto bëjnë veprime të jashtëligjshme. Organet e grumbullimit u marrin fshatarëve leshin dhe mishin e cilësisë së parë për cilësi të dytë, me qëllim që të jenë brenda. Kjo mund të ndodhë edhe me frutat e perimet, të cilat mund të prishen. Në qoftë se ne i marrim këto prodhime me çmime të ulëta mund të vijë koha që të kemi vështirësi më të mëdha.

E përsërit edhe një herë se për perimet duhet treguar një kujdes më i madh. Komunistët që punojnë në kooperativat e konsumit të kuptojnë qartë se qëllimi i Partisë dhe i qeverisë është që populli të furnizohet mirë dhe lirë. Në të kundërtën dëmtohet çështja e Partisë. Kur ka fruta të shumta ne do të përpiqemi t'i

eksportojmë, prandaj organet përkatëse brenda kushteve që kemi duhet të marrin masa. Fabrikat e përpunimit të frutave kanë reparte tharjeje, por si është e mundur që nuk transportohen kumbullat dhe gështenjat e Tropjës për t'u tharë në fabrikat e Shkodrës? Prandaj për të gjitha këto çështje është e domosdoshme që të mobilizohen si duhet organet e bujqësisë, të industrisë dhe veçanërisht kooperativat e konsumit dhe tregtia.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

**LETËR ORGANIZATËS SË BRPSH TË REPARTIT  
USHTARAK NR. 217**

*Leskovik*

**23 tetor 1959**

Të dashur shokë,

Me vëmendje të madhe lexova letrën që më dërguat me rastin e konferencës së repartit për dhënie llogari e zgjedhje në organizatën e BRPSH-së. Në emër të Komitetit Qendror të PPSH ju përshëndes dhe ju uroj nga zemra për sukseset që keni arritur në edukimin komunist të rinisë dhe në kryerjen e detyrës së shenjtë për ruajtjen e kufijve të atdheut tonë të dashur.

Ashtu si ju mëson Partia, ju flisni në letrën tuaj me zemër të hapur, flisni jo vetëm për sukseset, por edhe për të metat e dobësitë në punë. Por në të njëjtën kohë letra juaj është e përshkuar fund e krye nga besimi i patundur që ju, ashtu si gjithë rinia heroike e vendit tonë, keni te Partia, nga dashuria e pakufishme për popullin e atdheun, nga shpirti i vetëmohimit, vendosmëria dhe gatishmëria për të kapërcyer çdo vështirësi, për të ndrequr çdo të metë dhe për të kryer kurdoherë me nder detyrën.

Juve ju është besuar detyra e shenjtë e ruajtjes së paprekshmërisë së kufijve dhe të integritetit tokësor të atdheut; ju siguron punën dhe jetën paqësore të popullit tonë. Kjo është një çështje e madhe nderi dhe një detyrë patriotike.

Sigurisht, ju e dini mirë se imperialistët luftënxitës dhe shërbëtorët e tyre të të gjitha ngjyrave janë përpjekur dhe akoma përpiqen t'i vënë zjarrin botës; ata mundohen të ruajnë «luftën e ftohtë» e ta shndërrojnë atë në një «luftë të nxehtë», zhvillojnë garën e shfrenuar të armatimeve dhe ndërtojnë baza agresive atomike rreth vendit e kampit tonë socialist. Përballë tyre qëndrojnë vendet socialiste e të gjithë njerëzit paqedashës e përparimtarë të botës. Por mos vallë njerëzit paqedashës duhet të prehen mbi dafina? Përkundrazi. Fjala e urtë e popullit tonë thotë: «Ujë të fle, hasmi s'fle». Ujqërit monopolistë, që tërë jetën e tyre e kanë kaluar duke thithur gjakun dhe djersën e popujve dhe që nxjerrin fitime kolosale nga gara e armatimeve, qimen mund ta ndërrojnë, por zakonet jo; ata janë gati të shfrytëzojnë çdo rast për t'i ngulur dhëmbët e tyre mbi kampin tonë. Pa dyshim në një rast të tillë ata do të mbeteshin jo vetëm pa dhëmbë, por dhe pa kokë. Sidoqoftë popujve do t'u shkaktonin vuajtje e mjerime të mëdha. Në anën tjetër të kufijve të Republikës sonë ju e dini se ç'bëhet: në Itali janë ngritur baza atomike me raketa të drejtuara kundër nesh; në Greqi gjithashtu po ngrihen baza të këtilla; në Jugosllavi, revizionistët jugosllavë, armiq të betuar të marksizëm-leninizmit, blejnë aeroplanë nga amerikanët dhe aktivizojnë kriminelët e luftës që kanë grumbulluar, përgatitin spiunë



e diversantë kundër vendit tonë. Ju vetë jeni ndeshur më se një herë me spiunë, diversantë e shkelës të kufirit dhe u keni treguar atyre vendin; me të tillë ju do të ndesheni edhe në të ardhshmen.

Prandaj është e domosdoshme që të ruhet e të forcohet vigjilenca revolucionare që karakterizon popullin tonë dhe sidomos rojet tona trime të kufirit. Duke qenë vigjilentë syrit tuaj të mprehtë nuk do të mund t'i shpëtojë asnjë armik dhe kufirin tonë s'do të mund ta kapërcejë asnjë këmbë e tij. Për këtë arsye kufitari s'mund dhe s'duhet të pajtohet kurrsesi me mungesën e vigjilencës. Por që kufitari ta kryejë me nder besimin që i është dhënë, nuk mjafton vetëm kjo. Për këtë duhet dhe disiplinë e çelniktë. Të gjithë e dinë se disiplina në çdo detyrë bën që punët të shkojnë si sahat dhe të kryhen me përpikëri. Por për vetë natyrën dhe karakterin e detyrës së kufitarit ajo për ju ka një rëndësi vendimtare. Prandaj ju s'duhet të pajtoheni në asnjë rast me thyerjet e disiplinës dhe shthurjet në shërbim e në jetën e përditshme. Zbatimi i ndërgjegjshëm, pa kushte, shpejt, me përpikëri dhe mirë i urdhërave të oficerëve dhe nënoficerëve duhet të jetë motivi kryesor i kufitarit. Ndryshe s'mund të sigurohet mbrojtja e pakapërcyeshme e kufirit.

Sigurisht në kufi ka më tepër vështirësi se në sektorët e tjerë të jetës sonë; ju nuk i keni të gjitha kushtet që kanë punonjësit e tjerë në detyrat dhe në jetën e tyre të përditshme; ju jeni të detyruar të përlesheni me vështirësitë e natyrës, me shiun, borën e tufanin. Por pikërisht për këtë arsye populli ka dërguar në kufi bijtë e tij më të mirë që natë e ditë i mban në

zemër, prandaj ju duhet të jeni gjithmonë të papërkulur përpara çdo vështirësie. Në luftë me vështirësitë duhet të kalitet shpirti dhe trupi i kufitarit të Shqipërisë së re.

Një kusht i domosdoshëm për të kryer me nder detyrën është rritja e mjeshtërisë kufitare. Çdo njeri që dëshiron ta kryejë mirë punën në sektorin e tij, përpiqet në radhë të parë të zotërojë profesionin, të rritë mjeshtërinë e tij. Të dish të ruash kufirin, të gjurmosh, të zbulosh dhe të neutralizosh armikun është, si të thuash, një art më vete. Këtë art mund dhe duhet ta përvetësojë më së miri çdo njeri që i thotë vetes kufitar i vërtetë. Në këtë drejtim ju keni grumbulluar një eksperiencë të madhe sepse të panumërta janë mrekullitë e kufitarëve tanë të lavdishëm. Kjo eksperiencë duhet përgjithësuar me të gjitha mjetet e format. Ajo duhet pasuruar me inisiativën tuaj krijuese në përputhje me kërkesat e rregulloreve dhe urdhërat e komandës.

Ne kemi marrë vesh se ju aktivizoheni në punime të ndryshme; organizatat e rinisë kanë shpallur si aksion të tyre zbulimin e postave me lulishte e pemë, ju po krijoni ekonomi ndihmëse pranë tyre, ndihmoni fshatarët në punë etj. Të gjitha këto janë gjëra shumë të mira dhe për këtë Partia ju përgëzon. Ato ndihmojnë për ta bërë sa më të këndshme jetën në postat tuaja, për të krijuar kushte sa më të mira jetese. Këtë punë ju duhet ta vazhdoni edhe në të ardhshmen, bile të punoni edhe më shumë dhe të aktivizoheni të gjithë, atëherë përfitimet do të jenë edhe më të mëdha. Por duhet pasur kujdes që ato të mos bëhen në kurriz të

detyrës kryesore që ju është ngarkuar, që ato të mos pengojnë kryerjen mirë të shërbimit për mbrojtjen e kufirit. Këto duhet të bëhen me plan, me orar dhe sipas udhëzimeve që janë dhënë.

Një çështje mjaft me rëndësi është ajo e marrëdhënieve që ju kufitarët, duhet të keni me masat e popullit dhe me organizatat e rinisë së terrenit. Ju ruani popullin, por bazën dhe burimin e fuqisë suaj e keni te populli. Në të vërtetë, ashtu siç ju ka mësuar Partia, lidhjet midis jush janë mjaft të mira. Shprehje e qartë e kësaj është ndihma që ju u jepni fshatarëve në punët bujqësore, ndihma që ata ju japin juve në ndërtimet xhenero-teknike, njësitet e vigjilencës që kanë ngritur organizatat e rinisë së fshatrave, bashkëpunimi në kapjen e shkelësve të kufirit, mbrëmjet e përbashkëta të dëfrimit që organizoni etj. Por këto lidhje në të ardhshmen duhet të çelnicosen vazhdimisht. Nga ana tjetër, ju që mbroni popullin duhet të jeni edhe mbrojtësit më të zjarrtë të ligjshmërisë socialiste. T'i respektoni dhe t'i ruani si sytë e ballit të drejtat dhe pasurinë e popullit.

S'ka dyshim se këto detyra do të kryhen aq më mirë, sa më e lartë të jetë ndërgjegjja e kufitarit. Në këtë çështje organizatat e rinisë duhet të luajnë rolin e tyre kryesor. Të përmirësojnë dhe të forcojnë punën e tyre ideopolitike dhe kulturele — ja ç'kërkohet në radhë të parë nga organizatat e rinisë. Ju duhet të jeni në korrent të vendimeve të Partisë e të qeverisë, të kuptoni sa më thellë politikën e Partisë, të dini sa më mirë se ç'bëhet në botë dhe ta keni sa më të qartë fytyrën e egër dhe qëllimet agresive të imperialistëve.

Nga ana tjetër, kufitari duhet të jetë kudo e kurdoherë shembull i moralit të lartë komunist. Kufitarët duhet t'i karakterizojë gjithashtu dashuria e pakufishme për shoku-shokun, për kolektivin. Pas kryerjes së afatit të shërbimit ushtarak, nga repartet e kufirit duhet të kthehen në terren reparte të tëra punëtorësh e fshatarësh të kalitur nga pikëpamja ideologjike, politike dhe kulturele. Prandaj organizatat e rinisë të bëjnë vazhdimisht një punë edukative në forma sa më interesante, të zgjerojnë punën me leksione, të shfrytëzojnë sa më mirë shtypin, t'ju afrojnë sa më tepër me librin, të pajisin dhe të shfrytëzojnë si duhet dhomat ushtarako-politike.

Si gjithnjë në punën tuaj ju do të keni ndihmën e pakursyer të organizatave të Partisë dhe të komandave. Ju duhet të përpiqeni të siguronit sa më mirë udhëheqjen e Partisë, pasi kjo është garancia kryesore e të gjitha fitoreve tona. Kërkoni të zbatohen fjala e Partisë dhe urdhërat e komandës, shkoni te komunistët si te vëllezërit tuaj dhe ata do t'ju kuptojnë e do t'ju ndihmojnë për çdo gjë, shkoni te komandantët dhe zëvendëskomandantët për punë politike si te prindërit tuaj me zemër të hapur dhe ata do t'ju dëgjojnë e s'do të kursehen për t'ju ndihmuar që punët të shkojnë sa më mirë. Ata e dinë mirë detyrën e tyre dhe si gjithnjë do të jenë pranë jush.

Së shpejti do të festojmë 15-vjetorin e Çlirimit të atdheut, që është ngjarja më e lavdishme në historinë e popullit tonë. Fitore të shkëlqyera ka arritur populli ynë në këta vjetë nën udhëheqjen e PPSH. Në roje të këtyre fitoreve kanë qenë dhe janë forcat tona të

armatosura heroike, forcat e lavdishme të kufirit, gjithë populli ynë. Partia ka besim të patundur te ju dhe në të gjitha forcat e kufirit dhe është e sigurtë, ashtu siç thoni edhe ju në letrën tuaj, se «armiqtë s'do të mundin të prekin e të prishin lirinë e fitoret tona as në shekujt e ardhshëm».

Me këtë rast, në emër të Komitetit Qendror dhe timin personal, ju uroj ju dhe të gjitha forcat e lavdishme të kufirit që 15-vjetorin e Çlirimit të atdheut ta prisni me sa më shumë suksese në kryerjen e detyrës suaj fisnike, me gëzime e lumturi!

Rroftë BRPSH, ndihmësja dhe rezerva luftarake e PPSH!

Rrofshin forcat e kufirit, mbrojtëse besnike të kufijve të shenjtë të atdheut tonë të dashur!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 256 (3471), 24 tetor 1959*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **MBI ZGJERIMIN E INISIATIVËS SË HEROIT TË PUNËS SOCIALISTE, TRAKTORISTIT BUDO ISUFI**

*Thirrje traktoristëve të Shqipërisë*

**24 tetor 1959**

Traktoristi Budo Isufi, i frymëzuar nga vendimet historike të Kongresit III të PPSH, me qëllim që të japë kontributin e tij në përparimin dhe mekanizimin e bujqësisë, në vitin 1956 u zotua që me traktorin DT 54 të bënte 5 200 ha njësi hamullore pa riparim të përgjithshëm dhe të kursente 5 për qind të karburantit. Zotimi i marrur u realizua dhe, për nder të 15-vjetorit të Çlirimit, shoku Budo Isufi e rriti zotimin e do të bëjë 10 000 ha pa riparim të përgjithshëm.

Duke punuar me entuziazëm dhe me kujdes për plotësimin e zotimeve të marrura, deri në fund të muajit korrik të këtij viti shoku Budo Isufi ka kryer 8 400 ha njësi hamullore dhe ka kursyer 8 për qind karburant. Nga mirëmbajtja e traktorit i janë kursyer arkës së shtetit 593 200 lekë. Shembullin e shokut Budo Isufi e ndjekin rreth 200 traktoristë të SMT-ve dhe

NBSH-ve, mjaft prej të cilëve kanë arritur rezultate të kënaqshme në punë.

Duke çmuar këtë inisiativë të vlefshme në përpunimin dhe mekanizimin e bujqësisë dhe me qëllim që në të të përfshihen sa më shumë traktoristë, Komiteti Qendror i Partisë e aprovon këtë inisiativë patriotike të Heroit të Punës Socialiste, Budo Isufi, për të bërë me traktorin DT 54 10 000 ha njësi hamullore pa riparim të përgjithshëm.

Organizatat e Partisë, të bashkimeve profesionale e të rinisë, drejtoritë e SMT-ve e të NBSH-ve ta përkrahin aktivisht këtë inisiativë dhe ta organizojnë mirë punën për përfshirjen e gjithë traktoristëve.

Organet e shtypit e të radios të popullarizojnë dhe të përhapin sa më shumë rezultatet dhe eksperiencën e pjesëmarrësve në këtë lëvizje. Këshilli Qendror i BPSH dhe Ministria e Bujqësisë të marrin masa për përhapjen dhe përvetësimin e kësaj eksperience të vlefshme nëpërmjet vizitave, konsultave dhe mjeteve të tjera.

Komiteti Qendror i PPSH fton gjithë traktoristët e vendit tonë që të ndjekin shembullin e Heroit të Punës Socialiste, traktoristit Budo Isufi, dhe inisiativën e tij ta kthejnë në një lëvizje të gjerë të punonjësve të SMT-ve dhe të NBSH-ve.

Komiteti Qendror i PPSH është i bindur se traktoristët e vendit tonë, të ndërgjegjshëm për rolin e tyre të madh në zhvillimin e bujqësisë sonë, do të përkrahin aktivisht inisiativën për të bërë më shumë hektarë pa

riparim të përgjithshëm, për ta pritur 15-vjetorin e Çlirimit me suksese të reja.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
Nr. 257 (3472), 25 tetor 1959*

*Botohet sipas tekstit të gazetës  
«Zëri i popullit», Nr. 257 (3472),  
25 tetor 1959*



## REVIZIONISTËT JUGOSLLAVË TREMBEN NGA E VËRTETA<sup>1</sup>

31 tetor 1959

Lufta parimore konsekuente që i bëhet revizionizmit të sotëm në vendet tona të kampit socialist dhe në lëvizjen punëtore ndërkombëtare e shqetëson dhe e tremb shtypin jugosllav. Në faqet e tija janë botuar dhe botohen vazhdimisht artikuj e materiale në të cilat, midis të tjerash, përsëritet kjo ide qëndrore: Si është e mundur që në kushtet e sotme të uljes së tensionit ndërkombëtar nuk është ulur akoma tensioni i luftës kundër revizionizmit?

Ky qëndrim i shtypit jugosllav nuk është një qëndrim i izoluar dhe i rastit. Ai shpreh pikëpamjet zyrtare të qarqeve drejtuese jugosllave dhe prandaj kërkon përgjegjen e merituar.

Si gjithmonë, edhe kësaj radhe, drejtuesit jugosllavë dhe organet e tyre të propagandës, ngatërrojnë me qëllim dy gjëra krejt të ndryshme e të kundërta: çështjen e bashkekzistencës paqësore të vendeve me sisteme të ndryshme shoqëroro-ekonomike me luftën që i bëhet

---

<sup>1</sup> Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit».

revizionizmit. Dhe pyesin: Si mund të pajtohen njëra me tjetrën? Revizionistët prandaj janë të tillë, që t'i ngatërrojnë edhe gjërat më të qarta e të thjeshta. Bashkekzistenca paqësore e socializmit dhe e kapitalizmit, si alternativa e vetme për shpëtimin e njerëzimit nga rreziqet e një lufte shfarosëse, nuk nënkupton pajtimin ideologjik të tyre. Dhe për pasojë, pra, përmirësimi i gjendjes ndërkombëtare nuk nënkupton në asnjë mënyrë «pajtimin» me revizionizmin. Përkundrazi bashkekzistenca paqësore në terrenin ideologjik është platforma e njohur e shërbëtorëve të borgjezisë imperialiste, e oportunistëve dhe e revizionistëve.

Ja një shembull, midis çindra shembujve, të cilin na e servir «Borba». Ajo shkruante më 2 tetor se «disa elementë në Pekin dhe në Tiranë, të cilët bëjnë përsëri thirrje për luftë të vendosur kundër revizionizmit jugosllav, nuk janë për përmirësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare përderisa ndodhen objektivist të bashku në të njëjtat pozita destruktive me ata elementë në Perëndim, të cilët luftojnë për zgjatjen e luftës së ftohtë».

Sipas kësaj «logjike» origjinale, pra, ata që janë për luftën e vendosur kundër revizionizmit jugosllav nuk qenkan për përmirësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, por për zgjatjen e... «luftës së ftohtë»! Këtu kjo «logjikë» tradhton veten: bashkekzistencën paqësore dhe likuidimin e «luftës së ftohtë» revizionistët duan t'i kryejnë nëpërmjet «pajtimin» e «armëpushimit» ideologjik me armiqtë e klasës punëtore e të solidaritetit ndërkombëtar të punonjësve. Por ky «pajtim e armëpushim» që kërkohet nga revizionistët do të ishte vdekje-

prurës për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, për vetë çështjen e paqes e të socializmit në botë. Kërkesa të tilla që hyjnë në kuadrin e detyrave të «kalit të Trojës» vazhdojnë të bëjnë botërisht drejtuesit jugosllavë duke i mbuluar në mënyrë hipokrite me cipën e bashkekzistencës e të uljes së tensionit.

Por lufta parimore kundër revizionizmit të sotëm në asnjë mënyrë nuk i cenon parimet e bashkekzistencës paqësore. Për tërë botën është e qartë tashmë se politika leniniste e bashkekzistencës paqësore, lufta konsekuente për uljen e tensionit ndërkombëtar dhe për likuidimin e «luftës së ftohtë» përbëjnë thelbin e politikës së jashtme paqësore të vendeve socialiste. Pikërisht duke u mbështetur në një politikë të tillë të paqes e të miqësisë midis popujve, të unitetit vëllazëror me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore, Republika Popullore e Shqipërisë ka forcuar pozitën e saja ndërkombëtare, ka zgjeruar vazhdimisht marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me një numër gjithnjë më të madh shtetesh, është bërë një faktor i shëndoshë paqeje e stabiliteti në zonën e Ballkanit e të Adriatikut. Pesëmbëdhjetë vjet jetë të lirë kanë provuar se politika e qeverisë shqiptare ndaj vendeve fqinje ka qenë frymëzuar kurdoherë nga vullneti për të pasur marrëdhënie normale me këto vende fqinje dhe për t'i zhvilluar ato në frymën e marrëdhënieve shtetërore të fqinjësisë së mirë, të respektit e të dobisë reciproke dhe në interes të paqes së përgjithshme. Vlen për t'u theksuar se inisiativa të shumta në këtë drejtim kanë ardhur kurdoherë nga ana jonë, pasi vendi ynë është një nga vendet më të interesuara në Ballkan për

zhvillimin e marrëdhënieve paqësore normale të fqinjësisë së mirë.

Roli aktiv i Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e paqes dhe marrëdhëniet miqësore midis vendeve, propozimi për ta shndërruar zonën e Ballkanit e të Adriatikut në një zonë të paqes pa armë atomike, si edhe aksionet e tjera të qeverisë sonë për normalizimin e marrëdhënieve me shtetet fqinje, janë fakte historike që flasin për politikën konsekuente paqësore të vendit tonë, për politikën e afrimit, të miqësisë e të mirëkuptimit me të gjitha shtetet që e duan paqen.

Por në të njëjtën kohë ne nuk mund të rrimë me duar kryq dhe pa demaskuar botërisht rastet kur në vendet fqinje me Shqipërinë kurdisen komplete, kryhen akte dhe zhvillohen fushata që drejtohen jo vetëm kundër interesave të larta të popullit tonë, por edhe kundër paqes dhe bashkëpunimit miqësor midis popujve të tjerë. Ne nuk mund të rrimë pa i quajtur gjërat me emrin e tyre të vërtetë, sidomos në çështjet parimore. Kjo është detyra jonë internacionaliste dhe ne e bëjmë këtë për interesat e paqes e të sigurimit të popujve. Mos vallë drejtuesit e Beogradit nuk duan të quhen revizionistë? Edhe Harrimani<sup>1</sup> e Kebot Lloxhi<sup>2</sup> kërkojnë t'i ndryshohet emri kapitalizmit. Por këto orvatje të kota nuk e ndryshojnë thelbin, natyrën e kapitalizmit

---

<sup>1</sup> Averel Harriman, milioner amerikan, një nga drejtuesit e partisë demokrate të SHBA-së.

<sup>2</sup> Henri Kebot Lloxh, në atë kohë përfaqësues i SHBA-së në OKB, një nga drejtuesit e partisë republikane të SHBA-së.

e të revizionizmit. Revizionistët jugosllavë tremben nga e vërteta. Por nga kjo gjë nuk duhet ta pësojë e vërteta.

Fushatave revizioniste kundër vendeve socialiste u ka dalë boja me kohë. Tani në Jugosllavi është «stina» e fushatës antishqiptare e antikineze. Ne nuk na çudit aspak fakti që revizionistët jugosllavë flasin si Çan Kai Shia<sup>1</sup> e Sin Man Ria<sup>2</sup>. Edhe ata, si këta kanë të njëjtin fjalor, të njëjtën urrejtje organike kundër kampit socialist. Revizionistët jugosllavë flasin «shumë» kundër «luftës së ftohtë» por në punën e tyre e mbajnë gjallë «luftën e ftohtë». Gazeta «Politika», duke folur për incidentet në kufirin kino-indian, arrin ta quajë Kinën e madhe Popullore si «agresore». S'ka asnjë ndryshim politika e Beogradit nga «Nju Jork Taims». Mos është vallë e rastit që në sesionin e fundit të OKB-së delegacioni jugosllav mbajti të njëjtin qëndrim si Franca e Anglia në të ashtuquajturën «çështje të Tibetit»<sup>3</sup>, të provokuar nga intrigat imperialiste dhe qarqet reaksionare?

---

<sup>1</sup> Çan Kai Shi, kryetar i klikës reaksionare të Gomindanit, agjent i imperializmit amerikan. Pas fitores së revolucionit popullor në Kinë, ai dhe mbeturinat e klikës së tij u strehuan në ishullin kinez të Tajvanit, që mbahet i pushtuar në mënyrë të paligjshme nga forcat ushtarake të SHBA-së, dhe përdoret nga imperialistët amerikanë për të organizuar provokacione, spiunazh dhe diversion kundër Republikës Popullore të Kinës.

<sup>2</sup> Sin Man Ri, udhëheqës politik reaksionar korean, tradhtar i popullit korean, agjent i imperialistëve amerikanë. Në atë kohë kryetar i qeverisë kukull në Korenë e Jugut të pushtuar nga imperialistët amerikanë.

<sup>3</sup> Në mars 1959 klika reaksionare e Tibetit me Dalaj-lamën në krye, e shtyrë nga imperialistët dhe banda e Çan Kai Shisë,

Kohët e fundit shtypi jugosllav, e veçanërisht agjencia Tanjug, bëjnë zhurmë të madhe për «përparimet» e krahinave autonome në Jugosllavi e sidomos për Kosovën. Me sa duket gjendja me të vërtetë e mjerueshme ekonomike e kulturele e popullit të Kosovës dhe reagimi i opinionit publik i ka shtrënguar drejtuesit revizionistë të Beogradit në mos të bëjnë gjë, së paku të bëjnë zhurmë se po bëjnë diçka për fatin e atij populli të mjerë e të shtypur. Për këtë qëllim sajohen «plane shoqërore» për qarkun e Kosovës e të Metohisë, dërgohen atje për vizita të shkurtëra dhe për të mbajtur fjalime të gjata gjithfarë Veselinovër e Miniçer, Penziçer e Baboviçer. Por as «planet shoqërore shtetërore» as vizitat e këtyre «miqve» të padëshiruar nuk po ia përmirësojnë gjendjen popullit të vuajtur të Kosovës.

Në Prishtinë, kohë më parë, ka qenë hapur një ekspozitë në kuadrin e 40-vjetorit të PKJ, në të cilën pa pikën e turpit shtrëmbërohen të vërtetat e njohura historike. Sipas revizionistëve jugosllavë Partinë e Punës të Shqipërisë e paska themeluar Partia Komuniste Jugosllave! Me këtë pretendim sa absurd aq edhe idiot, revizionistët jugosllavë bien në të njëjtat pozita dhe përsëritin të njëjtin «leitmotiv» të armiqve të popullit

---

tentoi të shkëpuste Tibetin nga RP e Kinës. Dalaj-lama dështoi dhe u detyrua të arratiset dhe mbahet nga reaksionarët indianë. Imperialistët amerikanë dhe klika e Çan Kai Shisë, për të mbajtur të ngritur tensionin në këtë zonë, e ngritën këtë të ashtuquajtur «çështje të Tibetit» në OKB duke akuzuar RP të Kinës si pushtuese të Tibetit.

shqiptar, të fashistëve, ballistëve, zogistëve, se Partinë tonë heroike e kanë themeluar të huajt. Nuk është nevoja të ndalemi këtu për të vërteta historike të padiskutueshme. Partia jonë, flamurtarja lavdimadhe e luftës për lirinë e pavarësinë e atdheut, u themelua në gjirin e ngrohtë të popullit nga bijtë më të mirë të tij, në rrethanat e vështira të terrorit më të egër fashist, kur ishin pjekur kushtet objektive të brendshme e të jashtme për formimin e një partie të tillë, mbi bazat e marksizëm-leninizmit.

Në këtë ekspozitë flitet edhe për «ndihmat» që Jugosllavia i paska dhënë Shqipërisë për ndërtimin ekonomik. Mos është vallë fjala për një fabrikë sheqeri të kohës së Baba Qemos dhe një fabrikë litari që s'prodhoi kurrë asnjë metër spango, të cilat populli ynë i ka paguar njëqind herë, duke u grabitur paturpësisht prej «miqve» jugosllavë dhe për të cilat nuk vlen të ndalemi përsëri?

Organizimi i kompleteve, i fushatave shpifëse të përditshme kundër vendit dhe Partisë sonë, aktet armiqësore kundër popullit tonë dhe vendeve të tjera të kampit të paqes e të socializmit nga njëra anë, shtrembërimi i ndërgjegjshëm i fakteve historike, interpretimi i tyre tendencioz e arbitrarisht nga ana tjetër, kanë qenë dhe mbeten jo mjete dhe argumente vetëm të shtypit, por janë mjetet dhe argumentet kryesore të politikës së drejtuesve të sotëm të Jugosllavisë. Të gjitha këto provojnë se ata mbeten në pozitat e tyre të vjetra revizioniste. Prandaj demaskimi i vazhdue-

shëm, i pamëshirshëm e parimor i revizionizmit është në dobi të ruajtjes së unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të mbrojtjes së socializmit e të paqes në botë.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 262 (3477), 31 tetor 1959*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN XIV TË KQ TË PPSH

3 nëntor 1959

Nga punimet që u zhvilluan këto dy ditë, u duk qartë se plenumi është dakord njëzëri me raportet e Byrosë Politike të paraqitura nga shokët Hysni Kapo dhe Spiro Koleka<sup>1</sup>.

Raportet e Byrosë Politike i plotësuan me diskutimet e tyre shokët e Plenumit të Komitetit Qendror. Gjithashtu ne vlerësojmë shumë ndihmën që dhanë të gjithë shokët specialistë qoftë me parti ose pa parti, që morën fjalën në këtë plenum. Kjo ndihmë do të lehtësojë

---

<sup>1</sup> Plenumi XIV i KQ të PPSH që zhvilloi punimet më 2 dhe 3 nëntor 1959 mori në shqyrtim dhe diskutoi raportet e Byrosë Politike: «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për zhvillimin e ekonomisë pyjore, shfrytëzimin racional të pyjeve dhe ekonomizimin e lëndës së drurit», paraqitur nga shoku Hysni Kapo, si dhe «Mbi shtimin e sipërfaqes së tokave të ujitshme dhe mbi teknikën e ujitjes në bujqësinë tonë», paraqitur nga shoku Spiro Koleka.

Në punimet e këtij plenumi merrnin pjesë si të ftuar sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve, kryetarët e komiteteve ekzekutive, specialistë dhe kuadro të dikastereve, të rretheve, të ndërmarreve dhe të kooperativave bujqësore.

zbatimin si duhet të detyrave për zgjidhjen e këtyre dy problemeve kaq të rëndësishme.

Veçanërisht Komiteti Qendror i falenderon shokët specialistë pa parti, të vjetër dhe të rinj, për ndihmën që dhanë këtu në Plenumin e Komitetit Qendror në marrjen e këtyre dy vendimeve të drejta që do të ndihmojnë për sigurimin e së ardhshmes akoma më të mirë të popullit tonë. Shokët specialistë komunistë, të ftuar në këtë mbledhje, nuk po i falenderojmë veçanërisht, jo se nuk ndihmuan me mendimet e tyre, edhe ata dhanë një ndihmë të lavdërueshme, por ata kanë nderin që të kenë në xhep taserën e Partisë sonë të lavdishme. Kurse specialistët e tjerë si intelektualë patriotë e popullorë luftojnë njëllë si specialistët komunistë për zbatimin e vijës së Partisë, në fusha të ndryshme e për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, është detyra jonë, pra, që t'i falenderojmë këta shokë pa parti për punën e tyre të palodhur, të mirë dhe të guximshme në rrugën që ka caktuar Partia.

Kur them specialistë të vjetër nuk duhet kuptuar kjo nga mosha dhe as nga pikëpamjet e tyre, por nga stazhi në punë për t'i dalluar nga ata që kanë hyrë në jetë pas Çlirimit. Puna e këtyre shokëve tregon se ata pa qenë anëtarë partie, janë shumë afër Partisë, e duan atë dhe punojnë në rrugën e Partisë. Puna e tyre në këtë rrugë ka krijuar të tilla kushte që ata ta ndjejnë veten e tyre afër Partisë. Këta shokë e kuptojnë marksizëm-leninizmin, e ndjejnë dhe veprojnë sipas mësimëve të tij. Marksizëm-leninizmin mundet edhe ta mësosh, por, po të mos e ndjesh, nuk vepron dot si të mëson ai. Ne shohim se këta shokë pa parti, jo vetëm

e kuptojnë ç'është marksizëm-leninizmi, por edhe e ndjejnë e veprojnë në bazë të tij. Po të mos e ndjente marksizëm-leninizmin, për shembull, inxhinier Ilia Plasa nuk do të punonte me të gjitha energjitë e tija dhe këtu, në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror nuk do të kritikonte haptazi, jo vetëm të metat në punë, por edhe sekretarët e komiteteve të Partisë. Një njeri që nuk e ndjen veten afër Partisë, do të punojë vetëm për t'u dukur dhe nuk do të ketë guximin për të kritikuar të metat. Pikëpamjet e një njeriu të tillë nuk mund të jenë marksiste, kurse një njeri i mirë, punëtor, që e ndjen veten afër Partisë, mendon si marksist dhe kritikon haptas e pa drojtje. Një njeri i tillë kritikën e kupton si një armë të shëndoshë në shërbim të çështjes së Partisë, kur ajo është konstruktive dhe jodenigruese.

Një qëndrim i tillë marksist ndaj problemeve nga ana e shokëve punonjës pa parti është një sukses i madh i Partisë, prandaj ata i falenderon Komiteti Qendror dhe ne jemi të bindur se çdo ditë ata do të punojnë më mirë dhe në punën e tyre do të kenë përkrahjen dhe ndihmën e Partisë. Këtu e kam fjalën jo vetëm për shokët pa parti që janë këtu, po për të gjithë specialistët dhe punonjësit pa parti. Ne kemi me dhjetëra shokë të tillë të ndërgjegjshëm që punojnë mirë, sepse janë patriotë që e duan popullin dhe e shohin qartë se rruga marksiste-leniniste e Partisë sonë i sjell lumturinë popullit. Prandaj të gjithë duhet të punojmë akoma më shumë për t'i siguruar popullit tonë kushte edhe më të mira e të ndihmojmë që edhe shokët pa parti të japin kontributin e tyre me mundësitë që kanë.

U theksua shumë mirë, gjatë punimeve të këtij plenumi, rëndësia e madhe që kanë pyllëzimet dhe ujitja për ekonominë tonë popullore. Unë nuk dua të përsërit edhe një herë shifra e të dhëna që dolën shumë mirë në diskutimet mjaft të vlefshme që bënë shokët. Megjithatë dua të theksoj disa gjëra që ne duhet t'i kemi parasysh.

Problemi i pyllëzimeve dhe i ujitjes është problem me të vërtetë i rëndësishëm dhe me perspektivë të gjatë, për pyjet 15-vjeçare dhe për ujitjet 5-vjeçare. Them 15-vjeçare, sepse çështja e pyjeve do të vazhdojë tërë jetën, prandaj punën me pyjet sa më mirë dhe vazhdimisht ta bëjmë, aq më tepër lehtësi dhe fitime do të ketë populli në të ardhshmen. Problemi i pyjeve nuk është vetëm për t'u prehur ose për të shëtitur të rinjtë, të dashëruarit etj. Për këto punë ka sa të duash pyje. Po çështja është se pas shëtitjeve në pyll duhet shtëpia ku të rinjtë të futin kokën, duhen dhoma dhe ato t'i kenë të mobiluara me krevate, tavolina, karriçe etj. Dhe një nga degët e ekonomisë sonë, vendimtare për ndërtimin e banesave dhe pajisjen e tyre, është industria e përpunimit të drurit që hyn deri në ndërtimin e objekteve të mëdha industriale, pa folur për të mirat që i sjellin pyjet bujqësisë, klimës, zbukurimit të jetës së njeriut, zhvillimit të industrisë kimike për prodhimin e celulozës, që për vendin tonë është akoma një perspektivë e largët etj.

Këto detyra që na vihen nuk mund të realizohen pa luftë, këtë duhet ta kemi mirë parasysh dhe ne jemi të ndërgjegjshëm se pa një luftë të vazhdueshme dhe të vendosur këto probleme nuk zgjidhen. Vështirë-

sitë që do të hasim për realizimin e këtyre detyrave nuk duhet t'i mbivlerësojmë, po as nuk duhet t'i nënvleftësojmë. Vendimet që po marrim ne i konsiderojmë të drejta dhe plotësisht të realizueshme, po rrugës do të hasim edhe vështirësi që Partia dhe populli ynë kanë forca për t'i kapërcyer dhe do t'i kapërcëjnë.

Të gjitha problemet që i dalin vendit tonë Partia do t'i zgjidhë sepse ajo do të vazhdojë të mbajë lidhje të ngushta me popullin, ato do të zgjidhen me vijën e drejtë të Partisë dhe me një organizim të shëndoshë të punës.

Tani çështja është se çfarë vështirësish do të kemi ne në realizimin e këtyre detyrave. Mund të na vihet pyetja: A janë të menduara mirë masat që do të merren dhe a kemi forca ne për t'i realizuar këto masa. Për këtë Byroja Politike ka ngarkuar Komisionin e Planit të Shtetit, i cili në bazë të studimeve që ka bërë ka arritur në përfundimin se ne kemi forca për këtë qëllim.

Por këtë çështje ne duhet ta shohim në kompleks me të gjithë sektorët ekonomikë, sidomos me sektorët e bujqësisë. Ne kemi gjithë atë plan për mbjellje pemësh frutore, për hapje tokash të reja, për bonifikimet, për të cilat po bëjmë investime të mëdha e që kërkojnë forca të shumta pune, kemi planin e hapjes së kanaleve ujitëse, të mbjelljes së ullinjve, agrumeve, pastaj realizimin e planit në sektorin e drithërave e të bimëve industriale.

Siç e shihni, pra, të gjitha këto probleme të mëdha rëndojnë drejtpërsëdrejti mbi supet e fshatarësisë. Por këto probleme jetike ne jemi në gjendje t'i zgjidhim

në rast se mbajmë lart entuziazmin e popullit. Dhe ne i kemi të gjitha kushtet që këtë entuziazëm jo vetëm ta mbajmë në nivelin që kemi sot, por ta ngremë akoma më lart. Veprat e mëdha që ka realizuar pushteti ynë janë të tilla që i entuziazmojnë masat. Këto vepra tani kanë bërë që edhe njerëzit më skeptikë të fillojnë të shohin ndryshe dhe të çarmatosen. Fakt për këtë është puna e palodhur e popullit dhe vija e drejtë e Partisë që e mobilizon atë.

Për të vënë në jetë të gjitha këto detyra duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë mobilizimit të masave në mënyrë të organizuar. Kjo ka rëndësi të madhe. Kur t'i shikojmë me kujdes të gjitha këto probleme që shtrojmë dhe që duhen realizuar, atëherë lind nevoja që të bëhen hapa të rregullt që të mos na krijohen boshllëqe dhe të mos lindë një situatë dëshpërimi që do ta bënte të vështirë realizimin e këtyre planeve. Në këtë çështje një rëndësi të madhe merr forca organizuese e Partisë sonë për të bërë që këto probleme të preokupojnë çdo komitet partie, anëtar partie ose patriot, fshatar, punëtor apo intelektual deri te nxënësit e shkollave dhe t'i shikojnë këto probleme, jo vetëm në prizmin e detyrave të veçanta që kanë, po në kompleksin e të gjitha detyrave që ka shtruar Partia përpara popullit tonë.

Realizimi në kohën e duhur i të gjitha këtyre detyrave nga secili, do të bëjë që vendi ynë të ecë me ritmet që ka vendosur Partia në rrugën e socializmit dhe të komunizmit.

Përsa u përket konkretisht pyjeve e dimë se do të hasim në disa vështirësi. Duhet të kemi parasysh se

pyjet nuk do të hyjnë menjëherë në shfrytëzim. Ato që mbjellim sot do të hyjnë në shfrytëzim pas 40-50 vjetësh. Pyjet e degraduara kur i mbarështrojmë do të na japin mundësi t'i shfrytëzojmë në një afat edhe më të shkurtër. Afatet e largëta influencojnë shumë në psikologjinë e njerëzve për të ngadalësuar ose për të frenuar punën, për një arsye ose për një tjetër, në zbatimin me ritmin e duhur të detyrave të mëdha që Partia shtron për pyllëzimet. Prandaj duhet luftuar me vendosmëri kundër paragjyqimeve të vjetra që influencojnë te disa njerëz, të cilët, duke mos marrë prodhime të shpejta nga një punë, krijojnë pikëpamje të dëmshme duke thënë «kemi kohë» ose «këtë punë nuk do ta trashëgoj unë», pikëpamje që na pengojnë në zhvillimin me ritmin e duhur të zbatimit të këtyre detyrave.

Një çështje tjetër është që të mos mendojmë se ne e kemi të ngritur ndërgjegjen e fshatarësisë sonë në atë shkallë që ajo ta ruajë pyllin si pronën e vet. Fshatari mendon se pylli është pyll, Mentaliteti i vjetër që ekziston te ai, ushtron një farë presioni dhe e nxit atë për të plotësuar nevojat e tija imediate si për dru, për të djegur, ashtu edhe për gjethe, kullotë etj. Të tilla mbe-turina duken edhe te klasa punëtore që punon nëpër miniera, fabrika e uzina, ku puna është më e organizuar, ndërgjegjja e njerëzve më e lartë dhe njerëzit punojnë brenda katër mureve. Kurse pyjet janë pyje dhe këtyre pikëpamjeve josocialiste që ekzistojnë te fshatarët ne duhet t'u bëjmë një luftë sistematike e jo vetëm te fshatarët, po edhe në të gjitha entet e ndërmarrjet që kanë nevojë për lëndë druri. Në këto qendra pune punojnë njerëz besnikë, të cilëve Partia dhe shteti u

ngarkojnë detyra të caktuara që duhet t'i kryejnë. Por, siç doli edhe nga diskutimet, presioni mbi këta, për lëndë druri, është aq i madh saqë bëjnë lëshime dhe kështu dëmtohen pyjet.

Edhe ne vetë i kemi dëmtuar pyjet. Por gjatë këtyre 15 vjetëve të pushtetit popullor janë bërë gjithë këto ndërtime kolosale, të cilat s'mund të realizoheshin pa lëndë druri. Mendoni një herë sa banesa janë ndërtuar në fshatra dhe qytete gjatë këtyre 15 vjetëve. Po gjithë kjo industri kaq e madhe ç'lëndë druri ka harxhuar derisa është ngritur në këmbë dhe funksionon! Në këtë punë të madhe sigurisht janë bërë gabime, ka pasur mungesa serioze në rregullat për shfrytëzimin e pyjeve, ka pasur bile qëndrime kriminale të kryera me ndërgjegje ose pa ndërgjegje nga njerëz të veçantë ose nga ente. Mund të themi se në përgjithësi pyjet nuk janë shfrytëzuar si duhet, po duhet të kemi parasysh se edhe situata ishte e tillë, nevojat ishin të mëdha për dru dhe lëndë druri. Mendoni se 8 vjet më parë ne nuk kishim asnjë sharrë, punohej me sëpatë, nuk kishim as organizim. Po në atë kohë fabrika e kombinatit duheshin ndërtuar, prandaj duhej prerë lëndë druri. Duke gjykuar kështu ne mund të themi se druri nuk ka shkuar dëm, vetëm duhet të kishim një organizim më të shëndoshë me qëllim që të evitoheshin këto të meta dhe gabime që kanë ndodhur.

Tani ne e kemi organizuar më mirë punën, kemi mjete teknike më të mëdha, kemi më shumë mundësi financiare dhe të tjera, të krijuara edhe nga kolektivizimi, prandaj jemi në gjendje të hedhim një hap më të madh përpara në drejtim të pyllëzimeve për 15 vjet.



Megjithëkëtë në vend nuk kemi qëndruar. Pesëvjeçarin e pyllëzimeve e realizuam, por del se shumë drurë të mbjellë nuk kanë zënë.

Po të shohim në se ka hyrë në ndërgjegjen e popullit çështja e mbrojtjes së pyjeve, unë me siguri mund të them se diçka ka hyrë, qoftë nga propaganda e Partisë dhe nga masat që ka marrë qeveria herë pas here. Ne shohim se kjo ndërgjegje ka filluar të krijohet, tani ne kërkojmë që ajo të forcohet në mënyrë që pylli të konsiderohet si pasuri e vlefshme e të gjithë popullit dhe të punohet që kjo pasuri të ruhet ashtu si ruan njeriu shtëpinë e tij, sepse pa lëndë druri nuk mund të ndërtohet socializmi.

Një çështje që lidhet direkt me problemin e pyllëzimeve është ajo e banesave dhe e mobiljeve që kërkojnë lëndë druri. Ne kemi vështirësi të mëdha për banesa dhe luftojmë që ta zgjidhim këtë problem. Nga llogaritë paraprake që janë bërë do të na duhen akoma 18-20 vjet për ta zgjidhur definitivisht këtë problem. Por në rast se ne shohim se brenda 5-10 vjetësh problemi i pyllëzimeve ka marrë rrugë të mbarë, atëherë nuk do të kemi frikë të lëshojmë dorën për të prerë më shumë lëndë druri dhe të shpejtojmë ritmin e ndërtimit të banesave, të mobiljeve e orendive për popullin. Tani ne po krijojmë rezerva dhe disponojmë mundësi financiare për një intensifikim më të madh të ndërtimeve, mirëpo lëndë druri nuk kemi dhe nuk mund të ecim në rrugën që është ndjekur deri tani. Kjo nuk na lejohet se pastaj populli nuk do të na e falë. Prandaj duhet të ecim me llogari. Pavarësisht nga investimet e mëdha që bën tani qeveria për pyllëzime,

plani për shtimin dhe mbarështrimin e pyjeve nuk mund të realizohet pa mobilizimin e popullit.

Është fakt se tani me kolektivizimin dhe bashkimin e kooperativave bujqësore janë krijuar kushte që të organizohet më mirë puna në bujqësi, si për mbjelljen e pemëve frutore, për pyllëzime, për ujitje etj. Forca dhe vullneti i Partisë e i popullit nuk mungojnë, vetëm duhet organizim.

Të marrim çështjen e pjesëmarrjes së popullit në kanalizime. Kjo ka rëndësi edhe nga ana parimore, edhe nga ana ekonomike. Kur ka vendosur Komiteti Qendror për këtë çështje e ka parë jo vetëm nga ana ekonomike imediate por edhe në perspektivë. Po të mos krijojmë një ndërgjegje të lartë në popull, sidomos te fshatarësia, realizimi i detyrave në perspektivë do të jetë i vështirë. Mungesa e pjesëmarrjes së fshatarësisë dhe e një organizimi të mirë të punës nga ana e Partisë dhe e komiteteve ekzekutive, ka bërë që fshati të mos e japë ndihmën e duhur. Kur janë marrë seriozisht komitetet e Partisë me problemin e pyllëzimeve, në mos tërë planin, diçka kanë realizuar. Po në përgjithësi mungon kujdesi i veçantë për mobilizimin e masave në këto aksione shumë të rëndësishme, realizimi i të cilave eviton edhe investime të mëdha nga ana e shtetit dhe ndihmon edhe për ngritjen e ndërgjegjes së fshatarësisë. Kjo ka rëndësi të madhe. Ne mund t'u vëmë edhe taksë fshatarëve, po kjo metodë nuk jep rezultate. Fshatari tani mund të jetë në gjendje t'i paguajë edhe taksat, po për kanalin nuk do të kujdeset si duhet; mirëpo mirëmbajtja ka rëndësi të madhe ekonomike dhe edukative. Në qoftë se nuk ka derdhur djersë fshatari vetë, kanali

do të prishet, do të zihet dhe do të detyrohemi të përdorim përsëri buldozerët.

Këto detyra do të kryhen si thashë, në rast se organizatat-bazë të Partisë dhe organet e pushtetit në fshat ose në kooperativat bujqësore nuk i shikojnë ngushtë këto probleme, por në kuadrin kombëtar dhe hartojnë plane rigorozë që të kryhen në kohën e duhur. Rëndësi ka që këtë çështje ta kuptojnë shokët drejtues në bazë, se pa u kuptuar atje, çdo masë është e kotë. Në ushtri, në qoftë se nuk do t'i kemi nënoficerët njerëz të kalitur, të disiplinuar dhe me kulturë, sado mirë të punojnë shtabet dhe oficerët për edukimin e ushtarëve, puna nuk do të ketë efektin e duhur. Po kështu edhe në Parti, në rast se i kemi të forta organizatat-bazë që t'i shtrojnë si duhet këto probleme, të organizojnë mirë punën, në bazë të forcave që kanë në dispozicion, t'i hedhin këto në luftë në mënyrë të organizuar dhe së bashku me masat e popullit e duke mësuar prej tyre, të jenë në krye udhëheqësit e Partisë dhe të pushtetit, të jemi të bindur se këto dy detyra që shtrojmë do të realizohen.

Në pyllëzimet rëndësi të madhe ka organizimi i popullit si dhe edukimi me ndjenjën e dashurisë së madhe për pemët, për pyllin; t'u bëhet njerëzve pasion ashtu siç e kanë punonjësit e pyjeve, ose si pasionin që kanë gjuetarët për gjah. Por ky pasion do të krijohet, kur fshatari t'i mbjellë vetë pemët, t'i ruajë, t'i krasitë, t'u bëjë shërbimet e nevojshme. Prandaj pjesëmarrja e popullit ka rëndësi të madhe. Po me këtë frymë duhet të edukojmë edhe rininë.

Partia ka punuar dhe punon në këtë drejtim, po

për fat të keq fshatarët deri edhe fëmijët shpesh shqycj-  
në fidanet për të bërë shufra, pa lëri pastaj dëmet që  
bëjnë kafshët. Prandaj duhet punuar që të krijohen  
tradita të thella dhe të rrënjoset dashuria për pyjet.  
Vetëm kështu do t'i realizojmë këto plane dhe unë kam  
bindjen se do t'i realizojmë, sepse populli ynë është  
patriot, përparimtar, e do Partinë, puna është vetëm  
që ta organizojmë dhe drejtojmë mirë atë.

Për t'i dhënë hov problemit të pyllëzimeve është  
e domosdoshme të bëhet një punë e madhe edhe me  
njerëzit që punojnë në ndërmarrje shtetërore, ku duhet  
të bëhet shumë ekonomi për ruajtjen e lëndës. Ato  
që kanë ndodhur deri tani nuk duhet të ndodhin më.  
Të vendoset një disiplinë akoma më e rreptë nga ana  
e Partisë dhe e qeverisë mbi të gjitha entet që kanë  
të bëjnë me lëndën e drurit dhe të pyjeve. Të jemi  
shumë të rreptë për këto çështje, të mos lejohet që të  
digjet lënda shumë e vlefshme për përpunimin. Tani  
ne jemi në gjendje të vëmë rregull në këto çështje.  
Besoj se asnjë nga udhëheqësit e ndërmarrjeve eko-  
nomike nuk do që të vazhdojë një situatë e tillë e kri-  
juar nga pakujdesia, mungesa e kontrollit etj. Këto të  
meta që u vunë këtu në dukje duhen zhdukur dhe të  
na bëhen mësim. Për këtë qëllim është e nevojshme  
të merren masat që parashikohen në raport nga ana e  
Ministrit të Industrisë.

Pra, për mbarështrimin, ruajtjen dhe shtimin e  
pyjeve ne duhet të marrim masa serioze. Masa serioze  
duhet të marrim sidomos për problemin e kuadrit. Tani  
konstatojmë me kënaqësi se nuk jemi në gjendjen e  
parë. Megjithatë normat tona për çdo inxhinier, teknik

ose rojtar pyjesh janë shumë të mëdha. Prandaj duhet akoma të shtojmë përpjekjet për edukimin dhe përgatitjen e kuadrove pyjorë, të cilët t'i mësojmë me teknikën dhe dashurinë për pyllin.

Me të drejtë të gjithë duan lëndë druri, brenda planeve, pavarësisht se këto nuk janë parë mirë në shumë raste. Ministria e Industrisë duhej të mendonte më mirë për mekanizimin e sharrave, për transportimin e lëndës së prerë, sepse nuk është menduar seriozisht për evadimin e lëndës, pasi edhe mundësitë nuk kanë qenë të mëdha.

Keni parasysh, shokë të dashur, se përpara popullit po vihen detyra të mëdha për zhvillimin e ekonomisë në një shkallë më të gjerë. Tani po përgatitim planin e ri pesëvjeçar që parashikon ndërtime të mëdha në industri. Perspektiva të mëdha na hapen në zhvillimin e minierave që do të inkuadrohen në këtë plan pesëvjeçar, sidomos minierat e hekur-nikelit, të cilat do ta forcojnë ekonominë tonë, sepse do të krijojmë industrinë e metalurgjisë së zezë, dhe hekurin, që tani e sjellim nga jashtë, do ta prodhojmë në vend. Kjo gjë do t'i japë hov zhvillimit të mëtejshëm të industrisë, bujqësisë dhe kulturës. Komiteti Qendror dhe qeveria po studjojnë tani perspektivat e shkëlqyera që i hapen vendit tonë me ngritjen e industrisë kimike, jo vetëm të plehrave, po edhe të industrisë plastike. Derisa ne kemi naftë dhe gaz, pa llogaritur pyjet, ne mund ta ngremë industrinë plastike dhe të plotësojmë me të, në shkallë më të gjerë, nevojat e popullit për shumë sende, bile edhe të eksportojmë.

Nga ana e ministrive dhe e ndërmarrjeve janë

importuar mbi nevojat e tyre materiale dhe makineri, të cilat janë blerë me devizë. Në këtë çështje nuk kanë faj vetëm ministrat, por edhe ndërmarrjet. Prandaj kur bëhet plani i kërkesave të mos shihet ky problem me sy reparti por në shkallë Republike, të kenë parasysh shokët se shteti ynë është akoma i varfër në devizë, megjithëse ndihmohet nga miqtë. Prandaj këtë ndihmë dhe ekonominë tonë duhet ta administrojmë në mënyrë sa më ekonomike dhe t'i kryejmë detyrat e planit me minimumin e materialeve.

Kështu ne do të importojmë më të domosdoshmet e jo gjëra të tepërta dhe, ato që sjellim, të mbahen e të shfrytëzohen mirë, ashtu sikurse e shfrytëzoi Heroi i Punës Socialiste, Budo Isufi, traktorin e tij. Në këtë frymë të kursehet deri në bullonin më të vogël. Kërkesat nga importi të mos bëhen në bazë të katalogëve të shteteve ku prodhohen por në bazë të nevojave tona. Qeveria dhe dikasteret të luftojnë që të mos bëhen kërkesa të fryra, po nga kërkesat e shumta ato të pranojnë vetëm të domosdoshmet. Pra të gjithë të kenë parasysh që «të nderim këmbët sa kemi jorganin».

Duke vizituar vendet miq kam vënë re dashurinë e madhe që tregojnë rojtarët dhe teknikët për pyjet e tyre, të cilët ata i njohin me pëllëmbë. Ata dinë jo vetëm numrin e drurëve të sektorit që kanë në ngarkim, por edhe sa do të presin në këtë apo në atë kohë, sa kafshë të egra kanë në sektorin e tyre dhe të çfarë lloji janë, sa do të vrasin, bile kanë deri edhe fotografitë e tyre. Kështu, kur ndonjë njeri, çfarëdo përgjegjësie që të ketë, gjuan pa leje, dënohet. Në lejen e gjuetisë të thuhet se mund të vrasësh deri në dy kaf-

shë ose shpendë, më tepër nuk të lejohet të vrasësh, cilido qofsh ti. Këtë çështje e theksoj dhe duhet ta them se nuk jam i kënaqur nga «zelli» ose «aftësia» e disa gjahtarëve. Gjahu duhet të bëhet pasuri e popullit. Pula që ti rrit në kotecin tënd është tëndja, të tjerat janë të shtetit. Në qoftë se je gjahtar, të jesh për sport po të duash, kështu e kanë gjetkë. Atje rojtari i pyllit d'edhe personat që kanë pushkë gjuetie në rajonin e tij dhe kur i vjen një gjahtar nuk e lejon pa i treguar lejen dhe pa qenë e caktuar atje se sa do të vrasë. Edhe mua vetë më ka qëlluar në Çekosllovakia të shkoja një herë për gjah me sekretarin e partisë të rajonit. Në mbarim të gjahut, kur po errej, na doli një dre, shtiva dhe e vrava. Pas 5 minutash ia arriti motoçikleta me rojen e pyllit, po, mbasi kishim me vete edhe drejtorin e pyjeve që lëshon autorizimet, nuk na tha gjë.

Veç kësaj, te ne nuk ta merr mishin e gjahut kooperativa e konsumit, kurse është e detyruar të ta marrë. Për vete gjahtari ka të drejtë të blejë deri në 30 për qind të mishit të gjahut që ka vrarë, po jo ta marrë të gjithë si bëjmë ne, sepse kështu i bëhet një padrejtësi popullit e veç asaj edhe gjahu shkatërrohet. Pastaj edhe populli ka nevojë për mish. Prandaj me gjuetinë të mos vazhdojmë më si deri tani që gjahtarët të vrasin kafshë të egra dhe të mos na japin mishin. Te ne sulen të gjithë dhe o burra të vrasim lepurin e të marrim ca lekë për lëkurën. Për të marrë lëkurën, në vendet e tjera i zënë të gjalla kafshët dhe i shesin me një vlerë më të madhe. Kështu duhet të veprojmë edhe ne, të zhvillojmë gjahun në rrugë të drejtë, në interesin e popullit dhe jo për t'u bërë qejfin gjah-

tarëve. Duhet të marrim masa që gjahu të shtohet dhe të bëhet një sektor me leverdi për ekonominë popullore. Duke zhvilluar gjahun me kujdes, ne bëjmë një punë të mirë edukative edhe për mirëmbajtjen e pyjeve, se kur vete fshatari në pyll dhe sheh se nuk duhet të gjuajë sa të dojë e ç'të gjejë përpara, por sipas rregullave të caktuara, atëherë mendon se duhet të respektohen edhe rregullat e vendosura për mbrojtjen e pyllit dhe për shfrytëzimin e tij në bazë të kërkesave të vendosura. Këto rregulla do të luajnë një farë roli në psikologjinë e fshatarit tonë.

Pyjet i dëmton edhe dhija. Kjo është një nga arsyet që ne tani do të fillojmë gradualisht të pakësojmë dhinë. Ky pakësim do të bëhet patjetër, por kurdoherë të veprohet ashtu si ka porositur Byroja Politike. Në asnjë mënyrë të mos i pakësojmë dhitë menjëherë, po gradualisht, duke krijuar kushtet për zëvendësimin e saj me bagëti të tjera. Fshatarët që kanë vetëm dhi, sidomos ata të malësive, jetojnë me to, prandaj s'ua heqim dot pa menduar se duhet t'u sigurojmë kafshë të tjera për t'i rritur.

Kuadrot për sektorin e pyjeve duhet t'i përgatitim nëpër kurse dhe në fakultetin që kemi hapur, si edhe në teknikumin për pyje që do të hapet vitin e ardhshëm. Kësaj çështjeje t'i vihet rëndësi e madhe sepse pyjet janë një pasuri e madhe e popullit tonë dhe shërbejnë për të ndërtuar me sukses socializmin, sepse në çdo sektor të ekonomisë kërkohet lëndë druri. Popullin ta mësojmë që ta kuptojë mirë këtë çështje prandaj ta drejtojmë dhe ta organizojmë si të punojë në këtë drejtim dhe të jemi të sigurtë se këto plane do të reali-



zohen qind për qind, ashtu sikurse jemi të bindur që do të realizohen edhe planet që kanë të bëjnë me ujitjen. Nuk ka dyshim se realizimi i këtyre detyrave do ta forcojë akoma më tej ekonominë tonë.

Tani jemi përpara festës së madhe të 15-vjetorit të Çlirimit, prandaj të mobilizohemi që planet e këtij viti të realizohen. Në disa sektorë, sidomos në atë të minierave, duhet thënë hapur, këtu jemi në Komitetin Qendror dhe të ftuarit janë shokë e miq besnikë të Partisë, se do të kemi deficite, në radhë të parë për naftën. Komiteti Qendror duhet t'u tërheqë vëmendjen shokëve të industrisë, sidomos atyre të sektorit të naftës, për pakujdesitë që vihen re në këtë sektor. Prapë këto ditët e fundit mori zjarr një pus. Me masat që u morën ai u shua, po nuk duhej të kishte ndodhur kjo. Ministria e Industrisë dhe kombinati i naftës të kenë parasysh se populli dhe Partia bëjnë investime të mëdha në këtë sektor, prandaj duhet të bëhen përpjekje që plani të realizohet dhe t'i jepet naftë ekonomisë popullore, të sigurohen rezerva të gazit dhe të mos na digjet kot, po ta ruajmë gazin si një pasuri të madhe për një të nesërme të lumtur për popullin tonë.

Prandaj shokët e Partisë dhe të drejtorisë së kombinatit të naftës t'i zënë mirë kyçet, sidomos në pusët. Kur hapet një pus për herë të parë nga kuadrot tanë të rinj dhe pa eksperiencë, gjatë procesit të çimentimit të pusit, ata nuk duhet të lihen vetëm. Nuk është e drejtë, bile është e palejueshme që, kur shpohet një pus, ku punohet 6 muaj me radhë, kur kuadrot kanë punuar me durim dhe në çastet që ata presin të dalë nafta, drejtuesit e Partisë dhe të kombinatit të flenë.

Nuk lejohet që kur bëhet perforimi dhe çimentimi i një pusi të mos jenë atje pranë të gjitha mjetet e duhura. Kjo është si puna e kirurgut që, kur lind fëmija i vogël, ka afër të gjitha veglat që i duhen për t'i përdorur në çdo rast rreziku. Kështu duhet vepruar edhe në pusët e naftës, ashtu siç vepron kirurgu i mirë në maternitet, sepse një pus shpohet në 6 muaj, prandaj në kohën e fundit duhet të ndodhen atje kuadrot drejtues të kombinatit.

Për problemet e bujqësisë njerëzit tani janë mobilizuar më mirë, sidomos për vjeljen e pambukut. Por të çudit fakti që gazeta shkruan si pa gjë të keqe që këtë radhë kishin dalë në fushë edhe burrat! Po tani që shiu po vazhdon ç'do të bëhet me pambukun? Kjo punë kërkon një mobilizim total për këtë problem jetik. Pambukun e kemi akoma përjashta në fushë, prandaj të përfitojmë nga ditët me kohë të mirë, por edhe në ditët me shi, sa hap pak koha, të shkohet menjëherë në arë. Kështu të veprohet edhe për punët e tjera bujqësore si për punimin e tokave, për mbjelljet, sepse kjo çështje ka rëndësi të madhe. Atje ku toka mund të punohet dhe të plehërohet duhet me qenë kurdoherë në gatishmëri, ndryshe na krijohen deficite të mëdha dhe detyrohemi të hamë rezervat ose të importojmë më shumë misër dhe grurë nga sa kemi vendosur.

Tani qeveria është duke u përgatitur për t'i parqitur Byrosë Politike dhe Plenumit të Komitetit Qendror gjendjen e realizimit të planit gjatë këtyre 4 vjetëve. Neve na duhet të mobilizohemi totalisht për të mbushur deficitet që janë krijuar, gjatë kësaj periudhe, në disa drejtime. Kur deficitet rrjedhin nga disa kushte objek-

tive është një tjetër çështje, po s'duhet harruar se ne kemi edhe shumë të meta subjektive kundër të cilave duhet luftuar.

Gjendja e brendshme e vendit tonë është e fortë, sepse e fortë është edhe Partia jonë, i fortë është edhe kampi i socializmit. Ne po përpiqemi për forcimin e mekanizimit të bujqësisë. Këtë çështje e ngre më me forcë për të pasur një sasi force punëtore të lirë më të madhe për të përballuar gjithë këto punime të mëdha që po bëjmë në sektorin e ndërtimeve dhe në industrinë e re. Përveç kësaj, mekanizimi na nevojitet edhe për të shpejtuar punimin e tokave e për të siguruar rendimente më të mëdha të prodhimeve bujqësore.

Miqtë kanë shfaqur dashurinë, besimin dhe admirimin për forcën e Partisë sonë dhe qëndrimin e drejtë marksist-leninist të saj si dhe vendosmërinë e Partisë sonë në luftën parimore kundër revizionizmit. Ata e kanë kuptuar situatën konkrete në të cilën ndodhet vendi ynë për shkak të tendencave revizioniste dhe oportuniste të udhëheqësve jugosllavë, si dhe të kërcënimeve që i bëjnë vendit tonë vendet imperialiste rreth kufijve tanë. Kjo nuk është për të na bërë qejfin, po situata është e tillë që Partia jonë ndjek me besnikëri marksizëm-leninizmin dhe është e papajtueshme me elementët antiparti, oportunistë e revizionistë.

Çështjen e revizionistëve jugosllavë Partia jonë e ka parë, e sheh e do ta shohë drejt dhe ashtu sikurse thuhet në artikullin e botuar në gazetën «Zëri i popullit» disa ditë më parë, Komiteti Qendror i Partisë sonë nuk e përzien çështjen e bashkekzistencës paqësore me vendet e tjera me sisteme të ndryshme shoqërore,

me bashkekzistencën ideologjike. Ajo i qëndron besnike marksizëm-leninizmit. Për çështjen e revizionistëve në parimet ne nuk bëjmë asnjë lëshim. Në parimet bashkekzistencë nuk ka, kurse në rrugën shtetërore marrëdhënie ne mund të kemi.

Partia jonë u bën ballë të gjitha intrigave të armiqve, si dhe atyre të revizionistëve jugosllavë që s'kanë pushuar asnjë çast kundër vendit tonë. Ata vazhdimisht provokojnë, shkruajnë përditë kundër Partisë e shtetit tonë dhe ndërhyjnë në punët tona, dërgojnë grupe spiunësh e diversantësh, të cilët vazhdimisht janë kapur, sepse arma e sigurimit dhe rojet tona të kufirit janë të papërkulura dhe mbrojnë me vigjilencë atdheun nga armiqtë. Populli që jeton në krahinat kufitare është i lidhur si mishi me thoin me forcat e kufirit, bashkë me këto mbron lirinë e pavarësinë e atdheut dhe kufijtë i bën të paprekshëm nga goditjet e bandave që dërgon Tito dhe shokët e tij që bëjnë demagogji kur thonë se «janë për miqësinë» «dhe janë shqiptarët ata që i kanë fjalët në dhëmbë». E vërteta është se ne ndaj tyre jemi të matur, të drejtë, marksistë. Ato që revizionistët jugosllavë bëjnë kundër nesh mundohen t'i bëjnë edhe kundër vendeve të tjera socialiste, por kudo po u grisët maska, kudo po pësojnë disfata dhe po hanë grushte edhe atje ku kanë pasur shpresa të gjenin terren të favorshëm.

Sikurse kemi marrë vesh, kohët e fundit në Poloni kanë dalë disa vështirësi ekonomike. Ka pasur sidomos mungesë të theksuar në artikujt ushqimorë që janë si pasojë e vijës revizioniste të ndjekur nga ata edhe në sektorin e bujqësisë. Përsa i përket «vetadministrimit»,

në shumë ndërmarrje ekonomike ata kanë aplikuar metodat jugosllave. Kjo ka bërë që të ngrihen në mënyrë jomarksiste, josocialiste pagesat, që fshatarët të zhvillojnë tregun e zi, të pasurohen dhe ta bëjnë ata e jo shteti politikën e furnizimit të tregut me mish, të bëhen abuzime nëpër ndërmarrjet ashtu sikurse ndodh në shkallë të gjerë në Jugosllavi. Vetë Kardeli, kohët e fundit, pasi foli gjithë ato gjëra të bukura për partinë e tij, erdhi më në fund te çështja e ushqimeve dhe e qirave dhe e paralajmëroi popullin jugosllav për ngritjen e çmimit të mishit deri në 12-15 për qind. E njëjta gjë edhe për qiratë. Kështu ndodh atje ku drejtojnë revizionistët.

Një situatë e tillë e ka tronditur udhëheqjen e partisë në Poloni, ku tani janë duke u marrë disa masa pozitive. Të famshmit Moravski, që elementët antiparti në Konferencën e Tiranës e kishin si flamurtar, i vunë gishtin, po kështu edhe Zambrovskit, ndërsa Ohabin e kanë kritikuar rëndë dhe organizatat-bazë të partisë tani janë duke kërkuar nga udhëheqja arsyet që kanë sjellë në këtë situatë të rëndë ekonomike<sup>1</sup>. Shihet se revizionistët kudo po pësojnë disfata.

Ju jeni drejtues kryesorë dhe ndiqni vazhdimisht kursin e situatës ndërkombëtare. Në përgjithësi situata është e favorshme.

Duke pasur parasysh zhvillimin e situatës së jashtme e të brendshme, duke pasur në krye një Parti të tillë

---

<sup>1</sup> Revizionisti Gomulka u detyrua të merrte masa kundër revizionistëve Moravski, Zambrovski etj. nga presioni i masave të partisë.

si kjo e jona, me një unitet të fortë si çeliku dhe me lidhje shumë të ngushta me popullin, të jemi të sigurtë se detyrat që na ka ngarkuar Partia dhe populli ne do t'i kryejmë me sukses.

Rëndësi të madhe ka zbatimi me rigorozitet i vijës së Partisë, mobilizimi i të gjithëve rreth problemeve që shtron Partia dhe lufta për kapërcimin e vështirësive. Mbi të gjitha rëndësi të madhe ka lidhja me masat. Koha vërteton vazhdimisht se sukseset e Partisë në të gjitha fushat rrjedhin nga vija e saj e drejtë dhe nga lidhjet e saja të ngushta me masat.

Prandaj le t'i vihemi punës edhe për realizimin e këtyre dy detyrave të rëndësishme për Partinë që shtrroi në këtë mbledhje Plenumi i Komitetit Qendror. Le t'i kemi mirë parasysh të gjitha këto që na u thanë nga Komiteti Qendror dhe të mos harrojmë për asnjë çast, njëkohësisht edhe forcimin, kalitjen dhe ruajtjen e pastërtisë së Partisë. Duke vepruar kështu, si kurdoherë, edhe për këto dy probleme ne do të kemi përpertime dhe vija e Partisë do të fitojë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga protokoll  
i mbledhjes së plenumit që  
gjendet në AQP*

# NË SHQIPËRI NUK KA VEPËR QË TË MOS KETË EDHE VULËN E HEROIZMIT E TË VETËMOHIMIT TË VAJZAVE E TË GRAVE TONA<sup>1</sup>

8 nëntor 1959

Të dashura shoqe,

Me kënaqësi të madhe lexova letrat tuaja dhe u gëzova pa masë për sukseset që keni arritur. Në emër të Komitetit Qendror të Partisë ju përgëzoj dhe ju uroj që në të ardhshmen, si anëtare të denja të BRPSH-së, të korrni suksese të reja për të mirën e atdheut dhe tuajën.

Ajo që më bëri më tepër përshtypje në këto letra është pjekuria me të cilën ju vlerësoni fitoret e mëdha që ka arritur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë, besimi dhe vullneti juaj i patundur për të shkuar përpara, drejt një të ardhshme gjithnjë më të ndritur. Prapa

---

<sup>1</sup> Letër drejtuar të rejave të kooperativës bujqësore të zmadhuar «Vilhelm Pik» në Tiranë, të kooperativës bujqësore të zmadhuar të Lumas-Pëllumbasit në Berat, të kooperativave bujqësore të lokalitetit të Semanit në Fier, të rejave të rrethit të Mirditës, të kooperativës bujqësore «Skënderbej» të Gjoricës së Epërme në Peshkopi dhe të kooperativës bujqësore «Shkëndia» të Shtërmenit në Elbasan.

çdo fjale tuaj fshihet një forcë e çuditshme dhe kolosale që ka nisur, por që akoma më me vrull dëshiron të vërshojë për të vaditur kopshtin e lulëzuar që po lind kudo në atdheun tonë të ri socialist.

Ju shpesh bëni pyetjen: «E ç'ishim më parë ne të shkretat?» Me të vërtetë të shkreta ishit dje ju, shoqe të dashura; «edhe trarët e shtëpisë qajnë kur lindin vajza», thoshin dje për ju. Të katër muret e shtëpive, ku vajzat e gratë rrinin të mbyllura, janë dëshmitaret e lotëve të tyre të pashterur. Të shtypura dhe të lëna në errësirë, të paditura ishin nënat, gratë dhe motrat tona. Çarçafi dhe perçja e zezë ishin për to si një qefin për së gjalli. Por këto tani i takojnë së kaluarës. Rënkimet dhe protestën e tyre i dëgjoi Partia, ashtu siç dëgjoi edhe protestat e rënkimet e të gjitha masave punonjëse dhe me dufin e zemrave të tyre u sul mbi armiqtë dhe tradhtarët anadollakë, duke bërë shkumb e hi fronet e tyre. 15 vjet më parë, me Çlirimin e Shqipërisë dhe vendosjen e pushtetit popullor, agoi një ditë e re edhe për të rejat e gratë e vendit tonë. Çlirimi i femrës nga shtypja shekullore dhe dhënia asaj e të drejtave të barabarta me burrin është një nga realizimet më të mëdha të Partisë sonë, një nga fitoret më të shkëlqyera të popullit tonë. Tani në Shqipëri nuk ka vepër që të mos ketë edhe vulën e heroizmit e të vetëmohimit të vajzave dhe të grave tona, nuk ka fushë të aktivitetit ku të mos ndritë djersa juaj. Pa pjesëmarrjen e femrës nuk mund të ndërtohen socializmi dhe komunizmi.

Duke hyrë në radhët e Bashkimit të Rinisë, ju keni bërë një punë shumë të mirë dhe një hap tjetër



të madh përpara<sup>1</sup>. Organizata e rinisë është bërë ndihmësja dhe rezerva luftarake e Partisë. Ajo është një shkollë e madhe, ku edukohet dhe kalitet me vetitë e larta të moralit komunist brezi ynë i ri. Aty ju do të merrni mësimet e Partisë, të cilat do t'ju japin krahë dhe energji të pashtershme për të bërë shumë më tepër se deri tani, për të mirën e atdheut dhe tuajën.

Ju vetë thoni në letrat tuaja mbi ndryshimet dhe përparimet që janë bërë në fshat e kudo në Shqipëri. Po a mund të ndalemi ne këtu dhe të kënaqemi me kaq? Derisa u bëmë zotër të fateve tona, ne jetën do ta bëjmë gjithnjë më të pasur e më të bukur. Për këtë një rol vendimtar do të luani edhe ju, të rejtat. Puna është nder thotë një fjalë e urtë e popullit tonë. Prandaj duart tuaja të arta dhe mendja juaj e shëndoshë le të mos pushojnë së punuari. Rinia punëtore është zotuar ta realizojë pesëvjeçarën e dytë në katër vjet e gjysmë. Shoqet tuaja në fabrika, uzina e kombinatë po luftojnë për ta mbajtur me nder këtë zotim. Qindra prej tyre tani bëjnë pjesë në brigadat që punojnë për të fituar titullin e 15-vjetorit të Çlirimit. Te këto të reja populli shikon figurën e njeriut të ri, të brumosur nga Partia, të njeriut të epokës së socializmit, që, pa marrë parasysh asnjë pengesë e vështirësi, ka vendosur «të punojë më mirë, të mësojë më shumë dhe të jetojë në mënyrë të kulturuar». Shembullin e tyre duhet ta ndjekin mijëra të reja punëtore dhe kooperativiste.

---

<sup>1</sup> Në prag të 15-vjetorit të Çlirimit të atdheut, si rezultat i një pune të gjerë nga ana e Partisë dhe e organizatës së rinisë shumë vajza nga rinia e fshatit hynë në radhët e BRPSH-së.

Sikundër e shikoni edhe vetë, atdheu ynë është bërë si një kantier i madh ku vlon puna ndërtimore. Plane dhe vepra të reja, edhe më madhështore, kemi përpara. Është rritur dhe akoma më shumë do të rritet armata e lavdishme e klasës sonë punëtore. Në radhët e saja duhet të futen sa më shumë të reja që punojnë në industri, artizanat, ndërtim, transport etj. Partia ka besim se ato, që kurrë s'e kanë bërë dy fjalën e saj, patjetër do ta plotësojnë këtë porosi.

Rinia e kooperativave bujqësore dhe e fshatrave po punon me të gjitha forcat për të realizuar me nder zotimet e saj lidhur me mbjelljen e pemëve frutore, të ullinjve dhe në zhvillimin e blegtorisë. Në këto suksese një meritë e madhe ju takon juve, të rejave fshatare e malësore. Qindra të reja luftojnë sot për të marrë rendimente të larta në qumësht nga lopët, për të rritur sa më mirë viçat, për të marrë sa më shumë mish nga bagëtitë, për të rritur shpendë të majmë, krimbin e mëndafshit etj. Por këto janë akoma pak, mijëra e mijëra të tjera duhet të futen në garë me to, për ta bërë sa më të pasur jetën e fshatit dhe të mbarë vendit tonë. Sa gëzim i madh është kur mëson se ju luftoni për të tejkaluar minimumin e ditëve të punës, se ju punoni me dashuri të madhe e me plot rezultate në kultivimin e pambukut, të duhanit, të të lashtave etj.! Në shembullin tuaj duhet të ecin dhjetëra mijëra të reja të fshatit tonë të ri. Partia ka besim se kurdoherë ato do ta plotësojnë këtë porosi tjetër të saj.

Por që të punosh mirë duhet të dish. Pa këtë s'mund të realizohen as dëshirat as zotimet. Qindra shkolla e kurse profesionale për teknikë, agrozooteknikë

etj. janë hapur në të katër anët e vendit. Mjaft prej jush i ndjekin ato dhe po përfitojnë shumë. Për këtë Partia ju përgëzon. Por ato duhet t'i ndjekin sa më shumë të reja kooperativiste e punëtore, sepse nga rradhët tuaja duhet e do të dalin sa më shumë brigadiere, skuadërkomandante, teknike etj. Kryetarët e kooperativave bujqësore dhe drejtorët, agronomët dhe specialistët nuk janë kursyer dhe nuk do të kursehen as edhe në të ardhshmen për t'ju bërë të zonjat për sektorët tuaj, mjafton që ju të keni vullnet. Ju me siguri do ta përmbushni edhe këtë porosi të Partisë.

Për t'u lavdëruar janë edhe përpjekjet e inisiativat tuaja për një jetë sa më të kulturuar në familje dhe në shoqëri. Me duart tuaja të shkathëta ju keni nisur të vendosni rregull e pastërti në shtëpi, ju po shkelmoni me guxim mënyrën primitive e antihigjienike të jetesës, zakonet prapanike e paragjykimet fetare që u sillnin kaq mjerime e fatkeqësi fshatarëve e malësorëve; ju keni nisur të visheni sa më bukur, të merrni pjesë në grupe e aktivitete artistike dhe sportive. Ç'pamje të mrekullueshme po merr fshati ynë nga dita në ditë me vajza e gra të tilla të mrekullueshme si ju! Por ju nuk duhet të ndaleni në sukseset e para. Për të arritur atje ku duhet, nevojitet akoma shumë punë e luftë. Vajzat, kudo qofshin, në kooperativë, në fabrikë ose në shkollë, duhet të mësojnë vazhdimisht ta ekonomisin sa më mirë shtëpinë, të presin, të qepin ose të qëndisin. Ju duhet t'i bëni shtëpitë tuaja model të një jetese të kulturuar. Ju duhet të qëndroni të forta, ashtu si është gjithë rinia jonë heroike, në luftën kundër zakoneve prapanike që janë të dëmshme për të ardhshmen tuaj.

Mësimet e Partisë sonë, fjala e Partisë për ju duhet të jenë kurdoherë feneri që u ndriçon rrugën e lavdishme në të cilën ecën gjithë rinia jonë; ju nuk duhet t'i lejonit vetes që të zgjidhen problemet sipas zakoneve prapanike, në kundërshtim me edukatën që ju jep Partia, në kundërshtim me vullnetin tuaj. Të luftoni me vendosmëri çdo pengesë që ju del përpara dhe që ka të bëjë me të ardhshmen tuaj. Të gjitha këto mundësi të mëdha që ka krijuar pushteti popullor për rininë tonë të lavdishme, si shkolla, qendra kulture, artistike, fis-kulturale etj., duhet t'i shfrytëzoni sa më shumë. Mos harroni se të drejtat tuaja mbrohen me ligj nga pushteti popullor dhe ato s'guxon t'i shkelë asnjë njeri. Pranë jush kurdoherë është Partia. Kërkoni dhe ju do të gjeni gjithmonë mbrojtjen e përkrahjen e saj, të komunistëve, të organizatave të Partisë, të organizatave tuaja të rinisë dhe të organizatës së BGSH-së.

Tani ju, duke qenë anëtarë të BRPSH-së, mos harroni se duhet të jeni shembull për shoqet tuaja të tjera në çdo drejtim. Ato duhet të shohin te ju luftëtarët e papërkulura dhe më aktive për jetën e re të lumtur socialiste. Merrni pjesë gjallërisht në të gjitha aktivitetet e organizatës së rinisë. Tërhiqni në to edhe shoqet tuaja që nuk janë akoma të organizuara në rini dhe punoni për shtimin e radhëve të organizatës me sa më shumë të reja, të denja për titullin e lartë të anëtares së BRPSH-së. Bëhuni agjitatore të flakta, në radhë të parë te prindërit, vëllezërit dhe burrat tuaj, pastaj edhe në shoqet tuaja. Do të shihni se, në fund të fundit, përpjekjet tuaja do të kurorëzohen me sukses. Si lulet në pranverë që çelin, zbukurojnë e mbushin me aromë

natyrën, ashtu të rejat heroike të vendit tonë do të futen gjithnjë e më shumë në jetën aktive dhe do ta bëjnë atë më të këndshme e më të bukur.

Së shpejti ne do të festojmë 15-vjetorin e lavdishëm të Çlirimit të atdheut. Edhe një herë ju uroj nga zemra, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, që këtë festë të madhe ta prisni me sa më shumë suksese në punët tuaja paqësore e fisnike dhe me sa më shumë gëzim në jetën tuaj personale! Uroj gjithashtu që konferenca e dytë kombëtare e të rejave, që së shpejti do të mbli-dhet në Tiranë, të bëhet një armë e fuqishme në duart tuaja, për të shkuar gjithmonë përpara!

Rroftë BRPSH, ndihmësja dhe rezerva luftarake e Partisë së Punës të Shqipërisë!

Rrofshin të rejat dhe gratë heroike të vendit tonë, bashkëluftëtare aktive në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit!

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 269 (3484), 8 nëntor 1959*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## FJALA NË SHKOLLËN E BASHKUAR TË OFICERËVE «ENVER HOXHA»

8 nëntor 1959

Të dashur shokë kursantë të Shkollës së Bashkuar të oficerëve,

Të dashur shokë skënderbegas,

Të dashur shokë nënoficerë, oficerë, gjeneralë dhe admiralë të ushtrisë sonë të lavdishme,

Më lejoni që me rastin e 15-vjetorit të themelimit të shkollës suaj, t'ju sjell përshëndetjet më të zjarrra revolucionare të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të qeverisë sonë popullore dhe t'ju uroj juve suksese akoma më të mëdha në punën tuaj të lavdishme, t'ju uroj suksese në edukimin tuaj ushtarak, politik dhe ideologjik.

Ne më të vjetrit nga ju, gëzohemi pa masë për këto suksese të shkollës suaj, që i kushtohen Partisë sonë të lavdishme, e cila disa javë para çlirimit të plotë të Shqipërisë mendoj të krijonte shkollën tuaj për pregatitjen e oficerëve. Ju oficerët e rinj, kursantët, sigurisht jeni mbrujtur dhe edukuar me traditat e Luftës sonë heroike Nacionalçlirimtare që ka bërë populli ynë,

me traditat e Partisë sonë Komuniste (tani Partia e Punës) 18-vjetorin e themelimit të së cilës ne së bashku po e festojmë sot.

Jeni pikërisht ju që çdo ditë e çdo orë frymëzoheni nga lufta legjendare e popullit tonë, janë komandantët dhe pedagogët tuaj që me punën e tyre të palodhur kanë bërë që nga kjo shkollë të dalin kuadro të mrekullueshëm e besnikë që sot drejtojnë repartet e ushtrisë sonë moderne. Traditat revolucionare të popullit tonë, ju kursantët e skënderbegasit, duhet çdo ditë e më shumë t'i kalitni, t'i zhvilloni sepse, duke u mbështetur në to, do të ecni më me vrull dhe do të korrni suksese gjithnjë më të mëdha në punën tuaj.

Shokë kursantë, skënderbegas dhe oficerë! Mos harroni kurrë përpjekjet dhe sakrificat e mëdha të baballarëve, gjyshërve, vëllezërve dhe motrave tuaja për këto ditë të shkëlqyera. Këto ditë nuk erdhën aq lehtë, për to u derdh gjaku i bijve e i bijave më të mira të Shqipërisë, të cilët rrokën armët me thirrjen e Partisë dhe nuk kursyen as jetën po luftuan me heroizëm në kushte shumë të vështira, kur armiku kishte armë moderne dhe ne nuk i kishim ato. Këtë ata e bënë se në zemrën e tyre vlonte një dashuri e madhe për liri, demokraci e socializëm. Ata u bënë ballë armëve të armikut dhe vështirësive shumë të mëdha për bukë dhe veshmbathje, prandaj ne ata nuk duhet t'i harrojmë. Çdo vit Shqipëria do të përparojë, jeta e popullit do të bëhet akoma më e mirë, por të gjitha këto suksese të mëdha u bënë të mundura në saje të Luftës heroike Nacionalçlirimtare të popullit, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë.

Prandaj, për Partinë tonë të Punës të rrahin në çdo çast zemrat tona dhe kurdoherë secili të bëjë pyetjen: A është në interesin e Partisë kjo që bëj apo jo? Në rast se ajo punë është në interesin e Partisë, të veprohohet me të gjitha forcat për ta kryer, për të siguruar suksesin, në rast se nuk është dhe shihet se dëmtohet Partia, duhet të tërhiqemi menjëherë.

Në shpirtin tuaj, të dashur shokë kursantë dhe oficerë, këto këshilla të Partisë të rrënjosen thellë, se ju jeni bijtë e denjë të Partisë dhe të popullit, se Partia pas mbarimit të luftës ka menduar për ju, ka menduar për ushtrinë më shumë se për çdo gjë tjetër, duke u nisur nga interesi i lartë i mbrojtjes së atdheut dhe i jetës së lirë të popullit tonë. Ne menduam që ushtria jonë të jetë një ushtri moderne, komplekse, e pajisur me eksperiencën e madhe të Luftës Nacionalçlirimtare. Partia qysh gjatë kohës së luftës mendonte se pa një ushtri moderne, besnike deri në fund e popullit dhe e Partisë, nuk mund të fitohej dhe të mbroheshin fitoret e Luftës Nacionalçlirimtare. Pra, formimi i shkollës suaj është një nga kujdesjet e para të Partisë për plotësimin e këtyre detyrave.

Për forcimin dhe modernizimin e ushtrisë iu desh një punë e madhe Partisë dhe komandës dhe këtë detyrë e kreu me nder gjenerali i lavdishëm i ushtrisë sonë, shoku Mehmet Shehu. Ai organizoi shtabet tona dhe, si Shef i Shtabit të Përgjithshëm, organizoi ushtrinë dhe e modernizoi atë sipas shembullit të Ushtrisë Sovjetike. Ai mbrojti me sukses vijën e Partisë sonë në ushtri, artin dhe shkencën ushtarake sovjetike nga revizionistët e maskuar jugosllavë që përpiqeshin ta likui-



donin ushtrinë tonë, për ta bërë atë një bisht të prapambetur të ushtrisë së tyre.

Të dashur shokë, detyra jonë për forcimin e ushtrisë nuk ka mbaruar. Pavarësisht se tani situata ka ndryshuar ne duhet të kemi një ushtri të fortë, vigjilente, të pajisur me të gjitha mjetet e reja moderne për t'i bërë ballë çdo rreziku eventual. Vigjilenca duhet të jetë në qendër të vëmendjes suaj për mbrojtjen e vendit tonë, për mbrojtjen e kampit të socializmit.

Nuk na lejohet që, të entuziazmuar nga kjo situatë e favorshme që është krijuar në botë, të shkujdesemi. Jo, nuk duhet të shkujdesemi. Ritmi i punës në shkollë, disiplina, edukimi juaj duhet të vazhdojnë ashtu si kanë vazhduar më parë, bile edhe më fort. akoma, sepse vetëm kështu, duke pasur një ushtri të fortë, duke pasur një ushtri të çelniktë, besnike të Partisë, duke pasur sidomos një unitet të çelniktë në Parti, vetëm kështu do të bëjmë që imperialistët të prapsen përpara planeve të tyre agresive. Prandaj, edhe një herë në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë, ju këshilloj ju, të dashur oficerë dhe pedagogë, ta kryeni me nder këtë detyrë kaq të madhe, që ju ka besuar Partia.

Populli ynë ashtu si gjithë popujt e kampit socialist, është popull paqësor, nuk e do luftën. Por në një situatë të tillë si kjo e tanishmja vendet tona duhet të bëjnë nga njëra anë përpjekje për paqen, por nga ana tjetër barutin ta mbajnë kurdoherë të thatë.

Ushtria jonë është një ushtri e tipit të ri, ushtri e popullit. Ajo është një shkollë e madhe jo vetëm për mbrojtjen e atdheut, por edhe për përhapjen e kulturës

në vendin tonë. Në radhët e ushtrisë sonë me mijëra njerëz jo vetëm kanë mësuar të shkruajnë dhe të lexojnë, por shumë prej tyre kanë marrë një kulturë të mjaftueshme.

Ushtria jonë jo vetëm që ka kryer me nder detyrat e mëdha për përgatitjen ushtarake dhe politike, por ka çuar në fshat, në qendra pune e prodhimi ndjenjën e përgjegjësisë dhe të vullnetit të çelniktë për punën. Këtë e tregon çdo ditë me fakte në punën që bën për mbrojtjen e atdheut dhe për ndërtimin e socializmit, konkretisht në ndërtim, në bujqësi, ku reparte të tëra të ushtrisë ndihmojnë sektorë të ndryshëm të ekonomisë së vendit tonë.

Kjo cilësi e lartë e ushtrisë sonë i detyrohet në radhë të parë Partisë sonë të lavdishme marksiste-leniniste, punës plot ndërgjegje të komandës suaj udhëheqëse.

Ushtria jonë Popullore është e ndërgjegjshme për misionin e saj të lartë, se ajo mësohet e edukohet me shkencën marksiste-leniniste. Prandaj marksizëm-leninizmin, shokë, duhet ta mësoni në teori dhe ta vini në praktikë, në jetë. Shokët që kanë mësuar në Akademinë «Lenin», në Shkollën tonë të lartë të Partisë e në shkolla të tjera duhet t'ju mësojnë juve historinë e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik dhe historinë e Partisë sonë të Punës. Ata duhet ta lidhin atë me ndërtimin konkret të socializmit në vendin tonë dhe në vendet e tjera socialiste. Ju duhet t'i lidhni mësimet e Partisë me punën dhe edukatën tuaj ushtarake dhe politike. Të udhëhiqeni vazhdimisht nga marksizëm-leninizmi, sepse, duke mësuar marksizëm-leninizmin,

detyrat tuaja do t'i kryeni më mirë, ndryshe ato nuk do t'i kryeni dot. Për ata që zotërojnë marksizëm-leninizmin, kjo shkencë është armë për zgjidhjen e çdo problemi. Ata që janë besnikë deri në fund ndaj marksizëm-leninizmit, ata janë njerëzit më të devotshëm, që meritojnë respektin e popullit. Atyre që luftojnë marksizëm-leninizmin t'u jepet grusht hundëve.

Pavarësisht se Partia jonë si parti e re nuk ka pasur eksperiencë të madhe, ajo, duke i qëndruar besnike marksizëm-leninizmit dhe duke u bazuar në eksperiencën e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, u mësua, u kalit gjatë luftës, shpartalloi të gjitha grupet fraksioniste, trockiste, revizioniste e tradhtare dhe në momente shumë të vështira, kur në punët tona ndërhyjnë revizionistët jugosllavë, ajo diti t'i përballojë vështirësitë dhe më në fund të dalë fitimtare.

Shokë,

Kini parasysh se shekulli ynë është shekulli i teknikës dhe i shkencës. Ju keni në përdorim armë të reja nga më modernet dhe në të ardhshmen ato do të jenë më të perfeksionuara, por pa mësuar, pa zotëruar shkencën nuk do të jeni në gjendje t'i njihni e t'i përdorni. Veç kësaj, shumë shokë që mbarojnë shërbimin ushtarak në të ardhshmen do të punojnë në industrinë tonë shumë të përparuar që do të zhvillohet edhe më tej në perspektivë. Ju e dini se vendi ynë socialist deri tani ka ecur shumë përpara dhe në të ardhshmen do të ecë akoma më shumë.

Partia dhe qeveria janë duke përgatitur planet e ardhshme pesëvjeçare të vendit tonë. Nuk do të jetë e

largët koha, ose më mirë të themi nuk do të duhen më tepër se 10-15 vjet që vendi ynë të ketë shumë më tepër fabrika dhe uzina se sa tani dhe atëherë ne nuk do të themi më kombinati i tekstileve «Stalin», por kombinatet e tekstileve, nuk do të themi më fabrika e çimentos, por fabrikat e çimentos e kështu me radhë. Industria e naftës do të zhvillohet akoma më shumë sepse tani ne po zbulojmë burime të reja dhe tok me naftën do të nxirret dhe gazi që së bashku do të jenë baza e industrisë kimike. Në të ardhshmen do të kemi industri kimike jo vetëm për plehra, për prodhimin e të cilave po merren masa që të ngrihen dy uzina brenda pesëvjeçarit të ardhshëm, por dhe industrinë e petrokimisë për prodhimin e artikujve plastikë.

Ne do të ngremë metalurgjinë e zezë dhe një sërë fabrikash e uzinash të tjera që do të jetë e vështirë t'i numërojmë tani. Shqipëria, nga një vend gjysmëkolonial, nga një vend i prapambetur në të kaluarën, po i ngjit shkallët një nga një në ndërtimin e socializmit. Këtë rrugë ajo po e bën në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë të Punës. Kur shumë shokë moshë do t'i detyrojnë të dalin nga ushtria ata do të hidhen në prodhim për t'i drejtuar gjithë këto fabrika e uzina të reja që do të ngrihen, për të drejtuar traktorët e shumë dhe mekanizmat e tjera që ka në plan qeveria jonë të sjellë për të shtuar çdo vit prodhimet bujqësore, për të pasur populli më shumë bukë dhe prodhime të tjera bujqësore e blegtorale.

Populli ynë ka një dashuri dhe besim të madh të oficerët, nënoficerët dhe ushtarët e tij heroikë, bijtë e ushtrisë sonë të lavdishme që e çliroi atë një herë e

përgjithmonë nga zgjedha e pushtesve fashistë dhe e tradhtarëve të vendit dhe sot mbron punën e tij paqësore. Prandaj përgjegjësia juaj është shumë e madhe. Ju si komunistë dhe patriotë të ndershëm, duke pasur parasysh përgjegjësinë kaq të madhe që keni përpara popullit dhe Partisë, të jeni shembull jo vetëm në disiplinë, por në çdo hap të jetës suaj. Partia ka besim te ju dhe ju po i kryeni detyrat më së miri për të pasur një ushtri të gatshme për të përballuar në çdo çast rreziqet që mund t'i kanosen atdheut.

Në ushtri duhet të forcohet në radhë të parë puna e Partisë. Në qoftë se organizata e Partisë në ushtri nuk është e fortë, ndodhin gjëra të papëlqyeshme. Por po të jetë Partia e fortë, nuk do të ketë vend as për ndonjë shfaqje të sëmurë. Prandaj Partia të kalitet, të kaliten vetë komunistët një më një. Të mos mendojmë se te ne si komunistë nuk do të shfaqen mbeturinat e së kaluarës. Armikun e jashtëm ne e luftojmë me forcë të madhe, por, kur vjen puna për të luftuar kundër armikut të brendshëm, kundër këtyre mbeturinave, ka njerëz që nuk paraqiten në lartësinë e duhur. Prandaj të qëndrojmë në lartësinë e detyrave dhe me anën e kritikës dhe të autokritikës të luftojmë dobësitë dhe t'i zgjidhim problemet që na dalin në rrugën e Partisë.

Kujtdo mund t'i ngjasë ndonjë padrejtësi për ndonjë çështje që nuk i është zgjidhur. Kjo ndodh se ka edhe njerëz të pandërgjegjshëm. Këto çështje duhet t'i shikojmë drejt dhe për ndonjë padrejtësi që mund të bëhet nuk duhet të kalohet menjëherë në planin politik, se kjo është shumë e rrezikshme. Mund të ketë, për shembull, midis jush ndonjë që nuk i është zgjidhur

nevoja për strehim. Po kush do që të mos ju jepen juve dhe të gjithë punonjësve apartamente? Partia jonë dhe qeveria përpiqen vazhdimisht t'i plotësojnë nevojat e popullit, që populli të ketë banesa më shumë. Ju vetë e shikoni, të dashur shokë, se nga të katër anët e Shqipërisë po ndërtohen apartamente dhe këto ndërtohen për popullin tonë. Po nevojat janë të mëdha dhe ato gradualisht po plotësohen. Mundet që ndërtesat e banimit të ndërtohen më mirë, më shpejt dhe më lirë. Ne do të marrim masat për një punë akoma më të mirë në këtë drejtim. Po kemi dhe vështirësi se na mungon lënda e parë, bile, duke marrë parasysh ritmin e madh të ndërtimeve, na mungojnë edhe teknikët e specialistët. Ju shokë, duhet të jeni propagandistë të mirë në popull për të hequr nga disa njerëz, burra ose gra, turpin mikroborgjez për të punuar në ndërtim, për të bërë llaç dhe mure, sepse ka akoma të tillë që nuk e shikojnë punën si nder e lavdi. Kështu ne do të krijojmë armata të tëra ndërtuesish e do të plotësojmë më shpejt nevojat e popullit.

Por fjalën e kisha këtu, që çështjet e vogla t'i zgjidhim në rrugë partie dhe të mos i lëmë të kalojnë ato në pakënaqësi. Kështu Partinë tonë do ta mbajmë të pastër, sepse ju e kuptoni që armiqtë e fshehtë përpiqen t'i kapin këto pakënaqësi që nuk janë as parimore, as politike, t'i zmadhojnë e t'i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre kundër Partisë dhe shtetit tonë. Komunistët duhet të jenë të zgjuar në këtë drejtim, të jenë në gjendje që qysh në momentet e para t'i nuhatin e t'i njohin qëllimet e armiqve dhe të luftojnë kundër tyre.

Shokë të dashur, Partia jonë ka bërë një luftë të

vendosur për mbrojtjen e interesave të atdheut tonë socialist, të kufijve tanë, të nderit, të zakoneve dhe të jetës së re që po ndërtohet. Çështjen e bashkekzistencës paqësore revizionistët jugosllavë përpiqen ta përdorin për t'u hedhur pluhur syve popujve të vendeve socialiste. Ata e ngrenë çështjen e bashkekzistencës paqësore, por ne dhe gjithë partitë e tjera komuniste dhe punëtoresh nuk e kuptojmë dhe nuk do ta kuptojmë këtë bashkekzistencë që predikojnë ata.

Partitë tona janë dhe luftojnë në mënyrë aktive për bashkekzistencë paqësore, por jo për bashkekzistencë ideologjike. Në frontin ideologjik ne luftojmë dhe nuk pajtohemi me revizionistët, pra në këtë fushë nuk mund të ketë pajtim me ta. Me shtetin jugosllav ne dëshirojmë të kemi marrëdhënie të mira, por në marrëdhëniet me ne, ata shkelin ligjet ndërkombëtare, si për shembull në çështjen për rregullimin e shfrytëzimit të ujërave të përbashkëta dhe dëmtojnë kështu interesin tonë. Ne kemi bërë edhe marrëveshje tregtare, por ata nuk i zbatojnë. Ata vazhdojnë të dërgojnë diversantë dhe spiunë kundër vendit tonë, por deri sot nuk kanë pasur asnjë sukses, sepse rojet tona të kufirit janë vigjilente, sepse organet e sigurimit tonë ruajnë me besnikëri interesat e popullit dhe të atdheut dhe Partia jonë udhëheq me një unitet të çelniktë jetën e vendit tonë dhe arrin kurdoherë suksese të reja duke bërë të pamundur veprimtarinë e armiqve dhe duke u shkakuar atyre disfata pas disfatash.

Partia jonë qëndron gjithmonë vigjilente në luftë kundër revizionistëve jugosllavë. Këtë luftë të drejtë parimore e përkrahin të gjitha partitë motra komu-

niste e punëtore të botës dhe me të drejtë ne kemi fituar një respekt dhe dashuri nga të gjithë miqtë. Prandaj, të dashur shokë, ta duam Partinë, ta kalitim atë çdo ditë, sepse këtu qëndron siguria, e ardhshmja e vendit tonë, prandaj gjithë efektivitë jua, kursantët, ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, të vazhdoni punën me me vrull në përgatitjen tuaj ushtarake, politike dhe ideologjike, se në këtë mënyrë do të mbrojmë me besnikëri atdheun nga çdo rrezik dhe kur të largoheni nga ushtria ju do të jeni përsëri në ballë të frontit të punës për ndërtimin konkret të socializmit në vendin tonë.

Të rrojë Partia jonë heroike e Punës!

Të rrojë Ushtria jonë Popullore e lavdishme!

Të rrojnë, të përparojnë, të kaliten në rrugë partie kursantët e Shkollës së Bashkuar «Enver Hoxha» dhe të bëhen oficerë të denjë të ushtrisë sonë të lavdishme!

T'i keni në kujdes të veçantë, ashtu si i ka Partia, skënderbegasit e vegjël, të cilët janë fidanishtja, e ardhshmja e lavdishme e Ushtrisë sonë Popullore!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## TË MOS ULM SHIFRAT E PLANIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

16 nëntor 1959

Këto diskutime dhe propozime që u bënë në këtë mbledhje të Byrosë Politike duhet të shërbejnë për t'iu përmbajtur shifrave që janë caktuar nga Plenumi i Komitetit Qendror dhe, atje ku nuk ka mundësi, të luftohet për të arritur maksimumin e mundshëm. Në qoftë se shifrat shikohen me këtë sy dhe përsëri nxirret konkluzioni se ato nuk mund të arrihen, atëherë, nga ana e Byrosë Politike, t'i thuhet Plenumit të Komitetit Qendror arsyet pse nuk mund të arrihen zërat kryesorë që ai ka caktuar për vitin 1960. Ne si Byro Politike dhe si qeveri nuk kemi të drejtë të prishim vendimet që ka marrë Plenumi i Komitetit Qendror. Vetëm pasi të analizohen mirë dhe me hollësi këto çështje nga ana e qeverisë dhe e Byrosë Politike, atëherë mund t'i dalim

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u shqyrtuan shifrat kryesore të projektplanit të vitit 1960.

me propozime dhe me arsyetime Plenumit të Komitetit Qendror për të ndryshuar ndonjë vendim të marrë nga ana e tij.

Shtesat që u bënë në plenumin e shkurtit kanë qenë të drejta. Këtë e tregon edhe fakti se në mjaft zëra janë arritur shifrat e parashikuara, gjë që provon se ato kanë qenë të bazuara. Bile disa shifra edhe janë tejkaluar. Pra kanë qenë mundësitë që disa detyra të caktuara nga kongresi të tejkalohen. Por duhet njohur se ka edhe mosrealizime, kjo e ka burimin në faktin se disa nga studimet tona nuk kanë qenë të sakta, në disa raste ka munguar një orientim i qartë në punë, organizimi dhe kontrolli i zbatimit kanë pasur të meta, materialet e importit nuk kanë ardhur në kohë etj. Këto shkaqe duhet të zënë një vend me rëndësi në këtë analizë kritike që po bëjmë.

Është e domosdoshme që të japim llogari për ato që nuk janë realizuar për mungesat tona. Natyrisht, ka edhe çështje për të cilat nuk mund t'i bihet murit me kokë. Kështu, është, për shembull, çështja e naftës, por edhe këtu duhet thënë që ne fluturuam duke caktuar një prodhim jashtë mundësive tona aktuale. Por plenumi nuk mund të qëndrojë pa kritikuar mosrealizimin e planit për vitin 1959. Mua më duket se për këtë një përgjegjësi të madhe ka kombinati i naftës, ministri i Industrisë dhe i Minierave si dhe kryetari i Komisionit të Planit. Pra, në qoftë se nuk kritikojmë mosrealizimin e planit... ton naftë, nuk duhet të lëmë pa kritikuar mosrealizimin e detyrave të vitit 1959, gjë që ka rënduar shumë ekonominë e vendit tonë. Byroja Politike dhe Komiteti Qendror janë vënë në pozitë të vështirë, sepse

të ardhurat tona janë mbështetur duke llogaritur prodhimin e naftës sipas planit.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave duhet ta shikojë më thellë çështjen e naftës, të mos interesohet vetëm për rrugët dhe garazhet, por në radhë të parë rëndësi të madhe t'i kushtojë pusit që në kohën e hapjes së tij. Në këtë drejtim të ushtrohet një kontroll më rigoroz për realizimin e planit. Jam dakord që në prodhimin e naftës të qëndrojmë në... ton. Në rast se Ministria e Industrisë dhe e Minierave i shikon mirë se ku i ka të metat dhe gabimet në punën e saj, ka mundësi që ky plan të realizohet. Natyrisht, në qoftë se kjo ministri nuk ka siguri për të arritur këtë shifër, të mos caktojmë plane sipas dëshirës. Investimet në naftë janë kolosale, prandaj po të ulim prodhimin e saj, duhet të ulim edhe investimet. Kjo duhet shikuar me kujdes nga ana e qeverisë. Është e qartë se, po të mos marrim naftë, sondat nuk duhet të futen në përdorim. Kjo duhet parë jo vetëm për sondat, por edhe për transportin dhe sendet e tjera të importit.

Edhe në çështjet e tjera nuk jam për të ulur shifrat e planit. Kështu për shembull, po ulëm planin e prodhimit të kromit, do të ulen të ardhurat dhe kjo do të influencojë në nivelin e jetës së punonjësve. Në këtë çështje nuk do të zgjatem sepse jam dakord me të gjithë shokët e Byrosë që diskutuan.

Përsa u përket tekstileve të leshta, prodhimit të poçerive e të tjera, gjithashtu jam i mendimit që të zbatohen detyrat e Plenumit të Komitetit Qendror, sepse asgjë s'na mungon, veç organizimit dhe kontrollit të detyrave.

Deficiti më i madh është në prodhimet bujqësore. Në këtë çështje s'kam gjë për të shtuar, dëshiroj vetëm të theksoj se duhen bërë përpjekje më të mëdha për të rritur pjesëmarrjen e fshatarësisë në punë, për të zbatuar kërkesat agroteknike dhe për të rritur shkallën e punës së mekanizuar.

Lidhur me investimet në lëmin e ndërtimeve, jam dakord me Spiron [Koleka] që kjo çështje të shikohet në bazë të mundësive tona financiare dhe ekonomike. Shtesa e fuqisë punëtore nuk është reale, prandaj kjo duhet të shikohet. Për uljen e çmimeve, kështu siç paraqitet gjendja, është e qartë se tani për tani ka vështirësi që kjo detyrë të realizohet por duhet parë për më vonë. Me sa duket, nuk janë marrë të gjitha masat e duhura për rritjen e rendimentit dhe uljen e kostos, në këtë çështje nuk ka kontroll dhe disiplinë. Si është e mundur që një drejtues ndërmarrjeje të lejojë që para syve të tij të ndodhin gjëra të papëlqyera? Kështu për shembull, ka punëtorë, të cilët, për të lyer një dhomë, duan 4 ditë, ose për të lyer një vazo duan 4 orë pune, lëre pastaj se ç'ndodh në ndërtimet e mëdha. Ne duhet të luftojmë për një ulje kostoje më të madhe dhe kjo ka mundësi të arrihet sepse janë të gjitha kushtet.

Me këtë rast dëshiroj të vë në dukje se ministritë nuk kanë konsideratën e duhur për organet lokale të pushtetit. Është fakt se organet e pushtetit në rreth nuk kanë asgjë në dorë për ndërmarrjet nacionale që veprojnë në territorin e tyre. Mirëpo ata mund të japin një ndihmë të madhe në forcimin e punës të këtyre ndërmarrjeve. Më duket se ju ministrat dhe aparatet

tuaja nuk u kushtoni rëndësinë e duhur këtyre çështjeve. Sikur të dëgjohet zëri i organeve lokale të pushtetit për ndërmarrjet nacionale mendoj se do të ketë përmirësime. Sot ndodh që planet dhe modelet komiteteve ekzekutive u dërgohen nga lart dhe, kur vjen fundi, u themi «blini ato që u japim ne». Prandaj mendoj që të shikohet mundësia për t'u dhënë disa kompetenca më shumë komiteteve ekzekutive të kp të rretheve, që ato të kenë të drejtë të kontrollojnë dhe të sjellin kërkesat dhe vërejtjet e tyre në dikastere edhe për ndërmarrjet nacionale.

Mendoj që t'i sugjerojmë qeverisë t'i ketë parasysh këto vërejtje dhe, përveç naftës, zërat e tjerë të prodhimit të mos ulen.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjende' në AQP*

## FRYMA E KURSIMIT DUHET TË ZOTËROJË KUDO

### *Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH*

17 nëntor 1959

Ky relacion<sup>1</sup> që na paraqitet nga Komisioni i Planit të Shtetit është i papranueshëm nga të gjithë ne. Nuk lejojmë që të krijohen deficite të tilla të mëdha. Komiteti Qendror dhe Byroja Politike kanë theksuar që importi të shkurtohet, kurse propozimet që paraqiten janë për ta rritur. Kjo është shkelje e direktivave që ka dhënë Komiteti Qendror dhe Byroja Politike. Prandaj fajtorët të përgjigjen. Byroja Politike dhe qeveria gjer tani nuk kanë marrë masa për njerëzit që kanë gabuar dhe na kanë krijuar situata të vështira, prandaj duhet të ndëshkohen rëndë ata që gabojnë deri në shkarkimin e ndonjërit prej tyre.

Mendoj se qeveria duhet të krijojë një fond rezervë të cilin ta përdorë për import kur paraqitet ndonjë

---

<sup>1</sup> Mbi bilancin e pagesave të tregtisë së jashtme për vitin 1959-1960 dhe mbi realizimin e pritshëm të konsumit të bukës.

nevojë e ngutshme. Kjo rezervë e qeverisë të dalë nga shkurtimi që i duhet bërë importit, pa ulur prodhimin.

Në kushtet që jemi, mund të pranohet që të importohet edhe drithë. Derisa të vijë drithërat e reja të manevrohet me rezervat që kemi. Por nga ana tjetër të merren masat e duhura për gabimet që janë bërë në konsumin e bukës. Ne duhet të synojmë që rezervat e fshatarësisë ose tepricat t'i jepen shtetit. Format dhe mënyrat se si të grumbullohen detyrimet dhe tepricat janë caktuar dhe duhet të zbatohen. Unë them se po të luftohet për të siguruar grumbullimin e tepricave dhe të importojmë një pjesë drithërash, krijohet rezerva e mundshme e shtetit për të përballuar gjendjen. Me 20 milion rubla që shkurtohen nga importi, ne i japim qeverisë një rezervë të mirë për të manevruar. Rezervat shtetërore për drithërat nuk duhet të preken pa aprovimin e Byrosë Politike. Ne nuk duhet të shesim miell në fshatrat ku s'ka nevojë.

Në konsumin e bukës duhet të zbatohen rregulla të caktuara dhe jo të realizohet xhiroja e të shitet pa mend buka e shtetit. Të mos krijohet psikoza sikur «nuk ka bukë». Komiteti i grumbullimeve nuk duhet të shesë sa të dojë drithë për të realizuar planin e arkës. Për të realizuar këtë plan të gjenden burime të tjera. Realizimi i planit të arkës duke shitur drithëra në vend që të shiten konfeksionet dhe mallrat e tjera, është i gabuar. Në rradhë të parë të ardhurat duhet të vijë nga mallrat industriale dhe pastaj nga drithërat. Nuk mund të lejohet shitja vend e pa vend e drithërave, prandaj kjo çështje duhet të kontrollohet mirë. Drithi të shitet atje ku është e domosdoshme. Bukë në fshat

të mos shitet. Mendoj se në situatën që jemi nuk mund të përhapim në të gjithë Shqipërinë 20 asortimente bukësh. Më duket se në këtë drejtim duhet të marrim masa më të shtrënguara.

Dikastereve të mos u jepen mallrat e importit pa realizuar detyrat që kanë për prodhimin e mallrave të eksportit. Në qoftë se duan devizë, t'u jepet aq për qind sa realizojnë edhe planin e prodhimit. Kjo duhet bërë jo vetëm për dikasteret, por për të gjithë, edhe për komitetet ekzekutive. Rretheve t'u themi, për shembull, në rast se nuk realizoni planin e vallanidhit, nuk do t'ju japim tubacione dhe hekur për bancsat, të cilat s'ka se si t'i importojmë.

Fryma e kursimit duhet të zotërojë kudo. Nuk ka rrugë tjetër zgjidhjeje përveç kursimit; të realizohen planet me luftë, të kontrollohet zbatimi i detyrave dhe të punohet me ndërgjegje.

Këto vërejtje që bën Byroja Politike duhet t'i mbajmë mirë parasysh. Të forcohet kontrolli shtetëror dhe të luftohet kundër familjaritetit. Këto janë vërejtjet paraprake që kishim për këtë çështje, kurse Komiteti Qendror do t'i bëjë diskutimet më të ashpra.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## **SHPËRBLIMET TË JEPEN NË RRUGË TË DREJTË**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**17 nëntor 1959**

Forcimi i ndërgjegjes socialiste kërkon përmirësimin e punës ideopolitike dhe edukative të Partisë, por edhe vendosjen e disa rregullave e të një discipline më të fortë në zbatimin e tyre. Këto çështje duhet të jenë nën kontrollin e Partisë dhe të klasës punëtore.

Unë kam qenë për zgjerimin e kompetencave, por këto nuk duhen shpërdoruar siç ndodh ndonjëherë me disa nga ministrat dhe drejtorët e ndërmarrjeve tona, të cilët disponojnë miliona. Mendoj se duhet të shikohet çështja që këtyre titullarëve të mos u lihen kaq shumë para në dispozicion. Këto të holla duhet të shkojnë nën kontrollin e Ministrisë së Financave dhe të bankës. Kush do t'i kapërcejë këto norma do të jetë fajtor. Ndaj atij që nuk kursen lekun e popullit të merren

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u diskutua rreth relacionit të paraqitur nga aparati i KQ të PPSH «Mbi disa shfaqje të huaja që prishin ndërgjegjen e njerëzve».

masa të rrepta. Në qoftë se te ne janë caktuar dispozita për shpërblimet, këto duhen dhënë në rrugë të drejtë dhe nën kontrollin e Partisë e të klasës punëtore. Klasa punëtore nuk pranon që normat të tejkalohen 200 deri në 300 për qind. Ne shikojmë këtu një numër njerëzish që abuzojnë duke marrë nga shoqëria më shumë dhe duke i dhënë asaj më pak. Këta elementë nuk mund t'i konfundojmë me klasën punëtore.

Mendoj se të gjitha shpërblimet që jepen sot duhet të shikohen një nga një nga ana e qeverisë dhe të shkurtohen. Paraja po prish ndërgegjen e njerëzve. Të korrigjohen ato dispozita ligjore që s'janë të drejta. Të shkurtohen shumat e lekëve që jepen për konkurset e ndryshme. Në qoftë se do të pycnim klasën punëtore për këto, do të shikoni se çfarë do të thotë ajo. Klasa punëtore nuk do të pranonte në asnjë mënyrë që disa njerëz të mbushnin xhepin me paratë e shtetit.

Të gjithë thanë se janë tronditur shumë kur panë në listë emrat e disa kuadrove që marrin kaq shumë lekë mbi rrogën e tyre. Kjo çështje nuk shtrohet për herë të parë, por si duket disa shokëve ua ka marrë mendjen leku. Për ata që gënjejnë duke njoftuar tejkalinimin e planit, kur ky akoma s'është arritur, duhen marrë masa që nga drejtori e gjer te ministri. Natyrisht, të gjithë njerëzit nuk do të pushohen nga puna, por t'u ndërrohet vendi, të hiqet ndonjëri nga zyra dhe të dërgohet të punojë me krahë.

Çështja e të hollave që marrin përkthyesit është skandaloze. Kjo gjendje duhet të marrë fund. Mendoj që përkthimet të përqëndrohen në një dorë, në një

qendër. Të mos lejojmë atë që ndodh sot, që i hipën njerit në kokë dhe jep për t'u përkthyer diçka, e cila mund t'i duhet vetëm atij. Në qoftë se ndonjërit i duhen disa faqe për të përkthyer, të gjejë vetë rrugët, të shkojë te një shok i tij e t'i kërkojë ndihmë, por jo ta bëjë këtë me lekët e shtetit. Kjo do të thotë të abuzosh me lekët e popullit.

Po kështu, ne s'kemi nevojë për poezitë që shkruhen për të marrë para. Në qoftë se dikush do të shkruajë poezi, ai duhet ta bëjë këtë sepse i këndon zemra dhe jo të lidhë vargje me lekë. Prandaj kundër këtyre shfaqjeve duhet luftuar me këmbëngulje dhe qeveria të jetë shumë rigoroze në kursimin e lekut.

Tani që do të shikohen të gjitha ligjet dhe urdhëresat që përcaktojnë dhënien e këtyre parave, disa njerëz mund të thonë se «na u mbyt inisiativa». Natyrisht, këtë nuk do ta thonë njerëzit e thjeshtë, por ndonjëri që është mësuar të mbushë grushtet me para.

Unë jam dakord me propozimin që bëhet për t'u dërguar të gjitha organizatave të Partisë një letër nga ana e Komitetit Qendror ku të përmenden edhe disa emra të atyre njerëzve, të cilët kanë marrë shumë para dhe duke përfituar nga dispozitat ligjore.

Të meta e dobësi nuk ka vetëm në dhënien e parave, por edhe në akordimin e dekoratave. Kur vjen puna e propozimeve për dekorata, i dërgohen Presidiumit të Kuvendit Popullor 150 dhe 160 emra njëherësh. Kjo ndodh sepse nuk ndiqen njerëzit në punë e sipër e të propozohen për t'u dekoruar pjesë-pjesë e secili në

kohën e vet. Gjithashtu, fondi i drejtorit duhet të përdoret për qëllimin që është caktuar dhe jo të shpërndahet pa kriter të drejtë. Shpërblimet të jepen vetëm atëherë kur plani realizohet si sasi, cilësi dhe asortiment, ndryshe s'ka pse të bëhen shpërblime.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## GAZETAT TONA TË MBËSHTETEN MË SHUMË NË KORRESPONDENTËT VULLNETARË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

19 nëntor 1959

Gazetat «Zëri i popullit» dhe «Bashkimi» ushqehen edhe nga Agjencia Telegrafike. «Zëri i popullit» nuk duhet të botojë përshkrime të thata mbi realizimet që arrihen në sektorë të ndryshëm, por të nxjerrë konkluzione të rëndësishme. Materialet që merr nga Agjencia Telegrafike duhet t'i përpunojë dhe të botojë shkrime që të shërbejnë si direktivë. Kjo nuk do të thotë që të mos dalin në shtyp lajme për fshatin, qendrën e punës apo shkollën.

Gazetat «Bashkimi» dhe «Zëri i popullit» duhet të mbështeten më shumë në korrespondentët vullnetarë dhe në bashkëpunëtorët e tyre. Këtë punë në fshat mund ta kryejnë edhe mësues, agronomë, mjekë, se-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen e gazetës «Bashkimi».

kretarë organizatash partie etj. Por e vërteta është se këta njerëz të Partisë dhe të pushtetit nuk tërhiqen si duhet për të shkruar në gazetë. Sado mirë që të shkruajnë korrespondentët funksionarë ata kurrë nuk mund ta kryejnë detyrën pa aktivizuar një rrjet të gjerë korrespondentësh nga baza. Prandaj të bëhen përpjekje për firmat e tyre në faqet e gazetave tona.

Shpesh shihet që gazeta «Bashkimi» boton shkrime stereotipe, duke thënë se më parë kemi qenë ashtu dhe tani u bëmë kështu. Kjo tregon se në shkrime nuk ngrihen si duhet problemet që preokupojnë Partinë dhe pushtetin. Pse të shkruajë, për shembull, gazetari për çështjen e normave që shkelen? Këtë mund ta shkruajë fare mirë një punëtor. Ato që botohen nëpër gazeta lidhur me rezultatet e arritura në fushën e prodhimit, janë vetëm informacione. Edhe këto lexohen por jo me interesimin e duhur, sepse janë gjithmonë njëlloj.

Çështja e honorareve duhet parë mirë. Nuk është mendimi i klasës punëtore dhe i popullit shqiptar «më jep para dhe të shkruaj». Duke vepruar kështu ne po i mësojmë keq njerëzit. Ata që shkruajnë dhe u del emri në gazetën «Zëri i popullit» ose në «Bashkimi» duhet ta kenë për nder dhe jo të shkruajnë për të marrë para. Në përcaktimin e honorareve ne jemi nisur nga fakti se shumë njerëz janë të zënë me punë dhe që të shkruajnë u duhet të sakrifikojnë ca nga koha e lirë që kanë, prandaj edhe paguhen, por më duket se e kemi tepruar ca.

Kryeartikujt që shkruhen nga kryeredaktorët, duket se kanë një stil dhe shumë fjalë shkojnë bosh. Titujt e tyre janë të mirë, kurse brendia e kryeartikujve

ka ujë dhe fraza stereotipe. Prandaj të përmirësohet cilësia e kryeartikujve të organeve tona.

Mendoj se gazeta «Bashkimi» duhet të shkruajë edhe për gjendjen ndërkombëtare, sepse atë e marrin njerëzit e Frontit, të cilët duan të dinë edhe për situatën e jashtme. Në qoftë se ka paralelizma midis «Zërit të Popullit» dhe «Bashkimit» këtë duhet ta rregullojnë midis tyre kryeredaktorët e dy gazetave, por jo të gjendet rruga e shkurtër duke i hequr gazetës «Bashkimi» të drejtën për të botuar shkrime mbi gjendjen ndërkombëtare.

Është e vërtetë që gazetat tona kanë ecur përpara, kanë arritur suksese, se tani ato dalin më mirë, niveli i kuadrove është i ngritur, megjithëkëtë kërkohet që puna e tyre të përmirësohet kurdoherë. Mundet që disa korrespondentë të kenë mbetur prapa, prandaj ata duhet të kualifikohen.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## KRYESORJA PËR BIBLIOTEKAT ËSHTË ÇËSHTJA E KUADRIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

19 nëntor 1959

Kryesorja për bibliotekat është çështja e kuadrit. Në këto institucione me rëndësi duhet të dërgohen njerëz me kulturë, që ta duan librin dhe të punojnë me të. Mund të caktohen edhe normativa që organika të rritet në proporcion me shtimin e numrit të librave, por një gjë e tillë nuk mund të bëhet sot, kur në këta kuadro që kemi, ka edhe njerëz të paaftë, të cilët nuk e kuptojnë rëndësinë dhe punën që duhet bërë me librin.

Në radhë të parë, çështjen e kuadrit, cilësinë dhe sasinë e tij, duhet ta shohim për Bibliotekën Kombëtare, ku ka libra me vlera të mëdha. Këtu duhet të dërgohen njerëz të mirë. Këta njerëz t'i edukojmë në mënyrë

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen e bibliotekave dhe masat për përmirësimin e tyre.



të tillë që, kur lexuesi të kërkojë një libër, ata jo vetëm ta gjejnë me shpejtësi, por edhe të shpjegojnë përmbajtjen e tij. Krahas rritjes së veprimtarisë së Bibliotekës Kombëtare të shikohet edhe çështja e shtesës së kuadrit, por kjo të mos jetë fikse.

Ka rëndësi që në biblioteka të merren masa për ruajtjen e librave me vlerë dhe për ata që nuk kanë kopje të dyta. Të vihet rregull që këta libra të mos i jepen kujtdo dhe të mos dalin jashtë bibliotekës. Për këtë qëllim të sillen aparate mikrofilmimi.

Nga të dhënat që kemi, rezulton se shokët e komiteteve të Partisë në rreth nuk interesohen si duhet për punën me librin, për frekuentimin dhe veprimtarinë e bibliotekave, por kujdesen vetëm për të kërkuar ndonjë fond që biblioteka «të jetë në ndërtesë të re». Është e domosdoshme që shokët e komitetit të Partisë të bashkëpunojnë me bibliotekat, të tërheqin në aktivitetin e tyre arsimtarë dhe njerëz të tjerë, të rritet numri i anëtarëve të tyre, të cilët, në orë të caktuara, të venë në bibliotekë për të studjuar. Nuk mund të thuhet se ne kemi shumë libra shkencorë, por kur shkon në bibliotekë, gjen mjaft libra të pahapur, pra që nuk i lexon njeri. Mirëpo ne kemi plot specialistë, numri i të cilëve rritet vazhdimisht. A nuk do të ishte një detyrë e madhe për ta që, krahas leximit të librit politik, të lexonin edhe librin teknik e shkencor?

Biblioteká Kombëtare të marrë të tëra masat teknike për t'i furnizuar të gjitha bibliotekat e rretheve. Në qoftë se kjo punë organizohet mirë, Partia interesohet si duhet për librin e arsimtarët japin më shumë kontribut në fushën e edukimit të punonjësve

me anë të librit, atëherë rezultatet do të jenë më të mëdha se deri tani. Njerëzit e shkencës dhe të kulturës që i kuptojnë këto çështje, me siguri nuk do të kursehen për të bërë punë shoqërore duke punuar edhe jashtë orarit. Për leximin e librit duhet të kontribuojnë më shumë intelektualët, njerëzit e kulturës dhe të shkencës.

Bibliotekave të institucioneve t'u lihet minimalja e librave, sepse mund të ketë prej tyre që nuk i shfrytëzojnë si duhet botimet, për të cilat kanë nevojë njerëzit e tjerë. E them këtë se ka punonjës që janë të pasionuar pas librit, të cilët, kur shikojnë katalogët, porositin lloj-lloj librash.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## POPULLI KA NEVOJË TË SHOHE MË SHUMË FILMA

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

19 nëntor 1959

Shokët e kinostudios mund të përgëzohen për punën e tyre të mirë në këtë sektor me rëndësi që u ka ngarkuar Partia. Gjatë këtyre vjetëve në përhapjen e rrjetit kinematografik ka pasur ndryshime. Me siguri përparimet në këtë fushë do të jenë akoma më të mëdha në të ardhshmen. Por lidhur me kërkesat që bëhen për mjete, të cilat ne e kuptojmë se janë të nevojshme, situata e tanishme nuk na lejon që t'i plotësojmë të gjitha. Megjithatë, kur të shqyrtohet plani i pesëvjeçarit të tretë, Byroja Politike do të ketë parasysh që në sektorin e kulturës, kinematografisë t'i jepet më tepër precedencë, sepse ajo shërben për edukimin e punonjësve tanë, sepse populli ka nevojë për më shumë filma. Unë them se nuk ka asnjë nga shokët e Komitetit

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth disa çështje të kinematografisë.

Qendror që të mos e kuptojë nevojën e zgjerimit të kinematografisë në vendin tonë, natyrisht kjo do të bëhet brenda mundësive që kemi.

Faktet tregojnë se dikasteret e tjera kanë rënë në gabime duke bërë kërkesa të fryra ose duke importuar materiale që nuk duhen, të cilat i kanë justifikuar se «janë të nevojshme, sepse pa to nuk mund të realizohet prodhimi» etj. Gjer tani për këto çështje nuk janë marrë masat e duhura, por në të ardhshmen nuk do të lejohet që disa drejtues të mos interesohen si duhet për punën e shtetit, për të kursyer, për të ecur me kujdes në porositë që bëhen, në planet që hartohen, sidomos për importin.

Lidhur me kërkesat që bëhen për vitin 1960, disa prej tyre janë të drejta dhe duhet t'i sigurojmë. Nga kuota që ka Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, të shikohet se ç'mund të hiqen dhe, në vend të tyre, të bëhen porosi për të plotësuar disa nevoja të kinostudios. Është e drejtë vërejtja që bëhet, sipas së cilës më mirë të zvogëlohet numri i radiove nga importi dhe, në vend të tyre, të sillen më shumë aparate kinematografike.

Shfaqja e filmave në sa më shumë fshatra është një sukses i madh për ne. Kjo punë, natyrisht ka vështirësitë e veta, sepse lidhet me elektrifikimin e fshatit. Tani për tani lëvizja e aparateve të kinemasë bëhet me kuaj. Por kjo çështje që duket kaq e lehtë në teori, është e vështirë në praktikë, mbasi nuk mund të përballohet me kuaj dërgimi i filmit në çdo fshat. Prandaj të bëjmë sa të jetë e mundur më shumë në këtë drejtim, sepse në të ardhshmen, kur të kemi më tepër aparate kinematografie, më shumë rrugë komunikacioni në fshat

dhe fshatra të elektrifikuara, edhe filmi do të jetë më masiv.

Mundësitë janë më të mëdha për fshatrat që janë afër qytetit. Për këto fshatra, Partia duhet të organizojë punën që një herë në javë ose në muaj, një pjesë e fshatarëve të venë për të parë filma në qytete. Kjo është e realizueshme, sepse derisa fshatari vjen në qytet ditën e pazarit, pse të mos shkojë edhe në kinema? Mundet që, në ditën e pazarit, filmat për qytetarët, të shfaqen në seancat e mëvonshme, me qëllim që fshatarët të shohin filma para se të kthehen në fshat. Ja, kjo mendoj se ka mundësi të koordinohet.

Për kinematë stabël që disponojnë bashkimet profesionale në klubet e tyre, të organizohet puna në mënyrë të tillë që sallat të mos mbeten bosh. Bile, në ditë të caktuara që bashkimet profesionale nuk i zënë me mbledhje këto salla, të shfaqen filma për fshatrat që janë rreth. Në kushtet e sotme ne s'kemi pse t'ia kalojmë kinostudios për administrim aparatet që kanë sot bashkimet profesionale për klubet e tyre. Për shembull, pse t'ia japësh shtetit aparatet e kinemasë dhe klubin e bashkimeve profesionale të kombinatit të tekstileve «Stalin», kur klasa punëtore e përdor për nevojat e veta në qendrën e punës së saj? Me aparatet lëvizëse të kinemasë, për të cilat nuk ka salla, në këto raste të organizohet puna që 2-3 herë në javë të jepen shfaqje filmash për punëtorët dhe 2-3 ditët e tjera të javës të dërgohen për të dhënë shfaqje në fshat. Këtë punë duhet ta udhëheqë Partia sipas një plani të koordinuar. Jo të ndodhë që, për shkak të punës së dobët organizuese në fshat, aparatet e kinemasë

që dërgohen atje, të mos shfrytëzohen si duhet. Po kështu edhe ushtria, me aparatet lëvizëse që ka, brenda mundësive, të organizojë punën për të dhënë shfaqje filmash në fshatra. Kështu, populli do të shohë më shumë filma.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **NGA FJALA NË MBLEDHJEN SOLEMNE ME RASTIN E 15-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË SHQIPËRISË**

**28 Nëntor 1959**

Të dashur shokë e shoqe, motra e vëllezër,

Sot, gjithë populli shqiptar, me një entuziazëm të papërshkruar dhe në një unitet të plotë e të çelniktë rreth Partisë, kremton dy festa të mëdha, 28 dhe 29 Nëntorin. Më 28 Nëntor 1912, 47 vjet më parë, populli ynë pas shumë shekujsh lufte e përpjekjesh të lavdishme fitoi pavarësinë e tij kombëtare. Por megjithëkëtë, edhe pas vitit 1912, i sunduar nga regjimet antipopullore të bejlerëve dhe të borgjezisë reaksionare, populli ynë nuk gëzoi lirinë e vërtetë. Vetëm me Çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë, më 29 Nëntor 1944, 15-vjetorin e të cilit po festojmë sot me madhështi, populli shqiptar fitoi një herë e përgjithmonë lirinë e vërtetë, pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar. Më lejoni që në emër të Komitetit Qendror të PPSH, të Qeverisë së Republikës dhe të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të përshëndes me këtë rast gjithë popullin tonë heroik, klasën punëtore, fshatarësinë punonjëse, intelektualët, rininë dhe gratë e vendit tonë, të përshëndes ish-partizanët dhe partizanet e lavdishme të Ushtrisë sonë

Nacionalçlirimtare, të përshëndes Ushtrinë e lavdishme Popullore të Shqipërisë, punonjësit e armës së lavdishme të sigurimit dhe rojet heroike të kufirit. Gëzuar, shokë e shoqe, festën e Çlirimit, festën e jetës së re!

Çlirimi i Shqipërisë nga zgjedha fashiste shënon ngjarjen më të rëndësishme në historinë tonë kombëtare. Populli ynë, për të parën herë në historinë e tij shumëshekullore, jo vetëm fitoi një herë e përgjithnjë lirinë e pavarësinë e vërtetë kombëtare, por mori plotësisht në duart e veta drejtimin e vendit, u bë zot i fateve të tij, filloi ndërtimin e jetës së re, të socializmit.

Në këta 15 vjet, nën udhëheqjen e urtë dhe largpamëse të Partisë heroike të Punës, populli ynë tregoi talentin, forcën, vullnetin, vendosmërinë dhe aftësitë e tija të pashteruara, entuziazmin e pafund në ndërtimin e Shqipërisë së re; tregoi në fushën e punës paqësore të njëjtat cilësi të rralla që u shfaqën me forcë të papërshkruar gjatë Luftës fitimtare Nacionalçlirimtare.

Shqipërisë, atdheut tonë të dashur, i është ndryshuar pamja plotësisht. Dikur, vendi ynë konsiderohej si më i prapambeturi në Evropë, me fatet e të cilit luanin, si u donte qejfi, fuqitë e ndryshme imperialiste. Sot Shqipëria është një vend i lirë e sovran, me një regjim politik nga më të përparuarit, pjesëtare e denjë e kampit socialist. Me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste, populli punonjës brenda një kohe shumë të shkurtër e ktheu atdheun tonë në një vend agraro-industrial të përparuar. Këtë e dëshmojnë ndërtimet tona të mëdha, fabrikat dhe uzinat, hidrocentralet dhe kombinatet, veprat e bonifikimit



dhe makinat e shumta bujqësore, rrjeti i gjerë i shkollave dhe i qendrave të tjera kulture, njerëzit tanë të rinj, punëtorët e pararojës, fshatarët kooperativistë, intelektualët e dalë nga gjiri i popullit punonjës.

Shqipëria është shembull tipik i forcës së madhe transformuese të ideve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit, i vitalitetit të padiskutueshëm të sistemit socialist. Nën flamurin e Partisë, nën flamurin kurdoherë ngadhënjimtar të marksizëm-leninizmit, populli shqiptar, gjatë këtyre 15 vjetëve të pushtetit popullor, ka realizuar suksese e fitore të atilla të mëdha, të cilat provojnë plotësisht epërsinë absolute të sistemit tonë socialist mbi sistemin kapitalist.



Duke festuar 15-vjetorin e Çlirimit të atdheut dhe të vendosjes së pushtetit popullor populli ynë kujton Luftën e tij heroike Nacionalçlirimtare, vuajtjet dhe sakrificat e panumërta, kujton betejat e lavdishme të partizaneve dhe partizanëve trima, në saje të të cilëve u shkrua me gjak faqja më e lavdishme e gjithë historisë së popullit tonë. Lufta Nacionalçlirimtare, e cila u organizua dhe u udhëhoq me trimëri e zotësi nga Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës) ishte një luftë e gjerë popullore. Klasa jonë punëtore, fshatarësia punonjëse revolucionare dhe gjithë patriotët e ndershëm të vendit, nuk mund të duronin sundimin e huaj, çizmen e fashizmit italian e gjerman, si dhe shtypjen e tradhtinë e feudoborgjezisë së vendit. Pran-

daj ata me patriotizëm të flaktë e të kulluar iu përgjigjën thirrjes së Partisë për luftë kundër pushtuesit fashist dhe tradhtarëve të vendit.

Nën udhëheqjen e Partisë marksiste-leniniste të komunistëve shqiptarë, u krijua Fronti Nacionalçlirimtar, bashkimi i çelniktë i popullit, ushtria politike e revolucionit tonë popullor; u krijua forca e armatosur e këtij revolucioni, Ushtria heroike Nacionalçlirimtare, e cila e filloi veprimtarinë e saj luftarake me njësite të vogla e çeta dhe e përfundoi me divizione e korparmata, në radhët e të cilave numëroheshin në ditët e paraçlirimt rreth 70 000 partizanë e partizane.

Populli ynë dhe partizanët e tij trima, me komunistët në krye, gjatë vjetëve të luftës, në të katër anët e vendit, në qytete e fshatra, në Jug e në Veri, në Kurvelesh e në Skrapar, në Mallakastër e në Pezë, në Martanesh e në malësitë e Korçës, në Gjirokastrë e në Dibër, në Shkodër e në Vlorë, në Tiranën heroike dhe në malësitë e Kukësit e të Tropojës, luftuan me një heroizëm të rrallë, mbrojtën me gjak nderin dhe atdheun e tyre, hapën rrugën e lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit kombëtar, rrugën për një të ardhshme më të mirë.

Për Shqipërinë e re të popullit, për gjithçka që ne gëzojmë sot në atdheun tonë të lirë, për të nesërmen tonë, që do të jetë akoma më e mirë dhe më e begatshme, populli ynë, vëllezërit dhe motrat partizane, të mbujtura me mësimet e Partisë sonë të lavdishme, kapërcyen vuajtjet dhe vështirësitë, u bënë ballë me trimëri dhe heroizëm armiqve fashistë italianë e gjermanë dhe tradhtarëve të vendit, duke mos kursyer as

gjënë më të shtrenjtë, as jetën e tyre. Në këtë ditë të festës sonë të madhe, të dashur shokë e shoqe, le të nderojmë, duke u ngritur në këmbë, kujtimin e përjetshëm të bijve dhe bijave të paharruara të popullit tonë, të dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare, që ranë si heronj për çlirimin e Shqipërisë!

Formimi i Partisë është fitorja më e shkëlqyer e popullit shqiptar. Partisë sonë iu desh të luftonte në situata shumë të koklavitura, të brendshme dhe të jashtme, të cilat u përgjigjeshin kushteve konkrete të gjendjes dhe zhvillimit të vendit tonë, iu desh të luftonte në mënyrë frontale kundër rreziqeve shumë të mëdha që u kanoseshin atdheut, popullit dhe Partisë sonë. Vetëm një parti e tipit leninist mund të dilte triumfuese nga këto situata dhe një parti e tillë ishte Partia jonë Komuniste Shqiptare, prandaj ajo triumfoi.

Borgjezia dhe feudalët e vendit, që në fillim i quajtën komunistët kalamanë dhe luftën tonë çlirimtare, aventurë. Zotërinjtë borgjezë dhe feudalë harruan se mund të jesh i ri, por të veprosh si i pjekur dhe të mos bësh aventura, ashtu sikundër mund të jesh i shkuar nga mosha dhe të tregohesh axhami e aventurier.

Partia jonë ishte shumë e re, por megjithatë ajo s'bëri kurrë aventura. Mund të pyesë ndokush: Si ndodhi që, në rrethanë aq të koklavitura dhe aq të rënda, në të cilat gjendej atdheu ynë, të tregohesh një pjekuri kaq e madhe në politikë e në luftë nga një parti aq e re, e porsalindur, nga një parti që ishte pararojë e një klase punëtore aq të vogël dhe jo të regjur sa duhej në luftëra, greva e përpjekje të përgjakshme kundër kapitalistëve, siç janë shumë parti të tjera

komuniste e punëtore? Përgjegjja është e thjeshtë: Partia jonë e re përfaqësonte hovin vigan revolucionar të popullit tonë të lashtë e trim, me tradita të shkëlqyera luftarake; vija dhe programi i saj shprehnin dëshirat dhe aspiratat e popullit, ideologjia që i ndriste rrugën Partisë sonë për realizimin e qëllimeve të popullit nuk ishte e re, por e pjekur nga mosha dhe triumfuese në beteja. Kjo ideologji ishte marksizëm-leninizmi fitimtar.

Pjekuria e Partisë sonë të re qëndron në faktin që ajo diti, nën dritën e shkëlqyer të ideologjisë së saj, marksizëm-leninizmit, të çante errësirën, të analizonte drejt raportet e forcave në përlëshje, të organizonte dhe të çimentonte me durim e pjekuri aleancat e brendshme dhe të jashtme, të organizonte dhe të harmonizonte veprimet politike dhe luftarake në çdo etapë dhe rrethanë, të zbatonte një vijë politike revolucionare luftarake, taktike e strategjike për çdo etapë, lidhur ngushtë me ngjarjet në vend dhe jashtë. Çdo gabim, çdo lëshim, do të sillte katastrofën për popullin dhe atdheun tonë. Siç dihet, mbi supet e Partisë sonë të re qëndronte një barrë kolosale. Supet ishin të reja, por të çelnikta dhe barra e rëndë s'e përkuli kurrë Partinë tonë. Përgjegjësitë ishin shumë të rënda, por Partia jonë i mori këto mbi vete dhe kreu me nder detyrat e mëdha historike që i kishte besuar populli i vet. «Kalamane» nuk u qorollisën kurrë, por u treguan të pjekur dhe i sollën popullit fitoren. Kurse «të pjekurit» e borgjezisë dhe feudalët treguan fytyrën e tyre të vërtetë prej aventurierësh dhe tradhtarësh.

Pra, vendimtarja mbi vendimtarët ishte formimi i Partisë dhe qëndrimi i saj i vendosur e i palëkundur

në pozitaf e marksizëm-leninizmit. Vetëm me këto kush-  
te çdo gjë do të zgjidhej drejt, pa këto na prisnin disfata.  
Këto kushte nuk mund të krijoheshin as me urdhëra dhe  
aq më pak me dekrete. Ato u krijuan në luftën e ashpër  
dhe pa kompromis që bëri Partia jonë kundër pushtu-  
esve, kundër tradhtarëve të vendit, kundër tradhtarëve  
të Partisë, brenda e jashtë radhëve të saja. Partia jonë  
nuk lindi në shilte me pupla, ajo nuk u suall në kuvli  
nga jashtë, ajo nuk u formua pse u hipi qejfi një  
mëngjes revizionistëve të Beogradit, por ajo u formua  
dhe u themelua nga klasa heroike punëtore shqiptare,  
nga marksistët shqiptarë, një pjesë e të cilëve në më-  
nyrë legjendare ranë heroikisht në rrugët e qyteteve  
e në male për triumfin e çështjes së madhe të Partisë  
dhe të popullit tonë. Tradhtarët fashistë të popullit  
shqiptar dhe aleatët e tyre, revizionistët jugosllavë, në  
një kor të vetëm, lehin se gjoja Partinë tonë e kanë  
formuar të huajt. Partia jonë është pjellë e popullit  
tonë heroik, i cili në kushtet objektive të vendit e kri-  
joi atë si kusht të domosdoshëm për shpëtimin e tij  
përgjithmonë nga robëria shekullore e të huajve dhe  
e feudoborgjezisë vendëse.

Qëndresa shembullore e Partisë sonë në pozitaf  
e marksizëm-leninizmit u arrit me luftëra të ashpra  
kundër trockistëve, fraksionistëve, deviatorëve, oportu-  
nistëve, revizionistëve, aventurierëve, spiunëve të  
fshehtë të italo-gjermanëve, të anglo-amerikanëve dhe  
të trockistëve jugosllavë, kundër vetë revizionistëve  
renegatë jugosllavë, rrezikut të tmerrshëm kryesor që  
iu turr me tërbim Partisë dhe popullit tonë dhe gjithë  
lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Si vigan, në zjarr e në flakë, në përlëshje të përgjakshme me pushtuesit dhe kuislingët, e pamëshirshme kundër tradhtarëve të saj me shpatë në dorë, me zemër të çelniktë, me mendje të kthjellët, Partia e komunistëve shqiptarë çau rrugën e fitores së madhe të popullit. Në revolucionin e pandalshëm popullor, Partia jonë diti të zbatojë me pjekuri ligjet e revolucionit proletar, të cilin e udhëhoqi në fitoren e plotë Partia e lavdishme e bolshevikëve dhe gjeniali Lenin.

Partia jonë e vlerësoi shumë drejt rolin që do të luante në revolucionin popullor fshatarësia jonë revolucionare, si aleate shumë e fuqishme, në cilësi e në sasi, e klasës sonë heroike punëtore, të vogël. Luftën do ta fitonte, në kushtet e vendit tonë, ajo klasë që do të kishte fshatarësinë me vete. Dhe luftën e fitoi klasa punëtore, sepse ajo e bëri fshatarësinë aleatën e saj besnike. Borgjezia reaksionare dhe feudalët, me gjithë përpjekjet e tyre, me gjithë ndihmën e armëve të pushtuesve dhe përkrahjen e anglo-amerikanëve, nuk u treguan të zot dhe Partia nuk i lejoi që ta bënin fshatarësinë aleatën e tyre.

Aftësia e Partisë sonë qëndron në faktin historik se masën dërmuese të popullit shqiptar, fshatarësinë, jo vetëm e shpëtoi nga influenza e feudoborgjezisë dhe e pengoi këtë që ta bënte fshatarësinë qoftë edhe për një çast rezervën e saj, por e bëri këtë të kuptojë, që në fillim, se çlirimi politik dhe ekonomik i saj dhe i vendit do të arrihej vetëm duke luftuar nën flamurin e Partisë sonë marksiste-leniniste, nën flamurin e klasës punëtore dhe vetëm në aleancë të ngushtë dhe nën udhëheqjen e klasës punëtore.

Me një përbërje të madhe fshatarësh, Partia jonë si parti e vërtetë e tipit leninist, diti që në kudhrën e saj të kalitë komunistët me prejardhje fshatare, nga shtresat e borgjezisë së vogël të qyteteve dhe intelektualët dhe t'i bëjë ata luftëtarë të vendosur deri në fund për çështjen e proletariatit, për çështjen e mbarë popullit tonë. Kjo meritë e madhe historike i përket klasës sonë punëtore dhe ideologjisë së saj, leninizmit. Këtu e ka burimin fakti i rëndësishëm që në vijën e Partisë sonë, në vijën e Luftës sonë Nacionalçlirimtare, në rrugën e ndërtimit të socializmit, nuk u vërtetua kurrë asnjë gabim parimor, asnjë lëkundje, asnjë shmangie, qoftë nga e djathta ose nga e majta. Edhe për këtë, merita i takon klasës sonë heroike punëtore dhe leninizmit që e frymëzon atë.

Pushtuesit dhe kuislingët, as me luftë as me terror as me dredhi, nuk mundën ta shkatërronin Partinë, nuk mundën ta shuanin zjarrin e madh të Luftës Nacionalçlirimtare. As me krijimin e «Ballit Kombëtar», as të «Legalitetit» dhe as të organizatave të tjera tradhtarë, pushtuesit dhe aleatët e tyre, tradhtarët shqiptarë, nuk mundën ta izolonin dot Partinë. Përkundrazi ishte Partia ajo që i goditi pa mëshirë dhe i izoloi ata krejtësisht.

Reaksioni anglo-amerikan, me përkrahjen e fashizmit gjerman, u përpoq me të gjitha mjetet të nxirrte nga balta organizatat e tradhtarëve shqiptarë, t'ia kundërvinte këto Partisë dhe ta detyronte kësisoj atë të ndante pushtetin me këta vrasës dhe tradhtarë të popullit. Por Partisë sonë s'ia hante dot qeni shkopin. Anglezi me gjermanin një herë e copëtuan Shqipërinë në Kongresin e Berlinit, një herë u kurdis Traktati i

fshehtë i Londrës. Kohët kishin ndryshuar, kurse qëllimet e imperialistëve kishin mbetur të njëjta, por tashmë e kishte marrë ferra uratën. Grushti i Partisë ra i tmerrshëm mbi Mukjen. Kështu pjella e anglezëve, e gjermanëve, e kuislingëve dhe e oportunistëve dështoi që në embrion, ashtu siç kishin dështuar edhe më parë orvatjet e anglezëve dhe të agjentëve të tyre në Shqipëri për të krijuar një qeveri të ashtuquajtur shqiptare në emigracion, me kuislingun Mehdi Frashëri në krye, ashtu siç dështoi zbarkimi anglez në bregdetin tonë, ashtu siç dështuan edhe më vonë, pas Çlirimit, orvatjet e shumta të anglo-amerikanëve dhe të titistëve që synonin zhdukjen e Partisë, të shtetit dhe të të gjitha fitoreve të popullit tonë.

Si rezultat i Çlirimit të vendit, në Shqipëri u vendos pushteti popullor, në formën e regjimit të demokracisë popullore. Është një meritë e madhe e Partisë së Punës të Shqipërisë fakti që ajo vazhdimisht e ka lidhur ngushtë çështjen e Luftës Nacionalçlirimtare, çështjen e çlirimit të vendit, me çështjen e marrjes së pushtetit në duart e popullit. Vija e drejtë e Partisë sonë, politika e saj e përgjithshme, e cila kishte përkrahjen e njëzëshme të të gjithë popullit shqiptar, sepse ajo shprehte plotësisht aspiratat e tija, triumfoi mbi pushtuesit fashistë dhe bashkëpunëtorët e tyre, tradhtarët e vendit tonë.

Çlirimi nga sundimi fashist dhe vendosja e regjimit të demokracisë popullore janë të lidhura ngushtë edhe me luftën legjendare të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, me fitoren e saj historike mbi fashizmin, me miqësinë e madhe që lidh popullin tonë me popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik.



Të dashur shokë dhe shoqe,

15 vjetët që kanë kaluar, që nga Çlirimi i vendit, 15 vjet në pushtetin popullor, janë vjetët e fitoreve të shumta, të njëpasnjëshme, janë vjetët e transformimeve rrënjësore në të gjitha fushat e jetës, në ekonomi e në kulturë, në jetën materiale dhe në ndërgjegjen e njerëzve. Gjatë këtyre 15 vjetëve Republika jonë Popullore ka arritur suksese të mëdha, të cilat nuk i ka njohur ndonjëherë Shqipëria, gjatë gjithë historisë së ekzistencës së saj. Këto suksese dëshmojnë për drejtësinë e vijës së përgjithshme të ndjekur nga Partia e Punës e Shqipërisë, gjatë gjithë kësaj periudhe të rëndësishme historike, për zbatimin krijues të marksizëm-leninizmit, në kushtet konkrete të vendit tonë.

Gjatë këtyre 15 vjetëve, me punën e tij të palodhur, populli ynë ka krijuar dhe po zhvillon dita-ditës industrinë e tij të re socialiste, të pajisur me teknika moderne, e cila jep tashti gati gjysmën e prodhimit të përgjithshëm industrial e bujqësor dhe rreth 40 për qind të të ardhurave kombëtare.

Zhvillimi i ekonomisë së vendit në përgjithësi, e në radhë të parë industrializimi i tij, dallohet nga ritme të larta të papara në historinë e vendit tonë. Në fund të këtij viti prodhimi industrial sipas realizimit të pritshëm, do të jetë 22 herë më i madh se në vitin 1938. Në nivelin e tanishëm, brenda 16 ditëve, industria jonë nxjerr aq prodhime industriale sa prodhoheshin gjatë gjithë vitit 1938. Tani ne prodhojmë më shumë se në vitin 1938: energji elektrike 18,1 herë, naftë brut 4,6

herë, bitum natyral dhe naftë 2,3 herë, qymyrguri 77,3 herë, mineral kromi 36,5 herë, lëndë druri të sharruar 7,9 herë, çimento 8,4 herë, pëlhurë të pambukta 66,3 herë, këpucë 3,7 herë etj. etj.

Gjatë 15 vjetëve të pushtetit popullor janë krijuar një sërë degësh të reja të industrisë, si industria energjitike, e përpunimit të naftës, e përpunimit të metaleve, e punimit të drurit dhe industria ushqimore. Janë ndërtuar një numër i konsiderueshëm ndërmarrjesh të mëdha industriale, të pajisura me teknikë të përparuar moderne, janë zgjeruar degët e tjera të industrisë, në saje të ngritjes së ndërmarrjeve të reja, si për nxjerrjen e naftës, të qymyrgurit, të mineralit të bakrit, të hekur-nikelit, të kromit etj.

Për industrializimin socialist të vendit, vetëm gjatë vjetëve 1951 deri më 1958, janë investuar, me çmimet e vitit 1958, 22 miliard e 465 milion lekë, ose 46 përqind e të gjitha investimeve kapitale në ekonominë popullore. Për industrializimin socialist të vendit tonë na kanë ndihmuar Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera të kampit socialist. Ne ndërtuam dhe vumë në shfrytëzim: kombinatin e tekstileve «Stalin», hidrocentralet «V.I.Lenin» dhe «Karl Marks», rafinerinë e naftës në Cërrik, uzinën e çimentos «V.I.Lenin», kombinatin e drurit «Nako Spiru», fabrikën e sheqerit «8 Nëntori» në Maliq, fabrikat e zhveshjes së pambukut, të orizit, fabrikat e ekstrakt-taninit, të fermentimit të duhanit dhe një numër veprash të tjera të mëdha industriale, që janë krenaria e industrisë sonë.

Industria jonë tani plotëson tërësisht ose pjesërisht nevojat për një numër të konsiderueshëm pro-

dhimesh industriale që më përpara importoheshin. Vetëm gjatë vjetëve 1955 deri më 1958 janë prodhuar mbi 500 artikuj të rinj, duke lehtësuar shumë në këtë mënyrë furnizimin e popullit me artikuj të tillë dhe ekonominë popullore me materiale, pajisje dhe vegla pune të nevojshme.

Zhvillimi i industrisë sonë të re me ritme të shpejta tregon kújdesin e madh e të vazhdueshëm të Partisë dhe të pushtetit tonë popullor, politikën e drejtë të ndjekur nga Partia jonë për industrializimin socialist të vendit, si një ligj i përgjithshëm i ndërtimit të socializmit dhe një kusht i domosdoshëm për forcimin e të gjithë ekonomisë popullore e për ngritjen e nivelit material dhe kultural të popullit.

Prodhimi industrial gjatë vjetëve të pesëvjeçarit të parë është zhvilluar me një ritëm mesatar vjetor prej 22,5 për qind, ndërsa gjatë këtyre vjetëve të pesëvjeçarit të dytë rritja mesatare vjetore e prodhimit industrial është e barabartë me 16,7 për qind. Këto janë ritme shumë të larta zhvillimi. Zhvillimi i prodhimit industrial me ritme të tilla të mëdha shënon një sukses shumë të madh, tregon forcën e ekonomisë sonë popullore, lulëzimin e saj.

Të tilla ritme zhvillimi të prodhimit industrial nuk njeh absolutisht asnjë vend kapitalist. Përsa u përket ritmeve të zhvillimit të industrisë, Republika jonë Popullore ka lënë prapa shumë vende të tjera. Kështu p.sh. ndërsa në vitin 1958 kundrejt vitit 1950 prodhimi industrial në vendin tonë ishte 4,5 herë më i lartë, në Greqi ai është rritur vetëm 106 për qind, në Jugosllavi 101 për qind dhe në Itali 83 për qind. Siç shihet,

pra, në zhvillimin e industrisë ne kemi ecur dhe vazhdojmë të ecim me hapa të shpejtë përpara. Kjo ka bërë të mundur që Republika Popullore e Shqipërisë, brenda një periudhe historikisht të shkurtër, të pakësojë shumë distancën në lëmin e prodhimit industrial me vendet e tjera dhe sidomos me fqinjët e saj dhe, për disa produkte të caktuara, t'i arrijë dhe t'i tejkalojë ato në prodhimin për frymë të popullsisë.

Këtë vit ne prodhojmë për çdo frymë 109 kilovat-orë energji elektrike, duke e kaluar Turqinë qysh në vitin 1957 në masën 6 për qind; naftë brut — 322 kg, duke lënë mjaft prapa Italinë, Turqinë dhe Jugosllavinë; qymyrguri — 183 kg, duke lënë prapa Greqinë dhe Italinë; mineral kromi — 164 kg, duke ia kaluar qysh në vitin 1956 rreth 3 herë Turqisë dhe rreth 14 herë Jugosllavisë; tekstile të pambukta — 14,8 ml, duke kaluar Turqinë dhe Greqinë.

Rritja me ritme të tilla e prodhimit industrial është siguruar kryesisht mbi bazën e rritjes së vazhdueshme të rendimentit në punë që është ligj për shoqërinë socialiste. Duke pasur gjithmonë parasysh mësimet e V.I.Leninit, i cili thoshte se rritja e

*«Rendimentit të punës është, në fund të fundit, gjëja më e rëndësishme, gjëja kryesore për fitoren e rendit të ri shoqëror»<sup>1</sup>,*

Partia ka marrë masa që të sigurohen të gjithë faktorët dhe të hapen të gjitha rrugët që çojnë në rritjen

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 29, f. 474.

e vazhdueshme të rendimentit të punës. Në vitin 1959 rendimenti i punës për prodhimin industrial rritet 84 për qind, në krahasim me vitin 1950. Rritja në këtë masë e rendimentit të punës është ndër faktorët kryesorë që ka siguruar rritjen me ritme të shpejta të prodhimit industrial në vendin tonë. Partia edhe në të ardhshmen do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë rritjes së vazhdueshme të rendimentit të punës.

Industrializimi socialist ka sjellë me vete rritjen dhe forcimin e vazhdueshëm të klasës sonë punëtore, rritjen e kualifikimit të saj. Tani rreth 75 për qind e të gjithë punëtorëve, vetëm në ndërmarrjet e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave janë punëtorë të kualifikuar. Në këto tani në këto ndërmarrje 6,8 herë teknikë të mesëm më shumë se në vitin 1950 dhe 16 herë më shumë teknikë të lartë. Gjatë vjetëve të planit të parë pesëvjeçar dhe të vjetëve të planit të dytë pesëvjeçar janë përgatitur vetëm për nevojat e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave mbi 22 000 punëtorë të rinj të kualifikuar dhe janë ngritur në kualifikim edhe mbi 21 000 kuadro të tjerë ekzistues. Punëtorët tanë janë bërë zotër të përdorimit të teknikës dhe të makinave të reja të komplikuar, me të cilat është pajisur dhe po pajiset vazhdimisht ekonomia jonë popullore. Duart dhe mendja e punëtorëve tanë përdorin dhe drejtojnë fabrika, uzina dhe kombinatë të pajisura me teknikën moderne, ata kanë ndërtuar hidrocentrale dhe vepra të tjera teknike të komplikuar.

Të gjitha këto tregojnë se në gjirin e klasës punëtore, në gjirin e popullit tonë, ka energji të pashtershme për të ecur përpara, për të rritur dhe përvetësuar

gjithnjë e më mirë mjeshtërinë e tyre, për t'u bërë ndërtues sa më aktivë të socializmit në vendin tonë.

Sukseset e mëdha të arritura në lëmin e zhvillimit të prodhimit industrial janë rezultat i zhvillimit të pandërprerë të industrializimit të vendit tonë dhe i mobilizimit të klasës sonë punëtore. Por megjithatë para punonjësve tanë dalin shumë detyra, zbatimi i të cilave do të influencojë shumë për shtimin e mëtejshëm të prodhimit. Ne duhet të shkojmë me hapa më të shpejtë përpara, me qëllim që të ecim krahas vendeve më të përparuara socialiste.

Në radhë të parë një kujdes i veçantë i duhet kushtuar mekanizimit, elektrifikimit të proceseve të ndryshme të prodhimit si dhe perfeksionimit të tyre për shkurtimin e kohës së prodhimit për njësi, për rritjen e rendimentit të punës. Kjo do të bëjë që të ulët vazhdimisht kostoja. Për këtë klasa jonë heroike punëtore duhet të punojë intensivisht për të arritur shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve prodhuese, të shfrytëzojë mirë kohën e punës, të zhdukë avaritë dhe ndërprerjet në punë, të organizojë furnizimin material, me një fjalë të bëjë të gjitha ato që duhen dhe që kërkojnë rritja e pandërprerë e prodhimit, përmirësimi i vazhdueshëm i treguesve ekonomikë.

Një kujdes i madh duhet treguar edhe për cilësinë e prodhimeve. I duhet dhënë fund prodhimit sa për të prodhuar, me qëllim që të realizohet vëllimi global. Populli kërkon nga punëtorët e prodhimit industrial prodhime me cilësi të mirë, me kosto të ulët dhe me asortimente të shumta.

Gjatë 15 vjetëve të pushtetit popullor një revolu-

cion i vërtetë është bërë në fshatin tonë. Fshatarësia jonë punonjëse, pasi u çlirua nga zgjedha e bejlerëve dhe e agallarëve, filloi të marrë frymë lirisht. Ajo, duke pasur ndihmën e madhe të shtetit, iu vu me të gjitha forcat zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella dhe shtimit të prodhimeve bujqësore. Por me ekonominë e vogël individuale nuk mund të dilej nga prapambetja shekullore dhe as të përfitohej në masën e duhur nga ndihmat e shtetit. Prandaj fshatarësia jonë patriote, duke ndjekur mësimet dhe këshillat e Partisë, hyri me entuziazëm në rrugën e vetme të drejtë, në rrugën e kolektivizimit të bujqësisë, në rrugën që do t'i sigurojë asaj mirëqenien dhe bollëkun. Tani në vendin tonë kolektivizimi i bujqësisë, ky revolucion i madh në jetën e fshatit tonë, është në përfundim e sipër në të gjitha zonat bujqësore të vendit.

Si rregull kooperativat përfaqësojnë pakicën vetëm në zonat e larta malore të vendit, si Çermënika, Mirdita, Lura etj. Siç shihet, që tani, në përgjithësi, u plotësua detyra e Kongresit III të Partisë, lidhur me transformimin socialist të bujqësisë. Janë të gjitha mundësitë që deri në pranverën e vitit 1960 të kolektivizohen të gjitha zonat fushore e kodrinore pa përjashtim dhe pjesërisht zonat malore, duke pasur në kooperativa mbi 85 për qind të tokës arë.

Ne sot kemi rreth 1950 fshatra ku janë ngritur kooperativa bujqësore, kundrejt 2655 fshatrave që ka Shqipëria. Në to janë bashkuar 81,5 për qind e tokës së punueshme të fshatarësisë dhe 70 për qind e ekonomive fshatare të Republikës.

Detyra e Partisë, e gjithë punonjësve tanë, sot

është që, krahas me përfundimin e kolektivizimit, të marrin masa për forcimin organizativ dhe ekonomik të kooperativave bujqësore, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që krijon sistemi kooperativist. Duke u mbështetur në zbatimin e përpiktë të statutit dhe të rregullores së brendshme të kooperativave, duhet bërë një punë e gjithanshme për rritjen e pjesëmarrjes në punë, duke i bërë kooperativistët sa më të interesuar për rezultatet e punës. Një punë shumë e madhe duhet bërë për shfrytëzimin e rezervave të brendshme që kanë kooperativat bujqësore. Kjo do të thotë që të përdoret toka në mënyrë sa më racionale, të mos lihet asnjë pëllëmbë toke pa mbjellë, duke marrë dy dhe më shumë prodhime në vit nga e njëjta sipërfaqe.

Bujqësia jonë po bëhet një bujqësi gjithnjë e më intensive. Mjafton të themi se megjithëqë prodhimi i drithërave në vitin 1958 është shtuar 48,9 për qind, në krahasim me vitin 1938, pesha specifike e sipërfaqeve të tyre është ulur nga 96,5 për qind në 80,9 për qind. Në bujqësinë tonë sot zënë një vend shumë të rëndësishëm kultura të tilla të çmueshme si pambuku, duhani dhe panxhari i sheqerit. Në bujqësinë tonë po luajnë një rol gjithnjë më të madh plehrat kimike, bonifikimet dhe mekanizimi.

Nga një vend që përpara gati nuk e njihte fare traktorin, Shqipëria sot ka më shumë mjete të mekanizuara, në krahasim me sipërfaqen, se sa kanë Greqia, Jugosllavia ose Turqia. Mekanizimi i shpejtë i bujqësisë na ndihmon për zhvillimin me sukses të kulturave më të çmueshme dhe intensive, për rritjen e rendimenteve, uljen e kostos dhe shtimin e të ardhurave. Sot



në vendin tonë ka 25 SMT. Në SMT-të dhe në ndërmarrrjet bujqësore shtetërore kemi rreth 3 900 traktorë me 15 kuaj-fuqi, 256 kombajna, 1 325 makina mbjellëse etj. Në vitin 1958 u kryen në mënyrë të mekanizuar 66,6 për qind e punimit të tokës, — 44,7 për qind e mbjelljeve — 23,4 për qind e korrjeve dhe 77,4 për qind e shirjeve.

Punime të mëdha bonifikimi janë bërë dhe po bëhen në vendin tonë. Nga kjo jo vetëm u fituan shumë sipërfaqe të reja toke, por u krijuan edhe kushte shumë të favorshme për rritjen e rendimenteve. Nga kënetat e dikurshme e Maliqit, e Tërbufit, e Mbrostarit e të tjera, së shpejti nuk do të mbetet veçse kujtimi i tyre. Ato do t'u thahen plotësisht dhe përfundimisht. Do të kalojnë edhe pak vjet dhe ne do të përvetësojmë edhe zonën e Durrësit, e Karavastasë etj. dhe kështu praktikisht do të marrë fund bonifikimi i fushave të Shqipërisë. Kjo është një fitore e madhe, e cila pak kohë më parë as që mund të merrej me mend. Tani edhe tokat u bënë më pjellore edhe jeta e fshatarit ka ndryshuar si dita me natën.

Për përparimin e bujqësisë sonë një rëndësi të madhe kanë vendimet e Plenumit të fundit të Komitetit Qendror për pyjet dhe ujitjen. Vënia e tyre në jetë është një detyrë shumë e rëndësishme dhe do t'i japë një ndihmë të madhe gjithë ekonomisë sonë popullore.

Një kujdes të veçantë Partia tregon për sektorin e blegtorisë, si një sektor shumë i rëndësishëm për ekonominë e vendit. Plenumi i Nëntorit 1958 i Komitetit Qendror ka hapur perspektiva shumë të mëdha për

blegtorinë tonë. Në bazë të vendimeve të plenumit, gjatë këtij viti u bë një punë shumë e madhe për shtimin e blegtorisë në përgjithësi e sidomos në sektorin kooperativist. Jo vetëm në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, por edhe në shumë kooperativa bujqësore sot kemi ferma blegtorale të vërteta, ku prodhohet qumësht e mish në sasi të mëdha. Ne kemi arritur mjaft suksese të mëdha lidhur me përmirësimin e racës së dhenve, duke kryqëzuar artificialisht 78,5 për qind të të gjitha deleve që ka Republika. Me një punë të tillë të madhe ne kemi hedhur bazat, si për përmirësimin rrënjësor të cilësisë së leshit, ashtu edhe për shtimin e konsiderueshëm të tij.

Por detyra më e madhe në këtë drejtim ka qenë dhe mbetet sigurimi i bazës ushqimore për gjithë bagëtinë. Silazhimi i misrit po përhapet me shpejtësi të madhe në të gjithë vendin. Mjafton të themi se nga 70 000 tonë që silazhuam për herë të parë në vitin 1957, vjet bërmë 150 000 tonë, ndërsa sivjet afro 331 000 tonë. Siç shikoni, ritmet janë mjaft të shpejta, por ne nuk duhet të kënaqemi me kaq. Sigurimi i bazës ushqimore mbetet edhe për të ardhshmen detyra më kryesore, nga e cila varet dyfishimi i prodhimit të mishit e të qumshtit. Tani edhe ata që ishin më skeptikë për çështjen e derri, për ndërzimin artificial apo për silazhimin nuk kanë ç'të thonë. Jeta e provoi drejtësinë e parashikimeve të Partisë.

Sikurse shihet, ne me hapa të shpejtë po e nxjerrim bujqësinë nga prapambetja dhe po e zhvillojmë atë mbi baza të shëndosha socialiste. Ajo po merr sot një zhvillim të paparë ndonjëherë dhe po bëhet një mbësh-

tetje më e sigurtë për ekonominë tonë popullore. Por me gjithë këtë para punonjësve të bujqësisë dhe gjithë Partisë sonë dalin detyra shumë të mëdha.

Komiteti Qendror i Partisë ka studjuar me kujdes të madh mundësitë për të shtuar në mënyrë të konsiderueshme prodhimin e atyre kulturave që rriten më mirë në tokën dhe klimën e vendit tonë dhe që kanë vlerë po të eksportohen. Komiteti Qendror mendon se ne mund dhe duhet të shtojmë se tepërmi agrumet, vreshtat, pjeshkaç dhe kajsitë, arrat, bajamet dhe lajthitë, fiqtë dhe kumbullat e zeza, qershiat, vishnjët etj. Një rëndësi të madhe ka rritja e perimeve të hershme, të cilat bëhen fare mirë në vendin tonë, kërkojnë shumë në tregun e jashtëm dhe janë me leverdi të madhe për ekonominë tonë popullore. Ne do t'i zgjerojmë këto kultura të çmueshme në ato zona ku bëhen më mirë edhe nga mund të transportohen më lehtë.

Edhe në shembullin e Shqipërisë u vërtetua teza leniniste se rruga e vetme e përparimit të bujqësisë, e nxjerrjes së saj nga prapambetja, e ndërtimit të socializmit në fshat, është rruga e krijimit të ekonomive të mëdha të bashkuara, rruga e kolektivizimit të saj. Kooperativa krijon mundësi kolosale për modernizimin e shpejtë të bujqësisë, për shtimin e prodhimeve bujqësore dhe për nxjerrjen e fshatarësisë nga prapambetja.

15-vjetorin e Çlirimit të atdheut ne e festojmë me suksese të mëdha edhe në sektorët e tjerë të ekonomisë sonë. Një zhvillim të pakrahasueshëm me të kaluarën ka marrë transporti. Dikur, gjatë regjimeve antipopullore, prapambetjes së madhe të industrisë, të bujqësisë

si dhe të degëve të tjera të ekonomisë e të kulturës i përgjigjej një prapambetje edhe më e madhe në transport. Gjatë vjetëve të pushtetit popullor çdo gjë ka ndryshuar. Tani pothuajse nuk ka skaj të Shqipërisë ku nuk shkon automjeti. Është rritur në mënyrë të pakrahasueshme transporti urban e interurban, është krijuar transporti hekurudhor dhe është rritur shumë transporti detar. Kështu, transporti automobilistik i mallrave është rritur më 1958 rreth 21 herë më shumë se në vitin 1938, ndërsa ai i pasagjerëve 70 herë më shumë. Flota jonë tregtare, që është në krijim e sipër, është pajisur me mjete detare të mëdha e moderne, të cilat kanë filluar të çajnë jo vetëm valët e Adriatikut, por edhe të deteve të tjera.

Një hov të paparë kanë marrë në vendin tonë ndërtimet. Mund të thuhet pa frikë se Shqipëria e re e popullit është një kantier i vërtetë ndërtimi, ku çdo ditë ngrihen objekte të reja, shtëpi banimi, shkolla, fabrika apo hidrocentrale. Gjatë 15 vjetëve të pushtetit popullor kanë lindur qytete të reja si Cërriku, Maliqi, Patosi, Pishkashi, Kurbneshi, Ulëza, Bulqiza, zona industriale e Tiranës, Memaliaj e shumë e shumë të tjera. Vetëm në krahasim me vitin 1950 vëllimi i ndërtimeve në vendin tonë më 1959 është rritur afro 4 herë.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar ndërtimit të banesave për punonjësit. Pa llogaritur ndërtimet në fshat, vetëm në qytete, që nga viti 1945 e deri më 1957, është ndërtuar afro 1/4 e gjithë fondit të banesave ekzistuese të qyteteve të Shqipërisë, ose gjatë vjetëve të mësipërm pushteti popullor në qytete ka ndërtuar

një numër shtëpish banimi të barabarta me sasinë e gjithë banesave që kishte në vitin 1938 gjithë qyteti i Tiranës bashkë me atë të Gjirokastrës. Duhet shënuar se vetëm gjatë vjetëve 1955-1957 janë ndërtuar 40 për qind e gjithë sasisë së banesave të ndërtuara pas Çlirimit të vendit. Për të realizuar ndërtimet e kryera, vetëm gjatë vitit 1958, regjimeve antipopullore do t'u duheshin plot 70 vjet sikur të ecnin me ritmet e vitit 1938.

Të dashur shokë,

Qëllimi kryesor dhe aspirata më e lartë e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e Qeverisë Popullore, është ngritja e vazhdueshme e mirëqenies materiale dhe kulturele të masave punonjëse. Ky është ligji kryesor, nga i cili udhëhiqen ato në të gjithë veprimtarinë e tyre të përditshme.

Në bazë të rritjes së prodhimit industrial e bujqësor dhe të rritjes së rendimentit në punë, ekonomia e vendit tonë po zhvillohet me ritme shumë të shpejta dhe si rrjedhim po përmirësohet në mënyrë të pakrahasueshme niveli i jetesës së popullit. Për këtë flasin shumë fakte.

Të ardhurat kombëtare që janë burimi i rritjes së pasurisë shoqërore dhe i rritjes së nivelit të jetesës, po rriten në mënyrë të konsiderueshme. Kështu, në krahasim me vitin 1938, në vitin 1958 ato u rritën 3,5 herë, ndërsa në fund të vitit 1960 parashikohet të rriten rreth 5 herë. Nga ana tjetër, masat e vazhdueshme që kanë marrë Partia dhe qeveria gjatë këtyre 15 vjetëve, e sidomos gjatë pesëvjeçarit të dytë, për uljen

e çmimeve të mallrave të konsumit të gjerë, rritjen e rrogave, ngritjen e pensioneve, e rrogave të ulëta, shtimin e shpërblimeve për prindërit me shumë fëmijë, rritjen e çmimeve të blerjes nga ana e shtetit të prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe një varg masash të tjera, kanë sjellë si rrjedhim ngritjen e pagës reale të punëtorëve e nëpunësve si dhe rritjen e të ardhurave të fshatarësisë punonjëse. Në krahasim me vitin 1950, paga reale, në fund të vitit 1958, u rrit 43 për qind, ndërsa në fund të këtij viti do të jetë 54 për qind më e lartë se ajo e vitit 1950. Po kështu të ardhurat e fshatarësisë punonjëse në vitin 1958 ishin 39 për qind më të mëdha se ato të vitit 1950.

Një shprehje tjetër e gjallë e ngritjes së nivelit të jetesës së masave është rritja e vazhdueshme e konsumit të mallrave të ndryshme. Si rezultat i ngritjes së nivelit material e kultural dhe kërkesës nga masat është ndryshuar shumë struktura e mallrave të shitjes me pakicë, në krahasim me të kaluarën. Krahas kësaj, te ne po rritet vazhdimisht konsumi për frymë i popullsisë. Kështu, ndërsa në vitin 1950 shpërndarja nëpërmjet tregtisë socialiste ishte për çdo frymë 3,21 kg sheqer, — 0,95 kg sapun, — 5 ml tekstile të pambukta, — 0,33 palë këpucë e opinga, në fund të këtij viti shpërndarja për frymë do të arrijë në 6,80 kg sheqer, në — 1,9 kg sapun, në — 14,4 ml tekstile të pambukta e kadife, në — 0,97 palë këpucë e opinga.

Ndërsa në vendin tonë, si në të gjitha vendet socialiste, përmirësohet vazhdimisht jetesa e popullit, në vendet ku sundon prona private mbi mjetet e prodhimit dhe shfrytëzimi i njeriut nga njeriu, ndodh e kundër-

ta. Kështu në Greqi p.sh. 38 për qind e familjeve fshatare kanë të ardhura ditore më pak se gjysma e minimumit të jetesës. Më shumë se 3 milion njerëz, ose më shumë se 1/3 e popullsisë së Greqisë është shpallur e varfër. E njëjta tabullo paraqitet edhe për Italinë, ku nga shtatori i vitit 1957, deri në shtator 1958, kostoja e jetesës u ngrit 5,2 për qind, kurse po të krahasohet viti 1958 me vitin 1954, kostoja e jetesës është 19,8 për qind më e lartë. Në këtë rrugë gjendet edhe e vetë-quajtura Jugosllavia «socialiste». Në Jugosllavinë «socialiste» të Titos më 1956 konsumi i sendeve kryesore ushqimore dhe i mallrave industriale vazhdoi të jetë ai i vitit 1948. Në qershor të vitit 1958, në krahasim me vitin 1957, çmimet e sendeve ushqimore u ngritën 14 për qind. Në tetor të vitit 1958 u ngrit çmimi i miellit të bukës në 10-15 për qind, pa përmendur ngritjen e çmimit të mishit e të qirave të shtëpive etj. që u bënë tani së fundi. Ja shokë, një pasqyrë e qartë, e cila flet vetë mbi epërsinë e sistemit socialist, që tregon më së miri se vetëm socializmi krijon mundësitë reale që punonjësit të bëjnë një jetë më të mirë e më të begatshme.

Gjatë 15 vjetëve të pushtetit popullor suksese të mëdha janë arritur në fushën e përmirësimit të shëndetit të popullit. Dikur te ne malarja, sifilisi, tifoja, tuberkulozi e dizenteria bënëin kërdrinë. Para çlirimit një sëmundje e rëndë në familje ishte baras me një katastrofë ekonomike për atë që kishte ndonjë copë shtëpi, kurse atë që s'kishte e priste vdekja e sigurtë.

Po sot? Gjendja ka ndryshuar rrënjësisht. Këto sëmundje pothuajse janë zhdukur plotësisht ose janë

marrë masa të atilla, të cilat nuk lejojnë që ato të përbëjnë një rrezik për shoqërinë. Janë hapur kudo spitale, ambulanca, klinika, sanatoriume e qendra të ndryshme shëndetësore, ku punonjësit e vendit tonë, punëtorët, fshatarët e intelektualët në çdo kohë sigurojnë falas shërbimet e nevojshme.

Shprehja më e qartë e kujdesit të Partisë dhe të qeverisë për ruajtjen e shëndetit dhe përmirësimin e nivelit të jetesës së masave punonjëse është rritja e shpejtë e popullsisë. Ndërsa në vitin 1938 vendi ynë numëronte një milion e 40 mijë e 300 banorë, në fund të shtatorit 1959 popullsia jonë arriti në një milion e 572 mijë banorë.

Zhvillimi me vrull i ekonomisë sonë popullore ka sjellë në të njëjtën kohë një zhvillim të paparë ndonjëherë edhe të arsimit e të kulturës në vendin tonë. Në këtë drejtim te ne po kryhet një revolucion i vërtetë. Krahasime me të kaluarën as që mund të bëhen në këtë fushë, sepse është vështirë të krahasosh Shqipërinë e paraçlirimit, ku analfabetizmi ishte pothuajse total, me Shqipërinë e re të popullit, ku në çdo 6 vetë një njeri mëson në një kategori shkolle.

Nuk krahasohet dot gjendja e vitit 1938 kur në Shqipëri kishte gjithsejt 380 kuadro me arsim të lartë, me gjendjen e sotme, kur vetëm në një vit shkollor diplomohen mbi 500 kuadro të lartë. Teatri, opera, baleti, teatri i kukullave dhe estrada as që njiheshin para çlirimit. Një zhvillim të madh ka marrë kinemaja. Qindra e mijëra diletantë marrin pjesë në aktivitetet artistike në fshatra e qytete, në shtëpitë e vatrat e kulturës, në klubet e bashkimeve profesionale e të tjera



institucione, të cilave më parë as që u dihej emri. Bijtë e talentuar të Shqipërisë së re debutojnë me sukses në teatrot e vendeve të tjera, konkurrojnë në festivalet e rinisë botërore dhe shquhen për aftësitë e tyre.

Ja, ç'bëri Partia jonë e lavdishme. Ajo i dha hov përparimit kultural e arsimor të vendit, ajo zbuloi dhe inkurajoi talentet e mrekullueshme që fshiheshin në gjirin e popullit tonë, i edukoi, i mësoi ato, i vuri në shërbim të lulëzimit të mëtejshëm të atdheut tonë.

Sukseset e mësipërme janë arritur nën udhëheqjen e Partisë, me pjesëmarrjen direkte të masave punonjëse të vendit tonë. Në punën e lavdishme të ndërtimit ekonomik e kultural të vendit rolin kryesor e udhëheqës e ka luajtur dhe e luan kurdoherë klasa jonë punëtore heroike, e cila është forcuar dhe rritur si numër e si cilësi. Nga radhët e saja kanë dalë njerëz të shquar, punëtorë të pararojës, heronj të punës socialiste si Halil Kraja, Budo Isufi, Petro Olldashi, Xhel Jakupi, Koço Strakosha e shumë e shumë të tjerë. Ndërtimit të Shqipërisë së re i kanë kushtuar të gjitha forcat e veta fshatarësia jonë punonjëse, intelektualët e popullit tonë, rinia heroike e Shqipërisë së re dhe gratë e lavdishme të atdheut tonë socialist. Gjithë populli ynë heroik, i bashkuar në Frontin Demokratik të Shqipërisë, nën udhëheqjen e Partisë, ka vënë aftësitë e dije-nitë e tija për lulëzimin e atdheut tonë socialist.

Të gjitha fitoret, për të cilat bëmë fjalë, flasin për transformimet e mëdha që janë bërë në vendin tonë gjatë këtyre 15 vjetëve, flasin për përmirësimin e dukshëm të jetesës dhe të nivelit kultural të popullit tonë, flasin për krijimin e njeriut të ri të Shqipërisë së

re, i cili u edukua dhe u kalit nga Partia jonë e lavdishme, e njeriut që e do punën, e do popullin e tij dhe atdheun, njeriut, i cili, i edukuar me idetë e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, do me të gjitha forcat e tija të gjithë popujt e botës që luftojnë për çlirimin e tyre kombëtar dhe shoqëror.

Rruga e përshkruar nga populli ynë, gjatë këtyre 15 vjetëve, fitoret e arritura, na bindin edhe një herë se në të ardhshmen, populli ynë, i udhëhequr nga Partia e tij marksiste-leniniste, me ndihmën e miqve do të sigurojë fitore të reja akoma më të mëdha. Ne do të sigurojmë kushte më të mira jetesc për popullin tonë, një të ardhshme më të gëzuar e më të lumtur, ne do ta shndërrojmë vendin tonë në një kopësht të lulëzuar.

Të dashur shokë e shoqe,

Duke bërë bilancin e fitoreve të arritura gjatë këtyre 15 vjetëve, në të njëjtën kohë ne nuk duhet të harrojmë vështirësitë e pengesat e mëdha që kemi kaluar. Ato ne duhet t'i kujtojmë, sepse kështu do të forcojmë besimin se edhe në të ardhshmen do të dimë t'i kapërcejmë me guxim vështirësitë që do të na dalin përpara; ato duhet t'i dijë rinia jonë, brezat e ardhshëm, me qëllim që t'i vlerësojnë drejt fitoret e arritura, të cilat janë siguruar me luftë të përditshme, me përpjekje kolosale e heroizma të pashoqe, që nga rëndësia e tyre mund të krahasohen me ato të Luftës sonë Nacionalçlirimtare.

15 vjet më parë, pushteti ynë popullor e filloi veprimtarinë e tij për ndërtimin e Shqipërisë së re, jo

vetëm në kushtet e një prapambetjeje të madhe ekonomiko-kulturale të trashëguar nga e kaluara, por edhe në kushtet e një shkatërrimi pothuajse total, si rezultat i dëmeve jashtëzakonisht të mëdha të shkaktuara nga lufta. Kujtoni për një çast, të dashur shokë, fshatrat dhe qytetet tona të djegura, urat dhe portet tona të shkatërruara, atë pak industri që ekzistonte asaj kohe dhe që ishte gati krejtësisht e paralizuar nga mungesa e lëndës djegëse, apo sepse ishte nxjerrë jashtë përdorimit. Sillni ndër mend kushtet e rënda të jetesës së punonjësve tanë, kur buka e racionuar dhe preshi përbënin ushqimin e vetëm. Urtësia dhe forca e Partisë sonë të lavdishme, heroizini, vullneti dhe guximi i popullit tonë të mrekullueshëm u dukën edhe një herë, si gjatë luftës, në ato vitet e para të Çlirimit. Partia jonë ngriti në këmbë popullin punonjës, ajo përcaktoi qartë detyrat dhe një faqe e re e lavdishme filloi të shkruhej në historinë e Shqipërisë së re. Të gjithë e kemi të gjallë forcën vigane që tregoi populli ynë në veprën e madhe të rindërtimit, punën e palodhur dhe entuziazmin e papërshkruar të klasës sonë punëtore, hovin revolucionar të rinisë sonë heroike, e cila me brigadat e saja të lavdishme u bë mbështetje e fuqishme e pushtetit popullor për rindërtimin e vendit, punën plot sakrificatë të inxhinierëve dhe të teknikëve patriotë. Puna heroike dhe e ndërgjegjshme e klasës punëtore, e fshatarësisë punonjëse, e rinisë, e inxhinierëve dhe e teknikëve, sakrificat e panumërta të mbarë popullit tonë, qëndrojnë në themelin e të gjitha sukseseve të sotme.

Pushteti popullor e filloi veprimtarinë e tij pa pasur ndonjë eksperiencë në fushën e ndërtimit, pa kuadro të

pregatitur, pa teknikët dhe specialistët e nevojshëm për udhëheqjen e ekonomisë e të kulturës, të jetës së një shteti. Për këtë arsye, si edhe duke pasur parasysh vështirësitë që dilnin përpara pushtetit popullor, si rezultat i prapambetjes së madhe ekonomike e kulturele në të cilën ishte zhytur vendi, armiqtë tanë të jashtëm e të brendshëm qeshnin me ne e profetizonin se pushteti popullor do t'i kishte ditët të shkurtëra, se komunistët do të dështonin në planet e tyre për rindërtimin e vendit dhe ndërtimin e socializmit. Por parashikimet e armiqve mbetën vetëm ëndrra. Partia jonë me guxim e udhëhoqi popullin përpara, ajo ngriti kuadro të rinj nga radhët e punonjësve, dërgoi për studime jashtë shtetit me qindra bij të punëtorëve e të fshatarëve, hapi shkolla në vend.

Partia jonë në gjithë veprimtarinë e saj kishte parasysh mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ajo i kishte gjithnjë sytë e saj nga Moska e bolshevikëve, të cilët, para nesh, çanë të parët në botë rrugën e ndërtimit të shoqërisë së re socialiste. Jeta tregoi se Partia jonë veproi me zotësi dhe e udhëhoqi popullin në fitore. Dhe ja, shokë, sot ne rrojmë dhe bile të fortë. Pushteti popullor, nën udhëheqjen e Partisë, është forcuar, ndërsa armiqtë tanë, ata që profetizonin dështimin tonë, janë shndërruar në kërcunj. Pse ndodhi kjo? Sepse komunistët dhe Partia e tyre kishin besim të patundur te populli, te aftësitë krijuese të masave, të atyre që bënë luftën e çlirimit dhe që sot po ndërtojnë Shqipërinë e re të popullit.

Sukseset tona janë arritur nëpërmjet një lufte të ashpër klasash me armiqtë e jashtëm e të brendshëm.

Kujtoni, shokë, rezistencën e tërbuar të vjetëve të parë të Çlirimit të ish-klasave sunduese, të mbeturinave të bandave të armatosura të reaksionit, kujtoni veprimet e shumta armiqësore të qarqeve sunduese të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë etj., sabotimet që organizonin ata, inkurajimin që i jepnin reaksionit të brendshëm, propagandën e shfrenuar kundër pushtetit popullor, provokacionet gjithfarësh kundër Republikës sonë të re, që nga ato të kufijve e deri te provokacioni i njohur i kanalit të Korfuzit etj.

Nuk mund të harrohen dëmet e mëdha e shumë serioze, sabotimet dhe puna armiqësore e revizionistëve jugosllavë, të cilët gjoja nën maskën e «ndihmës» e të «miqësisë» bënë ç'u erdhi për dore për të penguar ndërtimin e vendit, për të organizuar komplete në dëm të lirisë dhe të pavarësisë së popullit tonë, për të grabitur pasurinë e popullit tonë. Por populli ynë, i udhëhequr me guxim nga Partia e tij heroike e Punës, e cila çështjen e mbrojtjes së lirisë dhe të pavarësisë së atdheut e konsideron si detyrën e saj kryesore, i mposhti me sukses të gjitha përpjekjet e armiqve dhe, i bindur në çështjen e tij të madhe, shkoi me siguri drejt ndërtimit të socializmit.

Ku i gjeti forcat populli ynë që të dalë fitimtar mbi pengesat e vështirësitë, mbi armiqtë dhe prapambetjen, që me aq entuziazëm dhe heroizëm, me aq guxim e sakrifica t'i futej çështjes së rindërtimit të vendit, çështjes së ndërtimit të socializmit dhe të arrijë sukseset madhështore për të cilat u fol më parë?

Forca e popullit punonjës të Shqipërisë së re konsiston në faktin se me triumfin e revolucionit tonë po-

pullor pushteti kaloi në duart e masave punonjëse. Pushteti popullor, i udhëhequr nga Partia, përfaqëson plotësisht interesat dhe aspiratat e punonjësve të vendit tonë. Që pas Çlirimit të vendit e deri sot pushteti ynë është forcuar gjithnjë e më shumë dhe roli i masave të gjera punonjëse në drejtimin e vendit është rritur vazhdimisht. Janë punëtorët dhe fshatarët e vendit tonë, si edhe intelektualët e dalë nga gjiri i tyre, ata që vendosin ligjet dhe planet e ndryshme për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës së Shqipërisë së re në të gjitha shkallët, që nga fshati, qyteti, rrethi e deri në Kuvendin Popullor. Janë përfaqësuesit e të njëjtave shtresa, që zbatojnë ligjet dhe planet e shtetit, që kryejnë funksionet ekzekutive të pushtetit tonë, që nga baza e deri në qendër. Ky fakt përbën një nga arsyet kryesore që shpjegon sukseset e arritura në vendin tonë, luftën këmbëngulëse dhe të vendosur të masave për realizimin e detyrave që kanë shtruar e shtrojnë Partia dhe qeveria.

Partia e Punës i ka kushtuar dhe i kushton një kujdes të veçantë forcimit të mëtejshëm dhe perfeksionimit të veprimtarisë së organeve të pushtetit popullor, duke pasur gjithnjë parasysh shtimin e vazhdueshëm të rolit të masave të popullit në punët e drejtimit dhe të administrimit të shtetit tonë të demokracisë popullore. Edhe në të ardhshmen Partia dhe qeveria jonë do t'i kushtojnë kujdes të veçantë, ashtu si deri tani, forcimit të të gjitha organeve të diktaturës sonë, të cilat i shërbejnë mbrojtjes së fitoreve të arritura nga populli ynë, sigurimit të lirisë dhe të pavarësisë së atdheut tonë nga çdo rrezik.

Partia dhe populli ynë kanë një dashuri të madhe dhe një kujdes të veçantë për Ushtrinë tonë Popullore dhe për organet e sigurimit të shtetit, që përfaqësojnë popullin e armatosur për mbrojtjen e lirisë dhe të sovranitetit të vendit, për ruajtjen e qetësisë dhe të rendit tonë demokratik. Forcat tona të armatosura dhe Sigurimi ynë i Shtetit, të krijuar dhe të edukuar me kujdes të veçantë nga Partia jonë e Punës, duke ruajtur e trashëguar me besnikëri traditat e partizanëve tanë trima, gjatë këtyre 15 vjetëve janë modernizuar, janë pajisur me një teknikë të lartë dhe me një shpirt moralo-politik të shkëlqyer. Gjatë 15 vjetëve të ekzistencës së Shqipërisë së re ato kanë qëndruar me vigjilencë në roje të fitoreve të popullit tonë, të punës paqësore të masave punonjëse. Forcat e armatosura të Republikës sonë Popullore kanë qenë kurdoherë dhe janë të gatshme që t'i tregojnë vendin çdo armiku, i cili do të orvatej të cenonte sado pak interesat e popullit tonë punonjës, interesat e atdheut tonë të dashur.

Faktori kryesor për arritjen e fitoreve tona në të gjitha drejtimet si dhe për kapërcimin me sukses të pengesave e vështirësive të ndryshme është roli udhëheqës i Partisë sonë heroike dhe të lavdishme të Punës, Partisë së klasës punëtore, besnike e patundur e ideve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit.

Partia jonë, që në fillim dhe vazhdimisht i ka vënë vetes për qëllim të luftojë dhe të punojë me të gjitha forcat për të ngritur në mënyrë të pareshtur nivelin material dhe kultural të punonjësve. 18 vjetët e ekzistencës së saj dhe 15 vjetët pas Çlirimit janë dëshmi e qartë se çfarë ka bërë Partia jonë e dashur. Bijtë më të

mirë të saj dhanë jetën e tyre për çlirimin e atdheut. Anëtarët e Partisë kanë qenë dhe janë në ballë të luftës për ndërtimin e Shqipërisë së re, për mbrojtjen e atdheut, për mbrojtjen e interesave të popullit.

Partia e Punës e Shqipërisë, si një parti marksiste-leniniste, që në ditët e para të themelimit të saj dhe vazhdimisht, u ka kushtuar një kujdes të madh lidhjeve me masat dhe këtu ka gjetur forca të pashtershme për realizimin e qëllimeve të saj. Vetë fakti se sot në radhët e Partisë numërohen mbi 51 mijë anëtarë e kandidatë për anëtarë partie, tregon qartë vijën e drejtë të Partisë sonë, përkrahjen dhe lidhjen e saj të ngushtë me klasën punëtore dhe masat e tjera punonjëse.

Forca e Partisë sonë qëndron në unitetin e çelniktë të radhëve të saja. Në saje të luftës së vendosur të Partisë kundër veprimtarisë përçarëse, veprimtarisë armiqësore dhe tendencave oportuniste, që kërkonin ta shmangnin atë nga rruga e saj e drejtë marksiste-leniniste, është forcuar uniteti i radhëve të Partisë. Gjithë Partia, si një trup i vetëm, është bashkuar rreth Komitetit Qendror leninist dhe janë dërrmuar të gjitha shpresat e armiqve për të çarë këtë unitet dhe për të rivendosur në vendin tonë sundimin e borgjezisë.

Partia jonë, besnike e ideve të socializmit shkençor, ka bërë dhe do të bëjë pa pushim një luftë parimore, për të mbrojtur deri në fund pastërtinë e marksizëm-leninizmit.

Revizionizmi përbën një rrezik serioz për lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Ai kërkon jo vetëm të çorientojë ideologjikisht klasën punëtore, ta nxjerrë atë nga binarët e marksizëm-leninizmit, ta



çarmatosë përpara borgjezisë dhe reaksionit ndërkom-bëtar, por edhe të minojë fitoret e arritura në vendet socialiste, të minojë unitetin e kampit socialist, të kryesuar nga Bashkimi Sovjetik, të hapë rrugën e restaurimit të kapitalizmit. Flamurin e reckosur të revizionizmit e mbajnë revizionistët jugosllavë, të cilët në mënyrë të hapur, me të gjitha mjetet, që nga ato të propagandës e deri te diversioni agjentural, sulmojnë ideologjinë marksiste-leniniste dhe vendet e kampit tonë socialist. Sulme të poshtra revizionistët jugosllavë bëjnë vazhdimisht sidomos kundër popullit dhe Partisë sonë.

Dihen dhe janë të faktuara përpjekjet, intrigat dhe komplotet e revizionistëve jugosllavë kundër Shqipërisë. Dihet gjithashtu se çfarë fshihej nën të ashtuquajturën «ndihmë» ekonomike nga ana jugosllave. Dihen metodat prej jezuitësh që përdorën titistët jugosllavë ndaj dorës së nderur nga ana jonë, ndaj singëritetit tonë, për një miqësi të pastër me popullin jugosllav, në bazat e marksizëm-leninizmit.

Por për fat të keq «miqësia» e titistëve ishte një maskë që fshihte fytyrën e tyre të vërtetë. Këtë maskë ua çori Partia jonë heroike, ajo Parti të cilën ata e kishin kurdoherë halë në sy dhe që u përpoqën ta shkatërronin nga brenda me agjentin e tyre, tradhtarin Koçi Xoxe e shokët e tij, ajo Parti që u qëndroi heroikisht sulmeve të revizionistëve dhe të agjentëve të tyre, grupeve të diversionit, kompleteve, propagandës së shfrenuar revizioniste për 18 vjet me radhë dhe që sot më e fortë se kurrë qëndron e papërkulur, vigjilente dhe dërrmon pa mëshirë veprimtarinë keqbërëse

që revizionistët jugosllavë vazhdojnë të vërshejnë si një rrëke e turbullt mbi vendin tonë.

Gjëra të paqena ne nuk i kemi zakon t'i krijojmë dhe as t'i zmadhojmë dhe as që kemi nevojë të bëjmë një gjë të tillë. Por këtë veprimtari armiqësore kundër Shqipërisë ne do ta demaskojmë pa mëshirë dhe do ta asgjësojmë ashtu si kemi bërë kurdoherë. Demagogjia e tyre nuk do të na ndalë për asnjë çast të mbrojmë atdheun tonë, të mbrojmë Partinë tonë dhe pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe populli vëlla jugosllav, që ne e duam me gjithë zemër, na kupton fare mirë, pavarësisht se propaganda titiste përpiket me të gjitha mjetet të na paraqitë si «armiq të popullit jugosllav». Populli jugosllav ka dhe do të ketë përjetë te populli shqiptar e Partia e tij e Punës, dy miq nga më të sinqertët dhe më besnikët.

Revizionistët jugosllavë dështuan në përpjekjet për aneksimin e Shqipërisë, por ata nuk heqin dorë nga këto qëllime. Ne u themi atyre se këto shpresa nuk do të realizohen kurrë. Në botë dhe në shekuj do të ketë një Shqipëri dhe vetëm një, një Shqipëri të lirë, sovranë, socialiste.

Presidenti i Jugosllavisë nuk mungon ta sulmojë Partinë dhe udhëheqjen tonë e njëkohësisht të luajë rolin e viktimës. Ai flet për «bashkekzistencë aktive», por nga ana tjetër i gjithë shtypi jugosllav, udhëheqësit jugosllavë dhe UDB-ja flasin dhe punojnë aktivisht kundër vendit tonë. Sigurisht këtu nuk ka përputhje të fjalëve me vepra. Fjalët i merr era dhe në qoftë se mendohet se fjalët «e bukura» që fshchin të keqen, do të zënë vend, se gjoja jemi ne që nuk duam qetë-

sinë në Ballkan, udhëheqësit jugosllavë i bëjnë hesapet gabim.

Ne kemi qenë dhe jemi kurdoherë për bashkekzistencë me shtetin jugosllav dhe me çdo shtet tjetër, çfarëdo forme regjimi që ato të kenë. Por, bashkekzistencë ideologjike me kapitalizmin dhe revizionizmin ne kurrë nuk do të kemi. Këto janë dy gjëra që nuk duhen përzier dhe ne nuk do t'i përziejme kurrë.

Revizionistët bëjnë çmos që nën maskën e bashkekzistencës të shesin qelbësirat e tyre ideologjike. Është e njohur taktika e «integritit paqësor të kapitalizmit në komunizëm». Këtë taktikë të oportunistëve, që e ka djegur përgjithmonë me zjarr Lenini i madh, e kanë ngritur në sistem revizionistët jugosllavë në kongresin e tyre të 7-të.

Sigurisht është qesharake dhe absurde të përpiqesh me demagogji të akuzosh Shqipërinë se gjoja «ajo nuk është për bashkekzistencën në Ballkan», apo se gjoja «për shkakun e saj nuk mund të merren vesh popujt e Ballkanit për të jetuar në paqe dhe në miqësi të mirë», kur bëhen rivendikime tokësore në kurriz të Shqipërisë, kur disa deklarojnë dhe qëndrojnë «në gjendje lufte» me Shqipërinë dhe, nga ana tjetër, me atë shtet që dikur pushtoi dhe dogji Shqipërinë dhe Greqinë, po puthen e përqafohen, kur disa pregatitin dhe hedhin çdo ditë e çdo javë banda diversantësh për të prishur qetësinë në vendin tonë. Formalitetet dhe gënjeshttrat nuk qëndrojnë dot përpara realitetit dhe së vërtetës.

Partia jonë ka pasur dhe ka një vijë të palëkundur marksiste-leniniste për të gjitha çështjet lidhur me Jugosllavinë. Çështja e minoritetit shqiptar në Jugos-

llavi është trajtuar dhe trajtohet në mënyrë të drejtë marksiste-leniniste nga Partia jonë dhe s'ishte aspak nevoja të ktheheshim në këtë çështje po të mos ishin veprimet e revizionistëve jugosllavë që kërkojnë të prishin marrëdhëniet shtetërore të fqinjësisë së mirë dhe të bashkekzistencës.

Revizionistët jugosllavë po e shndërrojnë Kosovën në një kamp ku stërviten në të gjitha format kundër Republikës Popullore të Shqipërisë fashistët dhe tradhtarët e arratisur të popullit shqiptar. Revizionistët jugosllavë, pasi e dogjën, e vranë, pasi i morën tokën, i mbyllën shkollat etj., e detyruan të emigronte në masë në Turqi popullatën shqiptare të Kosovës; tash, kohët e fundit, Popoviçët e Vukmanoviçët, pikërisht ata që bënë të gjitha këto mizori, me demagogji kërkojnë të nxitin kosovarët kundër Shqipërisë së re. «Mjaltë» rrjedh, ka disa muaj, nga goja e xhelatëve të kosovarëve për Kosovën dhe vrer e shpifje derdhen kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe kundër Partisë sonë.

Politikën e revizionistëve jugosllavë në minoritetin shqiptar të Kosovës mund ta barazosh me veprimet e një ariu të egër në një dyqan qelqurina, por ne u themi revizionistëve jugosllavë dhe kulishëve të tyre në Kosovë, ish-plehra të Partisë sonë, se kosovarët nuk janë qelqurina. Ne do të ishim të lumtur që në Kosovë nga çdo çesme të rridhte qumësht, por të përpiqesh t'i gënjesh ata me lugë të zbrazët dhe me gënjeshtër do të jetë e kotë. Por megjithatë ajo është puna e tyre dhe sa do t'u besojnë kosovarët që s'hanë bar, por që e kanë zemrën vrer dhe kurrizin plot plagë, edhe kjo është gjithashtu puna e tyre. Ne nuk përzihe-

mi në punët e tyre të brendshme. Por kur të gjitha këto manevra të revizionistëve jugosllavë synojnë, siç po synojnë, që të nxitin shqiptarët e Kosovës kundër Shqipërisë, duhet t'i paralajmërojmë ata se davanë e kanë të humbur përgjithmonë dhe faji s'do të jetë kurrë i yni, por i atyre. Veprime të tilla, pikërisht si ato që bëjnë tash titistët, i ka bërë në kohën e vet edhe ministri kuisling i gjermanëve, Xhafer Deva, kundër partizanëve shqiptarë, dhe titistët duhet të dinë se kosovarët e gënjyer nga Xhafer Deva, me të marrë vesh se do të luftonin kundër vëllezërve të tyre, hodhën armët dhe pranuan burgosjen dhe plumbin e fashizmit se sa të ngrinin dorën kundër vëllezërve të tyre të një gjaku. Le ta kenë parasysh këtë mësim të historisë zotërinjtë revizionistë jugosllavë.

Veprimtaria keqbërëse e revizionistëve jugosllavë duhet të konsiderohet, ashtu siç është në fakt, si një pjesë përbërëse e veprimtarisë agjenturale të imperializmit botëror kundër marksizëm-leninizmit dhe kampit të socializmit, prandaj edhe duhet luftuar si e tillë. Të gjithë tradhtarët e marksizëm-leninizmit, të flakur në shportat e plehrave nga partitë komuniste e punëtoreshë të botës, grumbullohen, ndihmohen, organizohen me durim nga agjentura revizioniste jugosllave kundër lëvizjes komuniste botërore. Revizionistët jugosllavë mbledhin plehra të tilla në Australi, në Amerikën Latine, në vendet arabe e kudo ku ia lyp nevoja imperializmit. Kudo ku lëvizja antikolonialiste e çlirimtare ka marrë një hov të madh dhe forcat përparimtare revolucionare bashkëpunojnë ngushtë me partitë marksiste, atje, pa një pa dy, do të shkojë ndonjë Popoviç që të intrigojë,

të organizojë, të vjellë vrer kundër komunistëve, kundër partive dhe shteteve tona, kundër Bashkimit Sovjetik, Kinës Popullore etj. Këtë detyrë ata e kanë marrë hapët në kongresin e tyre të fundit dhe po e vënë në veprim me konsekuencë. Kjo nuk na çudit aspak. E kundërta do të na çudiste.

Partia jonë kurdoherë e ka thënë, dhe këtë e ka mbështetur në fakte, se revizionistët jugosllavë janë armiq të tërbuar të marksizëm-leninizmit dhe faktet kanë treguar e çdo ditë vazhdojnë të tregojnë se ata nuk mund të heqin dorë, me gjithë grushtet e rënda që kanë ngrënë.

S'harrohet kurrë çështja tragjike e Hungarisë, ku revizionistët jugosllavë luajtën rolin e tyre të poshtër, mbrojtën tradhtarët e partisë dhe të popullit vëlla hungarez dhe në kongresin e tyre formuluan qartë tezat dhe veprimtarinë e tyre revizioniste. A thua se këta hoqën dorë nga Hungari të tjera? Vetëm se nuk ishin në kufijtë e Himalajeve se ndryshe edhe atje do të gjeje gishtin e tyre në veprimet armiqësore të feudalëve të egër të Tibetit. Por megjithatë zoti Popoviç edhe atje shkoi për të bërë punën e mizës së përrallës, e cila, pasi ishte ushqyer me plehra, kërkoi të nxiste dy buajt e fuqishëm që tërhiqnin qerren e rëndë në rrugën mallore. Të dërguarit e revizionistëve jugosllavë në Indi e në Nepal, në Beograd e në Prishtinë po akuzojnë Kinën e lavdishme dhe partinë e saj heroike marksiste-leniniste si luftënxitëse, si shkaktare të një lufte të re botërore dhe po përpiqen, si gjithë imperializmi, të diskreditojnë veprën paqësore dhe punën e lavdishme të 650 milion kinezëve drejt socializmit dhe komuniz-

mit, përpiqen të gjejnë të çara atje ku s'ka e ku s'do të ketë kurrë, përpiqen të vërtetojnë tezat e tyre të kalbura. Por sado që të përpiqen zotërinjtë Popoviçë, ata do të mbeten lakuriq e me duar bosh.

Udhëheqësve të tanishëm jugosllavë u djeg shumë kur i cilëson ashtu siç janë dhe siç veprojnë. Ata mendojnë se pa i përmendur mund të veprojnë lirisht kundër komunizmit, kundër kampit tonë. Por kjo është si historia e strucit: le ta futë sa të dojë kokën në rërë, ai prapëseprapë mbetet struc. Komunistët e të gjithë botës, si një trup i vetëm, ua thonë një herë ose dy herë në ditë, ua thonë në mëngjes apo në mbrëmje, zotërinj titistë, ju jeni njëlloj, revizionistë. Prandaj sado që të përpiqeni t'i hidhni ujë verës, çfarëdo taktike që të përdorni, sado «buzëqeshje» që të bëni, ju mbeteni revizionistë.

Partia jonë edhe në të ardhshmen do të vazhdojë luftën për demaskimin politik e ideologjik të revizionizmit, sepse ky, siç theksohet në Deklaratën e Moskës të 12 partive komuniste e punëtore, paraqit rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Së bashku me të gjitha partitë e tjera motra, Partia jonë do të luftojë edhe në të ardhshmen me vendosmëri për forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Shokë dhe shoqe,

Rezultatet e punës paqësore 15-vjeçare të popullit tonë janë një bazë e shëndoshë për suksese akoma më të mëdha.

Para popullit tonë janë hapur perspektiva të shkëlqyera të zhvillimit socialist. Këto perspektiva janë mi-shëruar në studimin 15-vjeçar (1961-1975), i cili është hartuar në mënyrë paraprake nga Partia dhe qeveria. Në kuadrin e këtij studimi po hartohet projekti i pesë-vjeçarit të tretë të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës për vjetët 1961-1965. Pikënisja kryesore e pesë-vjeçarit të tretë është krijimi i mundësive për të ecur vendi ynë, brenda një kohe relativisht të shkurtër, me këmbët e veta. Në këtë drejtim pesëvjeçari i tretë do ta vërë Shqipërinë në rrugën e shndërrimit të saj nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar.

Në fund të pesëvjeçarit të tretë do të rritet në masë të konsiderueshme prodhimi industrial, duke zhvilluar veçanërisht prodhimin e mjeteve të prodhimit. Me ritme të shpejta do të zhvillohen minierat, siç janë nxjerrja e naftës, e kromit, e bakrit, e hekur-nikelit e të tjera. Do të krijohen për herë të parë degë të reja të prodhimit industrial, nga më të rëndësishmet, siç janë industria kimike, industria metalurgjike e ferro-kromit, industria elektrometalurgjike e bakrit, së bashku me prodhimin e plehrave të superfosfatit etj.

Pesëvjeçari i tretë parashikon krijimin e bazës energjitike të nevojshme për sigurimin e zhvillimit në perspektivë të industrisë dhe të të gjitha degëve të tjera të ekonomisë popullore.

Një zhvillim i konsiderueshëm parashikohet edhe për degët e tjera të industrisë së rëndë, si industria mekanike dhe e materialeve të ndërtimit.

Krahas me zhvillimin e këtyre degëve është para-



shikuar rritja e mëtejshme e industrisë së lehtë, ushqimore etj., për prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë.

Bujqësia, si një nga degët shumë të rëndësishme të ekonomisë sonë popullore, do të ketë gjithashtu një zhvillim të vrullshëm. Një kujdes i veçantë do të tregohet për shtimin e tokave të reja si edhe për ujitjen e tokave, faktorë të rëndësishëm për rritjen e prodhimit bujqësor në kushtet e vendit tonë. Brenda pesëvjeçarit të tretë do të përfundojë ndërtimi i veprave kryesore të bonifikimit dhe të ujitjes, siç janë bonifikimet e Myzeqesë dhe të Roskovecit, të Thumanës, të Vurgut, bonifikimi i fushave të Lezhës, të Matit etj. Sipas të dhënave paraprake, në fund të pesëvjeçarit të tretë, sipërfaqja e punueshme parashikohet të rritet shumë në krahasim me vitin 1958. Nga 106 100 hektarë sipërfaqe të ujitshme në vitin 1958, në vitin 1965 parashikohet të ujitjen 201 200 hektarë tokë.

Për sigurimin e zbatimit të detyrave kryesore, pesëvjeçari i tretë parashikon një zhvillim të madh të ndërtimeve të reja. Përveç objekteve kryesore të bujqësisë, do të ndërtohen një varg objektivsh industriale për shfrytëzimin e vendburimeve të naftës dhe të minierave të reja të bakrit dhe të hekur-nikelit, do të ndërtohen një numër i konsiderueshëm veprash të mëdha industriale, si uzina e plehrave azotike, uzina elektrometalurgjike e bakrit dhe e plehrave fosfatike, fabrikat për pasurimin e kromit, një sërë fabrikash për prodhimet e materialeve të ndërtimit, si edhe për lëndën e drurit, kombinat i tekstileve të pambukta, do të bëhet zgjerimi i fabrikës së tekstileve të leshta me krehje

të lartë, do të ndërtohen një varg fabrikash të tjera të industrisë së lehtë dhe ushqimore, për prodhimin e këpucëve, për vajrat vegjetale, për përpunimin e rrushit, si edhe disa dhjetëra vepra të tjera të rëndësishme me karakter shoqëror dhe për mbrojtjen e shëndetit të popullit etj.

Zhvillimi në përpjesëtime më të mëdha i ekonomisë sonë popullore gjatë pesëvjeçarit të tretë do të sjellë ngritjen e pandërprerë të nivelit material e kultural të masave tona punonjëse. Do të zgjerohet shumë arsimi popullor, do të shtohen masat mbrojtëse për shëndetin e popullit dhe ndërtimi i bancesave parashikohet të rritet shumë në krahasim me pesëvjeçarin e dytë.

Këto janë në vija të përgjithshme perspektivat e shkëlqyera që ka përpara vendi ynë në drejtim të përparimit dhe të rritjes së mirëqenies së masave punonjëse. Pesëvjeçari i tretë do të jetë një pesëvjeçar që do t'i hapë perspektiva të mëdha popullit shqiptar për një jetë akoma më të lumtur, akoma më të begatshme. Kjo është perspektiva e afërt që i buzëqesh popullit tonë dhe që ia siguron vetëm sistemi socialist, që ia siguron vetëm puna e tij e lirë e paqësore dhe udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Shokë dhe shoqe,

Gjatë këtyre 15 vjetëve edhe në fushën ndërkombëtare shteti ynë popullor ka arritur fitore shumë të mëdha.

Revolucioni popullor, i udhëhequr nga Partia,

shkallmoi vargojtë e rëndë të imperializmit që e mbanin vendin tonë në skllavëri e në mjerim, i siguroi pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar, i çeli rrugën e shkëlqyer të socializmit. Në Shqipërinë e re u bënë realitet ëndrrat shekullore të popullit tonë, qëllimet e larta për të cilat luftuan dhe shkrinë jetën e tyre bijtë dhe bijat më të mira të popullit shqiptar, aspiratat më fisnike të patriotëve tanë të mëdhenj që nga Skënderbeu te Naim Frashëri dhe Ismail Qemali, te Çerçiz Topulli e Selam Musai, te Bajram Curri e Avni Rustemi, te Riza Cerova e Ali Kelmendi, te Koci Bako e Qemal Stafa. Partia jonë u bë mbrojtësja e sigurtë dhe e flaktë e traditave më të mira të popullit tonë të lavdishëm.

Partia i solli popullit shqiptar lirinë, nderin dhe dinjitetin në fushën ndërkombëtare, i çeli rrugën e begatisë e të lulëzimit, rrugën e mrekullueshme të socializmit e të komunizmit. Ajo i siguroi miqësinë vëllazërore me të gjitha vendet e kampit socialist, simpatinë dhe solidaritetin aktiv të të gjithë popujve dhe forcave paqedashëse në botë.

Pas Çlirimit, Partisë dhe qeverisë sonë iu desh të bëjnë një luftë të vendosur e të shumanshme për të mbrojtur dhe forcuar fitoret historike të Luftës Nacionalçlirimtare e të revolucionit popullor, për t'i zhdukur pasojat e hidhura të shtypjes shekullore, për të mbrojtur dhe siguruar të drejtat e ligjshme të atdheut tonë në fushën ndërkombëtare.

Ne hodhëm poshtë të gjitha traktatet dhe marrëveshjet e pabarabarta dhe grabitqare, me anën e të cilave fuqitë imperialiste e kishin skllavëruar dhe kthyer vendin tonë në një gjysmëkoloni dhe vendosëm marrë-

dhënie të barabarta e në përfitim reciprok me të gjitha shtetet që janë treguar të gatshme për një gjë të tillë.

Mbaroi koha kur fuqitë imperialiste dhe veglat e tyre në Ballkan luanin me fatin e Shqipërisë, bënë pazarllëqe në kurriz të saj. Mbaroi koha kur Shqipërisë i imponoheshin politika e «portës së hapur» dhe koncesione hajdutësh. 7 prilli nuk do të përsëritet kurrë më. Sot Shqipëria ka zot dhe ky zot është populli i saj heroik e i mrekullueshëm që udhëhiqet me urtësi dhe siguri nga Partia e tij e lavdishme marksiste-leniniste.

Politika e jashtme e Partisë dhe e qeverisë sonë ka qenë dhe do të jetë kurdoherë politika leniniste e paqes dhe e miqësisë midis popujve.

Marrëdhëniet tona me Bashkimin Sovjetik, marrëdhëniet tona me të gjitha vendet e tjera të kampit socialist, mbështeten në parimet leniniste të barazisë, të respektit reciprok dhe të mosndërhyrjes, të bashkëpunimit të ngushtë dhe të ndihmës reciproke vëllazërore. Këto marrëdhënie të tipit të ri u përgjigjen interesave jetike të popujve tanë, ato kanë gjetur shprehjen e tyre më të lartë në unitetin e kampit të socializmit, ato ndriçohen nga idetë triumfuese të marksizëm-leninizmit.

Duke ndjekur politikën e saj të paqes e të miqësisë, Republika Popullore e Shqipërisë ka zgjeruar marrëdhëniet e saja me vendet e tjera. Sot vendi ynë ka marrëdhënie diplomatike me 23 vende dhe marrëdhënie tregtare me një numër akoma më të madh vendesh. Ne jemi gati që të vendosim marrëdhënie të rregullta diplomatike, tregtare dhe kulturele me të gjitha ato vende që e dëshirojnë një gjë të tillë, në bazë të pa-

rimeve të barazisë, mosndërhyrjes, respektit dhe përfitimt reciprok, në bazë të bashkekzistencës paqësore.

Qeveria jonë i ka kushtuar kurdoherë kujdes të veçantë zhvillimit të marrëdhënieve me vendet fqinje, Jugosllavinë, Italinë dhe Greqinë, duke ndjekur kundrejt tyre politikën e bashkëpunimit, të bashkekzistencës, mosndërhyrjes në punët e brendshme të njërit-tjetrit dhe të fqinjësisë së mirë, duke kërkuar natyrisht që edhe ato të ndjekin kundrejt Shqipërisë të njëjtën politikë. Ne mendojmë se kjo politikë u përgjigjet interesave reciproke të vendeve tona dhe është në dobi të paqes në zonën e Ballkanit e të Adriatikut. Ne do të vazhdojmë edhe në të ardhshmen të njëjtën politikë dhe shpresojmë se edhe fqinjët tanë do të veprojnë po kështu. Ne mendojmë se, në kohën e sotme, mungesa e marrëdhënieve normale midis vendit tonë dhe Greqisë nuk ka asnjë bazë dhe faji nuk është i anës sonë. Kjo gjë u shërben vetëm atyre që duan të mbajnë një gjendje tensioni në Ballkan.

Duhet theksuar se në gjendjen e përgjithshme të zonës së Ballkanit e të Adriatikut, vendosja kohët e fundit e bazave atomike e të raketave në Itali dhe në Greqi ka qenë element keqësimi dhe tensioni. Qeveria jonë i ka dënuar vendosmërisht këta hapa të rrezikshëm.

Duke zhvilluar miqësinë tradicionale që ka bashkuar popullin shqiptar me popujt vëllezër arabë, qeveria jonë ka vendosur marrëdhënie miqësie dhe bashkëpunimi me vendet arabe dhe është e gatshme që këto t'i zgjerojë më tej. Ne mendojmë se, si shtete mesdhetare që kanë fituar lirinë me luftë të ashpër kundër

imperializmit, të gjitha vendet tona kanë interes të forcojnë bashkëpunimin mbi bazat e bashkekzistencës paqësore, për të mbrojtur fitoret e tyre nga imperia-  
lizmi dhe për ta kthyer këtë pellg në një zonë paqeje, pa armë atomike e raketa, pa baza të huaja ush-  
tarake.

Republika Popullore e Shqipërisë tani bën pjesë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në 14 or-  
ganizata të tjera ndërkombëtare. Në këto forume, ajo është përpjekur dhe do të përpiqet kurdoherë përkrah vendeve të tjera paqedashëse të japë kontributin e saj në zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, ajo ka përkrahur dhe do të përkrahë kurdoherë luftën e drejtë nacionalçlirimtare të popujve të shtypur, çështjen e zhvillimit ekonomik e të përparimit të tyre shoqëror, ajo do të luftojë si edhe në të kaluarën me të gjitha energjitë për të siguruar paqen dhe për të larguar rrezikun e luftës atomike.

Shokë,

15-vjetorin po e festojmë me fitore të mëdha në të gjitha fushat. Atdheu ynë socialist është bërë një faktor paqeje, stabiliteti dhe përparimi në Ballkan e në Mesdhe. Perspektiva më të shkëlqyera çelen përpara popullit tonë. Një etapë e re hapet përpara nesh, etapa e ndërtimit të socializmit me ritme akoma më të shpejta. Partia ka besim të plotë se masat punonjëse të vendit tonë, të bashkuara më fort se kurrë rreth saj, do të shumëfishojnë përpjekjet e tyre që forcat prodhuese të vendit tonë të zhvillohen shumë më shpejt se deri

sot, që jeta e popullit shqiptar të bëhet akoma më e lumtur dhe e begatshme.

Rroftë 15-vjetori i Çlirimit të atdheut!

Lavdi popullit tonë heroik!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, organizatorja e lavdishme e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
Nr. 287 (3502), 29 nëntor 1959*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**MESAZH DREJTUAR NXËNËSVE DHE  
PEDAGOGËVE TË SHKOLLËS PEDAGOGJIKE  
«LUIGJ GURAKUQI» NË ELBASAN ME RASTIN  
E 50-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SHKOLLËS**

**30 nëntor 1959**

Të dashur nxënës, mësues dhe pedagogë të shkollës  
pedagogjike «Luigj Gurakuqi»

*Elbasan*

Ju përshëndes nga zemra dhe ju uroj nxehtësisht  
me rastin e 50-vjetorit të themelimit të shkollës suaj!

Ngritja e shkollës normale të Elbasanit në vitin  
1909, kur Shqipëria ishte akoma nën sundimin e push-  
tuesve otomanë, është një ngjarje e shënuar në histo-  
rinë tonë kombëtare. Ajo, si e para shkollë e mesme te  
ne, shënon një tjetër sukses të madh në përpjekjet  
heroike të rilindasve dhe të të gjithë popullit tonë li-  
ridashës e përparimtar për hapjen e sa më shumë shko-  
llave në gjuhën amtare.

Që nga ajo kohë ka kaluar gjysmë shekulli. Ngjarje  
shumë të rëndësishme janë zhvilluar gjatë kësaj kohe  
në vendin tonë. Por shkolla normale e Elbasanit, me-



gjithëse në kushtet e vështira të regjimeve antipopullore, u bë një vatër e rëndësishme kulturele dhe arsimore për edukimin patriotik të nxënësve të saj, të cilët, pasi mbaronin studimet, shpërndareshin dhe përhapnin dritën e arsimit e të kulturës në masat punonjëse të vendit tonë.

Gjatë Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare, që e udhëhoqi me guxim dhe urtësi Partia e lavdishme Komuniste Shqiptare, shkolla normale e Elbasanit u bë një çerdhe e rëndësishme e luftës për lirinë e atdheut. Nxënësit e normales së Elbasanit përqaftuan me dashuri të madhe rrugën që u tregoi Partia, u bashkuan me luftën e popullit dhe luftuan me trimëri deri në çlirimin e plotë të atdheut.

Partia jonë e lavdishme, e udhëhequr nga mësimet e ndritura të marksizëm-leninizmit, ka vlerësuar dhe i ka ngritur lart traditat e shkëlqyera luftarake dhe përparimtare të popullit tonë. Ajo çmon gjithashtu shumë edhe kontributin e madh që ka dhënë gjatë gjithë kohës së saj shkolla normale e Elbasanit për përhapjen e arsimit e të kulturës dhe të ideve patriotike, liridashëse e përparimtare në masat e popullit tonë.

Me respekt do t'i kujtojnë kurdoherë populli dhe Partia jonë emrat e drejtuesve dhe pedagogëve të tillë që kanë dhënë mësim në shkollën tuaj, si patriotin e shquar Luigj Gurakuqin, doktor profesor Aleksandër Xhuvanin etj., ose të nxënësve të asaj shkolle, si patriotin demokrat Avni Rustemin, të dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare, si Tomor Sinanin, Jordan Misjen, Abdyl Myzyrin e shumë të tjerëve.

Të gjithë ne, të dashur nxënës, mësues dhe pe-

dagogë, jetojmë sot në atdheun tonë të lirë, kur populli, i udhëhequr nga Partia, po ecën përpara me sukses në rrugën e ndritur të socializmit. Pardje, i gjithë populli ynë festoi me madhështi 15-vjetorin e Çlirimit dhe bëri me këtë rast bilancin e fitoreve shumë të mëdha të realizuara gjatë kësaj periudhe të shkurtër historike. Sukseset që ka arritur deri tani populli shqiptar janë shumë të mëdha dhe një e ardhshme akoma më e lumtur e pret atë. Por, për ta shpejtuar ritmin e ndërtimit të socializmit neve na duhen akoma më shumë njerëz të mësuar dhe në këtë çështje një rol të dorës së parë do të luani ju, të dashur nxënës të shkollës pedagogjike, që, pasi të mbaroni shkollën, do të shpërndaheni në të katër anët e atdheut për të mësuar djemtë dhe vajzat e popullit.

Populli do t'ju besojë juve gjënë më të shtrenjtë, fëmijët e tij për t'i mësuar dhe edukuar, brezin e ardhshëm të atdheut tonë. Detyra si arsimtarë të ardhshëm është që t'ia shpërbleni popullit këtë besim të madh me punë të palodhur, duke vënë të gjitha forcat për kryerjen e detyrës me ndërgjegje të lartë. Partia jonë e vlerëson lart detyrën fisnike të mësuesit, punën e tij shumë të rëndësishme dhe delikate, prandaj të keni kurdoherë parasysh që kur të mbaroni shkollën t'i përgjigjeni me entuziazëm dhe menjëherë thirrjes për të shkuar atje ku do të caktoheni, në çdo skaj të atdheut, të kryeni me nder misionin e lartë të arsimtarit të ri popullor dhe të justifikoni besimin e madh që kanë vënë mbi ju Partia dhe populli.

Por që ta kryeni si duhet detyrën, që tani në bankat e shkollës, bëni të gjitha përpjekjet që të mësoni sa

më shumë, të dëgjoni me vëmendje dhe kujdes mësimet që ju japin mësuesit tuaj, të zbatoni porositë dhe këshillat e tyre dhe t'i respektoni, sepse ata kujdesen për t'ju përgatitur arsimtarë të vlefshëm dhe të aftë për të mësuar dhe edukuar brezin e ri me njohuri të shëndosha dhe me frymë të lartë patriotike, ashtu sikurse e ka traditë shkolla juaj. Shtoni përditë dashurinë për popullin tonë heroik, për mësuesen dhe udhëheqësen e tij të sprovuar, Partinë e Punës.

Me keqardhje ju njoftoj se nuk mund t'jua plotësoj dëshirën për të marrë pjesë në këtë gëzim të përbashkët, pasi në këto ditë punët e Partisë nuk më lejojnë, por ju siguroj se me zemër do të jem me ju në këto çaste kaq të gëzueshme.

Ju uroj edhe një herë shëndet, jetë të lumtur dhe suksese sa më të mëdha në mësimet, për të mbajtur kurdoherë lart e më lart traditat dhe emrin e mirë të shkollës suaj!

I Juaji

*Enver Hoxha*

Sekretar i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 290 (3505), 3 dhjetor 1959*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## DITURIA DHE KULTURA NË SHQIPËRINË E RE SOCIALISTE JANË BËRË TË MASAVE

*Fjala në konferencën kombëtare për zhvillimin  
e mëtejshëm të kulturës në fshat*

16 dhjetor 1959

Më parë dëshiroj t'ju përshëndes nga zemra në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë sonë dhe t'ju uroj suksese të mëtejshme juve, njerëzve të kulturës dhe të arsimit të të gjithë Shqipërisë, veçanërisht të fshatit, në këtë detyrë të madhe e të shenjtë që ju kanë caktuar Partia dhe qeveria.

Kjo konferencë ka një rëndësi shumë të madhe dhe do të ndikojë në zhvillimin e mëtejshëm të kulturës në të gjithë vendin në përgjithësi dhe veçanërisht në fshat.

Ju e dëgjuat raportin që u mbajt këtu. Atje u paraqit drejt dhe në mënyrë reale gjendja e kulturës dhe e arsimit në fshatin tonë, me sukseset e mëdha dhe me të metat e mungesat që ekzistojnë akoma në punën tonë. Ky raport është njëkohësisht mobilizues dhe detyrat që shtrohen atje do të bëjnë që zhvillimi i arsi-

mit dhe i kulturës të marrë në të ardhshmen një hov akoma më të madh se deri tani.

Pa nënvleftësuar të metat tona dhe përpjekjet serioze që duhet të bëjmë në të ardhshmen, ne mund të themi se kultura në vendin tonë gjatë kësaj periudhe të shkurtër prej pesëmbëdhjetë vjetësh ka bërë një përparim të madh dhe tani ne kemi një bazë të shëndoshë ku të mbështetemi për të ecur më me vrull përpara. Koha dhe gjendja jonë kërkojnë që zhvillimi i arsimit dhe i kulturës të ne, veçanërisht në fshat, të ecin me ritme akoma më të shpejta. Diskutimet që u bënë në këtë konferencë vërtetojnë dhe sigurojnë realizimin e kësaj detyre shumë të rëndësishme. Por siguria më e madhe që kultura e vendit tonë të ecë me sukses dhe akoma më me vrull përpara, është populli ynë i mrekullueshëm e përparimtar dhe ideologjia marksiste-leniniste që e udhëheq.

Vendi ynë s'ka shumë kohë që e ka fituar pavarësinë, qoftë atë formale, qoftë pavarësinë e vërtetë e të plotë. Por populli ynë është një popull i lashtë, një popull i kulturuar dhe jobarbar.

Populli shqiptar gjatë shekujve ka luftuar për të mbrojtur veten si popull e si komb dhe kuptohet që njëkohësisht ai ka mbrojtur edhe kulturën e tij.

Zhvillimi i kulturës së popullit tonë të vogël, sigurisht nuk pati atë hov dhe atë shkëlqim që patën kultura e vjetër greke, ajo romake, bizantine ose kultura sllave. Por edhe kultura jonë, me gjithë peripecitë gjatë shekujve, ka kontribuar në kulturën e përgjithshme të njerëzimit.

Vetë fakti që populli ynë i vogël nuk u zhduk dhe

nuk u asimilua as nga popujt e mëdhenj që e robëruan dhe as nga kultura e tyre e zhvilluar provon se në këtë drejtim ka kontribuar, tok me rezistencën e armatosur, edhe kultura e popullit tonë.

Shumë popuj të mëdhenj, pa le të vegjël, janë zhdukur gjatë shekujve, janë asimiluar prej popujve të tjerë, kanë përqafuar krejtësisht kulturën e popujve të mëdhenj që e kishin robëruar. Fakte të tilla i vërteton historia. Qenia gjallë e popullit shqiptar, gjithashtu fakti që ne gjendemi këtu, kemi trashëguar brez pas brezi në shekuj dhe kemi ruajtur të paprekur gjuhën, artin, muzikën, zakonet tona origjinale dhe shumë interesante, vërteton se ne jemi një popull i lashtë dhe i pamundur.

Tendenca e shtypësve dhe më vonë e borgjezisë së vendeve të ndryshme ka qenë dhe është të fshijë të kaluarën e popujve të vegjël për t'i skllavëruar më lehtë, të fshijë kontributin e kulturës së këtij ose atij populli për të vënë në dukje dhe më me shkëlqim kulturën e vet kombëtare.

Monumentet e kulturës të kohëve të kaluara të popullit tonë sapo fillojmë t'i zbulojmë dhe t'i nxjerrim nga balta. Flas për ato zbulime arkeologjike, që i përkasin krejtësisht kulturës së popullit tonë. Por edhe në ato zbulime, ku duket influenca e theksuar e kulturës helene, romake ose bizantine, në shumicën e tyre, vërtetohet zotësia artistike e kulturele e të parëve tanë që kanë punuar në to, që kanë derdhur zotësinë, guston, mjeshtërinë e tyre të rrallë.

Gjithë popujt e botës gjatë shekujve kanë kaluar faza dhe momente, gjatë të cilave kultura e tyre herë ka

shkëlqyer, herë ka rënë në errësirë dhe dekadencë, për t'u rimëkëmbur përsëri. Sigurisht kuptohet se këto faza rënieje, për një popull të vogël dhe të shtypur siç ishte populli ynë, kanë qenë shumë më të gjata dhe shumë më shkatërruese.

Vetëm shkenca e lavdishme e marksizëm-leninizmit, arma e fuqishme dhe busulla e pagabueshme e klasës punëtore, ringjalli popujt, vlerësoi si duhet thesarin e madh të kulturës botërore në të gjithë shekujt, ringjalli dhe rilindi popullin tonë të vogël e të shtypur në shekuj. Ajo zbulon çdo ditë virtytet e larta dhe kulturën e lashtë të popullit tonë, bën që populli ynë i vogël sot të lulëzojë ekonomikisht, edhe nga ana kulturore, dhe të kontribuojë në ndryshimet rrënjësore ku po kalon njerëzimi, në rrugën e ndritur të socializmit dhe të komunizmit.

Por megjithatë, shokë, ne trashëguam nga e kaluara një prapambetje shumë të madhe në krahasim me popujt e tjerë. Kur popujt e tjerë kishin dalë nga errësira e mesjetës, kur kishin kaluar nga epoka e rilindjes, kur në vendet e tyre revolucioni demokratiko-borgjez solli në fuqi borgjezinë dhe rrëzoi feudalizmin, kur Revolucioni i madh Socialist i Tetorit përmbysi në një të gjashtën e botës pushtetin e borgjezisë, të feudalëve dhe të kapitalistëve të Rusisë dhe krijoi Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, pushtetin e fortë, të fuqishëm dhe të përparuar të punëtorëve dhe të fshatarëve, kur për historinë e njerëzimit u hap faqja më e ndritur, populli ynë lëngonte në mesjetë, nën thundrën e bejlerëve e të feudalëve mesjetarë, barbarë, injorantë,

shtypës e shfrytëzues me tërë kuptimin e vërtetë të fjalës mesjetare.

Shtypja, mjerimi, uria, pushtimet e kishin pllakosur popullin tonë, por asnjëherë nuk e kishin dekurajuar. Brezat e sotshëm të Shqipërisë u treguan vazhdues të denjë të stërgjyshërve të tyre të çelniktë, ata përballuan rrebeshe të mëdha. Komunistët shqiptarë e udhëhoqën popullin me lavdi në luftën e çlirimit dhe bënë që vendi ynë nga gjysmëfeudalizmi të kalojë në socializëm. Këtë e bëri Partia jonë e lavdishme, e bëri marksizëm-leninizmi, e bëri populli ynë i mrekullueshëm.

Rilindasit tanë të lavdishëm na kanë lënë një thesar të madh kulture që lulëzoi dhe ndriti nën një shtypje të egër dhe të errët. Ata luftuan, si ata, për lirinë e atdheut, për dituri dhe dritë. U shkri si qiri i madhi Naim Frashëri për t'i dhënë dritë Shqipërisë, për ta parë zonjë Shqipërinë. Për dituri luftonin Samiu i pavdekshëm, Koto Hoxhi e qindra njerëz të tjerë me mendje të ndritur, me guxim të pashoq e me zemër të pastër. Për shkollën shqipe, për alfabetin shqip, që ta mësonin djemtë e popullit, luftoi tërë jetën dhe u vra nga armiqtë mësuesi i lavdishëm Petro Nini Luarasi, u masakrua nga shovinistët grekë Papa Kristo Negovani, u persekutuan me mijëra të tjerë.

Por flamuri i tyre i lavdishëm nuk ra përdhe. Atë e ngritën lart e me lavdi partizanët nëpër male, e ngriti lart Partia jonë heroike, e ngriti lart populli, i cili nga një anë luftonte, mbronte pëllëmbë për pëllëmbë tokën e tij të shtrenjtë dhe nderin, e nga ana tjetër mësonte, mësonte, se e dinte që pas çlirimit, Shqipëria



e rrënuar duhej ndërtuar dhe për ta ndërtuar duhej dituri. Kjo ishte rruga që na mësonte Partia. Dhe fill pas Çlirimit dolën njerëz të lavdishëm si Ndrec Ndue Gjoka që i vunë shpatullat punës dhe dhanë jetën për të përhapur arsimin dhe kulturën në popull. Tani shokët e Ndrec Ndue Gjokës janë batalione dhe armata, jeni ju, shokë, janë me qindra e mijëra njerëz të popullit që pajisen me dituri e kulturë për ta bërë vendin tonë të lulëzuar, për të kapërcyer prapambetjen me atë hov madhështor siç kapërcyem etapat e historisë. Në heshtjen e varreve të tyre, të nderuar nga populli ynë, rilindasit kanë pse mburren me nipërit dhe stërnipërit e tyre. Dituria, për zhvillimin e së cilës ata u përpoqën, ka marrë hov të madh në Shqipërinë e re socialiste, ajo është bërë e masave, ajo s'është më stoli e disave, por është demokratizuar.

Ky demokratizim i kulturës u bë për arsye se në vendin tonë erdhi në fuqi klasa punëtore. Lëvizja revolucionare e klasës punëtore është ajo që në çdo kohë i ka dhënë dhe i jep kuptimin e vërtetë kulturës, kulturës me kuptim të dyfishtë, me kuptimin e dominimit të natyrës nga njeriu si dhe me kuptimin e drejtimit të shoqërisë. Kulturën e ndërtuan si murin duke vënë tullën mbi tullë, jo parazitët, jo dembelët, jo injorantët, por punëtorët e mendjes dhe të krahut. «Ajo forcë gjykimimi që i bën filozofët të ndërtojnë sisteme të ndryshme filozofike, ka thënë Marksi, bën gjithashtu që duart e punëtorëve të ndërtojnë hekurudhat dhe t'i vënë ato në lëvizje». Fabrikat dhe pallatet e Amerikës e të Anglisë i ka ndërtuar mendja dhe dora e punëtorit. Por sot ato shfrytëzohen nga miliardërit kapitalistë, të cilët

me mendjen dhe djersën e të tjerëve krenohen dhe fabrikojnë topa për t'i hedhur ata punonjës dhe punonjësit e të gjithë botës në zjarrin e luftës.

Por punëtorët, duke punuar në fabrikat kapitaliste, mësuan njëkohësisht shkencën e kundërt të «shkencës së shfrytëzimit». Atje punëtori u bë një filozof i tipit të ri dhe u edukua që mendimet e tij t'i mprehë si një armë e kalitur për bukuri për të përmbysur botën e vjetër të mjerimit dhe të shfrytëzimit të njeriut nga njeriu, për të hapur rrugën e një bote të re, botën e socializmit, botën e njeriut me ndjenja njerëzore.

Një fenomen i tillë historik i pashmangshëm ngjau në Bashkimin Sovjetik, ai ngjau në vendet tona të demokracisë popullore, e do të ngjasë në mënyrë të pashmangshme edhe në vendet e tjera ku sundon kapitali. Ky është ligj i historisë. Borgjezia e ka varfëruar si kuptimin e kulturës, ashtu edhe përhapjen e saj. Zhvillimin e kulturës borgjezia e përdor kryesisht si mjet për të shtuar pasuritë e saja, duke shfrytëzuar punonjësit dhe duke i mbajtur sa të jetë e mundur më shumë në errësi.

Në mbarim të shekullit të kaluar, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ekzistonte një ligj i tillë që çdo njeri që guxonte t'i mësonte një zezaku të shkruante dhe të lexonte, hante 40 kërbaçë mbi kurriz. Ky ligj kundër zezakëve vazhdon edhe sot në kohën e atomit. Borgjezia krijon kuadrot e saj kryesisht nga shtresat e veta. Por në pamundësi të bënte ndryshe, sepse po zhvillohej industria, ajo lejoi punëtorët të mësonin të shkruanin e të lexonin. Industria s'mund të ecte përpara pa krijuar kuadrot e lartë. Këta borgjezia i krijoi

nga shtresat borgjeze dhe një pjesë nga aristokracia e klasës punëtore.

Por megjithatë, kultura është kurdoherë një armë kundër shtypësve. Mos harroni fjalët e feudalit Fejzi Alizoti, që kishte frikë e tmerrohej nga shkolla dhe nga njerëzit e kulturës. Fejzi Alizoti përfaqësonte mesjetën, ndërsa Rokfelerët janë të një brumi tjetër, por për të dy këta tipa punëtorët në fabrika, zanatçinjtë me duar të arta, muratorët që ndërtojnë pallate, mekanikët që vënë në lëvizje trenat, bujqit që prodhojnë të mirat që dalin nga toka, janë njerëz injorantë e pa kulturë, kurse ata që përfitojnë nga këto prodhime të punonjësve, pa punuar, janë njerëz «me kulturë», u bëhen të gjitha nderet, ata janë «puset e shkencës».

Këtij mashtrimi kolosal marksizëm-leninizmi ia çori maskën. Vendet tona të socializmit janë shembull i ndritur, për klasën punëtore të të gjithë botës, i vërtetimit në praktikë dhe në jetë të kësaj çështjeje të madhe se kush është krijuesi dhe mbartësi i vërtetë i kulturës, punëtori apo kapitalisti shfrytëzues. Kapitalizmi rron me këta njerëz që i quan «xhahilë» dhe «pa kulturë». Këta njerëz «pa kulturë», pa të cilët kapitalizmi nuk mund të hedhë asnjë hap përpara, po i bëjnë varrin kapitalizmit.

Edhe në vendet kapitaliste, dashka s'dashka kapitalizmi, kultura i thyen barrikadat dhe caqet e caktuara prej tij, por përpjekjet e kapitalizmit për shtypjen e klasës punëtore e të kulturës së vërtetë revolucionare janë të mëdha. Ne shohim të mbijnë si kërpudhat lloj-lloj tendencash dekadente në kulturë, në art, në muzikë, në teatër, në kinema, në filozofi, në shkencë dhe

në të gjithë mënyrën e jetesës, të cilat të gjitha kanë për qëllim të trullosin kokën e njerëzve, t'i degjenerojnë ata, t'i korruptojnë, ta bëjnë punëtorin skllav të fabrikës, të mos ketë as kohë as forcë fizike të edukohet, të mësojë, të dëfrojë. Me një fjalë borgjezia bën çmos që të pengojë dhe të ngadalësojë ecjen përpara të botës, të shkencës revolucionare dhe njerëzore që do të sjellë revolucionin botëror, socializmin dhe komunizmin në të gjithë planetin tonë.

Partia jonë ka pasur kurdoherë sukses në punët e saja dhe ka suksese në zhvillimin dhe lulëzimin e arsimit e të kulturës, se e ka parë këtë çështje në rrugën marksiste-leniniste dhe ka punuar në këtë rrugë.

Prandaj, duke e parë me syrin e një marksisti këtë çështje, në vendin tonë, ne mund të themi se në lëmin e kulturës dhe të arsimit kemi bërë një përparim kolosal. Ky përparim nuk duhet matur vetëm me numrin e kuadrove të lartë, por me atë mori kuadrosh që deri dje ishin analfabetë e që ndërtuan këto fabrika dhe kombine të mrekullueshme, ndërtuan këto qytete krejt të reja, po drejtojnë me sukses fabrika krejt moderne, prodhojnë gjëra të mrekullueshme për popullin, çajnë male e ndërtojnë hidrocentrale, nxjerrin naftë nga nëntoka gjashtë-shtatë herë më shumë nga sa nxjerrnin italianët në kohën e tyre, njerëzit tanë po thajnë moçale e liqene, mbajnë në duart e tyre armët më moderne, drejtojnë aviona e anije, po ndërtojnë dhe drejtojnë hekurudha, ndërtojnë rrugë të reja, zhvillojnë me sukses bujqësinë në rrugën e socializmit, drejtojnë shkolla në të katër anët e vendit, institute të larta, universitetin, shërojnë me sukses sëmundjet e popullit,

forcojnë dhe kalitin fizikisht njerëzit e Shqipërisë së re. Ky është hopi kolosal që ka bërë populli shqiptar në lëmin e arsimit, të kulturës, nën udhëheqjen e ndritur të Partisë. Dhe të gjitha këto i kemi arritur vetëm në 15 vjet.

Miqtë dhe dashamirësit e Shqipërisë që vijnë e i shikojnë këto, gëzohen dhe habiten. Me zjarr e me dashuri flasin për sukseset tona shokët dhe miqtë tanë sovjetikë, kinezë, çekë, polakë, bullgarë, etj. Me simpati të madhe flasin miqtë e Shqipërisë që kanë vizituar vendin tonë, qofshin këta francezë, italianë, arabë, indianë, indonezianë, amerikanë dhe anglezë.

Mjaft libra realistë shkruhen në shumë vende për Shqipërinë, por do të përmend disa radhë nga libri i një miku të shtrenjtë francez, udhëheqës i Partisë Komuniste Franceze dhe udhëheqës i vjetër i regjur i klasës punëtore franceze. Ky mik që quhet Gaston Monmuso, ka shkruar një libër për Shqipërinë me titull «Baba Tomorri». Pasi tregon ndjenjat e tija të zjarra për popullin shqiptar, ai thotë në një vend se rrugët tona për plakun Monmuso janë «ca të këqija» dhe shton duke iu drejtuar grave të Parisit: «Mos i mblidhni buzët, zonja të Parisit, për këtë që them. Parisit, për të qenë ai që është sot, i janë dashur 16 shekuj. Ju kërktoj vetëm 10 vjet afat për Shqipërinë dhe pas dhjetë vjetësh ju mund të vini të hidhni valle në rrugët e Shqipërisë edhe me këpucë me taka të larta».

Pra kemi plotësisht të drejtë kur themi që në saje të Partisë, në vendin tonë, kultura është bërë e masave të gjera të popullit, është demokratizuar, s'është një kulturë iluministe dhe akademike, por një kulturë e

lidhur ngushtë me prodhimin, për prodhimin, e lidhur ngushtë me të gjithë popullin dhe vetëm për popullin.

Kjo ka bërë, shokë, që ne të bëjmë hapa përpara në zhvillimin e ekonomisë sonë socialiste dhe popullore, të ngremë çdo vit mirëqenien e popullit.

Komiteti Qendror i Partisë do të mbledhet pas disa ditësh për të shqyrtuar realizimin e planit për katër vjetët e parë të planit tonë të dytë pesëvjeçar dhe do të shtrojë detyrat e planit për vitin e ardhshëm, viti i fundit i planit të dytë pesëvjeçar. Ç'del nga studimet e bëra? Vëllimi i përgjithshëm industrial realizohet si pesëvjeçar, jo vetëm qind për qind, por do të tejkalohet 8 për qind më shumë se detyrat e Kongresit III të Partisë. Investimet dhe ndërtimet tejkalohen 37 për qind më shumë nga detyrat që caktoi Kongresi dhe 97 për qind në krahasim me detyrën e caktuar nga Plenumi i Shkurtit i vitit 1958. Po kështu realizohet dhe tejkalohet transporti. Ngritja e nivelit material dhe kultural të punonjësve realizohet sipas vendimeve të Kongresit. Vetëm plani i bujqësisë nuk realizohet. Ai do të arrijë rreth 88 për qind.

Këto realizime u arritën me përpjekje të mëdha nga ana e Partisë dhe e të gjithë punonjësve. Ne korrëm suksese, po kemi edhe shumë të meta në punë që duhet t'i përmirësojmë, t'i korrigjojmë. Kjo do të bëhet me një punë më të kujdesshme, me një dituri dhe zotësi akoma më të madhe që duhet ta fitojmë në punë dhe në shkollë. Ne duhet të mobilizojmë të gjitha forcat tona për realizimin dhe tejkalimin e planit të vitit 1960 që të plotësojmë kështu deficitet e krijuara nga vjetët e mëparshëm dhe të përgatitemi për betejat e ardhshme që

do të shtrohen në planin e tretë pesëvjeçar që do të aprovohet në Kongresin IV të Partisë sonë i cili do të mbahet vitin e ardhshëm. Plani i ardhshëm pesëvjeçar do të jetë një hap tjetër vigan përpara në zhvillimin e forcave prodhuese të vendit tonë, në zhvillimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të industrisë sonë që do të pasurohet me fabrika dhe kombinatë të reja, në mes të të cilave do të figurojnë fabrikat e plehrave kimike, kombinati i ferrc-kromit, fabrika e re tekstile e shumë të tjera. Vendit tonë do t'i shtohen hidrocentrale të reja, do t'i shtohen sipërfaqe të reja toke të punueshme, do t'i shtohen prodhimet industriale dhe bujqësore, do t'i shtohen dhe do të përmirësohen shkollat, teatrot, shtëpitë e kulturës, kinematë etj. Jeta do të bëhet më e lumtur, më e gëzuar dhe më e begatshme për popullin tonë.

Të gjitha këto do të bëhen një realitet i madh për arsye të vijës së drejtë të Partisë dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik e të të gjitha vendeve të tjera të demokracisë popullore. Këto do t'i bëjë realitet popullin ynë i mrekullueshëm, me klasën e tij heroike punëtore në krye. Prandaj ne duhet të mobilizojmë tërësisht forcat tona fizike dhe mendore, t'i shtojmë çdo ditë këto forca, të shtojmë njohuritë dhe dituritë tona dhe të organizojmë mirë punën, se pa këto kushte asgjë e mirë nuk mund të dalë.

Këtu e ka qëllimin edhe konferenca që mbajmë sot. Kjo konferencë, punimi i materialeve të saj në bazë dhe ndjekja këmba-këmbës e detyrave të vëna përpara punonjësve është e lidhur me krijimin e të mirave materiale për njerëzit. Kjo nuk është një mbledhje

e shterpët, por një përgatitje për punë të vrullshme, veçanërisht në fshat.

Raporti që u mbajt në këtë konferencë vuri në dukje prapambetjen serioze dhe të madhe që ekziston akoma në fshatin tonë, gjë që krijon vështirësi të mëdha për zhvillimin me ritme më të shpejta të ekonomisë sonë. Të tilla vështirësi te ne nuk ka vetëm në fshat. Të tilla vështirësi ne kemi akoma edhe në qytet. Prandaj si në fshat, ashtu edhe në qytet detyrat për të kryer janë të mëdha e në radhë të parë nga ana e klasës punëtore dhe e inteligjencies së vendit tonë.

Klasa punëtore ka për detyrë të forcojë mirë organizimin në punë. Për këtë qëllim ajo duhet të zhvillohet dita-ditës më shumë nga ana kulture dhe të shtojë zotësitë e veta. Punëtorët tanë të mrekullueshëm nuk duhet të kënaqen me ato dituri që kanë fituar deri sot. Përkundrazi ata duhet të bëjnë përpjekje të reja edhe më të mëdha në këtë drejtim. Tani shteti dhe Partia jonë kanë krijuar mundësi të tilla për klasën punëtore dhe për të gjithë punonjësit e vendit tonë që ata të zhvillojnë shpejt dhe në shkallë të gjerë dituritë dhe njohuritë e tyre.

Në prodhim ne shohim akoma të meta që vijnë nga pakujdesia ose nga mungesa e njohurive. Prandaj duke rritur vazhdimisht kujdesin dhe duke shtuar njohuritë, këto të meta që ekzistojnë do të zhduken gradualisht dhe puna në fabrika e kudo do të përmirësohet, prodhimi do të bëjë hapa të rinj përpara si në sasi ashtu edhe në cilësi sidomos, do të ulët kostoja e prodhimit dhe populli do të ketë mundësi të blejë më shumë se deri tani. Kjo është një detyrë



e madhe e klasës sonë punëtore dhe e të gjithë punonjësve të qytetit.

Po vështirësitë të ne janë akoma më të mëdha në fshat. Me gjithë sukseset e mëdha që janë arritur në fshatin tonë, ne atje jemi akoma prapa. Po fshatari ynë është i mrekullueshëm, përparimtar; ai ka etje për dituri dhe kulturë dhe u vihet atyre me gjithë shpirt. Me gjithë prapambetjen që i ka lënë e kaluara, fshatari ynë nuk është prapanik. Vetëm fakti i kolektivizimit të bujqësisë, në një shkallë të tillë sa është arritur deri tani në fshatin tonë, tregon ngritjen e ndërgjegjes dhe të nivelit kultural të masave fshatare të vendit tonë pas Çlirimit.

Në vende të tjera të botës që janë më të përparuara ka akoma krahina ku sundojnë ligjet e mesjetës. Edhe në një vend të tillë të qytetëruar si Franca, në krahinën e Vandesë, ku sundon klerikalizmi më i zi, fshatari, jo vetëm paguan taksa të rënda, po i çon agait të tij, «zotnisë», sikurse i thonë atje, prodhime në natyrë, si pula, mish etj. Po ka edhe më keq. Atje fshatari i bën zotnisë punë të detyruar, ai punon në kanalet e kështjellës ose në kopshtet e pallatit të zotnisë së tij.

Ndërsa fshatarësia jonë është e përparuar, sepse ajo rrëzoi të vjetrën dhe doli fitimtare mbi ndjenjën mikroborgjeze të pronës private. D.m.th., ajo, jo vetëm u dha grushtin dërrmues bejlerëve dhe agallarëve, por bashkoi tokat dhe krijoi ekonomitë e mëdha kolektive. Kësaj i thonë fshatarësi përparimtare. Ajo me të dy këmbët po hyn në rrugën e socializmit me vullnetin e saj të plotë, ashtu sikurse na ka mësuar Lenini i madh.

Fshatari ynë e kuptoi rëndësinë e madhe ekonomike që sjell bashkimi i tokës dhe i mjeteve të punës. Ai kuptoi përfitimet e mëdha që sjell puna e përbashkët, në lëmin ekonomik, politik, kultural dhe shoqëror. Njerëzit prapanikë, ata që i janë mbërthyer së vjetrës, pronës së vogël individuale, nuk mund të dalin në këtë rrugë të ndritur.

Ndokush mund të pyesë: «Më e zgjuar, apo më e kulturuar doli kjo fshatarësia jonë nga fshatarësia amerikane, italiane apo ajo jugosllave?» Faktet tregojnë vetë. Bujqit amerikanë po i likuidon kapitalizmi dhe po i hedh në rrugën e madhe të papunësisë. Në fermat e kapitalistëve amerikanë niveli agroteknik, ai i mekanizimit dhe i prodhimit është i lartë, por në ato ferma sundon ligji shfrytëzues kapitalist mbi ata bujq punëtorë që punojnë në to. Vendet tona socialiste, kush më parë e kush më pas, do t'ua arrijnë dhe do t'ua kalojnë sepse ekziston ndryshimi rrënjësor që në kooperative tona zot i tokës, i pasurisë, i të ardhurave, i përparimit është vetë fshatari dhe as beu as agai as Garsti<sup>1</sup>.

Format josocialiste në bujqësinë jugosllave bëjnë që fshatari jugosllav të rrojë shumë keq dhe çdo vit që do të shkojë, akoma më keq do të rrojë, sepse zhvillimi i bujqësisë në atë vend forcon pozitat e pasanikëve të fshatit, në kurriz të fshatarësisë së varfër e të

---

<sup>1</sup> Rosuell Garst, fermer milioner amerikan, i specializuar në rritjen e misrit. Mik personal i N. Hrushovit. Fermën e tij Hrushovi e konsideronte si model për zhvillimin e bujqësisë në BRSS.

mesme, i ka hapur të dyja portat spekulimit dhe shfrytëzimit të fshatarësisë.

«Çuditi botën përparimi i bujqësisë jugosllave» — tha në një miting që mbajti në një rrugë presidenti i Jugosllavisë, por nga ana tjetër bërtet e i kërcënon fshatarët se hambarët e shtetit po presin më kot prodhimin e trumbetuar me kaq bujë dhe nuk do të çuditemi ndonjë mëngjes që kjo «bujqësi jugosllave që çuditi botën» të kërkojë nga Amerika t'i vijë në ndihmë me drithë.

Ne kemi shumë e shumë për të bërë në bujqësinë tonë. Duhet të punojmë shumë për ngritjen e ndërgjegjes dhe të kulturës në fshatin tonë, po këto janë vështirësi të kuptueshme të rritjes. Sistemi ynë shoqëror na i ka hapur portat e begatisë dhe të përparimit ekonomik e kultural.

Shokë, fshatarësia jonë e prapambetur, që rronte përpara 15 vjetësh në kushtet e vështira të shfrytëzimit, ka akoma mjaft mbeturina përsa i përket kuptimit të drejtë të punës. Ky duhet të bëhet një problem i madh nga ana e Partisë dhe e punonjësve të arsimit dhe të kulturës në fshatin tonë. Fshatari ynë duhet të kthejë fytyrën nga puna, ta dojë atë me gjithë shpirt dhe të kuptojë se ajo është shpëtimi i tij, i familjes së tij dhe i atdheut.

Partia, njerëzit e kulturës dhe të artit, të vënë të gjitha forcat në shërbim të prodhimit, por edhe në edukimin e fshatarëve, jo vetëm për pranimin e formave të reja në bujqësi, të agroteknikës, të përdorimit si duhet të mekanikës bujqësore, të zgjedhjes së farërave, etj. etj. që duhen për një kulturë të lartë prodhuese intensive, po t'u qëndrojnë afër fshatarëve, t'i mësojnë

që ata t'i vënë në jetë sa më parë dhe sa më mirë. Përhapja gjithnjë më e madhe e kulturës dhe e arsimit në fshat do të luajë një rol vendimtar në këto çështje shumë të rëndësishme për ekonominë tonë popullore.

Unë dua të theksoj këtu rolin e rëndësishëm që duhet t'u caktojë Partia arsimtarëve. Dihet se roli i mësuesve në fshat është i madh. Mësuesit tanë të jenë të ndërgjegjshëm për këtë besim të madh që u japin atyre Partia dhe shteti. Por mësuesit duhet, së pari, vetë të thellojnë njohuritë e tyre dhe të mos mendojnë se mbarimi i shkollës për ta është gjithçka. Çdo mësues i ndërgjegjshëm nuk duhet të mjaftohet me ato që ka mësuar në shkollë ose me ato që u jep përditë nxënësve të vet. Ai duhet të zgjerojë vazhdimisht njohuritë e tija, veçanërisht ato që kanë lidhje me ekonominë fshatare. E kam fjalën këtu për ata mësues që punojnë në fshat. Mësuesi duhet ta shikojë fshatin si shtëpinë e tij, të jetë i lidhur me nxënësit, me vajzat dhe djemtë e popullit që mëson dhe edukon përditë. Ai duhet ta shohë të ardhshmen e fshatit ku punon, me atë zell që punon për të krijuar njeriun e ri. Prandaj syri i mësuesit të jetë syri i Partisë në fshat për të ndihmuar zhvillimin e fshatit në të gjitha drejtimet.

Kur flas për mësuesit më kujtohet kurdoherë një fjalë e Dimitrovit. Kur u çlirua Bullgaria, një gazetar amerikan i kërkoi atij një intervistë dhe në mes të tjerave e pyeti nëse i pëlqente detyra që i kishte ngarkuar populli, dhe sikur ta pyesnin, çfarë profesioni do të dëshironte të ushtronte, cilin do të zgjidhte. Dimitrovi iu përgjigj se ai ishte ushtar i partisë dhe i popullit dhe do të punonte atje ku e kishin ngarkuar, po

sikur ta lejonin ai do të dëshironte të bëhej mësues në fshat. Revolucionari i madh, udhëheqësi i lavdishëm i proletariatis ndërkombëtar, bir i klasës punëtore bullgare, në kohën e pleqërisë kishte dëshirë të zjarrtë të bëhej mësues në fshat.

Shokë mësues, ju do të jeni krenarë kur në të ardhshmen djemtë dhe vajzat e popullit, që vetë do t'i keni mësuar dhe edukuar me dashuri të pakufishme për popullin, Partinë dhe atdheun, do t'i keni pajisur me shkencë, do të jenë inxhinierë për të ndërtuar rruga, ura, hidrocentrale e fabrika, agronomë për të shtuar me bollëk prodhimet bujqësore dhe blegtorale për popullin, mjekë për të shëruar sëmundjet e popullit, mësues dhe profesorë për të përhapur diturinë në popull. Kjo do të jetë një kënaqësi e madhe për ju. Ju do të jeni krenarë, ashtu sikurse janë sot krenare mësueset plaka sovjetike që në izbat e errëta të Rusisë, në shi, në borë e në të ftohtë mësonin me dashuri bijtë e punëtorëve dhe të muzhikëve që çliruan popullin e tyre nga robëria, që bënë të fitonte Revolucionin i madh i Tetorit, mësonin shkencëtarët e mëdhenj që shpikën raketat, sputnikët etj.

Prandaj, shokë mësues, të lidhur ngushtë me popullin dhe me partishmëri vazhdoni të mësoni e të edukoni si duhet brezin tonë të ri, filizat e ardhshëm të Shqipërisë, ndërtuesit e socializmit dhe të komunizmit. Të jeni kudo përkrah Partisë në shkolla, në shtëpitë e fshatarëve, në vatrat e kulturës, të cilat me ndihmën tuaj të bëhen qendra të rëndësishme të përhapjes së kulturës së re në fshatin tonë.

Për fat të keq para çlirimit ne nuk na kanë lejuar

dërit e tyre, të mburren për Partinë që edukoi të tillë prindër, të cilët u dhanë po atë edukatë të shëndoshë fëmijëve të tyre.

Për punëtorët dhe fshatarët që janë në fuqi, për shokët dhe bijtë e tyre që kanë mësuar nëpër shkolla, për rininë, për gruan duhet ditur se shkenca dhe dituria s'kanë mbarim dhe se kultura e tyre speciale duhet të shoqërohet jo vetëm me nocionet e gramatikës dhe të llogaritjeve, por edhe me nocionet e përgjithshme të historisë, të politikës, të ekonomisë politike. Të lexosh do të thotë të njohësh botën, historinë e saj, historinë e luftërave të popujve, shpikjet e shkencëtarëve. Prandaj të përvetësohen këto, të zbatohen në jetë dhe të zhvillohen më tej. Këtu qëndron detyra jonë, këtu e ka qëllimin lufta e përditshme e Partisë sonë, këtë qëllim ka edhe kjo konferencë që po bëjmë ne sot. Ajo nuk bëhet vetëm për arsimtarët dhe njerëzit e kulturës në fshat, por për të gjithë inteligjencien tonë të fshatit dhe të qytetit.

Ne kemi një inteligjencie të re, të pastër, dinamike, që i kupton mirë çështjet politike e ideologjike dhe është e lidhur ngushtë me Partinë dhe me popullin. Por tendencave borgjeze dhe mikroborgjeze në disa nga intelektualët tanë ne duhet t'u vëmë fre, kurdoherë që të shfaqen, dhe t'i zhdukim. Inteligjencia duhet ta kuptojë se dituria nuk është kurrë e mjaftueshme. Prandaj njeriu çdo ditë dhe në çdo rast duhet të mësojë dhe nuk duhet humbur kohë.

Të gjithë njerëzit e arsimit, të shkencës, të artit etj., të mos mendojnë se kultura është një armë vetëm për ta, një armë për të çarë rrugën për vete dhe të

kapardisen. Jo, nuk duhet menduar kështu. Ajo është një armë e popullit dhe në shërbim të popullit. Në qoftë se dikush ka marrë dituri, duke mbaruar shkollë të lartë, duhet që këtë dituri ta vërë në shërbim të popullit. Këtë gjë duhet ta ketë kurdoherë parasysh inteligjencia jonë popullore.

Lidhjet me popullin për të gjithë njerëzit e artit, të kulturës dhe të shkencës duhet të jenë sa më të ngushta. Mësuesit, agronomët, punonjësit e shëndetësisë, inxhinierët, shkrimtarët, poetët e të tjerë të jenë pranë popullit, të luftojnë ditë për ditë, së bashku me popullin. Ky duhet të jetë drejtimi, busulla e përditshme në punën e tyre. Secili prej tyre duhet të mendojë kurdoherë: Puna ime a i ka shërbyer drejt dhe si duhet popullit? Analiza në këtë drejtim duhet bërë gjithnjë dhe, kur të shikojë se puna që ka bërë i ka shërbyer çështjes së madhe të popullit, vetëm atëherë ai duhet ta ndjejë veten të kënaqur.

Njerëzit e inteligjencies sonë duhet të jenë të thjeshtë, ashtu sikurse është i thjeshtë populli, ashtu siç është e thjeshtë klasa jonë punëtore. Ata të marrin shembull nga klasa punëtore dhe të jenë si ajo, besnikë ndaj çështjes së madhe të popullit, njerëz të sakrificës. Dhe ne e kemi një inteligjencie me cilësi të tilla.

Por ka edhe disa që, për fat të mirë, janë shumë të paktë, të cilëve u rritet mendja dhe nuk venë në fshat, nuk shkojnë të punojnë pranë puseve të naftës po duan të bredhin nëpër bulevardet dhe rrugët e asfaltuara të Tiranës. Dhe këta kanë mbaruar shkolla të larta. Njerëz të tillë duhen sjellë në rrugë të drejtë. Këta duhet të dinë se rrugët e asfaltuara të Tiranës, ku

ata duan të bredhin, janë ndërtuar me atë baltë në të cilën partizanët tanë rrëshqitnin të gjakosur për të mbrojtur atdheun tonë pëllëmbë për pëllëmbë, janë shtruar me asfaltin që nxjerrin minatorët nga thellësitë plot lagshti të nëntokës sonë. Kështu punon e gjithë klasa jonë heroike punëtore, ajo lodhet dhe sakrifikon për t'ia bërë jetën më të bukur popullit, sakrifica të mëdha ka bërë klasa punëtore pikërisht për të mësuar këta njerëz. Prandaj me çështjen e klasës punëtore dhe të popullit nuk duhet luajtur, klasa punëtore është shumë zemërgjerë, por, po e zëmërove, ajo ta vesh me dorën e saj të çelniktë sa të të vijë mendja një qind herë rrotull.

Ne, shokë, në shumicën dërrmuese kemi specialistë të zot, të mrekullueshëm dhe besnikë të popullit, qofshin ata të vjetër ose të rinj. Ne kemi mjekë, inxhinierë, agronomë, artistë të mrekullueshëm, pedagogë dhe mësues me eksperiencë. Të gjithë punojnë dhe kanë bërë përparime të mëdha. Artistët dhe shkrimtarët tanë, brenda një kohe të shkurtër, megjithëse kanë stazh të ri, kanë nxjerrë vepra të bukura. Por duhet thënë se zotësia dhe aftësia e tyre duhet të zhvillohet akoma. Prandaj të gjithë këta artistë, shkrimtarë, punonjës të kulturës duhet të punojnë në mënyrë që e gjithë puna e tyre të jetë për popullin, të shprehë realisht ndjenjat, aspiratat, përpjekjet, vështirësitë dhe fitoret e popullit, të jetë një nxitëse dhe mobilizuese për fitore akoma dhe kurdoherë më të mëdha për punonjësit tanë.

Punonjësit e qytetit duhet të bëjnë përpjekje që fshatin ta ndihmojnë me të gjitha forcat. Lidhjet fshat-



-qytet të mos jenë formale, po reale. Roli i klasës punëtore të jetë në çdo rast edukues për fshatarësinë. Prandaj punëtorët e fabrikave, të uzinave të kenë kontakte të ngushta me fshatarët. Ta bëjmë fshatin tonë të bukur dhe të përparuar si edhe qytetin. Në këtë drejtim ne duhet të luftojmë vazhdimisht.

Ne duhet të luftojmë ashpër kundër tendencave burokratike dhe shfaqjeve dekadente e demoralizuese të kulturës së degjeneruar borgjeze, si dhe kundër tendencave mikroborgjeze e borgjeze që shfaqen te njerëzit. Të ndërtojmë çdo ditë njeriun e ri ashtu si thuhet në këngën që këndonim gjatë kohës së luftës, kur Partia krijoi njeriun e çelniktë që i dha përgjithmonë lirinë popullit, dhe sot njeriun e ri që ndërton socializmin.

T'i ruajmë dhe t'i zhvillojmë thesaret e kulturës sonë kombëtare, po në punën për zhvillimin e kulturës sonë, të kemi kurdoherë përpara si pasqyrë kulturën e lavdishme sovjetike, të mësojmë nga ajo, sepse ajo është kultura më e përparuar në botë. Gjithçka në kulturën sovjetike është shtruar dhe është zgjidhur në bazë të parimeve marksiste-leniniste, d.m.th. që t'i shërbejë popullit, mirëqenies së tij, ngritjes së ndërgjegjes dhe të kulturës së tij, ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit. Te kultura sovjetike njerëzit tanë të rinj do të gjejnë, të pastruar nga çdo mbeturinë, nga çdo falsitet i shkencës borgjeze, pasurinë e madhe kolosale të të gjithë shkencës botërore.

Ne nuk jemi kundër kulturës perëndimore, të asaj kulture që ka ndihmuar në përparimin e njerëzimit. Ne jemi vetëm kundër kulturës së degjeneruar borgje-

ze. Shkencëtarët, filozofët e mëdhenj materialistë, shkrimtarët dhe kompozitorët e mëdhenj të vendeve perëndimore janë shumë të afërt për ne, ashtu sikurse janë edhe për popujt e tyre. Kultura e vendeve socialiste, kultura e vendit tonë i vlerëson ata dhe ua bën të njohur masave të gjera punonjëse, e jo vetëm kaq, por ajo kalon më tej duke i dhënë artit një formë dhe përmbajtje të re socialiste.

Çdo punë që bëjmë duhet ta fillojmë kurdoherë me frymë partishmërie. Prandaj me të gjitha forcat duhet të mësojmë, të mësojmë marksizëm-leninizmin. Kjo është kryesore dhe vendimtare për zgjidhjen e drejtë të çdo problemi në punën tonë. Po të largohemi nga kjo rrugë do të gabohemi dhe do të qorollisemi. Interesat e popullit kërkojnë që çdo njeri në punën e tij gjithçka ta shikojë në frymën e Partisë, sepse Partia është ajo që bën të lulëzojë atdheu dhe të ndërtohet socializmi e komunizmi, jeta e lumtur dhe e begatshme për popullin.

Detyra e Partisë në fushën e kulturës, ashtu sikurse në të gjitha fushat e tjera, është kolosale. Ajo është e lavdishme pse është për popullin, për lumturinë dhe mirëqenien e tij. Komunistët për këto qëllime të larta nuk duhet të njohin ç'janë mungesat dhe vështirësitë, po t'i përballojnë dhe t'i kapërcejnë ato me vendosmëri. Kjo është një luftë e madhe dhe luftërat nuk i kanë trembur kurrë komunistët. Jetën e tyre ata qysh gjatë kohës së luftës ia kushtuan çështjes së madhe të popullit dhe tani ata janë gati dhe e vënë në shërbim të popullit e të atdheut të tyre të lirë socialist. Nën drejtimin e Partisë sonë të lavdishme të ecim përpara me hov të

madh, të zhdukim prapambetjen dhe të ngremë sa më lart kulturën e popullit tonë të mrekullueshëm.

Shqipëria e popullit është një vend i lirë dhe sovran. Fjala e Shqipërisë së vogël, ka peshën e saj të madhe, dashkan ose s'dashkan imperialistët dhe rrymat e ndryshme revizioniste e oportuniste që i shërbejnë kapitalizmit.

Popujt e vendeve të kampit të socializmit, që zgjodhën dhe vendosën regjimet socialiste në vendet e tyre, zgjodhën atë regjim dhe atë mënyrë jetese që u pëlqeu, që ishte më i miri, më i përparuari, pse çliroi njerëzit nga shtypja dhe shfrytëzimi barbar kapitalist.

Regjimin tonë asnjëri nuk na e imponoi me forcë dhe askujt s'ia imponojmë me forcë. Në vendin tonë, ata që u përpoqën me të gjitha mjetet t'i impononin me forcë dhe me gjakderdhje popullit regjimin barbar të shfrytëzimit dhe të mjerimit shekullor, ne i dërrmuam përgjithmonë dhe i lamë hesapet me ta.

Revolucioni nuk importohet, por mbarset në vend. Ashtu si mëma që e do me gjithë shpirt dhe e mbron nga çdo rrezik e sëmundje fëmijën e vet, dritën e syve të saj, ashtu edhe populli e mbron me të gjitha forcat e veta pjellën e revolucionit të tij popullor, regjimin socialist, dhe e ruan atë me vigjilencën më të madhe nga lakmitë imperialiste, nga intrigat dhe sëmundjet që në këtë rast nuk quhen tifo apo tuberkuloz, por revizionizëm, oportunistizëm e të tjera rryma si këto që janë variantet e kancerit kapitalist.

Çdo popull është i lirë dhe është i zoti vetë të zgjedhë formën e regjimit që i pëlqen; askush s'ka të drejtë të ndërhyjë në punët e brendshme të tjetrit.

Beta kapitaliste dhe revizionistët e Beogradit, jo vetëm që e kanë zili kompaktësinë e vendeve tona të socializmit, që udhëhiqen nga parimet e drejta humanitare, por ata veprojnë me të gjitha forcat në shumë drejtime: të shkatërrojnë kampin tonë të socializmit, të konsolidojnë kampin e tyre të imperializmit, që është i tronditur thellë e që brehet tmerrësisht nga kontradikta të brendshme.

Po këtyre qëllimeve imperialistët dhe ndihmësit e tyre revizionistë nuk do t'ua arrijnë, pse kohët kanë ndryshuar dhe popujt janë zgjuar.

Lufta është e huaj për popujt e vendeve tona dhe për të gjithë popujt e botës. Vetëm popujt janë vrarë, shfarosur dhe dërrmuar nga luftërat për shkak të mbretërve, lordëve dhe të mbretërve të topave. Gjaku i popujve i ka shërbyer për t'u pasuruar një grusht njerëzish, për të jetuar këta në bollëk dhe në kurrizin e popujve. Këta zullumqarë dikur i gënjenin lehtë turmat e popujve për t'i çuar në kasaphanë. Por tani s'është e lehtë dhe as me formulat e tyre të maskuara, as me formulat hipokrite të kishës, as me lutjet e zotit nuk mund t'i gënjejnë dot popujt si më parë të shkojnë në kasaphanë për hatërin e miliardëreve.

Fashizmi gjerman, fashizmi italian dhe militarizmi japonez hodhën botën në zjarrin e Luftës së Dytë Botërore, gjatë së cilës u vranë me dhjetëra milion njerëz dhe u dogjën pasuri kolosale të ndërhuara me djersën e njerëzve. Imperializmi botëror e mëkëmbi kuçedrën fashiste dhe më në fund e ndërseu kundër Bashkimit Sovjetik, kundër popujve që ndërtonin në paqe një jetë më të mirë dhe më të begatshme.

Ideja e bashkekzistencës paqësore në mes vendeve me regjime të ndryshme është dëshirë e vjetër e popujve, është ideja gjeniale e Marksit dhe e Leninit, e Partisë së lavdishme Bolshevike para Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore sikundër është dëshira edhe e popujve tanë që fituan lirinë, e partive tona marksiste-leniniste, e regjimeve tona socialiste.

Paqe në mes popujve — deklaroi Lenini me dekretin e parë të pushtetit sovjetik, porsa triumfoi Revolucioni i madh Socialist i Tetorit. Por imperialistët jo vetëm që s'e donin paqen, por iu vërsulën për ta mbytur që në embrion shtetin paqësor të punëtorëve që me trimëri fliste dhe luftonte për paqen e njerëzimit.

Pas katastrofës së Luftës së Parë Botërore, njerëzimi duhej të shkonte drejt paqes dhe të shëronte plagët e luftës. Vetëm Bashkimi Sovjetik luftonte me të gjitha forcat për të siguruar këtë paqe. Të rrosh në paqe do të thotë të zhdukësh shkaqet e luftërave dhe mjetet e luftës. Shkaqet e luftërave janë lakmitë grabitqare të imperialistëve, janë qëllimet e tyre për të shtypur popujt dhe për t'i shfrytëzuar ata. Dhe këtë ai e bën me forcën e armëve. Prandaj kuptimi i paqes për ta është «paqe imperialiste» që i përngjet «paqes romake».

Pas Luftës së Dytë Botërore, njerëzimi duhej të shkonte drejt paqes dhe të shëronte plagët e luftës. Vetëm Bashkimi Sovjetik dhe vendet e kampit të socializmit luftuan me të gjitha mjetet për të mbrojtur paqen e njerëzimit, për bashkekzistencën paqësore, kundër luftërave grabitqare të imperialistëve, kundër garës së armatimeve dhe ndërhyrjeve brutale të imperialistëve në punët e brendshme të popujve të tjerë

që luftojnë për t'u çliruar nga zgjedha e kapitalistëve dhe e kolonialistëve.

Imperialistët, duke pasur në krye imperializmin amerikan, filluan që në ditët e para, pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, luftën e ftohtë, mëkëmbjen e revanshistëve gjermanë, krijimin e blloqeve agresive ushtarake, garën e çmendur të armatimeve dhe ndërhyrjen e tyre ushtarake në shumë pika të botës, për krijimin e bazave ushtarake, për vendosjen e regjimeve antipopullore, për vendosjen e sundimit të kapitalit amerikan dhe të mënyrës së jetesës amerikane. Fjala demagogjike e «lirisë», e «botës së lirë», e «lirisë së popujve», do të thotë për ta «liria» për kapitalizmin «bota e lirë» për kapitalizmin. Fjala «paqe» për imperializmin amerikan, do të thotë «pax amerikana», njëlloj si «pax romana», domethënë të armatosemi për të imponuar paqen.

Fillimi i thyerjes së akullit të «luftës së ftohtë» nuk do të thotë se imperializmi tani u bë qëngj. Revizionistët që mendojnë se duhet t'i bëjmë koncesione imperializmit dhe të sakrifikojmë principet tona për ta bërë imperializmin «qëngj», janë armiq dhe s'na i shkojnë dot ato monedha false. Bisedimet me imperialistët duhen bërë pa lëshuar asnjë grimë nga parimet, pse po i dhe gishtin imperializmit ky ujk të rrëmben krahun. Bashkekzistencën paqësore midis popujve me sisteme shoqërore të ndryshme e kemi zbatuar dhe po e zbatojmë me vepra dhe jo me fjalë.

Me të gjitha vendet dhe shtetet e botës që kanë dashur, ne kemi dhe jemi gati të kemi marrëdhënie diplomatike, ekonomike, kulturele, me kondita recipro-

ke të përfitimit dhe të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit, me respektin e lirisë dhe të sovranitetit të njëri-tjetrit, me respektin e të drejtave dhe të dinjitetit të njëri-tjetrit. S'ka shtet që mund të na akuzojë ne për mungesë gatishmërie dhe për mungesë respekti në çështjen e zbatimit të bashkekzistencës.

A mund të konsiderohet bashkekzistencë paqësore nga ana e imperialistëve amerikanë, kur kanë 10 vjet me radhë që bëjnë një luftë të poshtër dhe të ftohtë kundër Kinës së lavdishme që fitoi lirinë, sovranitetin dhe me sukses ndërton socializmin? Kina Popullore prej 650 milion banorësh, që është faktor vendimtar për fatet e paqes dhe të përparimit njerëzor, për dëshirën e klikave sunduese imperialiste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mbahet jashtë Kombeve të Bashkuara, nuk lejohet të zërë vendin e saj të merituar në këtë organizatë të madhe ndërkombëtare dhe, në vend të Kinës së vërtetë, mbahet me zor me kleçka e me paturpësinë më të madhe një bandit siç është Çan Kai Shia, i cili ka lejuar që toka kincze e Tajvanit të bëhet një bazë ushtarake amerikane, një bazë agresioni kundër Kinës.

Udhëtimi i presidentit Ajzenhauer u shoqërua me provokacione të panumërta në të gjithë Azinë dhe Afrikën kundër Kinës së lavdishme, me qëllim denigrimi të influencës së madhe paqësore dhe përparimtare që ajo po zhvillon dhe do të zhvillojë në të gjitha këto vende. Por të tilla provokacione që i bëhen tani Kinës, bota i ka njoher edhe më përpara kundër Bashkimit Sovjetik. Dhe këto kanë dështuar si atëherë edhe tani. Popujt e vendeve të Afrikës dhe të Azisë nuk do të

shkelin në dërrasë të kalbur dhe nuk do të gënjenen nga fjalët e ëmbla por demagogjike të imperializmit që ka qenë dhe është armiku i lirisë dhe i mirëqenies së popujve që duan të rrojnë të lirë dhe në dinjitet njerëzor. Intrigat dhe provokacionet kundër Kinës do të dështojnë me turp, se Kina është një kolos, ajo është pjesëtare e kampit socialist, pse ne jemi të lidhur me njëri-tjetrin si mishi me koskën. Kina e madhe që ndërton me sukses socializmin, Kina e madhe që e udhëheq Partia Komuniste e lavdishme me Mao Ce Dunin në krye, ai popull kinez dhe ajo Parti Komuniste marksiste-leniniste që luftuan dhjetëra vjet me radhë kundër imperialistëve të egër, dhe që sot triumfojnë, janë të lidhur ngushtë me vendet tona të demokracisë popullore.

Jo vetëm Kinën e madhe nuk mund ta dëmtojnë intrigat e imperialistëve dhe të revizionistëve jugosllavë, por as Shqipërinë e vogël. Kur imperialistët flasin me demagogji për një farë «bashkekzistence paqësore», harrojnë që veprojnë ndryshe. Por ata s'duhet të harrojnë se nuk gënjejnë njeri dhe nuk do të na gjejnë në gjumë. 15 vjet ka Shqipëria e vogël që është çliruar dhe është bërë një vend i lirë e sovran. Amerika i mbaka mëri Shqipërisë dhe ajo nuk denjon të ketë marrëdhënie të rregullta diplomatike me të! Sikur neve na u prish ndonjë punë. Ne kemi rrojtur, rrojmë dhe do të rrojmë, dashka ose s'dashka Amerika të ketë marrëdhënie të rregullta me shtetin tonë. Bile ne u themi atyre se rrojmë shumë mirë.

Bashkekzistenca e vërtetë paqësore e kërkon minimumin e saj, vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.



Por farisenjtë e kapitalizmit që flasin gjoja për lirinë e popujve, për vetëvendosjen e tyre, lëshojnë deklarata të turpshme dhe idiote çdo vit, nga departamenti i shtetit, kundër sovranitetit dhe lirisë së Shqipërisë. Me këto provokacione ne jemi regjur dhe s'na trembin.

Dëshira e qarqeve sunduese amerikane që duan ta kthejnë Shqipërinë nën thundrën e tyre, të bejlerëve dhe të agallarëve të dikurshëm, shërbëtorë të përherëshëm të tyre, ka përcaktuar përgjithmonë. Ëndrrat e aleatëve të amerikanëve që përpiqen të mbajnë me Shqipërinë një gjendje lufte, për t'i këputur ndonjë copë në kohën e volitshme, janë ëndrra me sy hapur që s'do të realizohen kurrë. Amerika ka të bëjë dhe do të ketë të bëjë me këtë Shqipëri të popullit, dashka ose s'dashka ajo.

Për të mos përmendur një tok vendesh me të cilat ne kemi marrëdhënie të mira si me Francën, Republikën Arabe të Bashkuar etj., me Italinë, kundër së cilës brenda 20 vjetësh kemi luftuar disa herë se na ka pasë shkelur vendin dhe kishte rrëmbyer lirinë, sot kemi marrëdhënie normale. Por aleatit tonë të Luftës së Dytë Botërore, Anglisë, s'ia dashka qejfi të ketë marrëdhënie të rregullta me shtetin tonë. Gatishmëri për bashkekzistencë nga ana e saj i thonë kësaj punë? Mbretit Charl të Anglisë i preu kokën Kromuelli dhe jo ne. Ne u premë kokën fashizmit dhe tradhtarëve shqiptarë që shisnin popullin të huaji. Apo na mban mëri neve Anglia pse u shkëput prej saj Irlanda apo India që fituan lirinë dhe sovranitetin? Por të gjitha këto veprime absurde, që, fundi i fundit, as që na shqetësojnë, e kanë burimin në armiqësinë e imperia-

lizmit kundër lirisë dhe sovranitetit të popujve, e kanë burimin në papajtueshmërinë ideologjike në mes doktrinës sonë komuniste që mbron lirinë, demokracinë, sovranitetin e popujve dhe kapitalizmit që mbron me shpirt në dhëmbë të vjetrën, që mbron skllavërimin dhe shfrytëzimin e egër të popujve.

Popullin tonë imperialistët dikur e kanë quajtur barbar, se mbronte me luftë atdheun e vet. Ata e quanin popullin tonë injorant e të prapambetur se nuk u bindej pushtuesve. Por fakti që një popull i vogël si yni, i shtypur në shekuj, dhe çfarë shtypje, i cili ruajti të paprekur gjuhën, zakonet, kulturën e tij të lashtë dhe nuk u zhduk, as u asimilua nga të tjerët, tregon se populli ynë nuk ishte as injorant dhe as pa kulturë.

Tani imperialistët na quajnë vendi «më i mbyllur» i Evropës. Për njerëzit e mirë, për miqtë dhe njerëzit e ndershëm, nga çdo anë qofshin, vendi ynë ka qenë dhe është i hapur, por për armiqtë, sabotatorët dhe provokatorët ai ka qenë i mbyllur dhe do të mbetet i mbyllur. Sigurimi dhe mirëqenia e popullit tonë vlejnë më shumë se buzëqeshjet e ujkut. Vendi ynë i ka miq popujt e Anglisë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës etj. Turistë kanë ardhur dhe do të vijnë nga këto vende në vendin tonë. Këto kanë shërbyer dhe shërbejnë shumë për mirëkuptimin e njëri-tjetrit. Por edhe kjo duhet të bëhet në mënyrë reciproke e jo të përdoren nga ana e tyre kundër nesh forma diskriminuese. Këto ne s'i gëlltitim dhe shantazhet e tyre nuk na trembin.

Ne e kuptojmë shumë drejt bashkekzistencën paqësore dhe nuk e ngatërrojmë atë me bashkekzistencën ideologjike e as do të ndalemi kurrë për të vënë në

dukje me vepra dhe me propagandë superioritetin e regjimit tonë socialist mbi atë kapitalist, nuk do të mungojmë asnjëherë, të tregojmë kalbëzimin dhe tmerret e imperializmit e të kapitalizmit, dhe drejtësinë e shkencës së lavdishme të marksizëm-leninizmit. Asnjë lëshim nuk do të bëjmë në parimet dhe jo vetëm kaq, por kurrë nuk do të humbasim busullën dhe të mendojmë se duhet të forcojmë e të shtojmë buzëqeshjet tona për t'u lënë të kuptojnë imperialistëve se i kanë dyert të hapura te ne dhe t'i marrin këto si lëshime.

Ne jemi nga ata që çdo gjë të mirë, të artit, të kulturës apo të shkencës të vendeve të Perëndimit, e marrim në vendin tonë dhe e vëmë në dukje brenda mundësive tona materiale. Me dhjetëra janë përkthimet në gjuhën shqipe të veprave të shkrimtarëve, poetëve dhe shkencëtarëve të mëdhenj të vendeve të Perëndimit dhe me qindra mijë numërohet tirazhi i tyre. Gjuha franceze, angleze, gjermane etj. mësohet në shkollat tona. Në skenat tona luhen vepra të klasikëve dhe të autorëve përparimtarë të vendeve të Perëndimit, ekzekutohen vepra të kompozitorëve të mëdhenj të këtyre vendeve. Por në vendin tonë kurrë nuk do të kenë vend filmat e gangsterëve, librat mbushur me vjedhje dhe grabitje, siç janë komikset, kurrë nuk do të kenë vend në popullin tonë kërcimet e degjeneruara të rokenrollit dhe të hulahupit dhe as mënyra e jetesës së degjeneruar të Perëndimit. Për ne ky është degjenerim dhe korruptim.

Ne e dimë se populli amerikan dhe anglez kanë shumë gjëra të mira dhe do të ishim injorantë po t'i mohojmë. Këto ne i shohim me simpati, por metodat

e degjenerimit dhe shfrytëzimin e egër kapitalist në këto vende ne i urrejmë, i luftojmë dhe do t'i luftojmë.

Të njëjtën urrejtje dhe të njëjtën luftë ne i bëjmë dhe do t'i bëjmë revizionizmit modern që përfaqësohet nga revizionistët jugosllavë. Këta janë agjentët më të egër të këtij degjenerimi moral, politik, ekonomik dhe ideologjik dhe janë shumë të rrezikshëm se përpiqen të maskohen nën formulat marksiste. Revizionistët jugosllavë, jo më larg se dje, në mbledhjen solemne të Zagrebit, patën paturpësinë ta quajnë vijën e tyre revizioniste, si vijë «leniniste». Lenini i ka shpartalluar me kohë baballarët e revizionistëve jugosllavë dhe, si rrjedhim, revizionistët aktualë jugosllavë. Ata të mos harrojnë gjithashtu se Lenini ka thënë se çdo dollar kullon gjak nga i punëtorit dhe i popullit amerikan, kullon gjak nga trupi i popujve të botës.

Bashkekzistencën paqësore revizionistët jugosllavë e kuptojnë si bashkekzistencë ideologjike me kapitalizmin dhe integrim të kapitalizmit në socializëm. Këtë e vërteton çdo veprim i tyre, që nga dollarët që ata marrin nga imperialistët amerikanë dhe deri në heshtjen e plotë kundër imperializmit. Por jo vetëm kaq. Ata, duke atakuar në çdo moment kampin tonë të socializmit, regjimet tona socialiste dhe partitë tona komuniste e punëtore, na akuzojnë haptazi ne si satelitë të Bashkimit Sovjetik ashtu siç bën departamenti i shtetit i SHBA-së. Këta armiq të betuar të socializmit duhen demaskuar pa pushim, këta provokatorë duhen demaskuar deri në fund.

Ata veçanërisht kundër vendit dhe Partisë sonë

bëjnë një mijë e një të zeza, por pa sukses. Ata të jenë të sigurtë se populli dhe Partia jonë, të bashkuar si një trup, nuk do t'i lënë të livadhisin të qetë, por do të mbrojnë interesat e popullit, të Partisë dhe të kampit të socializmit me vigjilencën më të madhe dhe fitorja kurdoherë do të jetë në anën tonë, se në anën tonë është drejtësia.

Të rrojë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Të lulëzojë gjithnjë më shumë kultura socialiste në vendin tonë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 303 (3518), 18 dhjetor 1959*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**LETËR URIMI REDAKSISË SË GAZETËS «PIONIERI»  
ME RASTIN E 15-VJETORIT TË BOTIMIT  
TË GAZETËS**

**16 dhjetor 1959**

**REDAKSISË SË GAZETËS «PIONIERI»**

Të dashur shokë,

Me rastin e 15-vjetorit të botimit të gazetës «Pionieri» Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, ju dërgon juve, shokë të redaksisë, bashkëpunëtorëve tuaj, mësuesve, shkrimtarëve, pionierëve dhe gjithë lexuesve të vegjël, përhëndetjet dhe urimet më të mira!

Gazeta «Pionieri» filloi të botohet që në ditët e para të Çlirimit, kur para Partisë dhe popullit tonë qëndronin detyra të rëndësishme për të shëruar plagët e rënda të luftës. Kjo tregon vëmendjen e madhe, dashurinë dhe kujdesin e veçantë të Partisë sonë për edukimin e fëmijëve.

Gjatë këtyre 15 vjetëve, gazeta «Pionieri» ka luftuar që t'i edukojë fëmijët për çështjen e madhe të Partisë dhe të popullit. Ajo është bërë një ndihmë aktive e shkollës duke bërë një punë të madhe për

përvetësimin e mësimeve, për forcimin e disiplinës në shkollë dhe të sjelljeve të mira në familje e në shoqëri.

Komiteti Qendror i Partisë uron që edhe në të ardhshmen gazeta të luftojë me të gjitha forcat, që pionierët dhe fëmijët tanë ta duan Partinë, atdheun, shkollën dhe mësimin, të rriten të mençur e me duar të arta. Gazeta «Pionieri» duhet t'i njohë edhe më mirë fëmijët me traditat patriotike të popullit tonë, me luftën e Partisë sonë për ndërtimin e socializmit, të rrënjosë gjithnjë e më shumë në ta dashurinë për paqen dhe miqësinë midis popujve.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim se gazeta «Pionieri» do të jetë një mik dhe shok i ngushtë i pionierëve, që të çojë te ata këshillat e urta të Partisë, t'i mësojë të duan e të nderojnë prindërit dhe mësuesit e tyre.

Me rastin e këtij jubileu Komiteti Qendror i PPSH i uron gazetës «Pionieri» suksese të mëtejshme në punën e saj për edukimin komunist të pionierëve dhe të fëmijëve tanë!

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

Botuar për herë të parë  
në gazetën «Pionieri», Nr. 50  
(517), 16 dhjetor 1959

Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë

## **PARTIA NË USHTRI KËRKON DISIPLINË TË NDËRGJEGJSHME**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**18 dhjetor 1959**

Mendoj se në ushtri kemi përparime të mira. Këtë dëshiron edhe Partia, që ushtria jonë të jetë ushtri e popullit, e ngritur nga ana politike, ideologjike, teknike e disiplinore, që të ecë kurdoherë sipas mësimeve të Partisë, në rrugën e marksizëm-leninizmit.

Me gjithë përparimet, në ushtri ka edhe dobësi. Shokët që janë ngarkuar me drejtimin e ushtrisë duhet të shikojnë më mirë punën e Partisë për t'i korrigjuar këto dobësi. Por kjo nuk bëhet vetëm duke marrë masa disiplinore. Në raport pashë shumë masa të tilla ndaj oficerëve me gradë të ulët, gjë që nuk është aspak e mirë.

Është e domosdoshme që komandantët dhe udhë-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PPSH u diskutua mbi gjendjen e punës politike të Partisë në Ushtrinë Popullore.



heqësit politikë ta kenë të qartë se në ushtri disiplina duhet të jetë e fortë, por e ndërgjegjshme. Disiplina e ndërgjegjshme në ushtri të futet në gjak me punën ideopolitike dhe edukative të Partisë, në rrugën e Partisë. Nuk duhet të jetë frika ajo që ta bëjë ushtarin ose kuadrin në ushtri të ketë disiplinë, por bindja e brendshme, ndërgjegjja, të cilën e edukon organizata-bazë e Partisë. Partia në ushtri kërkon disiplinë të ndërgjegjshme. Natyrisht, kur shkelet rëndë disiplina ushtarake dhe shoqërore, merren edhe masa, por këto duhet të jenë me vend dhe sa më të pakta.

Në ushtri, më tepër se kudo kemi kuadro të mirë dhe të përgatitur që kanë mbaruar akademi dhe shkolla të tjera të larta. Prandaj, këta kuadro duhet të aktivizohen duke mbajtur referate me ushtarët, nënoficerët dhe oficerët, me qëllim që të ndihmojnë për ngritjen e nivelit të punës ideopolitike në ushtri. Kjo është një detyrë me rëndësi të madhe.

Po kështu edhe stërvitja duhet të përmirësohet. Në këtë drejtim është e nevojshme të luftohet kundër shfaqjeve të shabllonizmit. Më duket se nga ana e disa kuadrove të ushtrisë lihet pas dore njohja dhe përhapja e eksperiencës së mirë që ka në fushën e stërvitjes. Për këtë eksperiencë mund të zhvillohen referate të përgatitura mirë, por ajo që ka rëndësi është zbatimi i eksperiencës së përparuar. Lojnat ushtarake që organizohen ndihmojnë së tepërmi për të zhvilluar më tej edhe kulturën ushtarake, prandaj të përmirësohet gjithnjë e më shumë puna në to.

Nga ana e Drejtorisë politike mendoj se ka përpjekje dhe luftohet për forcimin e punës së Partisë

në ushtri, por te shoku drejtor dhe shokët e tjerë duhet të ketë më tepër gjallëri e dinamizëm, me e pasë më mirë në dorë situatën për çdo repart, i madh ose i vogël qoftë. Ushtria duhet të ndjejë në çdo rast dorën e Drejtorisë politike, që çon vijën e Partisë në ushtri dhe kontrollon zbatimin e drejtë të saj.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN XV TË KQ TË PPSH<sup>1</sup>

23 dhjetor 1959

Analiza që u bëri kohët e fundit Byroja Politike një sërë çështjeve ekonomike si dhe disa shkeljeve e veprimeve që prishin ndërgjegjen socialiste të punonjësve, u reflektua në raportin që iu paraqit këtij plenumi, i cili kryesisht përmban analizën e problemeve ekonomike gjatë këtyre katër vjetëve të pesëvjeçarit të dytë, si dhe detyrat për vitin 1960.

Nga diskutimet e shokëve duket se plenumi e aprovoi analizën e Byrosë Politike dhe detyrat e parashikuara për vitin 1960. Nga raporti dhe diskutimet u duk qartë se në punën tonë ka suksese, por ka edhe plot të meta e dobësi. Ishte plotësisht e drejtë që sukseset të viheshin në dukje, por edhe të metat e gabimet në punën tonë mendoj se mund të thekso-

---

<sup>1</sup> Plenumi XV i KQ të PPSH që zhvilloi punimet më 22 dhe 23 dhjetor 1959 dëgjoi dhe diskutoi rreth raportit të Byrosë Politike «Mbi realizimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për periudhën 1956-1959 dhe mbi detyrat e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1960», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave shoku Mehmet Shehu.

heshin akoma më me forcë sepse ato kanë ekzistuar dhe ekzistojnë akoma në forma të ndryshme, disa herë të vogla dhe herë pas here të mëdha. Kjo kritikë ishte e nevojshme edhe për udhëheqjen edhe për bazën.

Sikurse doli, përsa i përket realizimit të planit gjatë katër vjetëve që kaluan, ne kemi edhe rezultate pozitive. Është e drejtë që ne duhet t'i vëmë në dukje gabimet e të metat, lëshimet dhe dobësitë, po nuk duhet të lëmë përshtypjen se në punët tona çdo gjë ka qenë e zezë. Faktet tregojnë se ne kemi shumë sektorë ekonomikë ku i kemi realizuar dhe tejkaluar shifrat e Kongresit III të Partisë, bile në disa sektorë edhe ato të plenumit të vitit 1958, me përjashtim të sektorit të bujqësisë.

Por përpjekjet tona gjatë vitit 1960 duhet të jenë shumë të mëdha me qëllim që të realizojmë planin, sepse ai është mjaft i ngarkuar, megjithëse i realizueshëm, në mënyrë që të shkojmë në Kongresin IV të Partisë me ato parashikime që vendosëm. Përpjekjet tona bile duhet të jenë të tilla që ne t'i kalojmë edhe këto parashikime para se të shkojmë në Kongresin IV të Partisë. Sedra e anëtarëve të Partisë dhe e të gjithë patriotëve duhet të shërbejë për të mobilizuar të gjitha forcat e vendit për plotësimin e deficiteve që janë vërtetuar, dhe në planin e vitit 1960 t'i tejkalojmë detyrat e vëna që të mund t'i zvogëlojmë sa më shumë zërat e paralizueshëm.

Jam dakord se të metat duhet dhe do të na bëhen mësim. Dhe për angazhimet që marrim jemi të ndërgjegjshëm. Nuk ka dyshim se edhe klasa punëtore dhe fshatarësia janë të ndërgjegjshme për angazhimet që

marrin. Por mendoj se duhet të kemi mirë parasysh çështjen e organizimit më të mirë të punës. Ne kemi bërë përparime në organizimin e punës, por jemi akoma shumë prapa. Është e vërtetë se te klasa punëtorë kuptimi i detyrave dhe ndërgjegjja e saj janë shumë më të larta se te fshatarësia dhe inteligjencia. Por duhet të kemi parasysh se klasa punëtorë te ne ka një prejardhje fshatare, stazhi i saj si punëtor nuk është i gjatë. Megjithatë shohim se në industri e realizojnë planin, me përjashtim të naftës. Për çështjen e naftës nuk i bie faji më shumë klasës punëtorë. Punëtorët e naftës janë më të fortë, më të guximshëm, më të pjekur nga punëtorët e tekstilit, po këtu fajin e kemi ne që drejtojmë. Planin në industri në përgjithësi ne e realizojmë, se klasa punëtorë që punon në industri, në minierë ose në ndërtim është e organizuar mirë, e inkuadruar nga ana e Partisë. Por edhe aty ka dobësi, ka mosrealizime që rrjedhin nga mungesa e vigjilencës së Partisë dhe e klasës punëtorë. Mbeturinat e klasave të përmbysura bëjnë që të shfaqen thyerje të disiplinës, të mos realizohen normat, të humbet kohë gjatë punës etj. Por megjithatë shohim se organizimi i mirë i punës me kufi të caktuar, me stimulacion në baza të drejta, bëri që punët në miniera, në industri, në ndërtim, ku akoma ka shumë të meta, të vënë mirë. Por në fshat ne nuk e kemi një organizim të tillë dhe kjo reflektohet edhe në plan.

Mua më duket se Partia duhet t'i kthejë forcat e veta drejt bujqësisë. Deficitet në plan tregojnë se ne duhet t'i kushtojmë një kohë dhe kujdes shumë më të madh se deri tani bujqësisë dhe këtë punë duhet

ta fillojmë që nga organizimi. Këtu u diskutua se fshatari nuk punon sa duhet dhe në fakt kështu është. Në goftë se ne vetëm me propagandë dhe agjitacion mendojmë të ngremë ndërgjegjen e fshatarit në punë në nivelin e ndërgjegjes së klasës punëtore, të jemi të bindur se me këtë rrugë do të duhet një kohë shumë e gjatë, d.m.th. t'ia lëmë çështjen spontaneitetit. Prandaj duhet ta organizojmë mirë punën me fshatarët dhe për këtë unë mendoj që çdo komunist, kudo që punon, duhet të jetë një organizator i mirë.

Këtë çështje duhet ta kuptojnë në radhë të parë komunistët e fshatit. Po të mos i bëjmë këta të ndërgjegjshëm, që t'i shohin çështjet organizative në frymën e Partisë, për të organizuar mirë të gjitha punët dhe të ngjallin te fshatarësia ndërgjegjen dhe dashurinë për punën e disiplinuar, brenda vendimeve të qeverisë dhe statutit të kooperativës, atëherë nuk kemi kuptuar gjë.

Po nuk e kuptoi këtë organizata e Partisë në fshat atëherë ne do të ecim shumë ngadalë dhe do të gjejmë shumë vështirësi në punët tona në fshat. Shumë çështje për të cilat Partia na ka sinjalizuar, si p.sh. çështja që kooperativistët kërkojnë të largohen nga fshati, apo që gruaja nuk del në punë etj., tregojnë se në këtë drejtim ka lëshime të mëdha jo vetëm poshtë po edhe lart.

Ministria e Bujqësisë ka edhe ajo të mirat dhe të metat e saja. Unë nuk jam i mendimit se të gjitha fajet për këto dobësi në bujqësi i ka Ministria e Bujqësisë. Përsa i përket kritikës që iu bë ministrit të Bujqësisë<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Në këtë kohë ministër i Bujqësisë ishte Maqo Çomo, i cili më vonë u përjashtua nga Komiteti Qendror dhe nga Partia për veprimtari armiqësore antiparti.

unë jam plotësisht dakord ashtu sikurse është dakord e gjithë Byroja Politike. Ai ka të meta në punë, të cilat janë shumë serioze.

Drejtuesit e Ministrisë së Bujqësisë duhet ta kuptojnë se ata drejtojnë edhe bazën, pra edhe fshatin, se atje nuk kanë vetëm ndërmarrjet bujqësore për të drejtuar, NBSH-të janë një gjë e vogël në krahasim me gjithë bujqësinë socialiste ose private. Edhe sektori privat nuk duhet lënë pas dore, sepse nga oborret e ekonomive private dhe të kooperativistëve jo vetëm varet grumbullimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale në një sasi të konsiderueshme, por nga ato plotësohet edhe një pjesë e mirë e ushqimit të kooperativistëve. Prandaj interesimi nga ana e Ministrisë së Bujqësisë për bazën nuk duhet të lihet pas dore.

Vendimet që marrim nuk janë të shkëputura nga baza dhe nga këshillat e sugjerimet e shokëve të bazës, por ajo që ka rëndësi është se duhet të bëhen përpjekje të mëdha që ato të zbatohen sepse janë parashikuar të realizohen sipas mundësive të bazës. Në rast se udhëheqja e Ministrisë së Bujqësisë dyshon e nuk e vë në jetë një vendim të tillë, kjo është shumë e rrezikshme. Ne mendojmë se vendimet që janë marrë, p.sh. për ushqimin e blegtorisë, janë reale, por jeta do të na e tregojë më mirë këtë. Prandaj duhet të përpiqemi që çdo vendim ta vëmë një herë në zbatim, pastaj t'i bëjmë korrigjime. Të pagabueshëm ne nuk jemi dhe murit me kokë nuk i biem. Por as nuk lejohet që ndonjë nga ne të mos shfaqë mendimet e tij. Mendimet që kemi, të mira ose të këqija, të bazuara ose të pabazuara, duhet t'ia themi udhëheqjes. Ajo pastaj të gjykojë se ç'duhet bërë, nëse

duhet t'i studjojë ato mendime, të adoptojë masa të reja dhe të thotë se vendimi i marrë nuk është në rregull.

Por pa ndjekur këtë rrugë, të thuhet se vendimi për blegtorinë është pa baza, pa kaluar akoma as 6 muaj, nuk është e drejtë. Duhet gjithashtu që shokët e Ministrisë së Bujqësisë dhe ministri t'i kenë parasysh këto çështje. Ai ka pikëpamjen se ato që mendon ai janë të pagabueshme. Asnjë njeri nuk mund të kundërshtojë pikëpamjen që po nuk i dhe bagëtisë të hajë nuk ka qumësht. Po ushqimin bagëtisë ne duhet t'ia japim brenda mundësive tona, brenda planeve që kemi aprovuar. Kur të kemi bërë përpjekje dhe të shohim se plani i vendosur nuk mund të realizohet, vitin tjetër ose pas dy vjetësh vendimit mund t'i bëjmë korrigjime, po njëkohësisht duhen bërë korrigjime edhe nga ana tjetër, që të kompensojmë humbjen që do të kemi nga ky mosrealizim, sepse miqtë nuk do të na japin dhe do të na thonë të zgjatim këmbët sa kemi jorganin. Prandaj çështjet t'i shikojmë nën prizmin e situatës.

Faktet tregojnë se problemi i bazës ushqimore nuk është zgjidhur dhe mendimi im është se nuk do të zgjidhet shpejt sepse fshatarësia jonë akoma nuk është e predispozuar qind për qind që në një ose në dy vjet, përta i përket blegtorisë, të zbatojë direktivat ashtu si kërkon Komiteti Qendror. Por ne duhet të jemi optimistë se rritja e silazhit tregon që fshatari tani është duke hyrë në këtë rrugë. Tani mbetet që ta organizojmë si duhet punën. Kanë të drejtë shokët që kritikojnë Ministrinë e Bujqësisë se nuk bën më shumë konsulta për një çështje të tillë kaq të rëndësishme. Çështja e silazhit nuk është e lehtë dhe nuk duhet menduar se



fshatari e kuptoi atë me një mbledhje që bëri në qendër Ministria e Bujqësisë. Faktet tregojnë që silazhi priset, kalbet; duke hedhur silazhin e ri, fshatarët nxjerrin të vjetrin nga gropat, të kalbur. Që të bëhet mirë silazhi i duhet qëndruar mirë e në kokë punës. Prandaj nga Ministria e Bujqësisë duhen bërë mbledhje instruktive njëra pas tjetrës që të mos lejohet të komprometohet kjo direktivë kaq e rëndësishme e Komitetit Qendror. Është e lehtë të prishësh arat dhe të mbjellësh misër foragjer, por duhet ditur se ne duam edhe bukë.

Ministria e Bujqësisë e të gjithë specialistët e saj duhet t'i kuptojnë edhe më mirë këto gjëra dhe të lidhen mirë me fshatarët. Shokët e Partisë dhe të pushtetit në bazë lodhen, kanë shumë punë, kanë rezultate, por organizimi i punës në kooperativat ka akoma dobësi të mëdha. Po të pyesim shokët e Partisë se sa i studjojnë në fund të çdo viti rezultatet e çdo kooperative bujqësore në të gjitha të dhënat që po përgatitin kooperativistët dhe ç'konkluzione nxjerrin për vitin e ardhshëm, jam i bindur se me ndonjë përjashtim ata shumë pak interesohen për këto probleme. Edhe komitetet ekzekutive që e kanë detyrë organike t'i ndjekin këto probleme që nga gruri deri te plehu, zogjtë, bletët etj. jo vetëm nuk i studjojnë thellësisht, por mjaftohen vetëm me disa njohuri të përcipta.

Mua më duket se në bazë të këtyre kërkesave duhen ndërtuar planet e ardhshme në kooperativat bujqësore, sepse të flasësh veresie se duhen hapur kaq toka, duhet mbledhur kaq pleh, duhet të rriten kaq llopë, pa parë eksperiencën e kooperativave, sa janë mobilizuar krahët e punës, sa ditë-punë kanë bërë

kooperativistët, ku janë dobësitë e Partisë nga ana politike, organizative etj., ndihma e SMT-ve etj., më duket se ecim me sy mbyllur.

Nuk mund të forcohet organizimi në kooperativat bujqësore po të mos bazohet në situatën reale dhe në shifra konkrete, po të mos matet çdo gjë si duhet, duke filluar në radhë të parë nga mobilizimi nga ana e Partisë, sa i kanë inkuadruar forcat e fshatit Partia dhe pushteti në caqet që parashikojnë statuti i kooperativave dhe rregullat e Partisë e të qeverisë. Vetëm mbi këto baza ne duhet t'ua shtojmë rendimentet, d.m.th. të shohim nëse i kemi forcat apo jo, në rast se kemi mungesa atëherë duhet të marrim masa për të realizuar planin. Kjo punë nuk bëhet jo vetëm atje, por as në ministri as në komitetet e Partisë as në qeveri. D.m.th. këto studime që janë baza e realizimit dhe e mundësive të planeve, kalohen me një analizë të përciptë.

Pyeta shokun Spiro Koleka sa i përdorte këto studime për planet e bujqësisë kur ka qenë në krye të Komisionit të Planit të Shtetit. Ai m'u përgjigj se i studjonte, po nuk i kishte afër për t'u bazuar vazhdimisht mbi to, d.m.th. të bënte një studim pak a shumë shkencor. Shumë gjëra ngjasin në bujqësi. P.sh. fshatarët duhet të punojnë medoemos më shumë që të kenë të ardhura më shumë, të hanë më mirë, gjë që do të ndihmojë që të punojnë edhe më mirë, të kenë më shumë të holla dhe të bëjnë investime, jo vetëm për stalla, kinema, shkolla, por edhe për të hapur qilizma, për të mbjellë pemë frutore për të ardhshmen.

Në rast se këto mundësi nuk i studjojmë çdo vit

dhe të caktojme mirë caqet e punës organizative, ata do të na ikin, do të shturen. Nuk e zgjidh problemin çështja e bashkimit të 4-5 kooperativave në një të vetme dhe të dërgohet për drejtimin e saj ndonjë shok nga Tirana. Këtë do ta zgjidhë baza me kuadrot e vet. Ne kemi dërguar dhe do të dërgojmë kuadro, po kemi mijëra kooperativa dhe s'kemi ku t'i gjejmë njerëzit për të tëra, kurse në bazë njerëz kemi plot, vetëm duhet t'i edukojmë. Para se të vemi te fshatari të edukojmë brigadierët, traktoristët, llogaritarët etj. me një frymë disipline dhe me shpirt organizativ. Ne duhet të edukojmë gjithashtu teknikët e bujqësisë se ka prej tyre që më shumë shesin mendje duke thënë se kjo duhet mbjellë kaq thellë, kjo duhet bërë kështu, ajo duhet bërë ashtu. Këto le t'i thonë, po njëkohësisht të bëjnë mirë edhe punën organizative ashtu si duhet bërë dhe të mos shkojnë fluturimthi në fshat e të mjaftohen vetëm me dhënien e disa këshillave në këmbë. Prandaj Partia në këtë frymë t'i edukojë këta njerëz.

Çështjen e bashkimit të kooperativave ne e kemi ngritur drejt dhe drejt duhet ta shikojmë, por duhet të kalojmë në një fazë më të lartë, me kujdes dhe vetëm kur kjo punë ndihmon për shtimin e prodhimit. D.m.th. të mobilizohen forcat në mënyrë të organizuar dhe jo të bëhet bashkimi i kooperativave për t'u shturur, se kemi edhe shembuj negativë, p.sh. disa kooperativave që janë bashkuar, u janë pakësuar të ardhurat. Një gjë të tillë nuk duhet ta lejojmë. Por kur ne ta organizojmë punën mirë, të kemi një kryetar të mirë në kooperativë, atëherë bashkimin do ta bëjmë shumë.

lehtë dhe të mos e varim gjithë punën vetëm duke kërkuar të dërgojmë tre vetë nga Tirana. Kjo që këtej është e pamundur të bëhet.

Ne duhet të kujdesemi edhe për specialistët e financës, se, sikurse u tha në raport, ana financiare luan një rol të madh vendimtar. Ana financiare, të shikohet si një nga çështjet kryesore organizative, sepse për dobësi të këtij sektori anëtarët e kooperativave në disa raste nuk punojnë, bëhen hilerë dhe hatërc, nuk mbahen mirë llogaritë e anëtarëve, nuk u shkruhen drejt ditët e punës. Kjo çështje duhet të na preokupojë, Partia në bazë të ketë kujdes shumë të madh, ndryshe kooperativa nuk forcohet. Ministria duhet t'u qëndrojë mbi kokë dhe t'u japë ndihmë kooperativave bujqësore se deficitet e krijuara janë të mëdha.

Ne mund t'i njohim gabimet po fakti është se deficitet në fund të vitit do të na shtohen. Te ne ka të meta subjektive po ka edhe të meta objektive që nuk mund të mos i shohim. Sigurisht, në pranverë kur bën kohë e keqe dhe fillojnë shirat, nuk mbjell dot, punimet nuk i bën dot në kohën optimale dhe rendimenti i prodhimeve ulet, duke marrë parasysh sidomos mungesën e plehut te ne si dhe mungesën e një lufte sistematike kundër sëmundjeve etj. Me gjithë këto arsye, ne me një luftë të organizuar mund t'i pakësojmë anët negative.

Doja të theksoja edhe çështjen e naftës për të cilën kemi harxhuar shumë të holla. Partia dhe drejtoria në kombinatin e naftës nuk janë treguar të afta dhe nuk e kanë justifikuar besimin që u është dhënë për drejtimin e një sektori kaq të madh. Nuk është çështja që

të bëhet këtu autokritikë, por në qoftë se ka një sektor që është marrë në analizë shumë herë në qeveri dhe në Byronë Politike, ky ka qenë sektori i naftës. Mirëpo atje ka akoma të meta serioze që rrjedhin nga dobësitë në udhëheqjen e Partisë dhe të drejtorisë, ndaj të cilave tani duhet të marrim masa. Ne kemi dhënë ndihmë, por edhe e kemi toleruar një situatë të tillë. Tani Byroja Politike do të marrë masa për ta forcuar situatën që të realizohet plani e t'i jepet naftë popullit.

Edhe nga ana e Ministrisë së Ndërtimit duhet të merren masa më serioze. Për këtë sektor dua të flas pak në lidhje me problemin e projekteve. Është katastrofike në rast se lejojnë preventivimin e keq dhe të gabuar të objekteve. Kështu do të shkojmë drejt një rëndimi shumë të madh të ekonomisë sonë popullore. Në rast se për një ndërtim të vogël, që i shtohet fabrikës së cigareve, jepen 20 milion lekë dhe zbatuesi harxhon 40 milion, apo në rast se projekti i një rruge parashikon 80 milion dhe zbatuesi për ta përfunduar kërkon 160 milion, ekonomia popullore rëndohet shumë. Kjo do të thotë që të ketë më pak bukë dhe gjalpë, më pak mish dhe veshmbathje për popullin. Në rast se parashikohet të bëhet ndonjë gabim ky duhet të jetë i vogël 2-3 milion dhe jo 20 milion. Një situatë e tillë që po vazhdon prej kohësh është shumë e gabuar. Prandaj Ministria e Ndërtimit të jetë jashtëzakonisht rigoroze në këtë çështje dhe qeveria të marrë masa kundër kujt do qoftë, kur sheh se bëhen gjëra të tilla. Ne bëjmë gjithë këto shkurtime që janë të nevojshme e të drejta dhe ju shokë të bazës jeni të qartë për to. Kush nuk do

që të zbukurohen qytetet tona? Po kjo do të bëhet dalngadalë, jo menjëherë.

Të kuptohet mirë situata jonë ekonomike dhe financiare. Në rast se do t'i kishim realizuar të gjitha planet që kemi dhe të mos kishim krijuar deficite, do të ishte përmirësuar më shumë jeta e popullit. Me gjithë këto mungesa, niveli i jetesës së popullit nuk do të ulet dhe ne do të arrijmë faqebardhë në Kongresin e Partisë. Por duhet ditur se në këtë drejtim na kanë ndihmuar miqtë. Po t'i kishim realizuar sipas parashikimeve të gjitha planet tona do të kishim fonde dhe materiale për të plotësuar nevojat e rretheve më mirë dhe më shpejt. Prandaj në këtë drejtim tani kërkesat e rretheve duhet të jenë të matura dhe për ato që parashikohen në planet tona të merren të gjitha masat që të realizohen në kohë, me çmimet e caktuara dhe me cilësi të mirë. Të metat dhe lëshimet që po bëhen dita-ditës të zbulohen me kohë dhe të merren masa serioze që të mos përsëriten.

Të metat tona deri tani kanë qenë të mëdha. Tani sigurisht ato janë pakësuar por duhet të jemi të ndërgjegjshëm se ato janë akoma shumë të mëdha dhe duhet të luftojmë që të ecim duke i eliminuar. Kjo do të bëhet vetëm me një ndërgjegje të lartë në punë, me një kontroll të fortë në realizimin e vendimeve të marrura dhe me një organizim të mirë të punës sonë. Vetëm kështu mund t'u jepet fund këtyre të metave. Këtë jemi në gjendje ta bëjmë dhe do ta bëjmë.

Edhe fryma e kursimeve duhet të jetë në rendin e ditës te ne. Nuk duhet të harxhojmë të holla ashtu si i kemi harxhuar deri tani. Për këtë sigurisht faji

është yni, se ligjet ne vetë i kemi bërë. Por në krye ne kemi qënë një çikë dorëlëshuar për këto gjëra. Ne kemi pasur sinjalizime, jo vetëm tani që e mori këtë çështje në dorë Byroja Politike, por edhe më parë, megjithatë vetë ne jemi treguar liberalë dhe liberalizëm me të hollat e popullit nuk lejohet. Këtu kemi faj më shumë ne si Byro Politike.

Masat që marrim kanë të mirat dhe të metat e tyre. Prandaj organizatat e Partisë në rrethe duhet të mobilizohen dhe të mos presin letrën e Komitetit Qendror për problemin e shkurtimeve, të cilin shumë bukur e shtroi shoku Gogo Nushi në diskutimin e tij. Nga këto masa emulacioni socialist në punë nuk duhet të ulet në asnjë mënyrë. Me masat që morën Partia dhe qeveria nuk do të thonë se pritet stimuli material, inisiativa e punonjësve, po kjo të bëhet në rrugën marksiste-leniniste për ata që e kuptojnë. Të mos gjenden njerëzit në befasi dhe të mos lejohet që të punojë armiku në vend të Partisë.

Të mos shkojmë larg, ja tani po afron Viti i Ri. Deri dje bëheshin darka me të hollat e shtetit në të gjitha zyrat, sepse ne ishim treguar hovardarë duke dhënë 2 për qind të fondeve rezervë që krijoheshin nga mosplotësimi i organikave. Kush do ta festojë le të paguajë dhe të mos dëfrojë me të hollat e shtetit.

Lidhur me këto masa që po marrim Partia duhet të mobilizohet se armiku do të punojë. Fakti është se këto gjëra ne i kemi bërë në momente të ndryshme nga ato që kemi sot. Atëherë, për shembull, nuk na vinin njerëz të mirë në sektorin e financës, njerëzit e ndershëm kishin frikë të bëheshin llogaritarë. Prandaj

ne me ndërgjegje i kemi shtuar rrogat dhe stimulet, sepse në këtë sektor ishin mbledhur tërë tregtarët e vjetër. Po tani ne kemi kudo kuadrot tanë që kanë fituar eksperiencë edhe në këtë sektor, janë besnikë dhe këto masa tani i presin mirë.

Sigurisht ne duhej t'u dilnim përpara edhe më shpejt këtyre gjërave, por më mirë vonë se kurrë. Këto të meta ne i njohim, tani duhet t'u japim fund. Prandaj si kurdoherë, nga këto të meta që vërtetohen të mësojmë se ato në asnjë mënyrë nuk janë të pariparueshme. Këto janë të metat e rritjes. Ato të na bëhen mësim. Gabimet tona të rritjes, në punë e sipër, do të na shërbejnë për të na armatosur në mënyrë që vitin e ardhshëm ta organizojmë më mirë punën dhe të realizojmë planet.

Por kini kujdes se problemet janë të shumta, të gjitha duhen zgjidhur në kohën e tyre. Ne jemi përgjegjës për ta organizuar punën në mënyrë që t'i zgjidhim të gjitha problemet si duhet dhe në kohë. Të mos pritet, fjala vjen, që pse nuk është bërë akoma aktivi për pyllëzimet dhe ujitjen, të mos shpërndahen raportet e Byrosë Politike që mbajtën këtu shokët Hysni Kapo dhe Spiro Koleka. Shokët e Partisë, kudo që të jenë, menjëherë t'i marrin këto raporte. Ata nuk duhet të mjaftohen me një aktiv që do të bëhet p.sh. nesër në Elbasan. Komunisti duhet ta marrë raportin e Byrosë Politike, ta studjojë hollësisht në shtëpi dhe të mendojë se cilat janë arsyet e situatës së vështirë që është krijuar për këtë çështje, që u shtrua nëpër aktivet e Partisë. Kjo nuk bëhet, por jo se nuk kemi njerëz të mirë. Njerëz të mirë ne kemi



shumë kudo. Edhe për pyjet kemi njerëz të mirë, që kanë mbaruar shkolla, të zgjuar, të rinj e që diskutojnë shumë mirë. Mua më thanë shokët se në një aktiv pothuajse asnjë nuk e kishte lexuar akoma raportin e Byrosë Politike për problemin e pyjeve. Kjo tregon se disa komunistë mendojnë me indiferencë «ç'më duhet mua pylli» dhe nuk e shohin këtë çështje me syrin e Partisë.

Shumë probleme kemi përpara dhe të gjitha këto i bijen bazës në kurriz për t'i zgjidhur. Udhëheqësit të kuptojnë se punët nuk kryhen në zyrë, por në bazë. Prandaj, po të jetë e mundur, të shkundemi nga shkresat e shumta. Megjithëse ne kemi marrë vendime në Byronë Politike, në qeveri dhe në plenum, përsëri merremi me shumë letra, nuk shpëtojmë dot prej tyre. Edhe për këtë fajin e kemi vetë se nuk jemi më të prerë. Por edhe shokët e bazës kanë faj. Nuk është se ata s'kanë inisiativë dhe kompetenca, po shumë herë gjërat na paraqiten sa për të qenë brenda dhe për të marrë aprovimin tonë. Të kemi guximin të vendosim vetë, bile edhe baza. Ne ta ndihmojmë bazën se ky është roli ynë kryesor. Prandaj në këtë drejtim të lidhemi sa më shumë me bazën dhe të merremi sa më pak të jetë e mundur me letra. E them këtë që ta kemi të qartë se mbi bazën rëndojnë të gjitha. Ne mund ta kritikojmë bazën shumë, po nuk është e drejtë ta bëjmë këtë pa dhënë ndihmën e duhur. Kjo nuk na lejohet. Kur shohim se një shok nuk e bën detyrën mund të marrim edhe masa, por udhëheqësit më parë duhet t'i ndihmojnë shokët.

Duhet të shihet me kujdes edhe çështja e marrë-

dhënieve Parti-pushtet. Të gjithë, kudo që punojnë, janë njerëzit e Partisë. Çdo punonjës ka funksione të caktuara. Por pushteti nuk duhet të spostohej, secili duhet ta bëjë mirë punën. Partia duhet t'i japë kompetenca pushtetit, pastaj ta ndihmojë që ai t'i kryejë detyrat.

Spiro Pano<sup>1</sup> duhet të thërritet të marrë masa që t'u vërë fre njerëzve të pandërgjegjshëm të grumbullimit që vjedhin fshatarët për të qenë vetë brenda, se nga një gjendje e tillë u krijohej atyre mundësi që, duke pasur teprica leshi, pambuku etj., të vjedhin edhe votë. Po për këtë nuk mjafton vetëm puna që do të bëjë Spiro Pano. Partia dhe pushteti në bazë t'i kenë nën kontroll këta njerëz se edhe ata mund të jenë të ndershëm, por në fillim mendojnë se është më mirë të dalin suficit e pastaj kalojnë në vjedhje.

Prandaj t'i ndihmojmë njerëzit edhe politikisht edhe organizativisht, por punonjësit e grumbullimit në rastin konkret duhet të kenë edhe disa mjete për të qenë të sigurtë në punën e tyre. Kësaj çështjeje ne t'i japim rëndësi të madhe, të mos e spostojmë punën e pushtetit, po ta forcojmë këtë se e kemi të dobët, sidomos në lokalitet. Pushteti në lokalitet është një ndihmës i madh i pushtetit të rrethit. Kryetarët e lokaliteteve janë njerëz që mund të japin ndihmë shumë të madhe. Që të ketë rrethi një plan të mirë bujqësor, pa ndihmën e lokalitetit nuk do ta bëjë si duhet, ai duhet të jetë i lidhur me fshatarët, me kooperativat

---

<sup>1</sup> Në këtë kohë kryetar i Komitetit Shtetëror të Grumbullimeve.

bujqësore. Ai i di të metat, mundësitë dhe mund të bëjë sugjerime që i duhen rrethit. Po ne akoma nuk e ndihmojmë sa duhet lokalitetin.

Duhet t'u vëmë rëndësi këtyre problemeve se vetëm me diskutime dhe me fjalë këto punë nuk bëhen, sidomos pa një organizim të mirë të punës nuk do të dalim me plan të realizuar. Asnjëriut të mos i ngrihet mendja që një ose dy sekretarë të komiteteve të Partisë në rreth mund t'i bëjnë të gjitha punët e rrethit. Në rast se ata nuk do ta bëjnë punën në mënyrë kolegjiale, në rast se instruktorët e Partisë, inspektorët e kooperativave bujqësore nuk ndihmojnë çdo ditë e nuk mësohen, asgjë nuk do të bëhet. Të gjitha këto detyra organizative të punës të përfshijnë të gjitha format e ndihmës për njerëzit dhe atyre t'u jepet ushqimi i përditshëm.

Ne kemi bindjen se këto plane që aprovojmë janë të realizueshme, prandaj të vëmë të gjitha forcat që t'i zhdukim të gjitha gabimet dhe të metat tona, të realizojmë planet dhe të shkojmë në kongres me plane të realizuara.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**FJALA NË AKTIVIN E PARTISË TË RRETHIT  
TË ELBASANIT ME RASTIN E PUNIMIT  
TË MATERIALEVE TË PLENUMIT XIV  
TË KQ TË PPSH<sup>1</sup>**

**28 dhjetor 1959**

Ju falenderoj, shokë, për dashurinë e madhe që tregoni ndaj Partisë. Këtë dashuri ju e treguat edhe me diskutimet që u bënë në këtë aktiv në lidhje me këto dy probleme të rëndësishme ekonomike dhe jetike për popullin dhe Partinë tonë siç janë pyllëzimet dhe ujitja.

Mua më duket se diskutimet tuaja ishin të mira, por diskutimet për ujitjen ishin më të gjalla, më të mprehta, më këmbëngulëse dhe me më shumë kërkesa. Kjo jep shpresa që edhe detyrat për këtë problem të

---

<sup>1</sup> Plenumi XIV i KQ të PPSH që u mbledh më 2 dhe 3 nëntor 1959 mori në shqyrtim dhe diskutoi raportet e Byrosë Politike «Mbi gjendjen dhe masat që duhen marrë për zhvillimin e ekonomisë pyjore, shfrytëzimin racional të pyjeve dhe ekonomizimin e lëndës së drurit», paraqitur nga shoku Hysni Kapo, si dhe «Mbi shtimin e sipërfaqes së tokave të ujtshme dhe mbi teknikën e ujitjes në bujqësinë tonë», paraqitur nga shoku Spiro Koleka.

zbatohen më mirë. Edhe diskutimet për problemin e pyllëzimeve ishin të mira. Natyrisht problemi i ujitjes është më imediat, më afër fshatarit, ai ka lidhje të drejtëpërdrejtë me rendimentet e kulturave bujqësore, të drithërave, të duhanit, të pambukut e të tjera. Por edhe problemi i pyjeve ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për vendin tonë. Pyjet duhet t'i konsiderojmë si një pasuri të madhe të popullit, po aq të rëndësishme sa edhe bukën e naftën për ndërtimin e socializmit. Pyjet janë shumë të dashura për ne, sepse atje kanë jetuar stërgjyshërit dhe gjyshërit tanë brez pas brezi, ato na kanë ngrohur, na japin lëndë për të ndërtuar shtëpitë tona, në to jemi strehuar si partizanë, kemi luftuar kundër armiqve dhe në përpjekje me ta na janë vrarë shokë.

Megjithatë, këtë çështje të mos e marrim vetëm nga ana sentimentale. Konkretisht lënda e drurit që nxjerrim prej pyjeve është jashtëzakonisht e domosdoshme për ndërtimin e socializmit. Nevojat tona për lëndë druri me zhvillimin gjithnjë e më tepër të ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë nesër do të jenë akoma më të mëdha. Nevojat për shtëpi banimi do të vijnë vazhdimisht duke u shtuar. Kur ne të ndërtojmë një industri akoma më të madhe, kur ne ta kemi zhvilluar akoma më tepër se sot bujqësinë tonë socialiste, nevojat për lëndë druri do të jenë më të mëdha. Këto nevoja lidhen ngushtë me zhvillimin e industrisë, të minierave, të ndërtimit, të bujqësisë si dhe me përmirësimin e shëndetit të popullit.

Prandaj këtij problemi që na shtron përpara Partia duhet t'i kushtojmë kujdes të madh, d.m.th. të mobili-

zohemi totalisht për ta zgjidhur atë. Duhet ta kuptojmë mirë rëndësinë e madhe që ka për ne lënda e drurit dhe të jemi të sigurtë se do të mobilizojmë të gjitha forcat për kryerjen e kësaj detyre të rëndësishme që na vihet përpara.

Ky problem e ka preokupuar shumë Komitetin Qendror të Partisë. Po ta marrësh nga pikëpamja e përqindjes së sipërfaqes së vendit të zënë nga pyjet del se vendi ynë është pyjor, por po ta shikosh në thellësi problemin del se te ne sipërfaqen më të madhe të zonave pyjore e zënë shkurret dhe pyjet e degraduara, ndërsa pyjet me lëndë të përshtatshme për nevojat industriale janë të pakta.

Kjo gjendje është shkaktuar nga prerjet barbare që janë bërë në të kaluarën nga klikat sunduese dhe pushtuesit e vendit tonë. Por edhe pas Çlirimit organet e pushtetit tonë popullor nuk kanë prerë pak, vetëm se ato që janë prerë gjatë vjetëve të pushtetit tonë nuk u janë dhënë armiqve; me atë lëndë është rindërtuar vendi i shkatërruar nga lufta, janë krijuar qytete të reja, është ndërtuar industria jonë socialiste, si dhe shumë vepra të tjera të rëndësishme ekonomike dhe kulturele. D.m.th. lënda e drurit e prerë gjatë vjetëve të pushtetit popullor nuk ka shkuar kot, ajo ka shërbyer për të mirën e gjithë popullit.

Natyrisht gjatë kësaj pune të madhe janë bërë edhe gabime dhe këto kanë qenë të paevitueshme. Organizimi ynë i dobët në administrimin e pyjeve, mungesa e kuadrove pyjorë, sidomos nevojat e mëdha që kërkonte rindërtimi dhe ndërtimi i vendit, linin shteg për gabime. Nevojat e mëdha që kemi pasur na

kanë detyruar të prisnim në vendet ku për ne ishte më lehtë dhe kërkoheshin më pak shpenzime, pasi në kushtet tona nuk mund të bënim dot ndryshe. Kjo gjë ka bërë që ne sot të kemi deficite të mëdha në sektorin e pyllëzimeve. Prandaj kuadrot tanë duhet ta studjojnë me kujdes të madh raportin e Byrosë Politike që u mbajt nga shoku Hysni Kapo në Plenumin e Nëntorit të Komitetit Qendror të Partisë, sepse kështu do të kuptohen më mirë nevojat e mëdha që ka në përgjithësi vendi ynë dhe do të fillohet në mënyrë të ndërgjegjshme për realizimin e detyrave të rëndësishme që shtron plenumi.

Medoemos duhet t'i jepet rëndësi punës për pyllëzime edhe rreth kooperativave bujqësore ose lokaliteteve, por secili duhet të mendojë pak më larg, sepse çështja e pyllëzimeve në përgjithësi, e mbrojtjes dhe e mbarështrimit të pyjeve, është një çështje me rëndësi jetike nacionale që lidhet ngushtë me zhvillimin dhe përparimin e vendit. Duke e kuptuar çështjen kështu punonjësit do ta kuptojnë që pyllëzimi nuk duhet bërë vetëm rreth fshatit, por duhet të kryhen plotësisht të gjitha detyrat që cakton Komiteti Qendror në lidhje me pyjet, pasi ato kanë të bëjnë me interesat e të gjithë vendit, me interesat e të gjithë popullit dhe se përparimi dhe begatia e gjithë vendit do të sjellin edhe mirëqenien e çdo punonjësi veçanërisht.

Plenumi i Nëntorit i Komitetit Qendror konstatoi se shfrytëzimi i pyjeve, qoftë për nevojat e industrisë, ashtu edhe për drutë e zjarrit, nuk bëhet ashtu si duhet. Plenumi konstatoi gjithashtu se shumë lëndë druri humbet gjatë përpunimit. Prandaj u muar vendim që

gjatë pesëvjeçarit të tretë të përmirësohen dhe të bëhen prerje kulturele në rreth 40 mijë hektarë pyje të degraduara.

Natyrisht i duhet vënë rëndësi mbjelljes së pyjeve të reja, por njëkohësisht edhe përmirësimin e pyjeve të degraduara dhe mbarështrimin e tyre. Po të marrim masa për t'i përmirësuar brenda një kohe të shkurtër këto, ne do të kemi në këmbë pas pak vjetësh pyje të tëra, d.m.th. kemi leverdi më të madhe duke punuar për përmirësimin e pyjeve ekzistuese sa më shpejt.

Duhet pasur parasysh se pyjet janë të shtetit dhe shteti është i popullit. Të hollat që investon shteti janë përsëri të popullit. Shteti i rregullon të ardhurat kombëtare, që vijnë më shumë nga sektori i industrisë. Por fshatarësia duhet ta kuptojë që në të gjitha aksionet e mëdha me karakter nacional të japë edhe ajo kontributin e vet, prandaj është parashikuar që nga 40 mijë hektarë pyje të degraduara që duhen përmirësuar, 15 mijë hektarë duhet të bëhen me kontributin e fshatarësisë.

Si në çdo sektor edhe në këtë kërkohet organizim i shëndoshë. Pa organizim asgjë nuk mund të bëhet. Parulla dhe direktiva mund të hedhësh sa të duash, ato mund të jenë shumë të mira dhe të nevojshme, por, në rast se nuk organizohet mirë puna në bazë, ne nuk do të kemi sukses. Duhet punuar që çështja e pyjeve të kuptohet mirë nga fshatarësia, e cila nën udhëheqjen e klasës punëtore ka fituar gjithçka, jeta e saj do të bëhet po aq e ngritur sa edhe e qytetarëve dhe një ditë ajo do të shkojë në komunizëm.

Por në aktivizimin e fshatarësisë për këtë problem



t'i vihet kujdes i madh anës organizative. Ne duhet ta organizojmë mirë punën me fshatarësinë se karakteri i saj është i tillë që fare lehtë ajo mund t'i shpëtojë zbatimit pikë për pikë të direktivave, të cilat janë jetike për atë vetë. Këtë e theksoj, sepse dihet që te fshatarësia disiplina nuk është e fortë si te klasa punëtore, në punët e saja në përgjithësi nuk ekzistojnë ato rregulla e ligje si në fabrika e ndërmarrje, megjithëse edhe te disa punonjës në ndërmarrje e fabrika ekzistojnë mbeturina mikroborgjeze, sidomos te punëtorët e rinj e pa tradita. Edhe atje ka raste kur këto rregulla shkelen gjë që bën të ketë thyerje disipline, kohë të humbur pa punë etj. Megjithatë, në përgjithësi, në fabrika e ndërmarrje ka disiplinë, ka hov të madh në punë për realizimin me sukses të normave e në përgjithësi të të gjitha detyrave që shtrohen. Këto vijnë nga vetë karakteri i klasës punëtore dhe i punës së organizuar që bëhet me të. Kurse në fshat është ndryshe: në qoftë se për problemet që i dalin bujqësisë, si p.sh. për këto që po shtrojmë tani mbi pyllëzimet e ujitjen, nuk do ta organizojmë mirë punën, nuk do ta bindim kooperativistin për këto rregulla dhe ta bëjmë të punojë në kushtet e një organizimi të shëndoshë, nuk do të arrijmë aq shpejt ta nxjerrim bujqësinë në rrugën e madhe të përparimit.

Sukseset që kemi arritur në sektorin e bujqësisë pas Çlirimit janë të mëdha, por në krahasim me atë që duam të arrijmë përsëri ato janë të vogla. Prandaj duhet të bëjmë akoma një punë këmbëngulëse me fshatarësinë, sidomos nga ana organizative. Këtë gjë duhet ta bëjë Partia, ta bëjë organizata-bazë në fshat.

Ajo është motori që do ta çojë punën përpara. Shokët komunistë që punojnë në fshat duhet ta kuptojnë mirë çështjen e disiplinës, të organizimit dhe të edukimit në punë të fshatarëve me një frymë ashtu si e do klasa punëtore. Këtë punë mund ta bëjë vetëm organizata-bazë e Partisë.

Kështu dhe në çështjen e pyllëzimeve ka rëndësi të madhe organizimi, sepse me fjalë është lehtë të themi të pyllëzosh, po kjo në fakt nuk është një punë aq e lehtë. Ju në diskutimet tuaja përmendët plot fakte kur janë hapur gropa dhe fidanet nuk janë mbjellë nga pakujdesia, ose kur nuk merren masa për krijimin e fidanishteve etj.

Është e qartë se po të themi që të gjitha detyrat do të zbatohen menjëherë do të gënjejnë veten. Por ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm se në punë do të kemi vështirësi, prandaj duhet të mobilizohemi totalisht për t'i kapërcyer ato sa më shpejt.

Ashtu sikurse vendosi Plenumi i Komitetit Qendror, gjatë pesëvjeçarit të tretë ne do të pyllëzojmë 20 mijë hektarë tokë dhe deri në vitin 1975 — 60 mijë hektarë. Nga këto, gjysma e punës do të kryhet me ndihmën e fshatarësisë. Duhet të bëhen pyllëzime sa më shumë në blloqe të mëdha, sepse ato ruhen më mirë.

Përpara se të bëhej Plenumi i Komitetit Qendror për problemin e pyllëzimeve dhe të ujitjes, këto çështje u shtruan në bazë, u studjuan atje dhe pastaj u konkretizuan në referatet dhe në vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror. Megjithatë, ne shokët e Byrosë Politike të Komitetit Qendror, jemi të mendimit se për këtë problem ka akoma shumë gjëra për të cilat baza

duhet të dëgjohet akoma. Edhe në këtë aktiv dëgjuam shokë që propozuan shtesa mbi detyrat që janë caktuar në vendimet e plenumit. Edhe unë kështu mendoj, se në ato vendime ka akoma shumë për të shtuar. Mund të ketë edhe për të hequr, po Komiteti i Partisë dhe Komiteti Ekzekutiv i Rrehit të Elbasanit të punojnë edhe një herë që detyrat për çështjen e pyllzimeve t'i thellojnë gati për çdo kooperativë bujqësore. Kështu të veprohet edhe për problemin e ujitjes. Pastaj ata t'i koordinojnë akoma më mirë këto probleme dhe t'ua bëjnë të qarta shokëve që folën. Duhet gjithashtu t'u thuhet qartë edhe fshatarëve për mundësitë e shtetit dhe për mundësitë e tyre në realizimin e këtyre detyrave.

Plani i pyllzimeve është bërë për 15 vjet, periudhë gjatë së cilës do të investohen rreth 6 miliard lekë, por ne këtu po shtrojmë konkretisht detyra për pesëvjeçarin që vjen. Fare lehtë mund të bëhen edhe investime të tjera, po nuk kemi vetëm këtë problem për të zgjidhur. Gjatë pesëvjeçarit të tretë ne duhet të mbarojmë hidrocentralet që janë filluar, të ngremë vepra të reja të rëndësishme industriale, metalurgjinë e zezë që ka mundësi të ndërtohet këtu në Elbasan. Vetëm kjo vepër që është kolosale për vendin tonë do të kostojë miliarda. Në rast se një kooperativist do ta shikojë këtë punë me syrin e ngushtë të fshatit, do të mendojë «ç'na duhen ne këto gjëra të mëdha». Por pa zhvillimin harmonik dhe proporcional të të gjitha degëve të ekonomisë sonë, ne nuk mund të rrojmë si duhet. Ndërtimi i të gjitha këtyre veprave do të sjellë përparimin e madh edhe në bujqësi, pra edhe pasurimin e kooperativistëve tanë,

sepse të gjitha veglat që kërkon bujqësia bëhen me metal, me hekur.

Për fat të mirë, këtu afër Elbasanit, kemi gjetur rezerva të mëdha hekuri. Bile kemi edhe nikel, që është një metal shumë i vlefshëm. Këto rezerva bënë të mundshme që, në bazë të kërkesave të Komitetit Qendror dhe të qeverisë, në sesionin e fundit të Këshillit Ekonomik të Ndhmës Reciproke miqtë tanë vendosën që në Shqipëri të ngrihet metalurgjia e zezë. Për këtë vepër të madhe ne do të na ndihmojnë BRSS në radhë të parë dhe vendet e demokracisë popullore<sup>1</sup>. Natyrisht, për ngritjen e një vepre të tillë, nuk mjaftojnë një ose dy vjet, po disa vjet me radhë. Do të kalohet bile edhe në pesëvjeçarin e katërt, pa të mbarohet. Në pesëvjeçarin e tretë ndoshta mund të përfundojë ndërtimi i dy furrave të mëdha për përpunimin e metalit para mbarimit përfundimtar të kësaj uzine në të cilën do të punojnë disa mijëra punëtorë. Kështu Elbasani, që edhe tani nuk qëndron prapa me zhvillimin industrial, atëherë do të bëhet një rreth industrialo-agrar shumë i përparuar. Kur të ngrihet metalurgjia e zezë të ardhurat nga industria kanë për të zënë rreth 80 për qind të të ardhurave të popullatës së rrethit. Shihni pra ç'perspektiva të shkëlqyera!

---

<sup>1</sup> Koha tregoi se premtimet e udhëheqësve revizionistë sovjetikë dhe të vondeve të demokracisë popullore anëtare të KNER-it ishin vetëm demagogji. Ata jo vetëm që nuk na ndihmuan për të ndërtuar këtë vepër, por prenë kreditë edhe për të gjitha veprat e tjera të planit të tretë pesëvjeçar.

Ndërtimi i kësaj vepre filloi në pesëvjeçarin e pestë nga populli ynë me ndihmën internacionaliste të RP të Kinës.

Shpenzimet e mëdha që po bëhen për zhvillimin e ekonomisë sonë popullore, do të sjellin fryte më vonë kur të përfundojnë këto vepra të mëdha që do t'i sjellin ditë akoma më të lumtura popullit tonë.

Në të vërtetë shuma prej rreth 6 miliardësh, që do të investohet vetëm për pyllëzime gjatë 15 vjetëve, nuk është e vogël. Tani duhen bërë përpjekje që pyllëzimet të bëhen mirë. Prandaj nga komiteti ekzekutiv i rrethit të merren masat që parashikohen: të ngrihen fidanishtet, të zgjidhet mirë fara, të mbillen bimët me kohë dhe sipas metodave të përparuara agroteknike etj. Rëndësi ka jo vetëm ta ngulësh fidanin në tokë, po të marrësh masa që edhe të ruhet e të rritet. Po të mos i bëhet kujdesi i duhur bimës ajo mund të rritet edhe vetvetiu, po jo në shkallën dhe gjerësinë që kërkohet.

Njëkohësisht duhet të merren masa edhe për mbrojtjen e pyjeve dhe të mos qëndrohet si deri tani. Duhet thënë haptazi se ekziston akoma te shumë njerëz mentaliteti i vjetër që pylli është i shtetit dhe të mos tregohet asnjë kujdes për të. Pylli është i shtetit, por tani që populli është në fuqi, ai është pasuri e të gjithë popullit. Prandaj jashtë ligjeve nuk ke të drejtë t'i prekësh pyjet. Megjithatë, në këtë drejtim, pyjet priten e shkallmohen si pa gjë të keq. Kjo duhet kuptuar mirë nga fshatarët, nga entet që shfrytëzojnë pyjet, nga fabrikat që përpunojnë drurin si dhe nga artizanati. T'i ruajmë pyjet dhe të ekonomizojmë lëndën e drurit që është shumë e nevojshme për zhvillimin e ekonomisë sonë, sepse jemi deficit. Por, që të mbrohen pyjet, duhet punuar për t'i bindur fshatarët dhe ata që i

presin, e njëkohësisht të zbatohen ndaj shkelësve edhe masat që parashikojnë ligjet.

Ata që janë ngarkuar me mbrojtjen e pyjeve duhet të jenë të pamëshirshëm ndaj atyre që presin lëndë jashtë rregullave, ose pa leje, të dënohen pa hezitim dhe të bëhen shembull për të tjerë. Në Çekosllovakia e në vende të tjera ka shumë pyje të bukura, të pastra, të prera në rregull sepse atje ka punuar mirë dora e njeriut. Atje nuk pret njeri ku i do qejfi, se të tërë e kanë kuptuar mirë rëndësinë e madhe që ka pylli.

Çështja që rekomandon Plenumi i Komitetit Qendror për të mbjellë pyje të reja në blloqe të mëdha bëhet me qëllim që ato të ruhen më mirë, që në to të mos kullosin dhitë. Te ne dhija është armiku më i madh i pyjeve. Do të vijë koha që gradualisht dhija të zëvendësohet, se dëmton pyjet, sidomos pyllëzimet e reja. Natyrisht kjo do kohë. Dhitë nuk do të lihen të kullosin nëpër pyje, krande nuk do të lejohet të priten, në fushë ushqim për dhinë nuk do të gjendet, atëherë fshatarët do të mendojnë të rritin të tjera kafshë.

Këto masa ne i marrim jo se u duam të keqen atyre që kanë dhi, po duhet kuptuar nga të gjithë se pasuria pyjore është shumë më e rëndësishme nga dhitë që rritim në fshatra. Ndonjë fshatar mund të thotë se pylli është pasuri e shtetit dhe ai nuk përfiton gjë prej tij. Po ai duhet ta kuptojë se, duke u forcuar ekonomia pyjore, do të shikojë sa të mira do t'i vijnë edhe atij vetë, sepse kur të kemi më shumë pyje, më tepër lëndë druri se tani, do të sigurohet edhe fshati për ndërtim shtëpish e nevoja të tjera. Tani shumë

janë ata që duan të bëjnë shtëpi të reja në qytet dhe në fshat. Edhe në Elbasan ka shumë individë që janë të gatshëm të ndërtojnë shtëpi të reja me të hollat e tyre e dikush edhe me kredit bankar. Kjo është një gjë shumë e mirë, po që t'i plotësojmë të gjitha kërkesat nuk kemi materiale se na mungon lënda e drurit dhe çimentoja. Luftojmë që këto materiale t'i kemi me bollëk po vetëm pas disa vjetësh mund të japim në sasi më të mëdha.

Në vendimin e Plenumit të Komitetit Qendror ngrihet edhe çështja e luftës kundër erozionit. Veçanërisht ju, e dini sa rëndësi ka kjo luftë, se vuani nga Zaranika<sup>1</sup>. Prandaj Komiteti Qendror e ngre me forcë problemin e organizimit të luftës kundër erozionit, për mbrojtjen e pyjeve dhe të tokave bujqësore. Për këtë qëllim parashikohet të ndërtohen prita të vogla, tarraca etj., që të shpëtojnë nga erozioni sa të jetë e mundur më shumë toka. Çdo kooperativë bujqësore duhet të caktojë detyra konkrete për këtë çështje. Shteti parashikon të bëjë 100 mijë metra kub vepra përforcimi për mbrojtjen e pyjeve dhe të tokave nga erozioni. Një vëllim pune në këtë masë rekomandohet në vendim të bëhet edhe nga ana e kooperativave.

Rëndësi të madhe për zhvillimin e ekonomisë pyjore ka çështja e personelit pyjor. Këta duhet t'i edukojmë dhe t'i shtojmë. Pa hedhur poshtë punonjësit e pyjeve të vjetër nga mosha, po që kanë një eksperiencë të madhe, ne duhet të punojmë njëkohësisht që të ngremë edhe kuadro të rinj, më me kulturë, të cilët

---

<sup>1</sup> Përrua i rrëmbyer në afërsi të qytetit të Elbasanit.

të ndihmohen nga të vjetrit, që kanë eksperiencë dhe shërbejnë akoma. Kuadrot e rinj pyjorë jo vetëm duhet të jenë të zgjuar, por edhe me kulturë të lartë, sepse ne nuk kemi ndër mend të krijojmë pyje të reja të egra e pak prodhuese, po pyje me rendiment të lartë. Në bazë të sipërfaqeve pyjore që disponojmë ne kemi fare pak kuadro pyjorë dhe ata nuk janë në lartësinë e duhur teknike. Prandaj po merren masa që të shtohet numri dhe të përmirësohet niveli i tyre arsimor. Por punonjësit e pyjeve të respektohen dhe të ndihmohen nga Partia dhe fshatarësia. Të mos krijohet për ta përshtypja se janë ca pojakë të egër që rrinë nëpër pyje dhe nuk të lënë rehat të vesh të presësh ose të gjuash. Partia t'i përkrahë ata se janë punonjës shumë të vlefshëm dhe se puna e tyre është shumë e vështirë, gjë për të cilën duhet të bëhen të ndërgjegjshëm. Ata nuk janë njerëz vetëm për të vënë gjoba kundër shkelësve të ligjeve mbi pyjet, po që kanë në duart e tyre ekonominë pyjore bashkë me kafshët e egra që rrojnë në pyje.

Detyra e rojtarëve të pyjeve është me rëndësi, ajo kërkon njerëz të zot, të shkathët dhe të ndërgjegjshëm. Prandaj Partia, sidomos organizata-bazë në fshat, duhet t'i edukojë dhe t'i përkrahë ata, në mënyrë që të kryejnë si duhet detyrat. Ata, në erën e ftohtë të maleve, duhet të ndjejnë kudo ngrohtësinë dhe kujdesin e Partisë, ndryshe futen në kasolle dhe nuk çajnë kokën fare për këtë pasuri kaq të çmueshme të popullit. Kur të shohin se Partia i mbron dhe i përkrah, ata do të jenë më vigjilentë dhe do të punojnë më mirë që pyjet të mbrohen dhe të ruhen edhe kafshët e egra që jetojnë në to.



Më ka rënë rasti të vizitoj pyje si në Çekosllovakia e gjatë e të shoh si punojnë punonjësit e pyjeve dhe ç'arsim kanë. Shumica e tyre kanë arsim përkatës dhe vite të tëra jetojnë në pyje. Bile ka njerëz të apasionuar për pyllin që u vjen keq po t'i heqësh nga ajo punë. Ata i njohin pyjet pëllëmbë për pëllëmbë, njohin sa kafshë ka në to dhe çfarë kafshësh janë; dinë sa shtohen çdo vit dhe për këtë nuk gabojnë aspak, sepse i njohin mirë pyllin dhe kafshët e tija. Ata kanë fonde të posaçme që i harxhojnë për të ushqyer kafshët e pyllit dhe kështu kur u hedhin ushqim në dimër, kur ky mungon në natyrë, kanë rast t'i shohin sa janë dhe t'i regjistrojnë. Mbi këtë bazë ata planifikojnë edhe sa kafshë të egra duhen skartuar dhe cilat duhen skartuar në pyllin për të cilin ata kujdesen. Mbi këtë bazë jepen edhe lejet për të gjuajtur në çdo rajon pyjor. Çdo rojtar pylli di më parë edhe gjuetarët që do të vijnë për gjah dhe kur do të vijnë. Atje nuk të lë njeri të gjuash pa pasur autorizimin përkatës nga shefi i zyrës së pyjeve. Në autorizim përcaktohet edhe sa dhe çfarë kafshe lejohet të gjuash. Po nuk pate leje, cilido qofsh ti, ai të merr pushkën dhe të çon në polici si shkelës të ligjeve të gjuetisë dhe të pyjeve.

Një kujdes i tillë që tregohet për pyjet ka bërë që ato të ruhen e bashkë me to edhe kafshët e egra dhe të sigurojnë të ardhura shumë të mëdha si nga ekonomia pyjore ashtu dhe nga gjuetia e organizuar dhe e kontrolluar.

Edhe te ne gjuetia duhet të bëhet në mënyrë më të kulturuar dhe jo si deri tani. Shoqëria e gjuetarëve ka hapur kudo klube që shesin kafe dhe ëmbëlsira.

Klubet, shoqëria le t'i hapë në male, atje ku ka gjah, atje ku mund të shkojë gjahtari dhe të gjejë një farë komoditeti në mes të pyllit, d.m.th. të ketë ku të flejë dhe të ushqehet. Kështu bëhet kudo, prandaj edhe te ne s'ka kuptim të hapen klube në qytete, si ai në Tiranë, ku është okupuar një lokal i madh nga shoqëria e gjuetarëve dhe venë njerëzit luajnë bilardo.

Çdo gjë e shtetit është e të gjithë popullit. Edhe kafshët e egra janë pasuri e shtetit, pra pasuri e të gjithë popullit. Prandaj askush nuk ka të drejtë ta shfrytëzojë personalisht. Në qoftë se ti si gjahtar vret një derr ose disa rosa të egra, mishin duhet ta dorëzosh në organet e grumbullimit dhe nuk ke të drejtë të mbash përveç asaj që caktohet në rregullore. Gjetkë gjahtari ka të drejtë i pari të blejë me para, nga gjahu që ka vrarë, një sasi mishi.

Shumë njerëz janë të apasionuar pas gjahut. Bukur, shko dëfre duke gjuajtur, merr edhe një lepur, po të duash, nga ata që ke vrarë, po të tjerët duhet t'ua dorëzosh organeve shtetërore. Nuk është e drejtë kështu si është bërë deri tani te ne: hajde vra sa të duash dhe asgjë mos i jep shtetit. Po vrave, në mos e dorëzofsh, duhet të të vijë nëpunësi i grumbullimit dhe të ta marrë. Prandaj edhe ne tani mundet dhe duhet të vëmë disa rregulla të tilla që mendoj se janë të drejta.

Përveç pyllëzimeve, mbarështrimit, ruajtjes, ngritjes së kuadrit ka rëndësi të madhe edhe çështja e shfrytëzimit racional të lëndës së drurit. Po të vesh në Pukë do të gjesh shumë ndërmarrje që merren me shfrytëzimin e pyjeve. Kjo çështje tani duhet të përqëndrohet në një dorë të vetme, në atë të Ministrisë së

Industriisë. Për organet e Ministrisë së Ndërtimit do të lihet edhe një vit afat për të prerë si deri tani, sa të organizohet mirë kjo punë. Në këtë mënyrë mendojmë se do të ekonomizohet më mirë lënda e drurit.

Një tjetër çështje me rëndësi është që brenda këtij pesëvjeçari të bëhen 400 km rrugë të reja pyjore. Kjo punë natyrisht na kushton shumë, po jemi në pamundësi të bëjmë ndryshe. Përveç kësaj do të marrim edhe disa masa për zgjerimin e rrjetit teleferik që është shumë i përshtatshëm për zonat malore. Po ky rrjet do të jetë i kufizuar sepse teleferikët duhen importuar dhe kërkojnë devizë të huaj, prandaj nuk jemi në gjendje të blejmë shumë. Po disa teleferikë me gjatësi të vogël dhe që mund të zhvendosen shpejt për t'i vendosur në ato vende që nuk i arrijmë dot me rrugë automobilistike, kemi leverdi t'i blejmë.

Kujdes i madh duhet të bëhet nga konsumatorët në trajtimin e lëndës së drurit. Komiteti Qendror rekomandon që kudo të ulen normat e konsumit të drurit. Në këtë aktiv me të drejtë u fol shumë për këtë çështje, sepse në Elbasan ndodhet edhe kombinati i drurit, ndërmarrja më e madhe e vendit tonë për shfrytëzimin e lëndës së drurit. Në këtë ndërmarrje janë bërë mjaft përparime në punë çdo vit, po akoma ka shumë rezerva për të shfrytëzuar dhe shumë ekonomi për të bërë.

Që të ekonomizojmë lëndën e drurit, duhet pasur parasysh të vëmë në jetë edhe të gjitha racionalizimet që u përmendën këtu; ato duhet të mos mbeten në letër, po të vihen në jetë sa më parë.

Më bëri përshtypje fjala e inxhinierit të bonifiki-

meve, në diskutimin e të cilit dukej qartë se i dhimbset puna dhe i vjen keq që janë konstatuar gjithë ato të meta për të cilat u fol këtu. Partia na mëson se kundër të metave duhet luftuar që të zhduken. Mirë bëri ai që e lëvdoi kryetarin e komitetit ekzekutiv të rrethit për përkrahjen që ka dhënë për zhvillimin e ekonomisë pyjore, po duhet thënë edhe fakti se ndërmarrja, me të metat e mëdha që u përmendën këtu, nga kush varet? Prandaj unë i thashë atij në fillim që t'u hidhte lule atyre që kanë punuar mirë, po ama t'u bënte nga një kritikë edhe për ato që nuk kanë realizuar ose për gabimet e tyre. Mirëpo për dobësitë e shokëve përgjegjës ai nuk foli fare. Mund të bëjë gabime dhe lëshime një ndërmarrje ose përgjegjësi i saj, po ti që je më lart duhet t'i kërkosh llogari deri në një. Kështu ai do t'i vërë gishtin kokës dhe do të mendojë e do të bëjë të gjitha përpjekjet për përmirësimin e punës. Që të kryhen mirë detyrat duhet t'u shtërngohen mirë rripat atyre që bëjnë lëshime. Në këtë drejtim duhet luftuar me këmbëngulje dhe vazhdimisht.

Rinia duhet të luajë një rol të madh në çështjen e pyllëzimeve. Lidhur me aksionet që kanë të bëjnë me pyllëzimet, si p.sh. me javën pyjore, duhet të vihet në lëvizje rinia se ajo është në gjendje të bëjë punë të mëdha. Kjo nuk do të thotë që të tjerët të vënë këmbën mbi këmbë; të gjithë, burra e gra, duhet të punojnë, po natyrisht i riu ka më shumë dinamizëm.

Është karakteristikë ajo që konstatojmë se gratë tona punojnë më shumë nga burrat, por konsiderata për gruan, jo vetëm në fshat, po edhe në qytet, bile edhe te komunistët që duken shumë të përparuar, në

një formë ose në një tjetër, nuk është në lartësinë e duhur. Prandaj ta shohim drejt këtë çështje. Kjo nuk është jashtë temës për të cilën jemi mbledhur. Gruaja është një nga faktorët më vendimtarë të ndërtimit të socializmit. Pa gruan nuk shkohet në socializëm dhe asgjë nuk mund të bëhet ashtu siç porosit Partia.

Rëndësi shumë të madhe ka pjesëmarrja e gruas në shoqëri, në punë, në gëzimin e të drejtave të barabarta me burrin. Bile marksistët duhet të heqin diçka nga vetja dhe t'ia japin gruas se ajo ka qenë më e vuajtur, asaj i ka dhëmbur më shumë zemra dhe kurrizi. Nuk është e drejtë kur shihet se nuk mbahen sjellje të mira ndaj gruas, kur ajo nuk ndihmohet që të ecë përpara në jetë dhe të përparojë, kur përkundrazi i ngarkohen të gjitha punët edhe ato që ajo nuk duhet t'i bëjë e megjithatë nuk mbahet qëndrim. Partia nuk thotë kot të futen gra në Parti, të bëhen brigadiere, anëtare të kryesisë ose edhe kryetare të kooperativave bujqësore në fshat. Këtë Partia e thotë se gratë janë të zonjat sa edhe burrat, nganjëherë bile edhe më të zonjat.

Tani është përmirësuar gjendja e grave në Parti, po jemi akoma larg asaj që duhet të jemi. Në fund të vitit Byroja Politike ka kërkuar nga aparati i Komitetit Qendror të dijë sa burra dhe sa gra komuniste janë përjashtuar nga Partia gjatë këtij viti, sa kanë vërejtje, sa janë dënuar për përvetësime. Me siguri do të dalë se gra, në mos fare, janë përjashtuar shumë më pak nga Partia, sepse në radhët e grave ka shumë më pak përvetësuese dhe grabitëse të pasurisë socialiste ose nga ato që të kenë shkelur moralin proletar. Kjo tregon një

karakteristikë të lartë të grave dhe të komunisteve tona që janë në Parti. Dënimet më shumë i marrin burrat. Prandaj duhet futur gruaja në Parti, natyrisht jo pa e merituar. Të vepohet sipas kërkesave të Statutit, ashtu sikurse bëhet edhe për burrat, dmth të futen ato gra që e duan Partinë, që punojnë shumë mirë, që kanë ndërgjegje të lartë dhe janë të sakrificës.

Edhe në kooperativat bujqësore, kur e meritojnë, vini më shumë gra në udhëheqje dhe t'i mbështetë Partia një vit, dy vjet, pastaj të shikoni çfarë disipline dhe rregull do të vënë ato dhe si do të qëndrojnë kooperativistët përpara tyre me respekt. Po, për këtë duhen përkrahur. Në qoftë se i vëmë vetëm pse na thotë Partia dhe nuk i përkrahim, atëherë burrat do ta mbulojnë zërin e tyre në kooperativë, ato do të dëshpërohen dhe do ta ndjejnë veten të dobët.

\*  
\*   \*  
\*

Për ujitjen është bërë një punë mjaft e madhe pas Çlirimit. Është shtuar shumë sipërfaqja e tokave nën ujë dhe janë përmirësuar tokat. Asnjërit prej fshatarëve tanë nuk i shkonte në mendje që brenda pak vjetëve të bënim vepra kaq të mëdha, siç janë tharja e kënetës së Maliqit, të Tërbufit, të Bodenit, sistemimi dhe ndërrimi i shtretërve të lumenjve si të Gjadrit, Bistricës etj., kullimi i shumë fushave si ato të Myzeqesë, Zadrimës, Korçës, Kavajës etj. nga të cilat janë përfituar rreth 13 mijë hektarë toka të reja dhe janë përmirësuar

rreth 55 mijë hektarë toka të tjera pune. Kjo punë është në vazhdim.

Ju i dini planet e ardhshme për këto probleme. Janë në mbarim e sipër vepra kullimi si fusha e Roskovecit, e Hoxharës etj. dhe mund të themi se brenda pesëvjeçarit të tretë do të kemi mbaruar pothuaj nga bonifikimet e të gjithë Shqipërisë. Ky është një sukses shumë i madh për fshatarësinë tonë.

Natyrisht e gjithë kjo punë u bë në saje të mobilizimit të madh të Partisë, të kuptimit të drejtë nga fshatarësia jonë e kësaj çështjeje të madhe jetike.

Ne synojmë të përfitojmë sa më shumë toka, t'i kullojmë dhe t'i ujitim ato, t'i punojmë me mekanizma. Humbje të mëdha ka ekonomia jonë bujqësore vetëm nga vonesa në mbjelljen e kulturave bujqësore. Veçanërisht këtë vit shirat na kanë dëmtuar shumë, gjë që ka bërë të kemi rreth 30 mijë hektarë toka pa mbjellë në vjeshtën e këtij viti, të cilat janë lënë për t'u mbjellë në pranverë. Por në pranverën e ardhshme mund të gjendemi përsëri në një situatë të vështirë, po të kemi përsëri kohë me shira të mëdha. Kjo na vë si detyrë të shtojmë brenda mundësive mekanizmat që të përfitojmë nga koha e mirë dhe të mbjellim sa më shpejt. Këtë vit pambuku erdhi me vonesë, prandaj akoma nuk dimë nëse do të arrijmë realizimin e planit deri në 80 për qind, megjithëse bima u zhvillua mjaft mirë. Nga koha e keqe, pra, ne kemi shumë humbje për shkak të mungesës së mbjelljes në kohën e duhur. Përveç mbjelljes në afate sa më të shkurtëra ne duhet të marrim masa për plehërimin, mekanizimin e punimeve dhe ujitjen e bimëve.

Përsa i përket ujitjes, në vitin 1965 do të arrijmë të ujitim rreth 40 për qind të sipërfaqeve të punueshme dhe mendojmë se kjo shifër nuk është e vogël. Kjo për ne është një fitore e madhe që duhet ta arrijmë. Ju e dini rëndësinë e madhe që ka ujitja në bujqësi dhe se si duhet bërë ajo. Teknikën e ujitjes duhet ta njihni në radhë të parë ju, shokë komunistë, drejtues të organizatave-bazë, kryetarë të kooperativave bujqësore dhe ta merrni seriozisht këtë çështje, të bëni sa të jetë e mundur më shumë seminare me fshatarët, t'i kuptoni dhe t'i zbatoni si duhet metodat e reja shkencore të ujitjes. Po të bëhet kështu do të arrihen suksese si ato të kooperativës së Shalësit që ka mundur të marrë misër hamullor 23 kv për hektar. Ky është një sukses i mirë, duke marrë parasysh se i gjithë rrethi si kulturë të parë ka marrë mesatarisht 13 kv misër për hektar. Një sukses të tillë ka mundësi ta arrijnë të gjitha kooperativat, po, që të sigurohet ky sukses, kudo duhet që drejtuesit e kooperativës dhe organizata bazë e Partisë t'i vënë kujdes të madh kësaj çështjeje.

Rrethi i Elbasanit është shumë i favorizuar nga ujërat. Ju keni shumë mundësi për të ujitur. Prandaj sipërfaqja prej 5 800 hektarësh që ka vendosur Plenumi i Komitetit Qendror për rrethin tuaj, është një shifër reale, që do të realizohet plotësisht në rast se organizata e Partisë dhe të gjitha organet e pushtetit do të mobilizohen, do të sqarojnë së pari fshatarësinë për kryerjen e këtyre detyrave. Unë jam i sigurtë se me pak shpenzime po me punë ato do të kryhen dhe fitimet do të jenë të mëdha bile brenda një kohe prej 4-5 vjetësh. Prandaj këtij problemi duhet t'i vëmë rëndësi të madhe.



Në vendim janë vënë një sërë detyrash për të cilat u fol në raportet që paraqitën sekretari i komitetit të Partisë dhe kryetari i komitetit ekzekutiv.

Për problemin e ujitjes duhet të studjohen në hollësi të gjitha mundësitë që ka kooperativa bujqësore dhe t'i shfrytëzojë deri në fund. Shteti do të japë ndihmë aq sa thotë, deri në 30 për qind, por jo më shumë. Pra mbi këtë shifër të bëhen edhe llogaritë. Prandaj kooperativat bujqësore të studjojnë mirë mundësitë që kanë, t'i hedhin mirë në letër dhe pastaj t'i propozojnë komitetit të Partisë dhe komitetit ekzekutiv në rreth se çfarë kanalesh ose hauzesh u interesojnë dhe parashikojnë të bëjnë.

Për të kryer të gjitha këto detyra kaq të rëndësishme për ngritjen e mëtejshme të ekonomisë sonë bujqësore, fshatarët duhet të bëjnë në kooperativë jo 120 dhe 130 ditë-pune, as 200, por 360 ditë-pune në vit dhe këto t'i bëjnë duke qenë të organizuar mirë. Atëherë fshatari do të shikojë se sa shpejt do të rritet ekonomia dhe mirëqenia e tij, rritje kjo që do të arrihet vetëm me punë të palodhur dhe me djersë.

Në çdo kooperativë të llogariten mirë forcat e krahut dhe të vihen të gjitha në punë, pastaj edhe shteti do të japë ndihmë. Po pse nuk jep shteti më shumë se 30 për qind? Ju e dini se shteti është i juaji, i punëtorëve dhe i fshatarëve, por në kushtet e tanishme mundësitë e tija kaq janë. Prandaj në çdo kooperativë të llogariten mirë të gjitha mundësitë ekonomike dhe në të holla, zotësia e njerëzve, mençuria e organizimi i tyre dhe të fillohet nga puna.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë që u mbledh para disa ditësh, ashtu siç e keni parë në shtyp, analizoi realizimin e planit gjatë katër vjetëve të pesëvjeçarit të dytë dhe detyrat për vitin e ardhshëm. Sikurse e lexuat, në punët tona ne kemi akoma shumë të meta, po kemi edhe shumë suksese. Në sektorin e industrisë, plani jo vetëm është realizuar po edhe është tejkaluar, me gjithë shtesat që iu bënë në Plenumin e Shkurtit të vitit 1958. Planit është realizuar edhe në shumë sektorë të tjerë si në atë të ndërtimeve, në qarkullimin e mallrave, në rritjen e mirëqenies së popullit. Deri në fund të këtij pesëvjeçari mirëqenia e popullit do të realizohet ashtu siç e ka vendosur Kongresi III i Partisë. Me suksese të tilla ne kemi me se të vemi në Kongresin e ardhshëm të Partisë.

Por duhet thënë se në sektorin e bujqësisë ne kemi mjaft deficite, që nuk janë të vogla. Gjatë katër vjetëve ne kemi krijuar mjaft deficite për arsye se nuk janë realizuar planet dhe rendimentet e kulturave bujqësore ashtu sikurse janë vendosur në Kongresin III të Partisë dhe në Plenumin e Shkurtit të vitit 1958. Në këtë mosrealizim ka arsye subjektive, po ka edhe arsye objektive. Fshatarësia jonë u mobilizua mirë në fillim të pranverës së këtij viti, mbolli në kushtet dhe në kohën më të mirë nga vjetët e kaluar, po shirat e mëdha penguan realizimin e prodhimeve në masën e parashikuar.

Kur bëjmë analizën e punës sonë ne duhet t'i shohim arsyet objektive, por ne kemi edhe mjaft të meta subjektive që na pengojnë shumë në realizimin e detyrave. Partia duhet ta forcojë akoma punën në

sektorin e industrisë, ta kalitë akoma më shumë klasën punëtore, ta mobilizojë dhe ta edukojë atë me një frymë disipline më të fortë në punë; po Partia duhet ta kthejë fytyrën edhe nga fshati sidomos në drejtim të forcimit organizativ të punës dhe të edukimit teknik të kooperativistëve.

Ne kemi arritur një sukses shumë të madh në fshat, kemi kolektivizuar pjesën më të madhe të ekonomive bujqësore me vullnetin e vetë fshatarësisë. Por tani kooperativat që kemi ngritur duhet t'i forcojmë nga ana organizative. Në zbatimin e statutit të kooperativave bujqësore dhe të vendimeve të qeverisë për kooperativat, në lidhje me punën me norma, me oborret kooperativiste dhe për shumë probleme të tjera, ka dobësi të mëdha që pengojnë përparimin e shpejtë të kooperativave. Partia në këto çështje duhet të mobilizohet totalisht, në radhë të parë të ngrejë në shkallë të madhe te fshatarësia jonë dashurinë për punë në kooperativat bujqësore. Toka do të na japë aq sa punë do t'i bëjmë ne. Në qoftë se ne e organizojmë mirë punën dhe punojmë shumë, prodhimet nga toka do të jenë të mëdha.

Por ka fshatarë që kërkojnë të ikin nga fshati për të punuar në ndërmarrje të shtetit. Këtë çështje Partia ta analizojë mirë ku e ka shkakun, po më duket se disa fshatarë nuk e kuptojnë interesin e tyre. Ne kemi dhe do të kemi nevojë në qytete për punëtorë për nevojat e industrisë, të ndërtimeve etj. Për të ngritur veprat madhështore të vendit tonë, muratorët, karpentierët etj., patjetër duhet të vijnë nga fshati, të sigurohen

nga radhët e fshatarësisë. Po kjo punë duhet të bëhet në mënyrë të organizuar.

Në përgjithësi ardhja e fshatarëve në qytet për punë të bëhet si thashë në mënyrë të organizuar, d.m.th. të mos ikin pa leje. Në të vërtetë tani ne kemi krijuar disa pengesa që të mos vijnë nëpër qytete njerëzit sipas dëshirës. Kjo bëhet për të mirën e fshatarit, që ai të qëndrojë në fshat, sepse nuk ka çfarë do në qytet një fshatar, kurse në fshat lë tokën dhe shtëpinë. Komiteti ekzekutiv i rrethit ka të drejtë të mos i bëjë një njeriu të tillë pashaportizimin, sepse, duke ardhur në çdo kohë, nuk do të ketë punë për të, kurse mundësitë që të punojë në fshat i ka, prandaj nuk ka përse të lejohet të jetojë si parazit në qytet. Nderi i njeriut është në punë. Prandaj të forcohet ndërgjegjja e njerëzve për punën.

Fshatarët e kuptojnë se niveli i jetesës së klasës punëtore është më i ngritur nga ai i tyre. Po ne kemi shumë kooperativa ku është organizuar mirë puna e ku është përmirësuar shumë jeta e kooperativistëve. Kjo ka ardhur sepse organizatat-bazë i kanë bërë të ndërgjegjshëm kooperativistët, të cilët pastaj me punën e tyre kanë siguruar të ardhura të bollshme, kanë ngritur shtëpi me shumë dhoma, kanë radio, krevate dhe ushqehen mirë. Toka mund të të japë sa të duash po ta punosh. Prandaj të krijohet një situatë e tillë në kooperativat bujqësore që kooperativisti ta dojë dhe t'i përvishet si duhet punës.

Çështja tjetër që doja të theksoja ka të bëjë me disiplinën në punë, e cila luan një rol të madh jo

vetëm në kooperativat bujqësore ku prodhimet janë të pakta, po edhe në disa kooperativa të përparuara. Shumë herë shikon kooperativistë që venë në punë në orën nëntë të mëngjesit. Kjo nuk është aspak e mirë. Dihet se punëtorët shkojnë në fabrika që në orën 6 ose 7 të mëngjesit. Kështu duhet të shkojnë edhe kooperativistët në punë, aq më tepër kur dihet se fshatarët kurdoherë herët janë çuar të punojnë. Ka pastaj edhe raste të tilla kur në ndonjë kooperativë mbahet një njeri i veçantë e i paguhet edhe dita e punës vetëm për t'i rënë këmbanës që kooperativistët të lënë punën pasdite. Këto nuk janë të drejta, por në dëm të interesit të kooperativistëve.

Pastaj shumë fshatarë kooperativistë ditët e diela zbresin në pazar, duke humbur kohë të vlefshme për punë. Ata duhet të përfitojnë nga ditët e diela me kohë të mirë dhe të punojnë e të mos shkojnë për të shitur ndonjë gjë të vogël që mund ta shesin në dyqanin e konsumit në fshat. Të tillë që humbasin interesin e tyre nuk janë pak, për shkak të disa traditave jo të mira dhe për mungesë të disiplinës në punë. Prandaj në këtë drejtim Partia të mobilizohet si duhet që viti i ardhshëm të jetë një vit i mbarë dhe të mundim të plotësojmë deficitet e këtyre katër vjetëve. Në këtë mënyrë të vemi në Kongresin IV të Partisë me ballë hapët, t'i themi popullit se planet që vendosëm, Partia i realizoi, t'i themi gjithashtu edhe arsytet për ato që nuk janë realizuar. Po gjithnjë duhen bërë sa më shumë përpjekje që sa të jetë e mundur t'i mbulojmë deficitet. Prandaj qysh tani të fillohet nga përgatitjet për vitin e ardhshëm.

Në Sekretariatit e Komitetit Qendror ne morëm një vendim që në tremujorin e parë të ndihmojmë të gjitha kooperativat bujqësore të vendit. Për këtë qëllim nga qendra do të dërgohen ekipe për të detajuar planet e çdo kooperative për vitin 1960, për të diskutuar me ju mundësitë e brendshme dhe për të marrë masa për shfrytëzimin e tyre si dhe për t'i ndihmuar kooperativat për hartimin e planit të tretë pesëvjeçar. Në këto ekipe do të marrin pjesë të gjithë punonjësit që merren me bujqësi, duke filluar që nga Komiteti Qendror i Partisë dhe qeveria, nga Komisioni i Planit të Shtetit, nga Ministria e Financave, nga Shkolla e Partisë e deri te shkollat e mesme dhe të larta të bujqësisë e nga komitetet e Partisë në rrethe. Të gjithë do të organizohen nëpër ekipe komplekse, në mënyrë që t'ju ndihmojnë gjatë tremujorit të parë për çështjen e bujqësisë, për hartimin dhe zbatimin e planeve dhe të bëjmë që të na shkojë viti mbarë.

Megjithëse mund të duket shpejt, por duhet që tani të merren masa për t'u përgatitur për mbjelljet pranverore, për sigurimin dhe mbjelljen e farës së duhanit etj. Keni parasysh se deficite kemi në mbjelljet e këtij viti bujqësor ngaqë nuk arritëm të realizojmë planin e mbjelljeve në vjeshtë. Këto deficite në punimin e tokave duhet t'i plotësojmë me doemos në pranverë. Prandaj në këtë drejtim duhet të jepet një ndihmë e madhe.

Unë kam bindjen se planet tona janë të realizueshme, sepse te fshatarësia jonë shohim një zgjim të madh, shohim një hov të madh për të ecur përpara, shohim nga dita në ditë shumë ndryshime në mentali-

tetin e tyre. Tani p.sh. nuk mund të flitet më për gjerdhe; kjo çështje që ishte problem para dy-tre vjetësh tani i takon vetëm së kaluarës. Tani fshatari e ka kuptuar rëndësinë e madhe të bashkimit të forcave dhe të tokës, ai tani mendon të vejë e të bëhet edhe punëtor në ndërmarrjet shtetërore. Kjo është përparimtare për fshatarin tonë që ka qenë kurdoherë aq i lidhur me tokën, kjo tregon besimin e tij të madh te klasa punëtore, se e di që toka është në duart e shtetit dhe shteti është i tij pra edhe toka është e tij. Me një fjalë ne kemi një fshatarësi shumë të mirë, që është plotësisht e gatshme të ecë krah për krah me klasën punëtore. Por ashtu si punon me çdo njeri Partia, veçanërisht me fshatarësinë duhet të tregojë durim të madh. Ne të jemi të sigurtë se fshatarësia na kupton, ajo i përqafton vendimet e Partisë dhe punon për zbatimin e tyre, vetëm duhet organizim i mirë i punës. Kjo do të luajë rolin kryesor për përparimin e shpejtë të bujqësisë në vendin tonë.

\* \* \*

Sukseset e mëdha që kemi arritur kanë bërë që situata politike në vendin tonë të jetë e fortë. Shqipëria ka një situatë politike të brendshme dhe të jashtme të fortë, të palëkundshme. Këtë e bëri vija e drejtë që ka ndjekur dhe ndjek Partia jonë, e bëri uniteti i ngushtë i popullit rreth Partisë.

Situata ndërkombëtare tani është e favorshme, po kurdoherë duhet të jemi vigjilentë se kemi të bëjmë

me imperialistët, të cilët janë të pamëshirshëm kundër popujve, komunizmit dhe vendeve tona. Çdo hap yni duhet të jetë i matur, se imperialistët do të bëjnë çdo gjë për të na penguar në rrugën tonë dhe për të gënjyer. Imperializmi ka veglat e tija për ta bërë këtë, po duhet të dijë një gjë që komunistëve, të cilët ia njohin fytyrën dhe maskat e tija, nuk ua hedh dot. Komunizmi tashmë nuk është i ri, ai ka kaluar nga shumë luftëra dhe vështirësi dhe e kupton qëllimin e mbuluar me maska të bukura të imperialistëve. Imperialistët mund «t'u buzëqeshin» popujve, mund t'u japin disa kredi më tepër qeverive të disa vendeve, bile me fajde edhe më të ulët nga sa e jepte përpara, por popujt duhet të dinë se ç'fshihet nën këto «buzëqeshje» e kredi. Dollari, ka thënë Lenini, kullon gjak nga i punëtorëve.

Këtë gjë e di fare mirë edhe udhëheqja revizioniste jugosllave, por asaj i pëlqejnë dollarët amerikanë dhe vazhdon t'i marrë. Revizionistët jugosllavë janë bashkëpunëtorët më të zellshëm të imperialistëve. Ata janë shërbëtorët më besnikë të tyre megjithëse përpiqen të maskohen në këtë punë të ndyrë. Revizionistët jugosllavë me fjalë janë «komunistë», «leninistë», dhe përpiqen me çdo mjet të maskojnë dredhitë dhe tradhtinë e tyre. Në politikën ndërkombëtare ata thonë se në shumë çështje «janë dakord» me politikën e kampit tonë. Por kur vjen çështja në praktikë, gjëja e parë që bën gjithë udhëheqja revizioniste jugosllave është propaganda e shfrenuar kundër kampit tonë, sidomos kundër Shqipërisë. Këtë veprimtari ata nuk e bëjnë fshehurazi. Parullat e përgjithshme ata përpiqen t'i adaptojnë në disa situata me politikën tonë, po ata



flasin hapur kundër vendeve tona ashtu siç bënë në mbledhjen e fundit të përfaqësuesve të vendeve koloniale në Beograd, ku bashkë me përfaqësuesit e ish-vendeve koloniale ishin edhe përfaqësuesit e Anglisë dhe të Shteteve të Bashkuara. Kundër imperializmit amerikan revizionistët jugosllavë jo vetëm e kanë pushuar me kohë luftën, por ushqehen me dollarë prej tij dhe u rekomandojnë edhe vendeve të tjera të veprojnë si ata. Ja deri ku ka arritur tradhtia e revizionistëve jugosllavë ndaj socializmit.

Kuptohet sa vlerë kanë parullat për çështjet e politikës së jashtme që revizionistët jugosllavë pretendojnë se janë «dakord» me ne dhe nga e cila degë përpiqen të varen për të hyrë në kalanë tonë të marksizëm-leninizmit. Ne i kuptojmë mirë këto taktika të revizionistëve të Beogradit se kemi 18 vjet që i kemi hequr në kurriz, i kemi parë ata edhe në situatat kur «na buzëqeshnin» me hipokrizi, pastaj edhe në qëndrimet e tyre të egra kundër nesh që po i vazhdojnë edhe sot e kësaj dite me të madhe, kundër doktrinës sonë marksiste-leniniste.

Po tani është fakt se ata janë izoluar. Këtë ata po e ndjejnë dita - ditës më shumë, prandaj bëjnë përpjekje që ne të heshtim, të mos flasim më për ta dhe pastaj me dredhi të na hyjnë si «kali i Trojës». Marksizëm-leninizmi i ka përcaktuar qartë metodat e luftës kundër revizionizmit dhe Partia jonë, duke i zbatuar këto me përpikëri, e ka për detyrë që këta armiq të komunizmit t'i luftojë e t'i demaskojë dhe të mos i lejojë ata që për hir «të pajtimit», jo në rrugën marksiste, të bëjnë punën e tyre minuese dhe shkatërrimtare siç bënë

kundër Hungarisë, siç bënë dhe vazhdojnë të bëjnë kundër Partisë sonë, siç bënë dhe vazhdojnë të bëjnë kundër kampit të socializmit dhe gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Por qëllimit të tyre ata nuk do t'ia arrijnë kurrë, sepse partitë marksiste-leniniste të vendeve tona janë shumë vigjilente dhe në unitet midis tyre. Manevrat e revizionistëve jugosllavë kundër Partisë dhe vendit tonë nuk do të pinë kurrë ujë.

Perspektivat e situatës ndërkombëtare janë të mira dhe ato ndihmojnë edhe për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së vendit tonë dhe në veçanti të bujqësisë sonë. Me vendet miq ne koordinojmë planet tona. Për zhvillimin e bujqësisë ne kemi kushte shumë të favorshme. Klima dhe toka janë faktorë të rëndësishëm për këtë, ato favorizojnë zhvillimin e kulturave që sjellin mjaft të ardhura që janë deficitare në vendet e kampit tonë dhe popullit tonë i sjellin të ardhura të mëdha. Këto do të bëhen realitet në pesëvjeçarin e tretë. Juve ju kanë udhëzuar të punoni për përgatitjen e këtij pesëvjeçari. Tani do t'ju vijë edhe direktiva të reja për zhvillimin e bujqësisë në vendin tonë, pasi kjo çështje u muar përsëri në shqyrtim për t'i dhënë një hov të mëtejshëm zhvillimit të drithërave, perimeve dhe frutave.

Ne shohim, pra, se vendi ynë është i fortë politikisht dhe ekonomikisht. Kemi arritur deri tani plot suksese dhe akoma suksese të tjera më të mëdha do të korrin në të ardhshmen. Planet tona janë reale, ato ne do t'i realizojmë, gjë që do të bëjë të përmirësohet vazhdimisht jetesa e popullit.

Rëndësi të madhe ka mbi të gjitha fakti që Partia

jonë është monolite dhe e fortë si çeliku, Parti të cilën populli e do si shpirtin dhe me të cilën është i lidhur si mishi me thoin. Kjo është garancia vendimtare e përparimit të vendit tonë me hapa të mëdhenj. Prandaj ne, në këto situata, si komunistë, kemi detyra të rëndësishme përpara popullit tonë, prandaj duhet çdo orë dhe çdo ditë të mendojmë për këto probleme jetike, për zbatimin e tyre dhe të mësojmë për t'i vënë në jetë ato sa më mirë e sa më shpejt. Të kuptojmë si duhet direktivat e Partisë dhe t'i zbatojmë ato në jetë, të mobilizojmë gjithë popullin për to.

Këto janë detyrat që i vihen përpara popullit tonë e që ne do t'i kryejmë me siguri deri në fund, në interes të popullit, për t'i siguruar atij rrugën për në socializëm dhe në komunizëm.

Ju uroj, shokë, nga zemra vitin e ri 1960. Të jetë ky vit i gëzuar dhe i lumtur, për popullin, për Partinë dhe për ju personalisht, të jetë një vit plot suksese për ne dhe për miqtë tanë!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN 17 ..... V—VIII

1959

TË BËJMË BASHKIME TË KOOPERATIVAVE BUJ- QËSORE TË VOGLA, POR NË RADHË TË PARË TË PUNOJMË PËR TË FORCUAR KOOPERATIVAT EKZISTUESE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Po- litike të KQ të PPSH (16 shkurt 1959) .....	1—6
TË REALIZOJMË ME SUKSES DHE PARA AFATIT PLANIN E SHTETIT PËR VITIN 1959 — Nga raporti në Plenumin XIII të KQ të PPSH (18 shkurt 1959) ..	7—21
TË ORGANIZOJMË DHE TË ZHVILLOJMË MË MIRË PUNËN SHKENCORE NË UNIVERSITETIN SHTE- TËROR TË TIRANËS — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (20 shkurt 1959) ..	22—24
NGA FJALA NË SESIONIN III TË LEGJISLATU- RËS SË KATËRT TË KUVENDIT POPULLOR TË RPSH (3 mars 1959) .....	25—43
ÇËSHTJET ORGANIZATIVE TË PARTISË JANË ÇËSHTJE TË TË GJITHË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (9 mars 1959)	44—48
PARTIA TË INTERESOHET AKOMA MË SHUMË PËR EDUKIMIN E RINISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (10 mars 1959) ....	49—51

NGA FJALA NË KONFERENCËN E PARTISË TË QYTETIT TË TIRANËS (15 mars 1959) .....	52—81
MBI RRITJEN E VIGJILENCËS REVOLUCIONARE, PËR RUAJTJEN E SEKRETIT SHETËTOR E TË PARTISË — Letër gjithë organizatave-bazë të Partisë në terren, në ushtri dhe në repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme (28 mars 1959) .....	82—90
GJITHÇKA PËR MIREQENIEN E POPULLIT — KY ËSHTË QËLLIMI I PARTISË SONË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (8 prill 1959) .....	91—95
T'I JEPET PRIORITET EDUKIMIT IDEOPOLITIK TË PUNËTORËVE DHE TË RINISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 prill 1959)	96—98
KRYEARTIKUJT E SHTYPIT TONË TË JENË SA MË KONRETË, EDUKATIVË, TEORIKË DHE PRAKTIKË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 prill 1959) .....	99—102
RUAJTJA E SEKRETIT TË PARTISË DHE SHQYRTIMI I LETRAVE TË POPULLIT — DETYRA TË RËNDESESISHME PËR TË GJITHË NE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 prill 1959)	103—106
MBI SHPEJTIMIN E QARKULLIMIT DHE ULJEN E NORMATIVAVE TË MJETEVE TË XHIROS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 prill 1959) .....	107—110
TË SHPEJTOJMË PUNËN PËR BONIFIKIMIN E TOKAVE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 prill 1959) .....	111—114
TË FORCOHET PUNA PËR REALIZIMIN E PLANIT TË NAFTËS DHE SHPIM-SHFRYTËZIMIN E PU-	

SEVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 prill 1959) .....	115—117
TË NXJERRIM MËSIMI PËR FORCIMIN E KOOPE- RATIVAVE BUJQËSORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 prill 1959) ....	118—122
MBI DISA ÇËSHTJE LIDHUR ME RUAJTJEN E SE- KRETIT, ADMINISTRIMIN E KORRESPONDENCËS DHE SHQYRTIMIN E LETRAVE E TË ANKESAVE — Letër komiteteve të Partisë në rrethe (30 prill 1959)	123—130
SHËNIME TË MBAJTURA GJATË TAKIMIT ME SHQIPTARËT E MËRGUAR, PËRFAQËSUES TË SHO- QËRISË PATRIOTIKE «SKËNDI» «U» (4 maj 1959)	131—166
TË KUJDESEMI NË MËNYRË MË TË ORGANIZUAR PËR BUJQËSINË — Diskutim në mbledhjen e Sekre- tariatit të KQ të PPSH (5 maj 1959) .....	167—169
KOMUNISTI ËSHTË UDHËHEQËS I MASAVE — Dis- kutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 maj 1959) .....	170—172
TA SHPIEM MË PËRPARA PUNËN E PARTISË ME GRUAN — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 maj 1959) .....	173—176
MBI DISA PROBLEME TË HISTORISË SË SHQI- PËRISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (6 maj 1959) .....	177—184
MBI DISA ANKESA PËR TË MOS U LARGUAR NGA QYTETI NË FSHAT DHE KËRKESA PËR T'U LARGUAR NGA FSHATI NË QYTET — Letër komite- teve të Partisë në rrethe (16 maj 1959) .....	185—188
MBI DISA ÇËSHTJE TË KOOPERATIVAVE BUJ- QËSORE — Letër komiteteve të Partisë në rrethe (18 maj 1959) .....	189—198

FLOTA LUFTARAKO-DETARE DHE AVIACIONI — DY ARMË TË FUQISHME PËR MBROJTJEN E AT- DHEUT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (11 qershor 1959) .....	199—202
MË SHUMË FORMA PËR ZHVILLIMIN E EMULA- CIONIT SOCIALIST — Diskutim në mbledhjen e Se- kretariatit të KQ të PPSH (11 qershor 1959) .....	203—205
SHKOLLAT DYVJEÇARE TË PUNËTORËVE, NË KUSHTET E SOTME, JANË FIDANISHTE PËR TË PREGATITUR TEKNIKË TË MESËM — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ, të PPSH (11 qershor 1959) .....	206—208
NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË KOOPERATIVËN BUJQËSORE TË SOFRATIKËS, LOKALITETI I DROPULLIT TË POSHTËM (19 qer- shor 1959) .....	209—224
NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR ME RASTIN E INAUGURIMIT TË KANALIT TË ÇUKËS (21 qershor 1959) .....	225—239
NGA FJALA NË TAKIMIN ME KUADROT DHE PLE- NUMIN E KOMITETIT TË PARTISË TË RRETHIT GJIROKASTËR (24 qershor 1959) .....	240—270
NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË KUÇ ME RASTIN E 15-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË KRAHINËS SË KURVELESHIT (25 qershor 1959)	271—286
PËRSHËNDETJE NXËNËSVE DHE PEDAGOGËVE TË SHKOLLËS SË PARTISË «V. I. LENIN» ME RAS- TIN E PËRVJETORIT TË THËMELIMIT TË SHKO- LLËS (16 shtator 1959) .....	287—291
TELEGRAM KOMISIONIT TË FESTIMIT TË 15-VJE- TORIT TË ÇLIRIMIT TË GJIROKASTRËS (17 shta- tor 1959) .....	292—293



NGA FJALA NË MITINGUN E ORGANIZUAR NË KATUNDIN BICAJ ME RASTIN E 16-VJETORIT TË THEMELIMIT TË ÇETËS SË LUMËS (20 shtator 1959)	294—314
TË SHFRYTËZOJMË MË MIRË GJITHË MAKINERINË E SEKTORËVE EKONOMIKË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 shtator 1959)	315—319
TË LUFTOHET KUNDËR LIBERALIZMIT NË DREJTIM TË PËRVETËSIMIT E TË SHPËRDORIMIT TË PASURISË SOCIALISTE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (30 shtator 1959)	320—322
FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA E RP TË KINËS ME RASTIN E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT TË RP TË KINËS (1 tetor 1959)	323—327
NGA FJALA NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA E RD GJERMANE ME RASTIN E 10-VJETORIT TË THEMELIMIT TË RD GJERMANE (7 tetor 1959)	328—332
MBI PËRHAPJEN E INISIAIVËS SË KOLEKTIVIT PUNONJËS TË KOMBINATIT TË TEKSTILEVE «STALIN» PËR KURSIMITIN E LËNDËS SË PARË — Letër komiteteve të Partisë në rrethe (16 tetor 1959)	333—336
LETËR QYTETARIT SOVJETIK A. MUROMCJEV (21 tetor 1959)	337—338
TË PËRMIRËSOHET MË TEJ PUNA E PARTISË NË DIKASTERE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 tetor 1959)	339—342
POPULLI TË FURNIZOHET MIRË DHE LIRË ME PERIME E FRUTA — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 tetor 1959)	343—346
LETËR ORGANIZATËS SË BRPSH TË REPARTIT USHTARAK NR. 217 (23 tetor 1959)	347—353

MBI ZGJERIMIN E INISIATIVËS SË HEROIT TË PUNËS SOCIALISTE, TRAKTORISTIT BUDO ISUFI — Thirrje traktoristëve të Shqipërisë (24 tetor 1959)	354—356
REVIZIONISTËT JUGOSLLAVË TREMBEN NGA E VËRTETA (31 tetor 1959)	357—364
FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN XIV TË KQ TË PPSH (3 nëntor 1959)	365—386
NË SHQIPËRI NUK KA VEPËR QË TË MOS KETË EDHE VULËN E HEROIZMIT E TË VETËMOHIMIT TË VAJZAVE E TË GRAVE TONA (8 nëntor 1959)	387—393
FJALA NË SHKOLLËN E BASHKUAR TË OFICERËVE «ENVER HOXHA» (8 nëntor 1959)	394—404
TË MOS ULIM SHIFRAT E PLANIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (16 nëntor 1959)	405—409
FRYMA E KURSIMIT DUHET TË ZOTËROJË KUDO — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 nëntor 1959)	410—412
SHPËRBLIMET TË JEPEN NË RRUGË TË DREJTË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (17 nëntor 1959)	413—416
GAZETAT TONA TË MBËSHTETEN MË SHUMË NË KORRESPONDENTËT VULLNETARË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 nëntor 1959)	417—419
KRYESORJA PËR BIBLIOTEKAT ËSHTË ÇËSHTJA E KUADRIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 nëntor 1959)	420—422
POPULLI KA NEVOJË TË SHOHË MË SHUMË FILMA — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 nëntor 1959)	423—426

NGA FJALA NË MBLEDHJEN SOLEMNE ME RASTIN E 15-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË SHQIPËRISË (28 Nëntor' 1959) .....	427—475
MESAZH DREJTUAR NXËNËSVE DHE PEDAGOGEVE TË SHKOLLËS PEDAGOGJIKE «LUIGJ GURAKUQI» NË ELBASAN ME RASTIN E 50-VJETORIT TË THEMELIMIT TË SHKOLLËS (30 nëntor 1959) .....	476—479
DITURIA DHE KULTURA NË SHQIPËRINË E RE SOCIALISTE JANË BËRË TË MASAVE — Fjala në konferencën kombëtare për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës në fshat (16 dhjetor 1959) .....	480—515
LETËR URIMI REDAKSISË SË GAZETËS «PIONIERI» ME RASTIN E 15-VJETORIT TË BOTIMIT TË GAZETËS (16 dhjetor 1959) .....	516—517
PARTIA NË USHTRI KËRKON DISIPLINË TË NDËRGJEGJSHME — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (18 dhjetor 1959) ....	518—520
FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN XV TË KQ TË PPSH (23 dhjetor 1959) .....	521—537
FJALA NË AKTIVIN E PARTISË TË RRETHIT TË ELBASANIT ME RASTIN E PUNIMIT TË MATERIALEVE TË PLENUMIT XIV TË KQ TË PPSH (28 dhjetor 1959) .....	538—569